

# **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR ARSIMIN**

*Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare*

**Tetor 2010**

© i këtij botimi Qendra e Publikimeve Zyrtare

ISBN: 978-9928-01-007-0

## PËRMBAJTJA

### PËR ARSIMIN

Ligj nr.7952 datë 21.6.1995	Për sistemin arsimor parauniversitar <i>ndryshuar me:</i> - ligjin nr.8337, datë 30.7.1998 - ligjin nr.8872, datë 29.3.2002 - ligjin nr.9903, datë 17.4.2008 - ligjin nr.9985, datë 11.9.2008	17
Vendim i KM nr.396 , datë 22.8.1994	Për arsimin 8-vjeçar në gjuhën amëtare të personave të pakicave <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.502, datë 5.8.1996	30
Vendim i KM nr.78, datë 8.2.2006	Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.323, datë 30.5.2007; - vendim të KM nr.262, datë 27.2.2008 - vendim të KM nr.156, datë 11.2.2009	31
Vendim i KM nr.134, datë 8.3.2006	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, si shkollë e mesme e përgjithshme, e profilizuar “Memorial International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze	33
Vendim i KM nr.247, datë 27.4.2006	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, cikël i lartë “Amaro Tan”, që do të zhvillojë në programin mësimor edhe lëndë fetare	33
Vendim i KM nr.266, datë 5.5.2006	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor, privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Omios”	34
Vendim i KM nr.841, datë 13.12.2006	Për pagesën e anëtarëve, në përbërje të komisioneve për vlerësimin, miratimin dhe certifikimin e teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera ndihmëse, në sistemin arsimor parauniversitar <i>ndryshuar me:</i> -vendim të KM nr.71, datë 7.2.2007	34
Vendim i KM nr.135, datë 14.3.2007	Për krijimin e agjencisë qendrore të vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe për shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të vlerësimit dhe të provimeve <i>ndryshuar me:</i> -vendim të KM nr.630, datë 29.9.2007	35
Vendim i KM nr.569, datë 5.9.2007	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze	37
Vendim i KM nr.579, datë 5.9.2007	Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze	37
Vendim i KM nr.502, datë 16.4.2008	Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.1710, datë 29.12.2008	38
Vendim i KM nr.743, datë 1.7.2009	Për dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar, shkollë e mesme “Kryqi i nderuar”	41
Vendim i KM nr.799, datë 22.7.2009	Për miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit parauniversitar, për periudhën 2009-2013	42

Vendim i KM nr.879, datë 12.8.2009	Për dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, gjimnazi “Linz”, në qytetin e Tiranës	83
Vendim i KM nr.1067, datë 21.10.2009	Për dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollës 9-vjeçare, të ciklit të lartë “Hafiz Abdulla Zëmbaku”, që në programin mësimor do të zhvillojë edhe lëndë fetare	83
Vendim i KM nr.56, datë 3.2.2010	Për krijimin e Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar	84
Vendim i KM nr.66, datë 3.2.2010	Për riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore	85
Vendim i KM nr.67, datë 10.2.2010	Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA)	86
Vendim i KM nr.107, datë 10.2.2010	Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar	87
Udhëzim i MASH nr.41, datë 9.11.2006	Për zgjedhjen e literaturës ndihmëse, joartistike, në shkollat e arsimit parauniversitar	89
Udhëzim i MASH nr.26, datë 7.9.2007	Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare	90
Udhëzim i MASH nr.39, datë 16.10.2007	Për shpërndarjen e formularëve A2/1 në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore	95
Udhëzim i MASH nr.2, datë 10.1.2008	Për vjetërsinë e punës në arsim	96
Udhëzim i MASH nr.3, datë 10.1.2008	Për organizimin e kualifikimit për punonjësit që kanë vjetërsinë e duhur në arsimin parauniversitar për vitin mësimor 2007– 2008	97
Udhëzim i MASH nr.22, datë 29.5.2008	Për përdorimin e fondeve të planifikuara për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që mësojnë e punojnë larg vendbanimit të tyre	99
Udhëzim i MASH nr.25, datë 7.7.2008	Për kriteret profesionale dhe procedurat e konkursit për zgjedhjen e trembëdhjetë anëtarëve ekspertë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar <i>ndryshuar me: - udhëzim nr.28, datë 28.7.2008</i>	100
Udhëzim i MASH nr.22, datë 18.8.2009	Për përdorimin e fondeve të trajnimit të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar	101
Udhëzim i MASH nr.32, datë 26.10.2009	Për regjistrimin dhe vlerësimin e nxënësve që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë	102
Udhëzim i MASH nr.34, datë 2.11.2009	Për organizimin e veprimtarive në shërbim të nxënësve në arsimin parauniversitar	103
Udhëzim i MASH nr.2, datë, 6.1.2010	Për zbatimin e kurrikulës së klasës X	104
Udhëzim i MASH nr.3, datë 3.2.2010	Për normat e punës mësimore në arsimin parauniversitar dhe standarde të lidhura me to <i>ndryshuar me - udhëzim nr.5, datë 13.2.2010</i>	105

Udhëzim i MASH nr.7, datë 25.2.2010	Për përfundimin e vitit shkollor 2009-2010 dhe për zhvillimin e provimeve të lirim të sistemit të arsimit parauniversitar	108
Udhëzim i MASH nr.8, datë 25.2.2010	Për përfundimin e vitit shkollor 2009-2010 dhe për zhvillimin e provimeve përfundimtare dhe provimeve të maturës shtetërore, në sistemin e arsimit parauniversitar	109
Udhëzim i MASH nr.17, datë 29.6.2010	Për strukturën dhe planet mësimore në arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2010-2011	111
<b>ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL</b>		
Ligj nr.8872 datë 29.3.2002	Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë <i>ndryshuar me:</i> <i>- ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008</i>	122
Vendim i KM nr.690, datë 7.10.1996	Për krijimin, evidencimin dhe administrimin e të ardhurave që realizojnë qendrat e formimit profesional nga shërbimet që ato u ofrojnë të tretëve	131
Vendim i KM nr.411, datë 1.7.1998	Për krijimin e qendrës së formimit profesional të personelit të burgjeve	132
Vendim i KM nr.543, datë 31.10.2002	Për akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional (AFP)	132
Vendim i KM nr.616, datë 4.12.2002	Për përcaktimin e kategorive të tjera të grupeve të veçanta që përfitojnë nga ligji nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"	134
Vendim i KM nr.196, datë 20.3.2003	Për standardet e zhvillimit të kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional	135
Vendim i KM nr.675, datë 25.9.2003	Për përcaktimin e procedurave të krijimit, organizimit dhe mbylljes së institucioneve të formimit profesional, në varësi të Ministrisë së Punëve dhe të Çështjeve Sociale	136
Vendim i KM nr.808, datë 4.12.2003	Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit <i>ndryshuar me:</i> <i>-vendim të KM nr.736, datë 1.7.2009</i>	143
Udhëzim i MASH nr.6, datë 14.3.2003	Për regjistrimin e institucioneve të AFP-së	144
Udhëzim i MASH&MPÇS nr.17, datë 1.9.2003	Për përbërjen, organizimin dhe funksionet e komisionit të akreditimit të arsimit dhe formimit profesional	144
Urdhër i MPPTT nr.47, datë 29.3.2010	Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit"	145
Ligj nr.9557 datë 8.6.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Marrëveshjen kuadër për bashkëpunimin ndërmjet shteteve frankofone të Europës Qendrore dhe Lindore për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik"	165
Vendim i KM nr.273, datë 10.5.2006	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional	168
Udhëzim i MASH nr.1457, datë 28.7.2009	Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licencim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional	169

## ARSIMI I LARTË

Ligj nr.9741 datë 21.5.2007	Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë <i>ndryshuar me:</i> - <i>ligjin nr.9832, datë 12.11.2007</i> - <i>vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.3.2008</i> - <i>ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010</i>	171
Ligj nr.8834 datë 22.11.2001	Për ratifikimin e “Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë” (Lisbonë, 1997)	209
Vendim i KM nr.327, datë 17.5.2001	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë shqiptare dhe qeverisë maqedonase për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës	222
Ligj nr.9756, datë 18.6.2007	Për ratifikimin e “Programit për bashkëpunimin në fushën e arsimit, shkencës dhe kulturës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Bullgarisë për periudhën 2007-2009”	226
Vendim i KM nr.560, datë 12.8.2005	Për miratimin e kuotave të pranimeve në universitetet dhe shkollat e larta për vitin akademik 2005-2006, në sistemin me kohë të plotë, si dhe për përcaktimin e tarifave të shkollimit për këtë vit akademik <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.596, datë 22.9.2005</i>	232
Vendim i KM nr.28, datë 24.1.2007	Për përbërjen e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.1248, datë 11.12.2009</i>	242
Vendim i KM nr.467, datë 18.7.2007	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.91, datë 10.2.2010</i>	243
Vendim i KM nr.824, datë 5.12.2007	Për krijimin e disa njësive kryesore, fakultete në Universitetin Politeknik të Tiranës <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.345, datë 8.4.2009</i>	249
Vendim i KM nr.864, datë 5.12.2007	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “doktor” <i>ndryshuar me:</i> - <i>vendim të KM nr.877, datë 18.6.2008;</i> - <i>vendim të KM nr.103, datë 17.2.2010</i>	250
Vendim i KM nr.259, datë 27.2.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”	252
Vendim i KM nr.281, datë 12.3.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Epoka””	254
Vendim i KM nr.466, datë 16.4.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “ISSAT”	255
Vendim i KM nr.503, datë 16.4.2008	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në institucionet e arsimit të lartë	256
Vendim i KM nr.633, datë 23.5.2008	Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë	257
Vendim i KM nr.828, datë 4.6.2008	Për miratimin e rregullores “Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të arsimit të lartë dhe Shkencës”	258

Vendim i KM nr.830, datë 4.6.2008	Për licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e lartë “NEHEMIA””	264
Vendim i KM nr.875, datë 18.6.2008	Për përcaktimin e të drejtave e të detyrave dhe për procedurën e përzgjedhjes e të emërimit të kancelarit të institucioneve publike të arsimit të lartë	266
Vendim i KM nr.1037, datë 2.7.2008	Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009	267
Vendim i KM nr.1133, datë 5.8.2008	Për licencimin e institucionit të arsimit të lartë, privat “Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë”	276
Vendim i KM nr.1288, datë 24.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, në vitin akademik 2008-2009	277
Vendim i KM nr.1289, datë 24.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit “Fan S.Noli”, Korçë, në vitin akademik 2008-2009	277
Vendim i KM nr.1290, datë 24.9.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, pranë universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në vitin akademik 2008-2009	278
Vendim i KM nr.1509, datë 30.7.2008	Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin e lartë, 2008-2013	279
Vendim i KM nr.1549, datë 19.11.2008	Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2008-2009	307
Vendim i KM nr.23, datë 14.1.2009	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë, dhe miratimin e kuotave të pranimi e të tarifës së shkollimit për këto programe, në Universitetin e Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	312
Vendim i KM nr.29, datë 14.1.2009	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të dytë, dhe për miratimin e kuotave të pranimi e të tarifës së shkollimit për këto programe, në Universitetin e Tiranës, fakulteti i ekonomisë, për vitin akademik 2008-2009	314
Vendim i KM nr.74, datë 21.1.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, të ciklit të dytë, në shkollën e lartë universitare private “Universiteti European i Tiranës”	315
Vendim i KM nr.92, datë 27.1.2009	Për kalimin e përgjegjësisë së administrimit të kinoklubit “Studenti” nga “Trajtimi i studentëve, nr.1”, sh.a., Tiranë, Universitetit të Tiranës, për fakultetin e drejtësisë	316
Vendim i KM nr.96, datë 27.1.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë në shkollën e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti””	317
Vendim i KM nr.97, datë 27.1.2009	Për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë”, për përcaktimin e kuotave të pranimi e të tarifës së shkollimit në këtë program studimi, në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, në vitin akademik 2008-2009	318
Vendim i KM nr.135, datë 11.2.2009	Për mbylljen e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari” dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit	319
Vendim i KM nr.176, datë 19.2.2009	Për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë”, për përcaktimin e kuotave të pranimi e të tarifës së shkollimit në këtë program studimi, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në vitin akademik 2008-2009	320

Vendim i KM nr.279, datë 12.3.2009	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës private të arsimit të lartë, “Pavarësia”	321
Vendim i KM nr.331, datë 25.3.2009	Për ndarjen në nivele, brenda kategorive, të personelit akademik, në institucionet e arsimit të lartë, emërtimin e renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për secilin vend pune	322
Vendim i KM nr.516, datë 13.5.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.220, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, për periudhën janar-qershor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës”	325
Vendim i KM nr.564, datë 28.5.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit “Master i nivelit të dytë”, pranë shkollës së lartë universitare, private “Universiteti Marin Barleti”	329
Vendim i KM nr.615, datë 11.6.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në akademinë e arteve, në universitetin “ Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe në universitetin “ Fan S. Noli”, Korçë	331
Vendim i KM nr.619, datë 11.6.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	331
Vendim i KM nr.620, datë 11.6.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, në universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan	332
Vendim i KM nr.621, datë 11.6.2009	Për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në universitetin “ Aleksandër Xhuvani” Elbasan	333
Vendim i KM nr.675, datë 18.6.2009	Për hapjen e filialit të universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, në qytetin e Pogradecit	334
Vendim i KM nr.686, datë 18.6.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në fakultetin e drejtësisë, në Universitetin e Tiranës <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.1278, datë 23.12.2009 - vendim të KM nr.182, datë 10.3.2010	334
Vendim i KM nr.695, datë 18.6.2009	Për hapjen e programit të studimit të doktoratës, në fakultetin e teknologjisë së informacionit, në Universitetin Politeknik të Tiranës	335
Vendim i KM nr.696, datë 18.6.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.1279, datë 23.12.2009	336
Vendim i KM nr.697, datë 18.6.2009	Për hapjen e filialit të universitetit privat “Ufo University”, në qytetin e Beratit	337
Vendim i KM nr.793, datë 22.7.2009	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Universiteti i Tiranës Qendrës së Studimeve Albanologjike, të palestrës sportive të UT- së	338
Vendim i KM nr.796, datë 22.7.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit “Master i nivelit të dytë”, pranë shkollës së lartë universitare, private “Universiteti European i Tiranës”	345
Vendim i KM nr.802, datë 22.7.2009	Për hapjen e programit të përbashkët rajonal të studimit “Master në “Eu Business Law””, në fakultetin e drejtësisë të Universitetit të Tiranës <i>ndryshuar me:</i> -vendim të KM nr.1051, datë 23.10.2009	347



Vendim i KM nr.803, datë 22.7.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në matematikë, në fakultetin e shkencave teknike të universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës	348
Vendim i KM nr.825, datë 29.7.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në fakultetin e mjekësisë veterinarë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe miratimin e kuotave dhe të tarifës për këtë program <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.1168, datë 25.11.2009 - vendim të KM nr.1281, datë 23.12.2009	349
Vendim i KM nr.826, datë 29.7.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Universitetin Bujqësor të Tiranës	349
Vendim i KM nr.827, datë 29.7.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Universitetin e Tiranës	351
Vendim i KM Nr.829, datë 29.7.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në fakultetin e muzikës të Akademisë së Arteve dhe miratimin e kuotave dhe të tarifave për këto programe <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.1070, datë 21.10.2009	352
Vendim i KM nr.832, datë 29.7.2009	Për mbylljen e disa programeve të studimit të Universitetit Ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, dhe transferimin e studentëve të këtij universiteti në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës	353
Vendim i KM nr.854, datë 5.8.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në fakultetin e shkencave sociale dhe në atë të mjekësisë të Universitetit të Tiranës <i>ndryshuar me:</i> -vendim të KM nr.1169, datë 25.11.2009 -vendim të KM nr.163, datë 3.3.2010	354
Vendim i KM nr.855, datë 5.8.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës, në fakultetin e gjeologjisë dhe minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës <i>ndryshuar me:</i> -vendim të KM nr.1167, datë 25.11.2009	356
Vendim i KM nr.856, datë 5.8.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë në “gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në universitetin “Fan S. Noli” të Korçës <i>ndryshuar me:</i> -vendim të KM nr.977, datë 8.10.2009	357
Vendim i KM nr.857, datë 5.8.2009	Për hapjen, në qytetin e Peshkopisë, të filialeve dhe të programeve të studimeve, të fakulteteve të ekonomisë e të administrimit dhe të shkollës së lartë profesionale, të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010 <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.912, datë 26.8.2009 - vendim të KM nr.978, datë 8.10.2009	358
Vendim i KM nr.864, datë 29.7.2009	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010	360
Vendim i KM nr.880, datë 12.8.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të parë”, në Universitetin Bujqësor të Tiranës	363
Vendim i KM nr.881, datë 12.8.2009	Për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në Universitetin e Tiranës	364
Vendim i KM nr.909, datë 26.8.2009	Për hapjen e programit të studimit, të ciklit të dytë, në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	364

Vendim i KM nr.910, datë 26.8.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në Universitetin Politeknik të Tiranës	365
Vendim i KM nr.911, datë 26.8.2009	Për licencimin e shkollës së lartë, private “Universiteti Planetar i Tiranës”	366
Vendim i KM nr.976, datë 8.10.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në “administrim dhe politikë sociale”, në fakultetin e shkencave sociale, e “bioteknologji”, në fakultetin e shkencave natyrore të Universitetit të Tiranës, si dhe për përcaktimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit për vitin akademik 2009-2010	367
Vendim i KM nr.984, datë 30.9.2009	Për kuotat e pranimit dhe tarifave të shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve dhe “master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010 <i>ndryshuar me:</i> -vendim të KM nr.1089, datë 4.11.2009 -vendim të KM nr.1101, datë 11.11.2009 -vendim të KM nr.1160, datë 25.11.2009 -vendim të KM nr.1280, datë 23.12.2009 -vendim të KM nr.358, datë 12.5.2010	368
Vendim i KM nr.999, datë 30.9.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i nivelit të parë”, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë	375
Vendim i KM nr.1000, datë 30.9.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i nivelit të parë”, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	376
Vendim i KM nr.1001, datë 30.9.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i nivelit të parë”, në Universitetin e Tiranës	376
Vendim i KM nr.1002, datë 30.9.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës	377
Vendim i KM nr.1003, datë 30.9.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, në universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë	378
Vendim i KM nr.1004, datë 8.10.2009	Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në gjuhën shqipe, në qendrën ndëruniversitare të studimeve albanologjike	378
Vendim i KM nr.1005 datë 8.10. 2009	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në fakultetin e inxhinierisë mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës	379
Vendim i KM nr.1006, datë 8.10.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në fakultetet e historisë e filologjisë, të gjuhëve të huaja dhe të shkencave natyrore të Universitetit të Tiranës	380
Vendim i KM nr.1068, datë 21.10.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i niveli të dytë”, në kimi dhe kimi industriale e mjedisore, në fakultetin e shkencave natyrore të Universitetit të Tiranës	381
Vendim i KM nr.1070, datë 21.10.2009	Për përcaktimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë”, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009-2010, dhe për një ndryshim në vendimin nr.829, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve dhe miratimin e kuotave dhe të tarifave për këto programe” <i>ndryshuar me:</i> - vendim të KM nr.439, datë 9.6.2010 -vendim të KM nr.69, datë 17.2.2010	382

Vendim i KM nr.1108,datë 28.10.2009	Për përcaktimin e numrit të punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, për periudhën 14 shtator – 31 dhjetor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës	385
Vendim i KM nr.1113,datë 13.11.2009	Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010	389
Vendim i KM nr.1161,datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi	397
Vendim i KM nr.1162,datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit në këto programe studimi	398
Vendim i KM nr.1163,datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në Universitetin e Tiranës dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit në këto programe studimi	399
Vendim i KM nr.1165, datë 25.11.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në “shkenca komunikimi”, në fakultetin e historisë dhe filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, për këtë program studimi	400
Vendim i KM nr.1166, datë 25.11.2009	Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në fakultetin e shkencave të natyrës të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit dhe të tarifës së shkollimit, në këto programe studimi	400
Vendim i KM nr.1170, datë 25.11.2009	Për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), dhe për miratimin e kuotës së pranimeve dhe të tarifës së shkollimit për këtë program studimi, në Universitetin e Tiranës	401
Vendim i KM nr.1182, datë 3.12.2009	Për hapjen e Institutit të Studimeve Europiane në Universitetin e Tiranës	402
Vendim i KM nr.1183, datë 3.12.2009	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në institutin e studimeve europiane në Universitetin e Tiranës dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe	403
Vendim i KM nr.1184, datë 3.12.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Tiranës dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit në këto programe	404
Vendim i KM nr.1185, datë 3.12.2009	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në fakultetin e inxhinierisë mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program	405
Vendim i KM nr.1211,datë 11.12.2009	Për miratimin e kuotave shtesë të pranimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë”, në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010	406
Vendim i KM nr.1212,datë 11.12.2009	Për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë dhe arsimin e mesëm, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi	407
Vendim i KM nr.1282, datë 23.12.2009	Për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në programet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata, në fakultetin e mjekësisë të Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2009 – 2010, shtojca nr.1	408

Vendim i KM nr.1300, datë 29.12.2009	Për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë” në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi	409
Vendim i KM nr.14, datë 7.1.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në fakultetin e shkencave të natyrës të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këtë program studimesh	410
Vendim i KM nr.15, datë 7.1.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në fakultetin e inxhinierisë së ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këtë program studimesh	410
Vendim i KM nr.16, datë 7.1.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në fakultetin e historisë dhe filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi	411
Vendim i KM nr.36, datë 27.1.2010	Për përcaktimin e numrit të punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar - 30 qershor 2010, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës	412
Vendim i KM nr.89, datë 10.2.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit pranë shkollës së lartë private “Ufo University”, Tiranë	413
Vendim i KM nr.90, datë 10.2.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private “Epoka”, Tiranë	415
Vendim i KM nr.123, datë 17.2.2010	Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës	415
Vendim i KM nr.124, datë 17.2.2010	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë	417
Vendim i KM nr.177, datë 10.3.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private “Sevasti & Parashqevi Qiriazi”, Tiranë	418
Vendim i KM nr.199, datë 24.3.2010	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në fakultetin e infermierisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këtë program studimesh	418
Vendim i KM nr.282, datë 21.4.2010	Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për programin mbështetës (AlbVET) për arsimin dhe trajnimin profesional shqiptar (ATP), faza II, korrik 2009-qershor 2011	419
Vendim i KM nr.284, datë 21.4.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në fakultetin e inxhinierisë elektrike dhe në atë të inxhinierisë së ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi	425
Vendim i KM nr.285, datë 28.4.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në histori, në fakultetin e historisë dhe të filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimesh	426
Vendim i KM nr.286, datë 28.4.2010	Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në gjeografi, në fakultetin e historisë dhe të filologjisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program studimesh	427
Vendim i KM nr.320, datë 5.5.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të objektit “Godina e konviktit” nga shoqëria “Trajtimi i studentëve nr.2” sh.a., Tiranë, te Universiteti i Sporteve të Tiranës	428

Vendim i KM nr.350, datë 12.5.2010	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë “Juridik”, “Shkenca kompjuterike”, “Sistemet e informacionit” dhe “Teknologji informacioni”, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës	428
Vendim i KM nr.351, datë 12.5.2010	Për hapjen e programit të studimeve, në “Filozofi sociale”, në fakultetin e mësuesisë të universitetit “Fan S.Noli”, Korçë, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këtë program studimesh	429
Vendim i KM nr.352, datë 12.5.2010	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në “Biologji-kimi”, “Histori-gjeografi” dhe “Cikël i ulët dhe anglisht në ciklin fillor” në universitetin “Fan S.Noli” Korçë	430
Vendim i KM nr.353, datë 12.5.2010	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të dytë në “Gjuhësi”, në fakultetin e shkencave humane të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, dhe për kuotën e pranimit e tarifën e shkollimit, në këtë program studimi	430
Vendim i KM nr.354, datë 12.5.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, në shkollën e lartë private “Sevasti&Parashqevi Qiriazzi”, Tiranë	431
Vendim i KM nr.355, datë 12.5.2010	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë “Inxhinieri ekonomike”, në Universitetin Politeknik të Tiranës	432
Vendim i KM nr.356, datë 12.5.2010	Për hapjen e programit të studimeve, master i nivelit të parë, në “Teknik imazheri”, në fakultetin e infermierisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit, në këtë program studimesh	432
Vendim i KM nr.357, datë 12.5.2010	Për licencimin e shkollës private të arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”, Tiranë	433
Vendim i KM nr.381, datë 12.5.2010	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë matematikë-financë, shkenca kompjutacionale dhe shkenca aktuaristike, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë	434
Vendim i KM nr.406, datë 26.5.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë	435
Vendim i KM nr.407, datë 26.5.2010	Për hapjen e filialit të shkollës së lartë private “Kristal”, në qytetin e Gjirokastrës	436
Vendim i KM nr.408, datë 26.5.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private “Ufo University”, Tiranë	437
Vendim i KM nr.440, datë 9.6.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë kolegjit profesional privat “New generation” (brezi i ri), Tiranë	438
Vendim i KM nr.490, datë 23.6.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimeve, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë	438
Vendim i KM nr.491, datë 23.6.2010	Për licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë	439
Vendim i KM nr.515, datë 30.6.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të parë në Universitetin e Sporteve të Tiranës	440
Vendim i KM nr.516, datë 30.6.2010	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	441
Vendim i KM nr.517, datë 30.6.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të parë në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	442

Vendim i KM nr.518, datë 30.6.2010	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë, “Teknologji informacioni”, në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë	442
Vendim i KM nr.568, datë 14.7.2010	Për hapjen e programit të studimeve, të ciklit të parë “Teknologji informacioni dhe komunikimi”, në Universitetin e Tiranës	443
Vendim i KM nr.678, datë 13.8.2010	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në fakultetin e infermierisë të Universitetit të Tiranës, si dhe për kuotën e pranimit dhe tarifën e shkollimit në këto programe studimi	444
Vendim i KM nr.681, datë 25.8.2010	Për hapjen e programit të studimeve “Master i nivelit të parë”, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes të Universitetit të Sporteve, Tiranë	445
Vendim i KM nr.682, datë 25.8.2010	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të dytë, në fakultetin e drejtësisë të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	445
Vendim i KM nr.683, datë 25.8.2010	Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të dytë, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes të Universitetit të Sporteve, Tiranë	446
Vendim i KM nr.684, datë 25.8.2010	Për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në fakultetin e shkencave të edukimit, në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan	446
Vendim i KM nr.685, datë 25.8.2010	Për riorganizimin e universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës	447
Vendim i KM nr.699, datë 13.8.2010	Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Ismail Qemali”, të objektit “Departamenti i detarisë”, në Vlorë	450
Udhëzim i MASH nr.28, datë 17.9.2007	Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2007-2008	451
Udhëzim i MASH nr.30, datë 26.9.2007	Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve si dhe programeve të studimit “Master i nivelit të dytë” <i>ndryshuar me:</i> - <i>udhëzimin nr. 29, datë 28.7.2008</i> - <i>udhëzimin nr.24, datë 2.9.2009</i> - <i>udhëzimin nr.36, datë 9.11.2009</i>	453
Udhëzim i MASH nr.4, datë 22.1.2008	Për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit master të nivelit të parë dhe të dytë	464
Udhëzim i MASH nr.5, datë 22.1.2008	Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse <i>ndryshuar me:</i> - <i>udhëzim të KM nr.20, datë 29.7.2009</i>	471
Udhëzim i MASH nr.14, datë 3.4.2008	Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë	478
Udhëzim i MASH nr.15, datë 4.4.2008	Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë	485
Udhëzim i MASH nr.34, datë 29.9.2008	Për strukturën e vitit akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë dhe masat që duhen marrë për zbatimin e saj	499

Udhëzim i MASH nr.35, datë 17.10.2008	Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të rishpërndara në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2008- 2009	501
Udhëzim i MASH nr.36, datë 22.10.2008	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009	503
Udhëzim i MASH nr.37, datë 29.10.2008	Për transferim studimesh në ciklin e parë me kohë të plotë në vitin akademik 2008 - 2009	505
Udhëzim i MASH nr.38, datë 3.11.2008	Për administrimin e kuotave për shtetasit e huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2008-2009, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë	506
Udhëzim i MASH nr.40, datë 22.11.2008	Për plotësimin e kuotave të përealizuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2008 – 2009	507
Udhëzim i MASH nr.41, datë 4.12.2008	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009	509
Udhëzim i MASH nr.42, datë 9.12.2008	Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të përealizuara në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008- 2009	511
Udhëzim nr.43, datë 9.12.2008	Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të përealizuara në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në akademinë e arteve, në vitin akademik 2008 - 2009	512
Udhëzim i MASH nr.21, datë 30.7.2009	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë <i>ndryshuar me:</i> <i>-udhëzim nr.39, datë 8.12.2009</i>	514
Udhëzim i MASH nr.27, datë 17.9.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.25, datë 9.9.2009 të MASH-it “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2009 - 2010”	516
Udhëzim i MASH nr.30, datë 10.10.2009	Për plotësimin e kuotave të përealizuara dhe regjistrimin e kandidatëve fitues në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009-2010	517
Udhëzim i MASH nr.37, datë 20.11.2009	Për regjistrimin e kandidatëve dhe plotësimin e kuotave të përealizuara në fazën e katërt për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009–2010	519
Udhëzim i MASH nr.38, datë 25.11.2009	Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010	521
Udhëzim i MASH nr.40, datë 8.12.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”	526
Udhëzim i MASH nr.41, datë 8.12.2009	Për procedurat e njohjes së diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja	527
Udhëzim i MASH nr.1, datë 4.1.2010	Për rishpërndarjen e kuotave të përealizuara dhe regjistrimin e pranimeve për plotësimin e këtyre kuotave në ciklin e parë të studimeve, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009 - 2010	529

Udhëzim i MASH nr. 4, datë 5.2.2010	Për rishpërndarjen e kuotave të përealizuara dhe regjistrimin e pranimeve për plotësimin e këtyre kuotave në ciklin e parë të studimeve, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009 – 2010	533
Udhëzim i MASH nr.6, datë 16.12.2010	Për përcaktimin e koeficientëve të shkollave të mesme dhe të lëndëve me zgjedhje për programe të ndryshme studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, si kriter i përzgjedhjes së kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010 – 2011	534
Udhëzim i MASH nr.9, datë 25.2.2010	Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore	535
Udhëzim i MASH nr.25, datë 2.8.2010	Për disa shtesa në udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar	544



# ARSIMI PARAUNIVERSITAR

## LIGJ

Nr.7952, datë 21.6.1995

### PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

*(Ndryshuar me ligjin nr.8337, datë 30.7.1998;*

*ndryshuar me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002;*

*ndryshuar me ligjin nr.9903, datë 17.4.2008;*

*ndryshuar me ligjin nr.9985, datë 11.9.2008)*

*I përditësuar*

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

#### KREU I

#### PARIME TË PËRGJITHËSHME

##### Neni 1

Arsimi në Republikën e Shqipërisë është përparësi kombëtare.

Ai realizohet në përputhje me parimet e sanksionuara në legjislacionin në fuqi, mbështetet në traditat e arritjet e shkollës sonë kombëtare dhe kryhet në përputhje me marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Arsimi respekton të drejtat e fëmijëve dhe të të rriturve të sanksionuara në këto dokumente.

##### Neni 2

Arsimi ka për mision emancipimin shpirtëror, progresin material dhe zhvillimin social të individit.

##### Neni 3

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë gëzojnë të drejta të barabarta për t'u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit që përcakton ky ligj, pavarësisht nga gjendja sociale, kombësia, gjuha, seksi, feja, raca, bindjet politike, gjendja shëndetësore dhe niveli ekonomik.

##### Neni 4

Arsimi në Republikën e Shqipërisë realizohet në institucione arsimore publike dhe private, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

##### Neni 5

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përgjigjet për realizimin e politikës shtetërore të arsimit laik, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

## Neni 6

Mësimet në institucionet arsimore publike të Republikës së Shqipërisë zhvillohen në gjuhën shqipe, me përjashtim të rasteve që parashikon ndryshe ky ligj.

## Neni 7

7.1. Arsimi parauniversitar publik ka karakter laik.

7.2. Në institucionet arsimore publike ndalohet indoktrinimi ideologjik e fetar.

## Neni 8

*(Ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr.9985, datë 11.9.2008, neni 3)*

Të gjithë fëmijët e moshës 6-vjeçare në Republikën e Shqipërisë duhet të fillojnë arsimin bazë, i cili zgjat jo më pak se 9 vjet. Nxënësi është i detyruar të ndjekë arsimin e detyruar deri në moshën 16 vjeç.

## Neni 9

Në institucionet arsimore publike shteti u siguron nxënësve falas mjediset mësimore, bazën materiale të tyre dhe personelin mësimdhënës.

## Neni 10

10.1 Personave që u përkasin pakicave kombëtare u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre brenda kuadrit të planeve dhe programeve mësimore.

10.2 Për të mundësuar një pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, shteti krijon kushte që personat e pakicave të moshës shkollore të mësojnë gjuhën shqipe, historinë dhe kulturën shqiptare.

10.3 Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor, përcaktohen me akte të veçanta të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

10.4 Arsimi, për personat e pakicave, realizohet në njësi shkollimi dhe institucione arsimore të caktuara, hapja dhe funksionimi i të cilave bëhet sipas procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

## Neni 11

11.1 Personat me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtë të arsimohen në Republikën e Shqipërisë. Pranimi i tyre bëhet sipas akteve nënligjore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

11.2 E drejta e shtetasve të huaj për t'u arsimuar në institucionet arsimore publike të Republikës së Shqipërisë përcaktohet me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit.

## Neni 12

12.1 Institucionet arsimore publike bashkëpunojnë me prindërit për realizimin e detyrave të tyre.

12.2 Komuniteti i shkollave publike, i përbërë nga nxënësit, mësuesit, gjithë personeli tjetër i shkollës, prindërit dhe partnerë të tjerë socialë, synon ngritjen e nivelit mësimor-edukativ të nxënësve dhe integrimin optimal të tyre në jetën, emancipimin dhe përparimin e vendit.

### Neni 13

*(Shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr.8337, datë 30.7.1998, neni 2)*

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton me akte nënligjore kriteret e ekuivalentimit për rastet e fëmijëve shqiptarë që vijnë nga shkolla jashtë vendit.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton kriteret për dhënien e Medaljes së Artë nxënësve që përfundojnë arsimin e mesëm publik apo privat me rezultate të shkëlqyera.

### Neni 14

14.1 Në institucionet shkollore dhe parashkollore publike mësuesi është figura qendrore shkencore e pedagogjike. Ai zbaton programet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Mësuesi ka të drejtë të zgjedhë metodat dhe mekanizmat e përshtatshëm për zbatimin e programit themelor, duke u bazuar në aftësitë dhe përgatitjen e tij profesionale, duke siguruar një edukim të harmonizuar, duke ruajtur personalitetin e nxënësve dhe duke shmangur çdo ndikim që mund të krijojë me bindjet e tij sociale, politike e fetare.

14.2 Kërkesat bazë për përgatitjen iniciale dhe kualifikimin e mësuesve përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

14.3 Mësuesit dhe personeli tjetër mësimor kanë të drejtën e kualifikimit pasuniversitar sipas kërkesave të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, si dhe forma të tjera në bashkëpunim me institucione kualifikuese të specializuara brenda e jashtë vendit.

## KREU II SISTEMI ARSIMOR PUBLIK

### Neni 15

Sistemi arsimor publik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga rrjeti i institucioneve arsimore publike, që realizojnë tërësinë e planeve dhe programeve mësimore në nivele të ndryshme shkollore e parashkollore. Kërkesat e programeve për institucionet shkollore dhe parashkollore publike përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

### Neni 16

16.1 Rrjeti i instituconeve arsimore publike përbëhet nga shkolla të tipave të ndryshëm, duke përfshirë shkollat me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar. Kriteret për hapjen dhe funksionimin e këtyre institucioneve përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

16.2 Sistemi arsimor publik përbëhet nga:

16.2.1 Arsimi parashkollor publik.

16.2.2 Arsimi bazë publik.

16.2.3 Arsimi i mesëm publik.

16.2.4 Arsimi special publik.

## ARSIMI PARASHKOLLOR PUBLIK

### Neni 17

17.1 Arsimi parashkollor publik është niveli i parë i sistemit arsimor publik në Republikën e Shqipërisë.

17.2 Institucionet që realizojnë arsimin parashkollor janë kopshtet e fëmijëve.

### Neni 18

Institucionet parashkollore publike, në bashkëpunim me prindërit, synojnë edukimin e zhvillimin e personalitetit të fëmijëve dhe i parapërgatitin ata për në shkollë.

### Neni 19

19.1 Regjistrimi në kopshte i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç bëhet sipas dëshirës së prindërve dhe në përputhje me aktet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

19.2 Kopshtet funksionojnë gjatë gjithë vitit.

19.3 Kopshtet mund të jenë pa ushqim ose me ushqim. Kriteret e pagesës në kopshtet me ushqim caktohen nga Këshilli i Ministrave.

## ARSIMI I DETYRUAR PUBLIK

### Neni 20

*(Ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr.9985, datë 11.9.2008, neni 4)*

Arsimi bazë është arsimi i detyruar dhe i njësuar. Institucionet e tij shtrihen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 21

Arsimi bazë publik synon të zhvillojë aftësitë intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike të nxënësve, të zhvillojë personalitetin e tyre dhe t'i pajisë ata me elementet themelore të kulturës së përgjithshme dhe edukatën qytetare.

### Neni 22

22.1 Shkolla e arsimit bazë publik përfshin dy cikle:

- ciklin fillor;

- ciklin e lartë.

22.2 Cikli i lartë është vazhdim logjik dhe i natyrshëm i ciklit fillor.

22.3 Cikli fillor dhe cikli i lartë kanë tipare organizative dhe pedagogjike specifike, të cilat përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

22.4 Shkolla e arsimit bazë mund të jetë shkollë me cikël të plotë ose shkollë me kohë të shkurtuar. Shtetasit që kanë mbushur moshën 16 vjeç, por që nuk kanë përfunduar arsimin bazë, mund të ndjekin shkolla me kohë të shkurtuar. Këto shkolla funksionojnë në përputhje me udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

### Neni 23

Sipas numrit të nxënësve, terrenit dhe klimës, procesi mësimor mund të realizohet edhe në klasa kolektive. Për këto raste Ministria e Arsimit dhe e Shkencës nxjerr udhëzimet përkatëse.

#### Neni 24

Të gjithë prindërit, fëmijët e të cilëve i përfshin detyrimi shkollor, janë të detyruar t'i dërgojnë fëmijët e tyre në institucione publike ose private të arsimit bazë.

#### Neni 25

*(Shtuar pika 25.3 me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998, neni 3)*

25.1 Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë të shkollës së arsimit bazë bëhet me këto dokumente:

25.1.1 Certifikata e lindjes.

25.1.2 Certifikata e vaksinimeve e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

25.2 Regjistrimi i fëmijëve në klasat e tjera të shkollës së arsimit bazë bëhet me këto dokumente:

25.2.1 Dokumenti i përfundimit të klasës së mëparshme.

25.2.2 Certifikata e vaksinimeve e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

25.3 Institucioni arsimor, ku duhet të regjistrohet fëmija përcaktohet nga organet e pushtetit lokal, me propozim të drejtorisë arsimore të rrethit.

### ARSIMI I MESËM PUBLIK

#### Neni 26

Arsimi i mesëm publik synon të zhvillojë në mënyrë sa më të plotë e harmonike personalitetin dhe potencialin e nxënësve, për t'i aftësuar ata të kontribuojnë në mënyrë sa më aktive në zhvillimet ekonomike, politike, sociale e kulturore të vendit.

#### Neni 27

Arsimi i mesëm publik i përgatit nxënësit për të ndjekur universitetin, shkolla të tjera të larta ose për të ushtruar profesione të caktuara.

Arsimi i mesëm publik organizohet sipas niveleve të ndryshme të shkollimit, dallimeve të përmbajtjes dhe të profileve profesionale, në shkolla me kohë të plotë ose të shkurtuar. Sipas numrit të nxënësve, terrenit dhe klimës, procesi mësimor, në raste të veçanta, mund të bëhet edhe me klasa kolektive. Për këto raste Ministria e Arsimit dhe e Shkencës nxjerr udhëzimet përkatëse.

#### Neni 28

28.1 Të gjithë shtetasit kanë të drejtë të arsimohen në shkollat e mesme publike, pasi të kenë përfunduar shkollën e arsimit bazë.

28.2 Pranimet në shkollat e mesme publike bëhen sipas kriterëve që përcakton Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Ajo përcakton gjithashtu edhe kriteret për kalimin e nxënësve nga një lloj shkolle e arsimit të mesëm publik në një tjetër.

#### Neni 29

Në klasën e parë të shkollave të mesme publike me kohë të plotë pranohen nxënës jo më të mëdhenj se 16 vjeç, me përjashtim të rasteve të veçanta të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

## GJIMNAZE PUBLIKE

### Neni 30

*(Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 30.1 me ligjin nr.9985, datë 11.9.2008, neni 5)*

30.1 Gjimnaze publike japin një kulturë të përgjithshme që është zgjerim e thellim i kulturës dhe njohurive të fituara në shkollat e arsimit bazë. Afati i këtyre shkollave është 3 vjet.

30.2 Për të mundësuar që nxënësit të fitojnë njohuri, aftësi dhe përgatitjen e nevojshme personale për studime në shkollën e lartë, në fusha të ndryshme ose për një formim të caktuar profesional, gjimnazet mund të kenë drejtime të orientuara, që dallohen nga planet dhe programet mësimore.

### Neni 31

Në gjimnaze publike, krahas formimit të përgjithshëm mund të zhvillohen edhe lëndë ose kurse fakultative dhe lëndë me zgjedhje, sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

### Neni 32

Për fusha specifike, si ato artistike, socialkulturore etj., funksionojnë shkolla të mesme publike të veçanta. Afati i studimit për këto shkolla varet nga fusha e studimit dhe përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

## SHKOLLAT PROFESIONALE PUBLIKE

### Neni 33

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

### Neni 34

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

### Neni 35

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

### Neni 36

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

### Neni 37

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

### Neni 38

*(Shfuqizuar me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

### KREU III ARSIMI SPECIAL PUBLIK

#### Neni 39

39.1 Arsimi special publik është pjesë përbërëse e sistemit arsimor publik në Republikën e Shqipërisë.

39.2 Arsimi special publik synon që nëpërmjet përdorimit të formave dhe metodave të veçanta të sigurojë zhvillimin sa më të plotë të mundësive të personave që paraqesin paaftësi fizike, mendore ose emocionale, në përputhje me nevojat e tyre dhe kërkesat për një jetë sa më dinjitoze.

#### Neni 40

40.1 Arsimimi i fëmijëve që paraqesin nevoja të veçanta kryhet falas në institucionet arsimore publike, nëse kjo është dëshira e prindërve dhe zgjidhja më e drejtë profesionale.

Shteti merr masa për sigurimin gradual të kushteve të nevojshme për realizimin e integritimit.

40.2 Për fëmijët, të cilët paraqesin nevoja të veçanta që nuk mund të plotësohen brenda sistemit shkollor, ngrihen klasa dhe institucione të posaçme, ku trajtimi i specializuar bëhet falas.

40.3 Kriteret për përcaktimin e fëmijëve që përfitojnë arsimin special vendosen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 41

Për kualifikimin e kuadrit të arsimit special hapen degë dhe kurse specializimi të veçantë.

#### Neni 42

Për ndjekjen dhe studimin e problematikës së arsimit special krijohen me akte nënligjore struktura dhe institucione të posaçme.

### KREU IV ARSIMI PRIVAT

#### Neni 43

*(Shtuar dy paragrafët e fundit me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998, neni 4)*

Krijimi i institucioneve arsimore private lejohet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Shtetasit shqiptarë ose të huaj kanë të drejtë t'i ndjekin këto institucione, në përputhje me rregullat e pranimit të tyre.

Ndër institucionet arsimore, publike, parauniversitare mund të privatizohen vetëm institucionet e arsimit profesional. Në këto raste mjediset, pajisjet dhe trualli i tyre privatizohen në përputhje me dispozitat në fuqi.

Ndalohet ndryshimi i destinacionit të institucionit arsimor publik të arsimit profesional të privatizuar.

#### Neni 44

*(Shtuar pika 44.1 me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998, neni 5;  
ndryshuar pika 44.4 me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998, neni 6)*

44.1 Hapja e institucioneve arsimore private laike, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, bëhet vetëm me leje të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Për rastet e

institucioneve arsimore private, ku mësimet zhvillohen edhe në gjuhë të huaj ose kur zhvillohen edhe lëndë fetare, kjo leje jepet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës propozon institucionin arsimor publik të arsimit profesional, i cili do të privatizohet. Miratimi bëhet nga Këshilli i Ministrave me vendim të veçantë. Mënyrat dhe fazat e procesit të privatizimit përcaktohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit dhe nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

44.2 Leja jepet kur planet, programet mësimore dhe kushtet e realizimit të tyre nuk bien në kundërshtim me interesat kombëtare me legjislacionin shqiptar, me rendin publik, normat morale dhe higjienën, si dhe kur sigurohen kushtet materiale të domosdoshme së bashku me personelin e nevojshëm mësimor.

44.3 Gjuha dhe letërsia shqipe, historia e kombit shqiptar dhe gjeografia e Shqipërisë zhvillohen detyrimisht në shqip.

44.4 Kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes për shkollat private laike, në të cilat mësimi bëhet në gjuhën shqipe, rregullohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Për shkollat e tjera private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare ose në të cilat mësimi bëhet edhe në gjuhë të huaj, këto kriteret ose procedura caktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit. Leja për hapjen e institucioneve arsimore private nuk mund të jepet me parë se 3 muaj dhe jo më vonë se 1 vit nga koha e depozitimit të kërkesës.

44.5 Kur provohen shkelje të dispozitave të këtij ligji, leja e dhënë për institucionet arsimore private laike, në të cilat mësimi bëhet në gjuhën shqipe, hiqet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Për institucionet e tjera arsimore private kjo leje hiqet nga Këshilli i Ministrave.

44.6 Shkollat private, të cilave u është hequr leja, mund të bëjnë kërkesë për ta rifituar atë për vitin e ardhshëm shkollor.

#### Neni 44/a

*(Shtuar me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998, neni 7)*

44/a.1 Krahas institucioneve arsimore private të niveleve të arsimit parauniversitar, lejohen hapja dhe funksionimi i institucioneve arsimore, private, plotësuese. Quhen të tilla ato institucione arsimore e njësi shkollimi që funksionojnë jashtë strukturave të institucioneve arsimore, publike e private dhe ku punohet në drejtim të arsimit e të edukimit në lëndë e specialitete të veçanta, brenda ose jashtë planeve mësimore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

44/a.2 Leja për funksionimin e institucioneve arsimore, private, plotësuese jepet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës jo më parë se dy muaj nga data e depozitimit të kërkesës.

44.a.3 Kriteret për hapjen dhe funksionimin e tyre përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

#### Neni 45

45.1 Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton njëvlefshmërinë për njohjen e dokumenteve të përfundimit të një klase a një shkolle private. Nëse shkolla private zhvillon edhe lëndë fetare, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton njëvlefshmërinë për njohjen e pjesës laike të programit në përfundim të një klase a të një shkolle të tillë private.

45.2 Nxënësit mund të kalojnë nga një shkollë private në një shkollë publike sipas akteve nënligjore të veçanta të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

#### Neni 46

Për dhënien e lejes së hapjes së institucioneve arsimore private, ao duhet të provojnë se kanë personel pedagogjik me arsimin përkatës e me kualifikimin e duhur dhe se janë të pajisura me mjetet



mësimore për të realizuar kërkesat e planit e të programeve mësimore, si dhe sigurojnë kushtet materiale të domosdoshme së bashku me personelin e nevojshëm mësimor.

#### Neni 47

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe organet e saj arsimore në rrethe kontrollojnë periodikisht procesin mësimor laik në shkollat private për të verifikuar realizimin e kërkesave të planit e të programeve mësimore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

#### Neni 48

48.1 Për shkollat private të arsimit të detyruar leja jepet vetëm kur ato marrin përsipër të realizojnë kërkesat e planit e të programeve mësimore të detyrueshme për shkollat publike të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

48.2 Në rastet e heqjes së lejes shkollave private të arsimit bazë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe organet e saj në rrethe marrin masat e nevojshme për t'i sistemuar nxënësit në shkolla të tjera.

#### Neni 49

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton rastet e veçanta kur arsimi bazë zhvillohet pranë familjes në rrugë private. Përvetësimi i programeve mësimore kontrollohet me provime që jepen në shkollat publike të arsimit bazë.

### KREU V STRUKTURAT PLOTËSUESE TË ARSIMIT

#### Neni 50

50.1 Në Republikën e Shqipërisë veprojnë edhe struktura të tjera plotësuese që ndihmojnë, mbështetin dhe pasurojnë sistemin arsimor, si qendra kulturore, qendra të vlerësimit, qendra të dokumentacionit shkollor, lektoriume, kurse speciale, qendra të formimit profesional, institute të rritjes së shkallës së kualifikimit etj.

50.2 Strukturat plotësuese të arsimit janë nën vartësinë e dikastereve dhe të organizmave që i kanë krijuar.

### KREU VI DREJTIMI I SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

#### Neni 51

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës është organi më i lartë administrativ publik i arsimit. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, nëpërmjet specialistëve të saj dhe institucioneve vartëse, harton dhe përpunon programet e zhvillimit të arsimit në përputhje me prirjet dhe zhvillimet arsimore ndërkombëtare, si dhe veçoritë kombëtare, rajonale, socialekonomike e demografike të Shqipërisë.

#### Neni 52

52.1 Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ose institucione të tjera vartëse që ajo cakton, miratojnë dokumentet themelore arsimore, që përfshijnë planet, programet dhe tekstet mësimore për institucionet publike arsimore.

52.2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka të drejtën e eksperimentimit për përmirësimin e cilësisë në arsim në përputhje me standardet ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucione të specializuara të vendit dhe të huaja.

52.3 Inspektimet në procesin mësimor bëhen vetëm nga organet e specializuara të caktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

#### Neni 53

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton strukturën e vitit shkollor, ngarkesën mësimore të trupit pedagogjik, numrin e nxënësve për klasë, për të gjitha nivelet e institucioneve arsimore publike.

#### Neni 54

*(Ndryshuar me ligjin nr.9903, datë 17.4.2008, neni 1)*

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar.

2. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar këshillon, formulon mendime dhe propozime për:

a) hartimin e strategjive dhe të programeve kombëtare për arsimin parauniversitar, drejtimet e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore;

b) reformën e kurrikulave dhe të teksteve për arsimin parauniversitar;

c) projektbuxhetin e parashikuar për arsimin parauniversitar dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;

ç) standardet për vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar;

d) zhvillimin e politikave të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 54/a

*(Shtuar neni me ligjin nr.9903, datë 17.4.2008, neni 2)*

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar përbëhet nga 23 anëtarë, si më poshtë: Ministri i Arsimit dhe Shkencës, një përfaqësues nga drejtoritë arsimore rajonale, një përfaqësues i Ministrisë së Financave, një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, një përfaqësues i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë, një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, një përfaqësues i shoqatës së bashkive, një përfaqësues i shoqatës së komunave, një përfaqësues i shoqatës së këshillave të qarqeve dhe 13 anëtarë të tjerë, ekspertë të zgjedhur me konkurrim publik. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

2. Anëtarët, ekspertë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, janë figura të njohura për kontributin e tyre shkencor në fushën e arsimit dhe të shkencës, që zotërojnë, së paku, diploma të nivelit të dytë dhe të nivelit të dytë të integruar dhe kanë njohje të mirë të përvojës ndërkombëtare në fushën e zhvillimit të arsimit parauniversitar. Ata përzgjidhen me konkurrim publik nga një komision i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Komisioni përbëhet nga një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe një përfaqësues nga Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional, të caktuar nga vetë këto institucione.

3. Komisioni i përzgjedhjes, pasi shqyrton plotësimin e kriterëve profesionale, në përputhje me këtë ligj, rendit në një listë kandidatët, sipas pikëve të fituara. Kriteret dhe procedurat për

përzgjedhjen e kandidatëve caktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe bëhen publike.

4. Këshilli i Ministrave cakton në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar 13 nga kandidatët e klasifikuar.

5. Anëtarët ekspertë zgjidhen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

6. Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar mbështetet nga një sekretariat teknik, që ndodhet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Pagesa e anëtarëve të këtij këshilli, si dhe përbërja e detyrat e anëtarëve të sekretariatit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 55

*(Shfuqizuar pika 55.4 me ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

55.1 Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton kriteret për hapjen e institucioneve arsimore publike dhe private laike.

55.2. Hapja e kopshteve është në kompetencë të komunave dhe bashkive.

55.3 Hapja e shkollave të arsimit bazë dhe atyre të arsimit të mesëm të përgjithshëm publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, bëhet nga bashkitë për qytetet dhe nga këshilli i rrethit për komunat, pasi të jetë marrë miratimi nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

55.4 Shfuqizuar.

### KREU VII

#### MARRËDHËNIET FINANCIARE TË SISTEMIT ARSIMOR

#### Neni 56

Arsimi publik në Republikën e Shqipërisë financohet nga buxheti i shtetit, si dhe nga burime të tjera të parashikuara me ligj.

#### Neni 57

*(Shfuqizuar pika 57.2 me ligjin nr.8872, datë 29.3.2002, neni 31)*

57.1 Krahas detyrave kryesore të mësimdhënies, shkollat e arsimit bazë e të mesëm publik mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve mësimore, në përputhje me dispozitat ligjore.

57.2 Shfuqizuar.

#### Neni 58

Personat juridikë shtetërorë e privatë, në bazë të kapaciteteve të tyre, duhet të pranojnë dhe t'u krijojnë kushte të përshtatshme për kryerjen e praktikave nxënësve të shkollave profesionale sipas specialiteteve të tyre.

Marrëdhëniet që rrjedhin nga ky bashkëpunim, rregullohen me marrëveshje ndërmjet palëve të interesuara drejtpërsëdrejti ose institucioneve përfaqësuese të tyre.

## SANKSIONET

### Neni 59

*(Ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998, neni 8)*

Kur nxënësit e moshës 6 deri 16 vjeç, të cilët i përfshin detyrimi shkollor, mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, prindërit e tyre dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 1 000 deri në 10 000 lekë, si vijon:

59.1. Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye 30 - 50 përqind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 1 000 deri 3 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti, gjoba bëhet 5 000 lekë.

59.2. Kur nxënësi mungon pa arsye mbi 50 përqind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 5 000 deri në 7 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti ose braktisjeje të shkollës, gjoba bëhet 10 000 lekë.

59.3. Vendimi i gjobës jepet nga kryetari i bashkisë apo i komunës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës.

Kundër vendimit të gjobitjes mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

59.4. Përfshihen nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë, shqiptare a të huaj, brenda vendit, me kusht që të paraqesin dokumentin e regjistrimit pranë drejtorisë së shkollës në vendbanimin e tyre.

59.5. Përfshihen nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë jashtë vendit.

### Neni 60

Ndalohet punësimi i fëmijëve që përfshihen në detyrimin shkollor. Kur vërtetohen raste të punësimit të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, punëdhënësi shtetëror ose privat dënohet për kundërvajtje administrative nga inspektori i punës me gjobë 100 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me gjobë 200 000 lekë.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim dhe protestë, brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

### Neni 61

*(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998, neni 9)*

Hapja e institucioneve arsimore private dhe e institucioneve arsimore private plotësuese në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësit në çdo rast, dënohen me gjobë, përkatësisht 500 000 lekë dhe 200 000 lekë, si dhe me ndërprerje të veprimtarisë së filluar.

Vendimi për gjobë dhe ndërprerje të veprimtarisë merret nga ministri i Arsimit dhe i Shkencës për institucionet arsimore private laike dhe nga Këshilli i Ministrave për institucionet arsimore private, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare ose në të cilat mësimi bëhet edhe në gjuhë të huaj.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e Tiranës.

### Neni 62

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimi i vendimeve të dënimit me gjobë bëhet sipas dispozitave të caktuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtje administrative".

## DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 63

Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës nxjerr akte nënligjore në fushën e arsimit dhe ngarkon atë apo ministri të tjera sipas rastit për zbatim.

### Neni 64

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka të drejtë të miratojë rregulloren, udhëzime e urdhra për zbatimin e këtij ligji. Ajo përcakton llojin e dëftesave shkollore për çdo klasë e cikël.

### Neni 65

Ligji nr.4624, datë 24.12.1969 "Për sistemin e ri arsimor", ligji nr.7887, datë 8.12.1994 "Për detyrimin shkollor", si dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Shkollat private ekzistuese të hapura në periudhën 1991-1993 i nënshtrohen të gjitha dispozitave të këtij ligji. Shqyrtimi i kërkesave për vazhdimin e funksionimit të shkollave private ekzistuese të hapura në periudhën 1991-1993, si dhe ekuivalentimi i diplomave të lëshuara nga këto shkolla, bëhet brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

### Neni 66

Shteti garanton sigurimin e jetës dhe të veprimtarisë së mësuesve e nxënësve si dhe paprekshmërinë e institucioneve arsimore dhe të territoreve të tyre.

### Neni 67

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

***Ligj nr.7952, datë 21.6.1995, shpallur me dekretin nr.1144, datë 3.7.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha***

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, faqe nr.619*

***Ligj nr.8387, datë 30.7.1998, shpallur me dekretin nr.2178, datë 3.8.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani***

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.20, faqe nr.831*

***Ligj nr.8872, datë 29.3.2002, shpallur me dekretin nr.3291, datë 11.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani***

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, faqe 320*

***Ligj nr.9903, datë 17.4.2008, shpallur me dekretin nr.5696, datë 5.5.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi***

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.61, datë 7.5.2008, faqe nr.2726*

***Ligj nr.9985, datë 11.9.2008, shpallur me dekretin nr.5889, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi***

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 22.9.2008, faqe nr.6386*

**VENDIM**  
**Nr.396, datë 22.8.1994**

**ARSIM BAZË 8-VJEÇAR NË GJUHËN AMËTARE TË PERSONAVE TË PAKICAVE**  
*(Ndryshuar me vendimin të Këshillit të Ministrave nr.502, datë 5.8.1996)*

Nisur nga orientimi themelor politik i Republikës së Shqipërisë për të mbrojtur e respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të individit, përfshirë edhe atë të personave që u përkasin pakicave.

Duke synuar të konkretizojnë në sferën arsimore politikën shtetërore për të krijuar kushtet e duhura për shprehjen, ruajtjen e zhvillimin e identitetit kulturor e gjuhësor të personave që iu përkasin pakicave si dhe nevojën e integritit të tyre në shoqërinë shqiptare.

Bazuar në ligjin "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", miratuar nga Kuvendi Popullor më 31 mars 1993, neni 26 i të cilit parashikon: "Personat që u përkasin pakicave kanë të drejtë të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare".

Duke pasur parasysh dhe parimet e standardet e parashikuara në Kartën Europiane mbi Gjuhët Rajonale apo të Pakicave, miratuar nga Këshilli i Europës në Strasburg më 5 nëntor 1992, si dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare në këtë fushë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Personat që u përkasin pakicave kanë të drejtë të mësojnë dhe, ose të mësohen në gjuhën e tyre amtare në njësi shkollimi dhe institucione arsimore shtetërore të caktura.

2. Arsimi në gjuhën amtare i pakicave zhvillohet në mënyrë shumëformëshe në përputhje me parimet themelore të edukimit të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë dhe mbi bazën e planeve dhe programeve mësimore të shkollave shtetërore të vendit të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

3. Për t'u mundësuar një pjesëmarrje të barabartë dhe aktive në gjithë jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, të rinjtë që u përkasin pakicave duhet të dinë gjuhën shqipe dhe për këtë qëllim shteti krijon kushtet e nevojshme.

4. Njësitë e shkollimit në gjuhën e pakicave, ashtu si gjithë shkollat e tjera shtetërore funksionojnë nën mbikqyrjen dhe kontrollin e Ministrisë së Arsimit.

5. Në njësitë e shkollimit ekzistues ku mësohet dhe gjuha amtare e pakicave, nxënësit e këtyre pakicave kanë të drejtë të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare.

Plani dhe programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor të këtyre njërive përcaktohen me akte të veçanta të Ministrisë së Arsimit. Leximi dhe gjuha amtare e nxënësve të pakicave, si dhe leximi dhe gjuha shqipe zhvillohen si lëndë të veçanta. Në kuadrin e programit shkollor, nxënësve të pakicave në këto njësi u krijohen mundësi për të studiuar historinë, traditat dhe kulturën e tyre.

5/1. Mbi bazën e kërkesave të prindërve ose kujdestarëve të fëmijëve të pakicës greke në qytetet Sarandë, Delvinë dhe Gjirokastrë, të funksionojnë njësi shkollimi, ku nxënësit të mësojnë edhe në gjuhën amtare. Funksionimi i tyre të fillojë me klasat e para në vitin shkollor 1996-1997 pranë shkollave tetëvjeçare, ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, duke respektuar kriterin që numri i nxënësve për klasë të mos jetë nën 20.

Kërkesat e prindërve ose kujdestarëve të fëmijëve të pakicës greke me vendbanim në qytetin përkatës, që dëshirojnë të mësojnë në gjuhën amtare, paraqiten nga një përfaqësues i tyre në drejtorinë arsimore të rrethit deri në datën 5 shtator.

Kërkesa përmban listën emërore të fëmijëve të pakicës greke, sipas regjistrimit të gjendjes civile, moshën e tyre, si dhe nënshkrimin e prindit ose të kujdestarit.

Pasi bën verifikimet e duhura, drejtori i drejtorisë arsimore të rrethit dërgon në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve listë-kërkesën, së bashku me mendimin e tij.

6. Në qendrat e banimit (qytetet dhe fshatrat), ku jetojnë dhe personat që u përkasin pakicave, në rastet kur ka një numër të mjaftueshëm nxënësish të pakicave që i përgjigjet kriterëve të përgjithshme për funksionimin e njësive të shkollimit, ata kanë të drejtë që në kuadrin e sistemit shtetëror të arsimit tëdetyrueshëm, të mësojnë në mënyrë fakultative gjuhën e tyre amtare. Mënyra konkrete e organizimit të mësimin në këto njësi rregullohet me akte të veçanta të Ministrisë së Arsimit. Çelja apo mbyllja e klasave të mësimin fakultativ në shkollat ku gjuha amtare mësohet në mënyrë fakultative nga nxënësit e pakicës bëhet me vendim të Prefektit, pasi të merret miratimi i ministrit të Arsimit. Për çeljen e tyre paraqitet tek drejtori i drejtorisë arsimore të rrethit përkatës një kërkesë e nënshkruar nga prindërit ose kujdestarët e fëmijëve që do të regjistrohen në përputhje me të drejtat e tyre si individë dhe qytetarë. Kërkesa, që duhet të përmbajë listën emërore të fëmijëve sipas rregjistrimeve në zyrën e gjendjes civile, dorëzohet nga një përfaqësues i prindërve tek drejtori i drejtorisë arsimore të rrethit të paktën 6 muaj para fillimit të vitit shkollor të pritsëm. Pasi bën verifikimet dhe vlerësimet lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme për funksionimin e njësive të shkollimit, drejtori i drejtorisë arsimore ia paraqet kërkesën Prefektit shoqëruar me mendimin e tij. Me marrjen e vendimit, Prefekti udhëhiqet nga kriteret e përcaktuara në aktet ligjore, duke pasur parasysh përbërjen dhe rrethanat konkrete të popullsisë në qendrën përkatëse të banimit (qytetit a fshatit), veçanërisht nevojën për të siguruar në vijimësi kontigjentet e duhura të nxënësve. Vendimi i Prefektit i bëhet i njohur përfaqësuesit të prindërve apo kujdestarëve të interesuar të paktën një muaj para fillimit të vitit të ri shkollor. Kur ky vendim është pozitiv, ai duhet të miratohet me shkrim paraprakisht nga ministri i Arsimit. Të njëjtat kriteret janë të vlefshme edhe në rastin kur autoritetet e lartpërmendura shqyrtojnë e vendosin për mbylljen e një njësie të shkollimit.

Në rrethana të veçanta, kur numri i fëmijëve apo i nxënësve të pakicave është më i vogël se ai i kriterëve të përgjithshme, funksionimi i njësive të shkollimit ku mësohet dhe gjuha amtare e pakicave bëhet me vendim të veçantë të ministrit të Arsimit.

Për vitin shkollor 1994-1995 mësimi fakultativ i gjuhës amtare të fillojë me procedurë të përshpejtuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

*Vendim i KM nr.396, datë 22.8.1994, botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, faqe 783.*

*Vendim i KM nr.502, datë 5.8.1996, botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, faqe 790.*

**VENDIM**  
**Nr.78, datë 8.2.2006**

**PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA**  
**PUBLIKE**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.323, datë 30.5.2007;*  
*ndryshuar me vendim të KM nr.262, datë 27.2.2008;*  
*ndryshuar me vendim të KM nr.156, datë 11.2.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 31 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e maturës shtetërore, e cila realizon provimet e pjekurisë në përfundim të arsimit të mesëm 4 dhe 5-vjeçar, nëpërmjet vlerësimit të jashtëm. Matura shtetërore të përbëhet nga:

a) provime të detyruara,

b) provime me zgjedhje.

2. Arsimi i mesëm quhet i përfunduar kur nxënësi arrin rezultate kaluese në provimet e detyruara.

3. Kanë të drejtë të kërkojnë që të vazhdojnë studimet në shkollat e larta publike, vetëm ata kandidatë, të cilët kanë kryer provimet e maturës shtetërore ose ekuivalentet e saj, për nxënësit, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit.

3.1 Përjashtohen nga provimet me zgjedhje kandidatët, që kërkojnë të vazhdojnë studimet në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve, në Akademinë e Arteve dhe në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sporteve, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Në këtë rast, pranimi i kandidatëve bëhet me konkurs të organizuar nga institucioni publik i arsimit të lartë përkatës. Në rast aplikimi për programe të tjera studimi, këta kandidatë u nënshtrohen provimeve me zgjedhje të maturës shtetërore.

3.2 Përjashtohen nga provimet me zgjedhje kandidatët që kanë mbaruar arsimin e mesëm dhe të lartë përpara vitit 2006 dhe kërkojnë të vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në formën e studimit me kohë të pjesshme.

4. Ngritjen e Komitetit të Maturës Shtetërore, pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për drejtimin dhe organizimin e provimeve të maturës shtetërore, përbërja dhe detyrat e të cilit caktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

5. Pranimet në shkollat e larta publike, si rregull, të mbështeten në rezultatet e shkollës së mesme, sipas kësaj skeme:

a) 20 për qind në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme;

b) 80 për qind në mesataren e notave të provimeve të maturës shtetërore.

6. Shfuqizuar.

7. Përzgjedhja e kandidatëve për t'u pranuar në shkollat e larta publike të mbështetet në kriteret e përgjithshme, të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe të Shkencës, pas këshillimit me shkollat e larta publike. Këto shkolla mund të përcaktojnë kritere të veçanta, në përputhje me kriteret e përgjithshme. Për kriteret e veçanta duhet të merret mendimi i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

8. Për shkollat e larta ushtarake dhe për shkollat e larta të policisë kriteret e veçanta vendosen nga Ministri i Arsimit dhe të Shkencës dhe, përkatësisht, nga Ministri i Mbrojtjes e nga Ministri i Brendshëm, në përputhje me nenet 2, 3 e 8 të kreut I, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Efektet financiare:

9.1 për provimet e detyruara, të Maturës Shtetërore, të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;

9.2 për provimet me zgjedhje, të Maturës Shtetërore, të përballohen nga një tarifë e vetme për çdo nxënës/aplikant, prej 2000 lekësh në vit.

9.2.1 Nxënësi/aplikanti një kopje të mandatar-këtimit të pagesës së tarifës së mësipërme e dorëzon së bashku me formularin A2 të aplikimit, i cili shërben për krijimin e bazës së të dhënave, të kërkesave të maturantëve për degët, ku duan të konkurrojnë për studime universitare.

9.2.2 Tarifa e provimeve të Maturës Shtetërore arkëtohet nëpërmjet sistemit të bankave të nivelit të dytë ose zyrate të postës shqiptare, në adresë të Degës së Thesarit, Tiranë, për Agjencinë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve.

9.2.3 Administrimi i të ardhurave nga tarifa e provimeve me zgjedhje, të Maturës Shtetërore, realizohet nga Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe të ardhurat e siguruar nga kjo tarifë derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

9.3 Për pranimet e kërkesave për studim në shkollat e larta publike të mbulohen nga buxheti i shkollave të larta dhe nga tarifa përkatëse, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

11. Të gjitha aktet nënligjore për provimet e pjekurisë, të parashikuara në kreun V të dispozitave normative për arsimin parauniversitar dhe urdhrat që mbështeten në to, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, datë 23.2.2006, faqe 397*

*Vendim i KM nr.323, datë 30.5.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr.65, datë 8.6.2007, faqe 1761*

*Vendim i KM nr.262, datë 27.2.2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 19.3.2008, faqe 1829*

*Vendim i KM nr.156, datë 11.2.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, datë 10.3.2009, faqe 1479*



**VENDIM**  
**Nr.134, datë 8.3.2006**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SI SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME, E PROFILIZUAR  
“MEMORIAL INTERNATIONAL SCHOOL”, QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE  
NË GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, si shkollë e mesme e përgjithshme, e profilizuar “Memorial International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.20, datë 17.3.2006, faqe 641*

**VENDIM**  
**Nr.247, datë 27.4.2006**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE, CIKËL I LARTË “AMARO TAN”, QË DO  
TË ZHVILLOJË NË PROGRAMIN MËSIMOR EDHE LËNDË FETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor, privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, cikël i lartë, “Amaro Tan”, që do të zhvillojë në programin mësimor edhe lëndë fetare, në qytetin e Pogradecit.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen e zbatimit të dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, datë 12.5.2006, faqe 1378*

**VENDIM**  
**Nr.266, datë 5.5.2006**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR, PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE “OMIROS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen e institucionit arsimor, privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Omiros”, që do të zhvillojë mësimin edhe në gjuhën greke, në qytetin e Himarës.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen e zbatimit të dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.48, datë 17.5.2006, faqe 1431*

**VENDIM**  
**Nr.841, datë 13.12.2006**

**PËR PAGESËN E ANËTARËVE, NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE PËR VLERËSIMIN,  
MIRATIMIN DHE CERTIFIKIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE DHE TË MATERIALEVE  
TË TJERA NDIHMËSE, NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr. 71, datë 7.2.2007)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 52 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Anëtarët, në përbërje të bordit të miratimit të teksteve shkollore, për periudhën e veprimtarisë së bordit, të paguhet me 30 për qind të pagës mujore të “Doktorit të Shkencave”, në universitetet dhe shkollat e larta, ndërsa kryetari i bordit me 30 për qind të pagës mujore, të “Profesorit”, në universitetet dhe shkollat e larta.

2. Vlerësuesit e teksteve, të aktivizuar për kryerjen e procesit të vlerësimit, miratimit dhe certifikimit të teksteve shkollore, të paguhet, përkatësisht, sipas punës (për çdo tekst), po jo më shumë se 3 persona për secilën kategori vlerësimi duke përjashtuar nga ky rregull pagesën për anëtarët e aktivizuar gjatë vitit 2006:

- |   |             |
|---|-------------|
| a) Për vlerësim shkencor                                | 4 000 lekë; |
| b) Për vlerësim gjuhësor                                | 3 000 lekë; |
| c) Për vlerësimin e metodologjisë                       | 3 000 lekë; |
| ç) Për vlerësim dizanji                                 | 1 500 lekë; |
| d) Për vlerësim krahasues të njëjtësisë dhe ndryshimeve | 1 000 lekë. |

3. Specialistët a punonjësit, e thirrur pranë bordeve, komisioneve apo grupeve të punës, me kërkesë të bordit të miratimit të teksteve, për mbështetje teknike dhe veprime sekretarie, në

periudhat e miratimit të teksteve, të paguhen, sipas normave, për punën e kryer jashtë kohës normale të punës.

4. Shfuqizuar.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.140, datë 29.12.2006, faqe 5532*

*Vendim i KM nr.71, datë 7.2.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr.21, datë 2.3.2007, faqe 363*

## **VENDIM**

**Nr.135, datë 14.3.2007**

### **PËR KRIJIMIN E AGJENCISË QENDRORE TË VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE DHE PËR SHKRIRJEN E QENDRËS KOMBËTARE ARSIMORE TË VLERËSIMIT DHE TË PROVIMEVE**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.630, datë 29.9.2007)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Krijimin e Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, AVA, si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dhe shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve.

2. Objekti i AVA-së është vlerësimi i arritjeve të nxënësve, nëpërmjet provimeve kombëtare dhe vlerësimit të jashtëm, me kampionim, me anë të të cilit testohen dhe vlerësohen arritjet e një grupi pilot nxënësish.

3. AVA-ja ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit, dhe ka për detyrë:

a) të kontribuojë në hartimin e politikave të vlerësimeve arsimore dhe të strategjive të zbatimit të këtyre politikave;

b) të hartojë testet e provimeve kombëtare shkollore dhe të drejtojë menaxhimin e provimeve;

c) të hartojë testet e vlerësimeve të jashtme kombëtare, me kampionim, të arritjeve të nxënësve (më poshtë: Vlerësime) dhe të drejtojë menaxhimin e vlerësimeve;

ç) të analizojë dhe interpretojë, sipas standardeve bashkëkohore dhe kërkesave të grupeve të interesit, rezultatet e provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve;

d) të përgatisë ose drejtojë përgatitjen e personelit, që përfshihet në provimet kombëtare dhe vlerësimet;

dh) të krijojë dhe përditësojë një bazë të dhënash për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare dhe vlerësimet;

e) të përpunojë të dhënat shkollore dhe të maturës shtetërore, për pranimin e studentëve në shkollat e larta të vendit;

ë) të hartojë e botojë raporte për provimet kombëtare dhe vlerësimet me kampionim, për:

- politikëbërësit, vendimmarrësit, profesionistët arsimorë;

- institucionet e varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe grupet e interesit;

f) të mbështesë procesin e hartimit dhe të përdorimit të testeve të standardizuara lëndore në ndihmë të mësuesve, inspektorëve dhe drejtuesve të shkollave;

g) të marrë pjesë në trajnimin e drejtorëve të shkollave, inspektorëve dhe mësuesve, për përdorimin e testeve lëndore të standardizuara dhe përpunimin e interpretimin e arritjeve të nxënësve në to;

gj) të jetë zbatuese e testimeve ndërkombëtare, për arritjet e nxënësve, ku merr pjesë Shqipëria;

h) të hartojë çdo vit një raport për nevojat profesionale të mësuesve, të mbështetur në arritjet e nxënësve në provimet kombëtare dhe në vlerësimet;

i) të përpunojë të dhënat për provimet përfundimtare të mësuesve për shkallët e karrierës, kur një gjë e tillë i kërkohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

j) të bashkëhartojë dhe nënshkruajë dokumentin vjetor të bashkëpunimit me Institutin e Kurrikulave dhe të Standardeve dhe me Qendrën e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsim;

k) të kontribuojë në hartimin e rregulloreve të provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve.

4. Struktura dhe organika e AVA-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

5. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton:

a) Statutin dhe rregulloren e funksionimit të AVA-së;

b) Përbërjen e bordit këshillimor të AVA-së.

6. Drejtuesi i AVA-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AVA-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

8. Struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve në pozicionet "specialist" deri në "titullar i institucionit", të Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve caktohen në mbështetje të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës.

9. Numri i punonjësve të AVA-së të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

10. Për punonjësit, që pas riorganizimit humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

11. AVA-ja është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

12. Vendimi nr.309, datë 12.5.2001 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe të Provimeve", i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.34, datë 28.3.2007, faqe 653*

*Vendim i KM nr.630, datë 29.9.2007, botuar në Fletoren Zyrtare nr.133, datë 11.10.2007, faqe 3680*

**VENDIM**  
**Nr.569, datë 5.9.2007**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË 9-VJEÇARE “TIRANA INTERNATIONAL SCHOOL”,  
QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.120, datë 14.9.2007, faqe 3401*

**VENDIM**  
**Nr.579, datë 5.9.2007**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME “TIRANA  
INTERNATIONAL SCHOOL”, QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË GJUHËN  
ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë e mesme e përgjithshme “Tirana International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.120, datë 14.9.2007, faqe 3406*

**VENDIM**  
**Nr.502, datë 16.4.2008**

**PËR ADMINISTRIMIN E KONVIKTEVE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1710, datë 29.12.2008)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, të neneve 15 e 24 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave, materiale e monetare”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin e të gjitha funksioneve të administrimit të konvikteve në sistemin arsimor parauniversitar, për arsimin bazë, arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin profesional, kombëtar dhe vendor, sipas vendndodhjes territoriale të tyre, si funksion i deleguar njësive të qeverisjes vendore, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin, me transferim kapital, falas, të pasurive shtetërore të luajtshme, ku përfshihen pajisjet e kuzhinave e të mensave, inventarët në përdorim, mallrat ushqimore dhe joushqimore, gjendje në magazinë, në shërbim të konvikteve dhe të mensave, në sistemin arsimor parauniversitar, në adresë të njësive të qeverisjes vendore.

3. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim bëhen nga komisione të përbashkëta, të ngritura nga drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore dhe bashkitë e komunat.

4. Transferimi i ndërtesave të konvikteve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore do të bëhet në zbatim të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, në një fazë të mëvonshme.

5. Njësive të qeverisjes vendore, për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar, t’u shtohen 487 punonjës, të cilët pakësohen nga numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5.1 Njësive të qeverisjes vendore, për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar, t’u shtohen, respektivisht, 151 punonjës edukativë, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilët pakësohen nga numri i përgjithshëm i punonjësve, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Efektet financiare për këta punonjës të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të cilat të kalojnë si pjesë e grantit të pakushtëzuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore.

5.2 Punonjësit edukativë, që shtohen, të jenë me arsim të lartë për mësuesi.

6. Fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2008, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, për konviktet dhe të papërdorura deri më 1 korrik 2008, të kalojnë si pjesë e grantit të pakushtëzuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore.

7. Strukturat analitike, numri i punonjësve, rregullat për marrjen në punë, si emërimi, lirimi apo shkarkimi janë kompetencë të organeve të qeverisjes vendore, në zbatim të Kodit të Punës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.69, datë 21.5.2008, faqe 3025*

*Vendim i KM nr.1710, datë 29.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr.208, datë 22.1.2009, faqe 11178*

**NUMRI I PUNONJËSVE SIPAS DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE DHE ZYRAVE ARSIMORE NË KONVIKTET E SISTEMIT  
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

DAR/ZA	Punonjësit sipas emërtesës													Gjithsej punonjës	
	Nr. i konvik magazinier			Kuzhinier	Nd/kuzhinier	Pjata larëse	Rrobaqepëse	Rroba larëse	Mirëmbajtës	Pastruese	Rojë	Ekonomist	Infermiere		Kaldajist
DAR Berat	Bashkia Berat	2	2	2	2	7	1	2	2	7	3			0	28
ZA Skrapar	Bashkia Çorovodë	1	1	1	1	3	1	2		2	2				13
DAR Dibër	Bashkia Peshkopi	1	1	4		4	1	3	1	4	3	1	1	0	23
ZA Mat	Bashkia Burrel	1	1	2		2		1		3	2				11
DAR Durrës	Bashkia Durrës	2	2	2	2	2	1	1	1	6	4			1	22
DAR Gjirokastër	Bashkia Gjirokastër	2	3	4		4			1	6	3				21
ZA Tepelenë	Bashkia Tepelenë	1	1	1			1		1	1	1				6
ZA Përmet	Bashkia Përmet	1	1	1			1			1	1				5
DAR Fier	Bashkia Fier	1	1	2	1	1		1		3	3				22
	Komuna Qendër Fier	1	1	1	1	1	0	1	0	2	3				
ZA Lushnjë	Bashkia Lushnjë	1	1	1		1	1			3	1			1	9
DAR Elbasan	Bashkia Elbasan	1	0	2	2	5	2	1	1	4	3	1	0	0	36
	Bashkia Cërrik	1	0	2	1	4	1		1	3	3				
ZA Gramsh	Bashkia Gramsh	1	1	1				1		1	2	1			7
DAR Korçë	Bashkia Korçë	3	2	3	3	5	1	2		6	6				28
ZA Kolonjë	Bashkia Ersekë	1	1	1						1	0				7
	Bashkia Leskovik	1	1	1						1	1				
ZA Lezhë	Bashkia Lezhë	1	1	1	1	2	1	1		3	2				12
ZA Mirditë	Bashkia Rrëshen	1	1	1	1	4	1	2		2	1				21

	Bashkia Rubik	1	1	1	1	2	1	1		2	1				
DAR Kukës	Bashkia Kukës	1	1	1	2	3		1	5	1					14
ZA Has	Bashkia Krumë	1	1	1	1			1		1	1				6
ZA Kavajë	Komuna Golem	1	1	2	2		1	1	2	2	2				13
ZA Malësi e Madhe	Komuna Kelmend	1	1	1				1			1				4
DAR Shkodër	Bashkia Shkodër	4	4	4	5	9	3	6	0	11	6				48
ZA Pukë	Bashkia Pukë	1	1	1	1	2	1	2		4	1			1	14
DAR e Qyteti Tiranë	Bashkia Tiranë	6	7	7	6	15	1	5	7	20	12	7		4	91
DAR Vlorë	Bashkia Vlorë	2	2	4		4	1	2	2	6	3	2			26
Gjithsej		42	41	55	33	78	21	38	24	106	71	12	1	7	487



DARZA	Numri i punonjësve në konvikte		
	Gjithsej	Zv.drejtor	Edukator
DAR Berat	7	1	6
ZA Skrapar	3	1	2
DAR Dibër	5	1	4
ZA Mat	4	1	3
DAR Durrës	7	2	5
DAR Gjirokastrë	8	2	6
ZA Tepelenë	2	1	1
ZA Përmet	3	1	2
DAR Fier	6	2	4
ZA Lushnje	3	1	2
DAR Elbasan	14	2	12
ZA Gramsh	2	1	1
DAR Korçë	10	3	7
ZA Kolonjë	3	1	2
ZA Lezhë	3	1	2
ZA Mirditë	8	2	6
DAR Kukës	4	1	3
ZA Has	2	1	1
ZA Kavajë	3	1	2
ZA Malësi e Madhe	1	1	
DAR Shkodër	20	4	16
ZA Pukë	4	1	3
DAR e qytetit Tiranë	22	7	15
DAR Vlorë	7	2	5
<b>Gjithsej</b>	<b>151</b>	<b>41</b>	<b>110</b>

**VENDIM**  
**Nr.743, datë 1.7.2009**

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLË E MESME “KRYQI I NDERUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, shkollë e mesme “Kryqi i nderuar”, në Sukth, Durrës, që, sipas programit mësimor, do të zhvillojë edhe lëndë fetare.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin, nga ky institucion, të dispozitave ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin e nxënësve.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, datë 31.7.2009, faqe 5594*

**VENDIM**  
**Nr.799, datë 22.7.2009**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR,  
PËR PERIUDHËN 2009-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit parauniversitar, për periudhën 2009-2013, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.133, datë 10.9.2009, faqe 6201*

**STRATEGJIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**  
**(2009-2013)**

**LISTA E SHKURTIMEVE TË PËRDORURA**

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
CARDS	Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CBA	Cilësi dhe Barazi në Arsim
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
EFA	Arsimi për të Gjithë
EMIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim
GDP	Produkti Kombëtar Bruto
IKT	Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit
ILO	Organizata Botërore e Punës
ISCED	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit. UNESCO
INSTAT	Instituti i Statistikave
LSMS	Studimi Vlerësues i Standardit të Jetesës
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MBP	Menaxhimi mbi bazë performance
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
PV	Pushteti Vendor
DAPPS	Drejtoria e Analizës së Politikave dhe Planifikimit Strategjik
SKZHAP	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZA	Zyrë arsimore

## KAPITULLI I

### SITUATA AKTUALE PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Sistemi arsimor kombëtar shërben si sektor shërbimi, i cili do të pajisë qytetarët e ardhshëm shqiptarë me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar ekonomik e zhvillimor të vendit. Ky sistem, duke synuar plotësimin e nevojave kombëtare të tregut të punës dhe aspiratat social-kulturore të popullit, paraqitet si kushtëzues për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Përmbushja e objektivave afatmesme e afatgjata për rritjen e qëndrueshme ekonomike, reduktimin e varfërisë dhe zgjidhjen e problematikave sociale kërkon, në radhë të parë, reformimin e sistemit arsimor, si mbështetja reale për realizimin e nismave qeveritare. Në këtë kuadër vijimi i reformave në këtë sektor jetësor të shoqërisë duke pasur objektiva të qarta kanë një rëndësi të veçantë.

Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar SKAP shtron synime dhe objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm për sistemin dhe paraqet politikat për prioritetet strategjike për vitet që pasojnë deri në vitin 2013. Kjo strategji përfshin arsimin parashkollor, arsimin parësor dhe dytësor, arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin profesional.

Strategjia është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të arsimit në Evropë dhe në botë dhe ka si qëllim të orientojë zhvillimin e arsimit parauniversitar, në përputhje me vizionin e Qeverisë për politikat afatmesme dhe afatgjata për sektorin. Në të janë përfshirë sugjerimet e botës akademike dhe të grupeve të interesit brenda vendit. Strategjia përbën bazën e një Plani Veprimi me detyra të programuara për zbatim deri në vitin 2013.

Kapitulli në vijim evidenton problemet kryesore të gjendjes aktuale duke i ndarë në këto çështje të mëdha:

1. Pjesëmarrja në arsimin parauniversitar;
2. Sfidat e arsimit të mesëm profesional;
3. Cilësia e procesit mësimor;
4. Qeverisja-reformimi dhe forcimi i kapaciteteve menaxhuese, financimi i arsimit parauniversitar;
5. Ngritja e kapaciteteve dhe burimet njerëzore.

1. Pjesëmarrja/aksesi në arsimin parauniversitar

Aksesi në arsimin parauniversitar paraqet në nivel të ulët në krahasim me vendet e OECD. Aktualisht, në Shqipëri mesatarja e ndjekjes së shkollës është 11.9 vjet<sup>[1]</sup> (vendet e OECD: 14 vjet), gjë që shpjegohet me shkallën e ulët të frekuentimit të arsimit mesëm. Ka gjithashtu një variacion të madh në pikëpamjen e krahinave, p.sh. një i rritur në Tiranë ndjek shkollën mesatarisht 3.5 vjet më shumë në krahasim me mesataren e Republikës.

Tabela 1: Të dhëna statistikore për arsimin (2007-2008) krahasuar me vendet e rajonit dhe BE

Nr	Treguesi	Shqipëria	Evropa	Serbia	Maqedonia	Kroacia	Slllovenia
1	Mesatarja e viteve të shkollimit (ISCED 0-6)	11.9	17,4	13	12	15	16,2
2	Koha e mësimdhënies dhe e të mësuarit në shkollë						
	Numri mesatar i orëve në vit për moshat që i korrespondojnë arsimit të detyrueshëm	550 790	750 900	620 800	600 800	620 810	630 820
	Moshat 7-8	167	185	185	180	183	185
	Mosha 15	35	37	37	36	37	38
	Numri i ditëve të mësimdhënies						
	Numri i javëve të mësimdhënies						
3	Përqindja e regjistrimit neto						

	Parashkollor (ISCED 0)	50	75	45	29	45	75
	Shkolla e detyruar bazë (ISCED 1-2)	92	95	96	93	90	93
	Shkolla e mesme (ISCED 3)	57	85	82	80	84	91
	Përqindja e nxënësve në shkollat e mesme profesionale	19	62,7	70	65	70	

I parë në një këndvështrim të përgjithshëm në nivel vendi, tendencat në frekuentimin e shkollës në nivelin e arsimit parauniversitar projektohen si dy dimensionale: a) ulje në shifra absolute të numrit të nxënësve, si rezultat i uljes së numrit të lindjeve dhe b) rritje e përqindjes së pjesëmarrjes në nivelet më të larta për pasojë të politikave favorizuese të ndjekura nga qeveria. Tabela në vijim paraqet përqindjet e regjistrimeve<sup>[2]</sup> sipas nivelit arsimor:

Tabela 2: Regjistrimi në arsimin parauniversitar

Nr.	Viti shkollor	2004 - 2005		2005 - 2006		2006 - 2007		2007 - 2008		2008 - 2009	
		GER <sup>[3]</sup>	NER <sup>[4]</sup>	GER	NER	GER	NER	G E R	N E R	G E R	NER
1	Cikli i Arsimit Parashkollor	50	50	50	48	50	47	51.8	49	52.6	49.6
2	Cikli i plotë 9 - vjeçar	103	94	101	94	100	94	98	92	94.3	89.3
3	I mesëm i përgjithshëm	59	51	64	53	68	55	70	57.5	69.5	59.9

Lidhur me braktisjen e shkollës për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar rezultojnë në shifrat 0.94%. Siç vihet re është një shifër relativisht e ulët.

Braktisja e shkollës përbën një fenomen për fëmijët të shtresave në nevojë dhe sidomos ata romë. Aktualisht në Shqipëri ka rreth 5000 fëmijë romë të moshës 3-16 vjeç. Niveli i regjistrimit të fëmijëve në shkollë në moshën e caktuar sipas ligjit është i ulët. Vetëm 27% e fëmijëve në moshën 6 vjeç ndjekin aktualisht klasën e parë. 1 në rreth 2 fëmijë romë në moshë shkollë (6-16 vjeç) e ka braktisur shkollën. 54% e fëmijëve romë në moshën e detyrimit shkollor (6-16 vjeç) nuk kanë përfunduar asnjë klasë shkollë. 43% e fëmijëve romë të grupmoshës 15-16 vjeç janë analfabetë. Fenomeni bëhet edhe më shqetësues për vajzat rome. Rëni në frekuentimin shkollës prej vajzave rome pas moshës 11 vjeç janë dukshëm më të larta sesa ato të meshkujve (Në moshën 12 vjeç vajzat rome frekuentojnë shkollën në një masë prej 23% më pak sesa djemtë).

Problem përbëjnë dhe fëmijët e familjeve me të ardhura të pakta, të zonave të thella malore, vajzat në zonat me mentalitet të prapambetur dhe me probleme të tjera sociale.

Arsimi parashkollor. Ndarja e arsimit bazë në vitet e arsimit të detyruar dhe në vitet e arsimit parashkollor, duke i dhënë këtij të fundit vetëm një rol ndihmës, tashmë është tejkaluar.

Studimet kanë treguar se ndërhyrja cilësore në fëmijërinë e hershme ka një normë të lartë kthyeshmërie në arsimin bazë dhe më tej për të gjithë personat që përfitojnë nga kjo ndërhyrje. Si rrjedhim duhet të nxitet zhvillimi i arsimit parashkollor .

Ritmet e zhvillimit të arsimit parashkollor, në 15 vitet e fundit, kanë qenë të ngadalta. Fakti që arsimi parashkollor nuk bën pjesë në arsimin e detyruar ka kushtëzuar mungesën e vëmendjes së të gjitha Qeverive që pasqyrohet në zvogëlimin e vijueshëm të fondeve që alokohen për arsimin parashkollor. Nëse në vitin 2001 për arsimin parashkollor shpenzohej 5.9% e buxhetit të arsimit, në vitin 2005 ky tregues është 4.7%. Për pasojë, gjendja e ndërtesave të kopshteve dhe pajisjet e tyre me orë dhe mjete didaktike është e varfër dhe larg standardeve të përcaktuara. Kërkesat e shumta të prindërve për këtë shërbim, veçanërisht në zonat urbane të prekura nga migrimi i 15 viteve të fundit, mbeten të paplotësuara.

Megjithatë, në raport me numrin total të fëmijëve, përqindja e atyre që frekuentojnë kopshtet shënon rritje. Në vitin 1992, vetëm 34 % e fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç shkonin në kopsht, në vitin 2005 ky tregues ishte në 48.8 %, ndërsa në vitin 2009 arriti në 50%<sup>[5]</sup>). Duhet vënë në dukje se në shifra absolute numri i fëmijëve ka ardhur në rënie si në qytet edhe në fshat<sup>[6]</sup>, kjo për shkak të rënies së numrit të fëmijëve si pasojë e rënies së numrit të lindjeve, të emigracionit si dhe papunësisë së grave<sup>[7]</sup>.

Përpjekjet e viteve të fundit janë përqendruar në dobësitë e shfaqura: përmirësimi i infrastrukturës (sidomos në zonat rurale) që konsiston në përmirësimin e kushteve fizike që lidhen me godinat e pajisjet, të mjeteve didaktike si mjeteve bazë mësimore dhe sidomos në rritjen e cilësisë së mësimin të zhvillimit në kopshte si nëpërmjet zgjerimit të përshkallëzuar të zbatimit të standardeve të përmbajtjes, të koncepteve e praktikave bashkëkohore (të provuara tashmë në disa kopshte-pilot, duke i kthyer këto të fundit edhe në qendra-trajnuese), si dhe në drejtim të personelit.

Arsimi bazë. Ai zgjat 9 vjet dhe është i detyrueshëm me ligj. Është baza e gjithë arsimit parauniversitar.

Struktura e ciklit të ulët në arsimin e detyruar ka ndryshuar me planin e ri mësimor të miratuar nga Min istria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2004. Në bazë të kësaj strukture kohëzgjatja e këtij cikli ka ndryshuar nga 4 në 5 vjet. Në klasën e parë regjistohen fëmijë që mbushin moshën 6-vjeçare deri ditën e filimit të shkollës.

Infrastruktura fizike nuk i përgjigjet në të gjithë shtirjen e tij (sidomos në zonat rurale) kërkesave bashkëkohore. Këtu shtohet dhe mbështetja e pamjaftueshme e procesit mësimor me mjete shkencore didaktike, laboratorë kompjuterash, aplikativë ose demonstrativë, dixhitilazimi i proceseve administrative e vendimmarrës, pajisja me mobilje të përshtatshme në mbështetje të mësimin, etj.

Lidhur me cilësinë e mësimin, rishikimi i kurrikulave përbën një domosdoshmëri për arritjen e niveleve maksimale të tij.

Veprimi i këtyre faktorëve në ndërthurje me veprimin e faktorëve të jashtëm socialë ngrenë sfidën e zbutjes së analfabetizmit (duke mos e konceptuar ngushtë vetëm me braktisjen e shkollës), si dhe domosdoshmërinë e gjetjes së mekanizmave të përshtatshëm thithës e tërheqës në ato shkolla ku ky problem është më i mprehtë.

Arsimi i mesëm. Vihet re një rritje e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm vitet e fundit, si rezultat i politikave arsimore favorizuese të ndjekura nga MASH. Për vitin shkollor 2008-2009 tërheqja e nxënësve në arsimin e mesëm është rritur në 80 % të nxënësve që mbaruan arsimin e detyruar, kundrejt shifrës 71% që ishte në vitin shkollor 2003-2004<sup>[8]</sup>. Duhet vënë në dukje se përqindja aktuale e thithjes nga arsimi bazë konsiderohet akoma e ulët, e krahasuar kjo dhe me standardet evropiane (95 – 100%).

Numri i nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm me shkëputje nga puna, është rritur me 7577 nxënës. Për arsimin me shkëputje nga puna raporti: nxënës në arsimin e mesëm të përgjithshëm/nxënës në arsimin profesional është 81 me 19.

Gjithashtu ka një rritje të numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm jopublik. Në dy vitet e fundit është rritur me afërsisht 2000 në vit. Në të njëjtën kohë shënon rritje dhe numri i shkollave jopublike.<sup>[9]</sup>

Në rritjen e numrit të nxënësve në arsimin e mesëm ka ndikuar përmirësimi i kushteve të mësimin, përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor, si dhe shtirja e arsimit të mesëm profesional në degë të preferuara në varësi edhe të kërkesave të komunitetit dhe tendencave rajonale të zhvillimit në përputhje me kërkesat e tregut.

Me gjithë treguesit në rritje, arsimi i mesëm i përgjithshëm vijon të paraqesë probleme infrastrukture duke filluar me mbipopullimin e klasave në qytetet e mëdha apo me numrin e paktë të nxënësve në zonat rurale që rrit shpenzimet për nxënës në to. Kurrikulat në kuadrin e ndryshimeve strukturore të arsimit dhe në përgjigje të kërkesave të kohës kërkojnë vëmendje të veçantë dhe përditësim. Programet janë të ngarkuar nga ana konceptuale dhe kanë më shumë karakter teorik. Mungojnë metodat bashkëkohore të të mësuarit në funksion të nxitjes së të menduarit kritik, puna në grup dhe puna e pavarur. Gjithashtu gjykohet se në disa raste mungon lineariteti i përvetësimit të

koncepteve teorikë apo vërehet fragmentizimi i tyre. Nxënësit shfaqin mangësi të theksuara në njohuritë e gjuhës (drejtimi humanistik) dhe matematikë (drejtimi natyror), njohuri këto bazë të formimit të përgjithshëm.

Vlerësimi i nxënësve paraqet mangësi.

Problem vijon të mbetet dhe gjendja e pajisja e laboratorëve mësimorë e shkencorë, raporti kompjuter/nxënës, bibliotekat dhe dixhitalizimi i proceseve administrative.

## 2. Sfidat e arsimit të mesëm profesional (AP)

Sistemi aktual i arsimit dhe formimit profesional (AFP) në Shqipëri është i dobët, me gjithë ndërhyrjet reformuese të ndërmarra vitet e fundit, si dhe mbështetjen e donatorëve të huaj.

Kjo situatë, ndër të tjera është rrjedhojë e konceptimit të tij, vetëm brenda logjikës së sistemit të arsimit, rolit të paqartë dhe natyrës jo të plotë të rregullimeve institucionale, etj.

Në përgjithësi, ka mungesë të infrastrukturës së përshtatshme, financim të pamjaftueshëm e mekanizma financiarë të paqëndrueshëm, nivel të ulët të burimeve njerëzore, kurrikula të vjetruara dhe metodë menaxhimi të tejkualuar. Mungon sistemi i trajnimit paraprak (*pre-service*) për mësuesit dhe instruktorët e lëndëve e praktikave profesionale, si edhe mungon një program kombëtar i posaçëm për trajnimin në punën të tyre.

Shtirja dhe cilësia e arsimit profesional, pavarësisht prej zhvillimeve të kohëve të fundit, nuk u përgjigjet kërkesave të tregut të punës, reagon dobët ndaj këtyre të fundit dhe vijon të ketë lidhje të dobëta me partnerët socialë dhe aktorët e interesuar në përgjithësi. Kurrikula e AP, pavarësisht nismave për modularizim dhe decentralizim, në përgjithësi, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme për ta përshtatur me kërkesat e tregut dhe përfshirjen e përvojës evropiane në të. Sistemi i kualifikimit dhe certifikimit karakterizohet nga një orientim i pamjaftueshëm i ndaj zhvillimeve dhe standardeve të reja të BE.

Aktualisht në shkallë vendi funksionojnë 41 shkolla të arsimit teknik e profesional si dhe 33 shkolla social – kulturore (5 nga të cilat janë bashkë me shkolla tekniko – profesionale), të shpërndara në 22 rrethe. Nga këto, në zonat rurale funksionojnë 3 shkolla profesionale, me drejtim kryesor bujqësi-agrobiznes. Shkollat janë të ndara në 4 fusha kryesore: elektro-mekanike (19 shkolla), ekonomike (9 shkolla), ndërtim-mobileri (4 shkolla); bujqësi, pyje, veterinari (9 shkolla). Nxënësit përgatiten në rreth 35 specialitete kryesore.

Duke iu referuar regjistrimeve të vitit shkollor 2007 - 2008 në klasën e parë janë regjistruar gjithsej 7 093 nxënës, ku degët më të ndjekura janë mekanik automobilash, instalues hidrosanitar, ekonomik 5-vjeçar, elektrik i përgjithshëm 5-vjeçar, dhe më pak të ndjekura degët: përpunim druri, fermer, pyje, etj. Në këto shkolla në këtë vit shkollor mësonin gjithsej 27 288 nxënës nga të cilët 4 408 jetonin në konvikte.

Numri i nxënësve të regjistruar në shkollat tekniko-profesionale publike, duke përfshirë edhe ato artistike, pedagogjike, sportive dhe të gjuhëve të huaja (të ashtuquajtura social-kulturore), në vitin shkollor 2007 – 08 përbënte rreth 19% të nxënësve që vijonin arsimin e mesëm në përgjithësi. Kjo shifër është mjaft e ulët, duke pasur parasysh që në vendet e OECD, ky tregues është rreth 50% dhe në disa vende të zhvilluara perëndimore, akoma më i lartë.

Përsa i përket formimit profesional (FP), ai ofrohet nëpërmjet 10 qendrave publike të formimit profesional në qytetet më të mëdha të vendit si Vlorë, Shkodër, Tiranë (operojnë 2 qendra), Durrës, Elbasan, Korçë, Tepelenë dhe Fier dhe Qendra e Lëvizshme e Formimit Profesional Publik për Zonën Verilindore, si dhe 150 subjekte private të licencuara që ofrojnë formim profesional, nga të cilat 24 janë OJF, me një shtrirje në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Megjithatë, si arsimit profesional, ashtu dhe formimi profesional vijojnë të kenë një reputacion të ulët nga pikëpamja cilësore dhe në to angazhohen një përqindje mjaft e ulët e nxënësve, të rinjve, apo të rriturve. Edhe sektori privat i AFP është ende i dobët dhe karakterizohet nga tipare të ngjashme me atë publik.

Integrimi Evropian parashtron kërkesa të tilla, që e bëjnë të domosdoshëm përfshirjen e AFP në rrjedhën e zhvillimeve bashkëkohore, në harmoni me ato çka po ndodhin në rajon dhe Bashkimin Evropian. Ndikimet e proceseve të Bolonjës, Lisbonës dhe Kopenhagenit tashmë janë të pranishme dhe në Shqipëri dhe po ushtrojnë një “presion” pozitiv në nivelet politike për të kaluar

nga “riparimet e pjeshme sipas nevojave të çastit” drejt “zgjdhjeve të plota e afatgjata” në kontekstin e integritit rajonal dhe Evropian. Aktualisht, një sfidë për AFP paraqet fakti që sistemi i kualifikimit dhe certifikimit është i orientuar në mënyrë të pamjaftueshme ndaj zhvillimeve dhe standardeve të reja të BE-së.

Është miratuar në Këshillin e Ministrave dhe pritet miratimi nga Kuvendi i Ligjit për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve në përshtatje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

Gjithashtu, është kapërcyer faza e “pilotimeve në nivel shkolle”, me shanse të ulta për vijimësi e shtrirje të mëtejshme dhe po synohet krijimi i kushteve për zhvillimin e sistemit modern dhe unik të AFP.

Megjithatë, politika e reformimit të AFP në Shqipëri duhet të orientohet gjithnjë e më tepër drejt një “reformë të sistemit” duke përfshirë çështje të tilla si Korniza Shqiptare e Kualifikimeve profesionale (KSHK), zhvillimi institucional, akreditimi, certifikimi, analiza a tregut, analiza e nevojave, standardet, partneriteti social, etj.

### 3. Cilësia e procesit mësimor

Duke qenë se kurrikula dhe procesi mësimor përfaqësojnë bazën e sistemit arsimor, përmirësimet e sistemit nisin pikërisht me rishikimin e kurrikulës dhe modernizimin e procesit mësimor. Që nga viti 1993, kurrikula e arsimit parauniversitar dhe procesi i mësimdhënie-mësimnxënies kanë qenë dhe mbeten objekt përmirësimesh të vijueshme. Megjithëse është miratuar korniza e re kurrikulare për gjimnazin, problem mbetet kurrikula e arsimit bazë, në kundërvënje me prirjet zhvillimore, me përmbajtje jorelevante, metodat disi arkaike dhe jo efektive të mësimi. Vlerësimi dhe rihartimi i saj mbeten një sfidë në zhvillimin e një reforme tërësore dhe funksionale për cilësinë e arsimit.

Në të njëjtën mënyrë përgjithësisht mësuesit përqendrohen më shumë në përmbajtjen e teksteve shkollorë se sa në objektivat e kurrikulës.

Në lidhje me tekstet mësimore, pajisja me to e nxënësve bëhet mbas përzgjedhjes së tyre ndërmjet teksteve alternativë. Furnizimi i ka kaluar sektorit privat.

Për të gjitha klasat, MASH miraton standardet dhe programet lëndore të hartuara nga IKT, monitoron cilësinë e botimit, nëpërmjet KMT, për specifikimet teknike dhe përshtatjes me programin dhe garanton shpërndarjen në kohë të tyre. Tipar karakteristik është transparenca në përzgjedhjen dhe vlerësimin e teksteve alternative, nëpërmjet procedurave të hapura me pjesëmarrjen e eksperteve të shquar të fushës së botimeve dhe të mësuesve e përdoruesve të teksteve shkollorë.

Ky proces po orientohet shkallë-shkallë drejt liberalizimit të plotë të tregut të botimit të teksteve shkollorë.

Krahasuar me treguesit e ngarkesës për vendet e OECD, aktualisht ngarkesa mësimore e nxënësve tanë është shumë e lartë.

Përsa i përket kualifikimit të mësuesve<sup>[10]</sup> vihet re se trajnimet e realizuara deri tani kanë arritur të sjellin terma, koncepte dhe praktika bashkëkohore mësimdhënieje e nxënieje duke krijuar një mentalitet të ri për ushtrimin e profesionit të mësuesisë. Megjithë arritjet, vihen re mangësi dhe kërkohen ndërhyrje thelbësore e tërësore. Përderisa planifikimi vjetor i trajnimeve nuk mbështetet në plane strategjike afatmesme kombëtare ose lokale, sistemi aktual i trajnimit të mësuesve çfaq tendenca spontaniteti. Ky sistem karakterizohet dhe nga centralizmi, përderisa mbështetet tepër pak ose nuk mbështetet fare në identifikimin shkencor të nevojave profesionale të mësuesve në nivel qendror ose lokal. Këto tipare bëjnë që në këtë sistem të mbizotërojë oferta në dëm të kërkesës.

Trajnimet nuk planifikohen gjithnjë me pikënisje standardet profesionale të mësuesve dhe përmbajtja e tyre nuk hartohet mbështetur në objektiva të qarta kompetencash.

Gjatë viteve të fundit, krahas ndihmesës që ka dhënë qeveria, në ngritjen profesionale të mësuesve ka ndikuar mjaft edhe ndihmesa e organizmave të huaja dhe OJF vendase të mbështetura financiarisht nga donatorë të huaj. Por, ky kontribut ka mbetur i pakoordinuar, i fragmentarizuar, i pabarabartë për nga shtrirja gjeografike.

Që nga viti 2007 funksionon Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit (IKT), i cili është i fokusuar në dhënie të trajnimeve dhe kualifikimeve të specialistëve të arsimit parësor, duke siguruar rritjen e

performancës dhe rritjen e cilësisë së sistemit arsimor në përgjithësi. Nga IKT në tremujorin e katërt të vitit 2007 u trajnuan 6 600 mësues dhe 1 345 drejtues shkollash. Në vitin 2008 u trajnuan 16 732 mësues dhe 4 816 drejtues. Me të njëjtat përmasa parashikohen dhe trajnimet për vitin 2009.

Sistemi i zhvillimit profesional të mësuesve është i orientuar kryesisht nga trajnimi, duke lënë të pashfrytëzuar mirë të nxëniet ndërmjet mësuesve të një lënde brenda shkollës, atyre të një shkolle apo dhe grup shkollave të afërta. Botimet janë të pakta dhe të mangëta për të nxënë nga përvojat e suksesshme të kolegëve vendas e të huaj, kurse oferta e informacionit elektronik mungon si një shërbim i organizuar.

Shërbimi trajnues është i paakredituar përmes standardeve të sigurimit të cilësisë, i mangët për nga larmia e agjencive trajnuese, pasi në të nuk janë të përfshira vetë shkollat dhe universitetet; ai është i pabalancuar ndërmjet lëndëve, pasi ka lënë në hije ato shkencore kundrejt lëndëve shoqërore, nuk orienton vëmendjen e drejtuesve të shkollave kundrejt mësuesve, e më tej frenon shndërrimin e trupës së mësuesve të një shkolle në një organizatë profesionale, si dhe vuan nga një përshtatshmëri tejet e ulët ndaj nevojave individuale dhe të grupit të mësuesve në përgjithësi e ndaj mësuesve të rinj në veçanti.

Asistenca profesionale ndaj mësuesve e realizuar nga drejtuesit e shkollave është me dobi të papërfillshme, përgjithësisht katandiset thuajse në zëvendësimin e këshillimit profesional me kontrollin e madje autoritarizmin hierarkik dhe rezulton kështu me kosto-efektivitet të ulët. Asistenca nëpërmjet inspektorëve është ende pak e ndikueshme për shkak të mangësive të tyre profesionale dhe të përqendrimit të tyre në kontroll.

Sistemi i kualifikimit të mësuesve, i ngritur mbi parimin e pagës sipas meritës, nuk ka arritur qëllimin sepse ka funksionuar si një sistem provimesh që bie një shtesë automatike të pagës.

Një nga çështjet më kritike, me të cilat përballet MASH, është trajnimi i rreth 20% të mësuesve të pakualifikuar (pa arsim përkatës ose jashtë profilit) si dhe i mësuesve të rinj, në mënyrë që ata të përmbushin kompetencat në përdorimin e metodave të reja të mësimdhënie-mësimnxënies.

Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë një nga treguesit kryesorë të cilësisë dhe performancës së sistemit arsimor, sidomos kjo lidhur me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe shprehje të afta për përballimin e sfidave e kërkesave të kohës nga ana e tyre.

Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve (PISA<sup>[11]</sup>), që përbën një nga studimet më prestigjioze ndërkombëtare për matjen e arritjeve të nxënësve, është zbatuar fillimisht në 2001. Ky program tregoi se rezultatet janë relativisht të dobëta.

Krahasuar me treguesit e ngarkesës për vendet e OECD, aktualisht ngarkesa mësimore e nxënësve tanë është shumë e lartë.

Raporti nxënës/mësues Sipas tabelës 3 (më poshtë), shihet se ky raport është më i lartë në nivelin e arsimit të mesëm për qytetet kryesore. Një nga shkaqet e uljes së nivelit të cilësisë së mësimin është mbipopullimi i klasave sidomos në zonat e periferive të qyteteve kryesore si rezultat, siç përmendëm më sipër, i migrimit të brendshëm. Reagimi i ngadaltë i sektorit publik ndaj migrimit të popullsisë nga fshati në qytet ka bërë që shkollat në qytete dhe në zonat periferike urbane të punojnë mbi kapacitetin e tyre. Në të kundërt, në disa zona rurale raporti nxënës-mësues në nivel zonash është shumë i ulët dhe infrastruktura e dobët e transportit nuk mundëson përqendrimin e shkollave. Veç kësaj, marrja e masave të mëtejshme për rritjen e përqindjes së regjistrimit në ciklin e dytë, sidomos të fëmijëve të zonave rurale, e në veçanti vajzave, është e domosdoshme, duke përmbushur në këtë mënyrë një prioritet në kuadër të Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit të OKB dhe Partneritetit Evropian<sup>[12]</sup>.



Tabela 3: Raporti nxënës/arsimtar/ klasë/ shkollë për vitin shkollor 2007 - 2008<sup>[1]</sup>

	Niveli i arsimit	Raporti (në nivel kombëtar)	Viti shkollor 2006 - 07	Viti shkollor 2007 - 08	Mbi mesatare	Nën mesatare
1	Parashkollor	fëmijë/ edukatore	20.3	19.8	Durrës, Fier, Lezhë, Kukës, Tiranë Qytet	Gjirokastrë, Vlorë
		fëmijë/ grup	23.8	22.7	Fier, Durrës, Kukës, Lezhë, Tiranë Qytet	Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë Rreth
		fëmijë/ kopësht	45.2	44	Durrës, Kukës, Lezhë Tiranë Qytet (149).	Berat, Dibër, Fier, Shkodër
2	9 - vjeçar	nxënës/ mësues	17.2	17	Durrës, Lezhë, Tiranë Rreth, Tiranë Qytet	Berat, Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë
		nxënës/ klasë	22.1	22	Durrës, Fier, Lezhë, Tiranë Qytet	Berat, Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë
		nxënës/ shkollë	289.1	276	Durrës, Fier, Tiranë Rreth dhe Tiranë Qytet (849 <sup>[14]</sup> )	Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Vlorë
3	Mesëm	nxënës/ mësues	20.0	20	Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Tiranë Qytet, Tiranë Rreth	Berat, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Vlorë
		nxënës/ klasë	35.2	32	Durrës, Dibër, Fier, Tiranë Qytet	Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Vlorë
		nxënës/ shkollë	373.6	378	Durrës, Tiranë Qytet	Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Vlorë

Infrastruktura fizike e mësimi përbën një drejtim tjetër të përmirësimeve të vërejtura dhe të nevojshme për t'u përmirësuar në mënyrë sasiore dhe cilësore. Përveç hapësirave për çdo nxënës merren në konsideratë dhe kushte fizike të tilla si pamjaftueshmëria sasiore dhe cilësia e laboratorëve mësimorë e didaktikë, bibliotekat shkollore, lehtësirat e teknologjisë së informacionit si biblioteka dixhitale e kabinete informatike e burimore, etj.

Situata në shkolla paraqet mangësi, si në materialet didaktike dhe pajisjen me laboratorë, ashtu edhe në mirëmbajtjen e shkollave.

Në kuadër të decentralizimit mirëmbajtja e shkollave dhe investimet në infrastrukturën arsimore kanë kaluar në përgjegjësi të pushtetit vendor. Ndërkaq, financime të konsiderueshme i janë dhënë nëpërmjet granteve pushtetit vendor për ndërtimin dhe renovimin e shkollave. Në periudhën 2005 deri në mesin e vitit 2009 janë ndërtuar me Buxhetin e Shtetit 183 objekte të reja shkollore dhe rinovuar 691 të tjera<sup>[14]</sup>. Për periudhën 2005 – 2008, shpenzimet në Buxhetin e Shtetit, për këto ndërtime së bashku me pajisjen e shkollave, arritën në 12 193 170 000 lekë. Ndërsa për vitin 2009 janë planifikuar 12 272 422 lekë.

Një alternativë ndaj arsimit publik paraqitet dhe arsimit privat, treguesit e të cilit vijnë në rritje. Që nga viti 1995, kur u lejua hapja e shkollave private, ato janë zgjeruar me një ritëm të moderuar duke arritur që në vitin shkollor 2008 – 2009 të përfshijnë 4.9% të fëmijëve në arsimin parashkollor; 5.5% të nxënësve në arsimin parauniversitar (4.46% në arsimin bazë, 9.9% në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe 8% në arsimin e mesëm profesional)<sup>[15]</sup>.

#### Zhvillimi i arsimit jopublik në shifra

	Niveli i arsimit	Tregues për	Viti shkollor				
			2003 - 04	2004 - 05	2005 - 06	2006 - 07	2007 - 08
1	Arsimi 9-vjeçar	Nxënës	13600	14608	16108	17369	18358
		Shkolla	89	91	103	105	120
2	Arsimi i Mesëm	Nxënës	7700	9231	11316	13079	14470
		Shkolla	51	68	77	93	106

Në vitin shkollor 2007–2008 operonin 86 kopshte private nga të cilët 49 me ushqim dhe vetëm 15 prej tyre në fshat, 120 shkolla 9-vjeçare nga të cilat 9 në fshat, 106 shkolla të mesme nga të cilat 7 në fshat.

MASH luan një rol vendimtar në nxitjen e ushtrimit e veprimtarive të institucioneve arsimore private. MASH nëpërmjet proceduarve të miratuara për licencimin e tyre, u kërkon atyre plotësimin e një sërë kërkesash dhe standardesh lidhur me mjediset e mësimit dhe të aktiviteteve të tjera lidhur me të, organizimin, strukturat funksionale, programet e ndjekura si dhe organizimin e metodat e procesit mësimor.

Në të njëjtën kohë, duke e parë si një alternativë zhvillimi, mashë ka lehtësuar mjaft procedurat e licencimit duke shkurtuar ndjeshëm kohën e duhur për këtë. MASH mbështet procesin mësimor që zhvillohet në shkollat private jo vetëm duke kërkuar kushte mësimi sa më të mira dhe brenda standardeve por edhe duke u ofruar trajnime mësuesve ashtu si atyre të sektorit publik.

MASH subvencionon tekstet e nxënësve të shkollave private ashtu si dhe të atyre publike.

#### 4. Qeverisja – reformimi dhe forcimi i kapaciteteve menaxhuese

Qeverisja në arsim, veçanërisht lidhur me decentralizimin paraqet një nevojë urgjente për t'u zhvilluar sipas standardeve të kohës.

Ndërsa ristrukturimi formal kah decentralizimi ka shënuar progres të dukshëm në disa sektorë, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, ritmet e decentralizimit të përgjegjësive dhe të autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror drejt atij vendor për arsimin parauniversitar nuk kanë qenë të kënaqshme.

Së pari, mungon lidhja e plotë e funksionale e shkollës me komunitetin si një detyrim demokratik për të siguruar një arsim të mirë për të gjithë. Mungon mbështetja në fuqinë e familjes, në karakterin social të komunitetit, për të përmbushur plotësisht përpjekjet për arsimim. Kjo bazohet në nivelin jo të kënaqshëm të pjesëmarrjes dhe të përgjegjësisë së gjithë aktorëve. Pasojat ndihen në drejtim të mosfunksionimit në përputhje me nevojat e kërkesat e komunitetit të udhëheqjes arsimore, menaxhimit të shkollës, përmbajtjes së kurrikulave, planifikimit dhe menaxhimit të financave, mirëmbajtjes së shkollës, menaxhimit të personelit për të ofruar një shërbim bashkëkohor arsimor dhe kryerjen e funksionit integruar të shkollës.

Së dyti, qeverisja disa herë e centralizuar dhe e bazuar në urdhër, pasojë e mungesës së decentralizimit efektiv dhe transferimit të përgjegjësive dhe autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror në nivelin lokal të qeverisjes shpie në planifikimin e zhvillimin e fragmentizuar dhe jo me ritmet e kërkuara të vizionit arsimor në të gjitha nivelet, si dhe me mangësi në planifikimin e zhvillimin shkollor në të gjitha fushat, përdorimin eficient të burimeve të disponueshme për zhvillim, planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit vjetor, gjetjen e menaxhimin e fondeve shtesë, shpërndarjen e arsimit cilësor në të gjitha nivelet, etj

Së treti, pavarësisht nga përpjekjet e bëra deri tani për reformimin e mënyrës së auditimit dhe inspektimit në Sistemin Arsimor dhe arritjeve të pjesshme në këtë drejtim, ka ende të pranishme mbetje të praktikave të vjetra tradicionale në këtë fushë. Mangësi vihen re në konceptimin e përmbajtjes së këtyre funksioneve. Në vend të rolit të mbështetësve të zhvillimit të shkollës, audituesit mbeten shpesh në nivelin e kontrollit financiar dhe vëzhgues të jashtëm të procedurave ligjore dhe administrative. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për inspektimin në drejtim të standardeve, përmbajtjes e metodave të mësimit si dhe ato administrative.

Së katërti, mungesë serioze vihet re në funksionimin e kryerjen e plotë të rolit nga ana e bordeve të shkollës dhe të DAR/ZA. Ato ose shërbejnë si një lloj organizmi formal për plotësimin e rregullave rutinë, ose janë tërësisht joekzistente. Në rastet më të mira bordet e shkollave paraqiten si shtesa të drejtorive të shkollave dhe roli i tyre kufizohet në garantimin e kontributeve financiare nga ana e biznesit vendas. Ngritja dhe nxitja e këtyre organizmave është një domosdoshmëri për zhvillimin e autonomisë shkollore.

Së pesti, mangësi vihen re dhe në planifikimin e menaxhimin arsimor vendor e shkollor që bazohet në monitorimin dhe vlerësimin e jashtëm të shkollës, vetëvlerësimin e shkollës e vlerësimin e nxënësve, analiza e planeve të shkollës, etj ku ka mungesë konceptimi dhe kapacitetesh.


Së gjashti, normat e reja të sistemit arsimor shqiptar i lejojnë mësuesit të marrin iniciativa në 20% të kurrikulës, gjë që nuk është vënë ende në praktikë. Mësuesit nuk ndjehen të sigurt sa duhet për ta përdorur këtë ‘dritare’ të autonomisë në përmbushjen e profesionit të tyre.

Së fundmi, baza jo e plotë dhe korrekte e të dhënave paraqet pengesa të mëdha në hartimin dhe zhvillimin e politikave në sistemit arsimor. Analiza e politikave dhe planifikimi strategjik, shtron nevojën urgjente për ngritjen e një sistemi të përparuar të menaxhimit të informacionit arsimor dhe funksionimin efektiv të tij, EMIS.


#### 5. Financimi i arsimit parauniversitar

Aspiratat ekonomike dhe sociale diktojnë ndryshime të mëdha në sistemin arsimor, për pasojë ky sektor duhet të mbështet financiarisht me prioritet nga buxheti i shtetit dhe nga donatorë të huaj. MASH-i duhet të kërkojë mjete alternative financimi të cilat mund të përballohen nga burime të tjera publike dhe private .

Shpenzimet e Arsimit kundrejt PBB dhe Buxhetit



Shpenzimet e Arsimit (së bashku me Pushtetin Vendor) kundrejt PBB dhe Buxhetit



Shpenzimet e përgjithshme publike për arsimin, si pjesë e PPB, në shifra absolute kanë shënuar rritje të vijueshme. Në tregues relativë ka pasur disa oshilacione që lidhen me prioritetet e politikave arsimore apo veprimi i faktorëve ekonomikë jashtë arsimit (shih tabelën).

Duke iu referuar statistikave të OECD:

- Përqindja e shpenzimeve për Arsimin, në vendet e OECD, përbën mesatarisht 5.8% të PBB. Ndërsa 20 vende të BE 5.5%<sup>[16]</sup>.

- Përqindja e shpenzimeve për Arsimin, në vendet e OECD, përbën mesatarisht 13.2% të shpenzimeve publike. Në këtë drejtim, në varësi të politikave të ndjekura, të dhënat oshilojnë

dukshëm. P.sh. nën këtë mesatare paraqiten Gjermania, Franca, Republika Çeke, Japonia, etj me nën 10%. Ndërsa Meksika shpenzon për Arsimin 23% të Buxhetit të saj<sup>[17]</sup>.

Përqindja e shpenzimeve për Arsimin Parauniversitar kundrejt shpenzimeve në total për Arsimin, në vite paraqitet si vijon: (duke filluar nga viti 2006) 83%, 85%, 86%, 81%, 81%, 83%, 81%, 83%. Siç shihet në vitin 2007, në shifra absolute ka pasur rritje. Kjo përafrohet me raportet e OECD dhe të BE ku nënvizohet se shpenzimet e Arsimit Parauniversitar janë 3 – 4 herë më të larta se shpenzimet e Arsimit Universitar.

Është me rëndësi të theksohet se në planifikimin afatgjatë të shpenzimeve, fondi i pagave parashikohet me një rritje mesatare vjetore rreth (15 - 20)%, fond ky që siguron një rritje mesatare prej 25% të pagave të punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar.

#### 6. Informatizimi i shkollave.

Kapacitetet e TI të shkollave, megjithë përmirësimet e shpejta të 6 muajve të fundit, mbeten të ulta. Në vitin 2007 në të gjitha shkollat e mesme të vendit kishte 2400 kompjutera për 146293 nxënës, pra 61 nxënës për kompjuter (në fshat 133 nxënës për kompjuter ndërsa në qytet 46 nxënës për kompjuter).

Në vitin 2007 u pajisën me laboratorë kompjuterash të gjitha shkollat e mesme, nga të cilat 37 (nga 411 gjithsej) me nga dy laboratorë për arsye të numrit mbi 800 nxënës.

Në vitin 2008 mesatarja në nivel vendi, për shkollat e mesme, arriti në 35 nxënës për kompjuter (në fshat 36 nxënës për kompjuter ndërsa në qytet 33 nxënës për kompjuter). Ndërsa në Arsimin 9 vjeçar, brenda vitit 2008, u pajisën 353 shkolla. Në lidhje me trajnimin e mësuesve të informatikës, deri në fund të vitit 2008 u trajnuan 460 mësues të shkollave të mesme. Kështu, në nivel kombëtar, në vitin 2008, për të gjithë Arsimin Parauniversitar, u arrit në mesataren 42 nxënës për kompjuter.

Deri në mesin e vitit 2009, rezulton se, në të gjithë shkollat e vendit, të mëdha e të vogla, ishin instaluar 1 429 kabinete informatike, 17 mijë kompiutera, 2 000 laptopë e video-projektorë dhe rreth 2 000 shkolla u lidhën me internet. Kjo bëri që raporti nxënës për kompjuter të arrijë në 32 nxënës për një kompjuter.

#### 7. Ngarkesa mësimore në arsimin parauniversitar (2009-2013)

Ngarkesa aktuale mësimore dhe projekSIONET E SAJ PËR VITET E ARDHSHME PARAQITET SI VIJON:

Treguesi i performancës së sistemit	Viti 2007		Objektivat për Shqipërinë		
	Shqipëria	Mesatarja për EU (04) (përllogaritjet)	2009	2011	2013
Mësimdhënia dhe koha e të nxënësve në shkolla					
Numri mesatar i orëve për vit për moshat e arsimit të detyrueshëm:	570	750	600	660	750
7-8 vjeç	780	900	800	850	900
15 vjeç	167	185	175	180	185
Numri i ditëve të mësimit	35	37	35	36	37
Numri i javëve të mësimit					

## KAPITULLI 2

### VIZIONI, PËRPARËSITË SI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

#### Vizioni

Garantimi i një sistemi arsimor kombëtar modern, i cili nxit zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rrit konkurrueshmërinë në rajon e më gjerë, dhe konsolidon demokracinë.

#### Objektivat

Për përmbushjen e këtij vizioni, janë përcaktuar disa përparësi strategjike për zhvillimin e sektorit

1. Rritja e aksesit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

2. Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit politikëbërës, menaxhues dhe vendimmarrës, është një nga përparësitë në kuadër të Partneritetit Evropian, sipas te cilit "...Qeveria është e angazhuar për të realizuar autonominë shkollore, nëpërmjet reformës arsimore në bashkëpunim dhe me grupet e interesit"[18]

- Në nivel qendror: Ristrukturimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve të varësisë duke ndërtuar një skemë të qartë menaxhimi me bazë performance.

- Në nivel rajonal: Ristrukturimi i Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore me objektiv rritjen e kapaciteteve në ndihmë të shkollave.

- Në kuadër të decentralizimit: Decentralizimi dhe transferimi i përgjegjësiave dhe autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror në nivelin lokal të qeverisjes.

- Në nivel shkolle: Zbatimi i autonomisë shkollore në fushat e programeve të lëndëve, financimit, personelit dhe menaxhimit në nivel shkolle e më lart duke e plotësuar me bazën ligjore dhe organizmat realizues përkatës.

- Zhvillimi i politikave dhe marrja e vendimeve qendrore, lokale e shkollore bazuar në kërkim dhe orientuar nga të dhënat: Funksionimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në arsim.

3. Përmirësimi i cilësisë së procesit të mësimit përfshin disa drejtime:

- Modernizimi i kurrikulës 1-12: Ristrukturimi i arsimit të mesëm të lartë, hartimi i një kornize të re të programit të lëndëve, një shërbim arsimor cilësor njëherësh kombëtar dhe evropian.

- Zhvillimi profesional i mësuesve: Zbatimi i një reforme tërësore të zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave i mbështetur në kredite.

- Përmirësimi i teksteve shkollore: Përsosja e reformës së liberalizimit të botimeve të teksteve.

- Përmirësimi i vlerësimit të nxënësve: Konsolidimi i Maturës Shtetërore dhe reformimi i Provimeve të Lirimit, si dhe rritja e transparencës dhe besueshmërisë së publikut ndaj institucioneve arsimore.

- Zgjerimi i shërbimit arsimor privat, i kombinuar me një mbikëqyrje të cilësisë së këtyre shërbimeve.

4. Përmirësimi i frytshmërisë së financimit në arsim përfshin disa drejtime:

- Rritja e mbështetjes financiare të arsimit bazë nga qeveria qendrore dhe lokale

- Përmirësimi i skemës së financimit i mbështetur në numrin e nxënësve, zvogëlimi gradual deri në eliminimin e dallimeve rajonale të trashëguara arsimore, ekonomike e sociale dhe racionalizimi i shkollave bazuar në prirjet e ndryshimeve demografike.

- Sigurimi i rritjes së të ardhurave për arsimin nëpërmjet përjashtimit nga taksat të investimeve jopublike sidomos në infrastrukturën arsimore

5. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i burimeve njerëzore përfshin disa rrafshë:

- Profesionalizimi i mësimdhënies-mësimnxënies: Hartimi i standardeve të mësuesit dhe të statusit të tij, si dhe hartimi i standardeve dhe objektivave të arritjeve të nxënësve, me bazë performancën.

- Inspektimi dhe ndihma: Ndryshimi i rolit të inspektorëve nga një rol kryesisht kontrollues dhe ndëshkues, në një rol kryesisht mbështetës dhe përfshirja e inspektorëve në zhvillim intensiv profesional.

- Motivimi i mësuesve: Rritja në vijimësi e pagave të mësuesve pas dyfishimit të tyre në muajin maj 2009, mbështetja e rritjes së pagës mbi rritjen e kompetencave për mësimdhënie-mësimnxënie.

#### 6. Zhvillimi i arsimit profesional përfshin:

- Politikën e re të formimit dhe zhvillimit profesional (tanimë të hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta) dhe zbatimin efektiv të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në përputhje me kërkesat e tregut.

- Fuqizimin dhe shtimin e arsimit profesional duke ngritur infrastrukturën e duhur.

#### 7. Zgjerimi i ofrimit të arsimit parashkollor përfshin:

- Futjen e një viti përgatitor para fillimit të shkollës fillore, i cili synon rritjen e aftësisë për shkollë dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët e vegjël të grupeve të prekshme, sidomos (por jo vetëm) në Shqipërinë verilindore dhe për romët.

- Modernizimin e arsimit parashkollor: Përgatitja e mësuesve-edukatorë, ndërtimi i kopshteve dhe ngritja e kopshteve pranë institucioneve private dhe publike.

### KAPITULLI 3 POLITIKAT PËR PËRPARËSITË STRATEGJIKE

#### 1. Rritja e aksesit në të gjitha nivelet e sistemit parauniversitar

Lidhur me rritjen e aksesit në shkollë, së pari kërkohet realizimi i një studimi për cilësinë aktuale të fëmijëve të marginalizuar dhe shërbimit të nxënësve me aftësi të kufizuara, mbledhjen e të dhënave për çdo kategori të nxënësve që braktisin shkollën dhe me aftësi të kufizuara, krijimi i një data base efektiv e funksional, me qëllim krijimin e informacionit të plotë lidhur me identifikimin e problemeve e diagnostikimin e situatës si dhe më vonë hartimin e politikave e marrjen e masave për të rritur cilësinë dhe ofrimin e shanseve të barabarta për çdo nxënës. Këtu shtohet dhe rritja e frekuencës së inspektimeve në vit në shkollat që qëndrojnë mbi mesataren e Republikës, për numrin e nxënësve braktisës apo jashtë sistemit.

Masat që mendohen të merren janë:

- Hartimi i politikave të veçanta për të rritur përqindjen e fëmijëve parashkollorë në kopshte siç mund të jetë përfshirja e nxënësve 5-6 vjeçarë në arsimin e detyruar.

- Hartimi i programeve të veçanta pune në nivel klase dhe shkolle, me qëllim sensibilizimin e prindërve për rëndësinë e shkollimit, dhe për kthimin në shkollë të fëmijëve jashtë sistemit arsimor.

- Krijimi i ekipeve me mësues me reputacion të udhëhequr nga specialistë të shërbimit psikologjik me prindër dhe përfaqësues të pushtetit, për punë me prindërit e nxënësve të pargjistruar apo që kanë braktisur shkollën, si dhe për punë me vetë këta nxënës

- Ndihmë e ekonomike për familjet, me qëllim që të sigurohet minimumi jetik dhe përfitimi i kësaj ndihme me kusht që fëmijët të frekuentojnë shkollën.

- Instalimi i shërbimit psiko-social me specialistë të mirëfilltë, për shkollat të cilat kanë probleme të braktisjes dhe për rrjedhojë të dukurisë së analfabetizimit.

- Krijimi i kushteve sa më të përshtatshme për mësim e studim, i klasave mësimore dhe mjediseve të tjera, sidomos në zonat rurale apo me ngarkesë të madhe nxënësish.

- Rishikimi i programeve mësimore për të qenë sa më relevantë dhe më afër kërkesave të komunitetit dhe tregut të punës.

- Zgjerimi e forcimi i autonomisë së shkollave shpie në rritjen e interesit të aktorëve për shkollën.

- Realizimi i programeve mësimore suplementare (parashikimi i punonjësve mësimorë shtesë, norma mësimore të reduktuara, si dhe përcaktimi i mënyrës së shpërblimit të mësuesve që punojnë me nxënësit e marginalizuar).

- Racionalizimi i shtrirjes së shkollave në të gjithë territorin për të siguruar shërbimin arsimor në të gjithë zonat sidomos me dendësi të ulët popullore.

- Sigurimi i transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për fëmijët e tjerë të cilët banojnë larg shkollës.

- Ndërtimi i konvikteve për nxënësit e arsimit të detyruar, për të krijuar akses për nxënësit vendbanimi i të cilëve është larg shkollës. Zgjerimi i rrjetit të konvikteve të shkollave të mesme të përgjithshme.

- Gjetja e mundësive për pajisjen me bursa apo të formave të tjera të ndihmës ekonomike të sa më shumë nxënësve në arsimin parauniversitar.

- Bashkëpunimi më i mirë me shoqërinë civile dhe OJF të cilat kanë në fokus të punës së tyre shtresat e marginalizuara.

## 2. Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit politikëbërës, menaxhues dhe vendimmarrës

Ristrukturimi formal kah decentralizimi është bërë realitet në disa sektorë të jetës, duke përfshirë edhe sektorin e arsimit, megjithëse duhet pranuar që ritmet e decentralizimit të përgjegjësive dhe të autoritetit vendimmarrës nga niveli qendror drejt atij vendor për arsimin parauniversitar nuk janë në nivelin e duhur. Parë në këtë kontekst, hapat zhvillimorë të ndërmarra në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” (CBA), përbëjnë një hop të rëndësishëm zhvillimi dhe performance për sistemin arsimor parauniversitar. Ky proces ka pasur për objektiva final zhvillimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në të gjitha nivelet e sistemit bazuar në kërkim dhe orientuar nga të dhënat.

Ndërsa është realizuar një ristrukturim i MASH-t, me asistencën e dhënë në kuadrin e Projektit CBA dhe disa hapa janë hedhur në riorganizimin e nivelit të dytë (DAR/ZA), sfida pasuese është funksionimi i sistemit menaxhues të performancës në të gjitha nivelet e qeverisjes arsimore. Synohet të arrihet në menaxhimin mbi bazë performancë në të gjitha nivelet dhe në kulturën e matjes së saj. Kjo nënkupton rritjen e transparencës për rolet e vendeve të punës në të gjithë piramidën administrative dhe qartësimin më të mirë të detyrave, përgjegjësive dhe detyrimeve reciproke institucionale për secilin vend pune. Për pasojë do të rritet shkalla e performancës së çdo individi të angazhuar në menaxhimin e sistemit, do të sigurohet dhe ruhet niveli minimal i performancës, si dhe do të krijohen përgjegjësi individuale më të mëdha për vetëzhvillim dhe novacione. Sistemi i ri menaxhues i performancës do të sigurojë raportimin dhe auditimin në disa drejtime, përmes mekanizmave të brendshme dhe të jashtme, duke rritur në këtë mënyrë transparencën për veprimtarinë e tij.

Në një periudhë afatshkurtër, MASH do të operojë sipas modelit të menaxhimit me bazë performancë dhe më pas do të kalohet në nivel rajonal DAR, ZA dhe deri në nivel shkolle.

### 2.1 Vendimmarrja dhe decentralizimi

Decentralizimi i sektorit arsimor do të sigurojë zgjerimin e pjesëmarrjes dhe rritjen e efektivitetit të grupeve të interesit në përvijimin e projekteve arsimore dhe zbatimin e tyre. MASH-i, në bashkëpunim me Ministri të tjera, do të realizojë delegime të përgjegjësive te qarqet, bashki/komunat, DAR, ZA dhe shkolla. Ky proces do të realizohet përmes një balance të kujdesshme ndërmjet centralizimit dhe decentralizimit dhe do të shoqërohet me ndërgjegjësimin për rreziqet e mundshme dhe gjasat e suksesit.

Është me interes të evidentohet hartimi i Letrës së Politikave dhe Projektit Pilot për Decentralizimin e Shërbimit Arsimor, përgatitur me mbështetjen BB dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të ideve të strategjisë.

#### Autonomia e shkollave

Në këtë sistem të decentralizuar, shkollave do t'u kërkohet të marrin përgjegjësi të mëdha në planifikimin, menaxhimin dhe përmirësimin cilësor të shërbimeve që ato sigurojnë. Aktualisht, strukturat dhe personeli ekzistues kanë kapacitete të kufizuara për ta kthyer këtë në realitet. Në të kaluarën, komunitetet lokale dhe prindërit janë përfshirë shumë pak në planifikimin e veprimtarive shkollore dhe zgjidhjen e problemeve eventuale që shoqëronin procesin mësimor, prandaj ata nuk e ndjejnë si duhet përgjegjësinë, që kanë për zhvillimin dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve që ofron shkolla.

Zbatimi i autonomisë shkollore në fushat e kurrikulës, financimit, personelit dhe menaxhimit në nivel shkolle e më lart realizohet efektivisht duke e kompletuar me bazën përkatëse ligjore dhe ngritjen e organizmave përgjegjëse për ekzekutim e mbikëqyrje.

Realizimi i autonomisë shkollore përfshin ndryshimin e një pjese të legjislacionit aktual. Ky legjislacion nuk nxit dhe nuk mbështet sa dhe si duhet pjesëmarrjen e prindërve apo drejtorëve të shkollave për të marrë nisma novatore, që lidhen me përmirësimin e cilësisë së shërbimit shkollor. Skema e granteve për shkollat, si element thelbësor i autonomisë shkollore, do të favorizojë krijimin e kapaciteteve për planifikim dhe buxhetim në nivel shkolle dhe në nivelet e qeverisjes lokale. Këtu synohen rritja e efikasitetit dhe transparencës në punën e administratës shkollore dhe role të reja të drejtuesve të shkollave si menaxherë.

Me gjithë luhatjet, që mund të shoqërojnë procesin, progresi kah autonomisë shkollore do të jetë i qëndrueshëm në 5 vitet e ardhshme. Shkolla të mëdha ose grupe shkollash të vogla do të testojnë modelin e autonomisë. Është me interes të evidentohet hartimi i Projektit për Përmirësimin e shkollës dhe fuqizimin e autonomisë shkollore, në kuadër të CBA.

### 2.3 Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Sektorin e Arsimit (EMIS)

Baza jo e plotë dhe korrekte e të dhënave paraqet pengesa të mëdha në hartimin dhe zhvillimin e politikave në sistemit arsimor. Analiza e politikave dhe planifikimi strategjik, shtron nevojën urgjente për ngritjen e një sistemi të përparuar të menaxhimit të informacionit arsimor, EMIS. Kjo njësi e re, në bashkëpunim me Drejtorinë e informacionit dhe statistikës, do të bashkëpunojë ngushtësisht me INSTAT, për përcaktimin e kategorive dhe niveleve të përpunimit të të dhënave të sistemit arsimor e më gjerë.

Projekti i CBA, mbështet zhvillimin e EMIS, i cili do të ndihmojë MASH-in në realizimin e misionit të tij. Sistemi EMIS nënkupton edhe kërkimin konceptual dhe hetimin analitik të të dhënave për qëllime studimore. EMIS duhet të ketë kapacitetin për të kategorizuar të dhënat ekonomike, infrastrukturore, sociale (duke përfshirë edhe grupet e minoritetit) dhe arsimore, sipas niveleve: rural, urban dhe qendror, qarku, bashkie/komune, deri në nivel shkolle.

Menaxhimi arsimor do të përmirësohet dukshëm nëpërmjet modernizimit të infrastrukturës teknologjike në të tre nivelet, shkollë, DAR/ZA dhe ministri dhe zhvillimit të një sistemi informacioni të besueshëm, të shpejtë dhe të saktë. Rritja e produktivitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit arsimor do të vijë si pasojë e pajisjes dhe përdorimit efektiv të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në të gjithë sistemin tonë arsimor. Kjo do të thotë kompjuterizim i proceseve që lidhen me kryerjen e detyrave administrative të përditshme dhe specifikisht i shkëmbimit të informacionit arsimor midis niveleve të ndryshme shkollë-DAR/ZA-ministri.

Në vijim do të pajisen të gjitha shkollat dhe autoritetet arsimore vendore me sisteme teknologjike, me qëllim përmirësimin cilësor të menaxhimit të shkollës dhe krijimin e një rrjeti kompjuterik që mundëson komunikimin elektronik të të gjithë institucioneve të arsimit.

Në fillim do të krijohet një rrjet shkollash pilot dhe zbatohet një program aplikativ me bazë web që mundëson shkëmbim dijesh e informacioni si dhe ndërveprim midis nxënësve, mësuesve e prindërve.

Synimi është krijimi i bazave të dhënave arsimore dhe i një harte shkollore të dixhitalizuar për një planifikim efektiv arsimor dhe zhvillim politikash dhe vendimmarrjesh arsimore të përshtatshme.

Këto procese do të shoqërohen me trajnimin e personelit të institucioneve arsimore qendrore dhe lokale në përdorimin e aplikacioneve në funksion të sistemit të menaxhimit të informacionit.

Një rëndësi të veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me partnerët e këtij sektori nëpërmjet:

- Zhvillimit të kritereve për partnership me kompani lokale dhe ndërkombëtare për të siguruar dhe ofruar përmbajtje arsimore dixhitale për arsimin bazë dhe të mesëm.

- Zhvillimit të një platforme si pjesë e një master plani të TIK-ut që do mundësojë investime të kompanive të huaja dhe vendase në fushën e TIK-ut në dobi të arsimit.

### 2.4 Sigurimi i cilësisë së shërbimit arsimor



Ky kërkon një ndryshim filozofik thelbësor, i cili nuk ka të bëjë vetëm me bërjen e politikave, por edhe me monitorimin. Vetëvlerësimi i individit ose i strukturave të caktuara të sistemit arsimor është një instrument matës i fuqishëm dhe një procedurë e shpejtë që duhet të përdoret sa më dendur. Për të arritur besueshmërinë ndaj përfundimeve të bazuara në metodën e vetëvlerësimit, duhet të alternohet monitorimi periodik i jashtëm me atë të brendshëm. Organizimi i inspektimit me dy nivele, qendror dhe lokal, mundëson një monitorim të koordinuar (të jashtëm dhe të brendshëm) të zhvillimit të shërbimit arsimor, duke mundësuar krahasimin e cilësisë së performancës së institucioneve arsimore dhe individëve në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Sistemi i dyfishtë i monitorimit stimulon përdorimin e mënyrave të shumta për raportim dhe auditim, rrit transparencën e procesit dhe besueshmërinë e përfundimeve të arritura.

Kombinimi i monitorimit të brendshëm me atë të jashtëm mundëson ndërmarrjen e veprimeve të efektshme për përmirësime në formën e asistencës nga njësitë e specializuara lokale dhe kombëtare. Nëse një shkollë nuk arrin të përmbushë standardet e veta dhe objektivat e arritjeve të nxënësve, të përcaktuara në planet e veta zhvillimore, atëherë përgjegjësia i mbetet stafit pedagogjik dhe drejtuesve të shkollës. Në raste të tilla, qeveria vendore, e bazuar në përgjegjësitë e transferuara në kuadër të decentralizimit të sektorit arsimor, mund të kufizojë përgjegjësitë e deleguara tek shkolla dhe të shpërndajë bordin e shkollës.

### 3. Përmirësimi i cilësisë së procesit mësimor

Duke qenë se kurrikula dhe procesi mësimor përfaqësojnë bazën e sistemit arsimor, përmirësimet e sistemit nisin pikërisht me rishikimin e kurrikulës dhe modernizimin e procesit mësimor.

Për të rritur nivelin e arsimit të qytetarëve aktualisht po zbatohet një strukturë e re e arsimit parauniversitar. Në strukturën e rishikuar tre nivelesh, (5+4+3), arsimi bazë (i detyrueshëm), nga 8 vjet që ka qenë deri tani, do të zgjasë 9 vjet. Cikli i plotë 9 - vjeçar për herë të parë u realizua gjatë vitit shkollor 2008-2009. Këtu nuk kihet parasysh viti përgatitor që do të përfitohet në kuadër të zhvillimit të arsimit parashkollor, i projektuar për t'u shtrirë në mënyrë graduale në tërë vendin, zhvillim që trajtohet e sqarohet gjerësisht në Projektin e SKA Parashkollor. Zbatimi i kësaj strukture do ta afrojë sistemin arsimor shqiptar me atë të shumicës së vendeve të OECD.

Dy nivelet e para përqendrohen në aftësimin në shkrim e lexim, matematikë, njohuri për shoqërinë e shëndetin, natyrisht pa nënvleftësuar përvetësimin e njohurive, dhe aftësive për të qenë pjesë aktive në një shoqëri demokratike të bazuar në njohuritë. Niveli i tretë do të zhvillojë më thellë njohuritë, qëndrimet dhe aftësitë e nxënësve për jetën e përditshme në një ekonomi tregu të një bote demokratike. Në këtë nivel dy janë drejtimet kryesore. Njeri drejtim i përgatit nxënësit për të vazhduar shkollën e lartë, ndërsa drejtimi tjetër i pajis ata me aftësitë e shkathhtësitë profesionale të nevojshme, për tu bërë anëtarë produktivë të shoqërisë, qysh me mbarimin e shkollës së mesme.

#### 3.1 Zhvillimi i kurrikulës

##### Korniza kurrikulare kombëtare

Me gjithë hapat pozitive të kryera në zhvillimin e kurrikulës, mbeten ende shumë hapa të tjerë për të konceptuar dhe zhvilluar një kurrikulë të kompletuar e veçanërisht për zbatimin efektiv të Kornizës Kurrikulare Kombëtare dhe të politikave kurrikulare kombëtare. Njohuritë mbi gjuhën amtare të zhvillohen dhe shtrihen në kontekstin përkatës edhe në arsimin e mesëm dhe të mos mbyllet cikli i studimit të tyre në nivelin e arsimit bazë.

Institucionet e varësisë, si: Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit (IKT) dhe Agjencia e Vlerësimit të Arritjeve (AVA), të cilat financohen dhe përcaktojnë objektivat kryesore të punës nga MASH, janë ingranazhet e një mekanizmi të vetëm për përmirësimin e cilësisë së kurrikulës. Krahas monitorimit dhe vlerësimit të punës së kryer prej këtyre institucioneve, MASH-i, duhet të sigurojë kualifikimin e stafëve dhe përmirësimin e vazhdueshëm strukturor të tyre.

##### Racionalizimi i lëndëve

Tanimë është i domosdoshëm konceptimi dhe zhvillimi i një modeli kurrikular të orientuar nga kërkesa dhe i fokusuar në njohuritë dhe aftësitë e mjaftueshme për qytetarët aktivë të një shoqërie demokratike të bazuar në ekonominë e tregut. Realizimi i kësaj kërkesë dikton kalimin nga

metoda ekzistuese “Kurrikula me bazë lëndësh”, në “Kurrikulën e bazuar në rezultatet e të nxënësve”, sipas së cilës hapen zgjedhje për lëndë të reja dhe/ose integrimin e lëndëve.

#### Brendia

Një nga shkaqet e nivelit të ulët të përvetësimit të dijeve shkollore nga një masë e madhe nxënësish është mungesa e interesit të këtyre të fundit për mësimin. Është e nevojshme që të përshtatet përmbajtja kurrikulare dhe procesi mësimor me kërkesat e zhvillimit moshor të fëmijëve me aspiratat e nxënësve dhe të prindërve. Integrimi i lëndëve është një nga përvojat që e bëjnë procesin e nxënies më efektiv në vitet e shkollimit bazë..

Normalizimi i ngarkesës së nxënësve është një objektivi, i cili duhet të realizohet si nëpërmjet eliminimit të materialit të panevojshëm, ashtu dhe nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm të reformës kurrikulare të orientuar më mirë nga cilësia e mësimdhënie - mësimnxënies, duke iu siguruar nxënësve kohë të mjaftueshme për stimulimin e të menduarit të pavarur, kritik e krijues, të proceseve mendore të analizës sintezës, si dhe për të kultivuar shprehitë e punës në grupe, të punës eksperimentale, etj.

Zgjedhja e lëndëve nga nxënësit dhe zhvillimi i lëndëve të Integruara;

Zhvillimet e brendshme dhe kërkesa e afërimit me komunitetin evropian, diktojnë nevojën për rritjen e fleksibilitetit në hartimin e kurrikulës, në mënyrë që shkollat ose/dhe niveli lokal ta përshtatin atë, në masën që u lihet në dispozicion, me nevojat dhe kërkesat lokale të perspektivës ose traditës. Politikat që udhëheqin përdorimin e lëndëve, ose të grup-lëndëve me zgjedhje, i shërbejnë forcimit të këtij fleksibiliteti. Bordi i shkollës miraton politikën e kurrikulës në nivel shkolle, ndërsa qeveria vendore, nëpërmjet zbatimit të grandit në shkolla, ka rastin t’u japë prioritet projekteve kurrikulare të specifikuar.

Arsim për të gjithë, nuk do të thotë se çdo njeri studion të njëjtat lëndë në të njëjtën mënyrë. Sistemi arsimor duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë, që t’i pajisë nxënësit në nivelet e ulëta me njohuri bazë si shkrim e këndim, matematikë dhe aftësi bazë në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Ndërsa nxënësit kalojnë në nivele më të larta, kurrikula duhet të jetë më elastike dhe t’u ofrojë atyre bllok-lëndësh, si lëndë me zgjedhje. Kjo mënyrë rrit shkallën e specializimit, bazuar në zgjedhjen e lëndëve dhe njëkohësisht redukton nevojën për t’u ofruar nxënësve të gjitha lëndët. Nëpërmjet zgjedhjes kurrikulare, lidhur me numrin dhe llojet e bllok-lëndëve, shkolla fiton autonomi për të vendosur se çfarë kombinim lëndësh do t’u ofrohet nxënësve në shkollën e mesme.

Përveç kësaj, futja e shumë lëndëve të reja për mjedisin, biznesin, multimedian, komunikimin etj. kërkon që hartuesit e kurrikulave të jenë të guximshëm dhe të rishikojnë lëndët që mund t’u ofrohen nxënësve dhe/ose zgjedhjet e lëndëve të integruara, për të formuar lëndë më gjithëpërfshirëse. Integrimi i lëndëve do të përmirësojë rezultatet e nxënies dhe nuk do të jetë më nevoja e pasjes së një teksti mësimor për secilën lëndë. Futja e specializimit në klasat e shkollës së mesme mund të reduktojë shpenzimet e tepërta të shkaktuar nga detyrimi i nxënësve për të studiuar të gjitha lëndët. Këto ndryshime në kurrikul do të ndikojnë në zvogëlimin e numrit të mësuesve, teksteve shkollore dhe klasave. Futja e lëndëve të reja dhe/ose bashkimi i atyre të vjetra, si lëndë të integruara, mund të hasë mjaft rezistencë, meqë shumë mësues lëndësh mund të dalin të papunë. Hartuesit e kurrikulës duhet të konsultohen me literaturën kompetente, në mënyrë që t’i shpjegojnë publikut përfitimet që rrjedhin nga zbatimi i metodës së re të zhvillimit të kurrikulës.

Trajtimi me përparësi i gjuhëve të huaja

Politikat e gjuhëve të huaja të MASH hartohen e zbatohen në përputhje me zhvillimet e vendit tonë por dhe në respektimin e politikës së BE në të njëjtën fushë. Në këtë kuadër, respektohen dy orientimet bazë të BE shumëgjuhësia dhe multikultura, duke i kushtuar rëndësi jo vetëm gjuhëve të huaja por dhe gjuhëve të minoritetit.

MASH në të ardhmen do të vijojë të bazojë sistemin kurrikular në “Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët: mësimdhënia, mësimnxënja dhe vlerësimi” si dokument i cili parashtron Standardet Evropiane ku synojnë të gjitha vendet anëtare të BE. Synimi i MASH është që, deri në fund të klasës 12të, nxënësit të cilët mësojnë 2 gjuhë të huaja, ku gjuha e parë të arrijë nivelin B2, (sipas këtij dokumenti).

Përvoja e fituar në procesin e hartimit dhe akreditimit të “Portofolit Evropian të Gjuhëve“<sup>[19]</sup> për nxënësit e shkollave të mesme, do të lehtësojë zbatimin e të njëjtit proces edhe në Arsimin Bazë dhe atë të Lartë. Kjo do të synojë akreditimin e të gjitha niveleve të arsimit në përputhje me këtë instrument të KE.

### 3.2 Zhvillimi i profesionit të mësimitdhënies

Një sistem i zhvillimit profesional, qoftë edhe i mirë menduar, është veçse një mjet, i cili mundet të mos përdoret nga mësuesit në përgjithësi, nëse nuk përmbushen disa parakushte të rëndësishme të cilat janë:

- Një shkallë e mjaftueshme lirie profesionale e mësuesit në përvijimin e kurrikulës me bazë shkolle;

- Përgjegjshmëri e institucionalizuar për arritjet e nxënësve, kryesisht nëpërmjet hartimit dhe përmbushjes së objektivave të arritjeve të nxënësve për kapitull ose linjë lëndore e vit shkolle, si dhe vlerësimeve të jashtme të standardizuara;

- Krite vetëm profesionale të rekrutimit dhe zbatimit të paanshëm të këtyre kriterëve;

- Një pagë motivuese për statusin social të mësuesit;

- Kohë qëndrim më i madh në shkollë të mësuesve;

- Një shkallë autonomie financiare e shkollës për plotësimin e nevojave të veta infrastrukturore dhe profesionale;

- Hapësirë e mjaftueshme për projekte shkollore në dobi të zhvillimit profesional.

Një reformim i thellë i sistemit të zhvillimit profesional të mësuesve është tanimë i domosdoshëm për të përmirësuar arritjet akademike dhe formuese të nxënësve.

Sistemi i reformuar thellë i zhvillimit profesional të mësuesve duhet të ketë këto karakteristika themelore:

Të jetë:

- i menaxhuar mbi bazën e dokumenteve politikë kombëtarë, lokalë dhe shkollore të zhvillimit profesional të mësuesve dhe të planeve përkatës strategjike;

- i përshkruar nga standardet e kompetencave të mësuesit;

- i përshkruar nga standardet e sigurimit të cilësisë së shërbimeve e procedurave;

- i realizuar nëpërmjet një tregu të lirë të ofertave trajnuese, këshilluese e informuese;

- me përshtatshmëri të lartë ndaj nevojave individuale e ekipore për zhvillim profesional;

- i përshkruar nga liria e përzgjedhjes së ofertave të zhvillimit profesional nga individët, ekipet dhe shkollat.

- me larmi të gjerë të agjencive që ofrojnë trajnime, këshillime, informime, duke përfshirë, veç të tjerave, dhe mësues, shkolla e universitete;

- me larmi të gjerë të mënyrave të të mësuarit nga përvoja e kolegëve dhe e përhapjes së përvojave vetjake profesionale;

- me itinerar të karrierës të kushtëzuar nga performanca në trajnimet dhe nga çka mësuesi është në gjendje të bëjë dhe të arrijë me nxënësit e tij;

- me itinerar të karrierës të lidhur ngushtë me pagën;

- me mundësi të gjera për të konkurruar për projekte të zhvillimit profesional nga mësues, ekipe, shkolla e bashkësi shkolle;

- me institucione që sigurojnë funksionimin e shkollës si një organizatë profesionale;

- me autonomi të shkollës në përdorimin e fondeve qeveritare ose joqeveritare për të përmbushur objektivat e planit të saj të zhvillimit profesional.

Kompetencat e mësuesve

Ndihet nevoja për t'i pasqyruar këto kompetenca në programet universitare, të cilat duhet të udhëhiqen nga parimet e procesit të Bolonjës dhe të përfshirjes së praktikës profesionale si pjesë integrale e programit.

Skema motivuese të punësimit të bazuara në meritat

Tërheqja dhe mbajtja në punë e mësuesve cilësorë kërkon që MASH, IKT, në bashkëpunim me grupet e interesit, të studiojnë skema të reja motivimi, të cilat bazohen në rezultatet (meritën) dhe jo thjesht në stazhin e punës. Veprimi i parë që duhet të ndërmerret është respektimi i

profesionit të mësuesit duke përshtatur gradualisht pagat e tyre me ato të punonjësve civilë. Ngritja e Urdhrit të Mësuesit, si një organizatë profesionale, e mbështetur në Kodin Etik, do të jenë një faktor ndihmues për këtë. Natyrisht, ky do të jetë një proces i cili do të zhvillohet paralelisht me performancën e sistemit dhe cilësinë e përgatitjes, trajnimit dhe kualifikimit të specialistëve të arsimit.

Shqyrtimi i modeleve të reja dhe alternative të trajnimit të mësuesve

Përveç skemës bazë të trajnimit, IKT dhe strukturat qendrore e lokale të sistemit arsimor duhet të shqyrtojnë modele alternative për sigurimin e trajnimit të mësuesve, si përdorimi i Portofolit dhe krediteve, Trajnimi dhe kualifikimi në distancë ose në linjë, etj. MASH do të nxisë krijimin e institucioneve jopublike të trajnimit të mësuesve, për të mbështetur përpjekjet individuale për rritjen e performancës nga çdo mësues në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Sigurimi i cilësisë/licencimi i mësuesve

Duhet të zhvillohet procesi i licencimit dhe akreditimit të mësuesve, si dhe zbatimi i procedurave për monitorim të vijueshëm. Licencimi i mësuesve do të shërbejë si parakusht për të zënë një vend pune si mësues. Procedura e kërkesës për vend pune, e miratimit dhe e zgjidhjes së konflikteve duhet të hartohet dhe miratohet formalisht nga Qeveria dhe MASH-i. Kjo duhet të realizohet së bashku me ngritjen e strukturave akredituese dhe reformimin e programeve të trajnimit të mësuesve.

### 3.3 Tekstet shkollore

Zhvillimi i teksteve mësimore dhe liberalizimi i botimit të tyre përbën një nga projektet më të rëndësishëm të ndërmarrë nga MASH gjatë '2006 e në vijim. Projekti është përvijuar në dy drejtime bazë:

a) Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore

b) Liberalizimi i botimeve shkollore, shpërndarjes dhe delegimi i të drejtës së përzgjedhjes së teksteve konsumatorit (specialistëve dhe strukturave në shkolla).

Përzgjedhje më e mirë e përmbajtjes dhe strukturës: Cilësia e teksteve shkollore në procesin e mësimdhënie-mësimnxënies është argument i hapur për debate të mëtejshëm. Debatit po i nënshtrohet dhe duhet t'i nënshtrohet, në vijimësi si përmbajtja, cilësia, kostoja, ashtu edhe struktura tërësore e teksteve, duke e konsideruar një proces në zhvillim të pandërprerë.

Lidhur me konceptimin e përgatitjes së teksteve shkollorë do të punohet me kujdes në dy drejtimet, vertikal dhe horizontal.

Ndërsa do të shtohet efektiviteti i përgatitjes së alternativave të teksteve shkollorë dhe të tregohet kujdes dhe në integrimin horizontal lëndor, ku tekstet e lëndëve të ndryshme të së njëjtës klasë plotësojnë dhe mbështesin njëra tjetrën në zhvillimin e aparatit konceptual dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve.

Në të njëjtën kohë do të synohet dhe një integrim linear vertikal, efektiv, i cili do të ndjekë kërkesat e përmbajtjes në dinamikën e tyre.

Është e nevojshme të rishikohen dhe të përshtaten proceset e hartimit të teksteve shkollore dhe të sigurimit të cilësisë me ato të vendeve të BE dhe me vendet e tjera të zhvilluara.

MASH synon plotësimin e kurrikulës me tekste të huaja për shkencat, tashmë të filluar me shkollën e mesme e në vijimësi edhe në Arsimin Bazë. Ky proces do të ecë paralelisht me atë të rishikimit të programeve.

I njëjti proces do të zbatohet edhe në tekstet e metodave burimore për mësimin e gjuhëve të huaja duke synuar zëvendësimin total të metodave të autorëve shqiptarë.

Tekstet e reja shkollore, duhet të zbatojnë metodat e mësimdhënie-mësimnxënies, të cilat karakterizohen nga situata të marra nga jeta, të jenë të orientuara nga zbatimet, si dhe të kenë në qendër nxënësin. Ato duhet të inkurajojnë punën në grup si dhe mendimin e pavarur, krijues dhe kritik dhe individualitetin e nxënësve. Është e nevojshme që autorëve të mundshëm t'u ofrohen trajnime për hartimin e teksteve.

Koordinimi i kërkesës dhe ofertës për tekstet shkollore

Me metodat e mësimdhënie-mësimnxënies që vënë në qendër nxënësin, tekstet alternativë marrin rëndësi të madhe. Duhet të fuqizohet procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollore mbi bazën e

konkurrencës dhe transparencës, nga specialistë të kualifikuar e të trajnuar dhe që gëzojnë integritet të plotë intelektual. Në përzgjedhjen e këtyre teksteve do të përfshihen mësuesit dhe, gradualisht, grupet e interesit, si prindërit, shoqatat profesionale lëndore, etj., të cilët, do të ushtrojnë kështu trysni ndaj autorëve dhe shtëpive botuese.

#### Privatizimi

Furnizimi i nxënësve me tekstet shkollorë i ka kaluar sektorit privat. Për të gjitha klasat, MASH do të formulojë standardet e përmbajtjeve lëndore dhe cilësinë e botimit dhe shtypjes dhe garanton plotësimin dhe zbatim korrekt të kërkesave teknike të teksteve shkollore.

#### Mbulimi i kostos

Përveç teksteve shkollore, futja e metodave të reja mësimdhënëse -mësimnxënëse, kërkon një numër të madh burimesh, prandaj është e nevojshme që të gjenden mënyra të reja për financimin e burimeve alternative të mësimdhënies, duke pasur përparësi një politikë të diferencuar sociale.

#### Përdorimi masiv dhe efektiv i TIK

Futja gjerësisht e TIK në procesin mësimor synon që nxënësit tanë në përfundim të ciklit të studimeve të jenë përdorues konfidentë dhe produktivë të saj dhe janë të përgatitur për të qenë konkurrentë të aftë në tregun evropian të punës. Në funksion të saj kërkohet që edhe mësuesit tanë të jenë pajisur me aftësitë bazë të TIK dhe të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet integritit dhe të përdorimit të gjerë të TIK në procesin e mësimdhënies.

Për të arritur këtë objektiv do të synohet zhvillimi i një kurrikule bashkëkohore në fushën e TIK në arsimin parauniversitar me qëllim aftësimin e nxënësve në përputhje me standardet evropiane.

Kjo do të bazohet në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike përmes pajisjes së shkollave me laboratorë kompjuteri e pajisjesh periferike si dhe pajisjes së të gjitha klasave me nga 1 kompjuter. Synimi kryesor është arritja e treguesit "1 kompjuter për 10 nxënës" në arsimin parauniversitar. Ky proces do të shoqërohet me:

- zhvillimin e përmbajtjeve dixhitale mësimore dhe i materialeve multimediale;
- pajisjen e shkollave me laboratorë të lëvizshëm dhe programe aplikative me qëllim përmirësimin e vijueshëm të cilësisë së mësimdhënies;
- integrimin e TIK-ut në lëndët e ndryshme të kurrikulës shkollore.

Do të vijohet me përmirësimin e shërbimit të internetit në të gjithë shkollat dhe përdorimi i tij në arsim si një mjet burimor për materiale mësimore nga të gjithë nxënësit dhe mësuesit.

Krijimi i kapaciteteve të nevojshme nëpërmjet trajnimit të vijueshëm të të gjithë mësuesve të arsimit parauniversitar do të shërbejë si bazë që ata të jenë konfidentë në përdorimin e TIK në procesin e mësimdhënies.

#### 3.4 Burimet alternative të mësimdhënies

Burimi aktual dhe kryesor i procesit mësimor në arsimin parauniversitar është teksti shkollor. Për këtë arsye, mësuesit japin në mësim vetëm përmbajtjen e teksteve dhe nuk përdorin burime të tjera alternative. Ndjehet nevoja për futjen shkallë-shkallë të teksteve të tjerë të referencës, duke filluar në këtë mënyrë me krijimin e bibliotekave në klasa. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në programet e arsimit parauniversitar është shumë i kufizuar, prandaj në shkolla duhet shqyrtuar mundësia e krijimit të bibliotekave me lidhje interneti.

IKT duhet të gjejë mënyra për të zhvilluar dhe mbështetur me burime shtesë arsimin parauniversitar. Ai mund të punojë dhe të mbështesë mësuesit në mënyrë që ata të zhvillojnë praktikat më të mira dhe të shkëmbejnë më pas përvojën me kolegët e tyre në të gjithë vendin. Këto institucione duhet të angazhohen gjithashtu në kërkimin të informacionit të dobishëm për lëndë të ndryshme, si dhe të krijimit të CD-ve dhe materialeve të shumëfishuara, të cilat mund t'u shpërndahen shkollave. Gjithashtu, do të jetë e nevojshme që ato të mendojnë për funksionet e tyre në një formë të re, në kërkim të praktikave të reja si dhe të burimeve të reja të mësimdhënies-mësimnxënies. Ndërtimi i rrjeteve njerëzore profesionale janë një praktikë mjaft efektive, e cila mund të përdoret me sukses në këtë drejtim.

### 3.5 Provimet dhe vlerësimet

Krijimi i Agjencisë së Vlerësimeve të Arritjeve të nxënësve (AVA) dhe konceptimi e organizimi i ri i Drejtorisë së Inspektimit në MASH, shënon fillimin e dy reformave të rëndësishme institucionale. Ristrukturimi organizativ duhet të plotësohet me zhvillimin e burimeve njerëzore për të forcuar kapacitetet monitoruese dhe vlerësuese. Për të rritur efektivitetin e AVA-s, MASH parashikon vendosjen e një sistemi të dyfishtë, i cili përfshin monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm e të jashtëm, duke shtrirë ekspertizën e saj jo vetëm në provimet finale, por në vlerësime dhe analiza të vijueshme me tematika e objektiva të caktuara.

#### Forcimi i kapaciteteve

Kapaciteti aktual i AVA-së, duhet të zgjerohet duke përfshirë ekspertë, të cilët mund të hartojnë tregues rigorozë për matjen e rezultateve të të nxënësve. Kjo Agjenci ka nevojë për pajisje bashkëkohore që të përmbushë detyrën e saj dhe të përdorë me sukses tregues kombëtarë dhe ndërkombëtarë të rezultateve të procesit mësimor.

#### Monitorimi i cilësisë dhe përdorimi i treguesve ndërkombëtarë

Nisur nga synimi i përgjithshëm politik i sigurimit të kapaciteteve të afta për ta integruar vendin në BE, është tejet e nevojshme që të zhvillohen treguesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë arsimorë, si dhe sistemi i monitorimit të tyre. AVA ka përfituar disa trajnime të financuara nga projekti i BB në arsim, por ka ende nevojë për krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve. Kështu, bazuar në projektin CBA është arritur të krijohet një sistem korrigjimi dhe klasifikimi i barasvlershëm për të krahasuar rezultatet me vende të ndryshme të rajonit nëpërmjet vendosjes së grupit të indikatorëve të monitorimit të zhvillimit të shërbimit arsimor.

#### Zhvillimi dhe menaxhimi i provimeve kombëtare

Procesi i zhvillimit dhe korrigjimit të provimeve duhet të rishikohet në mënyrë të tillë që të mënjanohej mundësitë për kopjim. Të gjitha konfliktet e interesave dhe situatat komprometuese duhet të eliminohen nga sistemi i menaxhimit të provimit.

AVA do të kryejë kërkime dhe do të konsultohet me grupe të ndryshme interesi për të thelluar në vijimësi reformën “Matura Shtetërore”, e cila krahas përcaktimit të drejtë e të saktë të njohurive të fituara në arsimin e mesëm shërben edhe si kriter bazë për pranimet në universitete, i bazuar në sistemin e meritë preferencës.

Kuptohet që Matura Shtetërore nuk është qëllim në vetvete, por një reformë e cila do zhvillojë dhe do të mbështesë përmirësimin e sistemit arsimor në përgjithësi dhe afrimin e dy niveleve arsimore për nga konceptet, metodat dhe nivelet e studimit.

### 4. Financimi i arsimit parauniversitar

Aspiratat ekonomike dhe sociale diktojnë ndryshime të mëdha në sistemin arsimor, për pasojë ky sektor duhet të mbështet financiarisht me prioritet nga buxheti i shtetit dhe nga donatorë të huaj . MASH-i duhet të kërkojë mjete alternative financimi të cilat mund të përballohen nga burime të tjera publike dhe private .

Objektivi qeveritar për rritjen e buxhetit të arsimit parashikohet në masën 4.09% e PBB në fund të 2013. Shpenzimet publike për arsimin në raport me PBB duhet të rriten, pasi arsimi është prioritet zhvillimor kombëtar.

Një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve publike për arsimin zënë investimet. Shpenzimet publike për investimet parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej (20-30)%. Kjo rritje do të përballohet nga burimet e buxhetit të shtetit si dhe nga donatorët. Prioritet i investimeve publike në arsim janë ndërtimet e reja për arritjen e objektivit të qeverisë në 30 nxënës për klasë, rritja e kapaciteteve në arsimin nëntëvjeçar, ndërtimi i konvikteve për nxënësit në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale, pajisja me laboratorë të shkencave natyrore dhe të informatikës, etj.

#### 4.1 Instrumentet dhe proceset për transferimin e fondeve

##### Modeli “për nxënës” i financimit

Sistemi i financimit në arsim nuk i përgjigjet me efektivitet plotësimin të nevojave në ndryshim. Kështu, migrimi i brendshëm dhe i jashtëm i nxënësve ka krijuar probleme në sistemin e financimit në nivel rajonal. Për të kapërcyer këto dukuri, pra, për t’iu përgjigjur kërkesave në ndryshim si dhe për të siguruar barazinë e shanseve për nxënësit dhe rajonet, modeli i financimit

“për nxënës” (për capita), i cili lidhet drejtpërdrejt me shkollat, mund të jetë një alternativë e pranueshme. Ky model bazohet në numrin aktual të nxënësve, si dhe gjeografinë e shtrirjes së shërbimeve të nevojshme, në numrin e mësuesve dhe stafin mbështetës dhe jo në sasinë e parave të paracaktuara sipas praktikave pragmatike e jo transparente të përdorura deri më sot.

#### Menaxhimi i shpenzimeve korrente nga MASH

MASH-i menaxhon disbursimin e të gjitha shpenzimeve korrente, d.m.th. shpenzimeve të lidhura me botimin e teksteve shkollore, me bursat e nxënësve, me materialet didaktike, si dhe me transportin e mësuesve dhe nxënësve. Në dritën e kosto-efektivitetit, mbajtja e disa shërbimeve në nivel qendror përbën avantazh, ndërsa shërbime të tjera, si transporti i nxënësve dhe mësuesve ose bursat mund të realizohen më mirë nga niveli lokal. Realizimi i decentralizimit në sistemin arsimor do të rriste efikasitetin për këtë shërbim, duke ulur shpenzimet. Megjithatë, planifikimi buxhetor i detajuar është i nevojshëm për të rritur përgjegjshmërinë ndaj këtyre fondeve në të dyja nivelet, qendror dhe rajonal.

#### Kapaciteti i planifikimit të buxhetit

Modeli aktual i ofertës së shërbimeve arsimore reflektohet në sistemin financues. Një nga kërkesat kryesore të reformimit në skemën e menaxhimit dhe të financimit të shërbimit arsimor është kalimi në modelin e bazuar në kërkesën dhe performancën. Që të arrihet kjo, është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet në nivelet e ndryshme të sistemit financiar në mënyrë që të përfshihen aktivisht në hartimin e planit të detajuar buxhetor dhe në zbatimin e këtij plani të gjithë aktorët realizues dhe raportues.

#### Zbatimi i metodës së granteve konkurruese në buxhetimin arsimor

Duke filluar nga viti 2007, investimet në arsimin parauniversitar janë financuar përmes granteve konkurruese, një skemë e re financimi e cila harmonizon kërkesat për investime me prioritetet qeveritare, si dhe ato të zhvillimit rajonal, cilësinë e projekteve, etj.

#### 4.2 Rritja e efikasitetit në financimin e nënsektorit

##### Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

MASH-i nuk merr raportime për sasinë e financimit që qeveria vendore i akordon sektorit të arsimit në përgjithësi, dhe nën-sektorëve të tij. Mungesa e një informacioni të tillë e pengon seriozisht MASH-in për hartimin e një planifikimi financiar të besueshëm dhe efektiv.

Shkëmbimi i informacionit financiar midis MASH, MF, qeverisë vendore dhe shkollave ka munguar. Sistemi EMIS, i planifikuar për MASH-n, duhet të organizohet në formë të tillë që të mbledhë dhe të menaxhojë këtë lloj informacioni. Një grup ekspertësh financiarë duhet të angazhohen në përcaktimin e llojit të të dhënave, nivelin e mbledhjes, tipin dhe shkallën e analizës së tyre, gjë që do të forcojë kapacitetet në MASH për planifikimin dhe menaxhimin e veprimtarive të veta.

#### Mbledhja e të ardhurave nga shkollat

Duhet të rishikohen praktikat aktuale të sigurimit të të ardhurave nga shkollat, si për taksimin e tyre, ashtu edhe për vendimet përkatëse të bashki/komunave. Synohet rritja e mbështetjes financiare të arsimit bazë jo vetëm nga qeveria qendrore por edhe ajo vendore. Shkollat dhe komunitetet duhet të kenë kontroll të plotë të të ardhurave. Përqindjet aktuale që i kalojnë shtetit nga këto fonde duhet të rishikohen, me tendencë minimizimin e tyre, në mënyrë që të inkurajohen më shumë komunitetit dhe stafi shkollor. Shkolla duhet lejuar që të rrisë pavarësinë në përdorimin e të ardhurave të krijuara nga pajisjet e veta dhe mjediset si dhe nga punonjësit që angazhohen jashtë orarit të punës.

#### Përrjashtimi nga taksat

Shkollat duhet të inkurajohen që të gjejnë burime alternative financimi. Për të rritur kontributin bamirës të publikut, të gjitha financimet alternative duhet të përjashtohen nga taksat, në mënyrë që çdo qindarkë e dhuruar të përdoret për përmirësimin dhe mbështetjen e cilësisë në arsim. Gjithashtu, OJF-të, mësuesit dhe nxënësit, të cilët blejnë materiale mësimore si kompjuter etj., duhet të përjashtohen nga taksat. Është e nevojshme që të thjeshtohen rregullat për përjashtime të tilla, në mënyrë që njerëzit të financojnë më shumë në këtë fushë.

## Rialokimi i fondeve

Arsimi bazë është nënsektori parësor i arsimit. Prandaj MASH duhet të rishikojë shpenzimet në arsimin e lartë sipas modelit “përfituesi i shërbimit paguan koston”, me qëllim që të favorizojë financimin e niveleve të tjera të arsimit. Fondet shtesë të përfituara nga burimet e brendshme e të jashtme duhet të përdoren me përparësi nga arsimi parauniversitar.

### 4.3 Sistemet e ekspertizës dhe mbështetjes së reformës

Ekziston rreziku që disa komuna ose bashki mund të mos jenë të afta që të menaxhojnë shkollat me kosto-efektivitet. Kjo situatë mund të parandalohet duke krijuar partneritete me komuna ose bashki fqinje.

Disa shkolla, gjithashtu, mund të mos jenë në gjendje të përballojnë menaxhimin financiar. Ekspertët e institucioneve arsimore të specializuara dhe/ose ata të drejtorive arsimore rajonale, mund t’i asistojnë ato shkolla. Ky rrezik është më i pranishëm në shkolla të vogla, por mund të parandalohet duke i menaxhuar këto shkollat të vogla në grupime me buxhet të përbashkët.

## 5. Ndryshime konceptuale

Kalimi nga një sistem i centralizuar dhe i orientuar sipas ofertës në një sistem të bazuar në kërkesën, d.m.th. sipas vizionit të autoriteteve lokale dhe konsumatorit, dhe përgjegjshmëria në rritje kërkojnë një ndryshim thelbësor konceptual, i cili, nga ana e vet, do të ketë ndikimin e tij në çështjet operative. Propozimet kryesore rreth sistemeve të përgjegjshmërisë disa nivelesh dhe të orientuar nga kërkesa janë shumë komplekse po të kemi parasysh historinë e vendeve ku, në të kaluarën, ka sunduar ideologjia komuniste e bazuar në modelin e ofertës. Marrëdhëniet midis shtetit dhe qeverisë lokale, shtetit dhe individit, shtetit dhe sektorit privat etj., duhet t’i nënshtrohen një transformimi të madh. Për këtë arsye, në këtë kapitull shtjellohen disa ndryshime të rëndësishme dhe të nevojshme në sektorin e arsimit në kuadër të reformës arsimore.

Duke pasur parasysh rritjen e kostos në buxhetin e sektorit publik, të diktuar nga kërkesa për një sistem arsimor cilësor, është e nevojshme të përzgjidhen sisteme e modele të reja dhe efikase. Nga ky këndvështrim duhet të zbatohet një metodë e bazuar në kërkesën, e cila do të mbështetet nga një sistem rigoroz monitorimi dhe vlerësimi, i krijuar në kuadrin e projektit EMIS. Më poshtë jepen disa konsiderata të veçanta, si aspekte të rëndësishme të kësaj strategjie.

### 5.1 Arsimi si shërbim ndërsektoral

Sistemi arsimor kombëtar shërben si sektor shërbimi, i cili do të pajisë qytetarët e ardhshëm shqiptarë me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar ekonomik e zhvillimor të vendit. Ai synon plotësimin e nevojave kombëtare të tregut të punës dhe aspiratat social-kulturore të popullit. Miratimi i kornizës kombëtare kurrikulare kërkon të merren në konsideratë nevojat e të gjithë sektorëve, nevoja që mund të jenë të panjohura nga ata që janë të përfshirë vetëm në sektorin e arsimit. Dialogu ndërsektoral është i nevojshëm dhe për një sërë veprimtarish të financuara dhe mbështetura nga ministri të linjave të ndryshme, si p.sh., programet që lidhen me “fëmijët e punësuar”, programet “ushqim për edukim”, subvencionet për “familjet në nevojë”, etj.. Për të rritur ndikimin e këtyre programeve, kërkohet koordinimi i veprimeve ndërmjet ministrive që i menaxhojnë këto programe.

### 5.2 Racionalizimi i shpërndarjes së shkollave, krijimi i shanseve të barabarta

#### Racionalizimi i shpërndarjes së shkollave

Duke marrë në konsideratë tendencat e larta të migrimit, natyrshëm lind nevoja për të krijuar një bazë të besueshme të dhënash të hartës së shkollave. Me anë të saj, do të realizohet një planifikim më i besueshëm dhe afatgjatë, i cili do të sjellë një përdorim më eficient të burimeve, që janë në dispozicion të sektorit të arsimit parauniversitar. Duhet të rishikohen dhe të gjenden zgjidhje racionale për shkollat që janë joekonomike në menaxhim dhe të paqëndrueshme në kuadrin e zhvillimit institucional. Nga ana tjetër, duhen gjetur dhe eksperimentuar modele alternative për të siguruar shërbimin arsimor në zonat me dendësi të ulët popullore. Rishpërndarja e shkaktuar nga migrimi i brendshëm krijon nevojën për klasa të reja. Sigurimi i kushteve të përshtatshme të studimit për të gjithë nxënësit, dhe sidomos të atyre të zonave rurale, përbën një prioritet strategjik dhe programor të MASH. Në këtë këndvështrim, Studimi “30 nxënës për klasë” që parashikon hapjen e



shkollave të reja për 18 bashki në të gjithë vendin dhe në periferinë e Tiranës, proces i cili tashmë ka filluar por që do zgjasë disa vjet për shkak të vështirësive jashtë sistemit që dalin si gjetja e shesheve të ndërtimit, etj. si dhe ai “Për zgjerimin e rrjetit të konvikteve të shkollave të mesme të përgjithshme”, mundësojnë shkollimin nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve të konvikteve pranë shkollave në qendra urbane dhe nëpërmjet racionalizimit të shtrirjes së shkollave në të gjithë territorin.

#### Krijimi i shanseve të barabarta

MASH-i duhet të sigurojë në të njëjtën kohë barazinë e shanseve dhe efektivitetin për të gjithë nxënësit dhe veçanërisht për grupet e marginalizuara, si romët e evgjitet, fëmijët e familjeve në nevojë dhe natyrisht të sigurohen të drejtat dhe barazia e fëmijëve të minoriteteve. Me mjaft kujdes duhet të trajtohen në dokumentacionin shkollor dhe në procesin mësimor zhvillimet lidhur me ratifikimin e dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare, si: ligji për barazinë gjinore, ndryshimet në kodin e familjes, natyrisht të lidhura më problematikat që i shoqërojnë. Për më tepër, problemet e barazisë dhe krijimit të shanseve të barabarta, shtrohen dhe zgjidhen në parim në projektin e EFA, tashmë të miratuar edhe në rang ndërkombëtar.

#### 5.3 Inspektimi dhe ndihma

Roli i inspektorëve në MASH shihet më shumë si një mekanizëm ndëshkues dhe kontrollues. Kjo duhet të ndryshojë nëse dëshirojmë që profesionistët në arsim të jenë novatorë dhe të përfshihen në procesin e vetëzhvillimit. Opsioni më i mirë për rolin e inspektorëve do të ishte të qenit përherë i angazhuar në sigurimin e mbështetjes. Ky ndryshim konceptual ka rëndësi për suksesin e procesit të “vetë-raportimit”, si pjesë e sigurimit të cilësisë dhe monitorimit. Që individët të raportojnë me ndershmeri, ata duhet të kenë besim te sistemi. Nëse jo, problemet që lindin nga të dhënat dhe rezultati jo i besueshëm do të vijojë, prandaj çdo planifikim që merr për bazë këto të dhëna, s’do të ketë vlera. Performanca e sistemit të inspektimit dhe kualifikimi i inspektorëve të nivelit qendror dhe rajonal është një prioritet strategjik i MASH-it.

#### 5.4 Profesionalizimi i mësimdhënies

Ngarkesa aktuale mësimore për mësuesit kërkon një vëmendje të re lidhur me statusin e profesionit të mësuesit. Duke pasur parasysh se një nga objektivat e reformës është përafrimi i kapaciteteve dhe i sistemit arsimor me ato të vendeve të BE, mësimdhënia në Shqipëri duhet të shihet si një shërbim publik. Si rrjedhojë, mësuesit duhet të punojnë 30-40 orë në javë. Një trajtim i tillë do të rrisë angazhimin nga ana e mësuesve, si dhe do të justifikojë shtimin e rrogës bazuar në rritjen e kohës së punës. Kjo ngarkesë duhet të jetë e matshme dhe e kontrollueshme. Efikasiteti dhe efienca mund të rritet edhe nëpërmjet futjes së kompetencave ndërdisiplinore për mësuesit e arsimin bazë dhe të paktën në deri në dy disiplina mësimore për mësuesit e arsimin të mesëm. Këto veprime mund të sjellin ulje në numrin total të mësuesve, por do të ndihmojnë në përmirësimin e raportit mësues-nxënës dhe do ta bëjnë sistemin arsimor shqiptar të krahasueshëm me atë të vendeve të rajonit.

Shoqatat profesionale të mësuesve duhet të zhvillohen dhe mbështeten si një burim i rëndësishëm për përmirësimin e procesit të mësimdhënies-mësimnxënies, të novacioneve kurrikulare dhe eksperimentimit të ideve novatore.

#### 5.5 Shërbimi arsimor privat

I parë si një alternativë zhvillimi dhe faktor zgjerues të shërbimit arsimor shumë veprimtari të sektorit publik i kalojnë sektorit privat. Kjo fillon që nga funksionet planifikuese e menaxhuese. Mund të përmendim privatizimin e disa shërbimeve arsimore si botimi, shtypja dhe shpërndarja e teksteve shkollore, transporti i mësuesve apo nxënësve, po ashtu, ndërtimi, rehabilitimi e mirëmbajtja e godinave arsimore.

Arsimi privat sfidë për arritje cilësore në procesin arsimor

Ndjekja e shkollave private nuk i detyrohet aq larmisë së ofertës kurrikulare, pasi ndryshimet e pakta nga shkollat publike kufizohen kryesisht në përfshirjen e informatikës dhe të gjuhës angleze më herët ose të një gjuhe të huaj më tepër. Zhvillimi i këtij lloji shërbimi, në nivelin aktual, paraqitet më shumë si një reagim i publikut ndaj cilësisë së ulët të shkollave publike, e shprehur në numrin më të vogël të nxënësve për klasë, pajisjeve më të mira me laboratorë dhe mjeteve didaktike dhe në disa raste një personeli mësimor më të përzgjedhur. Ndërsa krahasimi

ndërmjet arritjeve të nxënësve të shkollave private me ato publike (Matura Shtetërore dhe Olimpiadat Kombëtare si testime të standardizuara) nuk shënon ndonjë dallim i madh.

Është i pranishëm rreziku që në disa nga këto shkolla interesat e biznesit arsimor të zbehin cilësinë e shërbimit arsimor. Për këtë arsye, MASH-i duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi zbatimit të standardeve dhe sigurimit të cilësisë në arsimin privat.

Përqendrimi i shkollave private në disa qytete më të mëdha ka kufizuar fort aksesin ndaj tyre sidomos për zonat rurale, kurse çmimet përgjithësisht të larta, i bëjnë ato një privilegj të shtresave të kamura.

Shërbimi privat është një nga mënyrat e rritjes së ofertës ndaj interesave dhe nevojave të ndryshme të klientëve arsimorë. Për këtë arsye të parë shërbimi privat arsimor duhet të inkurajohet përmes shtimit të shkollave private të të gjitha niveleve, zgjerimit të larmisë së institucioneve arsimore private, zgjerimit të ofertave për shërbime private në sistemin arsimor, si: agjenci trajnuese, vlerësuese të arritjeve të nxënësve, etj.

Arsimi privat burim për rritjen e investimeve në arsim

Një arsye e zgjerimit të shërbimit arsimor privat është ajo financiare. Me gjithë shtimin e domosdoshëm të përqindjes së PBB për sektorin e arsimit dhe të një politike të mundshme agresive në thithjen e fondeve të huaja, nevojiten burime të tjera financiare për të kryer një hop në cilësinë e arritjeve të nxënësve Tërheqja e biznesit kah tregu arsimor është një kërkesë që ka impakt pozitiv jo vetëm në arsimin kombëtar, por në progresin ekonomik e kulturore të vendit në tërësi.

Politika inkurajuese ndaj institucioneve arsimore private, vendase ose të huaja, duhet të realizohet nëpërmjet mekanizmave të tilla si lehtësira fiskale dhe mbulimin nga qeveria e një pjese të shpenzimeve korrente të tyre, por pa ndarë fitimet me to. Deri më sot janë subvencionuar tekstet shkollore të nxënësve të Arsimit Bazë, në të njëjtën masë si për shkollat publike.

Këto mekanizma do të përdoren me përparësi për arsimin profesional dhe atë pas-shkollës së mesme, në mënyrë që këto t'u përshtaten më me fleksibilitet nevojave të tregut të punës, si dhe për arsimin e lartë, në mënyrë që të shkarkohet buxheti shtetëror nga mbishpenzimet për këtë nënsektor, gjithashtu për arsimin parashkollor, në mënyrë që të sigurohet larmia e duhur e ofertave për të, edhe për shkollat e fëmijëve me nevoja të veçanta, për shkak të kostos veçanërisht të lartë të tyre, dhe së fundi, në zona me mbipopullim të klasave të shkollave të mesme që të mundësohet kështu sa më shpejt një raport normal nxënës për klasë.

Arsimi privat hap tregun, rrit konkurrencën dhe përmirëson cilësinë e shërbimit

Zgjerimi i tregut të shërbimit arsimor privat përtej thjesht shkollimit privat, do të sigurojë konkurrencën e mjaftueshme si një parakusht i përmirësimit cilësor të këtyre shërbimeve në përgjithësi. Rreziku që konkurrenca e shkollave private ndaj atyre publike të përkeqësojë shërbimin arsimor publik do të parandalohet nëpërmjet menaxhimit dhe mësimdhënie-mësimnxënies mbi bazën e performancës (arritjeve të nxënësve) dhe transparencës së këtyre arritjeve ndaj opinionit publik dhe profesional.

#### 6. Zhvillimi i arsimit profesional (AP)

Me gjithë ndërhyrjet reformuese të ndërmarra vitet e fundit, si dhe mbështetjen e donatorëve të huaj, pavarësisht shenjave pozitive për një rigjenerim të tij, AP vazhdon të jetë ende problematik duke mos arritur të luaj si duhet rolin e duhur në zhvillimet aktuale dhe të pritshme në arsimin dhe formimin profesional.

Në përgjithësi, infrastruktura materiale e pjesës më të madhe të shkollave profesionale është mjaft e dobët, por, ndërkohë ka pabarazi të mëdha midis shkollave profesionale për nga burimet njerëzore, financiare dhe të infrastrukturës.

Mungon sistemi i trajnimit paraprak (pre-service) për mësuesit dhe instruktorët e lëndëve e praktikave profesionale, po kështu, nuk ka një program kombëtar të posaçëm për trajnimin në punën të tyre.

Lidhjet e AP me tregun e punës dhe me partnerët socialë vijnë të jenë të dobëta. Kurrikula e AP, pavarësisht nismave për modularizim dhe decentralizim, në përgjithësi, ka nevojë për përmirësime të mëtejshme për ta përshtatur me kërkesat e tregut dhe përfshirjen e përvojës evropiane në të.

Sistemi i kualifikimit dhe certifikimit është i orientuar në mënyrë të pamjaftueshme ndaj zhvillimeve dhe standardeve të reja të BE-së. Miratimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në përshtatje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), krijon mundësinë që diplomat dhe certifikatat e dhëna që nga viti i ardhshëm akademik të jenë në përputhje me këto standarde.

#### Objektivat strategjike të arsimit profesional

Arsimi profesional gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm duhet të realizojë një reforme sistematike, e cila të synojë ndryshimin e AP në një sistem të aftë për t'u përshtatur ndaj tregjeve të punës në ndryshim të vijueshëm. Kjo reformë shkon përtej përmirësimeve thjesht institucionale, deri tek ndryshime thelbësore në vizionin, qëndrimet dhe sjelljen e të gjithë të angazhuarve.

Sistemi i AP duhet të ofrojë akses për të gjithë të interesuarit dhe mundësi më të mëdha punësimi dhe kalimi në nivelet e tjera më të larta (p.sh. terciar), të jetë reagues i menjëhershëm ndaj zhvillimeve dhe nevojave të tregut të punës në nivel rajonal/kombëtar dhe sidomos në nivel lokal, të jetë eficient, të mbështetet në një model partneriteti që angazhon në veprimtaritë e tij të gjitha palët përkatëse (qeveria, partnerët socialë, komuniteti, etj.). Ai duhet të bartë konceptin e të nxënësve gjatë gjithë jetës, pra të krijojë mundësinë e akumulimit, transferimit dhe njohjes së krediteve për arritjet e fituara me forma dhe mënyra të ndryshme, si dhe të përshtatet gradualisht në përputhje me nivelet e kualifikimit të pranuar nga Bashkimi Evropian.

Rruga e realizimit të këtyre objektivave:

1. Rritja e fleksibilitetit të ofertës, mundësive të pranimit, përparimit dhe mobilitetit vertikal e horizontal (midis niveleve dhe drejtimeve) në AP, do të arrihet nëpërmjet:

- a) Krijimit të një Kuadri Shqiptar të Kualifikimeve Profesionale (KSHKP);
- b) Përshtatjes së strukturës së sistemit të AP duke u bazuar në KSHKP dhe duke marrë parasysh nivelet rekomanduese të Kuadrit Evropian të Kualifikimeve;
- c) Krijimit të një cikli të veçantë për të plotësuar kulturën e përgjithshme të nxënësve që mbarojnë nivelin e punëtorit të kualifikuar për të ofruar diplomën e maturës teknike;
- d) Krijimit të një cikli pas-shkollës së mesme me orientim profesional për nxënësit që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe kërkojnë të marrin një kualifikim profesional.

2. Modernizimi i modelit kurrikular për ta afuar me kërkesat e botës së punës dhe për të rritur shkallën e fleksibilitetit (objektiv që i referohet kurrikulit të AFP) nëpërmjet:

- a) Institucionalizimit të një strukture Kurrikule të AFP dy shkallësh me skelet-kurrikula (si standard kombëtar) të hartuara në nivel qendror dhe kurrikula në nivel shkolle/qendre, të bazuara në skelet-kurrikulat përkatëse, kërkesat reale të tregut rajonal të punës dhe mundësitë konkrete të shkollës/qendrës.
- b) Modularizimit gradual të Kurrikulës të AFP për të lehtësuar integrimin e kompetencave e standardeve të profesionit dhe për të mundësuar akumulimin, transferimin dhe njohjen e krediteve të fituara me mënyra dhe forma të ndryshme.
- c) Institucionalizimit të një metodologjie të hartimit të Kurrikulave të AFP që bazohet në analizën e profesioneve, që e konsideron hartimin e kurrikulës si një proces të vijueshëm e shumëshkallësh dhe angazhon të gjithë të interesuarit në këtë proces.
- d) Mbështetjes së Kurrikulës të AFP me "tekste integrale" që përdoren për një kohë relativisht të gjatë, nga një numër i madh përdoruesish jo vetëm të një niveli apo drejtimi profesional, duke ulur ndjeshëm kostot e prodhimit të tyre.

3. Zhvillimi i mekanizmave institucionalë për kryerjen e funksioneve të reja dhe mbështetjen e funksioneve aktuale në AFP, nëpërmjet:

- a) Fuqizimit të rolit të Këshillit Kombëtar të AFP (komisioneve të specializuara dhe sekretariatit të tij) si një organizëm këshillimor trepalësh (qeveri, punëdhënës, punëmarrës), në mbështetje të zhvillimit të politikave reformuese të AFP.
- b) Krijimit të Agjencisë Kombëtare të AFP për të kryer funksione ndërsektoriale që aktualisht nuk mbulohen nga dikasteret dhe institucionet e AFP.
- c) Fuqizimit të Bordeve të Shkollave/qendrave me partnerë socialë (punëdhënës e punëmarrës).

d) Krijimit të Departamenteve (mbi baza profesionale) në shkolla/qendra, si njësi të zhvillimit dhe përshtatjes së kurrikulave në nivel shkolle, si dhe të trajnimit të brendshëm të mësuesve dhe instruktorëve.

e) Krijimit të një mekanizmi kombëtar për orientimin profesional dhe këshillimin për karrierën, me mbështetjen edhe të partnerëve socialë.

4. Zhvillimi sasior dhe cilësor i objekteve, mjediseve dhe mjeteve mësimore në mbështetje të rritjes së parashikuar cilësore dhe sasiore të ofertës së AFP, nëpërmjet:

a) Rinovimit të mjediseve ekzistuese për mësimin teorik e praktik në shkolla/qendra, duke treguar kujdes për personat me aftësi të kufizuar.

b) Pajisjes me bazën e nevojshme materiale/didaktike për mësimin teorik e praktik.

c) Krijimit të shkollave/qendrave të reja, shndërrimit të disa shkollave të përgjithshme në shkolla profesionale, si dhe krijimit të qendrave të trajnimit lëvizëse në ato rajone ku kërkesa është më e ndjeshme. Këto do të shoqërohen edhe me ndërhyrje të tjera si ristrukturime ndërtesash, krijim repartesh pune të reja dhe pajisje të atyre ekzistuese, rishikim i kualifikimeve që ofrohen, etj..

d) Ngritjes së një sistemi informacioni të kërkesë/ofertës në AFP, nëpërmjet futjes së internetit në sistemin arsimor, informatizimit të qendrave të formimit profesional, zyrave të punësimit dhe drejtorive rajonale të arsimit.

Shtirja dhe fuqizimi i arsimit profesional

Treguesi kryesor i zhvillimeve të pritshme në këtë periudhë do të jetë dyfishimi i tërheqjes së nxënësve në shkollat teknike-profesionale dhe ato social-kulturore, nga aktualisht 20% të arsimit të mesëm në 40%.

Duke pasur parasysh se Shqipëria është vend bujqësor-blegtoral dhe se mbi 50% e popullsisë banon në fashat, zhvillimi bujqësisë dhe blegtorisë mbetet një detyrë parësore e politikave arsimore për shtrirjen dhe zgjerimin e arsimit profesional, si: agrobiznes, veterinari, pemëtari, vreshtari etj. Këndej buron nevoja për hapjen e shkollave të reja bujqësore, zgjerimin e atyre ekzistuese me shkolla të profilit bujqësor, si dhe plotësimin e shkollave të arsimit të përgjithshëm me degë të profilit bujqësor. Për të motivuar ndjekjen e këtyre shkollave nga nxënësit e zonave të thella rurale dhe atyre me bujqësi më të zhvilluar do të realizohen politika financimi me bursa shteti, dhe mbështetje të tjera financiare. Kësisoj synohet të sigurohet formimi i fermerëve të ardhshëm të kualifikuar në shërbim të pronave të veta dhe më gjerë, hapja e tregut të punës dhe ulja e varfërisë. Struktura e re e arsimit profesional, që tashmë është në proces zbatimi, krijon fleksibilitete për përgatitjen e nxënësve edhe për fusha të tjera krahas atij bujqësor.

7. Zhvillimi i arsimit parashkollor

Objektivat kryesorë strategjikë për arsimin parashkollor janë:

a) Përmirësimi i përgatitjes për shkollë të fëmijëve, duke siguruar gradualisht të paktën një vit shkollor përgatitor për të gjithë fëmijët (5-6) vjeçar;

b) Konsolidimi i arritjeve të realizuara në kopshtet-pilot, ku zbatohen metodologji interaktive, duke i shfrytëzuar si agjenci trajnuese për zbatimin e standardeve të përbajtjes në arsimin parashkollor, i shoqëruar me alternativa të reja të shërbimit parashkollor;

c) Shtirja e mjaftueshme e institucioneve parashkollore;

d) Sigurimi i shërbimeve të fëmijërisë së hershme sidomos tek grupet e marginalizuara, veçanërisht në zonat verilindore;

e) Fuqizimi i përvojave të institucioneve parashkollore me kosto të ulët dhe të mbështetura nga ndihmesa e vetë komunitetit;

f) Mbështetje për shtrirjen e mëtejshme të sistemit aktual të arsimit parashkollor për fëmijët (3-5) vjeçar, duke nxitur edhe zhvillimin e arsimit parashkollor jopublik.

g) Një alternativë efektive për zgjerimin cilësor të arsimit parashkollor do të ishte ngritja e kopshteve pranë institucioneve të fuqishme të biznesit shtetëror dhe privat, duke u krijuar kushte lehtësuese për nënat-punonjëse të këtyre institucioneve. Harmonizimi i këtij procesi me politika fiskale lehtësuese do të nxis investimet private në arsimin parashkollor.

h) Zhvillimi i programeve informuese dhe trajnuese me prindërit për të mbështetur edukimin krahas kujdesit për fëmijët e vegjël, vendosja si prioritet i edukimit të fëmijëve në kopsht, në

kundërvënie ndaj mendësisë së trajtimit të kopshtit si institucion vetëm për shëndetin dhe sigurinë e fëmijës.

Parakushte të përmbushjes së objektivave

Përmbushja e objektivave strategjike kërkon plotësimin e disa parakushteve:

- Rritja e kapaciteteve ekzistuese të kopshteve dhe sigurimi gradual i klasave përkatëse për grupet përgatitore të arsimit parashkollor në të gjithë rrejtin e shkollave të arsimit të detyruar;

- Rishikimi i kurrikulës së fakulteteve të mësuesisë për të përgatitur “modelin e ri” të mësuesit të ciklit parashkollor dhe marrja në konsideratë e standardeve të përmbajtjes në përgatitjen e tij nga shkollat e larta;

- Hartimi i kurrikulës së re për vitin përgatitor dhe përgatitjen e programit të kualifikimit të mësuesve;

- Përgatitja e materialeve metodike dhe didaktike për mësuesit dhe fëmijët;

- Instalimi i një koncepti të ri menaxherial ndërsektorial të institucioneve parashkollore për sigurimin e shërbimeve cilësore ndaj fëmijërisë së hershme.

#### KAPITULLI IV RRJEDHOJAT PËR BURIMET

Për vlerësimin e përafërt të kostove të nevojshme për implementimin e kësaj Strategjie janë pasur parasysh: programi i buxhetit afatmesëm i MASH për periudhën 2009 - 2011, projektet e ndryshme me financim ose bashkëfinancim me të huaj, që kanë filluar implementimin e tyre apo që mendohet të fillojnë në fusha të veçanta, si dhe llogaritjet për projekte dhe aktivitete të tjera që po kryhen në partneritet me organizma e institucione politike e financiare ndërkombëtare, qeveritë e vendeve të tjera si dhe me shoqërinë civile, asistenca e të cilave nuk është vetëm teknike por edhe financiare. Gjate viteve të ardhshme parashikohen të financohen programet e zhvillimit të të gjithë niveleve të Arsimit Parauniversitar, si dhe të reformës së gjithanshme decentralizuese, ku një vend të rëndësishëm zë dhe ajo strukturore e rregullatore. Një pjesë e kostove, në varësi të masave, përveç MASH, dhe institucioneve të tjera të varësisë apo të autoriteteve arsimore vendore e shkollave, do të mund të përballohen gjithashtu edhe nga të ardhurat nga sektori privat apo shërbimet e tjera të ofruara.

Financimi i veprimtarive të parashikuara mbulohet nga Buxheti i Shtetit por edhe nga partnerët zhvillimorë në kuadrin e financimit SWAp<sup>[20]</sup> të Projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” (CBA). Projekti “Cilësi dhe Barazi në Arsim” i parashikuar të zbatohet në periudhën 2006 – 2010, i miratuar nga Qeveria shqiptare me VKM Nr. 234 dt. 26.04.06 dhe i përgatitur me asistencën teknike dhe mbështetjen financiare të Bankës Botërore, përbën arritjen kulmore në reformimin e shërbimit arsimor për periudhën në vijim.

Programi CBA, që po zbatohet gjerësisht, mbështetet financiarisht nga Buxheti i Shtetit (30 milion USD) dhe nga kreditë e Bankës Botërore, Bankës Evropiane të Investimeve dhe Bankës e Këshillit të Evropës për Zhvillim (45 milion USD) pra 75 milion USD në total).

Përparësitë kryesore të Programit CBA janë:

1. Forcimi i lidershipit, menaxhimit dhe qeverisjes së sistemit të arsimit (10 milionë US\$);

2. Përmirësimi i kushteve të mësimdhënies dhe të të nxënit (26 milionë US\$);

3. Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës arsimore, në veçanti në arsimin e mesëm (32 milionë US\$);

4. Përgatitja për reformën e arsimit të lartë (7 milionë US\$).

Përlllogaritja e kostove për periudhën afatmesme i përgjigjet në detaje projeksioneve buxhetore të PBA-së dhe në vijim me skenarët e miratuar të rritjes vjetore buxhetore në sektorin e arsimit.

Një vend me rëndësi në burimet e financimit të Strategjisë zë dhe master-plani i programit E-shkollave në Shqipëri, i cili synon sigurimin e aksesit të shfrytëzimit të gjerë të informacionit në nivel ndërkombëtar, nëpërmjet krijimit të parkut të TIK dhe sigurimit të shërbimit të internetit në çdo shkollë (në qytet apo në fshat).

Për investimet janë parashikuar kostot e të gjithë fazave të kryerjes së tij, që nga projektimi e deri në dorëzimin e tij. Në instalimin e EMIS është marrë parasysh edhe kosto për ngritjen e kapaciteteve (trajnime të ndryshme, etj.) dhe kosto e pajisjeve ose mobilierive të laboratorëve, etj

Disa nga fondet e angazhuara apo që do të angazhohen sipas zërave në vitet e ardhshme<sup>[21]</sup>:

- Për ndërtime

	Veprimtaria	Arsimi parashkollor	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i mesëm	Arsimi profesional	TOTALI
1	Ndërtime të reja	711 000	11 000 000	3 400 000	1 300 000	16 411 000
2	Rikonstruksione	546 000	13 000 000	5 000 000	3 000 000	21 546 000
3	Studime e projekte ndërtimi	54 000	430 000	240 000	45 000	769 000
4	<b>TOTALI</b>	<b>1 311 000</b>	<b>24 430 000</b>	<b>8 640 000</b>	<b>4 345 000</b>	<b>38 726 000</b>

- Në lidhje me konviktet e shkollave profesionale parashikohet që për ndërtime të reja të shpenzohen 45 000 000 lekë, për zgjerimin e rehabilitimin e mjediseve ekzistuese 443 000 000 lekë, studimin e projektimin e tyre 20 000 000 lekë dhe mobilimin dhe pajisjen e tyre 45 000 000 lekë. Për motivimin e nxënësve të këtyre shkollave me anë të bursave parashikohet të shpenzohen deri në 1 300 000 000 lekë.

- Për sigurimin e transportit për Arsimin Bazë deri në vitin 2013 parashikohet të shpenzohen 2 800 000 000 lekë.

- Në këtë strategji një vend të rëndësishëm zë dhe puna me shtresat e marginalizuara. Llogaritet se trajnimi i mësuesve që punojnë me këto shtresa arrin në shifrën e 30 000 000 lekëve, ndërsa për punën e mësuesve që merren me nxënësit që braktisin shkollën deri në vitin 2013 do të shpenzohen 30 000 000 lekë.

- Decentralizimi dhe autonomia e shkollave (shkolla që menaxhojnë vetë buxhetin) ka kosto të konsiderueshme e cila paraqitet si vijon:

	Veprimtaria	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i mesëm dhe profesional	TOTALI
1	Autonomia e shkollave	2 260 000	863 000	3 123 000
2	Trajnime të drejtuesve dhe të punonjësve të DAR/ZA	94 000		
	<b>TOTALI</b>	<b>3 217 000</b>		

- Ndërtimi dhe përdorimi funksional i EMIS do të kushtojë:

	Veprimtaria	Kostoja
1	Blerje dhe montim i pajisjeve të EMIS	123 000
2	Trajnime për EMIS	45 000
3	Dixhitalizimi i amzave	52 000
4	<b>TOTALI</b>	<b>220 000</b>

- Për krijimin e programeve mësimore e rishikimin e tyre në të gjitha nivelet parashikohen të shpenzohen deri në 746 607 300 lekë. Ndërsa për hartimin, botimin, rishikimin e teksteve shkollore parashikohet të shpenzohen 2 754 839 600 lekë.

- Vlerësimi i nxënësve ka kosto të konsiderueshme në buxhet e cila paraqitet si vijon:

	Veprimtaria	Kostoja
1	Vlerësimet kombëtare për provimet e lirimt	32 000
2	Përgatitja dhe zhvillimi i provimeve të Maturës Shtetërore	39 000
3	Trajnime për provimet e Maturës Shtetërore	58 000
4	Vlerësimi në përgjithësi i nxënësve	260 000
	<b>TOTALI</b>	<b>389 000</b>

- Krijimi dhe përdorimi funksional i laboratorëve të informatikës në shkolla, do të ketë koston deri në 1 100 000 000 lekë (përfshi trajnimet e mësuesve dhe pajisjen me mobilje të laboratorëve) Për ngritjen e tyre është planifikuar të mbulohet me shpenzimet si si vijon:

	Veprimtaria	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i mesëm	Arsimi profesional	T O T A L I
1	Ndërtim dhe pajisje laboratorësh informatikë	772 000	18 000	107 000	897 000

Ndërtimi dhe pajisja e laboratorëve virtualë e bibliotekave dixhitale dhe konvencionale si burime alternative mësimdhënieje do të kushtojë përafërsisht:

	Veprimtaria	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i mesëm	Arsimi profesional	T O T A L I
1	Ndërtim dhe pajisje laboratorësh virtualë	726 000	67 000	26 000	819 000
2	Biblioteka dixhitale	300 000	67 000		367 000
3	Pajisje bibliotekash	516 000	117 000		633 000
4	TOTALI	1 542 000	251 000	26 000	1 819 000

- Ndërtim laboratorësh të shkencave natyrore (matematikë, fizikë, kimi)

	Veprimtaria	Arsimi 9-vjeçar	Arsimi i Mesëm	Arsimi Profesional	T O T A L I
1	Ndërtim laboratorësh	2 300 000	630 000	160 000	3 090 000
2	Pajisje me mobilieri e tyre	65 000	20 000	32 000	117 000
3	TOTALI	2 365 000	650 000	192 000	3 207 000

Në vijim paraqitet buxheti i planifikuar për periudhën 2009 - 2013

**Buxheti i Arsimit Parauniversitar që nga viti 2007 dhe parashikimi i tij për 2010 - 2013**  
Sipas Treguesve të PBA (maj 2009) (në milion lekë)

Nr.	Emërtimi	Buxheti	Buxheti	Buxheti	Projektbuxheti	Projektbuxhet	Projektbuxhet	Projektbuxhet
		2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
I.	Totali i shpenzimeve të MASH	32.634	37.009	41.464	47.028	51.711	58.192	69.902
I.	Totali i shpenzimeve të arsimit parauniversitar MASH	27.598	31.947	33.717	38.201	42.711	47.027	52.641
II.	Totali i shpenzimeve ne sektorin e arsimit parauniversitar (I+C)	29.598	34.247	36.362	41.243	46.301	51.334	57.379
	(në % të PBB)	3,01%	3,18%	3,08%	3,18%	3,24%	3,39%	3,57%
III.	Totali i shpenzimeve ne sektorin e arsimit	34.634	39.309	44.109	50.070	55.300	62.499	65.640
	(në % të PBB)	3,53%	3,65%	3,74%	3,86%	3,87%	4,13%	4,09%
A.	Shpenzime korrente	21.567	24.991	24.844	26.728	30.872	34.057	37.463
1	Pagat + Sigurimet shoqërore	19.402	22.816	22.695	23.658	26.780	28.942	31.836
2	Mallra dhe shërbime	2.165	2.175	2.149	3.070	4.092	5.115	5.627
B.	Investimet	4.031	4.656	6.228	8.431	8.250	8.663	10.440
1	Financimi i brendshëm	3.486	3.956	4.762	6.681	6.480	7.033	8.127
2	Financimi i huaj	545	700	1.466	1.750	1.770	1.630	2.313
C.	Shpenzimet e pushtetit vendor	2.000	2.300	2.645	3.042	3.589	4.307	4.738
II.	Nr. i punonjësve	40.433	38.496	38.322	38.322	38.322	38.322	38.322
III.	GDP nominale	982.200	1.075.718	1.180.000	1.298.000	1.429.000	1.514.740	1.605.624



Tabela analitike të shpenzimeve për arsimin parauniversitar (Buxheti i Shtetit):

	2008	2008	2008	Totali
Titulli Programi Buxhetor	Paga + sig. shoq.	Të tjera korrente	Investime	
1. Planifikim menaxhim	563.742	284.150	103.850	951.742
2. Arsimi baze	16.736.649	1.302.369	3.365.185	21.404.203
3. Arsimi Mes.Përgj.	3.845.188	281.975	781.600	4.908.763
4. Arsimi profesional	1.669.868	306.828	405.569	2.328.265
<b>TOTALI</b>	<b>22.815.447</b>	<b>2.175.322</b>	<b>4.656.204</b>	<b>29.592.973</b>

	2009	2009	2009	Totali
Titulli Programi Buxhetor	Paga + sig. shoq.	Të tjera korrente	Investime	
1. Planifikim menaxhim	644.900	260.000	97.311	1.002.211
2. Arsimi baze	17.000.000	1.364.000	4.195.600	22.559.600
3. Arsimi Mes.Përgj.	3.410.000	380.000	1.312.300	5.102.300
4. Arsimi profesional	1.640.000	409.000	551.100	2.600.100
<b>TOTALI</b>	<b>22.694.900</b>	<b>2.413.000</b>	<b>11.116.211</b>	<b>31.264.211</b>

	2010	2010	2010	Totali
Titulli Programi Buxhetor	Paga + sig. shoq.	Të tjera korrente	Investime	
1. Planifikim menaxhim	648.900	320.000	160.000	1.128.900
2. Arsimi baze	17.592.930	1.755.000	5.748.000	25.095.930
3. Arsimi Mes.Përgj.	3.609.590	470.000	1.836.000	5.915.590
4. Arsimi profesional	1.807.000	525.000	687.000	3.019.000
<b>TOTALI</b>	<b>23.658.420</b>	<b>3.070.000</b>	<b>8.431.000</b>	<b>35.159.420</b>

	2011	2011	2011	Totali
Titulli Programi Buxhetor	Paga + sig. shoq.	Të tjera korrente	Investime	
1. Planifikim menaxhim	733.257	340.000	160.000	1.233.257
2. Arsimi baze	19.926.011	2.479.000	5.505.000	27.910.011
3. Arsimi Mes.Përgj.	3.978.837	585.000	1.715.000	6.278.837
4. Arsimi profesional	2.141.910	688.000	870.000	3.699.910
<b>TOTALI</b>	<b>26.780.015</b>	<b>4.092.000</b>	<b>8.250.000</b>	<b>39.122.015</b>

	2012	2012	2012	Totali
Titulli Programi Buxhetor	Paga + sig. shoq.	Të tjera korrente	Investime	
1. Planifikim menaxhim	791.558	425.000	100.000	1.316.558
2. Arsimi baze	21.540.172	3.098.750	5.846.000	30.484.922
3. Arsimi Mes.Përgj.	4.247.144	731.250	1.640.000	6.618.394
4. Arsimi profesional	2.363.263	860.000	1.077.000	4.300.263
<b>TOTALI</b>	<b>28.942.137</b>	<b>5.115.000</b>	<b>8.663.000</b>	<b>42.720.137</b>

	2013	2013	2013	Totali
Titulli Programi Buxhetor	Paga + sig. shoq.	Të tjera korrente	Investime	
1. Planifikim menaxhim	920.600	450.000	150.000	1.520.600
2. Arsimi baze	24.008.815	3.478.670	6.673.148	34.160.633
3. Arsimi Mes.Përgj.	4.894.767	841.300	2.126.475	7.862.542
4. Arsimi profesional	2.932.418	857.030	1.490.377	5.279.825
<b>TOTALI</b>	<b>31.836.600</b>	<b>5.627.000</b>	<b>10.440.000</b>	<b>48.823.600</b>

Shënim. Në tabelat analitike për shpenzimet sipas programeve buxhetore nuk janë përfshirë shpenzimet e parashikuara nga njësitë e pushtetit vendor për funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të sistemit arsimor parauniversitar sipas viteve sa vijon:

- për vitin 2008 ishin parashikuar 2.3 miliard lekë;
- për vitin 2009 janë parashikuar 2.64 miliard lekë;
- për vitin 2010 janë parashikuar 3.1 miliard lekë;
- për vitin 2011 janë parashikuar 3.6 miliard lekë;
- për vitin 2012 janë parashikuar 4.3 miliard lekë;
- për vitin 2013 janë parashikuar 4.7 miliard lekë.

## KAPITULLI V LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Strategjia Kombëtare e Arsimit Parashkollor, nëpërmjet përcaktimit të politikave që duhen ndjekur e objektivave që duhen arritur kërkon në thelb ndryshimin e gjendjes ekzistuese dhe ngritjen cilësore të Arsimit Parauniversitar në nivelin e kërkesave të kohës dhe proceseve integruese ku është përfshirë shoqëria jonë.

Për vlerësimin e arritjes së objektivave të Strategjisë përcaktohen tregues të matshëm. Referenca bëhet në të dhënat sasiore të prezantuara në kapitullin e parë. Treguesit, si pohime të ndryshimeve të synuara, paraqiten si detaje cilësore e sasiore të tërësisë së objektivave të përcaktuara dhe të rrugës së parashikuar të implementimit të Strategjisë. Përdorimi i tyre, jo vetëm në fund të procesit por edhe gjatë implementimit të Strategjisë, përbën atë mekanizëm kushtëzues mbi bazën e të cilit monitorohet ecuria, niveli i progresit në çdo moment kohe, kryhet dhënia e llogarisë dhe merren masa për përmirësime të mëtejshme.

Rëndësi të veçantë në proces, ashtu si edhe i objektivave, merr “zotërimi” i tyre nga ana e të gjithë aktorëve të interesuar për zhvillimin reformues të Arsimit Parauniversitar.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës luan rolin udhëheqës dhe mban përgjegjësinë kryesore në procesin e implementimit të Strategjisë. Në kryerjen e këtij roli, gjen dhe vë në veprim mekanizmat relevantë për evidentimin, mbledhjen e informacionit e përpunimin e tij. Ajo e realizon këtë në bashkëpunim me institucionet e varësisë në qendër e në nivel vendor, shkollat, komuniteti e aktorë të tjerë.

Së pari monitorimi dhe vlerësimi i ecurisë së Strategjisë realizohet nëpërmjet raportit të hartuar për këtë qëllim nga Departamenti i Analizës së Politikave dhe Planifikimit Strategjik pranë MASH. Ky raport hartohet në fund të vitit mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga DTIS, departamentet e MASH dhe institucioneve të varësisë në qendër e rrethe.

Raporti vjetor paraqitet për diskutim në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, në takim me aktorët e interesuar nga shoqëria civile e donatorë.

Raporti Vjetor Statistikor i Arsimit, i publikuar çdo vit të pasqyrojë edhe shkallën e përmbushjes së objektivave të kësaj Strategjie.

Nga institucionet arsimore vendore të sillet periodikisht (çdo 6 muaj) raport mbi ecurinë e implementimit të Strategjisë dhe rekomandimet e objeksionet e mundshme për përmirësimin e mëtejshëm të saj.

A. Tregues cilësorë të matjes së ecurisë së kësaj strategjie

1. Decentralizimi i shërbimit arsimor dhe rritja e autonomisë së shkollave. Përmirësimi i kapaciteteve dhe aftësive menaxhuese në nivelin qendror (MASH), rajonal, vendor si dhe i institucioneve të varësisë.

2. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, duke u bazuar në performancën.

3. Rritja e cilësisë së sistemit arsimor dhe matja e performancës nëpërmjet vlerësimeve.

4. Vendimmarrje në bazë të sistemit të menaxhimit të informacionit në shërbimin arsimor (EMIS).

5. Reformimi i sistemit të financimit dhe rritja e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet.

6. Sigurimi i kushteve dhe rritja e frekuentimit nga ana e shtresave të marginalizuara.

7. Zhvillimi cilësor dhe sasior i arsimit parashkollor.

8. Arsimit Profesional është në gjendje t'i përgjigjet, në dinamikën e tyre, tendencave dhe kërkesave të tregut lokal, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar të punës.

## B. Treguesit e matshëm sasiore

1. Menaxhim mbi bazë performance (MBP) është transferuar nga MASH tek institucionet vartëse si dhe në nivel rajonal e shkolle.
2. Punonjësit e të gjithë institucioneve qendrore dhe vendore kanë përshkrime të qarta të vendeve të punës
3. Përdorimi i standardeve të performancës për raportimin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin institucional e individual.
4. Shkollat menaxhohen në mënyrë autonome dhe operojnë me grant shkollor.
5. Zbatim efektiv i legjislacionit dhe rregulloreve mbi autonominë e shkollave në fushën e personelit. Pozicioni i ri i mësuesit me kohë të plotë dhe diversifikim i kompetencave të tij
6. Të gjitha shkollat janë informatizuar
7. Funksionimi i EMIS në 100% të nivelit rajonal dhe shkollor
8. Korniza e përgjithshme Kurrikulare Kombëtare (KKK) shërben si bazë për zhvillimin e politikave dhe planeve mësimore.
9. Urdhri i Mësuesit bazë rregullatorë e marrëdhënieve
10. Mësuesit rekrutohen në përputhje me kriteret e reja të MASH, bazuar në database mbi mësuesit në EMIS dhe sistemi i akreditimit të profesionit të mësuesit dhe i sigurimit të cilësisë funksionojnë efektivisht. Pozicioni i tij është përshtatur me atë të nëpunësit civil.
11. Botimi i teksteve alternativë shkollorë është liberalizuar plotësisht dhe tekstet sigurohen normalisht për të gjithë nivelet
12. Zbatimi efektiv i mekanizmave për mbulimin e kostos për tekstet shkollore
13. Zbatim efektiv i politikave për bibliotekat dhe burimeve të tjera alternative në të gjithë shkollat
14. AVA kryen veprimtaritë e saj në bazë të funksioneve të qarta të saj.
15. Përqindja e PPB (GDP) për AP arrin në masën 3,71% në 2013
16. Funksionim efektiv i modelit të financimit "për nxënës"
17. Funksionim efektiv i sistemit të transparencës së financimit / buxhetit dhe i politikave për inkurajimin e tërheqjen e fondeve nga sektori privat. Përrjashtimi nga taksat të investimeve në arsim.
18. Hartimi i politikave i bazuar në kërkim dhe i orientuar nga të dhënat.
19. Rritja e mesatares së viteve të shkollimit të popullsisë në 11.0 deri në 2013.
20. Shtrirja e shkollave në të gjithë territorin sidomos në zonat sidomos me dendësi të ulët popullore.
21. Shkolla me kohë të shkurtuar në çdo njësi administrative vendore,
22. Ndërtimi i konvikteve për nxënësit e arsimit të detyruar, sidomos për ata të cilët banojnë larg shkollës.
23. Arritja e kushteve optimale mësimore nëpërmjet përmirësimit të mjediseve shkollore dhe pajisjes së shkollave me mjete laboratorike didaktike dhe kompjuterë.
24. Përfshirja në masën 86% e tërheqjes së nxënësve në arsimin e mesëm.
25. Hartimi i listës së profesioneve dhe standardeve të tyre, krijimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve Profesionale sipas standardeve evropiane të kualifikimeve me kuadër ligjor të plotësuar.
26. Përqindja e nxënësve në arsimin e mesëm që ndjekin shkollat tekniko-profesionale dhe social-kulturore është 40% në vitin 2013.
27. Përqindja e nxënësve që mbarojnë nivelin e punëtorit të kualifikuar dhe ndjekin cikle plotësuese të kulturës së përgjithshme
28. Numri i rrjetit të konvikteve të shkollave të mesme të përgjithshme.
29. Regjistrimi në vitin shkollor përgatitor në moshën 5 vjeç.
30. Sigurimi i shërbimeve të fëmijërisë së hershme sidomos tek grupet e marginalizuara, dhe zonat e varfra
31. Rritja e përqindjes së fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor në masën 70% në 2013.

32. Përgatitja e modeli të ri mësuesi parashkollor dhe trajnimi i tyre në masën 80% deri në vitin 2013
33. Sigurimi i alternativave të reja të shërbimit parashkollor – tipe të ndryshme kopshtesh
34. Rritja e frekuentimit nga shtresat e marginalizuara dhe shtresat në nevojë
35. Rritja e raportit të regjistrimit neto (NER) nga 94% në 95% të nxënësve që frekuentojnë arsimin e bazë deri në 2013.
36. Monitorimi i cilësisë dhe përdorimi i treguesve ndërkombëtarë (rezultatet e PISA)

**MASAT NE ZBATIM TE OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
PËR PERIU DHËN 2009 - 2013**

MASAT DHE VEPRIMET PER T'U MARRE	INSTITUCIONI PERGJEGJES	TREGUESIT MONITORUES	AFATI I REALIZIMIT	Vërejtje
1. Rritja e aksesit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.				
<p>1.1 Politika të veçanta</p> <p>Hartimi i politikave të veçanta për të rritur përqindjen e tërheqjes së fëmijëve parashkollorë në kopshte</p> <p>Instalimi i shërbimit psiko-social me specialistë të mirëfilltë,</p> <p>Krijimi i ekipeve me mësues me reputacion të udhëhequr nga specialistë të shërbimit psikologjik me prindër dhe përfaqësues të pushtetit, për punë me prindërit e nxënësve të paregjistruar apo që kanë braktisur shkollën, si dhe për punë me vetë këta nxënës</p> <p>Ndihmë e ekonomike për familjet apo pajisjen me bursa</p> <p>Programeve mësimorë sa më relevantë</p> <p>Zgjerimi e forcimi i autonomisë së shkollave shpie në rritjen e interesit të aktorëve për shkollën.</p> <p>Realizimi i programeve mësimore suplementare</p>	MASH, institucionet e varësisë, MF, DAR/ZA, shkollat, PV, OJF	Rritje NER dhe GER Ulje e përqindjes së braktisjes së shkollës	2009 - 2013	
<p>1.2 Infrastruktura shkollore</p> <p>Racionalizimi i shtrirjes së shkollave në të gjithë territorin për të siguruar shërbimin arsimor në të gjithë zonat sidomos me dendësi të ulët popullore.</p> <p>Sigurimi i kushteve të përshtatshme të studimit për të gjithë nxënësit, dhe sidomos të atyre të zonave rurale</p> <p>Sigurimi i transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për fëmijët e tjerë të cilët banojnë larg shkollës.</p> <p>Ndërtimi i konvikteve për nxënësit e arsimit të detyruar, për të krijuar akses për nxënësit vendbanimi i të cilëve është larg shkollës. Zgjerimi i rrjetit të konvikteve të shkollave të mesme të përgjithshme.</p> <p>Bashkëpunimi më i mirë me shoqërinë civile dhe OJF të cilat kanë në fokus të punës së tyre shtresat e marginalizuara.</p>	MASH, institucionet e varësisë, MF, DAR/ZA, shkollat, PV, OJF	Ndërtim shkollash të reja dhe rikonstruksion sipas standardeve bashkëkohore	2009 - 2013	
2. Reformimi dhe fuqizimi i kapacitetit politikëbërës, menaxhues dhe vendimmarrës,				
<p>2.1 Sistemi menaxhues i performancës</p> <p>Zhvillimi i standardeve minimale të performancës dhe i skemave nxitëse për të inkurajuar nivele të larta të performancës</p>	MASH Institucionet e varësisë	Të gjitha institucionet, e varësisë të MASH do të adaptojnë MBP deri në fund të vitit 2008.	2009 - 2011	

Transferimi i menaxhimit me bazë performance (MBP) në nivele rajonale, lokale dhe shkollore Rritja e kapaciteteve për përdorimin e MBP në menaxhimin e MASH e DAR/Za nëpërmjet trajnimit intensiv.	DAR/ZA	100 % DAR / ZA përdorin MBP deri në vitin 2009. Reduktimi i kohës në marrjen e vendimeve në nivel qendror Iniciativë e rritur e stafit në zgjidhjen e problemeve		
2.2 Decentralizimi i sistemit Hartimi i udhëzimeve për funksionet që do të decentralizohen dhe procedurat për raportim dhe sigurim të cilësisë Pilotimi i decentralizimit Zhvillimi i kapaciteteve në nivel qarku, bashkie, komune dhe shkolle për të përdorur të dhëna për planifikim në nivel lokal	MASH, DAR/ZA	Udhëzues mbi decentralizimin 2008 Pilotim i procedurave të reja në 2009 Trajnime të gjithë stafit përkatës 50 % e funksioneve të miratuara të decentralizuara në shkallë vendi deri 2009 100 % e funksioneve të miratuara të decentralizuara në shkallë vendi deri 2012	2009 - 2012	
2.3 Autonomia e shkollave Zhvillimi i politikave të qarta për menaxhimin mbi bazë granti për drejtuesit e shkollës, bordin dhe shoqatave të prindërve. Vendosja e indikatorëve të jashtëm të cilësisë në të gjitha nivelet Krijimi i kapaciteteve për të përgatitur planet zhvillimore të shkollës Pilotimi i autonomisë së shkollës nga firma konsulentë Zhvillimi i sistemeve cilësore të përgjegjshmërisë	MASH, DAR/ZA, shkollat	40 shkolla të përzgjedhura për pilotim funksionojnë si shkolla autonome në vitin 2008 50% e të gjitha shkollave funksionojnë si ente autonome deri në vitin 2011. 100% e shkollave janë tërësisht ose pjesërisht autonome deri në 2013.	2009 - 2013	
2.4 Sistemi i menaxhimit të informacionit në sektorin e arsimit Hartimi i politikave EMIS Vlerësimi i kapaciteteve dhe ndërtimi i infrastrukturës Shtrirja e trajnimit për stafin teknik dhe profesional Trajnimi i stafit në nivel vendor që mbledh të dhënat Trajnimi i stafit në nivel vendor që analizon dhe raporton mbi të dhënat	MASH, DAR/ZA, shkollat në nivel kombëtar	EMIS pilotohet në 100 shkolla në 2009 EMIS vepron në 50% të nivelit qendror rajonal dhe shkollor në 2011 EMIS vepron në 100% të nivelit rajonal dhe shkollor në vitin 2013	2009 - 2013	
2.5 Raportimi dhe sigurimi i cilësisë Zhvillimi i indikatorëve të rinj të cilësisë Përshtatja e treguesve të performancës së MASH me ato të ministrive të tjera si dhe me treguesit ndërkombëtarë Zhvillimi i udhëzimeve mbi raportimin Trajnimi i supervisorëve dhe drejtorëve me procedurat e reja Zhvillimi i niveleve të ndryshme të raportimit për performancën e stafit Zhvillimi i sistemeve të vlerësimit të bazuara në evidenca	MASH, institucionet e varësisë, DAR/ZA, shkollat në nivel kombëtar	50% e Dr. DAR/ ZA.. zbatojnë vlerësimin e stafit dhe sigurimin e cilësisë deri në vitin 2009.  100 % e Dr. DAR/ ZAA. zbatojnë vlerësimin e stafit dhe sigurimin e cilësisë deri në vitin 2011	2009 - 2011	
3. Përmirësimi i cilësisë së procesit të mësimin:				
3.1 Zhvillimi i kurrikulës Hartimi i Kornizës Kurrikulare Kombëtare (KKK) Zhvillimi i politikave dhe i planeve mësimore për zbatimin e KKK duke rishikuar	MASH, IKT, DAR/ZA	KKK është hartuar dhe miratuar deri në 2008 Planet mësimore fillore të zhvilluara, eksperimentuara dhe zbatuara deri në 2010	2009 - 2013	

përmbajtjen lëndore dhe vijueshmërinë horizontale dhe vertikale Zhvillimi i politikave për hartimin e kurrikulave të lëndëve me zgjedhje dhe kurrikulës gjithëpërfshirëse. Pilotimi i kurrikulave së re Trajnimi i mësuesve në përdorimin e kurrikulës së re.		Planet mësim. të arsimit të mesëm të zhvilluara, eksperiment. dhe zbatuara deri në vitin 2013.		
3.2 Zhvillimi i profesionit të mësuesit Ndërtimi dhe funksionimi efektiv i sistemit për të dhënat mbi mësuesit në EMIS Forcimi i agjencive për zhvillimin e profesionit të mësuesit Rishikimi dhe forcimi i kurrikulës së trajnimit të mësuesve Rishikimi i kushteve të punësimit të mësuesve Rishikimi i sistemit të trajnimit të mësuesve në punë Zhvillimi i akreditimit të profesionit të mësuesit dhe i sigurimit të cilësisë	METE, MF	Përshkrime të qarta të vendeve të punës për IKT dhe emërimi në bazë merite deri 2009 Miratimi i MBP dhe realizimi i 12 vlerësimeve mujore brenda 2010 Krijimi i bordit të akreditimit të mësuesve dhe procedurave përkatëse deri në 2010. Akreditimi dhe shpërblimi i mësuesve bazuar në merita në 2011	2009 - 2012	
3.3 Tekstet shkollore Zhvillimi i politikave për tekstet alternative dhe privatizimi i plotë i botimeve të teksteve shkollorë Zbatimi i mekanizmave për mbulimin e kostos për tekstet shkollore Sigurimi i teksteve shkollorë	MASH, BOMIT, DAR/ZA	Finalizimi për mbulimin e kostos dhe pilotimi në 2011.	2009-2012	
3.4 Burimet alternative të mësimdhënies Zhvillimi i politikave për bibliotekat e shkollave, standardet e tyre minimale si dhe për sasinë dhe tipat e teksteve alternative, CD etj. Zhvillimi i politikave për sigurimin dhe përdorimin e Internetit në procesin mësimor Trajnimi i stafit pedagogjik për përdorimin e burimeve alternative	MASH, IKT, DAR/ZA	Pajisja e gjithë shkollave me qendra burimore alternative Trajnimi i gjithë stafit pedagogjik përdorues i burimeve alternative	2009 - 2013	
3.5 Provimet dhe monitorimi Forcimi i AVA Monitorimi dhe vlerësimi i vijueshëm me qëllim përmirësimin, me anë të nxjerrjes së akteve nënligjore; Zhvillimi i vijueshëm i kapacitetit të MASH, AVA dhe DAR/ZA Zhvillimi i kapacitetit të MASH dhe AVA për implementimin e indikatorë ndërkombëtarë		Organizimi me sukses i Provimeve të Lirimit në 2009 Provime të suksesshme të Maturës Shtetërore deri në 2013 Rigorozitet dhe besueshmëri në provimet e Lirimit dhe provimet e maturës	2009 - 2013	
4. Financimi i Arsimit Parauniversitar				
4.1 Instrumentet dhe proceset për transferimin e fondeve Zhvillimi i modelit të financimit "për nxënës" Zhvillimi i mekanizmave për financimin e decentralizimit (grantet shkollore) Trajnim i plotë në të gjitha nivelet për menaxhimin e planifikimit të buxhetit dhe raportimit	MASH, DAR/ZA, shkollat	Të gjitha shkollat në vitin 2013 menaxhohen mbi bazën e grantit shkollor Trajnimi i gjithë drejtuesve të shkollave, stafit menaxherial e financiar, inspektorëve e audituesve në lidhje me menaxhimin e fondeve	2009 - 2013	
4.2 Rritja e eficiencës në financimin e nënsektorëve Zhvillimi i sistemit për ndarjen e informacionit të financimit / buxhetit	MASH, KM, MF, DAR/ZA	Kuadër i plotë ligjor i financimeve të reja Rritje e fondeve të përfituara nga sektori	2009 - 2013	

Zhvillimi i politikave për tërheqjen e fondeve nga sektori privat Hartimi i legjislacionit për të inkurajuar shkollat në mbledhjen e fondeve Negocim për përjashtimin nga taksat të investimeve në arsim Konsolidimi i procesit për të inkurajuar publikun për financimin e arsimit		privat Sektori privat përjashtohet nga taksat Publiku informohet plotësisht mbi buxhetin		
4.3 Sistemet e ekspertizës dhe mbështetjes së reformës Zhvillimi i roleve dhe përgjegjësi midis ekspertit dhe ekspertizës për mbështetje me koncepte dhe procese të reja. Trajnimi i këshilluesve që do të punojnë në nivel Ministrie Trajnimi i këshilluesve që do të punojnë në nivel rajonal/PV Trajnimi i këshilluesve që do të punojnë në nivel shkolle		Krijimi i sistemeve të ekspertizës deri në 2009 Krijimi i grup-shkollave dhe rrjeteve rajonale deri në 2009 Trajnimi i gjithë këshilluesve deri më 2012	2009 - 2012	
5. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i burimeve njerëzore				
5.1 Arsimi si shërbim ndërsektorial Krijimi dhe fuqizimi i rolit të Këshillit Kombëtar të AP Ndërgjegjësimi dhe përfshirja publike	MASH	KKAP ka rol të ndjeshëm në hartimin e politikave e marrjen e vendimeve	2009 - 2013	
5.2 Racionalizimi i shpërndarjes së shkollave Zhvillimi i vetëdijes së publikut se cilësia dhe sasia sjellin kosto Rishikimi i objektivave lokal dhe kombëtar për të plotësuar parimin e barazisë dhe aksesit.		Krijimi i forumeve fillestare në nivel kombëtar deri në vitin 2009 Hartimi i dokument- diskutimit provizor deri në 2009		
5.3 Inspektimi dhe ndihma Krijimi i roleve të reja si kontrollues/këshilluesve Trajnimi i inspektorëve arsimorë për rolet e reja Zhvillimi i besimit nëpërmjet metodës për ndershmërinë në procesin e vet-raportim	MASH, DAR/ZA	Vlerësimi i performancës së inspektorëve deri në vitin 2009 Informacioni i përpunuar për drejtorët e shkollave dhe mësuesit	2009 - 2013	
5.4 Profesionalizimi i mësimdhënies Krijimi i Urdhrit të Mësuesit Përshtatja e statusit të mësuesve me atë të punonjësve civilë Kompetenca shumë-disiplinore të mësuesve për rritjen e aftësive profesionale	MASH	Adoptimi i legjislacionit deri në vitin 2009 Adoptimi i legjislacionit për përafrimin me nëpunësin civil deri në vitin 2013	2009 - 2013	
5.5 Shërbimi arsimor privat Plotësimi i kuadrit ligjor Zgjerimi i larmisë së institucioneve arsimore private	MASH, DShJ DAR/ZA	Plotësimi i kuadrit ligjor deri më 2009 Shtimi progresiv i numrit të institucioneve private dhe shërbimeve	2009 - 2013	
5.6 Hartimi i proceseve për bërjen e politikave në bazë të të dhënave Zhvillimi i kapaciteteve në përdorimin e të dhënave për të testuar idetë (pilotime) Trajnimi i stafit të DAPPS në analizën dhe raportimin e të dhënave	DAPPS MASH	Hartimi i politikave dhe procedurave për veprimtari kërkimore deri në vitin 2009 Numër në rritje i studimeve kërkimore të porositura Hartimi i një sërë dokumentesh politikë Numri i projekteve të OJQ-ve të vendit dhe të huaja.	2009 - 2013	
6. Zhvillimi i arsimit profesional:				
6.1 Fleksibiliteti i ofertës, mundësive të pranimit, sigurimi i mobilitetit vertikal e horizontal.	MASH	Plotësimi i kuadrit ligjor brenda vitit 2009	2009 - 2013	



<p>Arsimi Profesional relevant me kërkesat e tregut lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, reagues dinamik ndaj ndryshimeve të tyre. Krijimi i Përshtatja e strukturës disa nivelesh të sistemit të AP në përputhje me kuadrin kombëtar të kualifikimeve profesionale (standarde evropiane të kualifikimeve) Modernizimi i modelit kurrikular Zhvillimi i arsimit bujqësor nëpërmjet hapjes së shkollave të reja</p>		<p>Dyfishimi i përqindjes së ndjekjes së shkollave tekniko-profesionale dhe social-kulturore brenda vitit 2013 (40%) Rritja me 20% e vendeve të reja të punës deri në vitin 2013 Rritja me 10 % e të punësuarve jashtë vendit në profesione të vlerësuara deri në vitin 2013 Rritja e numrit të shkollave Bujqësore në përputhje me kërkesat</p>		
7. Zhvillimi i arsimit parashkollor				
<p>7.1 Shtimi i aksesit dhe përmirësimi i shërbimit në funksion të përgatitjes së fëmijëve për shkollë Pilotimi i uljes me një vit të moshës së regjistri-mit në shkollë, nga 6 në 5 vjeç, si një vit shkollor përgatitor Shtirja e mjaftueshme e institucioneve para-shkollore Sigurimi i alternativave të reja të shërbimit parashkollor Sigurimi i shërbimeve të fëmijërisë së hershme sidomos tek grupet e marginalizuara, dhe zonat e varfra Përgatitja e modeli të ri mësuesi parashkollor Sigurimi i programeve të reja dhe i materiale didaktike përkatës. Zbatimi i standardeve të përmbajtjes në sistemin e arsimit parashkollor Zhvillimi i programeve sistematike për edukimin e prindërve</p>		<p>Zbatimi i kurrikulës së arsimit parashkollor të përgatitur në vitin 2008 Përfshirja e fëmijëve në institucione të arsimit parashkollor në përputhje me standardet përkatëse (30% në zonat rurale dhe 50 në zonat urbane) deri në 2009 Trajnimi i edukatorëve të kopshteve në masën 40% deri në vitin 2010 dhe 80% deri në 2013 Përgatitja e materialeve didaktike në ndihmë të kualifikimit të prindërve për të ndihmuar fëmijët në përgatitjen e tyre deri në vitin 2010 Sigurimi i institucioneve të nevojshme dhe i bazës didaktike mësimore deri në vitin 2013</p>	2009 - 2013	

<sup>[1]</sup> Burimi: Zyra e Statistikave në MASH

<sup>[2]</sup> Të dhënat janë marrë nga Zyra e Statistikave në MASH

<sup>[3]</sup> numri i nxënësve të regjistruar në një nivel të caktuar arsimi, pavarësisht nga moshja, i shprehur si përqindje e popullsisë të grupmoshës teorike për të njëjtin nivel arsimi.

<sup>[4]</sup> Numri i nxënësve në moshën teorike për një nivel të caktuar arsimi të regjistruar në atë nivel, të shprehur si përqindje e popullsisë së grupmoshës teorike

<sup>[5]</sup> Marrë nga Zyra e Statistikave në MASH

<sup>[6]</sup> Duke filluar nga viti shkollor 2003 – 2004 e në vijim: 75755, 74766, 74642, 71860, 72600

<sup>[7]</sup> Në konfirmim të projeksioneve të përpunuara nga INSTAT

<sup>[8]</sup> Shih “RAPORTI VJETOR STATISTIKOR I ARSIMIT 2003 – 2004”

<sup>[9]</sup> duke filluar nga viti shkollor 2003 – 2004 e në vijim: 51, 68, 77, 93, 106, 121

<sup>[10]</sup> Në vitin 2009 janë punësuar 38 322 mësues që përbëjnë gati 43% të punonjësve buxhetorë – VKM Nr 439 datë 22.04.2009 “Për një ndryshim në vendimin nr.1694, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, për vitin 2009, në ministritë dhe institucionet qendrore”

<sup>[11]</sup> Test i kryer çdo tre vjet në nivel botëror për matjen e performancës së nxënësve 15 vjeçarë . Zbatimi i këtij testi koordinohet nga OECD. Qëllimi i tij është testimi dhe krahasimi i performancës së nxënësve në nivel botëror, me synim përmirësimin e metodave dhe rezultateve të mësimin. Rezultatet e tij për Shqipërinë në vitin 2001 nga PISA+.

Aftësi profesionale për shoqërinë e dijes	Rezultati
1. Performanca mesatare (dhe shpërndarja) e nxënësve (mosha 15 vjeçare) sipas shkallës së njohurisë së leximit të PISA-s	349
2. Performanca mesatare (dhe shpërndarja) e nxënësve (mosha 15 vjeçare) sipas shkallës së njohurive matematikore të PISA-s	381
3. Performanca mesatare (dhe shpërndarja) e nxënësve (mosha 15 vjeçare) sipas shkallës së njohurive shkencore të PISA-s	376
4. Përqindja me arritje të ultë (niveli 1 ose më poshtë) i pesëmbëdhjetë vjeçarëve për sa i përket leximit	44

<sup>[12]</sup> Shih PKZMSA, ARSIMI DHE SHKENCA, 3.19.3 ARSIMI PARAUNIVERSITAR

<sup>[13]</sup> Në vitin shkollor 2005 – 2006 ky tregues ka qenë 887

<sup>[14]</sup> Këtij numri i shtohen edhe objektet shkollore të financuara në bashkëpunim me Bankën Botërore, Këshillin e Evropës dhe institucione të tjera të huaja.

<sup>[15]</sup> EDUCATION AT A GLANCE 2008 (OECD Indicators) f. 346: në vendet e OECD në Arsimin Publik mësojnë 91.1% e nxënësve, ndërsa në 19 vende të BE mësojnë 89.9% e tyre.

<sup>[16]</sup> EDUCATION AT A GLANCE 2008 (OECD Indicators) f. 237

<sup>[17]</sup> EDUCATION AT A GLANCE 2008 (OECD Indicators) f. 256

<sup>[18]</sup> PKZMSA faqe 268

<sup>[19]</sup> instrument i krijuar nga Këshilli i Evropës për prezantimin personal të përvojave gjuhësore gjatë procesit formal dhe jo formal të shkollimit.

<sup>[20]</sup> Sector-Wide Approach – Përjasje sektoriale, mënyrë financimi me bashkimin e financimeve të disa donatorëve dhe vendi përfitues për një sektor të caktuar, në rastin konkret sektorin e arsimit

<sup>[21]</sup> Të gjitha sasitë janë në mijë lekë

<sup>[i]</sup> Të dhënat janë marrë nga Zyra e Statistikave në MASH

**VENDIM**  
**Nr.879, datë 12.8.2009**

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, GJIMNAZI “LINZ”, NË QYTETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, gjimnazi “Linz”, në qytetin e Tiranës, i cili do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.
  2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin e nxënësve në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.136, datë 18.9.2009, faqe 6299*

**VENDIM**  
**Nr.1067, datë 21.10.2009**

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLËS 9-VJEÇARE, TË CIKLIT TË LARTË “HAFIZ  
ABDULLA ZËMBLAKU”, QË NË PROGRAMIN MËSIMOR DO TË ZHVILLOJË EDHE  
LËNDË FETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, e ciklit të lartë “Hafiz Abdulla Zëmbaku”, në qytetin e Korçës, që në programin mësimor do të zhvillojë edhe lëndë fetare.
  2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.162, datë 27.11.2009, faqe 7217*

**VENDIM**  
**Nr.56, datë 3.2.2010**

**PËR KRIJIMIN E INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Inspektoratit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar (IKAP), person juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. IKAP-ja e ka selinë në Tiranë.
2. IKAP-ja është institucion i posaçëm i inspektimit, monitorimit, vlerësimit e këshillimit të cilësisë së arsimit parauniversitar dhe funksionimit të strukturave menaxhuese të tij (shkolla, drejtoria arsimore rajonale, zyra arsimore).
3. Kryeinspektori emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
4. Inspektorët emërohen nga kryeinspektori, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
5. Marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
6. IKAP-ja kryen këto funksione kryesore:
  - a) Inspekton, monitoron, vlerëson, këshillon dhe nxjerr përfundime mbi zhvillimin e procesit mësimor-edukativ, menaxhimin e bazës materialo-didaktike të shkollës;
  - b) Verifikon pajtueshmërinë e veprimtarisë të institucioneve arsimore me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, udhëzimet e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për DAR/ZA-t dhe për institucionet shkollë;
  - c) Monitoron problemet që paraqiten në shkollë me tekstin shkollor;
  - ç) Monitoron zbatimin e dispozitave normative të shkollës, kodit të etikës së mësuesit, punën e bordit të shkollës, si dhe të organeve demokratike të saj;
  - d) Inspekton zbatimin e rregulloreve të maturës shtetërore dhe provimeve të liritimit.
7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.10, datë 17.2.2010, faqe 333*

**VENDIM**  
**Nr.66, datë 3.2.2010**

**PËR RIORGANIZIMIN E DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE DHE ZYRAVE**  
**ARSIMORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore.
2. Drejtoritë arsimore rajonale të funksionojnë në çdo qark. Ato janë person juridik, publik e buxhetor, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
3. Drejtoria Arsimore Rajonale është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së shërbimit arsimor në nivel qarku dhe kryen këto funksione kryesore:
  - a) Mbështet ministrinë në hartimin e politikave të zhvillimit në fushën e arsimit parauniversitar, në nivel qarku, duke marrë parasysh veçoritë demografike, të terrenit, të zhvillimit ekonomik dhe të infrastrukturës vendore.
  - b) Garanton zbatimin me përpikmëri të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
  - c) Ndjek realizimin e politikave rajonale, në përputhje dhe në zbatim të strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit.
  - ç) Harton projekte me karakter vendor ose zbaton projekte me karakter kombëtar.
  - d) Ndjek me përparësi arsimin profesional, duke marrë të gjitha masat për shtrirjen e tij.
  - dh) Menaxhon dhe zhvillon burimet njerëzore për qarkun.
  - e) Zbaton kurrikulën dhe zhvillon elementet rajonale të saj.
  - ë) Organizon provimet e maturës shtetërore dhe provimet e lirit.
  - f) Ndjek përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tekstit shkollor në nivel qarku.
  - g) Zhvillon e mirëmban IT-në dhe bazën statistikore në shkollat e varësisë.
  - gj) Planifikon investimet e buxhetin, si dhe bën prokurime për qarkun.
  - h) Siguron asistencë juridike edhe për zyrat arsimore që ka në varësi.
  - i) Realizon vlerësimin real të cilësisë së shërbimit të ofruar.
  - j) Organizon dhe realizon trajnimin dhe kualifikimin e personelit mësimdhënës të shkollave që ka në varësi.
4. Zyrat arsimore të funksionojnë në çdo nënprefekturë. Ato janë në varësi të drejtorive arsimore rajonale.
5. Zyra arsimore ka këto funksione kryesore:
  - a) Bashkëpunon me drejtorinë arsimore rajonale, nga e cila varet për politikat e personelit, të buxhetit dhe të investimeve.
  - b) Ndjek kualifikimin e mësuesve, duke bashkëpunuar me institucionet që e ofrojnë këtë shërbim.
  - c) Përgjigjet për cilësinë e shërbimit të ofruar.
  - ç) Organizon provimet e maturës shtetërore dhe provimet e lirit.
  - d) Zhvillon e mirëmban IT-në dhe bazën statistikore në shkollat e varësisë.
  - dh) Menaxhon burimet financiare dhe shpenzimet për mjete didaktike.
  - e) Ndjek përzgjedhjen dhe shpërndarjen e tekstit shkollor.
  - ë) Ndjek me përparësi problemet e braktisjes shkollore dhe rritjen e numrit të nxënësve në arsimin profesional.

6. Për qarkun e Tiranës të ketë dy drejtori arsimore rajonale, nga të cilat, DAR-i Tiranë të mbulojë qytetin e Tiranës, dhe DAR-i qarku Tiranë, të mbulojë fshatrat e Tiranës dhe Kavajën e fshatrat e saj.

7. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton rregulloret e brendshme të funksionimit të drejtorive arsimore rajonale dhe të zyrave arsimore.

8. Drejtori i drejtorisë arsimore rajonale emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit ose të ministrit”.

9. Drejtuesi i zyrës arsimore emërohet ose largohet nga detyra nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale, që ka në varësi zyrën, ndërsa nëpunësit (përgjegjës sektori, specialistë) të këtyre drejtorive e zyrave, nga drejtuesit përkatës.

10. Për punonjësit, që, pas riorganizimit të drejtorive arsimore rajonale mbeten pa vend pune, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

13. Vendimi nr.707, datë 16.10.2003 “Për riorganizimin e drejtorive arsimore të rretheve në drejtori arsimore rajonale dhe në zyra arsimore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, datë 20.2.2010, faqe 394*

**VENDIM**  
**Nr.67, datë 10.2.2010**

**PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT (IZHA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA), si institucion publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e Institutit të Kurrikulave dhe Trajnimit (IKT).

2. Misioni i IZHA-së është që t’u ofrojë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve arsimore të të gjitha niveleve ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, të mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-shkencore studimore dhe praktikës së arsimit.

3. Instituti i Zhvillimit të Arsimit ka për detyrë:

a) t’u ofrojë ekspertizë strukturave politikëpërbërëse dhe vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit;

b) të zhvillojë punë kërkimore-studimore dhe të ofrojë ekspertizë e këshillim për institucionet arsimore të të gjitha niveleve, në fushat e përmbajtjes kurrikulare, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimit në tërësi;

- c) të mbështesë MASH-in në hartimin e studimeve/analizave periodike, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;
- ç) të ofrojë këshillim për nxënësit dhe qytetarët në fushën e arsimit të të gjitha niveleve;
- d) të zhvillojë metodologji për sigurimin e cilësisë e vlerësimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe programet e tyre mësimore;
- dh) të zhvillojë programe dhe standarde për kualifikimin e mësuesve, profesoratis dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore;
- e) të zhvillojë metodologji dhe standarde për tekstet mësimore;
- ë) të zhvillojë veprimtari informative për institucionet, nxënësit, studentët, punëdhënësit dhe punëmarrësit;
- f) të kryejë edhe detyra të tjera, të ngarkuara nga MASH-i dhe qeveria, brenda misionit të tij.

5. Statuti dhe rregullorja e funksionimit të IZHA-së miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Drejtuesi i IZHA-së emërohet, lirohet a shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirim ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të IZHA-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

8. Numri i punonjësve të IZHA-së të jetë i përfshirë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

9. Për punonjësit, që, pas riorganizimit, humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

10. IZHA-ja është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

11. Buxheti i planifikuar për Institutin e Kurrikulave dhe Trajnimit, si dhe të gjitha asetet e tij i kalojnë IZHA-së.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

13. Vendimi nr.418, datë 11.7.2007 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Institutit të Kurrikulave dhe të Trajnimit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, datë 19.3.2010, faqe 731*

**VENDIM**  
**Nr.107, datë 10.2.2010**

**PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE**  
**TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton dhe certifikon tekstet shkollore të arsimit parauniversitar, të cilat konkurrojnë, në barazi të plotë, në përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat e konkurrimit e të përzgjedhjes përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Procesi i botimit, shtypjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet, për miratim, në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Shpenzimet për tekstet shkollore të dërguara në shkollë ose DAR/ZA, për të konkurruar në përzgjedhjen e tyre, përballohen nga shtëpia botuese.

3. Tekstet shkollore shpërndahen/shiten në mjediset shkollore. Drejtoritë e shkollave ofrojnë një ose dy mjedise shkollore, që përdoren nga të gjitha shtëpitë botuese, që lëvrojnë tekste në shkollën në fjalë.

4. Çmimi i shitjes është ai i vendosur në kopertinën e tekstit shkollor të certifikuar. Çmimet e teksteve shkollore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, indeksohen çdo vit, në përputhje me rritjen e inflacionit, të publikuar nga INSTAT.

5. Tekstet duhet të jenë të pajisura me pullën me hologramë, të certifikimit, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Pulla me hologramë u shitet botuesve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kundrejt pagesës. Tekstet, që tregtohen pa këtë pullë, i nënshtrohen procesit të konfiskimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore, janë si më poshtë vijon:

6.1 për nxënësit në arsimin parauniversitar që:

a) gëzojnë statusin ligjor të jetimit;

b) vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit;

c) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

ç) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

d) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura.

Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në formën e “Transferts tek individët”, në masën 100 për qind të tij.

6.2 Për nxënësit në arsimin 9-vjeçar, që vijnë nga familje ku kryefamiljari është i punësuar në institucionet publike buxhetore dhe jobuxhetore të pushtetit qendror apo vendor, si dhe në shoqëritë me kapital shtetëror, me pagë mujore bruto deri 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat, çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet nga buxheti i vetë institucionit apo shoqërisë, në masën 50 për qind të tij.

6.3 Këshilli i Ministrave u rekomandon të gjithë punëdhënësve privatë të mbështesin financiarisht kompensimin e teksteve shkollore për të gjithë punëmarrësit e tyre, që kanë fëmijë në arsimin parauniversitar dhe që përfitojnë pagë mesatare mujore deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj. Kjo pagesë njihet si shpenzim i veprimtarisë për efekte fiskale.

6.4 Për tekstet shkollore të nxënësve të pakicave kombëtare, nga klasa I deri IX, çmimi i blerjes do të mbulohet në masën 100 për qind me fondet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Shitja e teksteve shkollore bëhet përkundrejt faturave. Për kategoritë e nxënësve, që përfitojnë sipas pikës 6 të këtij vendimi, pagesa bëhet nëpërmjet llogarive buxhetore të DARZA-ve ose të vetë shkollës, kur ka llogari të tillë, me fondet e miratuara si “Transfertë tek individët” në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

8. Procedurat e përdorimit dhe të shpërndarjes së fondeve buxhetore, për blerjen e teksteve shkollore, si dhe mënyra e pagesës për kategorinë e nxënësve përfitues, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.



10. Vendimi nr.260, datë 18.4.2007 i Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore, që janë në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.25, datw 19.3.2010, faqe 767*

**UDHËZIM**  
**Nr.41, datë 9.11.2006**

**PËR ZGJEDHJEN E LITERATURËS NDIHMËSE, JOARTISTIKE, NË SHKOLLAT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, të nenit 52 pika 1 dhe nenit 53 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, ndryshuar me ligjin nr.8387, datë 30.7.1998,

**UDHËZOJ:**

1. T’u rekomandohet nxënësve të shkollave/kopshteve të arsimit parauniversitar literaturë ndihmëse, në vijim të urdhrit nr.76, datë 13.3.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e bordit të rekomandimit të literaturës artistike, studimore e publicistike”.

2. Për realizimin e synimeve të programeve lëndore që zhvillohen në kopshtet e fëmijëve dhe shkollat e arsimit parauniversitar, përveç teksteve mësimore, të përdoret literaturë ndihmëse, e cila nuk është e detyrueshme për procesin mësimor.

3. Literaturë ndihmëse për shkollat e arsimit parauniversitar të konsiderohet ajo literaturë që nuk është në katalogun e teksteve shkollore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Literatura ndihmëse të blihet në libraritë ose dyqane të tjera, që e marrin përsipër këtë shërbim.

5. Mësuesit lëndorë dhe edukatorët e kopshteve të këshillojnë nxënësit/fëmijët parashkollorë dhe prindërit e tyre për blerjen e literaturës ndihmëse.

6. Literatura ndihmëse t’u rekomandohet të gjithë nxënësve të klasës ose një pjese të saj, p.sh. nxënësve me arritje të larta lëndore ose arritje të ulëta.

7. Nxënësi/fëmija parashkollor nuk duhet të detyrohet që ta sjellë literaturën ndihmëse në klasë.

8. Për një lëndë të rekomandohen jo më shumë se dy botime ndihmëse në vit, me përjashtim të revistave.

9. Procedurat e përzgjedhjes së literaturës ndihmëse, që u rekomandohet nxënësve/fëmijëve parashkollorë përshkruhen në aneksin e këtij udhëzimi.

10. Të mos jenë autorë të literaturës ndihmëse:

a) Punonjësit e MASH-it;

b) Punonjësit e DAR/ZA-ve për shkollat nën juridiksionin e tyre.

11 Në një shkollë apo kopsht fëmijësh të mos rekomandohet literatura ndihmëse me autor punonjës të asaj shkolle/kopshti.

12. Në këtë udhëzim nuk përfshihet përzgjedhja e literaturës artistike, studimore e publicistike për lëndën e letërsisë dhe gjuhës shqipe, e cila bëhet nga lista rekomanduese e librave artistikë, studimorë e publicistikë, që MASH ka dërguar për këtë qëllim në DAR/ZA.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi DAR/ZA dhe drejtoritë e shkollave.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.128, datë 8.12.2006, faqe 128*

#### ANEKS

#### I UDHËZIMIT NR.41, DATË 9.11.2006 TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS “PËR ZGJEDHJEN E LITERATURËS NDIHMËSE, JOARTISTIKE, NË SHKOLLAT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”

1. Autorët ose botuesit e literaturës ndihmëse të dërgojnë në fillimin e vitit shkollor ose në fillim të semestrit të dytë nga një kopje të literaturës ndihmëse në DAR/ZA ose në shkolla/kopshte fëmijësh (mundet edhe me të drejtë kthimi).

2. Drejtorët e shkollave/kopshteve të marrin nga një kopje të literaturës ndihmëse në DAR/ZA.

3. Komisionet lëndore të shqyrtojnë literaturën ndihmëse të ofruar. Në shkollat/kopshtet ku ka vetëm një mësues lëndor, procedura të realizohet nga ai mësues.

a) Komisioni të vendosë me shumicë votash dy, një ose asnjë libër ndihmës për lëndë/klasë (Me “shumicë votash” kuptojmë më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit lëndor.).

b) Nëse numri i votave është i barabartë, vendimi të merret sipas vendimit të mësuesit lëndor të klasës.

c) Vendimi t’i njoftohet me shkrim drejtorit.

d) Në njoftimin me shkrim të shkruhen emrat e mësuesve që kanë votuar “për” dhe “kundër”. Ky njoftim të firmoset nga kryetari i komisionit lëndor.

e) Drejtori i shkollës të afishojë listën me literaturën ndihmëse, të zgjedhur për çdo lëndë.

f) Drejtori i shkollës të ruajë për tre vjet procesverbalin dhe vendimin t’ua paraqesë eprorëve sa herë ata ta kërkojnë.

4. Drejtori të afishojë në sallën e këshillit të mësuesve këtë udhëzim bashkë me aneksin e tij, para se të nisë procesi i miratimit të literaturës ndihmëse.

#### UDHËZIM

**Nr.26, datë 7.9.2007**

#### **PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LEJES SË FUNKSIONIMIT PËR INSTITUCIONET ARSIMORE PRIVATE DHE INSTITUCIONET ARSIMORE PLOTËSUESE PRIVATE PARAUNIVERSITARE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

## KREU 1 KRITERET PËR DHËNIEN E LEJES

1. Subjekti që dëshiron të hapë një institucion arsimor privat parauniversitar, për marrjen e lejes së funksionimit duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kërkesën për llojin e institucionit arsimor për të cilin kërkon të pajiset me leje, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme, të cilat duhet të jenë të nënshkruara nga subjekti aplikant:

a) Formulari i autodeklarimit, i cili është i përbërë nga dy pjesë dhe është bashkëlidhur këtij udhëzimi:

Pjesa e parë përmban:

1. Deklaratën e subjektit mbi gjeneralitetet e tij;
2. Adresën e saktë të banimit;
3. Numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit privat;
4. Numrin dhe datën e lejes higjieno-sanitare;
5. Numrin dhe datën e vërtetimit nga njësia e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit;
6. Datën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe kohëzgjatjen e saj (jo më pak se pesë vjet), dhe/ose datën e dokumentit të pronësisë, të nxjerrë jo më herët se tre muaj nga data e depozitimit të kërkesës;
7. Datën e nxjerrjes dhe kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit dhe lejes së punës për shtetasit e huaj;
8. Deklaratën e subjektit që nuk është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë, proces gjyqësor, proces hetimi;
9. Deklaratën e subjektit që ka të ardhura të mjaftueshme për të ushtruar aktivitetin që kërkon të licencohet;
10. Numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT).

Pjesa e dytë përmban deklaratën e subjektit se njëh dhe zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të fushës përkatëse, si dhe mban përgjegjësi të plotë se i gjithë informacioni në formularin e plotësuar është i vërtetë.

b) Dokumentacioni teknik i mëposhtëm:

1. Deklaratë për emërtimin e institucionit, numrin e telefonit, nivelin e arsimit, numrin e grupeve apo klasave me të cilat do të punohet, numrin e fëmijëve/nxënësve për grup/klasë, titullin e dokumentit, që lëshohet në përfundim të çdo viti shkollor apo kursi;
  2. Deklaratë për shërbimet që ofron dhe tarifat për frekuentimin në institucion;
  3. Planin mësimor dhe programet lëndore që do të zbatojë institucioni;
  4. Lista e teksteve që do të përdoren:
    - në lëndët mësimore të detyruara sipas Altertektit;
    - në lëndët mësimore shtesë me zgjedhje apo fakultative.
  5. Lista e plotë e stafit drejtues, mësimdhënës dhe ndihmës, përfshirë edhe administratorin, të shoqëruar me deklaratën e subjektit për arsimin përkatës të stafit, si dhe për ngarkesën mësimore të tij;
  6. Deklaratë për inventarin faktik të bazës materiale dhe asaj didaktike që disponohet dhe që është në funksion të arsimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore, duke provuar se mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të realizuar kërkesat e planit mësimor dhe të programeve lëndore.
2. Në rast se vërehen mangësi apo deklaram të rremë lidhur me kërkesat e pikës 1 të udhëzimit, subjekti njoftohet për ndërprerjen e procedurës së filluar për licencim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2.1 Në rast deklarimi të rremë, subjekti aplikues i nënshtrohet masave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Kontrolli lidhur me vërtetësinë e informacionit të deklaruar në formularin e autodeklarimit ndërmerret nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

2.2 Vetëm pasi të plotësohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar në pikën 1 të udhëzimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës vazhdon procedurat me verifikimin e gjendjes fizike të objektit, në përputhje me standardet e përcaktuara për institucionet arsimore. Standardet normative për objektet që do të funksionojnë si institucione arsimore janë:

a) Klasë e zakonisht konsiderohet ai mjedis mësimor që ka një normativ sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m<sup>2</sup>/nxënës;

b) Nyjet hidrosanitare përfshijnë 1 boks për 40 djem, 1 boks për 30 vajza, si dhe 1 boks për administratën;

c) Për edukimin fizik subjekti që kërkon leje, të ketë në dispozicion një palestër (për shkollat nën 100 nxënës shfrytëzohet një klasë në katin përdhe me përmasa 60 m<sup>2</sup>) dhe një kënd sportiv, jo më të vogël se 100 m<sup>2</sup>;

d) Objektet arsimore që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme shkollimi (kopshte, shkollë 9-vjeçare dhe shkollë e mesme) të jenë ambiente që nuk komunikojnë me njëra-tjetrën;

e) Lidhur me normativën e ndriçimit natyral duhet që sipërfaqja e dritareve të mbulojë minimalisht 15% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohen të vendosen në murin ku është vendosur dërrasa e zezë;

f) Për shkollat e arsimit bazë (sistemi 9-vjeçar) kërkojnë minimumi 9 dhoma mësimore për ciklin e ulët dhe të lartë, dhe dy dhoma mësuesish. Për shkollat e ciklit të ulët (5-vjeçar) kërkojnë minimalisht 5 dhoma mësimore dhe një dhomë mësuesish. Për shkollat e mesme të përgjithshme/profesionale janë të domosdoshme 4-5 dhoma mësimore. Për kopshtet të ketë minimalisht 3 dhoma mësimore;

g) Objektet arsimore me mbi 200 nxënës duhet të pajisen me dalje dhe shkallë emergjence;

h) Objektet arsimore duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në to;

i) Objektet arsimore duhet të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit;

j) Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për nxënësit duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin e tyre nuk duhet të kenë elemente përbërëse të dëmshme për shëndetin e nxënësve. Këto materiale duhet të sigurojnë akustikë të mirë në mjedisin e mësimi dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave dhe luhatjeve të temperaturës;

k) Ndërtimi i objekteve arsimore të jetë larg zonave industriale, varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara;

l) Objektet arsimore të jenë siguruar me gjenerator dhe depozitë uji;

m) Objektet arsimore të jenë me sistem ngrohjeje.

2.3 Në rastet kur objektet e inspektuara nuk plotësojnë kërkesat dhe standardet e vendosura për realizimin e plotë të procesit mësimor, atëherë Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndërpret procedurën e filluar për licencim, duke njoftuar subjektin përkatës.

2.4 Në rastet kur objektet e inspektuara plotësojnë kërkesat dhe standardet e përcaktuara, Ministria e Arsimit dhe Shkencës vazhdon procedurën e filluar për licencim.

3. Për çdo nivel shkollimi (arsim parashkollor, arsim i detyruar dhe arsim i mesëm), kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë të veçanta.

4. Në rast mosushtrimi gjatë një viti shkollor nga momenti i marrjes së licencës, të aktivitetit për të cilin është licencuar, subjekti humbet automatikisht të drejtën për ta ushtruar këtë aktivitet. Për të rifilluar aktivitetin, ai duhet të paraqesë kërkesë me dokumentacionin shoqërues nga fillimi.

5. Të drejtën e pezullimit të përkohshëm, deri në 1 vit kalendarik të institucionit arsimor privat e ka Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me kërkesë të vetë subjektit ose me propozim të Drejtorisë së Inspektimit, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore, në rast shkelje të kritereve të përcaktuara në dokumentacionin përkatës ligjor e nënligjor.

5.1 Në rast pezullimi të përkohshëm të veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar, sistemimi i nxënësve do të bëhet në bazë të nenit 48 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar.

6. Në rast mbyllje të aktivitetit të institucionit arsimor privat parauniversitar, sistemimi i nxënësve do të bëhet në bazë të nenit 48 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar.

## KREU II TARIFAT E SHËRBIMIT

Institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare licencohen përkundrejt një tarife të përbërë si më poshtë:

1. Pagesa për llogari të MASH-it të shumës 5000 (pesë mijë) lekë për aplikim. Kjo pagesë është e pakthyeshme dhe përbën kusht refuzues të kërkesës në rast të kundërt.

2. Tarifa për çdo leje të dhënë, si më poshtë:

a) Për kopshtet 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

b) Për shkollat e ciklit të ulët fillor 40 000 (dyzet mijë) lekë;

c) Për shkollat e ciklit të lartë 9-vjeçar 40 000 (dyzet mijë) lekë;

d) Për shkollat 9-vjeçare 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

e) Për shkollat e mesme të përgjithshme 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë;

f) Për shkollat e mesme teknike-profesionale e social-kulturore 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë;

g) Për kurset plotësuese (IAPPrP) 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

## KREU III DETYRIMET E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR DHE INSTITUCIONIT ARSIMOR PLOTËSUES PRIVAT PARAUNIVERSITAR PËRKUNDREJT MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS

1. Një institucion arsimor privat parauniversitar apo institucion arsimor plotësues privat parauniversitar, pas fillimit të funksionimit të saj duhet:

a) Të paraqesë: pranë DAR/ZA numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve që do të fillojnë dhe mbarojnë vitin shkollor, sipas statistikave tip të miratuara nga INSTAT-i; planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të përdorë institucioni në fillim të çdo viti shkollor; certifikatën e regjistrimit në organin tatimor; listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor (për institucionin arsimor privat parauniversitar);

b) Të miratojë: çdo devijim apo ndryshim në planin mësimor, programet lëndore apo tekstet që do të përdorë institucioni; çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë sipas rastit; çdo ndryshim që ai mund të pësojë në vendndodhje, vendim gjykate, administrator etj.

2. Një institucion arsimor privat parauniversitar apo institucion arsimor plotësues privat parauniversitar duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacionin përkatës me ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, statistika të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) Regjistra të veçantë dhe të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat parauniversitar), planet mësimore dhe programet lëndore të zbatuara çdo vit shkollor;

c) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

d) Kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

e) Kontratat e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

Materialet duhet t'u vihen në dispozicion organeve kontrolluese kompetente.

3. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e këtyre informacioneve ndaj organeve kontrolluese kompetente, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësit, në çdo rast dënohen me gjobë, siç është parashikuar në ligj ose me heqje të lejes së dhënë.

#### KREU IV

##### MIRATIMI I NDRYSHIMEVE NË DOKUMENTACIONIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE PARAUNIVERSITARE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE PLOTËSUESE PRIVATE PARAUNIVERSITARE

1. Ndryshimet në planin mësimor, programet lëndore apo tekstet që do të përdorë institucioni arsimor privat i licencuar, çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë sipas rastit; si dhe çdo ndryshim tjetër që lidhet me anën kurrikulare të institucionit shqyrtohet dhe miratohet nga Drejtoria e Kurrikulës.

2. Ndryshimet në vendndodhje dhe në infrastrukturën e godinës që mund të pësojë institucioni arsimor privat i licencuar, shqyrtohen dhe miratohen nga Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, sektori i investimeve.

3. Ndryshimet që institucioni arsimor privat i licencuar mund të pësojë në vendim gjyqate, administrator etj., shqyrtohen dhe miratohen nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

#### KREU V

##### DISPOZITAT E FUNDIT

1. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.23, datë 18.10.2005 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare”, shfuqizohet.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Kurrikulës, Drejtoria e Inspektimit, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.131, datë 3.10.2007, faqe 3643*

Datë \_\_\_\_\_

## AUTODEKLARIM

Drejtuar: Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës

Pjesa e parë

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ i datëlindjes \_\_\_\_\_ deklaroj që jam banues \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, adresë \_\_\_\_\_ me seli \_\_\_\_\_ tel \_\_\_\_\_ cel \_\_\_\_\_ dhe me dokument identifikimi/nr. i pasaportës \_\_\_\_\_.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Jam i regjistruar me vendim gjykate si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit privat, me nr....., datë.....;
2. Kam vërtetim pronësie nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr....., datë...../ kontratë qiramarrje me pronarin e godinës nr....., datë....., kohëzgjatje.....;
3. Kam leje higjieno-sanitare nga Inspektorati Sanitar Shtetëror nr....., datë.....; vërtetim nga njësia e pushtetit vendor....., për mbrojtjen kundër zjarrit nr....., datë.....;
4. Për shtetasit e huaj leja e qëndrimit në Shqipëri nr....., datë...../ leja e punës nr....., datë.....;
5. Disponoj të ardhura të mjaftueshme për të ushtruar aktivitetin për të cilin kërkoj të licencohem;
6. Nuk jam në proces gjykimi, hetimi apo të jem i dënuar në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin;
7. Nuk kam asnjë detyrim financiar ndaj asnjë institucioni shtetëror/NIPT nr..... datë..... .

Pjesa e dytë

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

Njoh legjislacionin në fuqi në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.

Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Gjithashtu deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkëlidhur autodeklarimit tim janë edhe të gjitha dokumentet e tjera teknike, sipas legjislacionit në fuqi.

Emër, mbiemër

Firmë

## UDHËZIM

Nr.39, datë 16.10.2007

### PËR SHPËRNDARJEN E FORMULARËVE A2/1 NË DREJTORITË ARSIMORE RAJONALE DHE ZYRAT ARSIMORE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, i ndryshuar,

## UDHËZOJ:

1. Kuotat e mbetura të porealizuara si rezultat i regjistrimit paraprak dhe përfundimtar në universitetet publike do të plotësohen nga studentët kandidatë, të cilët:

- a) nuk janë fitues në asnjë degë sipas formularit A2;
- b) nuk janë regjistruar në asnjë fazë regjistrimi në universitetet publike;
- c) kanë kryer regjistrimin paraprak, por jo atë përfundimtar.

2. Studentët kandidatë të tërheqin formularët A2/1 pranë DAR/ZA-ve përkatëse, duke filluar nga data 17 tetor 2007.

3. Udhëzimet për plotësimin e formularit A2/1 do të jepen, më datë 16 tetor 2007 nga Qendra e Përpunimit Informatik (QPI).

4. Formulari A2/1 të plotësohet nga studentët kandidatë nga data 17-21 tetor 2007 dhe të dorëzohet pranë DAR/ZA-ve deri më datë 22 tetor 2007.

5. Formularët A2/1 të plotësuar nga studentët kandidatë, si dhe formularët e paplotësuar dorëzohen në QPI, më datë 23 tetor 2007 nga DAR/ZA-të.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Drejtorja e Kurrikulës në MASH, Qendra e Përpunimit Informatik, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.140, datë 24.10.2007, faqe 3893*

## UDHËZIM

**Nr.2, datë 10.1.2008**

### **PËR VJETËRSINË E PUNËS NË ARSIM**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 124 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative

## UDHËZOJ:

1. Vjetërsi pune në arsim njihet periudha e punës si mësimdhënës në arsimin e lartë, atë parauniversitar, si edukatore në arsimin parashkollor dhe instruktor në qendrat kulturore të fëmijëve.

2. Njihet vjetërsi në arsim periudha e punës në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Institutin e Kualifikimit dhe Trajnimit (IKT), Agjencinë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve (AVA), Agjencinë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional (AKAFP), Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) dhe Zyrën Arsimore (ZA), për punonjësit me diplomë mësuesie, që kanë në përshkrimin e tyre të punës përgjegjësi për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të procesit mësimor.

3. Udhëzimi i Ministrit të Arsimit nr.16, datë 3.10.1991 “Mbi vjetërsinë në arsim për efekt atestimi për të fituar shkallët e kualifikimit në arsimin parauniversitar për punonjësit që kanë vjetërsinë e duhur në arsim” dhe udhëzimet e tjera për vjetërsinë e punës në arsim, që bien në kundërshtim me këtë udhëzim, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorja e Menaxhimit të Përditshëm në MASH për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, datë 30.1.2008, faqe 200*



**UDHËZIM**  
**Nr.3, datë 10.1.2008**

**PËR ORGANIZIMIN E KUALIFIKIMIT PËR PUNONJËSIT QË KANË VJETËRSINË E DUHUR NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR PËR VITIN MËSIMOR 2007- 2008**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 106 dhe 107 të Kodit të Procedurave Administrative dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.537, datë 26.9.1994 “Për shtesë mbi pagën bazë për kualifikim të mësuesve dhe shtesë për veprimtari të inspektorëve të arsimit”,

**UDHËZOJ:**

1. Në të gjitha drejtoritë arsimore rajonale të zhvillohen provimet me shkrim më datën 29.3.2008 për shkallët e kualifikimit për punonjësit që plotësojnë vjetërsinë në sistemin arsimor parauniversitar, për vitin mësimor 2007-2008.

2. Kualifikimi i punonjësve që kanë vjetërsinë e duhur në arsimin parauniversitar për vitin 2008 të bëhet nëpërmjet provimeve dhe portofolit personal të zhvillimit profesional.

3. Në këto provime të përfshihen punonjësit (në vazhdim “kandidatët”) e sistemit të arsimit publik dhe jopublik:

a) Me diplomë mësuesie, me emërim definitiv, me kontratë të përkohshme ose në pritmëri;

b) Pa diplomë mësuesie, por me arsim të lartë, të cilët japin lëndët profesionale, në përputhje me profilin, në shkollat e mesme profesionale ose të përgjithshme dhe kanë kontratë individuale pune;

c) Pa diplomë mësuesie, që kanë kryer shkollën e mesme artistike ose Akademinë e Arteve dhe japin lëndët e edukimit muzikor ose të edukimit figurativ.

4. Provimeve të kualifikimit u nënshtrohen vetëm mësuesit të cilët deri më 31 dhjetor 2007 plotësojnë vjetërsinë e mëposhtme të punës në arsim:

a) nga 5 deri në 9 vjet, për shkallën e tretë të kualifikimit;

b) nga 10 deri në 19 vjet, për shkallën e dytë të kualifikimit, të paktën 5 vjet pas marrjes së shkallës së tretë;

c) nga 20 e më shumë vjet, për shkallën e parë të kualifikimit, të paktën 10 vjet pas marrjes së shkallës së dytë.

5. Të gjithë punonjësit mësimorë, të përmendur në pikën 3 të këtij udhëzimi, që kanë mospërputhje midis vjetërsisë së punës në arsim dhe shkallës së kualifikimit:

a) të kualifikohen për shkallën përkatëse më të ulët;

b) të kenë të drejtë që në vitet e ardhshme shkollë të kualifikohen për shkallën që u takon sipas vjetërsisë së punës në arsim.

6. Nëse një kandidat nuk merr pjesë në kualifikim për shkak rastësor ose nuk kualifikohet, ka të drejtë të marrë pjesë në provimin e vitit pasardhës.

7. Kërkesa për kandidatët dhe DAR/ZA:

a) Kandidatët që kanë vjetërsinë përkatëse në sistemin arsimor parauniversitar, brenda datës 20 janar 2008, të plotësojnë formularët e aplikimit për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit.

b) Listat përfundimtare të kandidatëve për provimet e kualifikimit, mbi bazën e kriterëve të mësipërme, i harton DAR/ZA brenda datës 31 janar 2008.

c) Listat të shpallen publikisht dhe të qëndrojnë të afishuara në mjediset e DAR/ZA gjatë periudhës 1-10 shkurt 2008.

d) DAR/ZA harton listat përfundimtare, të cilat i dërgon në MASH dhe IKT brenda datës 20 shkurt 2008. Pas kësaj date nuk bëhen ndryshime në listën e kandidatëve.

8. Provimet të realizohen mbi bazën e programeve të kualifikimit, të përgatitura nga Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit (IKT), për të gjitha fushat e përcaktuara në këtë udhëzim. Programet t'u vihen në shërbim kandidatëve brenda periudhës 25 janar deri në 5 shkurt 2008.

9. Provimi i kualifikimit për të gjithë kandidatët të zhvillohet me shkrim në të njëjtën datë dhe në të njëjtën orë, në mjediset e DAR, të planifikuara në bashkëpunim me IKT.

10. Në provimin e kualifikimit kandidatët të vlerësohen për:

- a) Zotërimin e programeve lëndore;
- b) Zotërimin e përmbajtjes shkencore të lëndës shkollore;
- c) Zotërimin e trajtimit metodik të lëndës.

11. Kandidatet që janë edukatore në kopsht i nënshtrohen provimit për të gjitha programet e arsimit parashkollor.

12. Kandidati që është mësues i arsimit fillor, i nënshtrohet provimit për të gjitha programet lëndore të këtij cikli.

13. Nëse kandidati, mësues në arsimin e mesëm të ulët ose në arsimin e mesëm të lartë, jep më shumë se një lëndë brenda profilit, të përzgjedhë për provimin e kualifikimit njëren prej tyre.

Provimi të mbulojë lëndën e përzgjedhur për të gjitha klasat e ciklit të mesëm të ulët ose të ciklit të mesëm të lartë.

14. Ngarkohet IKT me:

- a) Hartimin e testeve të provimeve me shkrim, dërgimin dhe marrjen e tyre në çdo DAR;
- b) Hartimin e udhëzimeve për komisionet e provimeve;
- c) Monitorimin e provimeve;
- ç) Vlerësimin e testeve të kandidatëve.

15. IKT ngarkohet për ngritjen, trajnimin dhe funksionimin e rrjetit të administratorëve. Administratorët të punojnë në qarkun ku zhvillohet provimi.

16. Çdo kandidat që merr pjesë në kualifikimin 2008 përgatit dhe dorëzon në DAR/ZA portofolin e zhvillimit të tij profesional, i cili shqyrtohet nga IKT për efekt vlerësimi përfundimtar të kandidatit.

17. Portofoli i zhvillimit profesional përmban:

- a) Curriculum Vitae (me fotografi);
- b) Planin mësimor vjetor (për një lëndë dhe për një klasë të caktuar);
- c) Objektivat e arritjeve të nxënësve për një kapitull, në tri nivele (në një lëndë dhe klasë të caktuar);
- d) Modele testesh të hartuara prej tij;
- e) Planifikimin e kurrikulës së lirë (për një lëndë dhe për një klasë të caktuar);
- f) Vlerësimin për punën e tij (nga vlerësues të brendshëm dhe të jashtëm).

18. Mbështetur në rezultatet e provimit dhe të portofolit të zhvillimit profesional, IKT t'i pajisë me certifikatë kandidatët fitues.

19. Drejtorja e Menaxhimit të Përditshëm në MASH ta përgatisë dhe ta dërgojë në DAR/ZA shkresën për fillimin e shtesës së pagës për efekt atestimi.

20. Të pajisen me certifikatën e shkallës përkatëse të kualifikimit, pa marrë pjesë në veprimtaritë kualifikuese, punonjësit të cilët:

- a) kanë kualifikimin "Master" ose gradën "Doktor i shkencave".
- b) janë punonjës të MASH, IKT, AVA, AKAFP, DAR dhe ZA me diplomë mësuesie dhe kanë në përshkrimin e tyre të punës përgjegjësi për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të procesit mësimor.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Menaxhimit të Përditshëm në MASH, Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit, si dhe DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, datë 30.1.2008, faqe 200*

**UDHËZIM**  
**Nr.22, datë 29.5.2008**

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË PLANIFIKUARA PËR TRANSPORTIN E MËSUESVE DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË E PUNOJNË LARG VENDBANIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.486, datë 8.4.2008 “Për përdorimin e fondeve buxhetore për transportin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit të tyre”,

**UDHËZOJ:**

1. Transporti i mësuesve që punojnë larg vendbanimit të tyre në distancë mbi 4 km dhe kthehen brenda ditës, si dhe transporti i nxënësve të arsimit të detyrueshëm që ndjekin shkollën larg vendbanimit të tyre në distancë mbi 2 km, mbulohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit të planifikuara për çdo drejtori arsimore rajonale/zyrë arsimore (DAR/ZA).

2. Shpenzimet dhe fondi limit për këtë shërbim prokurohen në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu II “Rregulla të përgjithshme të prokurimit”, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, nga çdo DAR/ZA për vitin kalendarik.

3. Për llogaritjen e fondit limit për këtë shërbim, nga çdo autoritet kontraktor ngrihet grupi i punës, i cili përcakton fondin limit për realizimin e këtij shërbimi, duke u mbështetur në të dhënat e mëposhtme:

- a) numri i mësuesve dhe nxënësve që udhëtojnë;
- b) numri i ditëve mësimore në javë;
- c) numri i javëve mësimore;
- d) çmimi mesatar i biletës ditore (vajtje-ardhje).

4. Për çmimin mesatar të biletës ditore grupi i punës mbështet në të dhënat e mëposhtme:

- a) çmimet mesatare të tregut,
- b) treguesit e botuar nga INSTAT, për indeksimin e çmimeve të shërbimit të transportit;
- c) çmimi mesatar i biletës për linjat interurbane, i miratur nga Ministria e Punëve Publike,

Transporteve dhe Telekomunikacionit.

5. Subjekti që merr përsipër kryerjen e këtij shërbimi, likujdohet çdo muaj për punën e kryer, në bazë të faturës tatimore, ku të ketë të përcaktuar numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin çdo muaj.

6. DAR/ZA çdo muaj kërkon nga drejtorët e shkollave paraqitjen e vërtetimit për numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin sipas linjave.

7. Në fund të çdo muaji, përpara pagimit të shërbimit, drejtori i DAR/ZA, përgjegjësi i burimeve njerëzore dhe specialisti i financës përpilojnë një aktrakordim, mbi numrin e mësuesve dhe të nxënësve, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga drejtoritë e shkollave dhe faturës së lëshuar nga subjekti që merr përsipër kryerjen e këtij shërbimi.

8. DAR/ZA në fillim të çdo viti kalendarik, përcaktojnë hartën e linjave dhe e miratojnë atë në këshillin e qarkut. Vendimi i këshillit të qarkut përmban distancën e linjave dhe kategorinë e rrugëve.

9. Për rastet e pamundësisë së zhvillimit të procedurës së prokurimit për ndonjë linjë të veçantë, pasi të jetë kryer e gjithë procedura e prokurimit, sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, DAR/ZA kryen pagesat për mësuesit dhe nxënësit, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga drejtorët e shkollave për numrin e mësuesve dhe të nxënësve që lëvizin

sipas linjave. DAR/ZA harton listëpagesat për mësuesit dhe nxënësit dhe kalon pagesën për mësuesit në numrin e llogarisë bankare dhe për nxënësit pranë zyrave të postës shqiptare.

10. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë DAR/ZA, në periudhën e planifikimit të numrit të mësuesve, në fillim të vitit shkollor kanë përgjegjësi për rritjen artificiale të lëvizjes së mësuesve, nga një njësi vendore në tjetrën.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Genc Pollo

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.93, datë 17.6.2008, faqe 4066*

**UDHËZIM**  
**Nr.25, datë 7.7.2008**

**PËR KRITERET PROFESIONALE DHE PROCEDURAT E KONKURSIT PËR  
ZGJEDHJEN E TREMBËDHJETË ANËTARËVE EKSPERTË TË KËSHILLIT  
KOMBËTAR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

*(Ndryshuar me udhëzim nr.28, datë 28.7.2008)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 54 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

I. Anëtarët ekspertë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të jenë figura të njohura për kontributin në fushën e arsimit dhe shkencës, të zotërojnë së paku Diplomë të Nivelit të Dytë dhe të Nivelit të Dytë të Integruar dhe të kenë njohje të mirë të përvojës ndërkombëtare në fushën e arsimit parauniversitar.

II. Këta anëtarë përzgjidhen me konkurrim publik, nga një komision i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

III. Komisioni përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

1. një përfaqësues i Këshillit të Ministrave;
2. një përfaqësues i MASH-it;
3. një përfaqësues i Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional.

IV. Kriteret profesionale të përzgjedhjes janë si më poshtë:

1. diploma;
2. titulli, grada shkencore;
3. kualifikimet pasuniversitare të certifikuara;
4. botimet (libra, monografi, artikuj) etj.;
5. punësimi.

V. Konkursi të bëhet më 25 shtator 2008, nëpërmjet dosjeve të dorëzuara brenda datës 20 shtator 2008.

VI. Komisioni i përzgjedhjes, pasi shqyrton plotësimin e kriterëve profesionale, rendit në një listë kandidatët sipas pikëve të fituara. Këshilli i Ministrave cakton në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, trembëdhjetë nga kandidatët e klasifikuar.

VII. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.113, datë 22.7.2008, faqe 5003*

*Udhëzim nr.28, datë 28.7.2008 botuar në Fletoren Zyrtare nr.133, datë 13.8.2008, faqe 5934*

**UDHËZIM**  
**Nr.22, datë 18.8.2009**

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE TË TRAJNIMIT TË PUNONJËSVE MËSIMORË NË  
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 14/3 të ligjit nr.7592, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, Ministri i Arsimit dhe Shkencës

**UDHËZON:**

1. Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit (IKT) të hartojë programin vjetor të trajnimeve, listën e moduleve të vitit 2009 për trajnimin e personelit të shkollave/kopshteve publike, e cila të miratohet nga MASH (Drejtoria e Kurrikulës dhe Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm).

2. DAR/ZA, mbështetur në programin vjetor të trajnimeve të miratuar nga MASH, të organizojnë trajnimet e personelit shkollor/parashkollor, këshillimin e mësuesve dhe shkëmbimin e përvojave në mes tyre.

3. Drejtoria e Planifikimit Buxhetor në MASH të detajojë për çdo DAR/ZA, sipas formulës, “Buxhet për mësues”, fondin e planifikuar për trajnimin e personelit të shkollave/kopshteve publike.

4. DAR/ZA të detajojë për çdo shkollë/kopsht fondin për trajnime, sipas formulës “Buxhet për mësues” dhe t’i njoftojë zyrtarisht ato për fondin që i takon për trajnimet e personelit të saj.

5. Secila shkollë, duke u bazuar në nevojat e saj për zhvillimin profesional dhe ofertat për trajnime, të paraqesë pranë DAR/ZA kërkesat e saj për trajnime.

6. DAR/ZA të hartojë listën përmbledhëse të kërkesave të shkollave për trajnime në nivel DAR/ZA dhe të shpallë kërkesën për trajnerë të certifikuar ose agjencitë trajnuese.

7. DAR/ZA, në zbatim të procedurave të prokurimit publik, duke marrë parasysh fondin vjetor që disponojnë, të realizojë të gjitha procedurat për të përzgjedhur ofertat trajnuese nga subjektet juridike, fizike, agjencitë trajnuese ose trajnerët e certifikuar/licencuar.

8. DAR/ZA të zbatojnë të gjitha procedurat për realizimin e kontratave të trajnimit me trajnerë të certifikuar ose me agjencitë trajnuese.

9. Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm në MASH koordinon veprimtarinë me DAR/ZA për programin vjetor të trajnimeve dhe certifikimin e të trajnuarve.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Parauniversitare, Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimit, drejtori dhe kryeinspektori i DAR/ZA kontrollojnë dhe raportojnë për realizimin e kontratave trajnuese, cilësinë e trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime të mësuesve të planifikuar nga shkollat dhe certifikimin e tyre.

11. Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm në MASH dhe DAR/ZA monitorojnë procesin e realizimit të planit të trajnimeve dhe raportojnë në Drejtorinë e Kurrikulës, Drejtorinë e Planifikimit Buxhetor në MASH, për numrin e personelit të trajnuar sipas klasave ose gruplëndëve, numrin e moduleve etj.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Parauniversitare harton dhe paraqet pranë Ministrit të Arsimit dhe Shkencës raportin përmbledhës të trajnimeve të zhvilluara gjatë vitit 2009.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Kurrikulës dhe Monitorim-Vlerësimit, Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, IKT dhe DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Fatos Beja

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9757*

**UDHËZIM**  
**Nr.32, datë 26.10.2009**

**PËR REGJISTRIMIN DHE VLERËSIMIN E NXËNËSVE QË KANË PËRFITUAR AZIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9098, datë 3.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Fëmijë të moshës 3-6-vjeç të personave të cilët janë azilantë në Republikën e Shqipërisë, regjistrohen në arsimin parashkollor mbi bazën e certifikatës së lindjes. Ngarkohet DAR/ZA të përcaktojë institucionet parashkollore për regjistrimin e këtyre fëmijëve.

2. Fëmijë të moshës 3-6-vjeç të personave të cilët janë azilantë në Republikën e Shqipërisë, por nuk zotërojnë certifikatën e lindjes, të regjistrohen në arsimin parashkollor sipas dëshmisë së prindërve dhe dokumentacionit që ai zotëron në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Ngarkohet DAR/ZA të përcaktojë institucionet parashkollore për regjistrimin e këtyre fëmijëve.

3. Nxënësi që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, për të vazhduar studimet në arsimin bazë ose të mesëm, të regjistrohet në bazë të dokumentit shkollor të shtetit nga vjen, të përkthyer e noterizuar dhe të sigluar në DAR/ZA sipas vendbanimit ku ai është vendosur. Nxënësi regjistrohet në:

a) klasën pasardhëse, kur vjen në fillim të vitit shkollor;

b) klasën përkatëse, kur vjen gjatë vitit shkollor.

4. Nxënësi i shkollës 9-vjeçare, që nuk provon me dokument shkollor të shtetit nga vjen vazhdimin apo përfundimin e një klase, provohet për shkallën e njohurive nga një komision i posaçëm që ngrihet në DAR/ZA. Komisioni harton procesverbalin përkatës të firmosur nga të gjithë anëtarët e tij. Mbi bazën e këtij procesverbali që depozitohet në DAR/ZA, drejtori i DAR/ZA lëshon vërtetimin për regjistrimin e nxënësit në klasën që miraton ky komision. Shkolla në të cilën regjistrohet nxënësi, mban në amzën e vet vërtetimin e mësipërm.

5. Nxënësi i cili ka kryer 8 vite shkollore, regjistrohet në klasën e 9-të me ose pa shkëputje nga puna sipas moshës që ka.

6. Për regjistrimin e tij, nxënësi paraqet pranë DAR/ZA dëftesë (dëftesat) origjinale të përkthyer dhe noterizuara. DAR/ZA bën konvertimin dhe ekuivalentimin e notave dhe siglon dëftesën e nxënësit. Drejtori i DAR/ZA përcakton shkollën ku do të vazhdojë studimet nxënësi që plotëson kushtet e mësipërme.

7. I huaji azilant, i cili provon me dokumente përfundimin e shkollës së mesme, ka të drejtë të konkurrojë për t'u regjistruar në institucionet e arsimit të lartë publik (IAL), sipas udhëzimeve përkatëse që harton MASH, për kriteret e ekuivalentimit dhe regjistrimit në IAL.

8. Shtetasit që nuk zotërojnë dokumentet e përfundimit të arsimit të mesëm, nuk mund të përfitojnë nga e drejta e arsimimit në IAL.

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave Parauniversitare dhe Drejtorja e Kurrikulës dhe Monitorim Vlerësimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9761*

**UDHËZIM**  
**Nr.34, datë 2.11.2009**

**PËR ORGANIZIMIN E VEPRIMTARIVE NË SHËRBIM TË NXËNËSVE NË ARSIMIN  
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 53 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Organizimi i veprimtarive në shërbim të nxënësve në arsimin parauniversitar, të jetë si më poshtë:

- a) Konsultime me talentet dhe nxënësit që kanë nevojë për ndihmë;
- b) Veprimtaritë kulturore, sportive;
- c) Rrethet lëndore.

2. Çdo mësues i sistemit arsimor parauniversitar të kryejë 1 (një) orë në ditë veprimtari, përveç orëve të planifikuara në orarin mësimor, sipas një grafiku të hartuar dhe të monitoruar nga drejtorja e shkollës.

3. Mësuesit që janë në marrëdhënie pune në sektorin publik nuk mund të kryejnë mësimet dhe kurse private.

4. DAR/ZA ndërmer masat e nevojshme për zhvillimin dhe monitorimin e veprimtarive në shkolla sipas një pasqyre të plotë të planit të veprimtarive dhe orarit të tyre për çdo shkollë.

5. Efektiviteti i veprimtarive është pjesë e vlerësimeve vjetore të punës së mësuesve dhe të drejtuesve të shkollave.

6. Shkolla përcakton nevojat mësimore të grupeve të nxënësve të saj dhe harton planin e veprimtarive sipas këtyre nevojave.

7. Plani i veprimtarive të jetë pjesë e orarit të mësimet të shkollës.

8. Drejtorja e shkollës monitoron realizimin dhe efektivitetin e veprimtarive dhe i analizon periodikisht në mbledhjet e këshillit të mësuesve.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave Parauniversitare, DAR/ZA dhe drejtoritë e shkollave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9768*

**UDHËZIM**  
**Nr.2, datë, 6.1.2010**

**PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS SË KLASËS X**

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Zgjidhjen e problemeve të dala si rezultat i zbatimit të kurrikulës së re të klasës X të gjimnazit, e cila përbëhet nga lëndë bërthamë (që janë lëndë të njëjta për të gjithë nxënësit e klasës X të gjimnazit) dhe lëndë me zgjedhje (që nuk janë lëndë të njëjta për të gjithë nxënësit e klasës X të gjimnazit), duke marrë masat e mëposhtme:

I. Plotësimin e dokumentacionit shkollor, në të cilin përfshihen:

a) Pasqyrimi në regjistrin e klasës, i cili të ruhet për 8 vjet, i të gjitha të dhënave sipas rubrikave që përmban ai (notat e nxënësve në lëndët bërthamë dhe lëndët me zgjedhje, mungesat e nxënësve në të gjitha lëndët, temat e zhvilluara në çdo orë mësimi, gjeneralitetet e nxënësve etj.). Të gjitha plotësimet në amzë të bëhen në mbështetje të të dhënave që përmbajnë rubrikat e regjistrit të klasës.

b) Regjistri i klasës do të përdoret dhe për klasat që janë formuar nga nxënës të përzier të paraleleve të klasës X, të lëndëve me zgjedhje. Mësuesi, në fund të ditës së mësimi, bën plotësimin e regjistrit të klasës.

c) Në amzë të pasqyrohen rezultatet e nxënësve për lëndët bërthamë dhe lëndët me zgjedhje, rezultate të cilat merren vetëm nga regjistri i klasës.

II. Përcaktimin e numrit të orëve në lëndët me zgjedhje, si më poshtë:

a) Në lëndët me zgjedhje të detyruar (4 orë gjithsej), në klasën X, nxënësi mund të zgjedhë lëndë të avancuar edhe gjuhën e huaj të dytë.

b) Nxënësi në klasën X mund të zgjedhë 2 orë lëndë të detyruara dhe 2 orë lëndë me zgjedhje të lirë.

c) Nxënësi në klasën X mund të zgjedhë 3 orë lëndë me zgjedhje të detyruar dhe 1 orë lëndë me zgjedhje të lirë.

III. Dhënien e provimeve në vjeshtë kur:

a) nxënësi është mbetës në një deri në dy lëndë bërthamë;

b) nxënësi është mbetës në lëndët/modulet me zgjedhje.

IV. Mbetjen e nxënësit në klasë, kur:

a) në përfundim të vitit shkollor është mbetës në tri lëndë bërthamë;

b) Nuk paraqitet në provimet e vjeshtës për një lëndë bërthamë;

c) është mbetës në provimet e vjeshtës në një lëndë bërthamë.

2. Nxënësi që nuk i nënshtrohet provimit të vjeshtës në një lëndë/modul me zgjedhje, ose mbetet në të, e kalon klasën, por nuk i fiton kreditet përkatëse.

3. Nxënësi, që është mbetës në provimin e vjeshtës në një lëndë/modul me zgjedhje, ka të drejtë t’i nënshtrohet përsëri provimit brenda vitit pasues.

4. Nëse lënda/moduli vijon edhe në klasën pasuese, nxënësi nuk ka të drejtë që të ndjekë atë lëndë/modul.

5. Kur nxënësi është kalues në lëndë/modul me zgjedhje, i fiton kreditet përkatëse të klasës X që përmban plani mësimor i gjimnazit.

6. Nëse nxënësi është kalues në të gjitha lëndët bërthamë dhe nuk ka plotësuar sasinë e mjaftueshme të krediteve që përmban plani mësimor i gjimnazit, nuk futet në provimet e Maturës Shtetërore.



7. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 802

**UDHËZIM**  
**Nr.3, datë 3.2.2010**

**PËR NORMAT E PUNËS MËSIMORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR DHE**  
**STANDARDE TË LIDHURA ME TO**  
(Ndryshuar me udhëzim nr.5, datë 13.2.2010)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 64 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për arsimin parauniversitar”, të ndryshuar

**UDHËZOJ:**

Duke filluar nga semestri i dytë i vitit mësimor 2009-2010, normat e punës mësimore në sistemin arsimor parauniversitar janë si më poshtë:

**I. ARSIMI PARASHKOLLOR**

Drejtoreshë kopshti 15-24 orë në javë;  
Edukatore kopshti 36 orë në javë.

**II. ARSIMI BAZË**

1. Norma mësimore, mësues në ciklin fillor:

a) Klasa I 23 orë në javë;  
b) Klasa II 23 orë në javë;  
c) Klasa III 25 orë në javë;  
d) Klasa IV 26 orë në javë;  
e) Klasa V 26 orë në javë.

2. Norma mësimore, mësues në ciklin e lartë:

a) Mësues i gjuhës shqipe, i leximit letrar 20 orë në javë;  
a/1 Mësuesi i letërsisë 20 orë në javë;  
b) Mësues i matematikës, i fizikës dhe biokimisë 22 orë në javë;  
c) Mësues i lëndëve të tjera 24 orë në javë;  
d) Mësues në institutet e fëmijëve 22 orë në javë.  
(me aftësi të kufizuara)

3. Norma mësimore për drejtuesit në arsimin bazë:

a) Drejtori i shkollës me 50-300 nxënës 12 orë në javë;  
b) Drejtori i shkollës me 301-700 nxënës 8 orë në javë;  
c) Zv/drejtori i shkollës me 301-700 nxënës 10 orë në javë;  
d) Drejtori i shkollës me mbi 700 nxënës 6 orë në javë;  
e) Zv/drejtori i shkollës me mbi 700 nxënës 10 orë në javë.

4. Norma mësimore e kontrollit:

a) Drejtori i shkollës 4 orë në javë;  
b) Zv/drejtori i shkollës 6 orë në javë.

5. Norma mësimore e shkollave të minoritetit

Në shkollat e minoritetit ngarkesa mësimore do të jetë sipas këtij udhëzimi.

### III. ARSIMI I MESËM

1. Normat mësimore për mësues:

- a) Mësuesi 22 orë në javë;  
(norma vjetore 700-750 orë)
- b) Mësuesi i praktikave profesionale 33 orë në javë;  
(norma vjetore 1180 orë)

2. Norma mësimore për drejtuesit:

- a) Drejtori i shkollës me 50-300 nxënës 12 orë në javë;
- b) Drejtori i shkollës me 301-700 nxënës 8 orë në javë;
- c) Zv/drejtori i shkollës me 301-700 nxënës 10 orë në javë;
- d) Drejtori i shkollës me mbi 700 nxënës 4 orë në javë;
- e) Zv/drejtori i shkollës me mbi 700 nxënës 8 orë në javë.

3. Norma mësimore e kontrollit:

- a) Drejtori i shkollës 4 orë në javë;
- b) Zv/drejtori i shkollës 6 orë në javë.

4. Norma të tjera

Përveç orëve të mësimin, elementet përbërëse që do të përfshihen në normën mësimore, të llogaritura me konvertim, janë si më poshtë:

- a) Orë për provimet me shkrim, vjetore dhe semestrale të klasave të korrespondencës 4 nxënës - 1 orë mësimore;
- b) Orë për shoqërimin dhe drejtimin e nxënësve (klasës) në praktikat profesionale 1.5 orë - 1 orë mësimore;
- c) Konsultim për sistemin e korrespondencës të nxënësve ( klasës) 1 orë - 1 orë mësimore;
- d) Mësim/shoqërim në qendrat kulturore të fëmijëve të nxënësve (klasës/grupit) 1 orë -1 orë mësimore.

### IV. NORMA TË VEÇANTA

a) Mësuesit që drejton bibliotekën dhe punon me librin në shkolla, i ulet norma mësimore 3 orë në javë.

b) Mësuesit e shkollave të mesme profesionale që ngarkohen me drejtimin e bazave prodhuese të mëdha (përgjegjës i bazës prodhuese), kanë gjysmën e orëve mësimore.

c) Kryetarit të sindikatës së arsimit në një rreth, në varësi të numrit të anëtarësisë me kuotizacion, t'i ulet norma nga 5 deri në 10 orë në javë. Në seksionet e qarqeve, që kanë më shumë se 600 anëtarë, i reduktohet norma mësimore javore me 6-8 orë edhe një personi të dytë”.

d) Në shkollat e mesme veterinare, mjekëve veterinerë që drejtojnë sektorë në klinikën veterinare pranë shkollës, u ulet ngarkesa me 4 orë javore.

e) Mësuesi i shkollës 9-vjeçare, që kryen punën e sekretarit të shkollës për amzën dhe organizimin e inventarit, i ulet norma si më poshtë:

- i) Në shkollat me deri 300 nxënës 4 orë më pak;
- ii) Në shkollat me 301- 700 nxënës 6 orë më pak.

f) Mësuesi i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës, që kryen punën e sekretarit të shkollës për amzën dhe organizimin e inventarit, i ulet norma mësimore 8 orë ose mund të ketë një sekretare pa ngarkesë.

g) Për llogaritje të punonjësve mësimorë, të nevojshëm, të merret parasysh plani mësimor dhe norma mësimore javore. Në ciklin e ulët të shkollës 9-vjeçare të llogaritet, për çdo klasë, një mësues.

h) Në ciklin e ulët, për efekt pagese, orët suplementare në klasat kolektive do të llogariten mbi ngarkesën javore, 24 orë, kur klasa kolektive ka mbi 10 nxënës, dhe, mbi ngarkesën javore, 26 orë, kur klasa kolektive ka nën 10 nxënës. Në ciklin e lartë, ora suplementare, për mësuesit e

klasave kolektive, llogaritet mbi ngarkesën javore 22 orë (sipas normës mësimore javore të përcaktuar më lart).

i) Drejtorit të shkollës që zhvillon mësim në ciklin e lartë me klasat kolektive, orët suplementare i llogariten mbi ngarkesën javore, 14 orë, dhe jo më shumë se tri orë suplementare në javë.

j) Për plotësimin e normës mësimore, mësuesi i shkollës 9-vjeçare ngarkohet edhe me orë mësimore jashtë profilit, pa cenuar cilësinë e procesit mësimor dhe kompetencën profesionale.

k) Mësuesit që, për shkak të programit mësimor, japin orë mësimore mbi normën e miratuar në paragrafët e mësipërm, u paguhen orë mbi normë, deri në 240 orë mësimore në vit.

l) Pagesa e orëve suplementare bëhet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave të ndryshuar, ku përcaktohet masa e pagesës për çdo orë mësimore mbi normën e lejuar.

m) Mësimi i edukimit fizik zhvillohet veç për djem e veç për vajza.

n) Në shkollat 9-vjeçare e të mesme në qytet, kur klasat kanë përbërje me më pak se 10 nxënës të një gjinie, mësimi i edukimit fizik bëhet duke bashkuar grupet e dy klasave paralele. Për shkollat me një paralele, kur klasa ka përbërje me më pak se 12 nxënës të një gjinie, mësimi i edukimit fizik të zhvillohet bashkë, djem e vajza.

o) Mësuesit që punojnë/zhvillojnë orë të veçanta në institucionet e arsimit parauniversitar (shkolla) dhe punojnë në institucione/apo biznes, si për shembull trajnerë, sportistë, inxhinierë, teknikë të lartë, mjeshtrë etj., paguhen vetëm për orët e mësimit që zhvillojnë në shkolla.

## V. STANDARDE MBI NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË

### 1. Arsimi parashkollor

a) Grupet formohen me jo më pak se 25 fëmijë që frekuentojnë.

b) Në fshat lejohet hapja e grupeve edhe me 15 fëmijë që frekuentojnë.

c) Në fshatra dhe zona të thella ku nuk sigurohet numri i fëmijëve, sipas normativave të mësipërme, grupi mund të hapet edhe me 10 fëmijë, që frekuentojnë.

### 2. Arsimi bazë, cikli fillor

a) Klasat formohen me jo më pak se 32 nxënës.

b) Në shkollat e fshatit, kur nuk plotësohet normativa e mësipërme, të punohet me klasa kolektive, në rast se nuk sigurohet përqendrimi i shkollave.

c) Klasat kolektive punojnë me sistem 6-orësh.

d) Numri i nxënësve për klasë është:

- me dy klasa kolektive deri në 25 nxënës;

- me tri dhe pesë klasa kolektive, duke filluar nga 20 nxënës.

### 3. Arsimi bazë, cikli i lartë

a) Klasat formohen me jo më pak se 32 nxënës.

b) Kur numri i nxënësve në dy ose më shumë klasa të ndryshme është deri në 25 nxënës, atëherë hapen klasat kolektive, të cilat punojnë me sistem 6-orësh (kur nuk ekziston mundësia e përqendrimit të shkollave).

c) Në klasat kolektive punohet me sistem 6-orësh.

### 4. Arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnazet) dhe arsimit tekniko-profesional.

a) Në klasat X, XI, XII, formimi i klasës bëhet me jo më pak se 35 nxënës.

b) Klasa XIII (APT) formohet me jo më pak se 32 nxënës.

c) Kur nuk realizohet numri i kërkuar i nxënësve sipas kërkesave të mësipërme, klasat hapen me propozim të drejtorisë arsimore dhe me miratim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

## VI. KUADRI DREJTUES NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Numri i drejtuesve në shkollat e arsimit parauniversitar është në përputhje me numrin e nxënësve që ka shkolla sipas përcaktimit të mëposhtëm:

a) Një kryemësues, kur shkolla ka deri në 50 nxënës;

b) Një drejtor kur shkolla ka 50-300 nxënës;

c) Një zv/drejtor kur shkolla ka 301-700 nxënës;

- d) Dy zv/drejtorë kur shkolla ka mbi 700 nxënës;
- e) Në shkollat fillore me 5 klasa të veçanta, nuk do të ketë drejtor, por kryemësues.
- f) Një drejtor në kopshtet e fëmijëve, të pavarura nga shkollat 9-vjeçare, me mbi 4 grupe.

## VII. QENDRAT KULTURORE TË FËMIJËVE

Qendrat kulturore të fëmijëve funksionojnë me rrethe dhe sektorë:

1. Rrethi formohet me 15-20 fëmijë. Rrethet e instrumenteve formohen me 8-10 fëmijë.
2. sektori formohet me jo më pak se 9 rrethe dhe caktohet 1(një) përgjegjës.
3. sektorët e qendrave kulturore të fëmijëve janë:
  - a) sektori i artit;
  - b) sektori i sportit;
  - c) sektori tekniko-shkencor.
4. Kur sektori ka mbi 15 rrethe, ka në organikë edhe një inspektor efektiv.
5. Përgjegjësi i sektorit dhe instruktori efektiv instruktojnë direkt 2 rrethe dhe përgjigjen për aktivitetet artistiko-kulturore të shkollave me nën 500 nxënës.
6. Qendrat kulturore që kanë mbi 15 rrethe dhe krijojnë 1 sektor, kanë drejtor të qendrës kulturore të fëmijëve. Drejtori i qendrës kulturore të fëmijëve instrukton direkt një rreth dhe kontrollon gjithë aktivitetin qendrës kulturore të fëmijëve.
7. Qendrat kulturore me deri 15 rrethe të ndryshme, që nuk krijojnë sektor, kanë përgjegjës të qendrës kulturore të fëmijëve.

## VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

Udhëzimi nr.12, datë 2.8.1994, shtojca nr.21/1, datë 8.8.1998 dhe udhëzimi nr.36, datë 9.10.2007, shfuqizohen.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 803*

*Udhëzim nr.5, datë 13.2.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 808*

## UDHËZIM Nr.7, datë 25.2.2010

### PËR PËRFUNDIMIN E VITIT SHKOLLOR 2009-2010 DHE PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË LIRIMIT NË SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

#### KREU I PËRFUNDIMI I KLASËS IX TË ARSIMIT BAZË

1. Viti mësimor 2009–2010, për klasën e IX të arsimit bazë, të përfundojë në datën 1 qershor 2010 dhe të llogaritet me 34 javë mësimore.
2. Provimet e lirimimit për klasën IX të zhvillohen më:
  - a) Gjuhë shqipe 7 qershor 2010,
  - b) Matematikë 19 qershor 2010.

**KREU II**  
**DATAT PËR SESIONIN E DYTË TË PROVIMEVE TË LIRIMIT**

1. Lëndët dhe datat e provimeve të lirimimit në sesionin e dytë për nxënësit mbetës janë:
- |                                  |                 |
|----------------------------------|-----------------|
| a) Gjuhë shqipe dhe lexim letrar | 1 shtator 2010, |
| b) Matematikë                    | 6 shtator 2010. |

**KREU III**  
**MASA PËR MBARËVAJTJEN E PROVIMEVE**

1. Drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe drejtoritë e shkollave të marrin të gjitha masat që viti mësimor 2009-2010, për klasat e nënta, të mbyllet sipas programit dhe me nota përfundimtare për çdo lëndë brenda datës 2 qershor 2010, duke shfrytëzuar orët në dispozicion.

**KREU IV**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Udhëzimi nr.31, datë 31.8. 2009 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2009-2010”, në lidhje me përfundimin e vitit shkollor 2009-2010, për klasat e 9 të arsimit bazë dhe në lidhje me zhvillimin e provimeve të lirimimit për sesionin e parë, revokohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri që mbulon arsimin parauniversitar, sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 809*

**UDHËZIM**  
**Nr.8, datë 25.2.2010**

**PËR PËRFUNDIMIN E VITIT SHKOLLOR 2009-2010 DHE PËR ZHVILLIMIN E**  
**PROVIMEVE PËRFUNDIMTARE DHE PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE, NË**  
**SISTEMIN E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

**KREU I**  
**PËRFUNDIMI I VITEVE TË FUNDIT TË SHKOLLAVE TË MESME DHE PERIUDDHA E**  
**ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE PËR SESIONIN E PARË**

1. Viti shkollor për arsimin e mesëm të përfundojë sipas udhëzimit nr.31, datë 31.8. 2009 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2009 - 2010”, me përjashtim të viteve të fundit të shkollave të mesme 4 dhe 5-vjeçare.

2. Për maturat dhe vitet e fundit të shkollave të mesme 4 dhe 5-vjeçare, viti shkollor 2009-2010 të përfundojë më 21 maj 2010.

3. Lëndët dhe datat e provimeve të Maturës Shtetërore në sesionin e parë janë:

- a) Gjuhë shqipe dhe letërsi 1 qershor 2010;
- b) Matematikë 15 qershor 2010;
- c) Provimet me zgjedhje (Z1 dhe Z2) 30 qershor 2010.

4. Periudha e provimeve përfundimtare në shkollat profesionale 3-vjeçare dhe në nivelin e parë 3-vjeçar të shkollave profesionale 3+2- vjeçare: 24 – 30 maj 2010.

5. Lëndët dhe datat për sesionin e parë të provimeve të Maturës Shtetërore për disa kategori shkollash të mesme janë:

- a) Në shkollat e mesme pedagogjike për minoritetin:  
Gjuha dhe letërsia greke 25 maj 2010;
- b) Në seksionet dygjuhëshe (profili shoqëror dhe natyror):  
Gjuhë e huaj 24 maj 2010;
- c) Në shkollat e mesme artistike dhe sportive:  
Formimi teorik-praktik profesional 25 maj 2010;
- d) Në shkollat e mesme teknike ekonomike dhe teknike-profesionale 5-vjeçare dhe 3+2-vjeçare:  
Formimi teorik-praktik profesional 25 maj 2010.

6. Lëndët e provimeve me zgjedhje të Maturës Shtetërore janë:

- a) fizikë,
- b) kimi,
- c) biologji,
- d) histori,
- e) gjeografi,
- f) njohuri për shoqërinë,
- g) njohuri për ekonominë, filozofi,
- h) gjuhë angleze,
- i) gjuhë frënge,
- j) gjuhë italiane,
- k) gjuhë gjermane,
- l) gjuhë spanjolle.

7. Në arsimin profesional 3-vjeçar dhe në nivelin e parë 3-vjeçar të shkollave profesionale 3+2- vjeçare provimet përfundimtare të jenë:

- a) Formimi teorik profesional;
- b) Formimi praktik profesional.

Tezat të përgatiten nga shkollat përkatëse. Datat për provimet përfundimtare të caktohen nga drejtoritë e shkollave.

## KREU II

### DATAT PËR SESIONIN E DYTË TË PROVIMEVE TË LIRIMIT DHE TË PROVIMEVE TË DETYRUARA TË MATURËS SHTETËRORE

1. Datat e zhvillimit të provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore në sesionin e dytë janë:

- a) Gjuhë shqipe dhe letërsi 8 tetor 2010;
- b) Matematikë 15 tetor 2010.

2. Nxënësit e klasave të katërta të gjimnazëve dhe të shkollave social-kulturore, të klasave të pesta të shkollave teknike, të klasave të treta të shkollave profesionale (me kohë të plotë) dhe të klasave të pesta të gjimnazëve me kohë të shkurtuar, që kanë mbetur në klasë në një apo dy lëndë, me përfundime (nota) vjetore jokalueuse, kanë të drejtë t'i japin ato provime klase në muajin shtator 2010, sipas një grafiku të veçantë të hartuar nga shkolla. Kur nxënësi vlerësohet kalues në provimet e klasës, ka të drejtë të pranohet në sesionin II të Maturës Shtetërore, të po atij viti shkollor.

### KREU III MASA PËR MBARËVAJTJEN E PROVIMEVE

1. Viti mësimor 2009-2010, për vitin e fundit të shkollave të mesme 4-5 vjeçare, të mbyllet në datën 21 maj 2010 dhe të llogaritet me 32 javë mësimore.
2. Çdo DAR/ZA të dërgojë brenda datës 21 maj 2010 në AVA emrat e nxënësve të klasifikuar mbetës në përfundim të vitit të fundit (të katërt ose të pestë), të shkollave të mesme, me qëllim që të hiqen nga lista e provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore.
3. Për provimet e Maturës Shtetërore të veprohet sipas rregullores së Maturës Shtetërore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.103, datë 17.2.2010 “Për miratimin e rregullores së Maturës Shtetërore 2010”.
4. Të gjitha testet e provimeve me shkrim, për të dy sesionet, të hartohen në AVA dhe të shpërndahen prej saj.
5. Në institucionet arsimore private, provimet e Maturës Shtetërore të zhvillohen në të njëjtat data dhe me të njëjtat teste, si dhe në institucionet ekuivalente publike.
6. Për shkollën e mesme pedagogjike për minoritetin grek për provimin “Gjuha dhe letërsia greke”, të përgatitet tezë e veçantë nga DAR, Gjirokastrë.
7. Tërheqja e testeve të provimeve me shkrim të Maturës Shtetërore të bëhet në bazë të rregullores së Maturës Shtetërore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 103, datë 17.2.2010 “Për miratimin e rregullores së Maturës Shtetërore 2010”.
8. Për ndjekjen e provimeve përfundimtare në shkollat profesionale 3-vjeçare, DAR/ZA të angazhojë specialistët përkatës sipas profileve.

### KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr.31, datë 31.8.2009 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2009-2010”, në lidhje me përfundimin e vitit shkollor 2009-2010, për vitet e fundit të shkollave të mesme 4 dhe 5-vjeçare dhe në lidhje me zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe provimeve përfundimtare për sesionin e parë, revokohet.
  2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri që mbulon arsimin parauniversitar, sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 810*

### UDHËZIM Nr.17, datë 29.6.2010

#### **PËR STRUKTURËN DHE PLANET MËSIMORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2010-2011**

Në zbatim të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të dispozitave normative për arsimin parauniversitar, shtator 2002, kreu IV,

UDHËZOJ:

Gjatë vitit mësimor 2010-2011 të punohet me strukturën dhe planet mësimore në vijim:

## KREU I

### 1. ARSIMI BAZË

#### 1.1 Struktura e vitit shkollor

Klasa	Mësim			Festa
	Semestri i I	Semestri II	Gjithsej	
I-IX	18 javë	17 javë	35 javë	6 ditë

#### MËSIM:

Për klasat I-IX:

Semestri i parë fillon më 6 shtator 2010 dhe mbaron më 28 janar 2011.

Semestri i dytë fillon më 31 janar 2011 dhe mbaron më 10 qershor 2011.

#### PUSHIME:

Periudha e parë: Pushimet fillojnë më 27 tetor 2010 dhe mbarojnë më 31 tetor 2010.

Periudha e dytë: Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2010 dhe mbarojnë më 5 janar 2011.

Periudha e tretë: Pushimet fillojnë më 28 mars 2011 dhe mbarojnë më 3 prill 2011.

#### PROVIME:

Provimet e lirimit për klasën IX zhvillohen në periudhën 15-30 qershor 2011.

#### 1.2 PLANET MËSIMORE

##### a) Plani mësimor i arsimit bazë

Nr.	LËNDA	KLASAT								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VII	IX
1	Gjuhë amtare (Gjuhë shqipe)	8	8	6	5	5	5	5	5	5
2	Gjuhë e huaj	-	-	2	2	2	2	2	3	3
3	Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
4	Dituri natyre	-	-	2	3	2				
5	Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2
6	Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
7	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2
8	Vendlindje	-	-	-	-	2	-	-	-	-
9	Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
10	Gjeografi	-	-	-	-	-	2	2	2	2
11	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
12	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	-
13	Edukim muzikor	1	1	1	1	1	2	2	2	2
14	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-
15	Edukim fizik	2	2	2	2	2	2	2	2	2
16	Informatikë							1	1	1
17	Veprimtari jashtëkurrikulare e lëndë me zgjedhje	1	1	1	2	2	2	1	1	1
	<b>Shuma (orë javë)</b>	<b>20</b>	<b>20</b>	<b>22</b>	<b>23</b>	<b>23</b>	<b>27</b>	<b>29</b>	<b>29</b>	<b>29</b>

##### b) Plani mësimor i arsimit bazë të pakicave kombëtare

Nr.	LËNDA	KLASAT								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VII	IX
1	Gjuhë amtare (greke/maqedonase)	8/7	6	5	4	4	4	4	4	3
2	Gjuhë shqipe dhe lexim letrar	0/2	5	5	5	5	4	4	4	4
3	Gjuhë e huaj	-	-	-	-	-	2	2	2	2
4	Matematikë	5	5	5	4	4	4	4	4	4
5	Dituri natyre	-	-	2	3	2	-	-	-	-
6	Fizikë	-	-	-	-	-	1	2	2	2
7	Kimi	-	-	-	-	-	-	1	1	2
8	Biologji dhe edukim shëndetësor	-	-	-	-	-	2	2	2	2



9	Vendlindja					2				
10	Histori	-	-	-	1	-	2	2	2	2
11	Gjeografi	-	-	-		-	2	2	2	2
12	Histori amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-	-	-	-	-	1
13	Gjeografi amtare (greke/maqedonase)	-	-	-	-	-	-	-	1	-
14	Edukatë shoqërore	1	1	1	1	1	1	1	1	1
15	Edukim figurativ	1	1	1	1	1	1	1	1	-
16	Edukim muzikor	1	1	1	1	1	2	1	1	2
17	Aftësim teknologjik	1	1	1	1	1	1	1	-	-
18	Edukim fizik	2	2	2	2	2	2	2	2	2
19	Veprimtari jashtëkurrikulare e lëndë me zgjedhje	1	1	1	1	1	1	1	1	1
20	Informatikë							1	1	1
	<b>Shuma (orë javë)</b>	<b>20/21</b>	<b>23</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>29</b>	<b>31</b>	<b>31</b>	<b>31</b>

Orët javore të tipit 8/7 dhe të tjera të shprehura në këtë formë në disa lëndë tregojnë: shifra e parë është sasia e orëve për semestrin e parë dhe shifra e dytë është sasia e orëve për semestrin e dytë.

## KREU II

### 2. ARSIMI I MESËM

#### 2.1 STRUKTURA E VITIT SHKOLLOR

a) Për gjimnazet, shkollat e mesme të gjuhëve të huaja dhe pedagogjike

Struktura për gjimnazet me kohë të plotë dhe të shkurtuar, për shkollat e gjuhëve të huaja (gjimnazet gjuhësore) dhe për shkollën pedagogjike “Luigj Gurakuqi” Elbasan:

Klasa	Mësim			Provime: Matura Shtetërore	Festa
	Semestri I	Semestri II	Gjithsej		
X-XI	18 javë	18 javë	36 javë	-	6 ditë
XII	18 javë	16 javë	34 javë	5 javë	6 ditë

b) Për shkollat e mesme artistike dhe koreografike

Klasa	Mësim		Praktikë e grupuar	Gjithsej	Provime: Matura Shtetërore	Festa
	Semestri I	Semestri II				
X-XI	18 javë	16 javë	2 javë	36 javë	-	6 ditë
XII	18 javë	16 javë	-	34 javë	5 javë	6 ditë

c) Për shkollat e mesme sportive

Klasa	Mësim		Praktikë e grupuar	Gjithsej	Provime: Matura Shtetërore	Takime sportive	Festa
	Semestri I	Semestri II					
X	17 javë	17 javë	2 javë	36 javë	-	3	6 ditë
XI	17 javë	17 javë	4 javë	38 javë		4	6 ditë
XII	17 javë	15 javë	4 javë	36 javë	5 javë	4	6 ditë

MËSIM:

KLASA X-XI

Semestri i parë fillon më 6 shtator 2010 dhe mbaron më 28 janar 2011.

Semestri i dytë fillon më 3 shkurt 2011 dhe mbaron më 17 qershor 2011.

## KLASA XII

Semestri i parë fillon më 6 shtator 2010 dhe mbaron më 28 janar 2011.

Semestri i dytë fillon më 31 janar 2011 dhe mbaron më 24 maj 2011.

### PUSHIMET:

Periudha e parë: Pushimet fillojnë më 27 tetor 2010 dhe mbarojnë më 31 tetor 2010.

Periudha e dytë: Pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2010 dhe mbarojnë më 5 janar 2011.

Periudha e tretë: Pushimet fillojnë më 28 mars 2011 dhe mbarojnë më 3 prill 2011.

### PROVIMET:

2011. Sezoni i provimeve të Maturës Shtetërore fillon më 26 maj dhe përfundon më 30 qershor

## 2.2 PLANET MËSIMORE

### a) Plani mësimor i gjimnazit

Kurrikula bërthamë për secilën klasë

Nr.	Lëndët	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
1	Arte (muzika, vallëzimi, teatri, arti pamor) Histori arti	1	1	1
2	Edukimi fizik dhe sportet	2	1	-
3	Gjuha e huaj e parë	3	3	4
4	Gjuha shqipe dhe letërsia	3	3	4
5	Karriera, aftësimi për jetën	1	1	1
6	Matematika	3	3	4
7	Kimia	2	2	-
	Fizika	2	2	-
	Biologjia	2	2	-
	Shkenca e tokës, mjedisit dhe hapësirës	2	-	-
	Shkenca natyrore			2
8	Qytetaria	2	1	-
	Historia	1	2	2
	Gjeografia	-	1	2
	Ekonomia	-	-	2
9	TIK	2	1	-
	Teknologjia	-	-	2
	Shuma	26	23	24
	Përqindja e kurrikulës-bërthamë	86%	76%	80%
	Zgjedhja e detyruar	2-4	4-6	4-6
	Zgjedhja e lirë	2	3	2
	<b>Numri i orëve javore gjithsej</b>	<b>30-32*</b>	<b>30-32*</b>	<b>30-32*</b>

Të gjitha gjimnazet janë të detyruara të ofrojnë 30 orë mësimore javore. Gjimnazet që kanë mundësi të ofrojnë 32 orë mësimore, e marrin këtë vendim me miratim të DARZA-ve përkatëse.

Kurrikula me zgjedhje për secilën klasë

Nr.	Fushat	Avancim dhe lëndë me zgjedhje	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Zgjedhje e detyruar gjithsej në orë
1	Artet (muzikë, vallëzimi, teatri, arti pamor)	-	-	-	-	-
2	Edukim fizik dhe sporte	-	-	-	2	-
3	Gjuha e huaj	Gjuha e huaj e dytë				

		-Anglisht	2	2	2	6
		-Frëngjisht	2	2	2	6
		-Italisht	2	2	2	6
		-Gjermanisht	2	2	2	6
		-Spanjisht	2	2	2	6
4	Gjuhë shqipe dhe letërsi	Letërsi	2	2	1	5
5	Karriera aftësimi për jetën	-	-	-	-	-
6	Matematika	Matematikë	2	2	1	5
7	Shkenca natyrore	Kimia	-	2	2	4
		Fizika	-	2	2	4
		Biologjia	-	2	2	4
8	Shkenca shoqërore	Trashëgimia kulturore	2	2	-	4
		Sociologji	-	2	-	2
		Psikologji	-	2	-	2
		Historia	-	2	2	4
		Gjeografia	-	-	2	2
		Ekonomia	-	-	2	2
		Filozofi	-	-	2	2
9	Teknologjia	TIK	1	1	1	3
		Teknologjia	-	-	2	2

Ndarja e orëve mësimore të kurrikulës me zgjedhje sipas klasave

Kurrikula me zgjedhje sipas planit mësimor	Klasa 10 (orë)	Klasa 11 (orë)	Klasa 12 (orë)	Ngarkesa gjithsej (orë)
Kurrikula me zgjedhje (zgjedhje e detyruar + zgjedhje e lirë)	4	7	6	17
Kurrikula me zgjedhje të detyruar	2	4	4	10
Kurrikula me zgjedhje të lirë	2	3	2	7

Në përfundim të gjimnazit, nxënësi duhet të ketë kryer:

- Shërbim komunitar 18 orë
- Projekt kurrikular 18 orë
- Modul profesional 36 orë

b) Plani mësimor i shkollës së mesme të profilizuar, për klasën e 12-të

Nr.	LËNDËT	Klasa 12		
		Drejtimi		
		Natyror	Shoqëror	I përgjithshëm
1	Letërsi dhe gjuhë shqipe	2	5	4
2	Gjuhë e huaj I	2	3	2
3	Histori	2	3	3
4	Histori arti	-	2	-
5	Gjeografi	2	2	2
6	Njohuri për shoqërinë	-	-	-
7	Njohuri për ekonominë	-	-	-
8	Psikologji	-	2	-
9	Filozofi	1	2	2
10	Matematikë	6	2	5
11	Fizikë	4	2	3
12	Kimi	3	-	2
13	Biologji	3	2	2
14	Teknologji	-	-	-

15	Informatikë	2	2	2
16	Edukim fizik	2	2	2
17	Lëndë me zgjedhje	0/2	0/2	0/2
<b>Shuma e orëve javore</b>		<b>29/31</b>	<b>29/31</b>	<b>29/31</b>

c) Plani mësimor i shkollës së gjuhëve të huaja (gjimnaz gjuhësor)

Nr.	Lëndët	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
1	Arte (muzikë, vallëzim, teatër, art pamor)	-	2	-
2	Edukim fizik dhe sporte	1	1	1
3	Gjuhë e huaj I	4	4	4
	Gjuhë e huaj II	4	4	4
4	Gjuhë shqipe dhe letërsi	3	3	3
5	Karriera aftësimi për jetën	-	1	1
6	Matematika	3	3	3
7	Kimi	2	-	-
	Fizikë	2	-	-
	Biologji	2	-	-
8	Qytetaria	2	1	-
	Historia	1	2	2
	Gjeografia	-	1	2
	Ekonomia	-	-	2
9	Tik	2	1	1
	<b>Shuma</b>	<b>26</b>	<b>23</b>	<b>23</b>
	% e kurrikulës bërthamë	86%	76%	76%
10	Kurrikula me zgjedhje (e detyruar)	3	6	6
11	% e kurrikulës me zgjedhje	14%	24%	24%
12	Kurrikula në bazë shkolle	1	1	1
13	<b>Shuma e orëve javore</b>	<b>30</b>	<b>30</b>	<b>30</b>

Kurrikula me zgjedhje (e detyruar)

Nr.	Avancim dhe lëndë me zgjedhje	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Zgjedhje e detyruar (gjithsej orë)
1	Gjuhë e huaj e parë ose e dytë (avancim)	2	2	2	6
	Anglisht				
	Frëngjisht				
	Italisht				
	Gjermanisht				
	Spanjisht				
	Rusisht				
2	Gjuhë e huaj e tretë	-	3	3	+6
	Anglisht				
	Frëngjisht				
	Italisht				
	Gjermanisht				
	Spanjisht				
	Rusisht				
3	Letërsi	1	1	1	3
	Matematikë	1	1	1	3

5	Kimi	-	1	1	2
6	Fizikë	-	1	1	2
7	Biologji	-	1	1	2
8	Trashëgimia jonë kulturore	1	1	1	3
	Sociologji	-	2	-	2
	Psikologji	-	2	-	2
9	Histori	-	2	-	2
10	Gjeografi	-	-	2	2
11	Ekonomi	-	-	2	2
12	Filozofi	-	-	2	2
13	Tik	1	-	-	1

### KREU III

#### 3. ARSIMI PROFESIONAL

##### 3.1 Shkollat e arsimit profesional të reformuar

Në kuadër të reformimit të arsimit profesional, në vitin shkollor 2010-2011, klasat e para dhe të dyta të shkollave profesionale do të punojnë me skeletkurrikulat e nivelit të parë (2-vjeçar), të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional.

Tabela e plotë për profilet e degëve për nivelin e dytë dhe të tretë po punohet nga AKAFP për saktësimin e emërtimeve përfundimtare dhe do t'u dërgohet me udhëzimin e vitit shkollor 2010-2011.

Klasa	Mësim			Provime	Festa
	Semestri I	Semestri II	Gjithsej		
X	18 javë	18 javë	36 javë	-	6 ditë
XI	18 Javë	16 javë	34 javë	2 javë	6 ditë

#### KLASA X-XI

Semestri i parë fillon më 6 shtator 2010 dhe mbaron më 28 janar 2011.

Semestri i dytë fillon më 3 shkurt 2011 dhe mbaron më 17 qershor 2011.

#### KLASA XII

Semestri i parë fillon më 6 shtator 2010 dhe mbaron më 28 janar 2011.

Semestri i dytë fillon më 31 janar 2011 dhe mbaron më 24 maj 2011.

#### PUSHIMET

Periudha e parë: pushimet fillojnë më 27 tetor 2010 dhe mbarojnë më 31 tetor 2010.

Periudha e dytë: pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2010 dhe mbarojnë më 5 janar 2011.

Periudha e tretë: pushimet fillojnë më 28 mars 2011 dhe mbarojnë më 3 prill 2011.

#### PROVIMET

Sezoni i provimeve të Maturës Shtetërore fillon më 26 maj dhe përfundon më 30 qershor 2011.

**PLANI MËSIMOR PËR KULTURËN E PËRGJITHSHME NË ARSIMIN PROFESIONAL**  
(Struktura 2+1+1=4 vite)

Plani mësimor për drejtimet: mekanik, elektroteknikë, elektronikë, hoteleri-turizëm, teknologji ushqimore, përpunim druri, bujqësi, peshkim, termohidraulikë, ndërtim etj.						
Nr.	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Niveli I		Niveli II	Niveli III
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A		Lëndët e përgjithshme (gjithsej)	15/17	11/13	8/10	15/17
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2		Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-	-	-
5		Histori	1	1	-	2
6		Gjeografi	-	-	-	2
7		Matematikë	2	1	2	2
8		Fizikë	2	1	-	-
9		Kimi	1	2	-	-
10		Biologji	-	-	-	2
11		Teknologji informimi e komunikimi	1	1	1	1
12		Edukim fizik	2	1	-	-
13		Edukimi për karrierën	-	1	-	-
14		Aftësi për jetën	-	-	1	-
15		Lëndë me zgjedhje të detyruar (fizikë, kimi, biologji, histori arti)	-	-	-	2
B		Lëndët profesionale (gjithsej)	10	8	7	9
1						
2						
C		Module të detyruara të praktikës profesionale (gjithsej)	5	10	12	6
1						
2						
D		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (gjithsej)	1	2	3	-
1						
2						
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>31/33</b>	<b>31/33</b>	<b>30/32</b>	<b>30/32</b>

**SHPJEGIME**

- Në klasën e 13-të ofrohen dhe lëndë me zgjedhje të detyruar (përzgjidhet vetëm njëra prej tyre).
- Në klasën e 10-të viti shkollor ka 36 javë mësimore, ndërsa në klasat 11, 12 dhe 13, viti shkollor ka 34 javë mësimore (2 javë për provimet përfundimtare të çdo niveli).
- Kultura e përgjithshme (për të 4 vitet së bashku) përbën rreth 40% të vëllimit të përgjithshëm të kurrikulit, si dhe rreth 69% të kurrikulit bërthamë të gjimnazit.

**PROVIMET**

Në përfundim të nivelit I (të parë) 2-vjeçar, nxënësit do të japin provimet e përfundimit:

1. Provimi i formimit të teorisë profesionale.
2. Provimi i formimit të praktikës profesionale.

Në përfundim të nivelit II (të dytë) 1-vjeçar, nxënësit do të japin provimet e përfundimit:

1. Provimi i formimit të teorisë profesionale.
2. Provimi i formimit të praktikës profesionale.

Në përfundim të nivelit III (të tretë) 1-vjeçar, nxënësit do të japin provimet e Maturës

Shtetërore:

1. Letërsi dhe gjuhë shqipe
2. Matematikë

3. Provimi i formimit të teorisë dhe praktikës profesionale.

**PLANI MËSIMOR PËR TIK**

**PËR KULTURËN E PËRGJITHSHME NË ARSIMIN PROFESIONAL – TEKNIK**  
(Struktura 2+2=4 vite)

<b>Plani mësimor për drejtimin “Teknologji informimi dhe komunikimi”</b> (Kodi.....)						
Nr.	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Niveli I		Niveli III	
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A		Lëndët e përgjithshme (gjithsej)	15/17	13/15	9/11	13/15
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2		Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-	-	-
5		Histori	1	2	1	-
6		Gjeografi	-	-	-	2
7		Matematikë	2	1	2	2
8		Fizikë	2	1	-	-
9		Kimi	1	2	-	-
10		Biologji	-	-	2	1
11		Edukim fizik	2	1	-	-
12		Edukimi për karrierën	-	1	-	-
13		Aftësi për jetën	-	1	-	-
14		Histori arti	-	-	-	2
15		Shkenca e tokës	1	1	-	-
16		Lëndë me zgjedhje të detyruar (fizikë, kimi, biologji)	-	-	-	2
B		Lëndët profesionale (gjithsej)	10	8	9	8
1						
2						
C		Module të detyruara të praktikës profesionale (gjithsej)	5	7	9	7
1						
2						
D		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (gjithsej)	1	2	3	2
1						
2						
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>31/33</b>	<b>30/32</b>	<b>30/32</b>	<b>30/32</b>

**PLANI MËSIMOR**

**PËR KULTURËN E PËRGJITHSHME NË ARSIMIN PROFESIONAL – TEKNIK**  
(Struktura 2+2=4 vite)

<b>Plani mësimor për drejtimet “Ekonomi/biznes” dhe “Pyje”</b> (Kodi.....)						
Nr.	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Niveli I		Niveli III	
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A		Lëndët e përgjithshme (gjithsej)	15/17	13/15	10/12	15/17
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2		Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-	-	-

5		Histori	1	2	1	-
6		Gjeografi	-	-	-	2
7		Matematikë	2	1	2	2
8		Fizikë	2	1	-	-
9		Kimi	1	2	-	-
10		Biologji	-	-	2	1
11		Teknologji informimi dhe komunikimi	1	1	1	1
12		Edukim fizik	2	1	-	-
13		Edukimi për karrierën	-	1	-	-
14		Aftësi për jetën	-	1	-	-
15		Histori arti	-	-	-	2
16		Lëndë me zgjedhje të detyruar (fizikë, kimi, biologji)	-	-	-	2
B		Lëndët profesionale (gjithsej)	10	8	8	10
1						
2						
C		Module të detyruara të praktikës profesionale (gjithsej)	5	7	9	6
1						
2						
D		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (gjithsej)	1	2	3	-
1						
2						
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>31/33</b>	<b>30/32</b>	<b>30/32</b>	<b>30/32</b>

#### SHPJEGIME

- Në klasat 10 dhe 12, viti shkollor ka 36 javë mësimore, ndërsa në klasën e 11-të dhe 13-të, viti shkollor ka 34 javë mësimore (2 javë për provimet përfundimtare).

- Kultura e përgjithshme (për të 4 vitet së bashku) përbën rreth 44% të vëllimit të përgjithshëm të kurrikulit, si dhe rreth 74% të kurrikulit bërthamë të gjimnazit.

#### PROVIMET

Në përfundim të nivelit I (të parë) 2-vjeçar, nxënësit do të japin provimet e përfundimit:

1. Provimi i formimit të teorisë profesionale.
2. Provimi i formimit të praktikës profesionale.

Në përfundim të nivelit III (të tretë) 2-vjeçar, nxënësit do të japin provimet e Maturës

Shtetërore:

1. Letërsi dhe gjuhë shqipe
2. Matematikë
3. Provimi i formimit të teorisë dhe praktikës profesionale.

#### PLANI MËSIMOR

#### PËR KULTURËN E PËRGJITHSHME NË ARSIMIN PROFESIONAL - TEKNIK

(Struktura bllok 4 vite)

Plani mësimor për profilin/drejtimin "Veterinari" (Kodi.....)						
Nr.	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore			
			Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	Klasa 13
A		Lëndët e përgjithshme (gjithsej)	15/17	11/13	12/14	14/16
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1	2	2
2		Gjuhë e huaj	2	2	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-	-	-
5		Histori	1	1	2	-



6	Gjeografi	-	-	-	2
7	Matematikë	2	1	2	2
8	Fizikë	2	1	-	-
9	Kimi	1	2	-	-
10	Biologji	-	-	2	1
11	Teknologji informimi dhe komunikimi	1	1	1	1
12	Edukim fizik	2	1	-	-
13	Edukimi për karrierën	-	1	-	-
14	Aftësi për jetën	-	-	1	-
15	Histori arti	-	-	-	2
16	Lëndë me zgjedhje të detyruar (fizikë, kimi, biologji)	-	-	-	2
B	Lëndët profesionale (gjithsej)	9	11	7	8
1					
2					
C	Module të detyruara të praktikës profesionale (gjithsej)	5	7	9	7
1					
2					
D	Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (gjithsej)	1	2	3	2
1					
2					
	<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/32</b>	<b>31/33</b>	<b>31/33</b>	<b>31/33</b>

#### SHPJEGIME

- Në klasat 10, 11 dhe 12 viti shkollor ka 36 javë mësimore, ndërsa në klasën e 13 viti shkollor ka 34 javë mësimore (2 javë për provimet përfundimtare).

- Kultura e përgjithshme (për të 4 vitet së bashku) përbën rreth 43% të vëllimit të përgjithshëm të kurrikut, si dhe rreth 73% të kurrikut bërthamë të gjimnazit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, datë 26.8.2010, faqe 5785

## ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL

### LIGJ

Nr.8872, datë 29.3.2002

### PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

### KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Qëllimi i ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të mbështesë zhvillimin e një sistemi të përbashkët të arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, i cili mund t'u përshtatet ndryshimeve shoqërore, ekonomike e teknologjike, nevojave të tregut të punës, si dhe të mundësojë një shfrytëzim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore.

2. Ky ligj vendos parimet themelore, strukturën, organizimin dhe administrimin e arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në bashkëpunimin e institucioneve shtetërore, qeveritare me partnerë socialë dhe aktorë të tjerë në fushën e arsimit dhe formimit profesional.

3. Ky ligj garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për arsimim dhe formim profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimit fillestar profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim, duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë.

#### Neni 2

#### Objektivat e arsimit dhe formimit profesional

Ky ligj përcakton objektivat kryesore të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, të cilat janë:

a) të zhvillojë karakteristikat personale kryesore të individit, të nevojshme për veprimtarinë e tij të ardhshme profesionale dhe ekzistencën e pavarur brenda një shoqërie të bazuar në parimet e demokracisë dhe të ekonomisë së tregut;

b) të përshtasë arsimin dhe formimin profesional në tregun e sotëm dhe të ardhshëm të punës;

c) të ofrojë dhënien e një kulture profesionale të përgjithshme dhe të një formimi profesional të specializuar, në përputhje me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë, si dhe me kulturën dhe traditën kombëtare;

ç) të krijojë kushte për arsimim dhe formim profesional, me qëllim aftësimin e individit për t'iu përshtatur ndryshimeve dhe kërkesave të tregut të punës;

d) të rrisë frytshmërinë e përdorimit të infrastrukturës së sistemit të arsimit dhe formimit profesional.

### Neni 3

Arsimi dhe formimi profesional është publik dhe jopublik dhe garantohet nga shteti.

### Neni 4

#### **Përkufizime**

*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008, neni 1)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Sistemi i arsimit dhe formimit profesional” është sistemi që përfshin të gjitha masat dhe veprimtaritë e arsimit profesional e teknik dhe ato të formimit, të riformimit dhe të riaftësisimit profesional në tregun e punës, si dhe në institucionet përgjegjëse dhe zbatuese të tyre.

b) “Arsimi profesional” është element i sistemit të arsimit dhe formimit profesional, i cili u jep nxënësve, që kanë përfunduar arsimin bazë, arsimimin bazë profesional, si dhe njohuritë e shprehite e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar për një specialitet të dhënë. Arsimi profesional kryhet në shkollat profesionale, në përputhje me planet dhe programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

c) “Arsimi teknik” është element i sistemit të arsimit dhe formimit profesional, i cili u jep nxënësve, që kanë përfunduar arsimin bazë, një arsimim bazë, të gjerë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehite e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e teknikut të kualifikuar, për një specialitet të dhënë. Arsimi teknik kryhet në shkollat e mesme teknike, në përputhje me planet dhe programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

ç) “Formimi profesional” është element i sistemit të arsimit dhe formimit profesional, i cili përfshin formimin, riformimin dhe riaftësimin profesional, për fitimin e aftësive të nevojshme profesionale, për t’iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.

d) “Institucionet e arsimit dhe formimit profesional” janë ato institucione publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë ose mbështesin arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri.

dh) “Ndërmarrja” është çdo subjekt fizik dhe juridik, në të cilën, sipas kushteve të saj, realizohen kurse formimi, formimi nëpërmjet punës dhe ku kryhen praktika profesionale të nxënësve si elementë të procesit të arsimit dhe formimit profesional.

e) “Nxënës” është ai person, që merr arsimim profesional e teknik në një nga shkollat e sistemit të arsimit dhe formimit profesional.

ë) “Kursant” është ai person, që merr pjesë në një program ose kurs të formimit profesional.

f) “Mësues” është ai person, i angazhuar me dhënien e mësimit teorik dhe praktik në institucionet e akredituara të arsimit dhe formimit profesional.

g) “Instruktor” është ai person, i angazhuar me dhënien e mësimit teorik dhe praktik në qendra formimi dhe ndërmarrje të akredituara në arsimin dhe formimin profesional.

gj) “Partnerë socialë” janë organizatat që përfaqësojnë interesat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, të cilat marrin pjesë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional dhe së bashku me institucionet administrative shtetërore punojnë për zbatimin e këtij ligji.

h) “Partnerë të tjerë” janë dhomat e tregtisë dhe të industrisë, organizatat jofitimprurëse, komunitetet e ndryshme, që marrin pjesë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional dhe së bashku me institucionet administrative shtetërore punojnë për zbatimin e këtij ligji.

i) “Dëftesa, dëftesa e pjekurisë, certifikata e aftësisë profesionale, dëshmia dhe certifikata e kualifikimit të njohura nga shteti” janë dokumente që vërtetojnë përmbushjen, nga ana e nxënësve dhe e kursantëve, e programeve të miratuara të arsimit dhe formimit profesional.

j) “Qendra e formimit profesional” është enti publik dhe jopublik, në të cilin zhvillohen programe formimi profesional dhe praktika profesionale për nxënësit dhe kursantët, pa qëllim fitimi.

#### Neni 5

#### **Përfituesit nga ky ligj**

*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008, neni 1)*

Nga ky ligj përfitojnë:

- a) të gjithë nxënësit që kanë përfunduar arsimin bazë;
- b) personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç, që janë kërkues pune dhe/ose dëshirojnë të formohen profesionalisht;
- c) grupe të veçanta, që dëshirojnë riaftësim profesional, si personat me aftësi të kufizuar, nënat me shumë fëmijë, personat nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë dhe çdo kategori tjetër që do të përcaktohet si e tillë me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 6

#### **Tipat e arsimit dhe formimit profesional**

Arsimi dhe formimi profesional përbëhet nga:

- a) arsimi profesional;
- b) arsimi i mesëm teknik;
- c) formimi profesional;
- ç) forma të tjera të arsimit dhe formimit profesional që përcaktohen me ligj.

Format e organizimit të tipave të mësipërm të arsimit dhe formimit profesional përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### KREU II

#### **KRITERE TË PËRGJITHSHME**

#### Neni 7

#### **Institucionet e arsimit dhe formimit profesional**

*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008, neni 1)*

Institucionet e arsimit dhe formimit profesional janë:

- a) Shkollat profesionale publike dhe jopublike, të nivelit të parë dhe të dytë, të cilat ofrojnë arsimimin teknik të nxënësve pas arsimit bazë. Këto shkolla realizojnë përgatitjen profesionale me karakter të theksuar praktik dhe u japin nxënësve arsimimin bazë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar për një specialitet të dhënë.
- b) Shkollat teknike publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë arsimimin teknik të nxënësve pas arsimit bazë. Këto shkolla u japin nxënësve një arsimim bazë të gjerë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e teknikut të kualifikuar për një specialitet të dhënë.
- c) Qendrat dhe kurset e formimit profesional, të cilat organizojnë formim, riformim dhe riaftësim profesional, për fitimin e aftësive të nevojshme profesionale për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.
- ç) Institucionet e specializuara të arsimit dhe formimit profesional për grupe të veçanta.
- d) Ndërmarrjet.
- dh) Institucionet e tjera publike dhe jopublike, veprimtaria e të cilave rregullohet me akte të veçanta nënligjore.

## Neni 8

### **Regjistrimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional**

Të gjitha institucionet që ofrojnë arsimin dhe formimin profesional duhet të regjistrohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale. Kriteret dhe rregullat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të dy ministrave.

## Neni 9

### **Akreditimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional**

Akreditimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në përputhje me aftësitë e këtyre institucioneve për të ofruar arsimin dhe formimin profesional. Kushtet dhe kriteret e akreditimit përcaktohen me akte të veçana nënligjore të Këshillit të Ministrave.

## Neni 10

### **Pranimi në arsimin dhe formimin profesional**

*(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008, neni 1)*

1. Në shkollat profesionale dhe në ato të mesme teknike publike dhe jopublike pranohen të gjithë individët që kanë përfunduar arsimin bazë dhe kanë marrë dëftesën e lirimt. Kriteret e pranimeve dhe procedurat e regjistrimit vendosen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Në kurset e ndryshme të formimit, të riformimit dhe të riaftësimt profesional publik dhe jopublik, të akredituar, marrin pjesë të rinjtë dhe të rriturit, të cilët pranojnë programet përkatëse të miratuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Procedurat e regjistrimit në formimin publik vendosen me udhëzim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

## Neni 11

### **Kohëzgjatja në arsimin dhe formimin profesional**

*(Ndryshuar pikat 2, 3 e 4 me ligjin nr.10 011, datë 30.10.2008, neni 2)*

1. Arsimi dhe formimi profesional ka kohëzgjatje të ndryshme në varësi të tipit të tij.

2. Arsimi profesional, publik dhe privat, fillon pas mbarimit të arsimit bazë, me kohëzgjatje 3 vjet (2+1) dhe ndahet në dy nivele:

a) niveli i parë vazhdon dy vjet;

b) niveli i dytë vazhdon një vit pas nivelit të parë.

Me mbarimin e nivelit të parë, krahas dëftesës së përfundimit të këtij niveli, nxënësit pajisen me certifikatë aftësimi profesional të nivelit të parë.

Në përfundim të nivelit të dytë, nxënësit marrin dëftesën e përfundimit të këtij niveli dhe certifikatën e aftësimt profesional të nivelit të dytë.

3. Arsimi i mesëm teknik, publik dhe privat, fillon:

a) pas mbarimit të arsimit bazë dhe zgjat katër vjet;

b) pas mbarimit të tri viteve të arsimit profesional dhe zgjat një vit.

Nxënësit, që mbarojnë shkollat teknike, publike dhe private, krahas dëftesës së pjekurisë, marrin edhe certifikatën e aftësimt profesional dhe teknik dhe u njihet mbarimi i shkollës së mesme dhe mundësia e vazhdimt të studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

4. Formimi profesional, publik dhe privat, zhvillohet përmes kurseve të formimit, të riformimit dhe të riaftësimt profesional, me kohëzgjatje deri në dy vjet.

## Neni 12

### **Kalimi nga një tip i arsimit dhe formimit profesional në një tjetër**

Ndërrimi i profilit dhe kalimi nga një tip i arsimit dhe formimit profesional në një tjetër bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës.

## Neni 13

### **Vlerësimi përfundimtar në arsimin dhe formimin profesional**

Vlerësimi përfundimtar i nxënësve dhe i kursantëve në arsimin dhe formimin profesional publik dhe jopublik, të akredituar, bëhet në bazë të provimeve, me pjesëmarrjen edhe të partnerëve socialë. Kriteret dhe rregullat e provimeve dhe të testeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përkatës.

## Neni 14

### **Certifikimi**

1. Sistemi i certifikimit të njohur nga shteti përfshin:
  - a) dëftesë, dëftesë përfundimi, dëftesë pjekurie, certifikatë e arsimit profesional, certifikatë e aftësisë tekniko-profesional për nxënësit;
  - b) dëshmi dhe certifikatë për kursantët.
2. Përmbajtja, forma dhe procedurat e lëshimit të dëftesave dhe të certifikatave për nxënësit përcaktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, kurse përmbajtja, forma dhe procedurat e lëshimit të dëshmive dhe të certifikatave për kursantët përcaktohen nga ministri përkatës.

## Neni 15

### **Këshillimi dhe orientimi në arsimin dhe formimin profesional**

Me këshillimin dhe orientimin në arsimin dhe formimin profesional synohet që të ndihmohen të gjithë shtetasit në zgjedhjen e arsimit, të profesionit, të formimit, të riformimit dhe të riaftësisë profesionale më të përshtatshëm për interesat dhe mundësitë fizike e mendore të tyre. Ministrinë përkatëse nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij neni.

## Neni 16

### **Dokumentimi, informacioni dhe statistikat**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale janë përgjegjëse për dokumentimin, për dhënien e informacionit dhe për mbajtjen e statistikave të arsimit dhe formimit profesional, sipas fushave përkatëse që ato mbulojnë. Të gjitha ministrinë e tjera, si dhe pushteti vendor janë të detyruar të japin informacione të këtyre dy ministrinë për veprimtarinë e arsimit dhe formimit profesional.

## Neni 17

### **Personeli në arsimin dhe formimin profesional**

1. Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional angazhohet personel mësimdhënës teorik e praktik, personel drejtues dhe personel ndihmës.
2. Personeli i mësimdhënies përbëhet nga:
  - a) mësuesit e kulturës së përgjithshme;
  - b) mësuesit e kulturës profesionale;
  - c) mësuesit e praktikave profesionale;
  - ç) instruktorët.

3. Kërkesat bazë për përgatitjen fillestare dhe kualifikimin e mësuesve (shkronjat a, b dhe c të pikës 2 të këtij neni) përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kurse për instruktorët nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

#### Neni 18 **Ndërmarrja**

Ndërmarrja shërben si vend i organizimit të kurseve të formimit nëpërmjet punës dhe si vend i realizimit të praktikave profesionale të nxënësve dhe të kursantëve. Shteti mbështet ndërmarrjet që përfshihen në sistemin e arsimit dhe formimit profesional.

#### Neni 19 **Vlerësimi i sistemit**

Mekanizmat e zhvillimit dhe të vlerësimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional përpunohen nga Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional. Vlerësimi bëhet çdo vit dhe rezultatet e tij publikohen në raportin vjetor kombëtar të arsimit dhe formimit profesional, i cili i paraqitet Këshillit të Ministrave.

### KREU III BASHKËRENDIMI I SISTEMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

#### Neni 20 **Kriteret e përgjithshme të bashkërendimit**

1. Bashkërendimi i përgjithshëm i sistemit të arsimit dhe formimit profesional publik dhe jopublik bëhet nga shteti.
2. Organizmat përgjegjës të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri janë:
  - a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për arsimimin profesional dhe të mesëm teknik;
  - b) Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, për formimin profesional;
  - c) Ministrinë dhe institucionet e tjera publike dhe jopublike, të cilat duhet të bashkërendojnë punën me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për arsimimin profesional dhe të mesëm teknik dhe me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale për formimin profesional;
  - ç) Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional.

#### Neni 21 **Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional**

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional është organizëm këshillimor. Ai i sugjeron Këshillit të Ministrave politika për zhvillimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional.
2. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional bashkëkryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.
3. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional përbëhet nga 14 anëtarë:
  - a) 2 anëtarë, përfshi ministrin, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
  - b) 2 anëtarë, përfshi ministrin, nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale;
  - c) 1 anëtar nga Ministria e Financave;
  - ç) 1 anëtar nga Ministria e Ekonomisë;
  - d) 1 anëtar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit;
  - dh) 1 anëtar nga Ministria e Shëndetësisë;
  - e) 1 anëtar nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit;
  - ë) 1 anëtar nga organizatat jofitimprurëse që zhvillojnë veprimtari në fushën e arsimit dhe formimit profesional;

f) 2 anëtarë nga organizatat e punëdhënësve;

g) 2 anëtarë nga organizatat e punëmarrësve.

4. Organizimi dhe veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional rregullohet me udhëzim të përbashkët të dy ministrave përkatës.

#### Neni 22

### **Kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në fushën e arsimit dhe formimit profesional**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

a) krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e arsimit profesional e teknik publik, që varen nga ajo, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) miraton krijimin ose riorganizimin e institucioneve jopublike, që realizojnë arsimin profesional e teknik, si dhe propozon tek organet përgjegjëse për mbylljen e tyre, kur provohet që veprimtaria e tyre nuk përputhet me aktet përkatëse nënligjore;

c) jep licencat për arsimin profesional e teknik, si dhe për kurset e formimit profesional në shkollat teknike e profesionale, për specialitetet që ato kanë, në përputhje me procedurat e vendosura nga Këshilli i Ministrave;

ç) përcakton kriteret e përgjithshme për marrjen në punë, për kualifikimin dhe për certifikimin e mësuesve në arsimin profesional e teknik;

d) përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve të arsimit profesional;

dh) merr pjesë (ose bën) në testimin dhe në certifikimin e nxënësve dhe të kursantëve në institucionet e arsimit dhe formimit profesional, që varen prej saj;

e) mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të arsimit teknik e profesional që varen nga ajo;

ë) jep leje për ushtrimin e profesionit të personave fizikë në arsimin profesional.

#### Neni 23

### **Kompetencat e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në fushën e arsimit dhe formimit profesional**

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale:

a) krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e formimit profesional në varësi të saj, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) jep licencat për kryerjen e veprimtarive të formimit profesional;

c) mbikëqyr veprimtarinë e licencuar të formimit profesional dhe e mbyll këtë veprimtari, kur nuk është në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore;

ç) siguron vazhdimësinë e formimit profesional në përputhje me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal, dhe me kërkesat e tregut të punës;

d) garanton të drejtën e individit për formimin profesional, duke lehtësuar pengesat ekonomike dhe shoqërore për vazhdimin e këtij formimi;

dh) organizon kualifikimin e vazhdueshëm të instruktorëve të formimit profesional në sektorin shtetëror;

e) përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve të formimit profesional;

ë) mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të formimit profesional që varen nga ajo;

f) merr pjesë (ose bën) në testimin dhe në certifikimin e kursantëve në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që varen prej saj.

g) jep lejet për ushtrimin e profesionit të personave fizikë në formimin profesional.



#### Neni 24

### **Kompetencat e ministrive të tjera dhe të institucioneve shtetërore të arsimit dhe formimit profesional**

Ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore të arsimit dhe formimit profesional:

- a) krijojnë, organizojnë dhe mbyllin institucionet e arsimit dhe formimit profesional që varen prej tyre, në përputhje me procedurat ligjore;
- b) përgatisin programet e formimit dhe paraqesin kurrikulat e formimit profesional në organin përgjegjës të përcaktuar me akte nënligjore;
- c) organizojnë formimin nëpërmjet punës të punonjësve të tyre dhe rikualifikimin e mësuesve dhe të instruktorëve në institucionet përkatëse;
- ç) marrin pjesë (ose bëjnë) në testimin dhe në certifikimin e nxënësve dhe të kursantëve në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që varen prej tyre;
- d) marrin pjesë në procesin e hartimit të standardeve shtetërore të kualifikimit profesional;
- dh) marrin pjesë në studime të arsimit dhe formimit profesional.

#### Neni 25

### **Kompetencat e pushtetit vendor në fushën e arsimit dhe formimit profesional**

Pushteti vendor:

- a) propozon hapjen dhe mbylljen e specialiteteve, të kurseve dhe të shkollave, në përputhje me nevojat e zhvillimit rajonal;
- b) kujdeset dhe mirëmban institucionet e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) hap kurse të formimit profesional me fondet e veta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 26

### **Kompetencat e partnerëve socialë**

Partnerët socialë:

- a) propozojnë hapjen dhe mbylljen e specialiteteve, të kurseve dhe të shkollave të reja, në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit;
- b) marrin pjesë në procesin e hartimit të standardeve kombëtare të formimit profesional;
- c) organizojnë kurse kualifikimi sipas nevojave specifike të fushave që ata mbulojnë. Certifikimi i këtyre kurseve bëhet në përputhje me procedurat e vendosura nga Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional;
- ç) marrin pjesë në komisionet e provimeve në përputhje me normat dhe procedurat e vendosura me akte nënligjore të ministrive përkatëse;
- d) ndihmojnë në zhvillimin e praktikave profesionale të nxënësve dhe të kursantëve.

#### KREU IV

### **STANDARDET DHE KURRIKULAT**

#### Neni 27

### **Lista dhe standardet e profesioneve**

1. Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me partnerët socialë, vendos një sistem të klasifikimit të profesioneve dhe të standardeve të aftësive profesionale, mbështetur në analizën e vendit të punës së popullsisë të punësuar.
2. Standardet e aftësive profesionale do të klasifikohen në nivele që të përfshijnë standardet kombëtare, industriale dhe të ndërmarrjes.

3. Lista e profesioneve dhe e standardeve të aftësive profesionale, kombëtare, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Standardet industriale dhe të ndërmarrjes do të formulohen dhe do të publikohen nga partnerët socialë.

Neni 28

### **Hartimi i kurrikulave**

1. Këshilli i Ministrave vendos standardet për zhvillimin e kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional në nivele të përshtatshme, mbështetur në rekomandimet e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional.

2. Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me partnerët socialë rishikon kurrikulat e arsimit dhe formimit profesional në vazhdimësi dhe në përputhje me zhvillimet ekonomike të vendit.

KREU V

### **FINANCIMI I SISTEMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Neni 29

### **Burimet e financimit**

Arsimi dhe formimi profesional publik financohet nga Buxheti i Shtetit, buxheti i pushtetit vendor, programet kombëtare dhe ndërkombëtare për arsimin dhe formimin profesional, kontributet e shoqatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, kontributet e dhuruesve, sponsorizimet dhe burime të tjera të lejuara nga ligji.

Neni 30

### **Vetëfinancimi**

1. Institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve mësimore, në përputhje me dispozitat ligjore.

2. Institucionet e arsimit dhe formimit profesional së bashku me qendrat e përgatitjes praktike veprojnë si njësi ekonomike për realizimin e veprimtarive prodhuese dhe të shërbimeve, duke kontraktuar me persona fizikë dhe juridikë.

3. Krahas arsimimit dhe kualifikimit profesional të nxënësve, në shkollat profesionale e teknike publike dhe jopublike kryhen edhe kurse formimi profesional, si shërbime për llogari të të tretëve.

4. Përdorimi i të ardhurave të përfuara nga këto veprimtari bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.

KREU VI

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 31

### **Shfuqizime**

1. Kreu I “Parime të përgjithshme” i ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, si dhe nenet e ligjit në fjalë, ku trajtohet arsimi profesional në kuadër të arsimit të mesëm të sistemit arsimor parauniversitar, mbeten në fuqi. Nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38, 55 pika 4 dhe 57 pika 2 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe aktet nënligjore për arsimin profesional e që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

2. Neni 5 paragrafi i dytë, neni 10 dhe neni 13 shkronjat b dhe c të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe aktet nënligjore, që lidhen me formimin profesional që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 32

### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndërsa ministrat përkatës brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 33

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Ligj nr.8872, datë 29.3.2002, shpallur me dekretin nr.3291, datë 11.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, faqe 320*

**Ligj nr.10 011, datë 30.10.2008, shpallur me dekretin nr.5930, datë 11.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 13.11.2008, faqe 8405*

### **VENDIM**

**Nr.690, datë 7.10.1996**

### **PËR KRIJIMIN, EVIDENCIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË REALIZOJNË QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL NGA SHËRBIMET QË ATO U OFROJNË TË TRETËVE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Qendrat e formimit profesional, të cilat financohen kryesisht nga buxheti i shtetit, kanë të drejtë që, krahas veprimtarisë së tyre kryesore, të kryejnë edhe veprimtari të tjera kundrejt pagesës, që specifikohen në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

2. Fitimi që krijojnë këto qendra nga shërbimet ose veprimtaritë që ato u ofrojnë të tretëve, të derdhet në një llogari të veçanë dhe jo në llogarinë ku financohen shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Në fund të çdo tremujori ministria dhe qendrat e formimit profesional rakordojnë me drejtorinë e buxhetit në Ministrinë e Financave për masën e realizimit të tij, 70% e të cilit do të mbahet nga vetë qendrat, kurse 30% do të derdhet në llogarinë e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

3. Të ardhurat mund të përdoren për investime, përmirësimin e kushteve të punës, përsosjen teknike ose për nevoja të tjera të qendrave, si dhe për shpërbimin e punonjësve. Kriteri dhe masa e përdorimit të tyre do të përcaktohen më hollësisht në udhëzimin përkatës të ministrisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Të ardhurat që do t'u mbeten qendrave dhe shpenzimet që do të përballohen nga këto të ardhura, të pasqyrohen si aneks në situacionin e shpenzimeve të buxhetit të shtetit.

5. Këtij vendimi t'i nënshtrohen të ardhurat e realizuara nga qendra që nga data 1 tetor 1996.

6. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, faqe 959*

**VENDIM**  
**Nr.411, datë 1.7.1998**

**PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË FORMIMIT PROFESIONAL TË PERSONELIT TË BURGJEVE**

Në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" dhe të nenit 4 të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 "Për policinë e burgjeve", me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e "Qendrës së formimit profesional të personelit të burgjeve", për kualifikimin e punonjësve të personelit dhe të efektivit të policisë së burgjeve.

2. Numri i punonjësve të shkollës të caktohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Ky numër të jetë brenda numrit të përgjithshëm organik, të miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

3. Shpenzimet për krijimin dhe funksionimin e kësaj shkolle mbulohen nga fondet e buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë të miratuara për vitin 1998.

4. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e akteve dhe të rregullave për funksionimin e kësaj shkolle.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare Ekstra IX, faqe 43*

**VENDIM**  
**Nr. 543, datë 31.10.2002**

**PËR AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL (AFP)**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të krijojnë Komisionin e Akreditimit të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, përbërja, organizimi dhe funksionet e të cilit të përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të të dy ministrave.

2. Komisioni vendos për akreditimin ose jo të institucioneve të AFP-së brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së kërkesës për akreditim, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm.

3. Kriteret e përgjithshme për dhënien ose jo të akreditimit janë:

a) Ligjshmëria e institucionit të AFP-së:

- dokumenti i regjistrimit si institucion i AFP-së;
- dokumenti ligjor që i jep të drejtë institucionit të përdorë truallin, ndërtesën dhe mjediset e tjera ndihmëse.

b) Menaxhimi i institucionit të AFP-së:

- struktura organizative e institucionit të AFP-së;
- përshkrimi i funksioneve për çdo njësi organizative;
- përshkrimi i punës për çdo anëtar të personelit;
- dokumenti i planifikimit të veprimtarisë së institucionit;
- rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit;
- rregullorja financiare e institucionit.

c) Përshkrimi i arsimim/formimit profesional që ofron institucioni i AFP-së:

- lista e specialiteteve të arsimit dhe formimit profesional që ofron institucioni;
- programi i përgjithshëm (skeletkurrikula) për secilin arsim/formim;
- programet e lëndëve/ moduleve për secilin arsim/formim;
- përshkrimi i nivelit të pritshëm të arritjeve të nxënësve në fund të arsim/formimit;
- llojin e dokumentit që lëshon në përfundim të arsimit/formimit.

ç) Personeli i institucionit të AFP-së:

- niveli dhe specialiteti i arsimimit, përvoja dhe kualifikimet e personelit drejtues dhe atij ndihmës;

- niveli dhe specialiteti i arsimimit, përvoja dhe kualifikimet e personelit mësimdhënës;
- numri i personelit, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme;
- struktura e pagave të personelit;
- marrëveshja me sigurimet shoqërore;
- kontratat e punës së personelit;

d) Infrastruktura e institucionit të AFP-së:

- mjediset, orënditë dhe pajisjet në funksion të personelit drejtues dhe atij ndihmës;

- mjediset, orënditë, pajisjet dhe materialet didaktike, në funksion të procesit mësimor, teorik e praktik;

- numri i nxënësve/kursantëve, në raport me mjediset mësimore;

- hapësirat e mjediseve mësimore;
- ndriçimi i mjediseve mësimore;
- masat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit;
- kushtet higjieno-sanitare.

4. Komisioni i Akreditimit angazhon grupe ekspertësh për hartimin e manualit të akreditimit të institucioneve të AFP-së, i cili përmban kriteret e akreditimit, të hollësishme nga pikpamja sasiore e cilësore.

5. Manuali i akreditimit të institucioneve të AFP-së miratohet nga Komisioni i Akreditimit.

6. Komisioni i Akreditimit mund të ngarkojë ekspertë/grupe ekspertësh për të bërë vlerësimin e institucioneve të AFP-së, që aplikojnë për akreditim.

7. Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit të Akreditimit dhe të ekspertëve të jashtëm bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Akreditimi jepet për një periudhë trevjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

9. Akreditimi hiqet kur shkelen kriteret e përcaktuara. Të drejtën për heqjen e akreditimit e ka komisioni i akreditimit.

10. Tarifa për akreditimin është 10 000 lekë.

11. Vendimi nr.354, datë 12.5.1996 i Këshillit të Ministrave "Për autorizimin dhe mbikëqyrjen e qendrave, publike e private, të formimit profesional" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.74, faqe 2068*

**VENDIM**  
**Nr. 616, datë 4.12.2002**

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË TJERA TË GRUPEVE TË VEÇANTA QË PËRFITOJNË NGA LIGJI NR. 8872, DATË 29.3.2002 "PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 5 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Grupe të veçanta, që përfitojnë nga ligji nr. 8872, datë 29.3.2002, përveç atyre të përcaktuara në nenin 5 të ligjit janë edhe:

a) personat që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura;

b) personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në proces reformimi, ristrukturimi dhe privatizimi;

c) vajzat, nëna, të papuna;

ç) vajzat dhe gratë e trafikuar;

d) gratë e divorcuara, me probleme sociale;

dh) personat që kthehen nga emigracioni me probleme ekonomike;

e) të sapodiplomuarit, të paorientuar në tregun e punës;

ë) personat që kanë vuajtur dënimin me burgim.

2. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.81, faqe 2332*

**VENDIM**  
**Nr.196, datë 20.3.2003**

**PËR STANDARDET E ZHVILLIMIT TË KURRIKULAVE TË ARSIMIT**  
**DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Strukturat e kurrikulave të kualifikimeve profesionale (profileve dhe e specialiteteve) për nivele të ndryshme, që ofrohen në shkollat teknike e profesionale, publike, si dhe në qendrat publike të formimit profesional, të jenë si më poshtë vijon:

A. Kurrikula në nivel qendror, si standard kombëtar i kualifikimit profesional përkatës, përmban:

- a) emërtimin e kualifikimit profesional;
- b) qëllimet e përgjithshme të kualifikimit profesional;
- c) përshkrimin e përgjithshëm të veçorive të kualifikimit profesional (strukturën e kualifikimit, kohëzgjatjen, vendin që zë në strukturën e kualifikimeve profesionale kombëtare, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm);
- ç) kriteret e përgjithshme të pranimin për kualifikimin përkatës;
- d) listën e njohurive, shprehive e qëndrimeve, që do të përvetësohen nga nxënësi ose kursanti gjatë periudhës së kualifikimit;
- dh) përmbajtja e përgjithshme (lëndët, temat, modulet mësimore) dhe synimet përkatëse;
- e) shpërndarja kohore për elemente të përmbajtjes;
- ë) kriteret e përgjithshme të vlerësimit të nxënësit ose kursantit, si dhe të provimeve përfundimtare dhe të pjekurisë;
- f) llojin e dëshmisë (dëftesë, diplomë, certifikatë) me të cilën pajiset nxënësi ose kursanti pas përfundimit të kualifikimit përkatës;
- g) udhëzimet e përgjithshme dhe kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të kualifikimit profesional përkatës.

B. Kurrikula në nivel shkolle ose qendre, e cila bazohet në kurrikulën e nivelit qendror përkatës, përmban:

- a) programet e hollësishme të lëndëve teorike dhe praktike ose moduleve të kualifikimit profesional përkatës, si dhe radhën e zhvillimit të tyre;
- b) objektivat e veçanta (rezultatet e pritshme) në procesin mësimor;
- c) shpërndarja kohore për elementet e hollësishme të përmbajtjeve;
- ç) mënyrat e mësimdhënies dhe format e vlerësimit të nxënësit ose kursantit;
- d) kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës porosin, financon dhe miraton kurrikulat e nivelit qendror për kualifikimet profesionale të ofruara nga shkollat teknike e profesionale, publike, në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja “A”.

3. Shkollat publike, teknike dhe profesionale, hartojnë kurrikulën në nivel shkolle, në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja “B”. Verifikimi dhe miratimi i kurrikulës bëhet nga një bord këshillimor, me specialistë të zgjedhur nga drejtoria arsimore dhe drejtoria e shkollës.

4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale porosin, financon dhe miraton kurrikulat e nivelit qendror të kualifikimeve profesionale, që ofrojnë qendrat publike të formimit profesional, në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja “A”.

5. Qendrat publike të formimit profesional hartojnë kurrikulën në nivel qendre në përputhje me strukturën e paraqitur në pikën 1 shkronja “B”. Verifikimi dhe miratimi i kurrikulës bëhet nga një bord këshillimor, me specialistë të zgjedhur nga drejtoria arsimore dhe drejtoria e qendrës.

6. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale mund të bëjnë rishikimin e kurrikulave përkatëse, të nivelit qendror për t’iu përgjigjur ndryshimeve të profesioneve.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.23, faqe 730*

## VENDIM

**Nr.675, datë 25.9.2003**

### **PËR PËRCAKTIMIN E POCEDURAVE TË KRIJIMIT, ORGANIZIMIT DHE MBYLLJES SË INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL, NË VARËSI TË MINISTRISË SË PUNËS DHE TË ÇËSHTJEVE SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a” të nenit 23 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Krijimi, riorganizimi dhe mbyllja e institucioneve të formimit profesional në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, të bëhet me urdhër të Ministrisë.

2. Institucionet e formimit profesional krijohen:

- mbi bazën e kërkesës së tregut të punës;
- kur ndryshojnë kushtet dhe kualifikimi për kategori të caktuara punësh;
- kur investimet e reja apo zbatimi i teknologjive bashkëkohore duhet të realizohet nga punonjës të kualifikuar;

- në raste të tjera, në varësi të politikave të punësimit.

3. Institucionet e formimit profesional riorganizohen:

- për shkak të përmbushjes së disa qëllimeve dhe shtimit të disa qëllimeve të tjera formuese;
- kur lind nevoja e një bashkëpunimi të ngushtë me institucionin e arsimit profesional për rritjen e frytshmërisë së përdorimit të infrastrukturës së arsimit dhe formimit profesional;

- mbi bazën e studimeve, nga të cilat rezulton se riorganizimi sjell përdorim racional të personelit, shfrytëzim efektiv të mjediseve dhe përvetësim maksimal gjatë procesit të formimit profesional;

- për shkak të domosdoshmërisë së një bashkëpunimi të ri me subjekte të tjera shtetërore ose private, në dobi të një formimi aktiv, nëpërmjet praktikave në ndërmarrje, institucione apo në qendra të ndryshme pune;

- me kërkesë të organeve të njëjësive të qeverisjes vendore, mbi bazën e studimeve të argumentuara;

- mbi bazën e kërkesës së banorëve të zonës, ku ushtrojnë veprimtarinë, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme dhe me struktura të reformuara;

- në çdo rast tjetër, në kuadër të zbatimit të reformave në fushën e politikave të punësimit.



4. Me urdhrin e krijimit ose të riorganizimit të këtyre institucioneve miratohet dhe statuti i tyre, i cili duhet të jetë në përputhje me statutin tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Institucionet e formimit profesional mbylLEN kur:

- kanë përmbushur qëllimin për të cilin janë krijuar ose kur nuk përmbushin asnjë qëllim;
- dendësia e institucioneve të formimit profesional në rajon është e madhe dhe funksionimi i institucionit të formimit profesional publik është i panevojshëm;
- frekuentimi i kurseve është i papërfillshëm;
- shpenzimet buxhetore për mbajtjen e institucionit janë të pajustificueshme;
- banorët e zonës ku ushtron veprimtarinë institucioni nuk shprehin asnjë interes për të përfituar nga shërbimet që ofrohen aty;
- nga politikat përkatëse të formimit profesional rezulton se institucioni duhet transferuar në një zonë tjetër për ushtrimin e veprimtarisë.

6. Në urdhrin ku përcaktohet mbyllja e një institucioni të formimit profesional parashikohen edhe trajtimi i punonjësve të institucionit që dalin të papunë dhe destinacioni i mjeteve, monetare e materiale, në përfundim të likuidimit përkatës.

7. Qendrat e formimit profesional, të cilat funksionojnë para hyrjes në fuqi të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të riorganizohen dhe funksionojnë mbi bazën e statuteve të miratuara në përputhje me statutin tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Vendimi nr.306, datë 21.6.1993 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin e sistemit të formimit profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.89, faqe 3908*

**STATUT-TIP**  
**I INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL, NË VARËSI TË MINISTRISË SË**  
**PUNËS DHE TË ÇËSHTJEVE SOCIALE**

Në mbështetje të.....

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Institucionet e formimit profesional kanë për qëllim të ofrojnë formim dhe kualifikim profesional të personave, në mbështetje të politikave të përgjithshme shtetërore dhe në dobi të punësimit të zgjedhur lirisht, si dhe këshillim e orientim profesional.

**Neni 2**  
**Pozita juridike**

1. Institucionet e formimit profesional janë persona juridikë publikë, në varësi të Ministrisë të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe nuk ushtrjnë veprimtari fitimprurëse.

2. Institucionet e formimit profesional gëzojnë privilegjet dhe lehtësirat e parashikuara në legjisllacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse.

Neni 3  
**Emërtimi dhe selia**

Krijohet ....., si institucion i formimit profesional, në varësi të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale. Ky institucion vepron brenda territorit të..... dhe ka selinë në.....

Neni 4  
**Kapitali fillestar dhe mjetet materiale**

Kapitali fillestar i institucionit është..... Institucionit i jepen në përdorim mjediset.....

Neni 5  
**Marrëdhëniet me institucionet e tjera shtetërore**

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në fushën e punësimit mbështesin dhe nxisin veprimtarinë e krijimit të kapaciteteve për formim profesional nëpërmjet zhvillimit dhe zgjerimit të sistemit të formimit profesional publik.

2. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, nëpërmjet institucioneve të formimit profesional, zbaton politikën shtetërore të formimit profesional.

3. Institucionet e formimit profesional bashkëpunojnë me institucionet e arsimit profesional, zyrat e punësimit, me organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, me universitetet, me INSTAT-in etj., për problemet e formimit profesional në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë për hartimin e kurrikulave, standardeve të profesioneve, trajtimin e personelit, realizimin e këshillimit dhe orientimit profesional.

**KREU II**  
**VEPRIMTARIA E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL**

Neni 6  
**Kursantët**

1. Kursantë janë personat që kanë mbaruar arsimin shkollor të detyrueshëm dhe që dëshirojnë të formohen profesionalisht.

2. Kanë përparësi në pranimin si kursantë ata persona që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura, personat që dalin të papunë nga ndërmarrjet dhe institucionet në procesin e reformimit, ristrukturimit dhe privatizimit, vajzat dhe nënat e papuna, nënat me shumë fëmijë, vajzat dhe gratë e trafikuar, gratë e divorcuara e me probleme sociale, personat me aftësi të kufizuara, personat nga familje nën nivelin e varfërisë, personat që kthehen nga emigracioni e me probleme ekonomike, të sapodiplomuarit, si dhe personat që kanë vuajtur dënimin me burg.

Neni 7  
**Procedura e regjistrimit, vlerësimit dhe certifikimit**

Procedurat e regjistrimit, vlerësimit përfundimtar dhe mënyra e certifikimit të kursantëve në institucionet e formimit profesional përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Neni 8  
**Hapja e kurseve të reja**

Institucionet e formimit profesional hapin kurse:  
- në përputhje me kërkesën e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në zbatim të politikave shtetërore;  
- në përputhje me nevojat imediate të tregut të punës.

Neni 9  
**Tarifat e kurseve të formimit profesional**

Institucionet e formimit profesional ofrojnë kurse me tarifa të favorizuara ose pa pagesë, në zbatim të politikave shtetërore të nxitjes së punësimit, sipas përcaktimit të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, për punëkërkuar të papunë dhe për shtresa të popullsisë në nevojë, që trajtohen nga zyrat e punësimit dhe kurse kundrejt pagesës, për personat e tjerë që kërkojnë të marrin pjesë në to.

Neni 10  
**Veprimtaritë e shërbimit dhe të prodhimit**

1. Institucionet e formimit profesional kanë të drejtë të zhvillojnë çdo lloj veprimtarie në funksion të formimit profesional të kursantëve. Ato mund të kryejnë edhe shërbime ose veprimtari prodhuese me përfitime financiare, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimin e institucionit për realizimin e programeve të formimit profesional dhe të mos përbëjë qëllim në vetvete.

2. Këto institucione bashkë me qendrat e përgatitjes praktike veprojnë si njësi ekonomike për realizimin e veprimtarive prodhuese dhe të shërbimeve, duke kontraktuar me persona fizikë ose juridikë.

3. Të ardhurat e krijuara nga këto veprimtari përdoren për mbulimin e nevojave të këtyre institucioneve dhe zgjerimin e veprimtarisë së tyre.

**KREU III**  
**ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL**

Neni 11  
**Organet drejtuese**

Organet drejtuese të institucioneve të formimit profesional janë:  
- këshilli drejtues;  
- drejtori.

Neni 12  
**Përbërja e këshillit drejtues**

1. Këshilli drejtues është organ kolegjal që realizon drejtimin e veprimtarisë së institucionit të formimit profesional. Në institucionet e mëdha ky këshill ka në përbërje jo më shumë se 6 anëtarë, ndërsa në institucionet e vogla jo më shumë se 4 anëtarë.

2. Anëtarët e këshillit drejtues të institucionit të formimit profesional emërohen nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe propozohen nga institucionet: një përfaqësues nga zyra e punës, një përfaqësues nga bashkia, një përfaqësues nga dhoma e tregtisë dhe e industrisë, një përfaqësues nga punëdhënësit dhe një nga punëmarrësit. Drejtori i institucionit të formimit profesional është anëtar i këshillit drejtues.

3. Anëtarët e këshillit drejtues shpërblehen me 20% të pagës së drejtorit të institucionit.

## Neni 13

### **Mbledhjet e këshillit drejtues**

1. Këshilli drejtues thirret me kërkesë të drejtorit ose të shumicës së anëtarëve. Këshilli mbledhet sa herë e kërkon interesi i institucionit, por jo më pak se një herë në muaj.

2. Këshilli merr vendim me shumicë votash, në praninë e shumicës së anëtarëve. Në rast barazie votash, përcaktuese është vota e drejtorit.

3. Procedurat e thirrjes, të mbledhjes dhe të votimit të këshillit përcaktohen në rregulloren e këshillit, e cila miratohet nga vetë këshilli.

## Neni 14

### **Kompetencat e këshillit drejtues**

Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

- miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit;
- miraton strukturën organizative dhe përcakton numrin e punonjësve për veprimtarinë e përhershme;
- përcakton tarifat për kurse dhe kapacitetin maksimal të tyre, nisur nga kërkesat e tregut, si dhe mbi bazën e grupeve të veçanta të kursantëve;
- përcakton tarifat e shërbimeve dhe çmimet e mallrave që ofron;
- miraton programin ekonomik-financiar;
- miraton llogaritë vjetore dhe raportin vjetor të veprimtarisë ekonomike të institucionit;
- përcakton pagat sipas funksioneve, indeksimin, rritjen e tyre, si dhe shpërblimet;
- përcaktimin e kritereve të marrjes në punë, të punonjësve të përhershëm dhe të instruktorëve;
- përcaktimin e pagave për instruktorët e brendshëm dhe të honorareve për instruktorët e jashtëm;
- shqyrtimin dhe miratimin paraprak të kontratave që lidhen me të tretët.

## Neni 15

### **Pozita juridike e drejtorit**

1. Drejtori përzgjidhet me konkurs publik, i cili organizohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale lidh kontratë pune me fituesin e konkursit për pozicionin e drejtorit të institucionit. Afati i kontratës është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje vetëm një herë.

2. Drejtori është përfaqësues ligjor i institucionit me të tretët dhe nënshkruan në emër dhe për llogari të institucionit.

3. Paga e drejtorit përcaktohet nga Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, me referencë strukturën dhe nivelin e pagave në institucionet buxhetore për pozicione dhe institucione analoge, si dhe mbi bazën e arritjeve në detyrë. Paga e drejtorit ndryshon (rritet) sa herë ndryshojnë (rriten) pagat në shkallë vendi.

## Neni 16

### **Kompetencat e drejtorit**

Drejtori ka këto kompetenca:

- administron veprimtarinë e institucionit;
- harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së institucionit dhe ia paraqet për miratim këshillit drejtues;
- harton planin vjetor të veprimtarisë formuese të institucionit;
- i paraqet këshillit drejtues buxhetin dhe programin për realizimin e çdo veprimtarie para fillimit të saj, në funksion të përmbushjes së programit të punës;

- harton dhe i paraqet për miratim këshillit drejtues bilancin e institucionit;
- përgjigjet për shpenzimet e bëra me buxhetin e institucionit, në përputhje me objektivat dhe qëllimin e funksionimit të institucionit;
- harton dhe zbaton procedurat e punësimit të personelit, duke përdorur konkurrimin publik, për çdo vend pune;
- bashkërendon punën me këshillin drejtues për të zbatuar me sukses politikatat shtetërore dhe strategjinë e formimit profesional;
- bashkëpunon me donatorë vendas dhe të huaj për të siguruar fonde për institucionin;
- krijon, zhvillon dhe ruan lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional dhe të institucioneve të tjera që lidhen me këtë fushë;
- koordinon veprimet për mbështetjen e kurseve të formimit, si dhe të shërbimeve të tjera e të prodhimit në dobi të kurseve;
- mbështet veprimtaritë që lidhen me trajnimin e personelit, hartimin e kurrikulave të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, si dhe këshillimin e orientimin e kursantëve;
- analizon dhe vlerëson studimet e bëra për tregun e punës dhe hapjen e kurseve të reja në rajonin ku vepron institucioni i tij dhe merr masa për zbatimin e studimeve të vlefshme.

#### KREU IV TË ARDHURAT DHE VEPRIMTARIA EKONOMIKE E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL

##### Neni 17

##### **Burimet e financimit**

- Burimet e financimit të institucioneve të formimit profesional përbëhen nga:
- fondet nga Buxheti i Shtetit ose nga qeverisja vendore për formimin profesional;
  - fondet nga programet kombëtare ose ndërkombëtare;
  - të ardhurat që krijohen nga vetë institucioni;
  - fondet, grantet ose dhurimet e ndryshme nga subjekte publike, private, vendase ose të huaja;
  - kontributet e shoqatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, sponsorizimet e ndryshme;
  - si dhe fonde nga burime të tjera të lejuara nga ligji.

##### Neni 18

##### **Transferimi i fondeve buxhetore**

1. Fondet nga Buxheti i Shtetit, të parashikuara në buxhetin vjetor të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për formimin profesional publik transferohen në fillim të çdo 4-mujori në llogarinë rrjedhëse të institucioneve të formimit profesional publik dhe bashkë me të ardhurat nga veprimtaritë e tjera të tyre ose me dhurimet e kontributet e tjera përbëjnë llogarinë aktive të këtyre institucioneve.
2. Institucionet e formimit profesional publik marrin fonde nga Buxheti i Shtetit në raport me kapacitetet për trajnim të kurseve të profesioneve. Zyrat përkatëse të punësimit dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit saktësojnë dhe vlerësojnë çdo vit, për vitin pasardhës, kontigjentet e kursantëve, punëkërkues të papunë, të parashikuara për formimin profesional. Llogaritja e financimit bëhet mbi bazën e kostove të plota të formimit profesional për çdo kursant. Kjo bazë llogaritjeje përbën dhe financimin shtetëror të institucionit në rajonin respektiv. Zyrat përkatëse të punësimit detyrohen të plotësojnë me kursantë kapacitetet e kurseve të profesioneve.

## Neni 19

### **Programi ekonomik e financiar**

1. Institucionet e formimit profesional publik përcaktojnë programin ekonomik e financiar dhe marrin vendime për zbatimin e tij. Në këtë program përfshijnë në mënyrë të posaçme fondet shtetërore dhe përgjigjen për realizimin e tyre kundrejt Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

2. Institucionet e formimit profesional publik sigurojnë ekuilibrin e tyre financiar nëpërmjet fondeve që akordohen nga Buxheti i Shtetit për formimin profesional, nga të ardhurat që krijojnë vetë nga shitja e shërbimeve dhe mallrave, nga dhurimet e subjekteve vendase ose të huaja, si dhe nga kontributet.

3. Institucionet e formimit profesional publik kanë të drejtë të marrin pjesë në çdo veprimtari të formimit profesional si: sipërmarrja, tenderime, prokurime të granteve të organizuara nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si dhe nga subjekte të ndryshme shtetërore ose private, vendase apo të huaja. Këto institucione mund të kontraktojnë, shesin apo blejnë shërbime të formimit profesional dhe shërbime e mallra, që realizohen gjatë procesit të formimit profesional të kursantëve ose që kërkohen nga ky proces. Çdo institucion mund të transferojë shërbimet e tij, kabinetet, pajisjet dhe mjetet e nevojshme didaktike në institucione të tjera e duke koordinuar këtë veprimtari me Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

## Neni 20

### **Raportimi i treguesve dhe të dhënave**

Institucionet e formimit profesional publik mbajnë kontabilitet, përgatisin e paraqesin llogaritë vjetore dhe raportojnë periodikisht treguesit dhe të dhënat statistikore, sipas dispozitave ligjore.

## Neni 21

### **Kontrolli i veprimtarisë së institucioneve dhe verifikimi i llogarive**

Veprimtaria e institucioneve të formimit profesional publik dhe llogaritë vjetore të tyre kontrollohen dhe nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Ky kontroll është i pavarur nga kontrollat e parashikuara në dispozitat e tjera ligjore dhe nuk i zëvendëson ato.

## Neni 22

### **Raporti vjetor i veprimtarisë**

1. Drejtori i institucionit të formimit publik i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, periodikisht çdo vit, raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit pas shqyrtimit e miratimit të tij në këshillin drejtues.

2. Raporti vjetor i veprimtarisë ekonomike e financiare u bëhet i njohur punonjësve.

## Neni 23

### **Përdorimi i të ardhurave**

Të ardhurat e institucionit të formimit profesional publik, pas realizimit të veprimtarisë vjetore, përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë së tyre.

KREU V  
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24  
**Çështje të veçanta**

Çështje të veçanta, të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga ky statut-tip, përcaktohen në varësi të pozitës së institucionit, në statutin e posaçëm dhe në rregulloren e veprimtarisë së tij.

Neni 25  
**Veprimi në kohë**

Ky statut shtrin veprimin e tij mbi çdo institucion të formimit profesional publik, në varësi të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, që është krijuar para hyrjes së tij në fuqi.

**VENDIM**  
**Nr.808, datë 4.12.2003**

**PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.736, datë 1.7.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 6 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi fizik, që ushtron profesionin e manovruesit të makinerive të rënda të ndërtimit, duhet të jetë i pajisur me dëshmi aftësie.
2. Shfuqizohet
3. a) Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shfrytëzimit të Transportit Rrugor të ngrihet komisioni i posaçëm për dhënien e dëshmisë së aftësisë, për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit.
- b) Kushtet dhe kriteret për dhënien e dëshmisë së aftësisë përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit përcaktohen në rregulloren, që do të hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe do të miratohet nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
4. Kursët teorike e praktike, për përgatitjen e manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike private, që plotësojnë kushtet e parashikuara në rregulloren e përmendur në shkronjën "b" të pikës 3 të këtij vendimi.
5. Shfuqizohet.
6. Përdorimi i makinerive të rënda pa dëshminë e aftësisë përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik në ndërtim.
7. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, faqe 4360*

*Vendim i KM nr.736, datë 1.7.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.116 datë 31.7.2009, faqe 5588*

**UDHËZIM**  
**Nr.6, datë 14.3.2003**

**PËR REGJISTRIMIN E INSTITUCIONEVE TË AFP-SË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",

**UDHËZOJMË:**

1. Institucionet, të cilat ofrojnë arsim dhe formim profesional, i nënshtrohen procesit të regjistrimit dhe përkatësisht për arsimin profesional në drejtoritë arsimore të rrethit përkatës dhe për formim profesional në zyrat e punësimit të rrethit përkatës. Procesi i licencimit bëhet përkatësisht në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

2. Këto institucione duhet të paraqesin në drejtoritë arsimore të rrethit përkatës (ku do të ushtrojnë aktivitetin) apo në zyrat e punësimit të rrethit përkatës (ku do të ushtrojnë aktivitetin) dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë
- Përshkrim i aktivitetit të arsim/formimit profesional

3. Drejtoritë arsimore të rretheve përkatëse dhe zyrat e punësimit të rretheve përkatëse mbajnë regjistrat e regjistrimit dhe lëshojnë vërtetim për regjistrimin sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Drejtoritë arsimore dhe zyrat e punësimit dërgojnë në ministritë përkatëse informacion mujor mbi numrin e institucioneve të regjistruara.

5. Inspektorati Shtetëtor i Punës dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ushtrojnë kontroll për procesin e regjistrimit dhe licencimit.

6. Procesi i regjistrimit nuk presupozon miratimin e programeve mësimore dhe atyre të formimit profesional.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I ARSIMIT DHE I SHKENCËS**

**LUAN MEMUSHI**

**MINISTRE E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE  
SOCIALE**

**VALENTINA LESKAJ**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.79, faqe 3544*

**UDHËZIM**  
**Nr.17, datë 1.9.2003**

**PËR PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONET E KOMISIONIT TË  
AKREDITIMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të vendimit nr.543, datë 31.10.2002 të Këshillit të Ministrave "Për akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional (AFP)"

**UDHËZOJMË:**

1. Komisioni i akreditimit të arsimit dhe formimit profesional ka në përbërje të tij:
- dy përfaqësues nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale;



- dy përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

2. Komisioni kryesohet me rotacion një vit nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe një vit nga përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Përfaqësuesit e secilës ministri, si dhe ai në rolin e kryesuesit përcaktohen nga ministrat përkatës, nga nëpunës civilë që mbulojnë përkatësisht fushën e formimit dhe të arsimit profesional.

3. Komisioni thirret nga kryesuesi me njoftim me shkrim, në të cilin përcaktohet data, ora, vendi i mbledhjes dhe rendi i ditës. Komisioni mblidhet të paktën një herë në muaj dhe në rast nevojë e urgjence menjëherë.

4. Komisioni i akreditimit merr vendim, pasi shqyrton materialin e paraqitur nga institucioni kërkues për t'u akredituar dhe pasi dëgjon relacionin vlerësues të ekspertëve për institucionin. Në përfundim të shqyrtimit Komisioni i akreditimit shprehet për:

- dhënien e akreditimit;
- mosakreditimin;
- plotësim të metash;
- shtyrje për shqyrtim të mëvonshëm.

Në çdo rast vendimi i Komisionit të jetë i arsyetuar dhe i bazuar ligjërisht. Komisioni merr vendim me shumicën e votave, kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve. Në rast barazie votash, përcaktuese është vota e kryetarit të Komisionit.

5. Komisioni i akreditimit ndihmohet nga një sekretari teknike, që përbëhet nga dy specialistë, njëri që mbulon formimin profesional dhe tjetri që mbulon arsimin profesional në ministrinë përkatëse.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi secili ministër përcakton përfaqësuesit e ministrisë. Vitin e parë të funksionimit Kryetari i komisionit caktohet me short nga dy përfaqësuesit, që janë përcaktuar për një funksion të tillë nga ministrat përkatës.

7. Mbledhja e parë e Komisionit mbahet brenda 10 ditëve nga caktimi i përfaqësuesve të ministrive.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE I  
SHKENCËS

**Luan Memushi**

MINISTRE E PUNËS DHE E ÇËSHTJEVE  
SOCIALE

**Valentina Leskaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.79, faqe 3544*

## URDHËR

Nr. 47, datë 29.3.2010

### **PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROGRAMET PËR PËRGATITJEN TEORIKE-PRAKTIKE TË KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE PËR PËRDORUESIT E MAKINERIVE TË RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE TOKE, SI DHE DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 2,b të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.808, datë 4.12.2003 “Për dhënien e lejeve të manovrimit të përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimit në tokë”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e

makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
Sokol Oldashi

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.44, datë 20.4.2010, faqe 1652*

## **RREGULLORE**

**PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROGRAMET PËR PËRGATITJEN TEORIKO-PRAKTIKE TË KANDIDATËVE, SI DHE DHËNIEN E DËSHMISË SË AFTËSISË PROFESIONALE PËR PËRDORUESIT E MAKINERIVE TË RËNDA PËR PUNIME NDËRTIMI DHE TOKE, SI DHE DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT**

### **KREU I**

**QËLLIMI, OBJEKTI I RREGULLORES DHE FUSHA E VEPRIMIT**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi i rregullores**

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen mbi baza unike e ligjore të aktivitetit, administrimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimin dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre në zbatim të rregullave të sigurimit teknik.

#### **Neni 2**

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe shtrirjen e fushës së veprimit të saj në:

1. Kërkesën që duhet të plotësojë personi fizik (individ), i cili kërkon të pajiset me dëshminë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë, në përvetësimin e kurseve teorike e praktike që kryhen nga subjekte juridike private, si dhe organizimi i komisionit të marrjes në provim.

2. Vendosjen e rregullave të administrimit, organizimit dhe përdorimit të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë nga subjekte ose persona që i kanë në pronësi ose me qira.

#### **3. Përkufizime**

a) “Dëshmia e aftësisë profesionale” (DAP)- dokument që provon se personi zotëron njohuri të mjaftueshme teoriko – praktike për përdorimin e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë, ku hyjnë të gjitha makineritë teknologjike, të cilat janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë.

b) “Subjekti juridik privat”- që mund të jenë person juridik, subjekte juridike private ose subjekte ndërtuese, apo ente, të aftë që plotësojnë kushtet për të kryer zhvillimin e mësimave teoriko - praktike, me qëllim kualifikimin e përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit, të cilët duhet të jenë të pajisur me licencë sipas nenit 5 të kësaj rregullore.

c) “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor” (DPSHTRR) është organi që jep dëshminë e aftësisë profesionale (DAP), nëpërmjet një komisioni të posaçëm me inxhinier mekanik të Drejtorisë së Kualifikim-Testimit.

## KREU II E DREJTA DHE KUSHTET E VEPRIMTARISË SË SUBJEKTIT PRIVAT

### Neni 3

Subjekti juridik privat do të shërbejë për të kryer zhvillimin e kurseve të trajnimit të vazhdueshëm teoriko-praktikë, të aplikantëve që dëshirojnë të pajisen me dëshminë e aftësisë profesionale (DAP), si përdorues të makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë.

Veprimtaria e subjektit privat është tërësia e funksionimit në zhvillimin e kurseve teoriko-praktike, në të gjitha komponentët bazë, që përfshijnë:

1. ambientet për zhvillimin e mësimdhënies së kursit teorik;
2. mjetet për kursin praktik;
3. mësuesit dhe instruktorët;
4. Të kenë, në pronësi ose me qira, makineri të rënda ndërtimi me tipat sipas nenit 6 të kësaj rregullore, respektivisht sipas kursit të trajnimit që do të zhvillojnë.

Subjekti privat, gjatë kryerjes së tij, duhet të mbajë dhe plotësojë rregullisht e me vërtetësi këto dokumente:

1. Regjistrin e evidentimit të aplikantëve për përdorues së makinerive të rënda të ndërtimit (amza).
2. Regjistrin e zhvillimit të kursit teorik në klasë, dhe atij praktik.

### Neni 4

Drejtnesit teknikë të subjekteve private janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e përdorimit të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, në funksion të përgatitjes e kualifikimit profesional nëpërmjet kurseve teoriko-praktike të personelit përdorues të tyre.

### Neni 5

1. Përgatitja teorike dhe praktike e përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit zhvillohet pranë subjekteve private, të cilave detyrimisht u kërkohet licencimi për këtë qëllim.

2. Licencimi i subjekteve private bëhet përpara se të fillojnë ushtrimin e kursit teoriko-praktik nga Drejtoria e Kualifikim-Testimit pranë DPSHTRR-së.

3. Subjektet juridike private licencohen duke plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 121, pikat 2, 5 dhe 7, të Kodit Rrugor dhe nenin 313, pika 3, të rregullores në zbatim të Kodit.

4. Licenca pezullohet dhe anulohet nga organi që e ka lëshuar, sipas nenit 121 pika 8 dhe 9 të Kodit Rrugor, si dhe rregullores në zbatim të tij.

5. Trajnimi në kursin teoriko-praktik kryhet nga inxhinier mekanik ose specialistë të specializuar që janë të punësuar pranë subjekteve private, për përvetësimin e njohurive të plota teoriko-praktike në funksionimin e këtyre makinerive, për rreziqet në punë dhe masat e sigurimit teknik për evitimin e tyre.

6. Subjektet private referuar pikës 1 të këtij neni, dorëzojnë listat me emrat e aplikantëve që kanë përfunduar kursin e plotë teoriko-praktik, pranë drejtorive rajonale të shërbimit të transportit rrugor, ku kanë vendbanimin e tyre.

**KREU III**  
**KRITERET PËR KLASIFIKIMIN DHE EMËRTIMIN E MJETEVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT**  
**DHE PUNIMIT TË TOKËS DHE LËSHIMIT SI DËSHMI AFTËSIE PROFESIONALE (DAP)**

**Neni 6**

Në kuptimin e kësaj rregullore, makineritë e ndërtimit ndahen në dy grupe, si:

1. Makineri të rënda të punimeve të ndërtimit, që përfshijnë grupin e makinerive që paraqesin vështirësi të larta teknologjike e teknike në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
2. Makineri të tjera ndërtimi, që përfshijnë të gjitha llojet e makinerive të ndërtimit e të prodhimit të materialeve të ndërtimit, të cilat nuk përfshihen në grupin e parë.

**Neni 7**

1. Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas dëshmive të aftësive profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a) Makineri gjurmimi e ngarkimi dherash: - vetëshkarkues, ngarkues-transportues, ekskavatorë, ekskavatorë të kombinuar me pajisje shtesë, lopata ngarkuese (me goma dhe me zinxhirë). Manovratorëve u jepet dëshmi për ekskavatoristë.

b) Makineri gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash: buldozerë, traktorë, skreper, greidera (nivelues), rulo kompresorë, shtruese asfalto-betoni(me goma dhe me zinxhirë). Manovratorëve u jepet dëshmi për buldozeristë.

c) Makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda. Manovratorëve u jepet dëshmi për automakinistë.

2. Përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit me rrota gome, përveç dëshmisë së aftësisë profesionale, duhet të jetë pajisur detyrimisht edhe me lejedrejtimi (patentë) automjetesh, të lëshuar nga DPSHTRR-ja, konform nenit 122 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**KREU IV**  
**ORGANIZIMI I TRAJNIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**

**Neni 8**

**Zhvillimi i kursit teorik**

Ambientet e subjektit privat (klasat), për zhvillimin e mësimit teorik, duhet të plotësojnë të gjitha kushtet me këto të dhëna, si:

1. Të ketë ambient të mjaftueshëm dhe funksional me kapacitet jo më pak se 10 vende, i kompletuar me tavolina dhe ndenjës të përshtatshme me hapësira optimale, si dhe të ketë vend për mësuesin e kursit teorik.

2. Të ketë ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm, si dhe ambiente hidrosanitare me parametra standarde dhe me ujë të vazhdueshëm.

3. Të ketë pajisje didaktike të ndryshme për demonstrimin e manovrimeve nga përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, ku këto njohuri të jenë fituar gjatë periudhës së kryerjes së kursit teorik, si:

a) Tabelë shkrimi, stenda apo makete, pllakata etj., për demonstrimin e manovrimeve nga përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit në kushtet e një kryqëzimi ose rrethrotullimi në rrugë qytetëse, kantiere ose joqytetëse.

b) Tabela me figura të ndryshme të tipave për makineritë e rënda ndërtimi, si: vetëshkarkues, ngarkues-transportues, autobetonjere, buldozer, automakineri-shpimi, ekskavator me zinxhirë, ekskavator me zinxhirë hidraulikë për hapje kanalesh, autoskreper për punime rrugësh, makinë niveluese, rul vibrues, automakineri betonshtuese, automakineri asfaltuese etj.

c) Makete makinerish ndërtimi të ndryshme, të zërthyera në pjesë të veçanta, modele agregatesh apo nyje të zërthyera nga mjete origjinale të sistemeve të ndryshme kryesore të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë.

d) Subjekti privat duhet të pajisë klasat e mësimit teorik me mjete audiovizive për ta bërë më të kuptueshëm dhe konkret demonstrimin e programit, si dhe dy kompjutera për qëllim mësimi të kandidatëve.

4. Koha e mësimeve për kursin teorik duhet të jetë 16 orë, pra 8 ditë nga 2 (orë), të cilat duhet të zhvillohen brenda ditës.

5. Plotësimi i regjistrit përkatës me aplikantët që kanë zhvilluar kursin e plotë teorik bëhet nga mësuesi i teorisë i subjektit privat.

## Neni 9

### Zhvillimi i kursit praktik

1. Subjektet juridike private duhet të kenë në pronësi ose me qira, makineri të ndryshme ndërtimi dhe punimeve në tokë, të përshtatshme, që plotësojnë kushtet për kursin praktik të aplikantëve që do të pajisen me dëshminë e aftësisë profesionale, si përdorues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

2. Makineritë e rënda të ndërtimit që plotësojnë kriteret, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisura nga drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor me autorizimin përkatës për “Mësimore”, të specializuara në zhvillimin e kursit praktik për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, si dhe të jenë të evidentuara në regjistrin përkatës të drejtorisë rajonale sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

3. Aplikantët duhet të kryejnë kursin praktik me makineri të rënda ndërtimi dhe punimeve në tokë, sipas përkufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim të Kodit Rrugor.

4. Për çdo subjekt privat, instruktori i praktikës duhet të jetë i pajisur me dëshminë e manovratorit me vjetërsi pune mbi 5 vjet, si dhe me lejen e drejtimit të kategorisë “C”.

5. Përgatitja praktike e aplikantëve do të bëhet si më poshtë:

a) fillimisht në fushë, rrugë e mjedise të pabanuara, ku nuk ka lëvizje të dendura;

b) në rrugë jashtë qyteteve e qendrave të banuara, ditën dhe natën;

c) në rrugë jo të rëndësishme, brenda qyteteve dhe me dendësi të madhe lëvizjeje, ditën dhe natën.

6. Koha e përgatitjes për kursin praktik, për çdo kandidat të jetë 8 (orë), pra 1(një) orë në ditë, i cili duhet të zhvillohet pas mësimit teorik.

7. Numri maksimal i aplikantëve që lejohen të stërviten në një cikël me një mjet (makineri të rënda ndërtimi) dhe një instruktor, për çdo lloj makinerie, nuk duhet të jetë më shumë se 8 veta.

8. Makineritë e rënda të ndërtimit vetëlëvizëse me goma, duhet të jenë me pamje të jashtme të rregullta dhe në gjendje të mirë teknike, të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik dhe të regjistruara me lejeqarkullimi pranë drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor.

## Neni 10

Për të provuar aftësitë profesionale të manovratorëve të makinerive të rënda të ndërtimit, që apikojnë për të marrë dëshmi aftësie profesionale, ngrihet një komision i posaçëm pranë DPSHTRR-së, me inxhinierë mekanikë transporti të Drejtorisë së Kualifikimit dhe Testimit, të cilët kanë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për marrjen në testim për makineritë e rënda të ndërtimit.

**KREU V**  
**REGJISTRIMI DHE ORGANIZIMI I TESTIMIT**

**Neni 11**  
**Regjistrimi i aplikantëve**

1. Aplikantët regjistrohen nëpërmjet subjektit privat pranë zyrave të pranimit në drejtoritë rajonale të shërbimit të transportit rrugor, sipas vendbanimit të tij.
2. Çdo aplikant duhet të ketë në dosjen e tij të plotësuar autorizimin përkatës të lëshuar nga DRSHTRR-ja, që i është bashkëngjitur kësaj rregulloreje, përpara se të fillojë kursin teorik e praktik duke paraqitur dhe këto dokumente:
  - certifikatë personale me foto dhe 4 fotografi 4.2 x 3.5;
  - fotokopje e letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
  - vërtetim banimi;
  - fotokopje e lejes së drejtimit në rast se e disponon.
3. Aplikanti, i cili do të regjistrohet, duhet të ketë mbushur moshën 21 vjeç.
4. Pas përfundimit të plotë të kursit teoriko – praktik që ka zhvilluar aplikanti pranë një subjekti privat që plotëson kriteret sipas pikës 1, neni 5, përgjegjësi i subjektit privat dorëzon në drejtorinë rajonale, brenda një jave, dosjen me dokumentacionin përkatës që vërteton përfundimin e kursit teoriko – praktik.
5. Drejtoritë rajonale të shërbimit të transportit rrugor i dërgojnë Drejtorisë së Kualifikim – Testimit pranë DPSHTRR-së, brenda dy ditëve, dosjet e plota të aplikantëve, së bashku me listën përkatëse.
6. Aplikanti, pasi ka përfunduar kursin teoriko - praktik pranë subjektit privat, mund të paraqitet në testim, një herë në muaj, sipas njoftimit që bëhet nga komisioni i testimit.

**Neni 12**  
**Zhvillimi i provimit**

1. Komisioni i marrjes në provim përbëhet nga 3 specialistë, inxhinierë mekanikë në fushën e transportit rrugor të Drejtorisë së Kualifikimit dhe Testimit.
2. Provimi do të kryet brenda 7 ditëve nga dita e përfundimit të kursit teoriko-praktik që ka kryer aplikanti.
3. Testet e provimit përgatiten nga specialistët e Drejtorisë së Kualifikim – Testimit, në përputhje me programin e hartuar nga Drejtoria e Kualifikim-Testimit, bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
4. Komisioni i provimit caktohet me propozim të drejtorit të drejtorisë së kualifikim-testimit dhe miratohet nga titullari i DPSHTRR-së.
  - Vlerësimi i aplikantit do të jetë pozitiv kur:
5. Aplikanti i nënshtrohet një provimi të detyrueshëm me shkrim, ku testi përmban 10 pyetje me 3 alternativa, pra 30 pikë.
6. Aplikanti që gjatë provimit grumbullon 24 pikë nga 30 pikë të mundshme që ka testi i provimit, quhet fitues në teori.
7. Aplikanti i vlerësuar fitues në testim, pajiset me dëshminë e aftësisë profesionale.
8. Aplikantët nuk mund të merren në provim pa realizuar programin e plotë teoriko - praktik, të vërtetuar nga subjekti juridik privat.
9. Komisioni i marrjes në provim nuk duhet të marrë më shumë se 20 kandidatë në ditë. Koha e provimit është 1 (një) orë.
10. Aplikantët kanë të drejtë të paraqiten deri në tri herë në provim, ku nga një provim me rezultat negativ në tjetrin, duhet të kalojnë jo më shumë se 30 ditë.
11. Provimi do të zhvillohet pranë subjekteve private, ku është bërë trajnimi, nga ora 10.00 - 16.00, për ditët që është planifikuar provimi, nga komisioni i marrjes në provim.

12. Dokumenti bazë për marrjen në provim të kandidatëve është libri i protokollit, ku hidhen të gjitha rezultatet në ditët e planifikuara nga komisioni i marrjes në provim, i cili harton procesverbalin përfundimtar të firmosur prej tyre.

#### Neni 13

### **Pajisja me dëshminë e aftësisë profesionale**

1. Aplikantët, të cilët kryejnë sipas programit kurset e trajnimit teoriko – praktik, si përdorues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, si dhe kalojnë me sukses provimin sipas nenit 12, përfitojnë dëshminë e aftësisë profesionale, sipas nenit 7 pika 1, si manovratorë të makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimit në tokë.

2. Dëshmia e aftësisë profesionale lëshohet në përputhje me modelin e paraqitur nga DPSHTRR-ja dhe e miratuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Dëshmia e aftësisë profesionale është e vlefshme me afat 5-vjeçar, nga data e lëshimit dhe shfrytëzohet vetëm për ato qëllime për të cilat ajo është lëshuar.

4. Çdo korrigjim e bën dëshminë të pavlefshme.

5. Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.

#### Neni 14

### **Rinovimi i DAP-it**

1. Aplikanti kërkon zëvendësimin e dëshmisë kur është mbushur afati i vlefshmërisë, me një kërkesë me shkrim dhe të shoqëruar me dëshminë origjinale.

2. Aplikanti mund të kërkojë zëvendësimin në rastet e humbjes së dëshmisë. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim me sqarime të hollësishme mbi humbjen e saj, si dhe kur paraqitet një vërtetim nga komisarati i policisë ku ai banon.

3. Aplikanti mund të kërkojë zëvendësimin dhe në rastin e dëmtimit të dëshmisë me kërkesën përkatëse.

4. Dëshmia lëshohet, vetëm kur plotësohen kërkesat si më sipër, kur janë shqyrtuar dhe verifikuar në protokollin përkatës nga komisioni i testimit, pranë DPSHTRR-së.

5. Kërkesat e aplikantëve për rinovimin e dëshmisë së aftësisë profesionale depozitohen pranë drejtorive rajonale.

6. Drejtoritë rajonale ia përcjellin me lista përkatëse Drejtorisë së Kualifikim-Testimit, pranë DPSHTRR-së.

## **KREU VI**

### **DISIPLINIMI I PËRDORIMIT TË MAKINERIVE TË NDËRTIMIT DHE RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK**

#### Neni 15

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, kërkohet në të njëjtën kohë përcaktimi i klasifikimit sipas tipave të makinerive të rënda të ndërtimit që :

1. Mjetet e ndërtimit janë makineri teknologjike vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makineri janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë.

2. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara në aktet nënligjore.

3. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor dhe disiplinimit të tyre, makineritë e rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë klasifikohen në :

a) mjete ndërtimi: vetëshkarkuese, ngarkues transportues, autobetonjere, buldozer, automakineri shpimi, ekskavator me zinxhirë, ekskavator me goma, ekskavator me zinxhirë hidraulik dhe ekskavator hidraulik me zinxhirë për hapje kanalesh;

b) mjete ndërtimi rrugësh: 1) autoskrepër si ; ngarkimi, transportimi, shkarkimi;

2) grejder (autoshatë niveluese), rul -vibrues, automakineri betonshtuese dhe automakineri asfaltuese.

#### Neni 16

Për t'iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makineri duhet të qarkullojnë në përputhje me rregullat e vendosura në nenin 113 të Kodit Rrugor, ku kërkohen kritere që në rastet e lëvizjeve të tyre në rrugë qytetëse, këto makineri nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/orë, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makinat teknologjike vetëlëvizëse me rrota jopneumatike a me zinxhirë, që lëvizin në rrugë peshës së verifikuar nga kjo qendër, duke përfshirë këtu vlerën e raportit minimal kantieresh ose rrugë rurale, këto makineri nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/orë, kur lëvizin në rrugë horizontale.

#### Neni 17

MPPTT, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ushtron kontroll dhe inspektime mbi veprimtarinë e subjekteve private të licencuara, duke iu referuar nenit 121, pikat 8 dhe 9. Përbëjnë kontroll veçanërisht:

- a) aftësia profesionale e personelit trajnues;
- b) gjendja e makinerive të ndërtimit sipas normave në fuqi;
- c) plotësimi i pajisjeve didaktike;
- d) përshtatshmëria e mjediseve;
- e) kryerja e rregullt e kurseve të trajnimit teoriko – praktik etj.

#### Neni 18

Disiplinimi i makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, duhet të karakterizohen nga lloji i tyre, konstruksioni, mënyra e përdorimit, si dhe qarkullimi me ose pa pajisjet e punës, të njohura nga qendra e miratimit apo homologimit si të çmontueshme, me kusht që për çdo rast të respektohen kufijtë e përmasave dhe ndërmjet peshës ose peshave që rëndojnë mbi aksin ose akset e përparme, si dhe të atyre që rëndojnë mbi aksin ose akset e pasme.

#### Neni 19

Makineritë e rënda teknologjike të ndërtimit duhet të jenë të miratuara dhe verifikuara me mjete të ndryshme ndërmjet tyre, në kushte që sistemi i punës të mos pësojë ndryshime, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimet e MPPTT-së.

#### Neni 20

Këto makineri të rënda ndërtimi, që në disa raste quhen mjete zhvendosëse, të caktuara në ato raste kur përdoren për transporte të kombinuara apo sipas lëvizjes së tyre në zonat si, në kantiere ndërtimi, rrugë, autostrada, ndërtim digash në hidrocentrale, porte, aeroporte ose vepra të tjera bonifikuese, të caktuara për të lidhur dy ose më shumë nga zonat, edhe kur ato janë ndërprerë nga zonat publike.



## Neni 21

Subjektet ndërtimore ua dorëzojnë me procesverbal makineritë, vetëm përdoruesve të pajisur me dëshmi aftësie profesionale, të cilët e shfrytëzojnë, mirëmbajnë dhe përgjigjen për dëmet që shkaktohen për faj të tyre. Procesverbali firmoset nga drejtuesit e shoqërisë dhe nga përdoruesi marrës në dorëzim.

## Neni 22

Procesverbali i marrjes në dorëzim të makinerisë dhe dëshmia e aftësisë profesionale (DAP), janë dokumente teknike që duhet të mbahen detyrimisht nga përdoruesi gjatë të gjithë kohës që shfrytëzon makineritë. Ato paraqiten sa herë që kërkohet nga personat e ngarkuar për kontroll. Ndalohet shfrytëzimi i makinerisë nga përdoruesit pa qenë të pajisur me këto dokumente.

## Neni 23

Për mjetet ngritëse, si vinç-kullë, vinç-derik, vinç-stacionarë, ashensorë, çmontimi dhe montimi në objektin e ri do të bëhet me specialistë, nën mbikëqyrjen e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe një inxhinier mekanik të pajisur me licencë, të cilët do të asistojnë dhe do të kontrollojnë të gjitha regjistrimet dhe provat që duhet të plotësojnë këto makineri (prova pa ngarkesë dhe me ngarkesë) për të qenë të gatshme për punë. Në përfundim të provave mbahet një procesverbal ndërmjet drejtuesit teknik të subjektit, specialistëve të montimit, inxhinierit mekanik dhe manovratorit.

## Neni 24

Përdoruesi i mjetit çdo ditë para fillimit të punës provon gjendjen teknike të makinerisë duke e venë atë në lëvizje. Nëse konstaton ndonjë mungesë ose defekt, ndalon makinerinë dhe lajmëron personat përgjegjës. Ndalohet fillimi dhe vazhdimi i punës me makineri të defektuara dhe me mungesa.

## Neni 25

Subjektet ndërtimore janë të detyruara të japin udhëzime mbi rregullat e sigurimit teknik dhe rregullat e shfrytëzimit të makinerive që janë në përdorim jo më pak se një herë në tre muaj.

## Neni 26

Në rastin kur makineria punon me ndërresa, kontrolli i gjendjes teknike të makinerisë bëhet në praninë e dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim. Marrësi në dorëzim, në qoftë se bindet se makineria është në gjendje të mirë, fillon punën, në të kundërtën lajmëron menjëherë përgjegjësin për gjendjen teknike të saj. Shënimet mbi gjendjen teknike të makinerisë bëhen në librin e dorëzimit të turnit, me të cilin pajiset çdo makineri që punon me ndërresa.

## Neni 27

Personeli inxhiniero-teknik, si dhe manovratorët e makinerive në shoqëritë ndërtimore, janë të detyruar që para vënies në shfrytëzim të makinerive dhe pajisjeve të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përdorimit, mirëmbajtjes dhe sigurimit teknik të tyre, si dhe të kryejnë provat e plota teknike dhe teknologjike.

#### Neni 28

Subjektet ndërtimore organizojnë punën me makineri në objektet që ndërtojnë sipas një planorganizimi të hartuar e të miratuar prej tyre duke pasur parasysh: kapacitetet teknike, zonat e lëvizjes dhe të manovrimit, thellësitë e gërmimit, këndet e skarpateve, rrugët e kalimit, distancat nga objektet e ndërtuara, shenjat kufizuese për njerëzit etj.

#### Neni 29

Përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit mbajnë përgjegjësi për gjendjen teknike të makinerisë që përdorin dhe duhet të sigurojnë punë me regjim teknik normal, pa avari dhe me siguri të plotë për jetën e tyre dhe të personave të tjerë që punojnë rreth tyre. Ata nuk zbatojnë asnjë urdhër apo nuk marrin asnjë iniciativë për të punuar në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

#### Neni 30

Për shkeljen e rregullave të administrimit dhe të përdorimit të makinerive, kanë përgjegjësi sipas rastit, disiplinore, materiale ose penale personat fajtorë, si dhe personat që kanë urdhëruar të punohet në kundërshtim me rregullat teknike dhe rregullat e sigurimit teknik.

#### Neni 31

Në rast se makineria, si rezultat i përdorimit të saj jo të rregullt, shkakton avari që shoqërohen dhe me viktima, njoftohet menjëherë organi i prokurorisë dhe merren masa për të ruajtur vendin ku ka ndodhur avaria për të mos bërë ndryshime. Përjashtohen rastet kur duhen nxjerrë personat e dëmtuar nga avaria për t'u dhënë ndihmën mjekësore, si dhe për të likuiduar vatrën që mund të zmadhojë dëmin.

#### Neni 32

Përdorimi i makinerive të rënda të ndërtimit pa dëshminë e aftësisë profesionale përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik.

#### Neni 33

##### **Dispozita të përgjithshme**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë të gjitha masat e duhura për zbatimin e kësaj rregulloreje brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të saj.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë masa për përgatitjen e autorizimit të identifikimit të aplikantit, protokollit të rezultateve të aplikantit në kurset e trajnimit teoriko-praktik, protokollit të rezultateve të provimit me shkrim, si dhe regjistri i dëshmive të lëshuara dhe të tërhequra.
3. Bashkëlidhur janë programi teoriko-praktik, autorizimi për regjistrimin e aplikantit dhe modelet e dëshmisë së aftësisë.
4. Shtojca 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur, janë pjesë përbërëse e kësaj rregullore.
5. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

## SHTOJCA NR. 1

Programi teoriko-praktik për zhvillimin e kursit, që ndiqet nga subjektet juridike private, do të organizohet si më poshtë:

Kursi teorik përfshin njohuri për:

- Makineritë e ndërtimit;
- Motorët me djegie të brendshme;
- Sistemet e frenimit;
- Sistemet e lëvizjes dhe të drejtimit;
- Sistemet hidraulike;
- Sistemet elektrike dhe elektronike në komandim ;

Sistemet e ngritjes (polispaset, kavot, cilindrat, pultet e komandimit, pompat hidraulike, shpërndarësit gjatë etj.);

Gjithsej 16 orë mësimore.

Materiali bazë studimor:

- Ligj nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 Rregullore ne zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

- Ligji nr.8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

- Kursi praktik përfshin njohuri për:

- Funksionimin e sistemeve të lëvizjes dhe frenimit;
- Funksionimin e sistemeve hidraulike dhe të ngritjes;
- Manovrat me makineritë e rënda të ndërtimit dhe punimit të tokës;
- Defektet e mundshme teknike dhe shërbimet përkatëse gjatë punës;
- Shërbimet periodike (ndërrim vaj motori, vaji hidraulik, filtra etj.);
- Rregullat e sigurimit teknik;

Gjithsej, 8 orë kursi praktik.



**REPUBLIKA E E SHQIPËRISË**  
**Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit**  
**Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor**  
**Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor .....**

Nr \_\_\_\_ Prot


Tirane më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2010

**AUTORIZIM**

Autorizohet aplikanti Emri ..... Atësia..... Mbiemri.....  
 Amësia.....  
 Datëlindja..... Vendbanimi..... Nr.  
 iden.....  
 Për t'u aftësuar për dëshmi aftësie profesionale (DAP)

Sipas llojeve të mjeteve të rënda të ndërtimit dhe punimit të tokës :

**DAP BULDOZERIST**



-----  
*Emer Mbiemer Firme (Aplikanti)*

\_\_\_\_\_  
**Drejtori Rajonal**

**Subjekti juridik** “ \_\_\_\_\_ ” NIPT \_\_\_\_\_  
 Nr. lic. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_\_  
 Periudha trajnimit teorik nga dt. \_\_\_\_\_ deri me dt. \_\_\_\_\_  
 Periudha trajnimit praktik nga dt. \_\_\_\_\_ deri me dt. \_\_\_\_\_

DREJTUESI TEKNIK

ADMIN. SUBJEKTIT JURIDIK

\_\_\_\_\_  
*Emër, Mbiemër, Firmë*

\_\_\_\_\_  
*Emër , Mbiemër, Firmë , Vula*

**Vlerësimi nga komisioni për testimin me shkrim**

Nr.i provimeve	Nr.i protokollit	Data e provimit	Nr.i testit	Nr.i pikëve	Rezultati	Komisioni		
						Kryetari	Anëtar	A nëtar
I								
II								
III								

**Aplikanti është fitues për dëshmi aftësie profesionale:**

**BULDOZERIST**

**KOMISIONI**

**ANËTAR**

.....

**KRYETARI**

.....

**ANËTAR**


.....

**Nr .....Prot.**

**Datë...../...../200**

Modeli A2

1. Emri: \_\_\_\_\_  
2. Mbiemri: \_\_\_\_\_  
3. Atësia: \_\_\_\_\_  
4. Datëlindja: \_\_\_\_\_



5. Vendbanimi: \_\_\_\_\_

SHTOJCA Nr.3

6. Lëshohet në bazë të vendimit të komisionit të testimit  
Nr. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Për : BULDOZERISTË

7. Lëshohet nga  
8. Data e lëshimit \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_  
9. E vlefshme deri më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Drejtori i Përgjithshëm

\_\_\_\_\_

**Shënim:**

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme:

Makineri gërmimi, transporti, nivelimi e ngjeshje dherash :

- buldozerë
- traktorë
- rulo-vibrues
- skrepera
- nivelues (greidera)
- shtruese asfalto betoni (me goma dhe zinxhirë)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË  
TRANSPORTIT RRUGOR



**Dëshmi e Aftësisë Profesionale**  
Për

Pëdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë

Nr. \_\_\_\_\_

Seria Nr. \_\_\_\_\_



Seria Nr. \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E E SHQIPERISE**  
**Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe**  
**Telekomunikacionit**  
**Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor**  
**Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor .....**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Tirane me \_\_\_\_/\_\_\_\_/2009


**AUTORIZIM**

Autorizohet Aplikanti Emri ..... Atësia..... Mbiemri..... Amësia.....  
 Datëlindja..... Vëndbanimi..... Nr. iden.....

Për t'u aftësuar për Deshmi Aftësie Profesionale ( D.A.P.)

Sipas llojeve te mjeteve te renda te ndertimit dhe punimit te tokes :

**D.A.P. EKSKAVATORIST**



.....  
 Emer Mbiemer Firme (Aplikanti)

\_\_\_\_\_  
**Drejtori Rajonal**

**Subjekti Juridik** " \_\_\_\_\_ " NIPT \_\_\_\_\_

Nr. Lic. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_\_

Periudha trajnimit teorik nga dt. \_\_\_\_\_ deri me dt. \_\_\_\_\_

Periudha trajnimit praktik nga dt. \_\_\_\_\_ deri me dt. \_\_\_\_\_

DREJTUESI TEKNIK

ADMIN. SUBJEKTIT JURIDIK

\_\_\_\_\_  
 Emer Mbiemer Firme

\_\_\_\_\_  
 Emer Mbiemer Firme Vule

**Vlerësimi nga komisioni për testimin me shkrim**

Nr.i provimeve	Nr.i protokollit	Data e provimit	Nr.i testit	Nr.i pikëve	Rezultati	Komisioni		
						Kryetari	Anëtar	A nëtar
I								
II								
III								

**Aplikanti është fitues për dëshmi aftësie profesionale:**

**EKSKAVATORIST**

**KOMISIONI**

**ANËTAR**

.....

**KRYETARI**

.....

**ANËTAR**

.....


**Nr .....Prot.**

**Datë...../...../200**



Modeli A3

1. Emri: \_\_\_\_\_  
2. Mbiemri: \_\_\_\_\_  
3. Atësia: \_\_\_\_\_  
4. Datëlindja: \_\_\_\_\_



5. Vendbanimi: \_\_\_\_\_

SHTOJCA Nr.3

6. Lëshohet në bazë të vendimit të komisionit të testimit

Nr. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Për : ESKAVATORISTË

7. Lëshohet nga

8. Data e lëshimit \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

9. E vlefshme deri më \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Drejtori i Përgjithshëm

\_\_\_\_\_

**Shënim:**

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme :

**Makineri gërmimi dhe ngarkimi dherash :**

- eskavatorë të kombinuar (me goma dhe me zinxhirë)
- eskavatorë për hapje kanalesh
- eskavatorë
- autoskreper
- lopata ngarkuese
- makineri gërmuese drage



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE  
TRANSPORTIT RRUGOR



**Dëshmi e Aftësisë Profesionale**

Për

Pëdoruesit e makinerive të rënc të ndërtimit dhe punimeve në to

Nr. \_\_\_\_\_

Seria Nr. \_\_\_\_\_



Seria Nr. \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E E SHQIPËRISË**  
**Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit**  
**Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor**  
**Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor .....**

Nr \_\_\_\_ Prot


Tirane më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2010

**AUTORIZIM**

Autorizohet aplikanti Emri ..... Atësia..... Mbiemri.....  
 Amësia.....  
 Datëlindja..... Vëndbanimi..... Nr.  
 iden.....  
 Për t'u aftësuar për dëshmi aftësie profesionale (DAP)

Sipas llojeve të mjeteve të rënda të ndërtimit dhe punimit të tokës:

**DAP AUTOMAKINIST**



-----  
*Emer Mbiemer Firme (Aplikanti)*

\_\_\_\_\_  
**Drejtori Rajonal**

**Subjekti juridik** “ \_\_\_\_\_ ” NIPT \_\_\_\_\_

Nr. lic. \_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_\_

Periudha trajnimit teorik nga dt. \_\_\_\_\_ deri me dt. \_\_\_\_\_

Periudha trajnimit praktik nga dt. \_\_\_\_\_ deri me dt. \_\_\_\_\_

**DREJTUESI TEKNIK**

**ADMIN. SUBJEKTIT JURIDIK**

\_\_\_\_\_  
*Emër, Mbiemër, Firmë*  
 Vula

\_\_\_\_\_  
*Emër, Mbiemër, Firmë,*

**Vlerësimi nga komisioni për testimin me shkrim**

Nr.i provimeve	Nr.i protokollit	Data e provimit	Nr.i testit	Nr.i pikëve	Rezultati	Komisioni		
						Kryetari	Anëtar	Anëtar
I								
II								
III								

**Aplikanti është fitues për dëshmi aftësie profesionale:**

**AUTOMAKINIST**

**KOMISIONI**

**ANËTAR**

.....

**KRYETARI**

.....

**ANËTAR**


.....

**Nr .....Prot.**

**Datë...../...../200**

Modeli A1

1. Emri: \_\_\_\_\_  
2. Mbiemri: \_\_\_\_\_  
3. Atësia: \_\_\_\_\_  
4. Datëlindja: \_\_\_\_\_



5. Vendbanimi: \_\_\_\_\_

SHTOJCA Nr.3

6. Lëshohet në bazë të vendimit të komisionit të testimit  
Nr. \_\_\_\_\_ Dt. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Për : AUTOMAKINISTË

7. Lëshohet nga  
8. Data e lëshimit \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_  
9. E vlefshme deri më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

Drejtori i Përgjithshëm

\_\_\_\_\_

**Shënim:**

- Dëshmia është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
- Çdo korigjim e bën atë të pavlefshme
- Ky dokument pezullohet nga organi që e lëshon.
- Kjo dëshmi është e vlefshme për mjetet e mëposhtme:

Makineri ndërtimi me bazë automjeti :

- autovinça
- autobetoniere
- autobetonpompa
- autobitumatriçe
- autosonda
- vetshkarkues
- ngarkues-transportues
- automakineri-shpimi
- automakineri-asfaltuese



Seria Nr. \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË  
TRANSPORTIT RRUGOR



**Dëshmi e Aftësisë Profesionale**  
Për

Pëdoruesit e makinerive të rënda  
të ndërtimit dhe punimeve në tokë

Nr. \_\_\_\_\_

Seria Nr. \_\_\_\_\_

**LIGJ**  
**Nr. 9557, datë 8.6.2006**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN KUADËR PËR BASHKËPUNIMIN NDËRMJET SHTETEVE FRANKOFONE TË EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE PËR ZHVILLIMIN E FORMIMIT PROFESIONAL DHE TEKNIK”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen kuadër për bashkëpunimin ndërmjet shteteve frankofone të Europës Qendrore dhe Lindore për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik”, bërë në Bukuresht më 5 nëntor 2004.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4941, datë 27.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.69, datë 6.7.2006, faqe 1979*

**MARRËVESHJA KUADËR**  
**BASHKËPUNIMI MIDIS SHTETEVE FRANKOFONE TË EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE PËR ZHVILLIMIN E FORMIMIT PROFESIONAL DHE TEKNIK**

Preambul

Në kontekstin e deklaratës së ministrave europianë të formimit profesional e teknik dhe të Komisionit European të nënshkruar në Kopenhagen në 29 dhe 30 nëntor 2002, shtetet e vendeve frankofone të nënshkuara, të quajtura më poshtë “Palë Kontraktuese”,

- të *nxitur* nga vullneti për të forcuar lidhjet e miqësisë dhe të solidaritetit që bashkojnë popujt e Frankofonisë;

- të *ndërgjegjshëm* për domosdoshmërinë e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore, anëtare ose vëzhguese, për të forcuar lidhjet e partneritetit në fushën e formimit profesional dhe teknik;

- *duke dashur* të zhvillojnë bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh në fushën e formimit profesional dhe teknik;

- lidhjet e shkëmbimit dhe bashkëpunimit midis sistemeve të formimit profesional dhe teknik që kanë nisur në kuadrin e mekanizmit rajonal të partneritetit ndërshtetëror të propozuar nga Agjencia Ndërqeveritare e Frankofonisë (AIF) pas Kongresit Frankofon për Formimin Profesional dhe Teknik të Bamakos (maj 1998),

vendosën dispozitat e mëposhtme.

## Neni 1

Palët kontraktuese vendosën të vazhdojnë së bashku, sipas mundësive të tyre dhe me shpirt solidariteti, përpjekjet e tyre për promovimin, zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e formimit profesional dhe teknik.

## Neni 2

Fusha e bashkëpunimit që përbën objektin e kësaj Marrëveshjeje kuadër mbulon veçanërisht realizimin midis krejt ose disa prej palëve kontraktuese:

1. e veprimtarive të partneritetit me karakter kombëtar dhe rajonal me një bashkëpunim të drejtpërdrejtë;
2. e studimeve dhe kërkimeve për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik;
3. e veprimtarive në vazhdim, ose që duhen zhvilluar në kuadrin e projektit në ndihmë të politikave kombëtare të formimit profesional dhe teknik të Agjencisë Ndërqeveritare të Frankofonisë, në mënyrë të veçantë e veprimtarive që lidhen me kuadrin global të inxhinierisë së formimit profesional e teknik dhe me bazën e njohurive frankofone;
4. e çdo formë tjetër bashkëpunimi të pranuar nga palët kontraktuese.

## Neni 3

Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, palët kontraktuese përfundojnë marrëveshje bashkëpunimi specifike për realizimin e veprimtarive të partneritetit ndërshtetëror që kanë të bëjnë me fushën e përcaktuar në nenin 2. Këto marrëveshje përcaktojnë termat e referencës, modalitetet dhe mjetet e bashkëpunimit teknik, dhe kushtet e realizimit të veprimtarive, veçanërisht:

- natyrën e veprimtarisë;
- objektivat që duhen arritur;
- kalendarin e punës;
- buxhetin e shpenzimeve dhe planin e financimit;
- detyrimet e secilës palë të interesuar, në mënyrë të veçantë, angazhimet financiare reciproke;
- organizmat përgjegjëse për zbatimin;
- burimet njerëzore pjesëtare dhe të ngarkuara për zbatimin
- modalitetet e ndjekjes dhe të vlerësimit
- Qëllimet dhe rezultatet konkrete afatshkurtëra dhe ndikimi afatgjatë mbi evoluimin e sistemeve të formimit profesional e teknik të vendeve të interesuara.

## Neni 4

1. Çdo palë kontraktuese zotohet të formojë një ekip kombëtar me njerëz kompetentë dhe përgjegjës për realizimin e veprimtarive të partneritetit që futen në fushën e përcaktuar nga neni 2, dhe të vër në dispozicion mjetet materiale dhe financiare të nevojshme, veçanërisht mjetet teknike të komunikimit që lejojnë një përdorim efikas të bazës së njohurive frankofone.

2. Ministri ose ministrat e ngarkuar për formimin profesional dhe teknik të çdo pale kontraktuese zotohen të caktojnë dhe madatojnë si përgjegjës (garant) kombëtar të kësaj Marrëveshjeje një nga personat kompetent të sistemit të formimit profesional dhe teknik.

3. Në kuadrin e mandatit të marrë, garanti kombëtar ka për detyrë t'i propozojë ministrit personat që kanë aftësitë për të krijuar ekipin kombëtar, të drejtojnë dhe të gjallërojnë ekipin kombëtar, të kordinojë për vendin e vet mekanizmin rajonal të partneritetit ndërshtetëror me homologët e vet, t'i sigurojë ose t'i delegojë çdo anëtar të ekipit të vet kombëtar, koordinimin rajonal të një veprimtarie partneriteti ndërshtetëror. Për këtë qëllim, është krijuar komiteti i lidhjeve

të të gjithë përgjegjësve (garantëve) kombëtarë për të koordinuar mekanizmin rajonal të partneritetit ndërshtetëror dhe të gjitha veprimtaritë që rrjedhin prej tij.

4. Sipas modaliteteve dhe mjeteve të bashkëpunimit teknik të përcaktuara në çdo marrëveshje bashkëpunimi, palët kontraktuese mund të kërkojnë financimin e plotë ose të pjesshëm, dhe pjesëmarrjen e të gjitha organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë për realizimin e projekteve që lidhen me fushën e përcaktuar në nenin 2.

#### Neni 5

Secila nga palët kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e saj përgjegjës, miraton masat e nevojshme për të lehtësuar hyrjen (lëshimin e vizave falas) dhe qëndrimin në vendin e vet të shtetasve të palëve të tjera kontraktuese për realizimin e projekteve të caktuara në marrëveshje kuadër.

#### Neni 6

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen objekt rishikimi me kërkesë të një ose shumë palëve kontraktuese. Dispozitat e rishikuara ose të amenduara me pëlqim reciprok hyjnë në fuqi sapo miratohen nga palët kontraktuese.

#### Neni 7

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Marrëveshje zgjidhet paqësisht me një frymë vllazërimi.

#### Neni 8

1. Secila nga palët kontraktuese mund ta denoncojnë këtë marrëveshje duke treguar qëllimin e vet me një njoftim me shkrim adresuar secilës palë kontraktuese gjashtë muaj përpara.

2. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje lidhet vetëm me autorin e saj dhe nuk prek zbatimin e projekteve në realizim e sipër ose vlefshmërinë e garancive tashmë të siguruara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 9

Kjo Marrëveshje kuadër mbetet e hapur për çdo vend frankofon të Europës Qendrore dhe Lindore, anëtar ose vëzhgues, nëpërmjet nënshkrimit të një protokolli shtesë.

Kjo Marrëveshje është lidhur për një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të çdo vendi nënshkrues, dhe sipas rastit, në datën e mbylljes së procedurave ligjore të miratimit specifik për secilën palë kontraktuese.

Bërë në Bukuresht, në 5 nëntor në katër ekzemplarë në gjuhën franceze, tekstet janë të gjithë të njëjtë.

Për Rumaninë:

Për Republikën Bullgare:

Për Republikën e Maqedonisë:

Për Republikën e Moldavisë:

**VENDIM**  
**Nr. 273, datë 10.5.2006**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT  
PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 7 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional, si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional ka objekt kryesor të veprimtarisë krijimin e një sistemi kombëtar e unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional harton programe për realizimin e politikave për zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Funkcionet kryesore të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional janë:

- a) hartimi dhe rishikimi i listës kombëtare të profesioneve dhe i përshkrimeve përkatëse;
- b) hartimi dhe rishikimi i kuadrit kombëtar të kualifikimeve profesionale (KKKP) me përshkrimin e standardeve për nivelet dhe drejtimet, si dhe i kriterëve të vlerësimit e certifikimit;
- c) hartimi dhe rishikimi i skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale;
- ç) akreditimi i institucioneve, që ofrojnë arsimim dhe formim profesional;
- d) përcaktimi i standardeve të trajnimit, fillestar dhe të vazhdueshëm, të personelit mësimdhënës të arsimit dhe formimit profesional;

dh) përcaktimi i kriterëve për vlerësimin dhe certifikimin e arsimit dhe formimit profesional;

e) ndërtimi dhe rifreskimi i bazës së të dhënave për kuadrin kombëtar të kualifikimeve profesionale (KKKP), për skeletkurrikulat, akreditimin, certifikatat e dhëna, nevojat për kualifikime profesionale etj., që lidhen me arsimin dhe formimin profesional.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional raporton, në mënyrë periodike, në Këshillin Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional për çështjet e veprimtarisë së vet.

5. Funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional bëhet në përputhje me rregulloren, e cila, pas këshillimit me Këshillin Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

6. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në sugjerimet e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, i propozon Kryeministrit strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional.

7. Organika dhe numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional të jenë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2006, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila të çelë një zë të veçantë në buxhetin e vet për Agjencinë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional.

9. Emërimi dhe lirimi nga detyra i Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional bëhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrave”.



Para nxjerrjes së aktit të emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të Drejtorit të Agjencisë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës këshillohet me Këshillin Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional.

10. Për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional respektohen procedurat e parashikuara në ligjin 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, datë 22.5.2006, faqe 1471*

**UDHËZIM**  
**Nr.1457, datë 28.7.2009**

**PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCIM, TË  
SUBJEKTEVE QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË FORMIMIT PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 8 dhe nenit 23, shkronja “c”, të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 5 kreu II, dhe pikës 4 kreu XI të vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave,

**UDHËZOJ:**

1. Kërkesat e subjekteve fizike/juridike, ofruese të formimit profesional, që kanë aplikuar pranë sporteve të Qendrës Kombëtare të Licencimeve (QKL) për t’u pajisur me licencë për ofrimin e formimit profesional dhe janë miratuar në fazën e parë, kalojnë në mënyrë elektronike pranë Drejtorisë së Politikave të Punësimit, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Personi përgjegjës pranë kësaj drejtorie bën regjistrimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të ardhur në regjistrin elektronik të krijuar për këtë qëllim dhe e përcjell atë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, brenda 3 ditëve pune nga marrja e tij.

3. Shërbimi Kombëtar i Punësimit:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, i cili përfshin dokumentet provuese sipas aneksit 1 fusha X kategoria X.2.B bashkëngjitur vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta” të Këshillit të Ministrave, dhe dokumentet provuese që lidhen me drejtuesin teknik, sipas përcaktimit të germës “a”, pika 4, kreu III, të këtij vendimi;

b) bën inspektimin në vend të shërbimit që ofron subjekti.

4. Në rast se gjatë inspektimit vihen re shkelje, pasaktësi të dokumentacionit, mosplotësim i standardeve apo mospërputhje me deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit, Shërbimi Kombëtar i Punësimit i kërkon subjektit plotësimin e mangësive të kostatuara brenda 5 ditëve pune. Nëse këto mangësi nuk plotësohen brenda këtij afati, Shërbimi Kombëtar i Punësimit i propozon komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencim të mos miratojë kërkesën e subjektit për t’u pajisur me licencë.

5. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës dhe kryerjes së inspektimit në vend, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dërgon në Drejtorinë e Politikave të Punësimit në MPÇSSHB, brenda 15 ditëve pune nga momenti i marrjes së dokumentacionit nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta:

- a) dokumentacionin që ka paraqitur aplikuesi;
- b) vlerësimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

6. Personi përgjegjës në Drejtorinë e Politikave të Punësimit informon me shkrim kryetarin e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licenca, duke i propozuar datën për mbledhjen e komisionit. Kryetari i Komisionit vendos për datën e mbledhjes së komisionit.

7. Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Licencë kryesohet nga Drejtori i Drejtorisë që mbulon çështjet e formimit profesional në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe përbëhet nga 2 anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga:

- a) sektori që mbulon çështjet e formimit profesional në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- b) Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

Ngritja e komisionit dhe caktimi i anëtarëve të tij bëhet me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

8. Komisioni, pasi bën vlerësimin e dokumentacionit, përgatit propozimin për miratimin/refuzimin e kërkesës për pajisjen me licencë dhe arsyetimin ligjor përkatës, dhe ia paraqet atë Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda 5 ditëve pune nga momenti i marrjes së praktikës nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

9. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta vendos për:

- a) miratimin e kërkesës për pajisje me licencë;
- b) refuzimin e kërkesës për pajisje me licencë.

10. Në rast se kërkesa miratohet, vendimi miratues, së bashku me arsyetimin ligjor përkatës përcillet në Qendrën Kombëtare të Licencimit, e cila pajis me licencë subjektin ofrues të formimit profesional me kodin X.2.B.

11. Në rast se kërkesa refuzohet, arsyetimi ligjor përkatës, në të cilin përcaktohen qartë shkaqet e refuzimit, përcillet në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

12. Nëse subjekti nuk është dakord me vendimin e marrë për refuzimin e kërkesës për licencim, ai ka të drejtën e ndjekjes së procedurës së ankimimit sipas nenit 30 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, brenda 10 ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit për refuzimin e kërkesës.

13. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shqyrton ankimimin dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të tij. Në rast se ky afat tejkalohet, si dhe në rastet kur ministri lë në fuqi vendimin për mosmiratimin e kërkesës për licencë, subjekti fizik/juridik i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të shqyrtimit të ankimimit.

14. Për pajisjen me licencë për veprimtari të formimit profesional, përveç tarifës së QKL-së, subjekti detyrohet të paguajë tarifën prej 10 000 lekësh pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, e cila derdhet në llogarinë bankare të këtij institucioni. Një kopje e faturës paraqitet pranë sporteleve të QKL-së në çastin e marrjes së licencës. Këto të ardhura përdoren nga SHKP-ja sipas legjislacionit në fuqi.

15. Pas licencimit nga Qendra Kombëtare e Licencimit, subjektet e licencuara i nënshtrohen një kontrolli periodik, jo më pak se dy herë në vit, i cili kryhet nga struktura përkatëse e Shërbimit Kombëtar të Punësimit në nivel qendror dhe/ose rajonal, sipas planit të punës së miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKP-së.

16. Nëse gjatë kontrollit të subjekteve të licencuara konstatohet se janë paraqitur deklarime të rreme, nuk janë respektuar standardet e kërkuara ose veprimtaria kryhet jo në përputhje me legjislacionin në fuqi, komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencë, bazuar në vlerësimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, i propozon Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të kërkojë nga QKL-ja revokimin e licencës.

17. Udhëzimi nr.1590, datë 4.8.2008 “Për procedurat e licencimit të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional” i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE  
DHE SHANSEVE TË BARABARTA  
**Viktor Gumi**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.122, datë 22.8.2009, faqe 5840*

## **ARSIMI I LARTË**

### **LIGJ**

**Nr.9741, datë 21.5.2007**

### **PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007;*

*ndryshuar me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe të rregullojë aspekte të krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit, sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane, si dhe rolin e shtetit e të shoqërisë në arsimin e lartë.

#### **Neni 2 Misioni i arsimit të lartë**

Misioni i arsimit të lartë është:

- a) të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve; të zhvillojë dhe të çojë përpara artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;
- b) të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimit i lartë gjatë të gjithë jetës;
- c) të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- ç) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Neni 3  
**Parime bazë**

1. Institucionet e arsimit të lartë kanë autonomi dhe liri akademike.
  2. Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë shprehet në:
    - a) vetëqeverisjen e tyre, për të organizuar strukturat e tyre të brendshme dhe veprimtaritë e tyre, nëpërmjet statuteve dhe rregulloreve, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore në fuqi;
    - b) të drejtën për hartimin dhe zhvillimin e pavarur të programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit;
    - c) të drejtën për të caktuar kritere të pranimit të studentëve në programet e studimeve;
    - ç) të drejtën për të mbledhur fonde dhe për të përfutur mjete materiale, sipas rregullave në fuqi, si dhe të drejtën për të realizuar marrëveshje të pavarura me Qeverinë ose organizma të tjerë për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore; të drejtën për të realizuar marrëveshje me institucione, shoqëri biznesi ose organizata të tjera, vendase ose të huaja, publike ose private; të drejtën për të administruar fondet publike e të ardhura të tjera, që disponojnë sipas mënyrës së përshkruar në ligj.
  3. Liria akademike e institucioneve të arsimit të lartë shprehet në lirinë e mësimdhënies, lirinë e kërkimit shkencor, lirinë e krijimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
  4. Arsimi i lartë në Republikën e Shqipërisë zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës europiane të arsimit të lartë.
  5. Arsimi i lartë është publik dhe privat. Arsimi i lartë publik është laik.
  6. Shteti garanton paprekshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të territorit të tyre. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose lejen e titullarit të institucionit të arsimit të lartë. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e titullarit të institucionit të arsimit të lartë.
- Cenimi i paprekshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.

**KREU II**  
**ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

Neni 4  
**Institucionet e arsimit të lartë**

1. Arsimi i lartë ofrohet nga institucionet e arsimit të lartë, që krijohen, funksionojnë dhe akreditohen në përputhje me këtë ligj.
2. Institucionet e arsimit të lartë janë persona juridikë, publikë ose privatë, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve përcaktohen në aktin e krijimit të tyre.
3. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të akredituara të studimeve. Struktura organizative e institucioneve të arsimit të lartë përcaktohet në varësi të llojeve e të programeve të studimeve që ato ofrojnë.
4. Institucione të arsimit të lartë janë: universitetet, akademitë, kolegjet profesionale, shkollat e larta dhe qendrat ndëruniversitare.

Neni 5  
**Universitetet**

1. Universiteti përfaqëson një strukturë, të përbërë dhe të integruar, që realizon arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, shkencës, profesioneve dhe transmeton njohuri në fusha dhe disiplina shkencore dhe profesionale.

2. Universiteti siguron arsimim të bazuar në kërkim dhe njohuri shkencore e teknologjike bashkëkohore; siguron arsimim të vazhduar, kualifikime, specializime; përgatit specialistë dhe shkencëtarë të rinj.

3. Universiteti realizon kërkim shkencor e të aplikuar dhe veprimtari krijuese, ofron shërbime, në përputhje me misionin e tij, mbështet dhe realizon aftësimin e personelit akademik.

Në varësi të misionit kryesor që ka, të përcaktuar në statutin e tij, universiteti siguron raportin e përshtatshëm ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që ofron.

4. Universiteti ofron programe të studimeve për të tre ciklet, të përcaktuara në nenin 26 dhe ka në përbërje, së paku, dy fakultete.

5. Për kryerje të veprimtarive të arsimimit dhe kërkimit me interes të përbashkët, universiteti ka të drejtë të bashkëpunojë me institucione të tjera: universitete, institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike dhe private. Për një bashkëpunim të tillë mund të krijohen qendra ndëruniversitare.

#### Neni 6

##### **Akademitë, shkollat e larta dhe qendrat ndëruniversitare**

*(Shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 3 me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, neni 1; zëvendësuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 1)*

1. Akademitë ofrojnë arsimim të lartë profesional dhe veprimtari krijuese në fusha specifike të artit, sportit, të sigurisë dhe të mbrojtjes e fusha të tjera profesionale. Ato mund të ofrojnë programe të studimeve për të tre ciklet dhe kanë në përbërje, së paku, dy fakultete. Akademitë ofrojnë edhe kërkim shkencor në fushat përkatëse, në varësi të ciklit të studimit, në përputhje me statutet e tyre.

2. Shkolla e lartë ofron arsimim të lartë në ciklin e parë ose edhe të dytë të studimeve. Shkolla e lartë mund të ofrojë kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime në fushat përkatëse, në përputhje me statutin e saj. Ajo ngrihet dhe funksionon edhe me, së paku, dy fakultete.

3. Qendra ndëruniversitare zhvillon dhe promovon programe dhe projekte të kërkimit shkencor dhe ndihmon në arsimim të avancuar pas ciklit të parë të studimeve universitare. Qendra ndëruniversitare krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Objekti i veprimtarisë, si dhe detyrat përcaktohen në aktin e krijimit. Ato organizohen dhe funksionojnë sipas këtij ligji dhe në përputhje me statutin e tyre.

#### Neni 7

##### **Kolegjet profesionale**

*(Shtuar fjala në pikën 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 2)*

1. Kolegji profesional ofron veprimtari mësimore dhe trajnuese në fusha të ndryshme të arsimit profesional universitar, jouniversitar, për përgatitjen e specialistëve me orientim praktik.

2. Kolegji profesional realizon veprimtari kërkimore të aplikuara, artistike, sportive etj., nëse është parashikuar në statutin dhe rregulloret e tij, si dhe ofron shërbime.

3. Kolegji profesional ofron programe të studimeve të ciklit të parë në disa fusha, në përputhje me procedurat e përcaktuara me akte nënligjore.

4. Kolegji profesional ka të drejtë të ngrihet edhe pranë universiteteve, akademive apo shkollave të tjera të larta. Në këto raste ai ka strukturë të ngjashme me fakultetin.

#### Neni 8

##### **Njësitë përbërëse të institucioneve të arsimit të lartë**

1. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të ndahen në njësi përbërëse organizative: kryesore, bazë dhe ndihmëse.

2. Fakultetet, institutet e kërkimit dhe zhvillimit, kolegjet profesionale, si pjesë e institucioneve dhe filialet e përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 11 konsiderohen njësi kryesore.

3. Departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit konsiderohen njësi bazë.

4. Laboratorët, stacionet eksperimentale, njësitë didaktike, bibliotekat dhe njësi të tjera, që realizojnë studime, projekte dhe shërbime konsiderohen njësi ndihmëse.

5. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë vetë organizimin e brendshëm në statutet dhe rregulloret e tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore që dalin në zbatim të tij.

#### Neni 9

##### **Fakultetet**

*(Shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 3)*

1. Fakulteti është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.

2. Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tre të tilla, nga të cilat dy departamente.

3. Shfuqizuar.

4. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

#### Neni 10

##### **Qendrat dhe institutet e kërkimit dhe të zhvillimit**

1. Qendrat dhe institutet e kërkimit dhe të zhvillimit të institucioneve të arsimit të lartë kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si dhe marrin pjesë në realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë.

2. Struktura e qendrave dhe instituteve të kërkimit dhe të zhvillimit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tyre përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore që dalin në zbatim të tij.

#### Neni 11

##### **Filialet e institucioneve të arsimit të lartë**

1. Një institucion i arsimit të lartë ka të drejtë të hapë filialet e tij në rajone të tjera, jashtë selisë qendrore, për të ofruar programe të studimeve, kërkim shkencor e shërbime të ndryshme.

2. Filiali është:

a) një njësi e veçantë në strukturën e institucionit të arsimit të lartë (njësi kryesore, njësi bazë ose njësi ndihmëse);

b) pjesë përbërëse e njësisë të selisë qendrore të institucionit.

3. Kriteret dhe procedurat për hapjen e filialeve përcaktohen në statut, në përputhje me këtë ligj.

#### Neni 12

##### **Departamentet**

*(Ndryshuar pikat 4, 5 e 6 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 4/1;  
shtuar pikat 6.1, 6.2 dhe 6.3 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 4/2)*

1. Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive.

2. Strukturë të ngjashme me departamentin kanë edhe qendrat e kërkimit dhe zhvillimit, fushat e kërkimit të cilave harmonizohen me interesa të departamenteve të fakultetit.

3. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj. Institucioneve të arsimit të lartë, të cilat funksionojnë, por nuk e plotësojnë këtë kriter, u lihet një afat 5-vjeçar.

4. Departamenti organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Grupi mund të jetë edhe vetëm kërkimor. Titullarët e grupeve duhet të kenë, së paku, gradën shkencore “Doktor” dhe përzgjidhen me konkurrim të hapur, të drejtuar nga një komision ad hoc, i ngritur nga Këshilli i Profesorëve. Procedurat e ngritjes së komisionit ad hoc dhe të konkurrimit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Titullari i njësisë bazë i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore emërimin e kandidatit të renditur në vendin e parë të listës nga komisioni ad hoc, për një periudhë 4-vjeçare.

5. Në fakultetet e institucioneve të arsimit të lartë publik, që kanë qendra spitalore universitare, lëndët/disiplinat klinike organizohen në shërbime. Shërbimi është njësi bazë e fakultetit dhe bën pjesë në strukturën e spitaleve universitare. Ai realizon funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e fakultetit, si dhe funksione diagnostike e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e spitalit universitar. Numri i personelit dhe kapacitetet e njësisë së shërbimit përcaktohen në bazë të kriterëve, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë qendra spitalore universitare, përgjegjës i shërbimit është titullari i shërbimit, në funksionet e njësisë bazë të fakultetit, i cili përzgjidhet me konkurs. Ai duhet të jetë figurë e spikatur në fushën e shërbimit, të ketë, së paku, gradën shkencore “Doktor” dhe përvojë pune në fushën përkatëse, si dhe të ketë kryer kërkime dhe botime shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Kriteret e tjera të kualifikimit dhe mënyra e organizimit të konkursit të përzgjedhjes përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë dhe të Qendrës Spitalore Universitare.

6.1. Për vlerësimin e kandidatëve, që konkurrojnë për përgjegjës shërbimi, ngrihet një komision vlerësimi, përbërja e të cilit propozohet nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit në fjalë, miratohet nga Bordi i Qendrës Spitalore Universitare dhe shpallet nga rektori. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga pesë personalitete, të vendit e të huaja, të njohura për kontributin akademik dhe shkencor në fushën e shërbimit në fjalë ose në fushat e klasifikuara nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit si të afërta me të (shërbimin).

6.2. Komisioni i vlerësimit përzgjedh dy nga kandidatët më të mirë konkurrues dhe ia përcjell ato Bordit të Qendrës Spitalore Universitare, i cili zgjedh një prej tyre dhe ia paraqet, për emërim, rektorit të institucionit të arsimit të lartë e Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Universitare.

6.3. Bordi dhe Drejtoria e Përgjithshme e Qendrës Spitalore Universitare vlerësojnë çdo pesë vjet veprimtarinë e njësisë së shërbimit dhe të përgjegjësit të saj.

Neni 12/1

### **Qendrat spitalore universitare**

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 5)*

1. Qendrat spitalore universitare janë njësi të sistemit arsimor dhe të sistemit shëndetësor. Ato realizojnë funksione mësimore e kërkimore, si pjesë e universitetit/fakultetit, si dhe funksione diagnostike e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, si pjesë e sistemit shëndetësor.

2. Qendrat spitalore universitare miratohen si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Shëndetësisë.

3. Qendra spitalore universitare përbëhet nga njësitë e shërbimeve.

4. Veprimtaria e qendrës spitalore universitare rregullohet me statutin e saj, i cili miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Shëndetësisë.

5. Fakultetet që ofrojnë programe studimi të fushave mjekësore mund të lidhin marrëveshje ose kontrata me spitalet e tjera jouniversitare për formimin praktik të studentëve dhe atë të kërkimit shkencor.

### KREU III

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

##### Neni 13

#### **Organet drejtuese dhe administruese në institucionet publike të arsimit të lartë**

*(Shtuar fjalët në fund të pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 6)*

1. Organe drejtuese dhe administruese në institucionet publike të arsimit të lartë janë: senati akademik, rektorati, këshilli i administrimit, këshilli i etikës dhe këshilli i fakultetit ose institutit.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë kanë të drejtë të formojnë dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e tyre.

##### Neni 14

#### **Senati akademik**

*(Shtuar fjalët në shkronjën "e" të pikës 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 7/1;*

*shtuar shkronja "gj" në pikën 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 7/1)*

1. Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës i institucioneve të arsimit të lartë, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.

2. Funkcionet kryesore të senatit akademik janë:

a) garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve;

b) miraton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;

c) vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e institucionit, pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit;

ç) miraton ndarjen e burimeve financiare;

d) miraton projektstatutin e institucionit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;

dh) miraton rregulloret e institucionit, që janë kompetencë e tij;

e) vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit apo pjesë të tyre si dhe hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore;

ë) vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore;

f) vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;

g) siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e institucionit, që garantojnë cilësinë dhe transparencën e duhur etj;

gj) miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore, si dhe atë financiar, në një mbledhje të hapur për gjithë personelin akademik e administrativ dhe për studentët.

3. Senati akademik kërkon mendimin e këshillit të administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit.

4. Funkcionimi i senatit akademik, përbërja, si dhe të drejta dhe detyra të tjera të tij përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj.



## Neni 15 **Rektorati**

1. Rektorati është organ kolegjal ekzekutiv, që përbëhet nga:
  - a) rektori;
  - b) zëvendësrektori/ët;
  - c) dekani/drejtori i çdo fakulteti dhe njësie tjetër kryesore;
  - ç) kancelari i institucionit.Rektorati kryesohet nga rektori.
2. Funkcionet kryesore të rektoratit janë:
  - a) harton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit;
  - b) harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në senatin akademik;
  - c) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
  - ç) parashtron përparësitë mes kërkesave konkurruese për financime mes njërive kryesore të institucionit;
  - d) harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në senatin akademik;
  - dh) harton planin për investime, kontratat dhe marrëveshjet, që janë kompetencë e tij;
  - e) paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
  - ë) zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga senati akademik dhe këshilli i administrimit;
  - f) monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit;
  - g) përgatit marrëveshjen ndërmjet institucionit të arsimit të lartë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për rregullat e financimit;
  - gj) propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
  - h) përgatit rregulloren e tij të punës, që miratohet nga senati akademik.
3. Rektorati kërkon mendimin e senatit akademik dhe të këshillit të administrimit për aspekte të kompetencës së këtyre të fundit.
4. Rektorati raporton një herë në semestër në senatin akademik dhe në këshillin e administrimit.
5. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe financiare dhe ia paraqet atë për miratim senatit akademik dhe këshillit të administrimit brenda datës 20 dhjetor të çdo viti.
6. Rektorati ka të drejtë t'ia delegojë kompetencat personelit apo organit tjetër të institucionit, në përputhje me rregulloren e tij.
7. Në statutin e institucionit publik të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj, përcaktohen të drejta dhe detyra të tjera, si dhe funksionimi i rektoratit.

## Neni 16 **Këshilli i administrimit**

1. Në institucionet e arsimit të lartë ngrihen dhe funksionojnë këshillat e administrimit. Këshilli i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtaritë e institucionit të arsimit të lartë, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të tij.
2. Funkcionet kryesore të këshillit të administrimit janë:
  - a) miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
  - b) miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e institucionit me dy të tretat e votave;
  - c) vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;

- c) miraton strukturën dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
  - d) miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga rektorati;
  - dh) vlerëson planin e zhvillimit të institucionit e programin vjetor të veprimtarive të tij;
  - e) miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
  - ë) miraton rregulloren e funksionimit të tij.
3. Rektori dhe kancelari i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky këshill.
4. Këshilli i administrimit përbëhet nga:
- a) anëtarë të personelit akademik, së paku me gradë shkencore, të zgjedhur drejtpërdrejt nga personeli akademik i çdo njësie kryesore të institucionit;
  - b) anëtarë të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga fushat e shkencës, ekonomisë, kulturës, autoritete të pushtetit qendror dhe vendor;
  - c) një anëtar, përfaqësues i zgjedhur nga këshilli i studentëve të institucionit.
5. Anëtarët, sipas shkronjës “b” të pikës 4 të këtij neni, caktohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Numri i anëtarëve të caktuar është një më pak se gjysma e numrit të anëtarëve të këshillit të administrimit. Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin, prej anëtarëve të brendshëm të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.
6. Anëtarësia në këshillin e administrimit është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të senatit akademik, të zëvendësrektorëve, të dekanëve/drejtorëve dhe të zëvendësdekanëve/zëvendësdrejtorëve.
7. Në statutin e institucionit publik të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj, përcaktohen të drejta dhe detyra të tjera të këshillit të administrimit, numri, përbërja, mandati, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve, sipas shkronjës “a” të pikës 4 të këtij neni, si dhe funksionimi i këshillit.

#### Neni 17

##### **Këshilli i etikës**

1. Këshilli i etikës ngrihet pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe diskuton probleme të etikës së jetës universitare. Ai i bën propozime rektorit për këto çështje.
2. Anëtarët e këshillit të etikës përzgjidhen nga senati akademik. Këshilla të etikës mund të ngrihen edhe pranë fakulteteve.
3. Përbërja, të drejtat, detyrat, organizimi e funksionimi i këshillit të etikës përcaktohen në statutet e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe në rregulloret e tyre të brendshme.

#### Neni 18

##### **Këshilli i fakultetit dhe njërive të tjera kryesore**

*(Ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 8; shtuar fjala në pikën 3 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 8/2)*

1. Këshilli i fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës, që programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. Ai propozon për programe të reja studimi a të kërkimit shkencor, për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh a njësish të tjera; merr vendime për problemet financiare të fakultetit, shqyrton e miraton, në një mbledhje të hapur për personelin akademik administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të fakultetit. Këshilli i fakultetit i propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

Këshilli i fakultetit kryesohet nga dekani.

2. Në statutin e institucionit të arsimit të lartë përcaktohen, në përputhje me këtë ligj, të drejta dhe detyra të tjera, si dhe funksionimi i këshillit të fakultetit.

3. Këshillat e njërive të tjera kryesore të institucioneve të arsimit të lartë janë organe kolegjiiale vendimmarrëse, me funksione të ngjashme me ato të këshillit të fakultetit. Detyra

specifike të tyre, funksionimi dhe përbërja përcaktohen në statutin e institucionit dhe në rregulloret e tij.

Neni 19

### **Këshilli i profesorëve**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 9)*

1. Për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës, në njësitë kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe studimi të ciklit të tretë, ngrihet Këshilli i Profesorëve. Këshilli i Profesorëve mund të ngrihet edhe në nivel të institucionit të arsimit të lartë, kur njësitë kryesore të tij nuk përmbushin numrin e nevojshëm të profesorëve me kohë të plotë. Nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit të Profesorëve individë që kanë dalë në pension edhe në rastet kur ata janë të angazhuar në mësimdhënie në një institucion të arsimit të lartë, në përputhje me nenet 48 e 49 të këtij ligji.

2. Përbërja, detyrat dhe funksionimi i këshillit të profesorëve përcaktohen në statutin e institucionit dhe në akte të tjera nënligjore.

Neni 19/1

### **Organet drejtuese të qendrave spitalore universitare të institucioneve të arsimit të lartë publik**

*(Shtuar neni me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 10)*

1. Qendrat spitalore universitare të institucioneve të arsimit të lartë publik drejtohen nga Bordi dhe Drejtorja e Përgjithshme.

2. Bordi është organi më i lartë drejtues, që kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë ose zëvendësministri i deleguar prej tij dhe ka në përbërje katër anëtarë:

- a) Rektori i institucionit të arsimit të lartë;
- b) Dekanin e Fakultetit të Mjekësisë;
- c) Kryetarin e Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë;
- ç) Drejtorin e Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor (ISKSH).

3. Bordi miraton politikat dhe strategjinë e zhvillimit, si dhe harton programet tekniko-financiare të veprimtarisë së qendrës, në përputhje me politikat qeverisëse për shëndetësinë, arsimin e lartë e kërkimin shkencor, si dhe planin e zhvillimit strategjik të universitetit e të fakulteteve të fushës së shëndetit.

4. Funksionet kryesore të bordit janë si më poshtë:

- a) i propozon Kryeministrit dy kandidatë, për emërim, në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Universitare, të përzgjedhur me konkurs;
- b) zgjedh, në bazë të konkursit të zhvilluar, kandidaturat për nëndrejtorë të përgjithshëm dhe ia dërgon ata për emërim e drejtorit të përgjithshëm dhe rektorit të institucionit të arsimit të lartë;
- c) zgjedh përgjegjës të shërbimit në Qendrën Spitalore Universitare, në bazë të kandidaturave të përzgjedhura nga komisioni ad hoc i konkursit;
- ç) miraton planin e projektbuxhetit, strukturën dhe organikën e Qendrës Spitalore Universitare;
- d) miraton raportin e veprimtarisë së Qendrës Spitalore Universitare;
- dh) miraton raportin e veprimtarisë financiare dhe bilancin e Qendrës Spitalore Universitare;
- e) miraton statutin e Qendrës Spitalore Universitare dhe rregulloret e funksionimit të saj;
- ë) kryen funksione të tjera, në përputhje me këtë ligj dhe statutin e rregulloret e Qendrës Spitalore Universitare.

5. Bordi mblidhet jo më pak se 4 herë në vit.

6. Drejtorja e Përgjithshme e Qendrës Spitalore Universitare është organi i vetëm ekzekutiv, që, nën mbikëqyrjen e bordit, drejton dhe organizon veprimtarinë mjekësore, financiare, administrative dhe teknike të kësaj qendre.

7. Drejtori i Përgjithshëm është autoriteti drejtues i Qendrës Spitalore Universitare.
8. Në statutin e Qendrës Spitalore Universitare përcaktohen, në përputhje me këtë ligj, të drejta dhe detyra të tjera, si dhe mënyra e funksionimit të bordit dhe Drejtorisë së Përgjithshme.

#### Neni 20

##### **Autoritetet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë**

*(Shtuar fjalët në shkronjën “a” të pikës 1 me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, neni 2;  
shtuar fjalia në fund të pikës 1 me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, neni 2;  
ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, neni 2;  
ndryshuar shkronja “c” e pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 11)*

1. Autoritete drejtuese në një institucion publik të arsimit të lartë janë:

- a) rektori, drejtori i qendrës ndëruniversitare;
- b) dekani/drejtori;
- c) përgjegjësi i njësisë bazë.

Rektori është autoriteti drejtues i institucionit të arsimit të lartë, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij. Dekani është autoriteti drejtues i fakultetit dhe përfaqësuesi ligjor i tij. Drejtori është autoriteti drejtues i një instituti të kërkimit dhe zhvillimit ose i një filiali (në rast se ai nuk ka statusin e fakultetit ose të departamentit) dhe e përfaqëson atë.

Drejtori i qendrës ndëruniversitare është autoriteti drejtues i qendrës, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të saj.

2. Autoritetet drejtuese rektor/dekan në institucionet publike të arsimit të lartë duhet të kenë të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.

3. Për institucionet e arsimit të lartë, në varësi të Ministrisë së Brendshme, autoriteti drejtues, i barasvlefshëm me rektorin ose dekanin, ka të drejtë të jetë komandanti ose drejtori.

4. Për postin e autoriteteve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të konkurrojnë individë të personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose individë jashtë tij. Këta të fundit, në rastin kur rezultojnë fitues, bëhen anëtarë të personelit akademik të institucionit.

5. Kriteria të tjera, që duhet të plotësojnë autoritetet drejtuese ose anëtarët e organeve drejtuese, detyrat dhe të drejtat e këtyre autoriteteve, që burojnë nga ky ligj, përcaktohen në statutet dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë.

#### Neni 21

##### **Zgjedhja e organeve dhe e autoriteteve drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë**

*(Shtuar fjalët në fillim të pikës 5 me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, neni 3;  
ndryshuar pika 5 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 12/1;  
shfuqizuar pikat 6 dhe 7 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 12/2)*

1. Në institucionet publike të arsimit të lartë organet dhe autoritetet e tyre drejtuese zgjidhen.

2. Organet drejtuese të një institucioni publik të arsimit të lartë përcaktohen si më poshtë:

- a) senati akademik përbëhet nga anëtarë, personel akademik, personel joakademik dhe studentë, të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit;
- b) këshilli i fakultetit përbëhet nga anëtarë të personelit akademik, të personelit joakademik dhe studentë, të zgjedhur drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të fakultetit;
- c) këshilli i instituteve të kërkimit dhe zhvillimit përbëhet nga anëtarë të personelit të tyre akademik dhe përfaqësues të personelit joakademik, të zgjedhur drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institutit;

ç) këshilli i kolegjit profesional përbëhet, në shumicën e tij, nga anëtarë të personelit akademik, të personelit joakademik dhe studentë, të zgjedhur drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të kolegjit. Në përbërje të këtij këshilli bëjnë pjesë edhe përfaqësues të komunitetit të biznesit, sipas llojit të programeve të studimit që kolegji profesional ofron;

d) senatet akademike dhe këshillat e fakulteteve, të instituteve dhe të qendrave përbëhen 15 për qind nga studentë, 5 për qind nga personel joakademik dhe pjesa tjetër nga personel akademik.

3. Autoritetet drejtuese në një institucion publik të arsimit të lartë zgjidhen sipas modaliteteve të mëposhtme:

a) rektori i institucioneve publike të arsimit të lartë zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e institucionit;

b) dekani/drejtori zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli joakademik dhe studentët e fakultetit/institutit të kërkimit dhe zhvillimit/kolegjit profesional;

c) përgjegjësi i departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik respektiv.

4. Në zgjedhjen e autoriteteve drejtuese, votat e studentëve dhe votat e personelit joakademik përlllogariten me përqindje, ato vlejné 20 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për studentët dhe 5 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për personelin joakademik.

5. Drejtori i Qendrës Ndëruniversitare përzgjidhet me konkurs të hapur. Kandidati fitues propozohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe emërohet nga Presidenti i Republikës. Drejtorët e njësive përbërëse të Qendrës Ndëruniversitare përzgjidhen me konkurs të hapur dhe emërohen nga Drejtori i Qendrës Ndëruniversitare. Kriteret dhe procedurat e zhvillimit të konkursit përcaktohen në statutin e Qendrës Ndëruniversitare.

6. Shfuqizuar.

7. Shfuqizuar.

8. Presidenti i Republikës emëron rektorin e zgjedhur. Rektori emëron dekanin/drejtorin e zgjedhur. Dekani/drejtori emëron përgjegjësin e departamentit/ qendrës së kërkimit dhe zhvillimit.

9. Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall ditën e fillimit të procesit zgjedhor në institucionet publike të arsimit të lartë. Zgjedhjet zhvillohen sipas rregullores së zgjedhjeve, të përgatitur dhe miratuar nga institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj. Rregullorja e zgjedhjeve përcakton procedurat dhe kriteret për organizimin e zgjedhjeve në të gjitha nivelet për organet dhe autoritetet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë.

## Neni 22

### **Autoritete të tjera të institucioneve publike të arsimit të lartë**

*(Shtuar fjalia në fund të pikës 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 13/1;*

*shtuar fjalia në fund të pikës 6 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 13/2)*

1. Autoritete të tjera të institucionit publik të arsimit të lartë janë:

a) kancelari i institucionit;

b) zëvendësrektori/ët;

c) zëvendësdekani/ët apo zëvendësdrejtori/ët;

ç) kancelari i fakultetit ose i njësive të tjera kryesore.

2. Kancelari i institucionit është përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të institucionit, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. Ai nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ, në institucionin e arsimit të lartë.

3. Kandidatura për kancelar e një institucioni të arsimit të lartë përzgjidhet nga këshilli i administrimit dhe rektori ia paraqet atë Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratim. Kancelari i një institucioni të arsimit të lartë duhet të ketë formim universitar, juridik ose ekonomik dhe së paku 5 vjet përvojë pune. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit të kancelarit të institucionit përcaktohet me akt të veçantë.

4. Zëvendësrektorët emërohen dhe shkarkohen nga rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në senatin akademik.

5. Zëvendësdekanët/zëvendësdekanët emërohen dhe shkarkohen nga dekan/drejtori pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në këshillin e fakultetit/institutit të kërkimit dhe zhvillimit.

6. Kancelari i fakultetit ose i njësive të tjera kryesore është përgjegjës për drejtimin e përditshëm, administrativ dhe financiar të fakultetit, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë. Ai nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ, në njësinë kryesore a në institucionin e arsimit të lartë.

7. Kancelari i fakultetit ose i njësive të tjera kryesore duhet të ketë formim universitar, juridik ose ekonomik dhe së paku 5 vjet përvojë pune. Ai emërohet nga rektori mes tri kandidaturave të propozuara nga këshilli i administrimit i institucionit.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë në statutet dhe rregulloret e tyre të drejta dhe detyra të tjera të këtyre autoriteteve, si dhe kualifikimet respektive.

#### Neni 23

### **Kohëzgjatja e mandatit për organet dhe autoritetet drejtuese**

*(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, neni 4;  
zëvendësuar fjala në pikën 5 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 14)*

1. Organet dhe autoritetet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë zgjidhen për një mandat 4-vjeçar. Autoritetet drejtuese nuk mund të rizgjidhen për dy mandate radhazi në të njëjtin funksion.

2. Rektori i një institucioni të ri publik të arsimit të lartë emërohet nga Presidenti i Republikës, sipas propozimit të bërë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me një mandat njëvjeçar në drejtim. Ky mandat mund të përsëritet, por jo më shumë se dy herë radhazi.

3. Rektori, i emëruar sipas pikës 2 të këtij neni, cakton dekanin/drejtorin. Dekani/drejtori i emëruar cakton përgjegjësin e departamentit/qendrës së kërkimit dhe zhvillimit.

4. Postet për autoritetet drejtuese, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, kriteret që këto autoritete duhet të plotësojnë dhe procedurat për përzgjedhjen e tyre bëhen publike.

5. Senati, këshilli i fakultetit, institutit, qendrës së një institucioni të ri publik të arsimit të lartë përbëhen nga i gjithë personeli akademik i institucionit, që gëzon së paku titullin "Doktor". Ata qëndrojnë në këtë detyrë deri në zgjedhjen e organeve drejtuese, sipas këtij ligji. Për këtë periudhë funksionet e këshillit të administrimit kryhen nga senati akademik.

6. Mandati për organet dhe autoritetet e tjera drejtuese dhe administruese të një institucioni të ri publik të arsimit të lartë është i njëjtë me atë të rektorit.

#### KREU IV

### **ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

#### Neni 24

### **Format e studimeve**

1. Format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë janë:

- a) studime me kohë të plotë;
- b) studime me kohë të pjesshme;
- c) studime në distancë.

2. Aplikimi dhe zbatimi i çdonjëres nga format e studimit, të parashikuara në këtë nen, bëhet me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Neni 25  
**Programet e studimeve**

1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.

2. Programet e studimeve hartohen nga vetë institucionet dhe miratohen në senatet e tyre akademike.

3. Institucionet e arsimit të lartë shpallin publikisht programet e akredituara të studimeve që ofrojnë, para fillimit të aplikimeve për pranime në to.

Neni 26  
**Ciklet dhe titujt e studimeve universitare**  
*(Ndryshuar neni me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 15)*

1. Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.

1.1 Studimet e ciklit të parë:

a) programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh;

b) programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) (më tej: kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike;

c) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

1.2. Studimet e ciklit të dytë:

1.2.1. Programet e studimeve “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”:

a) programet e studimeve të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti;

b) programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” në fushën e arsimimit të kryer.

1.2.2. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë:

a) institucionet e arsimit të lartë në fushat e mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës ofrojnë programe të integruara të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë së bashku;

b) programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë realizohen me jo më pak se 300 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është jo më pak se 5 vite akademike;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të programeve të integruara të studimeve lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” në fushën e arsimimit të kryer.

1.2.3. Programet e studimeve “Master profesional”:

a) programet e studimeve “Master profesional” u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë universitare së paku “Bachelor”, arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional;

b) programet e studimeve “Master profesional” realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare “Master profesional” në fushën e arsimitit e të trajnimit profesional të kryer;

d) institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të pranojnë kandidatë që kanë fituar diplomë “Master profesional” në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe të vendosin kritere për njohjen/transferimin e krediteve të vlefshme të fituara në studimet e masterit që i përgjigjen programit të studimeve të ciklit të dytë.

1.3. Studimet e ciklit të tretë:

1.3.1. Programet e studimeve të doktoratës:

a) programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese;

b) në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”;

c) këto programe të studimeve zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike. Institucionet e arsimit të lartë, në bazë të rezultateve të arritura në studimet e organizuara teorike, vendosin kritere klasifikimi për kandidatët që kanë të drejtë të zhvillojnë projektin kërkimor dhe të përgatisin tezën e doktoratës. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë standarde e kritere kualifikuese për njohjen e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, si dhe metoda për vlerësimin e nivelit teorik të përgjithshëm të kandidatëve. Kandidatët, që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të vazhduar më tej studimet e doktoratës dhe pajisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditet e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre;

ç) në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr).

1.3.2. Programet e studimeve specializuese afatgjata:

a) programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional, që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta në fushat e mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të inxhinierisë, të veterinarisë dhe të drejtësisë etj. Këto programe të studimeve përfshijnë studime teorike, të kombinuara me aplikime praktike e trajnime profesionale. Programet e studimeve specializuese në drejtësi realizohen në kuadër të Shkollës së Magjistraturës, që rregullohet me ligj të veçantë;

b) për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara;

c) studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;

ç) në përfundim të programeve të studimeve specializuese afatgjata lëshohet diplomë universitare specializimi me titullin në fushën përkatëse.

1.3.3. Në fushën e mjekësisë, programet e studimeve të doktoratës mund të ofrohen të integruara me studimet specializuese afatgjata, sipas planit dhe programit mësimor, të miratuar nga fakulteti dhe universiteti përkatës.

2. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë vetëm në ato fusha, ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore, në përputhje me këtë ligj.

3. Programet e studimeve të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë janë programe të studimeve universitare.

4. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të ofrojnë edhe programe të studimeve jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me jo më pak se 120 kredite. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve është jo më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimitit të kryer. Kreditet e akumuluar gjatë studimeve pas arsimit të mesëm mund të transferohen në studimet universitare të ciklit të parë, në përputhje me



kriteret që vendosin institucionet e arsimit të lartë.

5. Në statutet e institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen rregulla të hollësishme për programet e studimeve.

#### Neni 27

##### **Elemente të programeve të studimeve**

*(Zëvendësuar fjala në shkronjën “b” të pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 16/1; ndryshuar shkronja “dh” e pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 16/2)*

1. Programet e studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, si dhe ato specializuese ose të formimit të vazhduar duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:

a) të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesorë, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;

b) klasifikimin e programit të studimit, që bëhet i zbatueshëm me krijimin e kuadrit kombëtar të kualifikimeve;

c) kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimeve me numër të kufizuar;

ç) metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program;

d) kushtet për transferime ndërmjet programeve dhe kushtet për përfundimin e pjesëshëm të programit, nëse ai e parashikon këtë gjë;

dh) titujt akademikë dhe profesionalë, që akordohen sipas legjislacionit në fuqi.

2. Programet e studimeve të doktoratës ndërtohen si programe individuale për aftësim në kërkim shkencor të pavarur. Në to duhet të përcaktohen, veç të tjerave, fusha e studimit, përmbajtja dhe veprimtaria kërkimore.

3. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statute dhe rregullore elemente më të hollësishme të programeve të ndryshme të studimeve.

#### Neni 28

##### **Programet e studimeve ndërdisiplinore**

1. Brenda një institucioni të arsimit të lartë, fakultetet mund të organizojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore. Programe të tilla mund të organizohen edhe nga fakultete të institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.

2. Në përfundim të programeve të studimeve ndërdisiplinore lëshohet diplomë e përbashkët nga të dy institucionet e arsimit të lartë.

#### Neni 29

##### **Programet e studimeve të përbashkëta**

1. Programet e studimeve të përbashkëta realizohen në një institucion të arsimit të lartë ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

2. Programet e studimeve të përbashkëta organizohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë.

#### Neni 30

##### **Programet e studimeve të formimit të vazhduar**

1. Në vijim të programeve të ndryshme të studimeve, institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive. Ato mund të jenë dhe programe të kërkimit të avancuar. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit të tyre dhe të aftësive profesionale.

2. Në kuadër të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, institucionet e arsimit të lartë organizojnë edhe forma të tjera të ndryshme të mësimit informal si kurse, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme.

3. Struktura e programeve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen në mënyrë të pavarur nga secili institucion i arsimit të lartë.

4. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, institucionet e arsimit të lartë lëshojnë certifikatat përkatëse.

#### Neni 31

#### **Lëshimi i diplomave, certifikatave dhe dokumenteve të tjera** (Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 17)

1. Institucionet e arsimit të lartë pajisin studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

2. Diplomat, që jepen në përfundim të programeve të ciklit të parë, të ciklit të dytë apo të integruara, shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës.

3. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve, që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës etj.

4. Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga senatet akademike, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Individët, që kanë plotësuar detyrimet e një programi të formimit të vazhduar ose pjesë të një programi studimi pajisen me diplomat ose certifikatat përkatëse, që janë dokument zyrtar.

6. Çdo formë diplome ose certifikate, përpara se të lëshohet nga institucioni i arsimit të lartë, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 32

#### **Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies**

1. Studimet në institucionet publike të arsimit të lartë zhvillohen me bazë vitin akademik. Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall datën e fillimit të vitit akademik.

2. Viti akademik organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë në javë.

3. Organizimi i mësimdhënies për programet e studimeve të formimit të vazhduar përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

#### Neni 33

#### **Pranimi në ciklin e parë të studimeve**

(Shfuqizuar pika 3 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 18/1;  
ndryshuar pika 5 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 18/2)

1. Çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar me sukses Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

2. Kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ministria e Arsimit dhe Shkencës formulon propozimin e saj pas konsultimit me institucionet publike të arsimit të lartë dhe rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

3. Shfuqizuar.

4. Kuotat dhe kriteret e pranimi për ciklin e parë të studimeve për studentët e huaj në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë bëhen sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni. Në përcaktimin e kuotave respektohen marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.

5. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të propozojnë kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Këto kritere shqyrtohen dhe vlerësohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në këshillim me Konferencën e Rektorëve dhe Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe, mbi këtë bazë, ministri miraton, me udhëzim, kriteret dhe procedurat e pranimit në ciklin e parë të studimeve.

#### Neni 34

#### **Pranimi në ciklin e dytë e në ciklin e tretë të studimeve** (Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 19)

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv.

2. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e tretë të studimeve kandidatë që kanë fituar diplomë universitare "Master i shkencave"/"Master i arteve të bukura" ose një diplomë ekuivalente me të, si dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga institucioni përkatës.

3. Kriteret e pranimit për standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë të studimeve përcaktohen në statutet e institucioneve të arsimit të lartë, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

4. Kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ministria e Arsimit dhe Shkencës formulon propozimin e saj pas konsultimit me institucionet publike të arsimit të lartë dhe rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

5. Kuotat e pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet publike të arsimit të lartë në varësi të Ministrisë së Brendshme, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrisë përkatëse.

#### Neni 35

#### **Transferimet**

(Zëvendësuar fjalët në pikën 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 20)

1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë mundësi për transferime të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël, brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë.

2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë që pranon studentin, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e saj.

#### Neni 36

#### **Ndjekja e një programi të dytë studimi**

Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve. Nga ky rregull përjashtohen studentët e shkëlqyer.

Në statutet e institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen kriteret që duhet të plotësohen për t'u pranuar në një program të dytë studimi.

#### Neni 37

### **Njohja e diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të huaj**

1. Nëpërmjet procedurës së njohjes, një diplomë e huaj njësohet me një diplomë shqiptare nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin dhe e së drejtës për punësim. Kjo vlen dhe për njohjen e certifikatave, gradave ose titujve të huaj.

2. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të diplomave ose certifikatave, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, është Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila e kryen këtë proces nëpërmjet njësisë përgjegjëse të njohjes së diplomave, që funksionon edhe si Qendra Kombëtare e Njohjes së Diplomave dhe e Informimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të autorizojë institucionet e arsimit të lartë për kryerjen e këtij procesi për rastet e njësimit të diplomës nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin. Këto raste përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave ose titujve shkencorë, të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, është Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë.

4. Procedurat dhe kriteret për njohjen e diplomave, certifikatave, gradave e titujve, të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, përcaktohen me akt të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim.

#### Neni 38

### **Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve**

1. Nëpërmjet ekuivalentimit, pjesë ose programe të plota studimi ose diploma të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

2. Ekuivalentimi bëhet nga institucioni i arsimit të lartë, pranë të cilit është paraqitur kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm.

3. Procedurat dhe kërkesat për ekuivalentim përcaktohen në statutet e institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore.

## KREU V

### **HAPJA, NDRYSHIMI OSE MBYLLJA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

#### Neni 39

### **Statuti dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë**

1. Statuti i një institucioni publik të arsimit të lartë përmban normat që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

2. Statuti hartohet dhe ndryshohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij dhe miratohet nga senati akademik i institucionit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij. Statuti i dërgohet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës që, brenda dy muajve, kryen kontrollin e ligjshmërisë së tij. Kur konstatohen shkelje të ligjshmërisë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës ia kthen statutin për ripunim institucionit përkatës të arsimit të lartë. Kur Ministri i Arsimit dhe Shkencës nuk ka vërejtje për ligjshmërinë e statutit ose nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar, rektori e shpall atë duke e konsideruar të miratuar. Ndryshimet në statut miratohen me të njëjtat procedura.

3. Institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e tyre përbërëse rregullojnë veprimtarinë e tyre mbështetur në rregulloret e tyre të brendshme, që hartohen nga vetë institucioni në përputhje me këtë ligj dhe statutin e institucionit. Rregulloret miratohen sipas mënyrës së përcaktuar në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

4. Në statut, në përputhje me këtë ligj dhe aktin e hapjes së institucionit të arsimit të lartë, përcaktohen hollësisht organizimi i institucionit, veprimtaritë dhe puna e strukturave përbërëse të tij, e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhja ose përzgjedhja e tyre, nivelet e delegimit të autoritetit nga organet drejtuese e administruese, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, joakademik ose të studentëve, si edhe detyra të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë.

#### Neni 40

##### **Emri dhe stema e institucioneve të arsimit të lartë**

Çdo institucion i arsimit të lartë ka emrin zyrtar dhe stemën e tij, të cilat përcaktohen në aktin e hapjes së tyre. Institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të propozojë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ndryshime të emrit ose stemës së institucionit. Këto propozime bëhen nga titullari i institucionit, mbështetur në vendimin e senatit akademik.

#### Neni 41

##### **Hapja, mbyllja dhe ndryshimi i një institucioni publik të arsimit të lartë**

*(Ndryshuar pika 5 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 21)*

1. Hapja e një institucioni publik të arsimit të lartë, mbyllja e tij ose bashkimi me ndonjë institucion tjetër publik të arsimit të lartë, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Hapja e një institucioni të ri publik të arsimit të lartë bëhet me plotësimin e standardeve akademike dhe të kushteve të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo akte të tjera nënligjore, të nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit.

3. Mbyllja e një institucioni të arsimit të lartë apo bashkimi me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë kërkon paraprakisht mendimin e senatit akademik ose senateve akademike të institucioneve të arsimit të lartë, të përfshira në veprimet respektive.

4. Standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, ndryshimin dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë miratohen nga Këshilli i Ministrave, sipas propozimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

5. Hapja e njësive të reja kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, riorganizimi ose mbyllja e tyre bëhen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në bazë të propozimit të institucionit të arsimit të lartë.

6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, para se të marrë vendim sipas pikave 2, 3 dhe 5 të këtij neni, kërkon vlerësimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

7. Për institucionet publike të arsimit të lartë, që nuk janë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, këto të drejta i ushtrojnë ministrinë përkatëse.

#### Neni 42

##### **Hapja, mbyllja, riorganizimi dhe përshtatja e programeve të studimeve të të gjitha cikleve të arsimit të lartë publik**

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 22)*

1. Hapja e programeve të reja të studimeve të të gjitha cikleve të arsimit të lartë publik, riorganizimi dhe mbyllja e tyre bëhen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesës së institucionit të arsimit të lartë. Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë t'i kërkojë institucionit publik të arsimit të lartë hapjen e programeve të reja të studimeve në fusha prioritare.

2. Përshtatja e programeve/profileve të studimeve të miratuara sipas këtij ligji, që nuk cenojnë objektivat bazë të tyre, bëhet me propozimin e njësisë bazë dhe me miratimin e këshillit të njësisë kryesore, pasi të merret pëlqimi i senatit akademik të institucionit të arsimit të lartë.

3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës merr vendim, sipas pikës 1 të këtij neni, mbështetur në vlerësimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

## KREU VI ARSIMI I LARTË PRIVAT

### Neni 43

#### **Institucionet private të arsimit të lartë**

1. Institucionet private të arsimit të lartë krijohen dhe funksionojnë sipas këtij ligji, përveç kur ligji flet specifikisht për institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në mënyrë specifike për to.

2. Një institucion privat i arsimit të lartë ka të drejtë të krijohet me kërkesë të një subjekti juridik, vendas ose të huaj. Subjekti juridik është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë, administrimin dhe financimin e institucionit të hapur me kërkesën e tij.

3. Një institucion privat i arsimit të lartë fillon veprimtarinë e tij vetëm pas marrjes së licencës. Licencimi i tij bëhet kur ai plotëson standardet dhe kriteret shtetërore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, sipas propozimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Modeli i licencës përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

### Neni 44

#### **Licencimi i një institucioni privat të arsimit të lartë**

*(Shfuqizuar pika 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 23/1;*

*ndryshuar pika 4 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 23/2;*

*zëvendësuar fjalët në shkronjën "a" të pikës 7 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 23/3/a;*

*shtuar fjalët në fund të shkronjës "ç" të pikës 7 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 23/3/b)*

1. Subjekti që kërkon të hapë një institucion privat të arsimit të lartë, paraqet projektin e tij në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Shfuqizuar.

3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcakton dokumentacionin që duhet të përmbajë projekti i paraqitur për dhënien e licencës dhe që ka të bëjë me misionin dhe objektivat afatgjatë të institucionit, programet e studimeve, skemën e financimit, si dhe afatet dhe procedurat për shqyrtimin e projekteve.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës shprehet me vendim të argumentuar për projektin e paraqitur, mbështetur në vlerësimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë për programet e studimit, të paraqitura në projekt.

5. Një institucion privat, që zotëron një formë akreditimi nga një shtet tjetër, është i detyruar të paraqesë një certifikatë për këtë akreditim në këshillin e akreditimit, i cili bën vlerësimin e tij në përputhje me licencën e kërkuar, sipas dispozitave të këtij ligji.

6. Kur projekti për veprimtaritë, programet e studimeve, burimet materiale e financiare për hapjen e institucionit privat dhe statuti i institucionit janë në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës përcjell propozimin e saj në Këshillin e Ministrave për dhënien e licencës.

7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës refuzon një projekt në këto raste:

a) Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë jep vlerësim negativ për të gjitha programet e studimeve;

b) institucioni i kërkuar i arsimit të lartë nuk provon se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme financiare dhe të infrastrukturës për veprimtaritë e kërkuara;

c) statuti i tij është në konflikt me aktet ligjore në fuqi;

ç) raste të tjera të argumentuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin e refuzimit të një projekti të paraqitur, Ministria e Arsimit dhe Shkencës informon aplikantin për vendimin dhe shkaqet e marrjes së tij. Vendimi mund të apelohej në gjykatë.

8. Licenca e dhënë bëhet e pavlefshme në rastet kur institucioni privat nuk fillon veprimtarinë mësimore-shkencore as në vitin akademik pasardhës.

9. Licenca për fillimin e veprimtarisë së një institucioni privat përmban edhe detyrimin, që në rastin kur ai institucion ndërpret veprimtarinë e tij, të ofrojë mjetet e nevojshme financiare dhe mundësitë për përfundimin e studimeve të filluara, për të gjithë studentët që janë të regjistruar në institucion.

10. Një institucion privat ndërpret veprimtarinë vetëm në fund të vitit të akademik.

Neni 44/1

### **Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimeve të cikleve të arsimit të lartë privat**

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 24)*

1. Hapja e programeve të reja të studimeve të të gjitha cikleve të arsimit të lartë privat, mbyllja dhe riorganizimi i tyre bëhen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesës së institucionit të arsimit të lartë.

2. Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcakton dokumentacionin që duhet të përmbajë projekti i paraqitur për dhënien e lejes për hapjen e programeve të reja dhe që ka të bëjë me misionin e objektivat afatgjatë të institucionit, programet e studimeve, skemën e financimit, si dhe afatet e procedurat për shqyrtimin e projekteve.

3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i kërkon Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë të paraqesë vlerësimin e tij për programet e studimit, të paraqitura në projekt.

4. Ministri i Arsimit dhe Shkencës refuzon një projekt në rastet kur:

a) Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë jep vlerësim negativ për të gjitha programet e studimeve;

b) institucioni i kërkuar i arsimit të lartë nuk provon se është në gjendje të ofrojë garancitë e nevojshme financiare dhe të infrastrukturës për veprimtaritë e kërkuara.

Në rastin e refuzimit të një projekti të paraqitur, Ministria e Arsimit dhe Shkencës informon aplikantin për vendimin dhe për shkaqet e marrjes së tij.

Neni 45

### **Organizimi i studimeve në institucionet private të arsimit të lartë**

1. Organizimi i programeve të studimit në institucionet private të arsimit të lartë bëhet sipas:

a) përskrimeve të bëra në nenet 25, 26, 28, 29 dhe 30 të këtij ligji;

b) një modeli tjetër, kur ai ofrohet nga një institucion që jep diplomë të një institucioni të huaj ose të ngjashëm me të. Në këtë rast, ato duhet të shoqërohen edhe me vlerësimin në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), për të mundësuar njohjen e studimeve dhe transferimet e studentëve.

2. Një institucion privat i licencuar i arsimit të lartë, që ka organizim të programeve të studimit të ndryshëm nga ai i shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, është i detyruar ta njoftojë këtë publikisht, para se të fillojë regjistrimin e studentëve.

3. Institucionet private të arsimit të lartë duhet të paraqesin çdo fillim viti akademik gjendjen financiare të institucionit, përbërjen e stafit akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin në vazhdim, për secilin program studimi.

4. Për institucionet private të arsimit të lartë, të cilat nuk respektojnë këtë ligj, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, vendos masa konkrete deri në pezullimin e veprimtarisë së tyre për një periudhë deri në dy vjet (mospranim të studentëve të rinj) apo heqjen e licencës.

KREU VII  
PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Neni 46

**Personeli i institucioneve të arsimit të lartë**

1. Personeli i institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ.

2. Detyrat dhe të drejtat e personelit të institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen në statutin e institucioneve përkatëse e në rregulloret e tyre, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 47

**Personeli akademik dhe titujt akademikë**

*(Shtuar fjalët në shkronjën “a” të pikës 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 25/1/a; ndryshuar shkronja “c” e pikës 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 25/1/b; hequr fjalia e dytë në pikën 4 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 25/2; ndryshuar paragrafët e dytë dhe tretë të pikës 6 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 25/3)*

1. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillim të institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme përcaktohen në rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë dhe janë pjesë e kontratave të punës mes palëve.

2. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në: a) profesorë; b) docentë dhe c) lektorë.

a) Në kategorinë “Profesorë” janë anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë gradën shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus”, “Akademik i asociuar” dhe “Akademik”.

b) Në kategorinë “Docentë” janë anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë titullin akademik “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”.

c) Në kategorinë “Lektorë” janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Lektorët duhet të kenë të paktën diplomën “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” ose ekuivalente me të dhe të përmbushin kriteret që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Në kolegjet profesionale dhe në programet e studimeve jouniversitare, lektorët duhet të kenë diplomën “Master profesional”, sipas përcaktimit të nenit 26 të këtij ligji.

3. Ndarja në nivele, brenda secilës kategori, emërtimi dhe renditja e tyre, si dhe kriteret më të hollësishme kualifikimi për secilin rast përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, referuar edhe përshkrimin të vendit të punës.

4. Numri i përgjithshëm i personelit në çdo institucion publik të arsimit të lartë miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Niveli i pagave, sipas kategorive dhe vendeve të punës, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Titujt akademikë jepen nga institucione të arsimit të lartë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë. Titulli “Profesor i asociuar”, “Profesor emeritus” dhe “Docent” jepen nga institucionet e arsimit të lartë. Titulli “Profesor” jepet nga Këshilli i Vlerësimit të Titujve Akademikë.

Titujt “Akademik i asociuar” dhe “Akademik” jepen nga Akademia e Shkencave, në përputhje me ligjin për Akademinë e Shkencave.



Titulli “Docent” u jepet anëtarëve të personelit akademik që kanë gradën shkencore “Doktor”. Ai u jepet edhe anëtarëve të personelit akademik me, së paku, diplomë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura” ose ekuivalent i saj në vende të tjera, të vlerësuar me rezultatin “shumë mirë” ose “shkëlqyer” dhe që kanë veprimtari mësimore-kërkimore në një institucion të arsimit të lartë, jo më pak se 5 vjet, përjashtuar diplomat e ekuivalentuara, sipas paragrafit të katërt të nenit 89 të këtij ligji.

7. Kriteret dhe procedurat e dhënies së titujve akademikë “Docent”, “Profesor i asociuar”, “Profesor” dhe “Profesor emeritus” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 48

##### **Personeli akademik i ftuar**

1. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor, këshillat e fakulteteve, me propozim të departamenteve, ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme.

2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.

3. Kriteret e detajuara për aktivizimin dhe përzgjedhjen e lektorëve të ftuar përcaktohen në rregulloret e njësisë përkatëse kryesore.

#### Neni 49

##### **Personeli akademik me kontratë**

*(Shtuar fjalia pas fjalisë së parë të pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 26/1;  
shtuar pika 1.1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 26/2)*

1. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të punësojnë me kontratë personalitete, vendase ose të huaja, për periudha të shkurtra kohe. Te kjo kategori përfshihen edhe studiues, artistë dhe personalitete me kontribut të shquar jashtë vendit. Ky personel punësohet me vendim të senatit akademik, sipas propozimeve të njësisë kryesore të institucionit.

1.1 Autoritetet drejtuese të njësisë kryesore, me propozimin e përgjegjësve të njësisë bazë dhe të titullarit të grupit mësimor kërkimor, për të plotësuar nevojat e institucionit, punësojnë personel akademik me kohë të plotë për veprimtari mësimore e kërkimore, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme, sipas kërkesave të vendit të punës. Modalitetet e punësimit përcaktohen në statutin e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të punësojnë, mbi bazën e një kontrate të përkohshme, edhe studentë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës dhe të përgatitjes së disertacionit për gradën shkencore “Doktor”, të cilët mbështesin profesorët udhëheqës të disertacionit në procesin mësimor dhe gjatë kësaj periudhe trajtohen si “Lektor”.

3. Kriteret e punësimit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen në statutin dhe rregulloret e institucionit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore rregulluese.

4. Shpenzimet për personelin akademik të përcaktuar në nenet 48 dhe 49 përballohen nga të ardhurat e institucionit.

#### Neni 50

##### **Punësimi në institucionet e arsimit të lartë**

*(Shtuar pika 1.1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 27/1;  
shtuar fjalët në fund të fjalisë së parë të pikës 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 27/2;  
ndryshuar pika 3 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 27/3;  
ndryshuar pika 4 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 27/4;  
shtuar fjali në fund të pikës 6 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 27/5;  
shtuar pika 7 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 27/6)*

1. Kriteret për punësim në institucionet e arsimit të lartë, për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ, përcaktohen në statutet e institucioneve. Ky personel punësohet me kohë të plotë ose të pjesshme.

1.1 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në një institucion të arsimit të lartë, publik ose privat, ka të drejtë, me miratimin e titullarit të njësisë kryesore dhe të institucionit të arsimit të lartë, të angazhohet si personel akademik i ftuar me kohë të pjesshme, në një institucion tjetër të arsimit të lartë, publik ose privat, brenda dhe jashtë vendit.

Autoritetet drejtuese, rektor, dekan dhe ato të njësuar me to, nuk kanë të drejtë të angazhohen me kohë të plotë në veprimtari mësimdhënieje, kërkimi apo në veprimtari të tjera në institucionet e tjera të arsimit të lartë, publik ose privat, brenda ose jashtë vendit, përveçse, me kohë të pjesshme, pas miratimit, përkatësisht, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ose të rektorit.

2. Kandidatët konkurrojnë në bazë të konkurseve publike në njësitë kryesore të IAL-së. Në statutet e institucioneve të arsimit të lartë përcaktohen procedura transparente për përzgjedhjen e kandidatit fitues, që plotëson kërkesat e publikuara dhe i përgjigjet më mirë përshkrimit të vendit të punës.

3. Për emërimin e personelit akademik, autoriteti drejtues i njësisë kryesore i paraqet autoritetit drejtues të institucionit të arsimit të lartë kandidatin e renditur i pari në klasifikimin e bërë nga komisioni ad hoc i konkursit publik, i krijuar nga autoriteti drejtues i njësisë kryesore. Autoriteti drejtues i institucionit të arsimit të lartë lidh kontratë pune me kandidatin e përzgjedhur, mbështetur në këtë ligj dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 47 të këtij ligji.

4. Mësimdhënia është detyrim, si rregull, me së paku 6 orë mësim në javë në auditor për të gjithë personelin akademik dhe me së paku 3 orë mësimi në javë në auditor për personelin akademik, në fakultetet e mjekësisë, që ushtron veprimtari klinike në njësitë e shërbimeve të spitaleve universitare, në përputhje me përcaktimin e nenit 12. Ngarkesa e plotë për personelin akademik në institucionet e arsimit të lartë përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

5. Personeli akademik me titullin “Profesor” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur me kërkesën e tij lirohet nga detyra.

6. Personelit akademik i ndërpriten marrëdhëniet e punës kur nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në kontratë, shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statuteve dhe rregulloreve të institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, si dhe dispozitave të këtij ligji. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të personelit akademik bëhet vetëm pasi është marrë mendimi i titullarit të grupit mësimor kërkimor, si dhe i autoriteteve drejtuese të njësisë bazë e të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, përjashtuar rastet e shkeljes flagrante të Kodit të Punës dhe të etikës akademike.

7. Personeli akademik me titull “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh, të rinovueshme, për t’u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Këtu përfshihen edhe pozicionet drejtuese të agjencive të rëndësishme të sistemit të arsimit dhe shkencës. Për periudhën e shkëputjes, ky personel akademik mund të zëvendësohet nga personel akademik me kontratë të përkohshme ose nga personel akademik i ftuar.

#### Neni 51

Personeli akademik gëzon status të veçantë. Përveç sa parashikohet në këtë ligj, Këshilli i Ministrave rregullon me vendim të tij aspektet e trajtimit të veçantë dhe përfitimeve të tjera për personelin akademik.

#### Neni 52

##### **Viti akademik sabatik**

*(Shtuar fjali në fund të pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 28)*

1. Personeli akademik me tituj i institucioneve të arsimit të lartë ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik, sipas kriterëve të

përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit pas miratimit të këshillit të fakultetit të njësisë kryesore. Autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë nuk kanë të drejtë për vit sabbatik gjatë kohës së ushtrimit të mandatit si drejtues, i zgjedhur apo i emëruar.

2. Gjatë kësaj periudhe, personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënieje. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi deri tremujore jashtë institucionit.

## KREU VIII STUDENTËT

### Neni 53 **Statusi i studentit**

Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin e tij në një institucion të arsimit të lartë dhe e humbet këtë status me marrjen e diplomës ose certifikatës përkatëse, si dhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen në bazë të këtij ligji, si dhe në statutet e institucioneve të arsimit të lartë.

### Neni 54 **Të drejtat dhe detyrat e studentëve**

1. Studentët kanë të drejtë:
  - a) të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
  - b) të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterash dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
  - c) të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e institucionit parashikuar për studentë, në përputhje me këtë ligj dhe statutin e institucionit;
  - ç) të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit.
2. Studentët kanë detyrë:
  - a) të zbatojnë rregullat e hartuara nga institucioni;
  - b) t'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
  - c) të paguajnë tarifën e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofrojnë institucionet;
  - ç) të respektojnë kodin e etikës, të përcaktuar në statutet ose rregulloret e institucioneve respektive të arsimit të lartë;
  - d) të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë etj.
3. Në statutin e institucionit përcaktohen të drejta dhe detyra të tjera të studentëve në përputhje me këtë ligj.

### Neni 55 **Këshillat e studentëve**

*(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 29)*

1. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve nëpër institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këta këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve.

2. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo 2 vjet nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit.

3. Këshillat e studentëve organizohen në nivel fakulteti (këshilli i studentëve të fakultetit), në nivel institucioni (këshilli i studentëve të institucionit) dhe në nivel kombëtar (Këshilli Kombëtar i Studentëve). Në organizimin e këshillave të studentëve në nivel kombëtar bëjnë pjesë edhe këshillat e studentëve të institucioneve private të arsimit të lartë, në rastet kur ato paraqesin interes për këto organizime.

4. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë. Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në statutet dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me këtë ligj, mbështetur edhe në propozimet e paraqitura nga studentët.

5. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.

6. Institucionet e arsimit të lartë mbështesin këshillat e studentëve dhe financojnë veprimtari të tyre.

#### Neni 56

##### **Karta e studentit**

1. Studentët e institucioneve publike e private të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës përcakton kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit.

3. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë.

4. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

#### Neni 57

##### **Bursa për studime**

1. Studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë përfitojnë bursa si mbështetje ekonomike për studimet e tyre, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera.

2. Bursat, sipas pikës 1 të këtij neni, përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe donacione të ligjshme. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret shtetërore dhe procedurat për përfitimin e bursave.

3. Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë në statutet e tyre kriteret dhe procedura për shpërblime të studentëve, që përballohen nga vetë institucionet.

4. Me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave konsideron dhe raste të tjera për dhënie bursash, si dhe bursa për studentë të shkëlqyer dhe shkencëtarë.

#### Neni 58

##### **Regjistri i studentëve**

1. Një institucion i arsimit të lartë duhet të mbajë regjistër bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore.

2. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme.

3. Çdo studenti, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë, i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcakton rregullat për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.

## KREU IX SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË – AKREDITIMI

### Neni 59

#### **Sigurimi i brendshëm i cilësisë**

1. Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ngrenë njësinë përkatese të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në to merr pjesë gjithmonë edhe një përfaqësues nga organizimet studentore të institucionit, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike, si dhe të veprimtarive administrative e financiare të institucionit. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.

2. Kriteret dhe procedurat për ngritjen dhe funksionimin e këtij sistemi hartohen nga institucionet e arsimit të lartë, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe përcaktohen në statutet e institucioneve.

3. Institucionet e arsimit të lartë publikojnë rezultatet e vlerësimit që kryejnë.

### Neni 60

#### **Sigurimi i jashtëm i cilësisë**

1. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit.

2. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë ose agjenci të tjera akreditimi, pjesë të Rrjetit European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për organizimin dhe veprimtarinë e këtyre agjencive.

3. Pranë Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë funksionon këshilli i akreditimit. Këshilli i akreditimit është një organ kolegjal që rekomandon, bazuar në vlerësimin e jashtëm të cilësisë, akreditimin e programeve/institucioneve në arsimin e lartë publik dhe privat. Ai është i pavarur në punën e tij dhe bën publik vendimet e këshillit, duke shprehur edhe mendimet kundër. Në këshill përfaqësohen në mënyrë të balancuar institucionet e arsimit të lartë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, ekspertë të fushave, si dhe një student nga organizimet studentore. Ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron anëtarët e këshillit të akreditimit nga kandidatët e propozuar nga palët e përfaqësuara. Kryetari i këshillit të akreditimit përzgjidhet nga kandidatët e propozuar nga këshilli i akreditimit dhe emërohet e shkarkohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Anëtarësia në këshillin e akreditimit është e papajtueshme me detyrën e rektorit, zëvendësrektorit dhe dekanit.

4. Mandati i anëtarëve të këshillit të akreditimit është 5 vjet.

5. Për të ndihmuar procesin e vlerësimit, vendimmarrjen dhe hartimin mbi baza profesionale të rekomandimeve të akreditimit, këshilli i akreditimit ngre edhe komisione të ekspertëve, sipas fushave kryesore të arsimit të lartë. Këto komisione kanë karakter të përkohshëm dhe përbëhen nga ekspertë vendas apo të huaj.

6. Funksionimi, fusha e veprimtarisë dhe kompetencat e tjera të institucioneve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë përcaktohen me akte nënligjore të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

7. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë hartojnë një raport vjetor të veprimtarisë së tyre, i cili bëhet publik.

Neni 61  
**Vlerësimi i cilësisë**

1. Vlerësimi dhe akreditimi mund të jenë në nivel institucional dhe programesh studimi.
2. Vlerësimi dhe akreditimi mbështeten në standardet shtetërore të cilësisë. Këto standarde përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Propozimi për standardet shtetërore të cilësisë bëhet nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, mbështetur dhe në udhëzimet e Sigurimit të Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.

Neni 62  
**Akreditimi**

*(Shfuqizuar paragrafi i dytë i pikës 1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 30)*

1. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në rekomandimet e këshillit të akreditimit, jep vendimin përfundimtar për akreditimin institucional dhe të programeve në arsimin e lartë publik dhe privat. Ai shprehet brenda një muaji, në të kundërt këshilli i akreditimit shpall vendimin e tij.
2. Vendimi për akreditimin mund të jetë pozitiv, negativ ose me kusht. Vendimi negativ bën që një institucion ose program të mos njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.
3. Çdo institucion i arsimit të lartë apo program studimi në arsimin e lartë publik dhe privat, përpara lëshimit të diplomave të para, i nënshtrohet procesit të akreditimit të parë. Akreditimi i parë i jep të drejtën një institucioni publik ose privat të arsimit të lartë të lëshojë diploma të njohura në Republikën e Shqipërisë.
4. Çdo program/institucion i akredituar i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik. Vlerësimi dhe akreditimi periodik kryhet çdo 6 vjet.
5. Procedurat, kërkesat, kriteret dhe standardet për vlerësimin dhe akreditimin janë të njëjta si për institucionet publike të arsimit të lartë, ashtu dhe për ato private. Për institucionet e arsimit të lartë, që operojnë e ofrojnë diploma të përbashkëta me institucione të huaja të arsimit të lartë, si dhe për filiale të institucioneve të arsimit të lartë të huaja, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, vlerësimi dhe akreditimi kryhen duke marrë parasysh edhe vlerësimin dhe akreditimin e tyre në vendin e origjinës.
6. Shpenzimet për vlerësimin e jashtëm të cilësisë përballohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë.
7. Rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit bëhen publike.

KREU X  
**RAPORTET E SHTETIT ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Neni 63  
**Përgjegjësitë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës**

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjëse për realizimin e programit politik qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Ajo miraton planin strategjik dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë lidhje me politikën në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
2. Siguron dhe përgatit të gjithë bazën ligjore të nevojshme në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
3. I propozon Këshillit të Ministrave buxhetin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve në aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Ajo miraton modelin e financimit për secilin institucion publik të arsimit të lartë.
4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e

Shqipërisë. Ajo kontrollon zbatimin e ligjshmërisë dhe përdorimin e fondeve publike në institucionet publike të arsimit të lartë, në bazë të këtij ligji, si dhe zbatimin e ligjshmërisë në institucionet private të arsimit të lartë.

5. Gjatë ushtrimit të autoritetit të saj, Ministria e Arsimit dhe Shkencës respekton autonominë institucionale, akademike dhe financiare që institucionet e arsimit të lartë kanë në këtë ligj.

6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës mban regjistrin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, të hartuar sipas një formati të përcaktuar prej saj me akt nënligjor, si dhe regjistrin e programe të akredituara të studimeve.

Neni 64

### **Kontrolli i ligjshmërisë**

*(Shfuqizuar pika 2 me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.3.2008;  
shfuqizuar pika 7 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 31)*

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës kryen periodikisht, të paktën një herë në tre vjet, kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në institucionet publike ose private të arsimit të lartë dhe të paktën një herë në vit kontroll financiar në institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Shfuqizuar.

3. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga rektori i një institucioni të arsimit të lartë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës urdhëron pezullimin e tij, duke ia dërguar atë për procedura të mëtejshme Presidentit të Republikës, i cili duhet të përgjigjet brenda një muaji. Ministri i Arsimit dhe Shkencës cakton njërin prej zëvendësrektorëve që do të zëvendësojë rektorin e pezulluar, deri në zgjedhjen e rektorit të ri, sipas këtij ligji. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, menjëherë pas dekretimit të shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme.

4. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga një autoritet drejtues i një njësie kryesore, rektori urdhëron pezullimin e atij autoriteti dhe i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji. Rektori cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të pezulluar deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, sipas këtij ligji. Rektori organizon zgjedhjet e parakohshme.

5. Në raste të ngjashme, dekani/drejtori urdhëron pezullimin e përgjegjësit të një njësie bazë dhe i propozon rektorit shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji. Dekani/drejtori cakton njërin prej përgjegjësve të grupeve kërkimore ose shkencore që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të pezulluar deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, sipas këtij ligji. Dekani/drejtori organizon zgjedhjet e parakohshme.

6. Në rastet kur Ministria e Arsimit dhe Shkencës konstaton raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga një autoritet drejtues i një njësie kryesore ose bazë të një institucioni të arsimit të lartë, ministri i përcjell materialin organit të emërtesës për veprime të mëtejshme, sipas këtij ligji.

7. Shfuqizuar.

## **KREU XI**

### **STRUKTURA NDËRMJETËSE NË ARSIMIN E LARTË**

Neni 65

### **Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës**

1. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit në arsimin e lartë dhe shkencë.

2. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës formulon mendime dhe propozime për:

a) hartimin e strategjive e programeve kombëtare për arsimin e lartë e kërkimin shkencor, drejtimet e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore;

- b) fushat parësore dhe programet e kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik;
  - c) projektbuxhetin e parashikuar për arsimin e lartë dhe shkencën dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;
  - ç) standardet për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ose programeve të studimeve;
  - d) kriteret për dhënien e titujve dhe gradës shkencore, së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë;
  - dh) zhvillimin e politikave të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre;
  - e) çdo problem tjetër që kërkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës etj.
3. Veprimtaria e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës ushtrohet në përputhje me rregulloren, që miratohet nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 66

### **Përbërja dhe përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës**

1. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës përbëhet nga 19 anëtarë si më poshtë: Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Kryetari i Akademisë së Shkencave, Kryetari i Konferencës së Rektorëve, 1 përfaqësues i caktuar nga Ministri i Financave dhe 15 anëtarë të tjerë, ekspertë të zgjedhur me konkurrim publik.
2. Anëtarët ekspertë të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës përzgjidhen nga fusha të ndryshme të shkencës, me konkurrim publik, nga një komision përzgjedhjeje, i ngritur në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, i përbërë nga një përfaqësues nga Kuvendi, një përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe një përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve, të caktuar nga vetë këto institucione.
- Komisioni i përzgjedhjes, pasi shqyrton plotësimin e kriterëve profesionale, në përputhje me këtë ligj, rendit në një listë kandidatët, sipas pikëve të fituara. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe bëhen publike.
3. Përfaqësuesi i caktuar nga Ministri i Financave duhet të ketë kualifikim profesional të ngjashëm me përfaqësuesit ekspertë.
4. Këshilli i Ministrave cakton në detyrën e anëtarit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës 15 nga kandidatët e klasifikuar.
5. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
6. Anëtarët ekspertë zgjidhen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.
7. Pagesa e anëtarëve të këtij këshilli përcaktohet me akt nënligjor të Këshillit të Ministrave.
8. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës mbështetet me sekretariat teknik, që ndodhet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Përbërja e sekretariatit, detyra dhe pagesa e tyre caktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 67

### **Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë**

1. Pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ngrihet dhe funksionon Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë.
2. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë përbëhet nga 15 anëtarë. Ministri i Arsimit dhe Shkencës është Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë. 14 anëtarët e tjerë janë përfaqësues me titullin akademik ose profesor nga fusha të ndryshme të shkencës.
3. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, detyrat dhe të drejtat, funksionimi dhe pagesa e tyre përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.



4. Sekretari i komisionit është punonjës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 68

#### **Konferenca e Rektorëve**

1. Konferenca e Rektorëve është organ kolegjal i pavarur i autoriteteve drejtuese të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë.

2. Konferenca e Rektorëve, në respektim të plotë të autonomisë së institucioneve të veçanta të arsimit të lartë, kryen veprimtari të koordinimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

3. Konferenca e Rektorëve shpreh opinione për probleme të zhvillimit të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe për rastet e parashikuara në ligj. Ajo shpreh opinionin e saj në çdo rast kur e gjykon të nevojshme.

4. Konferenca e Rektorëve mban lidhje me shoqata homologe për nxitjen e shkëmbimeve universitare, që ndihmojnë përparimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

5. Konferenca e Rektorëve funksionon në bazë të statutit të miratuar prej dy të tretave të anëtarëve të saj.

#### KREU XII

#### **KËRKIMI SHKENCOR DHE SHËRBIMET E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

#### Neni 69

#### **Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në institucionet e arsimit të lartë**

1. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë kërkim shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese në mënyrën e përcaktuar në statutin e institucionit të arsimit të lartë, sipas objektivave specifike të institucionit në këto drejtime.

2. Veprimtaria e kërkimit dhe zhvillimit që kryhet në institucionet e arsimit të lartë, synon dhe në rritjen e cilësisë së arsimimit. Ajo u jep studentëve aftësi metodologjike për kërkim, jep mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, përmirëson kualifikimet e personelit akademik të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe krijon mjete materiale për zhvillimin dhe punën në institucion etj.

3. Personeli akademik është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:

a) plotësimin e detyrimeve ndaj institucionit, sipas kontratës së punës;

b) plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse të institucionit për kërkim shkencor, sipas pikës 1 të këtij neni.

Në mënyrë të detajuar, në statutin e institucionit përcaktohen kushtet për realizimin e veprimtarisë së kësaj pike të nenit.

#### Neni 70

#### **Veprimtaritë kërkimore në institucionet e arsimit të lartë**

1. Veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit në institucionet e arsimit të lartë duhet të sigurojnë integrimin e kërkimit me mësimin.

2. Temat ose afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Këto përcaktohen mbështetur në nevojat e zhvillimit të vendit, rëndësinë e kërkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, si dhe burimet financiare në dispozicion.

3. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë për të tretë edhe shërbime të ndryshme të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime klinike, informacioni etj., që rregullohen në statutet dhe rregulloret e tyre. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të

interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari shkojnë tërësisht në favor të institucionit. Kur të ardhurat sigurohen nga veprimtari kërkimore, studimore dhe krijuese të personelit akademik të institucionit, një pjesë e tyre mund të përdoren edhe për shpërblimin dhe motivimin e personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të hartojnë programe dhe projekte kërkimore të bashkëpunimit me institucione të tjera, publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me shoqata, fondacione etj.

5. Këto institucione bëjnë një raport vjetor për veprimtarinë kërkimore-shkencore ose krijuese të çdo lloji.

#### Neni 71

### **Planifikimi i veprimtarive kërkimore**

1. Veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj ose akte të tjera.

2. Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë.

3. Programet e studimeve të ciklit të tretë dhe, në masë më të vogël, programet e studimeve të ciklit të dytë konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen gjithashtu planifikimit.

#### KREU XIII

### **PRONAT DHE FINANCIMI I INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

#### Neni 72

### **Parime të përgjithshme të politikës shtetërore për financimin e institucioneve publike të arsimit të lartë**

1. Institucionet publike të arsimit të lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare.

2. Të ardhurat e krijuara nga institucionet e arsimit të lartë përdoren tërësisht prej tyre dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës.

3. Transfertat e pakushtëzuara, që Buxheti i Shtetit akordon në vitin buxhetor pasardhës për institucionet e arsimit të lartë, do të përcaktohen duke marrë në konsideratë edhe pjesën e këtyre transfertave që do të mbarten nga viti paraardhës.

4. Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre bëhen në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimin financiar publik.

5. Në përdorimin e burimeve financiare përparësi kanë të ardhurat e veta, të cilat do të shpenzohen në përputhje me procedurat e buxhetit afatmesëm.

6. Të gjitha transaksionet e arkëtimeve, përfshirë dhe të ardhurat e veta, si dhe ato të pagesave të institucioneve publike të arsimit të lartë kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit, duke respektuar të gjitha rregullat e kontrollit financiar, të përcaktuara sipas kuadrit ligjor në fuqi.

7. Këshilli i Ministrave, përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe opinioni publik kanë të drejtë të kërkojnë transparencë të plotë për përdorimin e këtyre të ardhurave, si dhe financimeve nga Buxheti i Shtetit. Ky informacion do të përfshihet në raportin vjetor të çdo institucioni, që i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe bëhet publik.

#### Neni 73

### **Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë**

1. Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:

a) transfertat nga Buxheti i Shtetit;

- b) të ardhura të krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë;
  - c) burime të tjera me destinacion.
2. Këshilli i Ministrave, përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, u jep institucioneve publike të arsimit të lartë fonde për përmbushjen e misionit të tyre sipas standardeve.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë bëjnë rregulloret e tyre mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat (pika 1 shkronja “b” e këtij neni), duke respektuar rregullat financiare të përcaktuara nga ligjet e shtetit.

#### Neni 74

#### **Të ardhurat e institucioneve publike të arsimit të lartë**

1. Në të ardhurat e institucioneve publike të arsimit të lartë përfshihen:
- a) tarifat e studimeve, të cilat janë të diferencuara sipas cikleve, formave të studimeve etj.;
  - b) të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë, sipas marrëveshjeve të lidhura;
  - c) të ardhura nga shërbimet që realizohen nga institucionet publike të arsimit të lartë, që veprojnë në fushën e artit, kulturës dhe sportit;
  - ç) të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara;
  - d) të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim të palëve të treta në trajtën e kontratave të qiradhënies dhe me forma të tjera kontraktimi;
  - dh) dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike;
  - e) financimet e pakthyeshme, të marra nga burime të huaja në kuadrin e projekteve dy e shumëpalëshe;
  - ë) financime të tjera të ligjshme, të marra nga burime të ndryshme.
2. Të ardhurat e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni derdhen 100 për qind në llogarinë e institucionit dhe përdoren nga vetë ai, sipas rregullave të përcaktuara.

#### Neni 75

#### **Tarifat**

1. Tarifat e studimeve përfshijnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit.
2. Tarifat e regjistrimit për të gjitha programet e studimeve propozohen nga institucionet publike të arsimit të lartë përkatës dhe miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
3. Tarifa e shkollimit për ciklin e parë për sistemin e studimeve me kohë të plotë, ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve vendoset nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo e fundit merr edhe mendimin e Konferencës së Rektorëve dhe Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.
4. Tarifat e shkollimit për ciklin parë për sistemin e studimeve me kohë të pjeshme dhe në distancë propozohen nga institucionet publike të arsimit të lartë përkatës. Kjo tarifë caktohet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave.
5. Tarifa e shkollimit në çdo rast nuk mund të kalojë vlerën e kostos së studimeve.
6. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

#### Neni 76

#### **Financimi nga Buxheti i Shtetit**

1. Transferta nga Buxheti i Shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë jepen në formë granti, që përdoret sipas këtyre kategorive:
  - a) transferta e pakushtëzuar;
  - b) transferta me konkurrim për investime.

2. Transferta e pakushtëzuar përdoret për financimin e shpenzimeve që lidhen me funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për financimin e investimeve me karakter të vazhdueshëm.

Transferta me konkurrim për investime përdoret për financimin e investimeve me karakter ndërtimi dhe projekte të tjera të mëdha, sipas klasifikimit në procedurat për menaxhimin e investimeve publike dhe për kërkim shkencor.

Neni 77

### **Shpërndarja e financimit nga Buxheti i Shtetit**

1. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar bazohet në një formulë që garanton barazi, drejtësi dhe transparencë. Kriteret dhe komponentët e formulës përcaktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe miratohen në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit.

2. Shpërndarja e grantit konkurrues për investime bëhet mbi bazën e projekteve që paraqiten nga institucionet e arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin vjetor të buxhetit.

3. Struktura e hartimit të buxhetit për çdo institucion publik të arsimit të lartë bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 78

### **Hartimi i buxhetit të institucioneve publike të arsimit të lartë**

Projektbuxheti i një institucioni publik të arsimit të lartë hartohet nga rektorati, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse të institucioneve, si dhe miratohet nga senati akademik, pasi miratohet prej këshillit të administrimit. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga Ministria e Financave. Projektbuxheti i përcillet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, i cili brenda 30 ditëve ushtron kontrollin që i takon sipas ligjit në formën e kërkesës së motivuar për rishikim.

Institucionet publike të arsimit të lartë kanë të drejtë të detajojnë dhe të miratojnë buxhetin e tyre vjetor sipas rektoratit, fakulteteve, departamenteve, qendrave kërkimore dhe njësisë të tjera të njëvlershme me to, sipas statutit dhe rregulloreve të tyre. Të gjitha këto njësi janë autonome në administrimin e buxhetit të tyre, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 79

### **Rregullat e administrimit dhe raportimit financiar**

Rregullat e administrimit financiar të institucioneve publike të arsimit të lartë janë të njëjta me ato të institucioneve të tjera publike.

Neni 80

### **Auditimi i jashtëm**

1. Institucionet e arsimit të lartë i nënshtrohen auditit financiar, që realizohet nga institucionet e parashikuara me ligj për këtë qëllim.

2. Në këtë proces, institucionet shtetërore të auditit financiar kanë të drejtë të angazhojnë edhe institucione të specializuara nga sektori privat.

3. Rezultatet e auditit financiar bëhen publike.

Neni 81

### **Kontrolli dhe auditimi i brendshëm**

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë përbërëse të tyre realizohet nga njësitë e auditit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

dhe institucioneve të arsimit të lartë. Krijimi dhe funksionimi i njësive të auditit të brendshëm bëhet sipas kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Rezultatet e kontrollit dhe auditit bëhen publike.

Neni 82

### **Pronat e paluajtshme të institucioneve publike të arsimit të lartë**

1. Pronat e paluajtshme publike, të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë, kalojnë në administrim të institucioneve publike të arsimit të lartë me vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë mirëmbajnë dhe përdorin për interesa të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pronat e paluajtshme publike që u janë lënë në administrim. Ato hipotekohen në pronësi të shtetit për përdorim nga universitetet.

## **KREU XIV**

### **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 83

Institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat janë krijuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të riorganizojnë strukturimin e brendshëm të tyre dhe programet e studimit, sipas këtij ligji, brenda një viti nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 84

Kërkesat për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, të paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, shqyrtohen sipas standardeve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet që dalin në zbatim të tij.

Neni 85

Institucionet private të arsimit të lartë duhet të riorganizohen, sipas këtij ligji, brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e tij. Ministri i Arsimit dhe Shkencës nxjerr udhëzime shpjeguese për ristrukturimin e institucioneve të arsimit të lartë privat.

Neni 86

Zgjedhjet e para për këshillat e studentëve në institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe organizimi i tyre deri në nivel kombëtar do të kryhen në përfundim të mandatit të organizimeve ekzistuese, sipas ligjit të vjetër.

Neni 87

Institucionet e arsimit të lartë në vend duhet të hartojnë dhe të miratojnë statutet dhe rregulloret e tyre, në përputhje me këtë ligj, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 88

Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi për kohëzgjatjen normale të tij. Studentët mbetës do të marrin një diplomë në varësi të afateve të studimeve të tyre dhe kurrikulës.

Studimet pasuniversitare në institucionet e arsimit të lartë do të vazhdojnë deri në përfundimin e studentëve të regjistruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 89

Diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur 3 vite (6 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat e nivelit të parë.

Diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas sistemit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat e integruara të nivelit të dytë.

Diplomat e fituara në studimet në kuadër të “Shkollës pasuniversitare të studimeve të thelluara” janë ekuivalente me diplomat “Master i Nivelit të Dytë”.

#### Neni 90

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë duhet që, brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të jetë bërë pjesë e Regjistrisë Europiane të Agjencive të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Këshilli i akreditimit riorganizohet, sipas këtij ligji, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e tij.

#### Neni 91

Institucionet e arsimit të lartë, të cilat janë krijuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit dhe akreditimit, sipas këtij ligji, brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e tij. Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të bëjë publike të gjitha institucionet e akredituara, publike dhe private, të arsimit të lartë.

#### Neni 92

Institucionet e arsimit të lartë, në përputhshmëri me rezultatin e akreditimit të tyre, riorganizojnë strukturimin e institucionit dhe ciklet e studimit sipas këtij ligji.

#### Neni 93

Personeli akademik i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, i cili nuk ka shkallën e kërkuar të kualifikimit sipas vendit të punës, duhet që brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e tij të kryejë kualifikimet e kërkuara ose të largohet nga vendi i punës. Personeli akademik i institucioneve publike të arsimit të lartë riorganizohet, sipas këtij ligji, me fillimin e vitit të ri akademik të parë.

#### Neni 94

Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall menjëherë, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese të institucionit. Zgjedhjet do të bëhen sipas procedurave të këtij ligji dhe rregullores së zgjedhjeve. Rregullorja për zgjedhjet e para për autoritete dhe organe drejtuese përgatitet, sipas këtij ligji, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me Konferencën e Rektorëve. Institucionet publike të arsimit të lartë përgatisin bazën ligjore të nevojshme për organizimin e këtyre zgjedhjeve të para.

#### Neni 95

Financimi i institucioneve publike të arsimit të lartë do të fillojë të aplikohet, sipas këtij ligji, por në mënyrë të shkallëzuar, që nga viti buxhetor 2008. Transferi buxhetor në nivel agregat për vitin 2008 do të jetë jo më pak se niveli i vitit paraardhës. Deri në përfshirjen e këtyre institucioneve

në këtë skemë financimi për to, do të veprojë financimi sipas mënyrës së përcaktuar në ligjin nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### Neni 96

Zbatimi i skemës së financimit, sipas këtij ligji, në mënyrë të shkallëzuar për institucionet publike të arsimit të lartë vendoset nga Ministri i Financave me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 97

Këshilli i Vlerësimit të Titujve Akademikë organizohet, sipas këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Mandati i anëtarëve ekzistues të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës mbaron me afatet e parashikuara në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### Neni 98

Aktet nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk vijnë në kundërshtim me të do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar.

Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të përgatitin të gjitha aktet nënligjore për vënien në zbatim të këtij ligji.

#### Neni 99

*(Shfuqizuar neni me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 32)*

#### Neni 99/1

*(Shtuar neni 99/1 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 33)*

1. Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi, për kohëzgjatjen e parashikuar të tij, dhe në përfundim do të pajisen me diplomë, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në përshtatje me programin e studimit të kryer.

2. Institucionet e arsimit të lartë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtatin emërtimet e diplomave, që i përkasin programeve të studimeve në vijim dhe t'i depozitojnë për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 99/2

*(Shtuar neni 99/2 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 33)*

1. Diplomat e nivelit të parë (DNP), të lëshuara ose të ekuivalentuara me to, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare “Bachelor”.

2. Diplomat e nivelit të dytë (DND) dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë (DIND), që kanë grumbulluar në studimet universitare, së paku, 300 kredite, të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare “Master i shkencave” dhe “Master i arteve të bukura”.

3. Diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (tetë semestra), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare “Master i shkencave” dhe “Master i arteve të bukura”.

4. Diplomat “Master i Nivelit të Parë” (MNP), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare “Master profesional”.

5. Studimet universitare, në kuadër të programeve të Shkollës së Magjistraturës, si dhe programeve të deritanishme të Shkollës Pasuniversitare të Studimeve të Thelluara (SHPU) dhe “Master i Nivelit të Dytë” (MND) njihen si të barasvlershme me diplomat universitare për specializime apo kualifikime postmaster. Këto studime mund të njihen, pjesërisht ose plotësisht, për studimet e doktoratës, në përputhje me përcaktimet e bëra në statutet e IAL-ve.

Neni 99/3

*(Shtuar neni 99/3 me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 33)*

1. Institucionet e arsimit të lartë në vend duhet të pasqyrojnë në statutet dhe rregulloret e tyre ndryshimet, në përputhje me këtë ligj, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Institucionet e arsimit të lartë të përshtatin, brenda gjashtë muajve, programet e studimeve, në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e këtij ligji.

Neni 100

*(Ndryshuar neni me ligjin nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 34)*

Ligji nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër që lidhet me arsimin e lartë e që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

***Dispozitë e shtuar me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, neni 5;***

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në këshillim me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe Konferencën e Rektorëve, miraton rregulloren për zgjedhjet e para, sipas këtij ligji, të autoriteteve dhe organeve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik, jo më vonë se 15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Rregullorja përcakton kriteret për hartimin e listave zgjedhore, regjistrimin e kandidatëve, procesin e votimit, kriteret e vlefshmërisë e të numërimit të votave, rregullat për shpalljen e rezultatit dhe të fituesve, procesin dhe afatet e ankimimit.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall, brenda një muaji nga miratimi i rregullores, datën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë publik. Këto zgjedhje zhvillohen në të njëjtën datë për të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik. Data e zgjedhjeve caktohet jo më parë se tre javë nga data e fillimit të procesit zgjedhor dhe jo më vonë se tre muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Për personat, të cilët, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë mbi tre vjet që vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e autoriteteve drejtuese, të zgjedhur apo të emëruar, zbatohet rregulli i përcaktuar në pikën 1 të nenit 23 të këtij ligji.

Autoritetet drejtuese rektor/dekan në një institucion publik të arsimit të lartë, të zgjedhur ose të emëruar, sipas paragrafit më sipër, qëndrojnë në detyrë deri në shpalljen e zgjedhjeve të para, sipas këtij ligji. Këto autoritete nuk mund të kandidojnë për të njëjtin pozicion në këto zgjedhje. Funkcionet administrative të autoriteteve drejtuese rektor/dekan ushtrohen nga zëvendësit e tyre deri në emërimin e autoriteteve të reja përkatëse.

Në mungesë të zëvendësrektorëve, ose kur këta kandidojnë vetë për ndonjë pozicion autoriteti drejtues, në vend të tyre Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, komandon anëtarë të brendshëm të personelit akademik me kualifikimet e duhura.

Zëvendësrektorët komandojnë zëvendësdekanët, në rastet e mungesës së tyre, ose kur ata kandidojnë vetë për pozicion autoriteti drejtues.



Neni 101

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5352, datë 11.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 16.6.2007, faqe nr.1917*

*Ligj nr.9832, datë 12.11.2007 shpallur me dekretin nr.5517, datë 15.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi, botuar në Fletoren Zyrtare nr.153, datë 16.11.2007, faqe nr.4489*

*Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 19.3.2008 botuar në Fletoren Zyrtare nr.45, datë 1.4.2008, faqe nr. 2042*

*Ligj nr.10 307, datë 22.7.2010 shpallur me dekretin nr.6663, datë 13.8.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi, botuar në Fletoren Zyrtare nr.111, datë 19.8.2010, faqe nr.5474*

## **LIGJ**

**Nr.8834, datë 22.11.2001**

### **PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË EUROPË” (LISBONË, 1997)**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Konventa për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë” (Lisbonë, 1997).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3169, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, datë 21.12.2001, faqe 1773*

**KONVENTA**  
**PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË EUROPE**

Lisbonë 1997

Palët e pranishme në këtë Konventë:

Të ndërgjegjshme për faktin se e drejta për arsimin është e drejtë e njeriut dhe se arsimi i lartë, që luan një rol të rëndësishëm në marrjen dhe përparimin e dijeve, përbën një pasuri të jashtëzakonshme kulturore dhe shkencore, si për individët, ashtu edhe për shoqërinë;

Duke marrë në konsideratë faktin se arsimi i lartë duhet të luajë një rol thelbësor në promovimin e paqes, të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të tolerancës dhe që të kontribuojë në krijimin e besimit të ndërsjellë midis popujve dhe kombeve;

Duke marrë në konsideratë faktin se diversiteti i madh i sistemeve arsimore që ekziston në Europë reflektohet në diversitetet kulturore, sociale, politike, filozofike, fetare dhe ekonomike dhe që nga ky moment përfaqëson një pasuri të jashtëzakonshme që duhet respektuar plotësisht;

Duke dashur t'u lejojnë të gjithë evropianëve të përfitojnë plotësisht nga pasuria që përfaqëson ky diversitet, duke lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve të çdo shteti dhe të studentëve të shkollave të larta të çdo Pale në burimet arsimore të Palëve të tjera dhe, me veçanërisht, duke u lejuar atyre të vazhdojnë formimin ose të kryejnë një pjesë të studimeve në shkollat e larta të këtyre Palëve të tjera;

Duke konsideruar faktin që njohja e studimeve, dëftesave, diplomave dhe e titujve të marrë në një shtet tjetër evropian përbën një masë të rëndësishme për nxitjen e mobilitetit akademik ndërmjet Palëve;

Duke i kushtuar një rëndësi të madhe parimeve të autonomisë së shkollave dhe të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së këtij parimi;

Të bindur që një njohje e barabartë e kualifikimeve përfaqëson një element kyç të së drejtës për arsimim dhe një përgjegjësi të shoqërisë;

Duke pasur parasysh Konventat e Këshillit të Evropës dhe të UNESCO-s në lidhje me njohjen akademike në Europë;

Konventa Europiane për ekuivalentimin e diplomave që lejojnë regjistrimin në universitet (1953, STE No 15) dhe Protokollin e saj shtesë (1964, STE No 49);

Konventa Europiane për ekuivalentimin e periudhave të studimeve univiersitare (1956, STE No 21);

Konventa Europiane mbi njohjen akademike të kualifikimeve univiersitare (1959, STE No 32);

Konventa për njohjen e studimeve dhe të diplomave të arsimit të lartë në Shtetet e Europës (1979);

Konventa Europiane për ekuivalentimin e përgjithshëm të periudhës së studimeve univiersitare (1990, STE No 138);

Gjithashtu, duke pasur parasysh Konventën Ndërkombëtare mbi njohjen e studimeve, të diplomave dhe të gradave të arsimit të lartë në Shtetet Arabe dhe në Shtetet Europiane që lag Mesdheu (1967), e adoptuar në kuadër të UNESCO-s dhe që mbulon pjesërisht njohjen akademike në Europë;

Duke kujtuar se kjo Konventë duhet të konsiderohet edhe në kontekstin e Konventave dhe të Rekomandimeve Ndërkombëtare të UNESCO-s që mbulojnë rajone të tjera të botës dhe se është i domosdoshëm përmirësimi i shkëmbimeve të informacioneve ndërmjet këtyre rajoneve;

Të ndërgjegjshëm për evolucionin e thellë në arsimin e lartë në rajonin e Europës që kur janë adoptuar këto Konventa, duke pasur për pasojë një rritje të diversifikimit si në gjirin e sistemeve kombëtare të arsimit të lartë, ashtu edhe ndërmjet tyre, si dhe të nevojës së përshtatjes të instrumenteve juridike dhe praktikave për të reflektuar këtë evolucion;

Të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve të përbashkëta për probleme praktike të shtruara nga njohja në Rajonin Europian;

Të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e përmirësimit të praktikave të tanishme të njohjes, për t'i bërë më transparente dhe të përshtatura më mirë me gjendjen aktuale të arsimit të lartë në Rajonin Europian;

Të bindur për rëndësinë e një konvente të përpunuar dhe të adaptuar nën patronazhin e përbashkët të Këshillit të Europës dhe të UNESCO-s, duke krijuar një kuadër për zhvillimin e ardhshëm të praktikave të njohjes në Rajonin Europian;

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e parashikimit të mekanizmave të përhershme të vënies në jetë, me qëllim zbatimin e parimeve dhe dispozitave të kësaj Konvente,

Kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Seksioni I. Përcaktime

## Neni 1

Sipas kësaj Konvente, termat e përmendur më poshtë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Pranim (në arsimin e lartë) - është e drejta e kandidatëve për të kërkuar dhe për t'u marrë në konsideratë për t'u pranuar në arsimin e lartë.

Pranim (në institucionet dhe programet e arsimit të lartë) - është akti ose sistemi që u lejon kandidatëve të cilësuar për të ndjekur studimet në një institucion të caktuar dhe/ ose në një program të caktuar të arsimit të lartë.

Vlerësim (i institucioneve dhe i programeve) - është procesi që përcakton cilësinë e mësimdhënies në një institucion ose të një programi të arsimit të lartë.

Vlerësim (i kualifikimeve individuale) - vlerësim me shkrim, nga një organizëm kompetent, i kualifikimeve jashtë shtetit të një individi.

Autoritete kompetente në fushën e vlerësimit - një organizëm i ngarkuar zyrtarisht të japë vendime shtrënguese për njohjen e kualifikimeve të huaja.

Arsim i lartë - të gjitha tipet e cikleve të studimeve ose bashkësia e cikleve të studimit, të formimit ose formimit për kërkim, i nivelit post-sekondar, të njohura nga autoritetet përkatëse të një Pale sipas sistemit të saj të arsimit të lartë.

Institucion i arsimit të lartë - institucion përhapës i arsimit të lartë dhe i njohur nga autoritetet kompetente të një Pale sipas sistemit të saj të arsimit të lartë.

Program i arsimit të lartë - cikël studimesh i njohur nga autoritetet kompetente të një Pale sipas sistemit të arsimit të lartë dhe përfundimi i suksesshëm i të cilave i jep studentit një kualifikim të arsimit të lartë.

Periudhë studimesh - çdo pjesë e një programi të arsimit të lartë, që ka qenë objekt i një vlerësimi ose të një vlefshmërie dhe që, megjithëse nuk përbën një program të plotë studimesh në vetvete, përfaqëson një përvojë domethënëse të njohjeve të aftësive.

Kualifikim

A. Kualifikim i arsimit të lartë. Çdo gradë, diplomë, dëftesë tjetër ose titull tjetër i lëshuar nga një autoritet kompetent dhe që vërteton përfundimin me sukses të një programi të arsimit të lartë.

B. Kualifikim që lejon pranimin në arsimin e lartë - çdo diplomë ose dëftesë tjetër e lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton përfundimin me sukses të një programi arsimor dhe i jep titullarit të saj të drejtën për t'u marrë në konsideratë për t'u pranuar në një institucion të arsimit të lartë (shih përcaktimin e pranimit).

Njohje - vërtetim i lëshuar nga një autoritet kompetent për vlerën e një kualifikimi arsimor të huaj, me qëllim pranimin në aktivitetet e arsimit dhe/ose të punësimit.

Kushtet e nevojshme

A. Kushte të përgjithshme - kushtet që duhet të plotësohen, në të gjitha rastet, për të hyrë në arsimin e lartë, për të hyrë në një nivel të përcaktuar në një nivel të përcaktuar të këtij arsimit ose për dhënien e një kualifikimi të arsimit të lartë të një niveli të caktuar.

B. Kushte të veçanta - kushtet që duhet të plotësohen, përveç kushteve të përgjithshme, me qëllim pranimin në një program të veçantë të arsimit të lartë ose dhënien e një kualifikimi të veçantë të arsimit të lartë në një disiplinë të veçantë studimi.

## Seksioni II.Kompetenca të autoriteteve

### Neni II.1

1. Kur autoritetet qendrore të një Pale janë kompetente për të vendosur për çështjet e njohjes, kjo Palë lidhet menjëherë me dispozitat e kësaj Konvente dhe merr masat e domosdoshme për zbatimin e këtyre dispozitave në territorin e saj.

Kur janë njësitë përbërëse të Palës që kanë kompetencën për të vendosur për çështjet e njohjes, Pala i jep, njërit prej depozituesve, një raport të shkurtër mbi situatën ose strukturën e saj konstitucionale, në momentin e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, të pranimit, aprovimit ose aderimit ose në çdo moment tjetër në vazhdim. Në raste të tilla, autoritetet kompetente të njërive përbërëse të Palëve në fjalë marrin masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në territorin e tyre.

2. Kur janë institucionet e arsimit të lartë ose njësi të tjera që kanë kompetencë për të vendosur individualisht për çështjet e njohjes, çdo Palë, sipas situatës ose strukturës së saj konstitucionale, u komunikon tekstin e kësaj Konvente këtyre institucioneve ose njërive dhe merr çdo masë të mundur për t'i inkurajuar ta analizojnë dhe të zbatojnë dispozitat me dashamirësi.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen mutatis mutandis me detyrimet e Palëve sipas neneve të mëtejshëm të kësaj Konvente.

### Neni II.2

Në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit ose në çdo moment tjetër në vazhdim, çdo Shtet, Selia e Shenjtë, Komuniteti Europian do t'i tregojnë njërit prej depozituesve të kësaj Konvente cilat janë autoritetet kompetente që marrin vendime të ndryshme në çështje njohjesh.

### Neni II.3

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me dispozitat më të favorshme në lidhje me njohjen e kualifikimeve të dhëna nga njëra nga Palët. Këto mund të përmbahen në një traktat ekzistues ose të ardhshëm, ose në një si rezultat, dhe pjesë e së cilës mund të bëhet një Palë e kësaj Konvente.

## Seksioni III. Parimet bazë për vlerësimin e kualifikimeve

### Neni III.1

1. Titullarët e kualifikimeve të dhëna nga njëra nga Palët kanë një hyrje të përshtatshme në vlerësimin e këtyre kualifikimeve, me anë të një kërkesë të tyre adresuar një organizmi kompetent.

2. Në këtë pikë nuk bëhet asnjë dallim i bazuar në seksin, racën, ngjyrën e lëkurës, handikapin, gjuhën, opinione politike ose çdo opinion tjetër, origjinën kombëtare, etnike ose sociale, përkatësinë në një minoritet kombëtar, pasurinë, lindjen ose çdo rrethanë tjetër të kërkuesve, ose çdo rrethanë tjetër që nuk ka lidhje me vlerën e kualifikimit për të cilën është kërkuar njohja. Për të siguruar këtë të drejtë, çdo Palë angazhohet të ndër marrë dispozitat e nevojshme për të vlerësuar çdo kërkesë njohjeje të kualifikimit, duke marrë parasysh vetëm njohjet dhe aftësitë e fituara.

### Neni III.2

Çdo Palë do të kujdeset që procedurat dhe kriteret e përdorura për vlerësimin dhe njohjen të jenë transparente, koherente dhe të besueshme.

### Neni III.3

1. Vendimet e njohjes merren mbi bazën e informacioneve të përshtatshme në lidhje me kualifikimet për të cilat është kërkuar njohja.

2. Përgjegjësia e dhënies së informacioneve të nevojshme bie, në radhë të parë, mbi kërkuesin, i cili duhet t'i japë në mirëbesim.

3. Megjithë përgjegjësinë e kërkuesit, me kërkesën e këtij të fundit, institucionet që kanë dhënë kualifikimet në fjalë kanë për detyrë t'i japin informacionet e përshtatshme në limitet kohore të arsyeshme. E njëjta detyrë bie edhe mbi institucionet ose organet kompetente të vendit ku është kërkuar njohja.

4. Palët u japin udhëzime të gjitha institucioneve të arsimit, sipas sistemeve të tyre arsimore, të përcjellin çdo kërkesë të arsyeshme informacione të bërë me qëllim vlerësimin e kualifikimeve të bëra në këto institucione ose, sipas rastit, t'i inkurajojnë këto institucione për ta bërë këtë gjë.

5. U takon organizmave që ndërmarrin vlerësimin të vërtetojnë se një kërkesë nuk i plotëson kushtet e nevojshme.

### Neni III.4

Me qëllim lehtësimin e njohjes së kualifikimeve, çdo Palë do të kujdeset që të jepen informacione të nevojshme dhe të qarta mbi sistemin e vet arsimor.

### Neni III.5

Vendimet e njohjes merren me një afat të arsyeshëm, të përcaktuar paraprakisht nga autoritetet kompetente në çështjet e njohjes, duke filluar nga momenti kur janë dhënë të gjitha informacionet e duhura për ekzaminimin e kërkesës. Në rast të një vendimi negativ, jepen arsytet e refuzimit dhe kërkuesi informohet mbi masat që mund të marrë për të arritur njohjen në një moment të dytë. Në rast të një vendimi negativ ose të mungesës së vendimit, kërkuesi duhet të ketë mundësinë të apelojë kundrejt këtij vendimi në një afat kohor të arsyeshëm.

## Seksioni IV. Njohje e kualifikimeve që lejojnë hyrjen në arsimin e lartë

### Neni IV.1

Çdo Palë njihet (me qëllim hyrjen në programet që varen nga sistemi i tij i arsimit të lartë), kualifikimet e dhëna nga Palët e tjera dhe që plotësojnë, në këto Palë, kushtet e përgjithshme të hyrjes në arsimin e lartë, vetëm më rastet kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet kushteve të përgjithshme të hyrjes në Palën në të cilën është bërë kualifikimi dhe në Palën ku është kërkuar njohja.

### Neni IV.2

Në mënyrë aletnative, mjafton që njëra Palë t'i lejojë titullarit të një kualifikimi të kryer në njërin nga Palët e tjera të arrijë vlerësimin e këtij kualifikimi, me kërkesën e titullarit të kualifikimit, dhe dispozitat e nenit IV zbatohen mutatis mutandis në një rast të tillë.

### Neni IV.3

Kur kualifikimi lejon hyrjen vetëm në disa tipe institucionesh ose programesh specifike të arsimit të lartë në Palën në të cilën është kryer ky kualifikim, çdo Palë tjetër i garanton titullarit të një kualifikimi të tillë hyrjen në disa programe specifike të ngjashme në institucionet që varen nga sistemi i tij i arsimit të lartë, me përjashtim të rastit kur vërtetohet se ekziston një ndryshim

thelbësor ndërmjet kushteve të hyrjes në Palën në të cilën është kryer kualifikimi dhe kushtet e hyrjes në Palën në të cilën kërkohet njohja e kualifikimit.

#### Neni IV.4

Kur pranimi në programet e veçanta të arsimit të lartë varet nga kushte të veçanta plotësuese të kushteve të përgjithshme të hyrjes, autoritetet kompetente të Palës përkatëse mund t'i imponojnë të njëjta, kushte plotësuese titullarëve të kualifikimeve të kryera në Palët e tjera ose të vlerësojnë nëse kërkuesit që kanë kryer kualifikime në Palët e tjera plotësojnë të njëjtat kushte.

#### Neni IV.5

Kur në Palën tjetër, në të cilën janë marrë dëftesat e arsimit të mesëm, lejojnë hyrjen në arsimin e lartë vetëm kur shoqërohen nga dëshmi të dhënies së provimeve plotësuese, si kusht paraprak për hyrjen, Palët e tjera mund të kushtëzojnë hyrjen me të njëjtat kërkesa ose të ofrojnë një alternativë që mund të plotësojë këto kërkesa plotësuese në gjirin e sistemeve të tyre arsimore. Çdo Shtet, Selia e Shenjtë, Komuniteti European, në momentin e nënshkrimit ose në momentin e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimin, aprovimit ose aderimit, ose në çdo moment tjetër në vazhdim, mund t'i deklarojnë njërit prej depozituesve se përdorin dispozitat e këtij neni, duke precizuar Palët kundrejt të cilëve ato kanë ndërmend të zbatojnë këtë nen, si dhe arsyet që justifikojnë këtë masë.

#### Neni IV.6

Pa paragjykuar dispozitat e neneve IV.1, IV.2, IV.3, IV.4 dhe IV.5, pranimi në një institucion të përcaktuar të arsimit të lartë ose në një program të caktuar të këtij institucioni mund të jetë i kufizuar ose selektiv. Në rastet kur pranimi në një institucion dhe/ose në një program të arsimit të lartë është selektiv, procedurat e pranimin duhet të jenë të konceptuara në atë mënyrë që vlerësimi i kualifikimeve të huaja bëhet konform me principet e barazisë dhe të mosdiskriminimit të përshkruar në seksionin III.

#### Neni IV.7

Pa paragjykuar dispozitat e neneve IV.1, IV.2, IV.3, IV.4 dhe IV.5, pranimi në një institucion të caktuar të arsimit të lartë mund të varet nga prova që disponon kërkuesi. Kjo provë mund të jetë e njohjes së mjaftushme të gjuhës ose të gjuhëve të mësimin në institucionin në fjalë ose gjuhë të tjera të specifikuar.

#### Neni IV.8

Në Palët në të cilat hyrja në arsimin e lartë mund të arrihet mbi bazën e kualifikimeve jotradicionale, kualifikime të tjera të ngjashme të kryera në Palë të tjera vlerësohen në të njëjtën mënyrë si kualifikimet jo tradicionale të kryera në Palën në të cilën kërkohet njohja.

#### Neni IV.9

Për arritur pranimin në programet e arsimit të lartë, çdo Palë mund të pranojë që njohja e kualifikimeve të kryera nga një institucion arsimor i huaj, i vendosur në territorin e vet, i nënshtrohet kushteve specifike të legjislacionit kombëtar ose marrëveshjeve specifike të nënshkruara me Palën prej nga është origjina e këtij institucioni.

## Seksioni V. Njohja e periudhave të studimit

### Neni V.1

Secila Palë njeh periudhat e studimeve të kryera në kuadër të një programi të arsimit të lartë në një Palë tjetër. Kjo njohje përfshin periudhat e studimeve që synojnë përfundimin e një programi të arsimit të lartë në Palën në të cilën është kërkuar njohja, me përjashtim të rasteve kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet periudhës së studimeve të kryera në një Palë tjetër dhe pjesës së programit të arsimit të lartë që ato do të zëvendësonin në Palën ku është kryer njohja.

### Neni V.2

Në një alternativë tjetër, mjafton që një Palë t'i lejojë një personi që ka kryer një periudhë studimesh në kuadër të një programi të arsimit të lartë të një Pale tjetër të marrë një vlerësim të kësaj periudhe studimesh, me kërkesë të vetë personit, dhe dispozitat e nenit V.1, në një rast të tillë, zbatohen mutatis mutandis.

### Neni V.3

Në veçanti, secila Palë lehtëson njohjen e periudhave të studimit kur:

- a) ka një marrëveshje paraprake ndërmjet, nga njëra anë, institucionit të arsimit të lartë ose autoritetit kompetent përgjegjës për periudhën e studimeve dhe nga ana tjetër, institucionit të arsimit të lartë ose autoritetit kompetent në çështje të njohjes, përgjegjës për njohjen e kërkuar; dhe
- b) institucioni i arsimit të lartë ku është kryer periudha e studimeve dhe është lëshuar një certifikatë ose listë notash që vërteton se studenti i ka plotësuar kërkesat e nevojshme për këtë periudhë studimesh.

## Seksioni VI. Njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë

### Neni VI.1

Në rastet kur një vendim njohjeje bazohet mbi njohjet dhe dijet e vërtetuara nga një kualifikim i arsimit të lartë, secila Palë njeh kualifikimet e arsimit të lartë të dhëna nga një Palë tjetër, me përjashtim të rasteve kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet kualifikimit të cilit i kërkohet njohja dhe kualifikimit korrespondent në Palën në të cilën kërkohet njohja.

### Neni VI.2

Në mënyrë alternative, mjafton që një Palë t'i lejojë mbajtësit të një kualifikimi të arsimit të lartë, të dhënë nga njëra nga Palët e tjera, të marrë një vlerësim të këtij kualifikimi, me kërkesë të mbajtësit, dhe në këtë rast dispozitat e nenit VI.1 zbatohen mutatis mutandis.

### Neni VI.3

Njohja nga njëra Palë e një kualifikimi të arsimit të lartë i dhënë nga një Palë tjetër mbart dy pasojat e mëposhtme ose njërin prej tyre:

- a) hyrjen në studimet e larta plotësuese, duke përfshirë provimet që kanë të bëjnë me to, dhe/ose në përgatitjen e doktoratës, në të njëjtat kushte me ato që zbatohen për mbajtësit e kualifikimeve të Palës në të cilën është kërkuar njohja.

b) përdorimin e një titulli akademik sipas ligjeve, rregullave ose të juridiksionit të Palës në të cilën është kërkuar njohja.

Përveç kësaj, njohja mund të lehtësojë hyrjen në tregun e punës, sipas ligjeve, rregullave ose juridiksionit të Palës në të cilën është kërkuar njohja.

#### Neni VI.4

Vlerësimi, nga një Palë, i një kualifikimi të arsimit të lartë të dhënë nga një Palë tjetër mund të ketë njërin nga format e mëposhtme:

- a) vlerësime të papërdorshme për qëllime pune;
- b) vlerësime të drejtuara një institucioni arsimor për pranim në programet e tij;
- c) vlerësime të destinuara për çdo autoritet tjetër kompetent në çështje njohjesh.

#### Neni VI.5

Duke qenë se flitet për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë të dhëna nga një institucion i arsimit të lartë i vendosur në territorin e vet, secila Palë mund t'ia nënshtrojë këtë njohje kushteve specifike të legjislacionit kombëtar ose marrëveshjeve specifike të nënshkruara me Palën prej nga e cila varet ky institucion.

Seksioni VII. Njohje e kualifikimeve të refugjatëve, e personave të zhvendosur dhe e personave të krahasuar me refugjatët.

#### Neni VII

Secila Palë merr të gjitha masat e mundshme dhe të arsyeshme në kuadrin e sistemit të vet arsimor, konform dispozitave konstitucionale, ligjore dhe administrative, për të përpunuar procedurat e përshtatshme që lejojnë vlerësimin e drejtë dhe efikas, nëse refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët plotësojnë kushtet e nevojshme për hyrjen në arsim të lartë, ndjekjen e programeve të arsimit të lartë plotësuese ose ushtrimin e një aktiviteti profesional dhe kjo do të ndodhë edhe kur kualifikimet e kryera në njërin nga Palët nuk mund të vërtetohen nga dokumente që mund ta bëjnë këtë gjë.

Seksioni VIII. Informacion mbi vlerësimin e institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë.

#### Neni VIII.1

Secila Palë jep informacionet e nevojshme mbi të çdo institucion që varet nga sistemi i saj i arsimit të lartë, si dhe mbi çdo program të organizuar nga këto institucione, me qëllim që t'u krijojë mundësinë autoriteteve kompetente të Palëve të tjera të verifikojnë nëse cilësia e kualifikimeve të dhëna nga këto institucione justifikon njohjen në Palën në të cilën është kërkuar njohja. Një informacion i tillë paraqitet si më poshtë:

a) në rastin e Palëve që kanë krijuar një sistem zyrtar të vlerësimit të institucioneve dhe të programeve të arsimit të lartë; informacion mbi metodat dhe rezultatet e këtij vlerësimi dhe mbi normat e cilësisë specifike për çdo tip institucioni të arsimit të lartë që jep kualifikime të arsimit të lartë dhe programet e tyre;

b) në rastet e Palëve që nuk kanë krijuar një sistem zyrtar të vlerësimit të institucioneve dhe të programeve të arsimit të lartë; informacion mbi njohjen e kualifikimeve të ndryshme të kryera në çdo institucion ose nëpërmjet çdo programi që varet nga sistemi i tyre i arsimit të lartë.



## Neni VIII.2

Secila Palë merr dispozitat e nevojshme për të përcaktuar, rifreskuar dhe për të shpërndarë:

- a) një tipologji të tipeve të ndryshme të institucioneve të arsimit të lartë, që varen nga sistemi përkatës i arsimit të lartë, duke përfshirë karakteristikat specifike për çdo tip institucioni;
- b) një listë të institucioneve (publike dhe private) të njohura si vartëse të sistemit arsimor përkatës, duke saktësuar kapacitetin e tyre për të dhënë tipe të ndryshme kualifikimesh, si dhe kushtet e kërkuara për hyrjen në çdo tip institucioni dhe programi;
- c) një përshkrim i programeve të arsimit të lartë;
- d) një listë institucionesh të arsimit, të ndodhura jashtë territorit të saj dhe që ajo konsideron si vartëse të sistemit të saj arsimor.

## Seksioni IX. Informacion mbi çështjet e njohjes

### Neni IX.1

Për të lehtësuar njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë, Palët angazhohen të përcaktojnë sisteme transparente që lejojnë një përshkrim të plotë të kualifikimeve të dhëna.

### Neni IX.2

1. Duke ditur domosdoshmërinë e informacioneve të duhura, të sakta dhe të rifreskuara, secila Palë krijon ose mirëmban një qendër kombëtare të informacionit dhe i njofton njërët prej depozituesve këtë krijim ose çdo modifikim që ka të bëjë me të.

2. Në secilën Palë, Qendra Kombëtare e Informacionit:

- a) lehtëson marrjen e informacioneve të sakta dhe të besueshme mbi sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet e vendit në të cilin ndodhet;
- b) lehtëson marrjen e informacioneve mbi sistemet e arsimit të lartë dhe kualifikimit të Palëve të tjera;
- c) jep këshilla ose informacione mbi njohjet dhe vlerësimet e kualifikimeve, duke respektuar ligjet dhe rregullat kombëtare.

3. Çdo qendër kombëtare informacioni duhet të ketë në dispozicion mjetet e nevojshme për të kryer funksionet e saj.

### Neni IX.3

Palët inkurajojnë, me ndërmjetësinë e qendrave kombëtare të informacionit ose me mjete të tjera, përdorimin, nga institucione të arsimit të lartë të palëve, të Suplementit të Diplomës të UNESCO-s, Këshillit të Evropës ose çdo dokument tjetër i krahasueshëm.

## Seksioni X. Mekanizmat e zbatimit

### Neni X.1

Organet e mëposhtme vëzhgojnë, nxisin dhe lehtësojnë zbatimin e Konventës:

- a) Komiteti i Konventës mbi njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në rajonin e Europës;
- b) Rrjeti European i Qendrave Kombëtare të Informacionit mbi njohjen dhe mobilitetin akademik (rrjeti ENIC i krijuar me vendim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 9 qershor 1994 dhe të Komitetit Rajonal për Europën i UNESCO-s më 18 qershor 1994).

## Neni X.2

1. Komiteti i Konventës mbi njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në rajonin europian (që nga ku moment “Komiteti”) krijohet nga kjo Konventë. Ai është i përbërë nga një përfaqësues për çdo Palë.

2. Për nenin X.2, termi “Palë” nuk aplikohet për Komunitetin Europian.

3. Shtetet e përmendura në nenin XI.1.1 dhe Selia e Shenjtë, nëse nuk janë Palë në këtë Konventë, Komuniteti Europian si dhe Presidenti i rrjetit të ENIC mund të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues. Përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare që veprojnë në fushën e njohjes në Rajon mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues.

4. Edhe Presidenti i Komitetit Rajonal të UNESCO-s për zbatimin e Konventës mbi njohjen e studimeve dhe diplomave të arsimit të lartë në Shtetet që i përkasin Rajonit të Europës do të ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues.

5. Komiteti nxit zbatimin e kësaj Konvente dhe vëzhgon vënien e saj në jetë. Për këtë qëllim, ai mund të miratojë, me shumicën e Palëve rekomandime, deklarata, protokolle dhe kode praktike për të ndihmuar autoritetet kompetente të Palëve në zbatimin e Konventës dhe në shqyrtimin e kërkesave të njohjes së kualifikimeve të arsimit të lartë. Megjithëse nuk detyrohen nga këto tekste, Palët nuk do të kursejnë asnjë përpjekje për t'i zbatuar, për t'i vënë në vëmendje të autoriteteve kompetente dhe për të inkurajuar zbatimin e tyre. Komiteti kërkon mendimin e Rrjetit ENIC para se të marrë vendimet e tij.

6. Komiteti u raporton instancave përkatëse të Këshillit të Europës dhe UNESCO-s.

7. Komiteti siguron lidhjen me komitetet rajonale të UNESCO-s për zbatimin e konventave mbi njohjen e studimeve, diplomave dhe gradave të arsimit të lartë, të miratuara nën patronazhin e UNESCO-s.

8. Kuorumi arrihet kur është e pranishme shumica e Palëve.

9. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme. Ai mbledhet në një sesion të zakonshëm të paktën çdo tre vjet. Komiteti mbledhet për herë të parë brenda afatit njëvjeçar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

10. Sekretariati i Komitetit i besohet bashkërisht Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

## Neni X.3

1. Secila Palë zgjedh si anëtare të Rrjetit Europian të Qendrave Kombëtare të Arsimit mbi mobilitetin dhe njohjen akademike (Rrjeti ENIC, Qendra Kombëtare e Informacionit e krijuar ose mirëmbajtur nga Pala sipas nenit IX.2), në rastin kur janë krijuar më shumë se një qendër kombëtare e informacionit në një Palë sipas nenit IX.2; të gjitha këto qendra janë anëtare të Rrjetit, por këto qendra kombëtare të informacionit disponojnë vetëm një zë.

2. Rrjeti ENIC, në përbërjen e tij që kufizohet në qendrat kombëtare të informacionit të Palëve në këtë Konventë, sjell mbështetjen e tij dhe ndihmën në zbatimin praktik të Konventës nga autoritetet kombëtare kompetente. Rrjeti mbledhet të paktën një herë në vit në sesion plenar. Ai zgjedh Presidentin dhe Byronë e tij në përputhje me mandatin e tij.

3. Sekretariati i Rrjetit ENIC i besohet bashkërisht Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

4. Palët bashkëpunojnë, nëpërmjet Rrjetit ENIC, me qendra të tjera të informacionit të Palëve të tjera, duke u bërë të mundur marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për realizimin e aktiviteteve të qendrave kombëtare të informacionit në lidhje me njohjen dhe mobilitetin akademik.

## Seksioni XI. Dispozita finale

### Neni XI.1

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim:
  - a) ndaj Shteteve anëtare të Këshillit të Europës;
  - b) ndaj Shteteve anëtare të Rajonit të Europës të UNESCO-s;
  - c) ndaj çdo nënshkruesi tjetër, Shtet kontraktues ose Palë e Konventës kulturore europiane të Këshillit të Europës dhe/ose të Konventës së UNESCO-s mbi njohjen e studimeve dhe diplomave të arsimit të lartë në Shtetet e Rajonit të Europës, që janë të ftuar të marrin pjesë në Konferencën diplomatike e ngarkuar për miratimin e kësaj Konvente.
2. Këto Shtete dhe Selia e Shenjtë mund ta shprehin miratimin e tyre për të qenë të lidhur:
  - a) me nënshkrim, pa rezerva ratifikimi, pranimi ose aprovimi, ose
  - b) me nënshkrim, duke iu nënshtruar ratifikimit, pranimi ose aprovimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi se aprovimi; ose
  - c) me aderim.
3. Nënshkrimet do të bëhen pranë një depozituesi. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit do të depozitohen pranë njërit prej depozituesve.

### Neni XI.2

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit, që vjen pas skadimit të një afati njëmuor pas shprehjes së miratimit të pesë Shteteve, prej të cilëve të paktën tre Shtete anëtare të Këshillit të Europës dhe/ose të Rajonit Europë të UNESCO-s, për të qenë të lidhur nga kjo Konventë. Ajo do të hyjë në fuqi, për çdo shtet tjetër, ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të afatit njëmuor pas datës së shprehjes së miratimit për të qenë e lidhur nga kjo Konventë.

### Neni XI.3

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo Shtet përveç atyre që i përkasin njëres prej kategorive të renditura në nenin XI.1 mund të paraqesë një kërkesë aderimi në Konventë. Çdo kërkesë do t'i komunikohet njërit prej depozituesve, i cili do t'ua transmetojë Palëve të paktën tre muaj para mbledhjes së Komitetit të Konventës mbi njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Rajonin European. Depozituesi do të njoftojë edhe Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës dhe të Këshillit Ekzekutiv të UNESCO-s.
2. Vendimi për të ftuar një Shtet që ka paraqitur kërkesë për të aderuar në këtë Konventë merret me më shumë se dy të tretave të Palëve.
3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti Evropian mund të aderojë, me kërkesën e Shteteve të tij anëtare, kërkesë që i drejtohet njërit prej depozituesve. Në këto rrethana, neni XI.3.2 nuk zbatohet.
4. Për çdo Shtet aderues, dhe për Komitetin European, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të afatit njëmuor pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë njërit prej depozituesve.

### Neni XI.4

1. Palët e kësaj Konvente, që janë në të njëjtën kohë Palë të njëres ose disa prej Konventave të mëposhtme:
  - Konventa Europiane mbi ekuivalentimin e diplomave që lejojnë hyrjen në institucionet universitare (1953, STE No 15) dhe Protokollin i saj (1964, STE No 49);
  - Konventa Europiane për ekuivalentimin e periudhave të studimeve universitare (1956, STE No 21);

Konventa Europiane mbi njohjen akademike të kualifikimeve universitare (1959, STE No 32);

Konventa Ndërkombëtare mbi njohjen e studimeve, të diplomave dhe të gradave të arsimit të lartë në Shtetet Arabe dhe në Shtetet Europiane që larg Mesdheu (1976);

Konventa mbi njohjen e studimeve dhe të diplomave të arsimit të lartë në Shtetet e Rajonit të Europës (1979);

Konventa Europiane mbi ekuivalentimin e përgjithshëm të periudhës së studimeve universitare (1990, STE 138):

a) do të zbatojnë dispozitat e kësaj Konvente në marrëdhëniet e tyre reciproke;

b) do të vazhdojnë të zbatojnë konventat e përmendura më sipër, në të cilat ato janë Palë, në marrëdhëniet e tyre me Shtetet të tjera Palë në konventat e mësipërme, por jo në këtë Konventë.

2. Palët e kësaj Konvente angazhohen të abstenojnë nga të qënit Palë në konventat e përmendura në paragrafin 1, në të cilat ato nuk do të ishin ende Palë, me përjashtim të Konventës Ndërkombëtare mbi njohjen e studimeve, të diplomave dhe gradave të arsimit të lartë në Shtetet Arabe dhe Shtetet Europiane që lagen nga deti Mesdhe.

#### Neni XI.5

1. Çdo Shtet mund të përcaktojë territorin ose territoret për të cilët zbatohet kjo Konventë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit në Konventë.

2. Në çdo moment tjetër, secili Shtet mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër me një deklaratë të drejtuar njërit prej depozituesve. Konventa do të hyjë në fuqi, për këtë territor, ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të një afati njëmuor, duke filluar nga data e marrjes së një deklaratë të tillë nga depozituesit.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, për çdo territor të përcaktuar nga një deklaratë e tillë, mund të tërhiqet me një notë drejtuar njërit prej depozituesve. Ajo do të ketë efekt ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të një afati njëmuor pas datës së marrjes së një note të tillë nga depozituesit.

#### Neni XI.6

1. Secila Palë mund të denoncojë në çdo moment këtë Konventë me një notë drejtuar njërit prej depozituesve.

2. Denoncimi do të ketë efekt ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të një afati prej dymbëdhjetë muajsh pas datës së marrjes së notës nga depozituesi. Megjithatë, ky denoncim nuk do të prekë vendimet e njohjes të marrë më parë sipas dispozitave të kësaj Konvente.

3. Anulimi i kësaj Konvente ose pezullimi i zbatimit të saj si rrjedhojë e shkeljes nga ana e një Pale të një dispozite thelbësore për realizimin e objektivit ose qëllimit të Konventës do të bëhet konform ligjeve ndërkombëtare.

#### Neni XI.7

1. Çdo Shtet, Selia e Shenjtë, Komuniteti European mund të deklarojë se rezervojnë të drejtën për të mos zbatuar, pjesërisht totalisht, njërin ose disa prej neneve të mëposhtëm të kësaj Konvente. Kjo rezervë mund të bëhet në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit pranimit aprovimit ose aderimit në Konventë. Nenet nën rezervë:

Neni IV.8

Neni V.3

Neni VI.3

Neni VIII.2

Neni IX.3

Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

2. Çdo Palë që ka formuluar një rezervë sipas paragrafit të mësipërm mund ta tërheqë, të gjithën ose pjesërisht, me një notë drejtuar njërit prej depozituesve. Tërheqja merr efekt datën e marrjes së notës nga depozituesit.

3. Një Palë që ka formuluar një rezervë kundrejt një dispozite të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë zbatimin e saj nga një Palë tjetër; megjithatë, ajo mund të pretendojë zbatimin e kësaj dispozite në masën që ajo ka pranuar në rastin kur rezerva është e pjesshme ose e kushtëzuar.

#### Neni XI.8

1. Komiteti i Konventës mbi njohjen e kualifikimeve në arsimin e lartë në Rajonin European mund të miratojë projekte amendamentesh për këtë Konventë me një vendim të marrë me më shumë se dy të tretat e Palëve. Çdo amendament i miratuar në këtë mënyrë është i përfshirë në një protokoll të kësaj Konvente. Protokollin specifikon modalitetet e hyrjes së tij në fuqi e cila, për çdo rast, kërkon miratimin e Palëve në mënyrë që ato të lidhen me protokollin.

2. Asnjë amendament nuk mund të bëhet për seksionin III të kësaj Konvente sipas procedurës së paragrafit 1 më sipër.

3. Çdo propozim amendamenti duhet t'i komunikohet njërit prej depozituesve, i cili do t'ua transmetojë Palëve të paktën tre muaj para mbledhjes së Komitetit. Depozituesi do të informojë edhe Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës dhe Këshillin Ekzekutiv të UNESCO-s.

#### Neni XI.9

1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën janë depozituesit e kësaj Konvente.

2. Depozituesi pranë të cilit është depozituar një akt, notë ose komunikatë do t'u bëjë të ditur Palëve këtë Konventë, si dhe Shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës dhe/ose Rajonit Europë të UNESCO-s:

1. çdo nënshkrim;
2. depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit;
3. çdo datë hyrjeje në fuqi të kësaj Konvente sipas dispozitave të neneve XI.2 dhe XI.3.4;
4. çdo rezervë të bërë për zbatimin e dispozitave të nenit XI.7 dhe tërheqjen e çdo rezerve të bërë për zbatimin e dispozitave të nenit XI.7;
5. çdo denoncim të kësaj Konvente në zbatim të nenit XI.6;
6. çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit II.1 ose nenit II.2;
7. çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit IV.5;
8. çdo kërkesë aderimi të bërë sipas nenit XI.3;
9. çdo propozim të bërë sipas nenit XI.8;
10. çdo akt tjetër, notë ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.

3. Depozituesi që merr një komunikatë ose procedon sipas një note sipas dispozitave të kësaj Konvente do të informojë menjëherë depozituesit e tjerë.

Në mirëbesim, përfaqësuesit e nënshkruar, të autorizuar plotësisht, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Lisbonë, më 11 prill 1997, në gjuhët angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, të katër tekstet duke patur vlerë të barabartë, në dy kopje, njëra prej të cilave do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës dhe tjetra në arkivat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën dhe një kopje e noterizuar do t'u shpërndahet të gjitha Shteteve të përmendura në nenin XI.I, Selisë së Shenjtë dhe Komunitetit European, si dhe Sekretariatit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

**VENDIM**  
**Nr.327, datë 17.5.2001**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SHQIPTARE DHE  
QEVERISË MAQEDONASE PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ARSIMIT DHE  
SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30, faqe 941*

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET QEVERISË SHQIPTARE DHE QEVERISË MAQEDONASE PËR BASHKËPUNIM**  
**NË FUSHËN E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Qeveria Shqiptare dhe Qeveria Maqedonase, në tesktin e mëposhtëm të quajtura “Palë Kontraktuese”,

Të udhëhequr nga dëshira të zhvillojnë bashkëpunimin e pandërprerë në fushën e arsimit dhe shkencës,

Të bindur, që ky bashkëpunim do të çojë drejt forcimit të raporteve miqësore ndërmjet të dy shteteve dhe thellimit të mirëkuptimit ndërmjet popujve të tyre,

Të vendosur që t’u bashkangjiten parimeve të aktit Final të Konferencës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (Akti i Helsinkit – i vitit 1975), Dokumentit të Parisit për Europën e Re, Konventës Kulturore Europiane, Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Deklaratës së Përgjithshme për të drejtat e njeriut, Konventës Europiane për të drejtat e njeriut, Konventës Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventës mbi njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë Lisbonë 1997, Paktit Ndërkombëtar për të drejta sociale, ekonomike dhe kulturore dhe Konventës për të drejtat e fëmijës

**Neni 1**

Bien dakord si më poshtë vijon:

Të dy palët do të nxisin dhe përkrahin bashkëpunimin në të gjitha fushat e arsimit dhe shkencës.

**Neni 2**

Të dy palët do të nisin dhe përkrahin bashkëpunimin aktiv dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e arsimit dhe shkencës. Për këtë gjë palët:

Do të bashkëpunojnë në nënshkrimin e dokumenteve për bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrisë Maqedonase të Arsimit dhe të Shkencës, si dhe ndërmjet shkollave përkatëse, universiteteve dhe institucioneve shkencore;

Do të ofrojnë bursa dhe të drejta studimi për kurse të plota dhe të pjesshme për kërkime shkencore për studentët, specializime pasuniversitare dhe doktoratura sipas mundësive të tyre dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar;

Do të realizojnë shkëmbimin e pedagogëve universitarë, kërkuesve shkencorë, doktorëve, specialistëve, studentëve e nxënësve;

Do të realizojnë shkëmbim të informacioneve dhe të publikimeve në të gjitha fushat e veprimtarisë arsimore dhe shkencore;

Do të shkëmbejnë eksperiencë në fushën e përgatitjes së teksteve për arsimin tetëvjeçar dhe të mesëm;

Do të shkëmbejnë lëndë mësimore nga fusha e shkencave natyrore, të aplikuara, humane e sociale;

Do të shkëmbejnë përvoja nga fusha e metodologjisë mësimore në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe materialeve didaktike;

Do të shkëmbejnë përvoja nga arsimi profesional;

Do të përkrahin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve që merren me punë hulumtuese shkencore dhe i nxisin të gjitha format e mundshme të veprimtarisë shkencore;

Do të realizojnë projekte të përbashkëta kërkimore shkencore;

Do të mbështesin pjesëmarrjen e përbashkët në projekte me karakter ndërkombëtar e rajonal.

### Neni 3

Palët, në mënyrë reciproke, mbështesin dhe ndihmojnë njëra-tjetrën në realizimin e së drejtës dhe cilësisë së arsimit të kombësive në të dy vendet, në përputhje me standardet e së drejtës ndërkombëtare dhe sipas legjislacionit të brendshëm të të dy vendeve. Për këtë qëllim ata do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e arsimit dhe ushtrimin prej tyre në gjuhën amtare, në format dhe nivelet e përcaktuara në kuadër të sistemeve shtetërore arsimore dhe në përputhje me nevojat arsimore.

Palët midis të tjerave:

Do të shkëmbejnë literaturë dhe tekste, mjete dhe materiale mësimore;

Do të bashkëpunojnë në realizimin dhe organizimin e seminareve, konsultave, simpoziumeve dhe formave të tjera në nivel profesional për zhvillimin e veprimtarisë arsimore në të gjitha shkallët e arsimit, duke shkëmbyer vizita të kuadrove të kualifikuara arsimore në institucionet arsimore përkatëse;

Pala maqedonase do të mbështesë mësimin e gjuhës maqedonase në Departamentin e Gjuhëve Sllave të Universitetit të Tiranës me literaturë dhe staf mësimor.

### Neni 4

Dëftesa e pjekurisë që jepet nga institucionet arsimore shqiptare pas përfundimit të arsimit të mesëm (gjimnaze dhe shkollat teknike e profesionale 4 ose 5-vjeçare) dhe diploma e përfundimit të arsimit të mesëm (gjimnaze dhe shkollat teknike e profesionale 4 ose 5 vjeçare) dhe diploma e përfundimit të arsimit të mesëm (gjimnazet ose shkollat teknike e profesionale 4 ose 5 vjeçare), që jepet nga institucionet arsimore maqedonase, njihen në të dy shtetet dhe konsiderohen ekuivalente për pranimin në shkollat e larta të të dy vendeve.

### Neni 5

Diplomat e arsimit të lartë profesional që jepen nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe diplomat e arsimit të lartë profesional që jepen nga institucionet e arsimit të lartë në Maqedoni me të njëjtën kohëzgjatje janë ekuivalente dhe njihen për punësim në të dy vendet në përputhje me specialitetin (profesionin) dhe kualifikimin, që shënohet në këto dokumente.

Studentët kanë të drejtë të studiojnë më tej në përputhje me rregullat dhe ligjet në të dy vendet.

#### Neni 6

Diplomat universitare jo më pak se 4-vjeçare, që jepen nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe Maqedoni, njihen dhe konsiderohen ekuivalente në territorin e të dy vendeve për të vazhduar studimet pasuniversitare, si dhe për t'u punësuar në përputhje me specialitetin dhe kualifikimin e shënuar në to.

#### Neni 7

Diploma e studimeve të thelluara pasuniversitare, që jepet nga shkollat e larta shqiptare dhe diploma maqedonase e magjistratit që jepet nga shkollat e larta maqedonase, njihen në të dy vendet dhe sigurojnë të drejtën për të vazhduar studimet për doktoratë dhe punësim në territorin e të dy vendeve, në përputhje me specialitetin dhe kualifikimin e shënuar në to.

#### Neni 8

Diploma shqiptare e “Doktorit të Shkencave” dhe diploma maqedonase e “Doktorit të Shkencave”, që jepen në vendet respektive, njihen dhe konsiderohen ekuivalente dhe u japin zotëruesve të drejtën të ushtrojnë veprimtari profesionale në të dy shtetet, në përputhje me gradën e akorduar.

#### Neni 9

Palët do të shkëmbejnë informacion mbi sistemet e arsimit, mbi modelet e dokumenteve shtetërore për arsimin dhe gradat shkencore, si dhe do të informojnë njera-tjetrën për çdo ndryshim në fushën në fjalë.

Ato do të informohen në mënyrë të ndërsjellë për ndryshimet e bëra në legjislacionin e të dy palëve në fushën e arsimit dhe shkencës.

#### Neni 10

Palët përkrahin bashkëpunimin dhe informimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet ministrive përkatëse të arsimit dhe shkencës në fusha të interesit të përbashkët, si dhe atë të shkencave natyrore, të aplikuara, humane e sociale, si edhe shkëmbimin e planeve dhe programeve mësimore, të librave dhe teksteve shkollore.

#### Neni 11

Palët do të kujdesen që të gjitha çështjet në fushën e bashkëpunimit në arsim dhe shkencë të të dy shteteve të zgjidhen përmes bashkëpunimit dhe dialogut të ndërsjellë.

#### Neni 12

Palët përkrahin bashkëpunimin aktiv në kuadër të projekteve dhe programeve të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, UNESCO-s, nismave rajonale dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, iniciativave dhe programeve nga fusha e arsimit dhe shkencës.



#### Neni 13

Palët do të ndihmojnë dhe nxisin bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e organizatave dhe institucioneve të tyre arsimore dhe shkencore në kuadrin e programeve dhe projekteve ndërkombëtare e rajonale në fushën e shkencës, teknologjisë dhe zhvillimit.

#### Neni 14

Palët nxisin dhe favorizojë bashkëpunimin midis institucioneve arsimore në nivel lokal midis komunave, qyteteve të binjakëzuar etj.

#### Neni 15

Palët përkrahin realizimin e kontakteve dhe shkëmbimeve të nxënësve dhe studentëve nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve për bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve kompetente të të dy palëve.

#### Neni 16

Në përputhje me legjislacionin e vet dhe në bazë të reciprocitetit, palët do të krijojnë kushte për lehtësimin e hyrjes dhe daljes së materialeve informative për arsimin, të mjeteve dhe pajisjeve didaktike, librave shkollore etj.

#### Neni 17

Aktivitetet konkrete të kësaj Marrëveshjeje, kushtet financiare dhe kushtet e tjera për shkëmbim, përcaktohen me programe për bashkëpunim trevjeçar midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës së Republikës së Maqedonisë, me marrëveshje të ndara për bashkëpunim të drejtpërdrejtë midis institucioneve dhe organizatave homologe në fushat përkatëse, si dhe programe plotësuese, të cilat nuk janë përcaktuar në këtë Marrëveshje, por janë në përputhje me qëllimet e saj.

#### Neni 18

Për realizimin e kësaj Marrëveshjeje, palët do të formojnë një komision të përbashkët prej 6 (gjashtë) personash; secila palë do të ketë nga 3 (tre) anëtarë, të cilët do të takohen periodikisht në territorin e të dy vendeve kontraktuese.

#### Neni 19

Kjo Marrëveshje nënshkruhet për një periudhë 5(pesë)-vjeçare dhe automatikisht do të vazhdojë për një periudhë të re 5(pesë)-vjeçare, në qoftë se asnjëra nga palët, përmes rrugëve diplomatike me letër, më vonë se 6 muaj para skadimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje, nuk paralajmëron anulimin e saj.

Anulimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do ta ndërpresë realizimin e programit realizues të nënshkruar ose ndonjë kontratë tjetër, të nënshkruar për realizimin e Marrëveshjes.

#### Neni 20

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga dita e sjelljes së notës së dytë me të cilën palët përmes rrugëve diplomatike në mënyrë të ndërsjellë informohen, që janë realizuar procedurat e legjislacioneve kombëtare, të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në Shkup në datën 23.2.2001 në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, maqedone dhe angleze me tekstet ekuivalente. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretimin e teksteve, do të vlejë teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë Shqiptare

Për Qeverinë Maqedonase

## LIGJ

Nr.9756, datë 18.6.2007

### **PËR RATIFIKIMIN E “PROGRAMIT PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË PËR PERIUDHËN 2007-2009”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Programi për bashkëpunimin në fushën e arsimit, shkencës dhe kulturës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për periudhën 2007-2009”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5374, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.80, datë 4.7.2007, faqe 2381*

#### **PROGRAM**

**PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHAT E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË BULLGARISË, PËR PERIUDHËN 2007-2009**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë këtu quhen “të dy Palët”;

*të nisura* nga dëshira për të zhvilluar dhe thelluar bashkëpunimin e tyre në fushat e arsimit, shkencës dhe kulturës;

*me synimin* e forcimit dhe nxitjes së marrëdhënieve miqësore ndërmjet popujve të Shqipërisë dhe Bullgarisë;

*për zbatimin* e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës, dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë mbi bashkëpunimin kulturor dhe shkencor, nënshkruar në Sofje, më 13 mars 1990;

kanë rënë dakord të nënshkruajnë Programin e mëposhtëm të bashkëpunimit në fushat e arsimit, shkencës dhe kulturës, për periudhën 2007-2009.

## I. ARSIMI DHE SHKENCA

### Neni 1

Të dy Palët do të nxisin vendosjen dhe konsolidimin e kontakteve ndërmjet institucioneve arsimore dhe shkencore të Shqipërisë dhe Bullgarisë dhe do të inkurajojnë nënshkrimin e marrëveshjeve të drejtpërdrejta të bashkëpunimit ndërmjet tyre. Ato do të mbështesin zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Kliment Ohridski dhe Universitetit të Tiranës, nënshkruar më 23 korrik 1998 në Tiranë.

### Neni 2

Të dy Palët do të shkëmbejnë informacionin dhe dokumentacionin mbi strukturat dhe përmbajtjen e arsimit dhe shkencës në secilin vend, me synim njohjen më të mirë me sistemin e arsimit dhe kërkimit shkencor në vendin tjetër.

### Neni 3

Të dy Palët do të lehtësojnë dhe inkurajojnë:

- studimin e gjuhës dhe letërsisë bullgare në Shqipëri dhe të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Bullgari, në kuadër të sistemeve respektive të arsimit, si dhe në kuadër të nismave arsimore, të ndërmarra dhe të mbështetura nga shoqatat përkatëse kulturore dhe arsimore në territoret e të dy vendeve;

- studime në institucionet e arsimit të lartë të palës tjetër kundrejt pagesave dhe mbi bazën e legjislacionit të brendshëm të të dy Palëve, duke i dhënë prioritet shtetasve shqiptarë që flasin bullgarisht dhe shtetasve bullgarë që flasin shqip.

### Neni 4

Të dy Palët do të bien dakord çdo vit për bursat, të cilat mund të përdoren për kurse trajnuese të plota ose të pjesshme, studime të specializuara afatshkurtra ose afatgjata dhe studime pasuniversitare.

Numri i muajve bursë për çdo person, i bursave dhe temave të trajnimeve do të përcaktohet çdo vit, duke ruajtur interesat e të dy Palëve.

### Neni 5

Pala bullgare do të ofrojë çdo vit 3 (tre) vende për pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë në studimet bullgare gjatë seminareve verore në gjuhën dhe kulturën bullgare në Sofie dhe Veliko Turnovo. Pala shqiptare do të ofrojë çdo vit 2 (dy) vende për pjesëmarrjen e studiuesve bullgarë në seminarët verore të gjuhës dhe kulturës shqiptare.

### Neni 6

Të dy Palët do të mbështesin punën e lektorateve në gjuhën shqipe në universitetet në Sofie dhe Veliko Turnovo dhe lektorateve në gjuhën bullgare në universitetet e Tiranës dhe Elbasanit.

### Neni 7

Të dy Palët do të shkëmbejnë ekspertë në fushën e arsimit, për pjesëmarrje në konferenca, simpoziume dhe sesione kërkuese shkencore me interes të përbashkët. Numri i këtyre shkëmbimeve dhe kohëzgjatja e tyre do të përcaktohet në ftesat që do të dërgohen.

#### Neni 8

Të dy Palët do të shkëmbejnë shkencëtarë dhe lektorë në institucionet e arsimit të lartë dhe organizatat shkencore në fushën e legjislacionit, organizimit dhe menaxhimit të arsimit dhe shkencës. Kuotat vjetore për këto shkëmbime do të jenë 3-4 persona, për një periudhë 7-10 ditë secila.

#### Neni 9

Të dy Palët do të garantojnë një njohje korrekte të historisë, gjeografisë, kulturës dhe aspekteve të tjera social-politike dhe ekonomike të jetës në vendin përkatës, në tekstet mësimore dhe publikimet shkencore/traktatet, enciklopeditë, fjalorët. Për këtë qëllim, ato do të shkëmbejnë informacion, dokumente, libra shkollorë të historisë, gjeografisë etj.

#### Neni 10

Të dy Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e publikimeve shkollore, programeve dhe teksteve mësimore, filmave teknikë dhe shkencorë dhe materialeve të tjera për qëllimet e trajnimit dhe kërkimit shkencor. Ky shkëmbim do të mbështetet në kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet organeve arsimore shqiptare dhe bullgare, instituteve të kërkimit pedagogjik dhe shtëpive botuese të teksteve shkollore në nivele të ndryshme.

#### Neni 11

Të dy Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin për çështjet e arsimit parashkollor dhe rritjes së fëmijëve, përfshirë aktivitetet jashtëshkollore.

#### Neni 12

Të dy Palët do të mbështesin zbatimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin Shkencor ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, nënshkruar më 12 tetor 1999 në Sofje dhe marrëveshjeve ndërmjet institucioneve shkencore përkatëse shqiptare dhe bullgare.

#### Neni 13

Fëmijëve të anëtarëve të misioneve diplomatike nuk do t'u kërkohej të paguajnë tarifa në shkollat publike në vendin tjetër për aq kohë sa prindërit e tyre janë me mandat zyrtar në atë vend.

Pala pritëse nuk do të paguajë bursë dhe as do të ofrojë konvikt për studentët e pranuar për t'u arsimuar atje.

## II. KULTURA DHE ARTI

#### Neni 14

Të dy Palët do të shkëmbejnë ftesa dhe informacion për aktivitete dhe festivale në të gjitha sferat e artit me pjesëmarrje ndërkombëtare (festivale, konkurse, mbledhje, simpoziume etj.) të mbajtura në territoret e tyre.

#### Neni 15

Të dy Palët do të nxisin kontakte direkte ndërmjet institucioneve të angazhuara në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare nëpërmjet bashkëpunimit në kërkimin, dokumentimin dhe mbrojtjen e monumenteve kulturore të secilit vend, që ndodhen në territorin e vendit tjetër.

#### Neni 16

Të dy Palët do të mbështesin nismat e shoqatave përkatëse arsimore dhe kulturore në territoret e të dy vendeve, me synimin e ruajtjes së objekteve kulture dhe fetare, që lidhen me historinë e të dy popujve.

#### Neni 17

Të dy Palët do të mbështesin bashkëpunimin në fushën teatrale, nëpërmjet vendosjes së kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet teatrit të kukullave dhe dramave, pritjes së ekspertëve për pjesëmarrjen në ngjarjet teatrore ndërkombëtare ose vëzhguesve për të ndjekur shfaqje teatrore dhe festivale.

#### Neni 18

Të dy Palët do të inkurajojnë zhvillimin e bashkëpunimit në fushën e muzikës dhe të kërcimit dhe do të shkëbejnë informacion për festivale ndërkombëtare të folkut, baletit dhe kërcimit, si dhe për konkurse të zhvilluara në territoret e tyre.

#### Neni 19

Të dy Palët do të nxisin shkëmbimin dhe bashkëpunimin në fushën e punës muzeale dhe trashëgimisë historike/kulturore nëpërmjet: inkurajimit të kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet muzeve të veçanta; shkëmbimit të ekspozitave të zgjedhura të artit, seleksionimi dhe kushtet e të cilave do të përcaktohen nëpërmjet kanaleve diplomatike; shkëmbimit të literaturës dhe ekspertëve në fushën e punës muzeale dhe menaxhimit të muzeve, aktiviteteve arkeologjike dhe ruajtëse/restauruese.

#### Neni 20

Të dy Palët do të ndihmojnë në krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave të tyre kombëtare dhe instituteve bibliografike nëpërmjet shkëmbimit të ekspertëve, materialeve informuese, librave dhe publikimeve të tjera të fondit të tyre; pjesëmarrjes në takime shkencore dhe konferenca dhe në projekte të përbashkëta kërkimore dhe botuese.

#### Neni 21

Të dy Palët do të nxisin zhvillimin e shkëmbimeve dhe bashkëpunimin në fushën e përkthimit, publikimit të librave dhe shpërndarjes së tyre: duke inkurajuar përkthimin, publikimin dhe popullarizimin e autorëve të vendit tjetër; duke inkurajuar vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet shoqërive të librit dhe ndërmjet shtëpive botuese të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë; duke shkëmbyer informacion në ekspozitat ndërkombëtare dhe panairët e librit të organizuara në territoret e tyre.

#### Neni 22

Të dy Palët do të zhvillojnë një bashkëpunim të drejtpërdrejtë në fushën e prodhimit të filmit, duke nxitur nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërmjet organizatave të tyre të filmit dhe organizimit të javëve të filmave shqiparë dhe bullgarë.

#### Neni 23

Të dy Palët do të mbështesin bashkëpunim ndërmjet shoqatave profesionale të fotografëve dhe do të ndihmojnë në shkëmbimin e ekspozitave të dokumenteve fotografike dhe artit të fotografisë.

#### Neni 24

Të dy Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet bashkimeve, shoqatave dhe organizatave profesioniste të të dy shteteve me synimin e njohjes reciproke me kulturën e vendit tjetër, pjesëmarrjen në takime krijuese, në konferenca dypalëshe dhe shumëpalëshe.

#### Neni 25

Të dy Palët do të lehtësojnë bashkëpunimin ndërmjet komisioneve të tyre kombëtare të UNESCO-s.

#### Neni 26

Të dy Palët, nëpërmjet marrëveshjeve reciproke, do të shkëmbejnë krijues dhe përfaqësues të sferave të ndryshme të kulturës dhe të artit (jo më shumë se dy në vit) për të shkëmbyer eksperiencë dhe kryerjen e udhëtimeve krijuese profesionale deri në 10 ditë.

### III. ARKIVAT

#### Neni 27

Të dy Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet arkivave shtetërore dhe do të sigurojnë mundësinë për t'i parë ato, do të shkëmbejnë eksperiencë dhe kopje të dokumenteve, publikimeve dhe literaturës së specializuar arkivore në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Palët do të çojnë më përpara zbatimin e Protokollit të bashkëpunimit në fushën e arkivave ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe Administratës Qendrore të Arkivave të Këshillit të Ministrave të Republikës së Bullgarisë, nënshkruar në Sofje, më 7 mars 2000.

### IV. TELEVISIONI, RADIO, SHTYPI

#### Neni 28

Të dy Palët do të zhvillojnë më tej lidhjet dhe do të inkurajojnë vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta në fushën e transmetimeve radio-televizive ndërmjet Radio Televizionit Kombëtar Shqiptar dhe Televizionit Kombëtar Bullgar dhe Radios Kombëtare Bullgare.

#### Neni 29

Të dy Palët do të mbështesin bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet agjencive të lajmeve kombëtare.

## V. SPORTET

### Neni 30

Të dy Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin dhe kontaktet ndërmjet organizatave rinore dhe institucioneve që merren me aktivitete kulturore dhe publike.

Të dy Palët do të shkëmbejnë informacion dhe eksperiencë në të gjitha fushat e lidhura me rininë dhe që synojnë forcimin e lidhjeve midis të rinjve dhe kontribuojnë për paqen ndërmjet tyre.

## VI. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE KUSHTET FINANCIARE

### Neni 31

Pala dërguese, në lidhje me shkëmbimin e personave, do t'i propozojë palës pritëse, të paktën 2 muaj përpara, informacionin e kërkuar për kandidatët-kualifikimet profesionale, titujt dhe gradat akademike etj., si dhe një program pune gjatë qëndrimit të tyre, ndërsa pala pritëse do të komunikojë përgjigjen e të paktën 3 (tri) javë përpara datës së planifikuar të vizitës.

Pala dërguese do të njoftojë palën pritëse për mënyrën e transportit dhe për datën e saktë të mbërritjes së personave, jo më vonë se 2 (dy) javë më përpara.

### Neni 32

Bursistët e pranuar në zbatim të këtij Programi do të përfitojnë një tarifë financiare, shuma e së cilës do të përcaktohet në përputhje e legjislacionin në fuqi të çdo vendi. Shpenzimet e transportit për në vendin e studimeve do të paguhet nga pala dërguese.

### Neni 33

Çdo Palë do t'i dërgojë Palës tjetër (jo më vonë se 31 maji i çdo viti për studentët pasuniversitarë dhe 31 korriku për studentët) dokumentacionin e plotë të aplikuesit për bursat e miratuara nga pala tjetër. Pala pritëse do të ftojë palën dërguese, deri më 31 gusht të çdo viti, aprovimin e aplikuesve bursat dhe do të përcaktojë gjithashtu vendin dhe datën e fillimit të studimeve.

### Neni 34

Lektorët do të dërgohen në bazë të kushteve të mëposhtme: Pala pritëse do t'u sigurojë lektorëve të huaj një shpërblim sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me kualifikimin e tij/saj, ndërsa pala dërguese do të jetë përgjegjëse për akomodimin dhe shpenzimet e udhëtimit të lektorëve.

### Neni 35

Shkëmbimi i personave në bazë të këtij Programi do të realizohet sipas kushteve të mëposhtme:

a) Pala dërguese do të paguajë shpenzimet e transportit të personave për në/dhe nga kryeqyteti i palës pritëse, si dhe siguracionin e tyre. Pala Pritëse do të mbulojë shpenzimet e transportit të brendshëm, akomodimin dhe ushqimin në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm në fuqi.

b) Këto kushte do të aplikohen edhe për shkëmbimin e personave dhe ansambleve artistike (deri në 15 persona) në fushën e arteve skenike.

Shkëmbimi i grupeve mbi 15 persona do të kryhet nëpërmjet organizatorëve ose nga marrëveshjet e arritura nëpërmjet kanaleve diplomatike për çdo rast specifik.

#### Neni 36

Trajtimi mjekësor, në rast sëmundjesh të papritura dhe që rrezikojnë jetën e personit, do të paguhet nga pala Pritëse, derisa gjendja kritike të ketë kaluar. Kujdesi tjetër shëndetësor do të ofrohet kundrejt sigurimit mjekësor ose sigurimit shëndetësor sipas dispozitave të legjislacionit të palës Pritëse.

#### Neni 37

Në shkëmbimin e personave ose të ansambleve artistike (deri në 15 persona) në fushën e arteve skenike, pala Pritëse do të mbulojë gjithashtu shpenzimet e qirave të sallave, të printimit të posterave dhe ftesave, si dhe çdo shpenzim i vjetër lidhur me reklamimin e shfaqeve.

#### Neni 38

Në shkëmbimin e ekspozitave, pala dërguese do të jetë përgjegjëse për shpenzimet e transportit dhe sigurimit të ekspozitave për në dhe nga kryeqyteti i vendit pritës, ndërsa pala pritëse, do të paguajë shpenzimet e transportit të brendshëm, qirasë së sallave, publikimin e katalogut dhe shpenzimet për reklamë.

Organizimi i ekspozitave muzeale me vlera të veçanta kulturore dhe historike do të realizohet në bazë të marrëveshjeve specifike.

#### Neni 39

Çdo Palë do të përjashtojë shtetasin e vendit tjetër nga çdo taksë për qëndrimin e tyre apo zgjatjen e këtij qëndrimi, kur ata kanë ardhur në zbatim të këtij Programi.

Personat e shkëmbyer në zbatim të këtij Programi nuk kanë nevojë për leje pune në shtetin pritës.

#### Neni 40

Ky Program nuk përjashton realizimin e aktiviteteve të tjera në fushën e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit, të negociuara nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Ky Program do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit të vendeve, nëpërmjet të cilit ato informohen për përmbushjen e kërkesave ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi dhe do të jetë i vlefshëm deri më 31 dhjetor 2009.

Bërë në Tiranë më 29 janar 2007, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze, dhe të të gjitha tekstet kanë të njëjtën vlerë autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

### VENDIM

**Nr.560, datë 12.8.2005**

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMEVE NË UNIVERSITETET DHE SHKOLLAT  
E LARTA PËR VITIN AKADEMIK 2005-2006, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË, SI  
DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR KËTË VIT AKADEMIK**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.596, datë 22.9.2005)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në universitetet dhe shkollat e larta publike, për vitin akademik 2005-2006, në sistemin me kohë të plotë, të jetë 18 054 studentë dhe të ndahet:

a) Kuota e pranimeve të reja	17 414;
b) Kuota për degë të dytë	300;
c) Kuota për vite të ndërmjetme	300;
ç) Kuota për shtetasit e huaj, me kombësi joshqiptare	40.
2. Kuota e pranimeve të reja përbëhet nga:	
a) Kuota kryesore	15 610;
b) Kuota dytësore	1 503;
c) Kuota për shqiptarët jashtë trojeve të Republikës së Shqipërisë	301.

3. Kuotat e pranimeve të reja ndahen sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi (në këtë tabelë nuk janë pasqyruar kuotat me vite të ndërmjetme, dege e dyte dhe kuotat për shtetasit e huaj me kombësi joshqiptare), ndërsa kuotat kryesore ndahen sipas tabelës nr.2 dhe kuotat dytësore sipas tabelës nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Metvegje konkurrojnë për kuotat e pranimit, të përcaktuara sipas degëve të paraqitura në tabelën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj, me kombësi joshqiptare, që do të studiojnë në universitetet dhe shkollat e larta të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bazë të kërkesave të paraqitura pranë universiteteve dhe shkollave të larta.

Për shtetasit rumunë, nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të jepen 5 (pesë) bursa studimi universitare dhe pasuniversitare.

6. Kuotat e pranimeve për vitet e ndërmjetme dhe për degë të dytë administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bazë të kërkesave të paraqitura nga universitetet dhe shkollat e larta.

7. Kandidatët, që do të vazhdojnë studimet në një degë të dytë, e fitojnë atë pa konkurs, por janë të detyruar të paguajnë një tarifë, e cila është e njëjtë me tarifën e shkollimit për kuotat dytësore, e përcaktuar në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrisë së Financave.

Në rastet kur ka më shumë kandidatë se kuotat e përcaktuara në këtë vendim, përzgjedhja e tyre bëhet në bazë të masës së ekuivalentimit dhe të cilësisë së rezultateve.

8. Tarifa vjetore e shkollimit për çdo student, që do të regjistrohet në vitin akademik 2005-2006, në kuotat kryesore, përfshirë edhe studentët e kurseve të tjera më të larta, të regjistruar në kuotat kryesore, të jetë në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në vit.

9. Tarifa e shkollimit, për çdo vit akademik, për studentët e degës "Regji filmi dhe TV", në Akademinë e Arteve, është 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë.

10. Studentët përsëritës, të regjistruar në kuotat kryesore, paguajnë tarifën e shkollimit të përcaktuar në këtë vendim, ndërsa ata të regjistruar në kuotat dytësore, paguajnë tarifë shkollimi të njëjtë me tarifën e shkollimit për kuotat kryesore, të përcaktuar në këtë vendim.

11. Studentët, që kërkojnë të transferohen nga universitetet dhe shkollat e larta jopublike në ato publike (brenda sistemit tonë të arsimit të lartë), si dhe studentët që vijnë nga jashtë Republikës së Shqipërisë (me përjashtim të atyre, që janë dërguar me studime sipas marrëveshjeve shtetërore, ndërinstucionale) i nënshtrohen tarifës së shkollimit në kuotën dytësore.

12. Mënyrat e plotësimit të kuotave të përcaktuara, përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me universitetet dhe shkollat e larta.

13. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të nxjerrë udhëzimet përkatëse për procedurat e regjistrimit dhe të pranimit në universitetet dhe shkollat e larta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63, faqe 2302

Vendim i KM nr.596, datë 22.9.2005, botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, faqe 2451

Tabela Nr. 1

KUOTA E PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AFFS	Σ
1	Histori	120										120
2	Gjeografi	120										120
3	Histori-Gjeografi				90	170		180				440
4	Gjuhë Letërsi	120			140	170	130	160	250			970
5	Edukim Qytetar				90							90
6	Anglisht	200			90	110	90	90	160			740
7	Frëngjisht	120			60			60				240
8	Italisht	130			90			60	130			500
9	Gjuhë Sllave Ballkanike	60										60
10	Gjermanisht	120			40			60				220
11	Gjuhë Letërsi Greke	80										140
12	Gjuhë Turke	53										53
13	Çikll i Ullit				180	140	140	160	220			840
14	Çikll i Ullit Parashkollor				110	90	90	90	150			530
15	Fizikantë						80	60			127	127
16	Matematikë	140										140
17	Fizikë	140										140
18	Matematikë-Fizikë				120	80		60	80			280
19	Biologji-Kimi	120			130	140		160				550
20	Kimi	70										70
21	Kimi Teknologjike dhe aplikimere	70										70
22	Kimi Industriale	70										70
23	Matematikë-Informatikë					130						130
24	Informatikë	70						80				150
25	Teknologji Informaticioni								90			90
26	Gazetar	90			80							170
27	Punë Sociale	130			110			120				360
28	Filozofi-Sociologji	130			90		90					310
29	Pedagogji e Specializuar								25			25
30	Psikologji	130			120			140				390
31	Shkenca Politike	130										130
32	Drejtësi	360						180	220			760
33	Regji Film dhe TV									10		10
34	Art Skenik									70		70
35	Arte Figurative									77		77
36	Muzikë									107		107
37	Mjekësi	230										230
38	Stomatologji	75										75
39	Farmaci	75										75
40	Infermeri	420			150	100	140	140	230			1180
41	Administrim Publik				130	150	100	120	220			1500
42	Administrim-Biznes	470			90							1040
43	Ekonomikë	95										185
44	Financë	470			130	240	160	120				1120
45	Jafë Ekonomikë	70										70
46	Utrizen					170	90	120	170			550
47	Marketing						90					90

## KUOTA E PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	
48	Insh. Dstare								80		80	
49	Navigation								80		80	
50	Mekamke		120								120	
51	Insh. Materiale		60								60	
52	Tekstil		60								60	
53	Elektrik		100								100	
54	Elektronik		140								140	
55	Ndërtim		230								230	
56	Arkitekturë		110								110	
57	Insh. Matematike		35								35	
58	Insh. Fizike		35								35	
59	Inshinier Gjeodet		50								50	
60	Inshinier Ambienti		60								60	
61	Insh. Ne shkencat e tokes		80								80	
62	Gjeoinformatike		60								60	
63	Inshin. i Gjeoburimeve		100								100	
64	Drejtim Fernalsh dhe AGB			200			90				290	
65	Ekonomi dhe P. Agrare			200							200	
66	Insh. Agr. ne Hortikulture dhe MB			140			90				230	
67	Insh. Agr. ne P. Bimor			120							120	
68	Insh. Agrar ne Zootek. dhe B. Blek			120							120	
69	Akunkulturë dhe M. Peshkimi			130							130	
70	Insh. Agromjedisit			150							150	
71	Tek. Agroushqimore			100							100	
72	Agr. Agroushqimor						60				60	
73	Vreshtari dhe Enologji			60							60	
74	Insh. Pjesh			100							100	
75	Insh. P. Druri			70							70	
76	Veterinari			130							130	
	<b>GJITHSEJTI</b>	<b>4678</b>	<b>1240</b>	<b>1520</b>	<b>2040</b>	<b>1840</b>	<b>1440</b>	<b>2160</b>	<b>2105</b>	<b>264</b>	<b>127</b>	<b>17414</b>

## KUOTAT KRYESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USU	UV	AA	AEPS	Σ
1	Histori	105										105
2	Gjeografi	106										106
3	Histori-Gjeografi				78	156		157				391
4	Gjuhë Letërsi	104			124	153	117	139	242			879
5	Edukim Qytetar				77							77
6	Anglisht	181			79	99	81	77	144			661
7	Frëngjisht	120			60			54				234
8	Italisht	118			79	81		50	117			445
9	Gjuhë Sllave Ballkanike	60						50				60
10	Gjermanisht	120			40							210
11	Gjuhë Letërsi Greke	80				55						135
12	Gjuhë Turke	50										50
13	Cikli i Ulet				165	126	125	139	200			755
14	Cikli i Ulet Parashkollor				100	81	89	66	137			473
15	Fizikulturë										113	113
16	Matematikë	121					79	51				251
17	Fizikë	120						52				172
18	Matematikë-Fizikë				120	75			80			275
19	Biologji-Kimi	104			114	126		141				485
20	Kimi	61										61
21	Kimi Teknologjike dhe ushqimore	61										61
22	Kimi Industriale	61										61
23	Matematikë-Informatikë					118						118
24	Informatikë	60						69				129
25	Teknologji Informacioni								81			81
26	Gazetari	80			70							150
27	Punë Sociale	114			96			108				318
28	Filozofi-Sociologji	115			81		80					276
29	Pedagogji e Specializuar								25			25
30	Psikologji	113			108			123				344
31	Stikencat Politike	113										113
32	Drejtesia	320						160	200			680
33	Regji Filmi dhe TV									10		10
34	Art Skenik									68		68
35	Arts Figurative									76		76
36	Muzikë									103		103
37	Mjekësi	203										203
38	Stomatologji	64										64
39	Farmaci	64										64
40	Infermieri	374			130	90	124	122	207			1047
41	Administrim Publik					134						134

KUOTAT KRYESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

42	Administrim-Biznes	423				117		89	105	198								
43	Ekonomiks	82				81												932
44	Financë	424				117	218	143	105								163	
45	Info. Ekonomike	60															1007	
46	Turizëm						153	80	103	153							60	
47	Marketing							83									489	
	<b>DEGA</b>	<b>UT</b>	<b>UPT</b>	<b>UBT</b>	<b>UE</b>	<b>UGJ</b>	<b>UK</b>	<b>USH</b>	<b>UV</b>	<b>AA</b>	<b>AEPS</b>						83	
48	Insh. Detare									80							80	
49	Navigation									80							80	
50	Mekaniqë		103														103	
51	Insh. Materiale		49														49	
52	Tekstil		49														49	
53	Elektrik		90														90	
54	Elektronik		125														125	
55	Ndërtim		205														205	
56	Arkitekturë		98														98	
57	Insh. Matematike		31														31	
58	Insh. Fizike		31														31	
59	Inshimier Gjeodet		45														45	
60	Inshimieri Ambienti		53														53	
61	Insh. Ne shkencat e tokës		72														72	
62	Gjeomorfmatike		54														54	
63	Inshim. i Gjeoburimeve		90														90	
64	Drejtim Fëmash dhe AGJB			178				83									261	
65	Ekonomi dhe P. Agrare			178													178	
66	Insh. Agr. ne Hortikulture dhe MB			127				88									215	
67	Insh. Agr. ne P. Bimor			107													107	
68	Insh. Agrar ne Zootek. dhe B. Blek			107													107	
69	Akuakulturë dhe M. Peshkimi			115													115	
70	Insh. Agromjedis			132													132	
71	Tek. Agroushqimore			85													85	
72	Agr. Agroushqimor							60									60	
73	Vreshitari dhe Entologji			49													49	
74	Insh. Pjesh			84													84	
75	Insh. P. Druri			57													57	
76	Veterinari			108													108	
	<b>G-JITHESJEJT</b>	<b>4181</b>	<b>1095</b>	<b>1327</b>	<b>1836</b>	<b>1665</b>	<b>1321</b>	<b>1871</b>	<b>1944</b>	<b>257</b>	<b>113</b>						<b>15610</b>	

KUOTAT DYTESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Tabela Nr. 3

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEEF	Σ
1	Histori	12										12
2	Gjeografi	12										12
3	Histori-Gjeografi				9	14		18				41
4	Gjuhë 1 Letësi	12			14	17	13	16	8			80
5	Edukim Qytetar				9							9
6	Anglisht	14			9	11	9	9	16			68
7	Frëngjisht							6				6
8	Italisht	12			9	9		6	13			49
9	Gjuhë Shllave Ballkanike											0
10	Gjermanisht							6				6
11	Gjuhë Letësi Greke					5						5
12	Cikli i Ullit				10	14	14	16	20			74
13	Cikli i Ullit Parashtetësor				5	9		15	13			42
14	Fizikulturë										12	12
15	Matematikë	14						5				19
16	Fizikë	12						5				17
17	Matematikë-Fizikë					5						5
18	Biologji-Kimi	12			13	14		16				55
19	Kimi	7										7
20	Kimi Teknologjike dhe ushqimore	7										7
21	Kimi Industriale	7										7
22	Matematikë-Informatikë					12						12
23	Informatikë	6						8				14
24	Teknologji Informacioni								9			9
25	Gazetari	8			8							16
26	Punë Sociale	12			11			12				35
27	Filozofi-Sociologji	11			9		9					29
28	Psikologji	13			12			14				39
29	Shtetësi Politike	13										13
30	Drejtesia	36						18	20			74
31	Njëkësi	23										23
32	Stomatologji	7										7
33	Farmacitë	7										7
34	Infërmieri	37			14	10	14	14	23			112
35	Administrim Publik				16							16
36	Administrim-Biznes	42			13		10	12	22			99
37	Ekonomiks				9							18
38	Finanës	42			13	22	16	12				105
39	Infë. Ekonomike	6										6
40	Turizëm					17	9	12	17			55

KUOTAT DYTESORE TE PRANIMEVE TE REJA PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Tabela Nr. 3

Nr.	Marketing	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	7
41	Marketing											7
42	DEGA		12									12
43	Insh. Materiale		6									6
44	Tekstil		6									6
45	Elektrik		10									10
46	Elektronik		14									14
47	Ndërtim		23									23
48	Arkitekturë		11									11
49	Insh. Matematike		4									4
50	Insh. Fizike		4									4
51	Inshinier Gjeodet		5									5
52	Inshinieri Ambienti		6									6
53	Insh. Ne shkencat e tokes		80									80
54	Gjeoinformatike		60									60
55	Inshin. I Gjeoburimeve		10									10
56	Drejtim Fëmash dhe AGB			20			5					25
57	Ekonomi dhe P. Agrar			20								20
58	Insh. Agr. ne Hortikulture dhe MB			10								10
59	Insh. Agr. ne P. Bimor			10								10
60	Insh. Agrar ne Zootek. dhe B.Blek			10								10
61	Akuakulturë dhe M. Peshkimi			13								13
62	Insh. Agromjedis			15								15
63	Tek. Agroushqimore			10								10
64	Vrështari dhe Enologji			6								6
65	Insh. Pjesh			10								10
66	Insh. P. Druri			7								7
67	Veterinari			13								13
	<b>GJITHSEJTI</b>	<b>393</b>	<b>125</b>	<b>144</b>	<b>167</b>	<b>175</b>	<b>106</b>	<b>220</b>	<b>161</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>1503</b>





KUOTAT PER KANDIDATET NGA TROJET PER VITIN AKADEMIK 2005-2006

Tabela Nr. 4

Nr.	DEGA	K o s o v a		M a q e d		M a l i Z i		U P T U B T A A		U S H U E A A		U S H U E A S		Σ												
		UT AA	UB4 USHUE	UP4 UT	UP4 UBTUE AA	UK	UT	UPT	UAS	AA	UT	UUBT	AA		USHUE	AS										
35	Finançë	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	8												
36	Inf. Ekonomike	1		1		1		1		1		1		4												
37	Turizëm		2			1	2					1		6												
38	Mekanikë			2	1		1				1			5												
39	Insh. Materiale			2	1		1				1			5												
40	Tekstil			2	1		1				1			5												
41	Elektronik										1			1												
42	Ndërrim										2			2												
43	Arkiteturë										1			1												
44	Inshim ambianti										1			1												
45	Drejtim Fëmash dhe AGB	1			1	2								4												
46	Ekonomi dhe P. Agrare	1			1									2												
47	Insh. Agr. në Hortikulturë dhe MB	1			1	2					1			5												
48	Insh. Agr. në P. Bimor	1			1						1			3												
49	Insh. Agr. Në Zoocik dhe B. Blektorat.	1			1						1			3												
50	Akuunkulturë dhe M. Peshkimi	1			1						1			2												
51	Insh. Agromjedisi	1			1						1			3												
52	Tek. Agroushpimore	2			2						1			5												
53	Insh. Druri	3			2						1			6												
54	Insh. Pjesh	3			2						1			6												
55	Veterinari	4			4						1			9												
56	Vrëshari dhe Enologji	2			2						1			5												
<b>GJITHSEJTI</b>		<b>37</b>	<b>7</b>	<b>21</b>	<b>28</b>	<b>21</b>	<b>6</b>	<b>25</b>	<b>3</b>	<b>19</b>	<b>15</b>	<b>0</b>	<b>13</b>	<b>21</b>	<b>3</b>	<b>25</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>22</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>0</b>	<b>16</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>301</b>

1. Presheve, Medvegje, Bujanovc

**VENDIM**  
**Nr.28, datë 24.1.2007**

**PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE SHKENCËS**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1248, datë 11.12.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10/2, 10/3, 10/4 e 10/5 të ligjit nr.9576, datë 3.7.2006 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë””, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës të përbëhet nga 19 anëtarë, si më poshtë vijon:

a) Në detyrë funksionale shtetërore:

- |   |         |
|---|---------|
| i) Ministri i Arsimit dhe Shkencës                      | kryetar |
| ii) Kryetari i Akademisë së Shkencave                   | anëtar  |
| iii) Kryetari i Konferencës së Rektorëve                | anëtar  |
| iv) Një përfaqësues i caktuar nga Ministria e Financave | anëtar. |

b) 15 përfaqësues, ekspertë të fushës së arsimit të lartë, shkencës, teknologjisë dhe sektorit

privat:

1. Artan Fuga
2. Anila Godo
3. Aleksandër Xhuvani
4. Gëzim Karapici
5. Evan Roco
6. Lindita Lati
7. Llukan Puka
8. Marenglen Gjonaj
9. Pavli Kongo
10. Petraq Petro
11. Romeo Gurakuqi
12. Spiro Qirko
13. Thoma Korini
14. Ylli Pango
15. Xhezair Zaganjori

2. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës të paguhet, për çdo muaj, përkatësisht me 30 për qind dhe 20 për qind të pagës së sekretarit të përgjithshëm në ministri.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.131, datë 3.10.2007, faqe 3647*

*Vendim i KM nr.1248, datë 11.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 31.12.2009, faqe 8307*

**VENDIM**  
**Nr.467, datë 18.7.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN,  
SHKENCOR E PEDAGOGJIK, TË PERSONELIT AKADEMIK**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.91, datë 10.2.2010)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1.1 Sistemi i kualifikimit shkencor ka si qëllim përgatitjen e shkencëtarëve, të aftë për të konceptuar, organizuar, planifikuar dhe drejtuar studime e hulumtime, kërkimore-shkencore e pedagogjike të nivelit bashkëkohor.

1.2 Sistemi i kualifikimit shkencor përfshin studimet e doktoratës dhe kualifikimin, shkencor e pedagogjik, pas saj.

1.3 Universitetet, që kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik për titullin “Profesor”, janë:

- a) Universiteti i Tiranës;
- b) Universiteti Politeknik i Tiranës;
- c) Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- ç) Akademia e Arteve të Bukura, Tiranë;
- d) Akademia e Kulturës Fizike dhe Sporteve, Tiranë;
- dh) Qendrat kërkimore-shkencore, me status të krahasueshëm me atë të një universiteti.

1.3.1 Institucionet e arsimit të lartë (më tej universitetet), që kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik për titujt “Profesor i Asociuar”, janë institucionet e arsimit të lartë publik.

1.4 Të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik, të punësuar me kohë të plotë, për titullin “Docent” dhe “Profesor emeritus”. Institucionet private të arsimit të lartë, të akredituara, kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik, të punësuar në to, me kohë të plotë, për titullin “Docent”.

1.5 Për organizimin dhe drejtimin e kualifikimit, shkencor e pedagogjik, pas doktoratës, në fakultetet e institucioneve të arsimit të lartë ngrihet këshilli i profesorëve (KP). Në të bëjnë pjesë të gjithë profesorët me kohë të plotë të fakultetit. Numri minimal i anëtarëve të KP-së është shtatë veta, nga të cilët, së paku, pesë janë “Profesorë”. Një ose dy anëtarë të KP-së janë “Prof. Asoc.”, të punësuar me kohë të plotë, në fakultetin në fjalë ose fakultete të tjera të universitetit, që janë në prag të promovimit për titullin “Profesor”. Në rast se numri i profesorëve të fakultetit është më i vogël se pesë, për të arritur këtë numër në KP mund të thirren deri dy profesorë, të ftuar nga fakultetet e tjera, brenda universitetit ose nga universitete e tjera brenda ose jashtë vendit.

Një profesor e drejton KP-në, me rotacion, për një vit akademik. Përbërja dhe funksionimi i KP-së rregullohen në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë.

**KREU II**  
**KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TITUJVE AKADEMIKË**

2.1 Titulli “Docent”

2.1.1 Kriteret për dhënie të titullit “Doc.”

Titulli “Docent” (Doc.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, të cilët përveç kriterëve bazë, të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë (pika 6 e nenit 47), plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:

a) Kanë, së paku, një vit përvojë në mësimdhënie, në institucionet e arsimit të lartë, pas përfundimit të studimeve të doktoratës. Kandidatët, që kanë fituar gradën “Master të nivelit të dytë (MND)”, duhet të kenë, së paku, 5 vjet përvojë në mësimdhënie, në institucionet e arsimit të lartë;

b) Kanë përgatitur materiale mësimore (skripte, leksione, udhëzues praktikash ose ushtrimesh) për, së paku, një lëndë a modul;

c) Kanë realizuar, së paku, tri referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca e kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, një referim ose paraqitje duhet të jetë mbajtur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në “Proceedings”;

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë) që ka realizuar, së paku, tri koncerte recitale--premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), ndër të cilat, së paku, 1 (një) të jetë realizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku vepra të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.

ç) Kanë botuar, së paku, dy artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilët, së paku, njëri duhet të jetë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur, me bord editorial.

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si solist, së paku, në 2 (dy) realizime artistike (koncerte premierë, vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, ndër të cilat, së paku, 1(një) të luajtur nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.

#### 2.1.2 Procedurat për dhënien e titullit “Doc.”

a) Promovimi për titullin “Docent” bëhet nga KP-ja e fakultetit, me kërkesë të kandidatit.

b) KP-ja dëgjon një leksion të hapur të kandidatit/es dhe vlerëson veprimtarinë kërkimore-mësimore të tij/saj. KP-ja merr vendim brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës.

c) Kur vendimi është pozitiv, ajo i dërgon dekanit propozimin për dhënien e titullit “Docent”.

ç) Diploma “Docent” nënshkruhet nga dekanit dhe rektori, dhe vulozet me vulë të thatë, pasi është regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucionin e arsimit të lartë.

d) Kur vendimi i KP-së është negativ, kandidati ka të drejtë të riparaqesë kërkesën për të fituar titullin “Docent”, jo më parë se 2 vjet, pas refuzimit të kërkesës së parë.

#### 2.2 Titullin “Prof.Asoc.”

##### 2.2.1 Kriteret për dhënien e titullit “Prof.Asoc.”

Titulli “Profesor i Asociuar” (Prof.Asoc.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, të cilët kanë fituar gradën shkencore “Doktor” dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Kanë, së paku, tre vjet përvojë në mësimdhënie (së paku, pesë vjet për lektorët e ftuar) dhe gëzojnë aftësi të mirë mësimdhënëse. Titulli “Docent” nuk është parakusht për kërkimin e titullit “Prof.Asoc.”;

b) Kanë realizuar, pas doktoratës, së paku, 8 referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca dhe kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, pesë duhet të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në “Proceedings”;

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka realizuar së paku 4 (katër) koncerte recitale-premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), ndër të cilat, së paku, 1(një) të realizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.

c) Kanë botuar, pas doktoratës, së paku, 5 artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilat, së paku, në 2 prej tyre si autor i parë, si dhe, së paku, 2 prej tyre të jenë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur, me bord editorial. Së paku, një artikull, duhet të jetë botuar në një revistë shkencore të huaj, me faktor impakti;

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si i parë, së paku, në 4 (katër) realizime artistike (solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara, ndër të cilat, së paku, 1(një) të luajtur nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional.

Një monografi shkencore, e botuar si autor i parë, në gjuhë të huaj, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri 6 artikuj shkencorë. Një monografi shkencore, e botuar si autor i parë, në gjuhën shqipe që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri 4 artikuj shkencorë, të botuar brenda vendit.

Për personelin akademik të Akademisë së Arteve një koncert recital, i luajtur jashtë Republikës së Shqipërisë në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri 3 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjtat kushte. Një koncert recital-premierë brenda Republikës së Shqipërisë në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri në 2 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjtat kushte;

ç) Kanë qenë titullarë, së paku, të një lënde a moduli për më shumë se dy vite akademike dhe kanë përgatitur materiale mësimore, në formë skriptesh, cikël leksionesh, udhëzues praktikash ose ushtrimesh.

#### 2.2.2 Procedurat për dhënien e titullit “Prof.Asoc.”

Promovimi për titullin “Prof. Asoc.” bëhet nga KP-të e fakulteteve të institucioneve të arsimit të lartë publik (më tej universitetet), me kërkesë të vetë kandidatit/es. Kandidatët, që punojnë me kohë të plotë, pranë institucioneve të arsimit të lartë, dorëzojnë dosjen te dekani i fakultetit të tyre. Dekani ia kalon dosjen KP-së së fakultetit, i cili brenda një muaji jep mendim për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatit/es. Në rastet kur një fakultet nuk ka arritur të krijojë KP-në, dekani i kërkon rektorit të universitetit ta përcjellë dosjen në një nga IAL-të e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës për titullin “Prof.Asoc.” bëhet sipas kësaj procedure:

a) Brenda një muaji, KP-ja vlerëson nëse dosja është e plotë dhe ngre komisionin vlerësues (KV), i cili përbëhet nga 7 anëtarë, që kanë titullin “Profesor”. Së paku, katër anëtarë të KV-së duhet të jenë nga jashtë universitetit dhe, së paku, dy anëtarë duhet të jenë profesorë të shkencave teorike bazë. Në përbërje të KV-së mund të jetë edhe një profesor i fushës ose i një fushe të afërt,

nga universitetet e huaja. Në këtë rast kandidatit/es i kërkohet që dosjen dhe referatin e hapur, t'i paraqesë edhe në një gjuhë të huaj, që ai/ajo zotëron dhe që është e përshtatshme për anëtarët e KV-së;

b) Brenda tre muajve, komisioni i vlerësimit vlerëson aftësitë pedagogjike-didaktike të kandidatit/es. KV-ja merr pjesë, së paku në 3 seanca mësimore dhe e fton kandidatin/en në një referat të hapur shkencor;

c) Komisioni vlerësues harton një raport përfundimtar vlerësues për veprimtarinë botuese dhe aftësitë pedagogjike të kandidatit/es, të cilin ia paraqet KP-së, së bashku me rekomandimin për dhënien ose jo të titullit;

ç) KP-ja zyrtarizon rekomandimin e KV-së. Në rast se kërkesa e kandidatit/es nuk miratohet, ai/ajo ka të drejtë të riparaqesë kërkesën jo më parë se dy vjet, pas refuzimit të kërkesës së parë;

d) Dekani i fakultetit organizon një leksion të hapur përrues, ku i dorëzohet kandidatit/es diploma "Prof.Asoc."

Diploma "Prof. Asoc." nënshkruhet nga dekani e rektori, vuloset me vulë të thatë, pasi është regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të universitetit.

### 2.3 Titulli "Prof."

#### 2.31 Kriteret për dhënien e titullit "Prof."

Titulli "Profesor" (Prof.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, që kanë fituar gradën shkencore "Doktor" dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Kanë së paku, pesë vjet përvojë në mësimdhënie (së paku shtatë vjet për lektorët me kohë të pjesshme), pas marrjes së gradës shkencore "Doktor". Titujt "Docent" dhe "Prof.Asoc." nuk janë parakusht për kërkimin e titullit "Profesor";

b) Gëzojnë aftësi të mira mësimdhënëse dhe kanë marrë pjesë aktive në zhvillimin, akademik dhe institucional, të institucioneve të arsimit të lartë;

c) Kanë pasur një përvojë kërkimore ose mësimdhënëse prej, së paku, një viti, në një institucion kërkimor-mësimor, jashtë vendit. Përvoja të tilla vlerësohen, kur qëndrimet në institucionet homologe jashtë shtetit kanë qenë pa ndërprerje ose edhe me ndërprerje.

Në rastin e personelit akademik të Akademisë së Arteve mund të llogariten edhe drejtimi i *masterclass*-ave apo *workshop*-eve ndërkombëtare;

ç) Janë në gjendje të mbajnë, në nivel të kënaqshëm, leksione të veçanta ose cikle leksionesh, në njërin nga këto gjuhë të huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht dhe rusisht;

d) Kanë realizuar si autorë të parë, pas marrjes së gradës "Doktor", së paku, 15 referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca dhe kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, 8 duhet të jenë mbajtur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) ku punimet janë pranuar, në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në "Proceedings".

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka realizuar pas marrjes së titullit "Prof.Asoc.", së paku, 6 (gjashtë) koncerte recitale-premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone), ndër të cilat, së paku, 2 (dy) të realizuara jashtë Republikës së Shqipërisë në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku performanca (vepra) të jetë pranuar, në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse, në shtypin profesional.

dh) Kanë botuar, pas marrjes së gradës "Doktor", së paku, 9 artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilët 4 si autorë të parë, si dhe, së paku, 4 prej tyre duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur me bord editorial. Së paku, dy artikuj duhet të jenë botuar në një revistë shkencore të huaj, me faktor impakti.

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i brendshëm, i ftuar dhe me kontratë i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë,

dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si i parë, së paku, në 7 (shtatë) realizime artistike (solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura) në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara, ndër të cilat, së paku, 3 (tri) të luajtura nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse, në shtypin profesional.

Një monografi shkencore e botuar, si autor i parë, në gjuhë të huaj, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri gjashtë artikuj shkencorë. Një monografi shkencore, e botuar, si autor i parë, në gjuhën shqipe, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri katër artikuj shkencorë, të botuar brenda vendit.

Për personelin akademik të Akademisë së Arteve një koncert-recital, i luajtur jashtë Republikës së Shqipërisë, në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri 3 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjta kushte. Një koncert recital-premierë, brenda Republikës së Shqipërisë, në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri 2 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjtat kushte.

e) Kanë qenë titullar, së paku, të një lënde a moduli për më shumë se katër vite akademike dhe kanë përgatitur materiale mësimore, në formë skriptesh, leksionesh, udhëzues praktikash ose ushtrimesh për programin mësimor të dy ose më shumë lëndëve a moduleve, njëra prej të cilave në ciklin e dytë të studimeve “Master”.

#### 2.3.2 Procedura për dhënien e titullit “Prof.”

a) Promovimi për titullin “Prof.” bëhet nga KP-ja e fakulteteve të shkollave të larta, të përmendura në pikën 1.3 të këtij vendimi, me kërkesë të kandidatit/es. Kandidatët, që punojnë me kohë të plotë, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të cilët nuk përfshihen në pikën 1.3, dorëzojnë dosjen në KP-në e fakultetit të tyre. Brenda një muaji, KP-ja jep mendim për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatit/es dhe ia përcjell dosjen shkollës së lartë dhe fakultetit të fushës, që gëzon të drejtën e promovimit për titullin “Prof.”, siç përcaktohet në pikën 1.3.

b) Brenda një muaji, KP-ja verifikon nëse dosja është e plotë dhe ia përcjell atë senatit të shkollës së lartë, së bashku me propozimin për përbërjen e komisionit vlerësues (KV). Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët duhet të kenë titullin “Prof.”. Së paku, pesë anëtarë të KV-së duhet të jenë jashtë universitetit, nga vjen kandidati/ja dhe, së paku, dy anëtarë të KV-së duhet të jenë profesor të shkencave teorike bazë. Në përbërje të KV-së mund të jetë edhe një profesor i fushës ose i një fushe të afërt, nga universitetet e huaja. Në këtë rast kandidatit/es i kërkohet, që dosjen dhe referatin e hapur ta paraqesë edhe në një gjuhë të huaj, që ai zotëron dhe që është e përshtatshme për anëtarët e KV-së;

c) Brenda një muaji, senati e shqyrton kërkesën dhe merr vendim për t’i propozuar Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë komisionin vlerësues. Titullari i institucionit i dërgon kryetarit të KVTA-së, vendimin e senatit.

ç) Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë shqyrton, brenda dy muajve, kërkesën e senatit, miraton komisionin vlerësues dhe merr vendim për fillimin e vlerësimit pedagogjik të kandidatit. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë gëzon të drejtën, kur e gjykon të nevojshme, të kërkojë vlerësime, me shkrim, nga profesorë të huaj ose marrjen pjesë në komisionin e vlerësimit të një ose dy profesorëve të huaj.

Vendimi i KVTA-së për përbërjen e komisionit vlerësues dhe fillimin e vlerësimit pedagogjik të kandidatit i dërgohet për zbatim titullarit të institucionit.

d) Brenda tri muajve komisioni i vlerësimit vlerëson aftësitë pedagogjike-didaktike të kandidatit/es. Komisioni i vlerësimit merr pjesë, së paku, në 3 seanca mësimore dhe e fton kandidatin/en në një referat të hapur shkencor. Një pjesë të referatit kandidati/ja e paraqet në një gjuhë të huaj, që zotëron;

dh) Komisioni vlerësues harton një raport përfundimtar vlerësues për veprimtarinë botuese dhe aftësitë pedagogjike të kandidatit/es, së bashku me rekomandimin për dhënien ose jo të titullit.

Raporti i dërgohet titullarit të institucionit, i cili ia përcjell atë, së bashku me dosjen përkatëse, kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë.

e) Brenda dy muajve, Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë shqyrton raportin e komisionit vlerësues dhe merr vendim për dhënie ose jo të titullit “Prof.”. Kur vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë është negativ, kandidati i jepen argumentet përkatëse. Kandidati ka të drejtë të rifillojë procedurën jo më parë se dy vjet nga data e refuzimit të kërkesës së parë;

ë) Diploma e titullit “Prof.” nënshkruhet nga Ministri dhe regjistrohet në regjistrin e Komisionit të Vlerësimit të titujve Akademikë;

f) Rektori i universitetit i dorëzon kandidatin/es fitues diplomën e titullit “Prof.” në një ceremoni, leksion përurues të profesurës.

2.4 Titujt “Akademik i Asociuar” dhe “Akademik” janë tituj, që fiton çdo profesor, i cili është pranuar anëtar i Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Në rastin kur ai/ajo është profesor në institucionin e arsimit të lartë, gëzon të gjitha atributet, që i takojnë titullit “Akademik i Asociuar” dhe “Akademik”.

2.5 Titulli “Profesor emeritus” (Prof.emeritus) është titull, që u jepet profesorëve më të suksesshëm, kur arrijnë moshën e pensionit, sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Profesorëve emeritus u jepet mjedis pune në departament, si dhe mund të thirren për leksione të veçanta ose të përfshihen në grupe pune apo komisione. Atyre u jepet një shpërbllim mbi pension, masa e të cilit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2.6 Titulli “Doctor honoris causa” u jepet figurave të shquara të shkencës dhe shoqërisë, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe të shkencës, si dhe në zhvillimin, në tërësi të vendit tonë. Ky titull jepet nga institucionet e arsimit të lartë, pasi të jetë marrë pëlqimi i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë.

2.7. Të gjitha shpenzimet, që lidhen me promovimin për titujt akademikë, përballohen nga të ardhurat e institucionit të arsimit të lartë, ku zhvillohet procedura.

### KREU III DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

3.1 Shfuqizuar.

3.2 Shfuqizuar.

3.3 Shfuqizuar.

3.4 Afatet e përcaktuara për procedurat e dhënies së gradave dhe të titujve akademikë, brenda institucioneve të arsimit të lartë, u referohen vitit akademik.

3.5 Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë vlerëson dhe njehson titujt akademikë, të fituar jashtë shtetit, të barasvlefshëm me titullin akademik “Prof.”. Në këto raste, për titullin nuk lëshohet diplomë e re, por mjafton një regjistrim pranë këtij komisioni.

3.6 Titujt akademikë, të fituar jashtë shtetit, të barasvlefshëm me titullin akademik “Prof.Asoc.”, vlerësohen dhe njehsohen nga universitetet, në përputhje me pikën 1.3 të këtij vendimi. Në këto raste për titullin nuk lëshohet diplomë e re, por mjafton një regjistrim pranë institucioneve të arsimit të lartë.

3.7 Vendimi nr.786, datë 17.12.1998 i Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore, të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.109, datë 15.8.2007, faqe 3150*

*Vendim i KM nr.91, datë 10.2.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, datë 19.3.2010, faqe 736*



**VENDIM**  
**Nr.824, datë 5.12.2007**

**PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETE NË UNIVERSITETIN  
POLITEKNIK TË TIRANËS**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.345, datë 8.4.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në Universitetin Politeknik të Tiranës:
    - a) Krijohet Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili të ketë në përbërje:
      - Qendrën e Kërkimit dhe Zhvillimit në Teknologjitë e Informacionit, (INIMA);
      - Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit, që krijohet nga ndarja e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike, ish-pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike;
      - Departamentin e Inxhinierisë Informatike, që krijohet nga ndarja e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike, ish-pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike;
      - Seksionin e Informatikës, ish-pjesë e Departamentit të Matematikës dhe Informatikës, në varësi të rektoratit.
    - b) Krijohet Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, që ka në përbërje:
      - i) Departamentin e Inxhinierisë Matematike;
      - ii) Departamentin e Inxhinierisë Fizike;
      - iii) Departamentin e Kimisë;
      - iv) Qendrën e Gjuhëve të Huaja.
    - c) Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike riorganizohet dhe ka këto departamente:
      - Departamentin e Sistemeve Elektrike të Fuqisë;
      - Departamentin e Elektroteknikës;
      - Departamentin e Automatikës.
  2. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike do të ofrojnë të njëjtat programe studimi, në të tri ciklet, që ofronte Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, të ndara sipas disiplinave përkatëse, struktura e të cilave përcaktohet nga vetë institucioni. Programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë do të riorganizohen sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për vitin akademik 2008-2009 do të ofrohen, pasi të miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
  3. Shfuqizuar.
  4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.168, datë 17.12.2007, faqe 5068*  
*Vendim të KM nr.345, datë 8.4.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.51, datë 29.4.2009, faqe 2475*

**VENDIM**  
**Nr.864, datë 5.12.2007**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PËRCAKTIMIN E  
KUSHTEVE, QË DUHET TË PLOTËSOJË STUDENTI PËR MARRJEN E DIPLOMËS PËR  
GRADËN SHKENCORE “DOKTOR”**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.877, datë 18.6.2008;  
ndryshuar me vendim të KM nr.103, datë 17.2.2010)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Institucioni publik i arsimit të lartë, që aplikon për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, duhet të jetë universitet, akademi apo edhe një shkollë e lartë universitare, e cila provon se plotësohen standardet akademike dhe ato të infrastrukturës, për të hapur ciklin e tretë të studimeve dhe për të organizuar studime të doktoratës.

2. Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat plotësojnë kushtin e përcaktuar në pikën 1, duhet të paraqesin kërkesën pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, e cila shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) fushën shkencore dhe emërtimin e programit të studimit të doktoratës, i cili duhet t'i referohet një sektori, disiplinor apo ndërdisiplinor, me relacionin shpjegues përkatës;

b) programin e studimit, të miratuar nga senati akademik i institucionit, i cili duhet të paraqitet sipas rregullave të parashikuara në statut dhe të përmbajë edhe organizimin, didaktik dhe shkencor, të programit, planin mësimor për fazën e thellimit teorik, si dhe parashikime për periudha të qëndrimit në institucione të huaja kërkimore;

c) afatet kohore të realizimit të programit të studimit;

ç) tarifën e studimit për çdo student, e argumentuar, si dhe burime të tjera financimi, për studimet e doktoratës, nëse ka të tilla;

d) parashikimin për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoratës, jo më i vogël se tre;

dh) personelin akademik, që do të mbulojë realizimin e disiplinave teorike të studimeve të doktoratës, si dhe udhëheqjen e disertantëve, sipas titullit apo gradës shkencore, dhe numrit përkatës të studentëve, për çdo udhëheqës. Nëse në ekipet mësimore mund të përfshihet dhe personel akademik i ftuar, ai duhet të jetë i miratuar nga këshilli i profesorëve të fakultetit;

e) rregulloren për studimet e doktoratës;

ë) të dhënat për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit, njësinë bazë, që drejton administrativisht programin e doktoratës, kur kjo është ndërdisiplinore etj.;

f) dokumentin për përvojat e mëparshme të strukturave në formime pasuniversitare, nëse ka pasur;

g) bashkëpunimet shkencore për realizimin e të gjithë programit të studimit, apo pjesë të tij me institucione të tjera kërkimore, ose ente publike apo private;

gj) njësinë apo njësitë bazë propozuese të programit të studimit të doktoratës, që garantojnë ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme, ndërtimore e laboratorike, për zhvillimin e programit;

h) modelin e diplomës.

3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës mund të paraqesë në Këshillin e Ministrave propozimin për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, vetëm pasi ka marrë nga Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë vlerësimin pozitiv për programin e studimit që jepet brenda dy muajve nga data e paraqitjes së dokumenteve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Propozimi në Këshillin e Ministrave duhet të jetë i shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi vlerësimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, si dhe relacionin përkatës të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për këtë propozim.

4. Udhëheqësi shkencor i studentit, në një program studimi të doktoratës, duhet të ketë, së paku, gradën shkencore “Doktor”, të fituar në universitete perëndimore. Numri i studentëve të udhëhequr njëkohësisht nga një udhëheqës përcaktohet në rregulloret e institucionit, sipas propozimit të këshillave të profesorëve të njëjësive kryesore përkatëse.

5. Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, përpara paraqitjes në provimin e doktoratës, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) të ketë realizuar, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat një referim ose paraqitje duhet të jetë mbajtur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) i pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në “Proceedings), të indeksuar me kod ISBN-je;

b) të ketë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku, njëri prej artikujve duhet të jetë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore ndërkombëtare, me bord editorial;

c) Të ketë paraqitur në këshillin e profesorëve të njësisë kryesore dosjen e plotë, që përmban edhe disertacionin e përfunduar, me një përmbledhje, të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Pas shqyrtimit të dosjes, këshilli i profesorëve i përcjell autoritetit drejtues të njësisë kryesore vendimin për vazhdimin ose jo të procedurës së mbrojtjes së doktoratës. Kur këshilli vendos pozitivisht, ai i propozon autoritetit drejtues të njësisë kryesore edhe jurinë për mbrojtjen e doktoratës.

5/1. Promovimi i përshpejtuar i shkencëtarëve të rinj të talentuar të bëhet si më poshtë vijon:

a) Kandidatët, që kanë diplomë universitare të nivelit të dytë (DND) ose diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë (DIND) dhe kanë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë, në revista të huaja, me faktor impakti mbi 1.0, kanë të drejtë t'i paraqesin dekanit të fakultetit dhe, për dijeni, rektorit të institucionit të arsimit të lartë, që ofron studime të doktoratës, një kërkesë për mbrojtjen e doktoratës, mbi bazën e artikujve shkencorë të botuar (disertacion kumulativ). Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar nga dy referenca/rekomandime nga profesorë, të vendit ose të huaj, që vlerësojnë se vëllimi dhe cilësia e punimeve shkencore të përfunduara me botimet e sipërpërmendura, plotësojnë kushtet për kërkimin e gradës shkencore “Doktor” dhe i propozojnë këshillit të profesorëve e dekanit ngritjen e jurisë për provimin e doktoratës.

b) Dekani i fakultetit ia kalon kërkesën menjëherë këshillit të profesorëve, për shqyrtim, i cili shprehet, brenda një muaji nga marrja e kërkesës, për ngritjen e jurisë për provimin e doktoratës. Dekani nxjerr urdhër për ngritjen e saj.

c) Juria, brenda një muaji, vlerëson provimin e doktoratës së kandidatit, sipas vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar.

ç) Kandidatët, që nuk janë në marrëdhënie pune në një institucion të arsimit të lartë, i dërgojnë kërkesë dekanit të fakultetit të institucionit të arsimit të lartë, që zhvillon studime të doktoratës në fushën ku është kryer kërkimi shkencor dhe është përgatitur teza e disertacionit në formë kumulative.

d) Në rastet kur dekanit dhe këshilli i profesorëve, të fakultetit, shprehen negativisht për kërkesën e kandidatit/es, ai/ajo ka të drejtë të ankohet te rektori i institucionit të arsimit të lartë dhe te Ministri i Arsimit dhe Shkencës, si dhe të kërkojë një rivlerësim të kërkesës.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programet e studimit të doktoratës, i organizojnë ato brenda standardeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe sipas rregullores së institucionit përkatës.

7. Studentët, që janë regjistruar në studimet e doktoratës:

a) përpara datës 31 dhjetor 2005, kanë plotësuar kërkesat e vendimit nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për klasifikimin

e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar, dhe dorëzojnë në dekanat dosjen e plotë, me disertacionin e përfunduar, deri më 31 dhjetor 2008, kryejnë mbrojtjen e doktoratës, sipas procedurave të parashikuara në shkronjën “c” të pikës 5 të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave.

b) nga data 1 janar 2006 deri më 31 dhjetor 2007 dhe studentët e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 7, por që nuk arrijnë të dorëzojnë dosjen brenda afatit të përcaktuar më sipër, do t’i vazhdojnë studimet në ciklin e rregullt, sipas vendimit nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar, por do të plotësojnë kriteret e pikës 5 të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave, për mbrojtjen e doktoratës.

c) pas datës 1 janar 2008 e në vazhdim, i përfundojnë ato në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave.

8. Të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të doktoratës, sipas ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, duhet të riorganizojnë strukturimin e këtyre programeve, sipas kërkesave dhe standardeve të parashikuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim, dhe duhet të paraqesin, për rivlerësim dhe miratim, sipas këtij vendimi, këto programe studimesh, e nëse nuk arrijnë miratimin ato nuk do të marrin kuota të reja studimi.

Institucionet publike të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve në pikën 9 të këtij vendimi nuk mund të pranojnë studentë të rinj në studimet e doktoratës, deri në miratimin e tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim dhe në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe të studimeve të doktoratës, si dhe ato institucione, të cilat do të ofrojnë programe të studimeve të doktoratës për zbatimin e këtij vendimi. Institucionet publike të arsimit të lartë duhet të parashikojnë në statutet e tyre organizimin e studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

10. Të gjitha aktet nënligjore të mëparshme, të cilat bien ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.175, datë 16.12.2007, faqe 5424*

*Vendim i KM nr.877, datë 18.6.2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr.109, datë 18.7.2008, faqe 4831*

*Vendim i KM nr.103, datë 17.2.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, datë 19.3.2010, faqe 760*

**VENDIM**  
**Nr.259, datë 27.2.2008**

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË**  
**“SHKOLLA E LARTË AMERIKANE E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës” do të organizohet në tri fakultete:

a) Fakulteti Mjekësor, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

- i) stomatologji (5 vite akademike);
- ii) infermieri (3 vite akademike);
- iii) teknik laborator (3 vite akademike);
- iv) fizioterapi (3 vite akademike);
- v) teknik farmacist (3 vite akademike);
- vi) teknik imazherie (3 vite akademike).

b) Fakulteti i Drejtësisë, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

- i) drejtësi (3 vite akademike);
- ii) jurist/specialist ndërmarrjeje (3 vite akademike).

c) Fakulteti i Ekonomisë, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

- i) administrim biznesi (3 vite akademike);
- ii) financë-bankë (3 vite akademike).

3. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, në Fakultetin Mjekësor do të ofrojë një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili do të zgjasë 5 vite, dhe në mbarim të tij do të lëshojë diplomë të integruar, të nivelit të dytë (DIND), në fushën e arsimimit të kryer, ndërsa programet e tjera të këtij fakulteti dhe të fakulteteve të tjera do të jenë programe studimi të ciklit të parë të cilat do të zgjasin 3 vite, dhe në mbarim të tyre do të lëshohet diplomë të nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

4. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë Amerikane e Tiranës”, duhet t’ i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 19.3.2008, faqe 1827*

**VENDIM**  
**Nr.281, datë 12.3.2008**

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “SHKOLLA E LARTË “EPOKA””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë “Epoka””, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Ky institucion privat i arsimit të lartë do të organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

i) Arkitekturë (4 vite akademike);

ii) Inxhinieri ndërtimi (4 vite akademike);

iii) Inxhinieri kompjuterike (4 vite akademike).

b) Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë:

i) Ekonomik (4 vite akademike);

ii) Financë/bankë (4 vite akademike);

iii) Administrim-biznes (4 vite akademike);

iv) Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare (4 vite akademike).

3. Institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e lartë “Epoka””, do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 4 vite, dhe në mbarim të tyre do të lëshohet diploma “Bachlor”.

4. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e lartë “Epoka””, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplineve kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e Lartë “Epoka””, do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë, “Shkolla e lartë “Epoka””, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.46, datë 9.4.2008, faqe 2096*

**VENDIM**  
**Nr.466, datë 16.4.2008**

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË “ISSAT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “ISSAT”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Ky institucion privat i arsimit të lartë do të organizohet në dy fakultete:
  - a) Fakulteti Financë-Bankë, me programet e studimit:
    - i) Strategji ndërmarrjesh dhe politikë ekonomike;
    - ii) Bankë dhe menaxhim bankar;
    - iii) Kontabilitet dhe financë.
  - b) Fakulteti Administrim-Biznes, me programet e studimit:
    - i) Biznes ndërkombëtar;
    - ii) Menaxhim turizmi;
    - iii) Menaxhim i sistemeve të informacionit.
3. Institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT” do të ofrojë programe studimi, të ciklit të dytë, të cilat do të zgjasin 2 vjet, në plotësimin e të paktën 60 kredite, dhe, në mbarim të tyre, do të lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP).
4. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.
5. Institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.  
Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.
6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
7. Institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63, datë 14.5.2008, faqe 2776*

**VENDIM**  
**Nr.503, datë 16.4.2008**

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PRANIMEVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (APRIAL), si institucion qendror me statusin e personit juridik, publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. APRIAL-i ka si objekt të veprimtarisë shërbimet ndaj institucioneve të arsimit të lartë publik. Kjo agjenci, gjithashtu, në bazë të akteve dhe marrëveshjeve të veçanta dhe kundrejt pagesës së tarifave, që do të miratohen për këtë qëllim, mund t’u ofrojë shërbime edhe institucioneve të arsimit të lartë privat. Këto shërbime do të klasifikohen në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave detyësore në institucionet buxhetore.

3. Qëllimi i veprimtarisë së APRIAL-it është krijimi i një sistemi kombëtar, unik dhe transparent, për përcaktimin e fituesve ndërmjet maturantëve kandidatë për studime në programet e studimit, që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë.

4. APRIAL-i, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Realizon përcaktimin e fituesve ndërmjet maturantëve kandidatë për studime në institucionet e arsimit të lartë, sipas parimit meritë-preferencë, të shprehur si më poshtë vijon:

i) Parimi i meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara, në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore dhe, për programe studimi të caktuara, edhe në bazë të plotësimit të kriterëve të veçanta, të vendosura nga institucionet e arsimit të lartë e të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

ii) Parimi i preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë, të zgjedhur prej tyre.

b) Përgatit bazën elektronike të të dhënave për maturantët kandidatë me të gjitha elementet e nevojshme të gjenealitetëve, rezultateve në provimet e Maturës Shtetërore, mesataren e shkollës së mesme, e të tjera.

c) Ruan dhe administron, në formë elektronike, të gjitha të dhënat e procesit, nga fillimi dhe deri në regjistrimin përfundimtar të studentëve. Këto të dhëna ruhen në arkivin e APRIAL-it për nevoja studimore.

ç) Shqyrton ankimimet për procesin e pranimeve në institucionet e arsimit të lartë dhe u përgjigjet të interesuarve brenda një afati të caktuar.

d) Analizon dhe përgatit të gjitha të dhënat e procesit, duke bërë edhe krahasime me vitet e mëparshme.

dh) Studion dhe propozon përmirësimin e sistemit të pranimeve në arsimin e lartë publik.

e) Realizon studime për pranimet në institucionet e arsimit të lartë, me porosi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, institucioneve të arsimit të lartë ose subjekteve të interesuara.

5. Struktura dhe organika e APRIAL-it miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6. Funksionimi i APRIAL-it bëhet në përputhje me rregulloren, e cila miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Drejtuesi i APRIAL-it emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 256



7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimn ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose ministrit”.

8. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të APRIAL-it rregullohen në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

9. Struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit” caktohen në bazë të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar.

10. Numri i punonjësve të APRIAL-it, prej 6 vetash, është brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

11. APRIAL-i është institucion buxhetor, që financohet nga Buxheti i Shtetit. Buxheti i APRIAL-it çelet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

12. Efektet financiare për vitin 2008, prej 12 088 000 (dymbëdhjetë milionë e tetëdhjetë e tetë mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për këtë vit, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.69, datë 21.5.2008, faqe 3029*

**VENDIM**  
**Nr.633, datë 23.5.2008**

**PËR FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT  
TË TITUJVE AKADEMIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 67 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) funksionon si organ kolegjal, vendimmarrës, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Ky komision, në ushtrim të funksioneve dhe të përgjegjësive, të përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kryen dhe ka këto detyra e të drejta:

a) Vlerëson dhe merr vendim për propozimet e institucioneve të arsimit të lartë, për dhënien e titullit akademik “Profesor”. Propozimet dhe vendimet për dhënien e titullit regjistrohen nga sekretariati i KVTA-së, në regjistrin e krijuar për këtë qëllim.

Formati i regjistrimit të të dhënave përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

b) Kryen njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave ose titujve shkencorë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, sipas procedurave, të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Kërkesat dhe vendimet për njohjen e titullit regjistrohen nga sekretariati i KVTA-së, në regjistrin e krijuar për këtë qëllim. Format i regjistrimit të të dhënave përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

c) U bën rekomandime institucioneve të arsimit të lartë për organizimin e studimeve të doktoratës dhe promovimin për titujt akademikë.

ç) Vlerëson, me kërkesë të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, zbatimin e kritereve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor nga institucionet e arsimit të lartë dhe, kur vëren shkelje të kuadrit ligjor dhe nënligjor, propozon masat përkatëse.

d) Gëzon të drejtën të dërgojë përfaqësuesit e vet, për të mbikëqyrur procedurat për mbrojtjen e doktoratave, si dhe për shqyrtimin e titujve akademikë, të cilat zhvillohen nga institucionet e arsimit të lartë në mbledhjet (seancat) e hapura.

KVTA-së mund t'i ngarkohen edhe detyra të tjera për kualifikimin shkencor, në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. KVTA-ja merr vendim me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Komisioni mblidhet me njoftim të kryetarit, sipas rendit të ditës, të përcaktuar prej tij.

5. Mbledhjet zhvillohen sipas rregullores, të miratuar nga vetë KVTA-ja.

6. Përbërja e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë përcaktohet në përputhje me vendimin nr.599, datë 31.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e komisionit të kualifikimit shkencor".

7. Paguesa e kryetarit dhe e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, për çdo muaj, nëse zhvillohen mbledhje, të jetë, përkatësisht, 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj kryetari, dhe nga 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj anëtarët. Kryetari dhe anëtarët e këtij komisioni nuk e përfitojnë këtë shpërblim për muajt që nuk mblidhen.

8. Efektet financiare, prej 2 364 000 (dy milionë e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.70, datë 23.5.2008, faqe 3100*

**VENDIM**  
**Nr.828, datë 4.6.2008**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE SHKENCËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 65 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores "Për ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.108, datë 18.7.2008, faqe 4786*

**RREGULLORE**  
**PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË**  
**DHE SHKENCËS**

Neni 1

**Objekti dhe qëllimi i rregullores**

1. Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës rregullon veprimtarinë e tij mbështetur në këtë rregullore e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe që përcakton kompetencat, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, që më pas në tekst do të quhet Këshilli, si dhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të tij.

2. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH-i) mund të përgatisë edhe rregullore të funksionimit të tij të brendshëm apo për koordinimin e veprimtarive të përcaktuara në këtë rregullore, por brenda kompetencave dhe fushave të veprimtarisë së tij.

3. Veprimtaria e Këshillit ushtrohet në përputhje me këtë rregullore, e cila ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik për veprimtarinë e tij.

Neni 2

**Funksioni i Kryetarit të Këshillit**

1. Kryetari i Këshillit thërret mbledhjet dhe i drejton ato, cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, koordinon punën, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta. Ai merr në konsideratë vendimet e marra përgjatë mbledhjeve të Këshillit, si dhe të orientimeve programore, kur ato janë marrë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, pavarësisht vlerësimit të tij individual.

2. Kryetari cakton ndërmjet anëtarëve të zgjedhur të Këshillit një zëvendës, me funksion zëvendësimit të kryetarit në rast mungese të tij ose në rast delegimi të drejtimit të Këshillit.

Neni 3

**Funksioni dhe detyrat e Këshillit**

1. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit në arsimin e lartë, kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik në vend.

2. Këshilli formulon mendime dhe propozime lidhur me:

a) hartimin e strategjive e programeve kombëtare për arsimin e lartë e kërkimin shkencor, drejtimet e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore;

b) fushat parësore dhe programet e kërkimit shkencor e zhvillimit teknologjik;

c) projektbuxhetin e parashikuar për arsimin e lartë dhe shkencën dhe metodologjinë e shpërndarjes së tij;

ç) standardet për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ose programeve të studimeve;

d) kriteret për dhënien e titujve dhe gradës shkencore, së bashku me Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë;

dh) zhvillimin e politikave të veçanta, të kërkuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe rrugët e financimit të tyre;

e) çdo problem tjetër që kërkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Neni 4

**Përbërja dhe zgjedhja e anëtarëve të Këshillit dhe sekretariati teknik**

1. Përbërja e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës është sipas përcaktimeve në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007. Ai ka në përbërje 19 anëtarë, ndër të cilët 15 anëtarë janë ekspertë të

fushave të ndryshme të shkencës, të zgjedhur me konkurrim publik, si dhe disa anëtarë të tjerë, ekspertë për shkak të funksioneve.

2. Anëtarët ekspertë në Këshill zgjidhen për një mandat 7-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Ndërkohë në Këshill 15 anëtarët ekspertë të zgjedhur me konkurrim publik i nënshtrohen një mandati me rotacion, ku pesë anëtarë të tij do të kenë mandat 3-vjeçar dhe pesë anëtarë të tjerë do të kenë një mandat 5-vjeçar. Përcaktimi i tyre do të bëhet me short, i cili do të hidhet respektivisht në përfundim të periudhës 3-vjeçare dhe asaj 5-vjeçare.

3. Në vijim mandati i anëtarëve të këtij Këshilli do të jetë 7-vjeçar.

4. Këshilli mbështetet me sekretariat teknik, i cili koordinon veprimtarinë e Këshillit me atë të Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Drejtorinë e Kërkimit Shkencor në MASH, vë në dispozicion të Këshillit materiale dhe dokumente lidhur me çështje brenda kompetencave të drejtorisë, të cilat do trajtohen në Këshill, kërkon gjithashtu ndimën e Këshillit edhe për çështje të brendshme të drejtorisë, të cilat përputhen me detyrat dhe misionin e Këshillit. Sekretariati përpunon informacionet e propozuara në mbledhjen e Këshillit në formën e kërkuar për ekzekutim dhe ia paraqet ato ministrit. Në sekretariatit e Këshillit marrin pjesë Zëvendësministri për Arsimin e Lartë në MASH, i cili njëkohësisht koordinon edhe të gjithë punën e këtij sekretariati, Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë, Drejtori i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor, Drejtori i Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë, si dhe një jurist.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës mund të përcaktojë edhe përbërje ndryshe të sekretariatit teknik. Sekretariati ka gjithashtu brenda tij edhe një ose dy sekretarë, të cilët mbajnë procesverbalet e zhvillimit të mbledhjeve, fotokopjojnë materialet që do të shpërndahen për mbledhje, mbajnë korespondenca lidhur me njoftime të ndryshme të anëtarëve të Këshillit, si dhe shërbime të tjera.

5. Përbërja nominative e sekretariatit teknik, detyra të tjera dhe pagesa e tyre caktohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

#### Neni 5

### **Komisionet, komitetet dhe grupet e punës së këshillit**

1. Këshilli, me qëllim realizimin e misionit dhe detyrave të tij, ndahet në komisione të përhershme dhe në komitete të fushave disiplinore. Ai mund të ngrëjë gjithashtu grupe të përkohshme pune për studimin e çështjeve a problematikave të veçanta.

2. Anëtarët e komisioneve të përhershme, e komiteteve të fushave disiplinore dhe grupeve të përkohshme të punës zgjedhin ndërmjet tyre koordinatorët/kryetarët të cilët drejtojnë mbledhjet dhe organizojnë punën në grupet përkatëse.

3. Kryetari i Këshillit mund të thërrasë një ose më shumë komisione, komitete ose grupe të përkohshme pune në mbledhje të përbashkëta.

4. Veprimtaria e komisioneve, e komiteteve dhe e grupeve të përkohshme të punës nuk mund të zhvillohen në të njëjtën kohë me mbledhjet e Këshillit.

5. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të asistojë dhe të japë mendimin e tij në mbledhjet e komisioneve e komiteteve ose të grupeve të punës, në të cilat nuk është anëtar.

#### Neni 6

### **Komisionet e përhershme**

1. Këshilli ngrë, në bazë edhe të përbërjes së tij, komisionet e përhershme të punës, të cilat janë:

- a) Komisioni i strategjive dhe politikave të arsimit të lartë dhe shkencës;
- b) Komisioni i vlerësimit të cilësisë dhe organizimit të studimeve në arsimin e lartë;
- c) Komisioni i buxhetit dhe autonomisë universitare;

2. Komisionet mund të kenë edhe fusha të tjera nëndisiplinore nën kompetencën e tyre. Këto fusha propozohen në mbledhjen e Këshillit duke u miratuar me shumicë të thjeshtë votash dhe caktohen më pas me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. Çdo anëtar i Këshillit merr pjesë vetëm në një komision të përhershëm.
4. Komisionet zhvillojnë detyra studimi, dokumentimi dhe propozimi për tema të interesit të përgjithshëm sipas fushave përkatëse, të cilat relatohen në mbledhjen e Këshillit.

#### Neni 7

### **Komitetet e fushave disiplinore**

1. Këshilli ngre në bazë, të përbërjes së tij, komitetet e fushave disiplinore të mëposhtme:
  - a) shkencat e natyrës;
  - b) shkencat mjekësore;
  - c) shkencat agrare e veterinare;
  - d) shkencat inxhinierike;
  - e) shkencat e informatikës dhe teknologjive të informacionit;
  - f) shkencat filologjiko-letrare, politike dhe sociale;
  - g) shkencat juridike, ekonomike dhe statistike;
  - h) shkencat e edukimit.
2. Çdo komitet përbëhet nga tre anëtarë. Në përbërje të komiteteve të fushave disiplinore mund të marrin pjesë edhe ekspertë të jashtëm jo anëtarë të Këshillit për periudha të përcaktuara, të thirrur nga Kryetari. Koordinator i secilit komitet është anëtar i Këshillit, sipas fushave respektive të njëjta ose të përafërta disiplinore.
3. Për çështje specifike apo të karakterit ndërdisiplinor, komitetet e fushave disiplinore mund të veprojnë së bashku, me propozim të shumicës së anëtarëve të çdo komiteti dhe miratim të Kryetarit.
4. Komitetet zhvillojnë detyra studimi, dokumentimi dhe propozimi për probleme të fushave disiplinore përkatëse, të cilat relatohen në mbledhjen e Këshillit.

#### Neni 8

### **Grupet e përkohshme të punës**

1. Për trajtimin e temave specifike, Këshilli mund të thërrasë edhe grupe të përkohshme pune me përbërje deri në 3 ekspertë të jashtëm, si dhe 1 ose 2 nga anëtarët e Këshillit, ekspertë të asaj fushe. Grupet krijohen nga kryetari me konsensus edhe të shumicës së anëtarëve të këshillit.
2. Grupet e përkohshme të punës të Këshillit funksionojnë për periudha të caktuara dhe shqyrtojnë apo japin mendime a qëndrime të ndryshme lidhur me fusha specifike, të veçanta apo që kërkojnë mendime më të specializuara. Këto grupe pune i marrin detyrat nga Kryetari, i cili i ka diskutuar më parë në mbledhjen e këshillit.
3. Detyrat e grupeve të përkohshme të punës prezantohen në mbledhjet e Këshillit dhe materiali i paraqitur shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit, ku ky miraton materialin e propozuar me shumicë votash, ose e refuzon atë për përdorim. Në çdo rast materiali ruhet në arshivën e materialeve të Këshillit.

#### Neni 9

### **Funksionet e relatorëve**

1. Komisionet e përhershme të Këshillit, komitetet e fushave disiplinore dhe grupet e përkohshme të punës caktojnë nga një relator ndërmjet anëtarëve të tyre, për t'i relatuar Këshillit në lidhje me çështjet përkatëse të trajtuara prej tyre.
2. Kryetari mund t'u ngarkojë drejtpërdrejt komisioneve të përhershme, komiteteve të fushave disiplinore ose grupeve të përkohshme të punës çështje të veçanta për shqyrtim. Në këtë rast, relatori përkatës përgatit relacionin për ta paraqitur atë në mbledhjen e Këshillit.
3. Relatorët paraqesin në mbledhjen e Këshillit tekstin e dokumentit apo punimit që do të diskutohet, i cili iu bëhet i njohur të gjithë anëtarëve të Këshillit nëpërmjet Sekretarit, duke zbatuar procedurat e përmendura në këtë rregullore.
4. Në përfundim, propozimet e mësipërme miratohen me shumicën e thjeshtë të votave.

Neni 10  
**Mbledhjet e Këshillit**

1. Këshilli mblidhet mbi bazën e një kalendari semestral. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe.
2. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar nga Sekretari, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime.
3. Mbledhjet bëhen nëse në to janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit.

Neni 11  
**Mbledhjet e jashtëzakonshme**

Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren me kërkesë të Kryetarit ose me kërkesë me shkrim të 1/3 së anëtarëve të Këshillit.

Neni 12  
**Thirrja e mbledhjeve të Këshillit**

1. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen nëpërmjet postës elektronike, të paktën 3 ditë para datës së thirrjes së mbledhjes, si dhe njoftimeve nëpërmjet telefonit. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme bëhen duke respektuar të njëjtën procedurë, të paktën 1 ditë para datës së thirrjes së mbledhjes.
2. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje do të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

Neni 13  
**Rendi i ditës**

1. Kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës mund të përfshijë çështje të propozuara nga komisionet apo nga të paktën 5 anëtarë të Këshillit. Rendi i ditës mund të përfshijë edhe relatime të problemeve të veçanta për shqyrtim, të ngarkuara nga Kryetari drejtpërdrejt komisioneve të përhershme, komiteteve të fushave disiplinore ose grupeve të përkohshme të punës.
2. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 ditë para datës së vendosur për mbledhjen.
3. Rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin shoqëruar duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, nëpërmjet postës elektronike, të paktën 3 ditë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.
4. Në fillim të mbledhjes, me kërkesë të Kryetarit ose të paktën 10 anëtarëve të Këshillit, mund të propozohen shtesa në rendin e ditës, të cilat duhet të miratohen nga shumica e anëtarëve të Këshillit të pranishëm në mbledhje. Nëse trajtimi i çështjeve shtesë kërkon parapërgatitje, seanca shtyhet me 24 orë.

Neni 14  
**Marrja e vendimeve**

Këshilli merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës ose për çështje shtesë të rendit të ditës të miratuara paraprakisht si pjesë e rendit të ditës.

Neni 15  
**Diskutimet**

1. Diskutimet mund të zgjasin deri në 20 minuta kur u referohen argumenteve të karakterit të përgjithshëm, ose 15 minuta kur u referohen praktikave të veçanta ose grupe praktikash, replikat eventuale nuk mund të kalojnë 3 minuta.

2. Relatimet, diskutimet për çështje prioritare ose tema të tjera të një rëndësie të veçantë të kërkuara nga vetë Kryetari, jashtë diskutimeve normale, nuk janë pjesë e përcaktimeve të bëra në paragrafin e parë të kësaj pike.

Neni 16

### **Votimi i detyrueshëm**

Anëtarët e Këshillit që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, nuk mund të abstenojnë. Kryetari i Këshillit voton në fund.

Neni 17

### **Forma e votimit**

1. Votimet zhvillohen në mënyrë të hapur. Me kërkesën e të paktën 5 anëtarëve të Këshillit, formuluar në përfundim të diskutimeve ose me iniciativë të Kryetarit, votimi bëhet me apel nominal sipas rendit alfabetik, ose i fshehtë.

2. Modalitetet e votimit të fshehtë përcaktohen me rregulla të brendshme.

3. Kur votimi lidhet me propozimin e personave joanëtarë të Këshillit në pozicione me rëndësi të veçantë, ky vendim merret me votim të fshehtë dhe pa debat. Profili shkencor i kandidatit të propozuar prezantohet nga një anëtar i Këshillit dhe materiali respektiv iu shpërndahet të gjithë anëtarëve të tij duke zbatuar procedurat e përmendura në rregullore.

Neni 18

### **Shumica e nevojshme për të marrë vendime dhe barazia e votave**

1. Votimi në Këshill quhet i rregullt kur në të marrin pjesë të paktën 50% + 1 e anëtarëve të Këshillit.

2. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, ky do të quhet votim me shumicë të thjeshtë.

3. Asnjë anëtar i Këshillit nuk mund të marrë pjesë në votimin që bëhet për çështje që lidhen me të personalisht apo familjarë e të afërm të tij, në bazë të ligjit “Për konfliktin e interesit”.

4. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e Kryetarit është vendimtare.

Neni 19

### **Procesverbali i mbledhjes**

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje në formë sintetike e gjithçkaje që u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

2. Anëtarët e Këshillit mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Këshilli.

3. Procesverbali i çdo mbledhjeje të Këshillit redaktohet në formë sintetike nga sekretari që mban procesverbalin gjatë mbledhjeve, nën mbikëqyrjen e Sekretariatit teknik.

4. Çdo anëtar i Këshillit ka të drejtë të regjistrojë në procesverbal mosaprovimin e tij ose mendimin kundër mbi argumente të veçanta, si dhe të kërkojë përfshirjen e një deklarami të bërë prej tij gjatë mbledhjes, të cilin e përgatit me shkrim.

5. Secili nga anëtarët e Këshillit mund të kërkojë të shohë procesverbalin e mbajtur. Ai duhet të pasqyrojë qartë dhe me transparencë atë çka ndodh në mbledhje, duke pasqyruar edhe mendimet pro apo kundër të anëtarëve të Këshillit.

6. Procesverbali mbahet nën përgjegjësinë e sekretariatit dhe është i disponueshëm në sekretari. Ai duhet të firmoset nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse, duke konfirmuar kështu edhe pjesëmarrjen e tyre.

Neni 20  
**Informimi i publikut**

1. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës hapet një faqe e veçantë për veprimtarinë e Këshillit.

2. Sekretariati teknik i KALSH-it merr masat për hapjen e një rubrike të veçantë në faqen zyrtare të internetit të ministrisë. Ai përgatit dhe publikon, në mënyrë korrekte dhe të shpejtë, të gjitha informacionet e që mund të bëhen publike. Para publikimit merret miratimi i kryetarit të Këshillit.

Neni 21  
**Ndryshimet e rregullores**

Propozimi për ndryshim të rregullores së veprimtarisë së Këshillit miratohet me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

Neni 22  
**Dokumentacioni**

Këshilli ruan të gjitha dokumentet, informacionet, raportet, studimet a materiale të tjera të paraqitura në formën zyrtare në mbledhjet e Këshillit. Këto materiale ruhen pranë drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë në MASH nën përgjegjësinë e Sekretariatit teknik dhe në fund të çdo viti kalendarik depozitohen në protokollin e ministrisë në një dosje me mbishkrimin “Materiale të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës”. Këshilli ruan gjithashtu të gjitha procesverbalet e mbajtura për zhvillimin e mbledhjeve të tij në formën e përshkruar më sipër.

**VENDIM**  
**Nr.830, datë 4.6.2008**

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË**  
**“SHKOLLA E LARTË “NEHEMIA””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e institucionit privat të arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia””, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Pogradecit.

2. “Shkolla e Lartë “Nehemia”” do të organizohet në dy fakultete, si më poshtë vijon:

a) Fakulteti i Biznesit dhe Teknologjisë, i cili do të ofrojë programe studimi, të ciklit të parë, në:

i) statistikë dhe matematikë;

ii) shkenca kompjuterike;

iii) biznes dhe ekonomi.

b) Fakulteti i Shkencave Humane, i cili do të ofrojë:

- programe studimi, të ciklit të parë, në:

i) gazetari;

ii) gjuhë moderne;

iii) edukim dhe etikë.

- programe studimi, të ciklit të dytë, në:

i) lidërsip dhe vlerësim arsimor;



ii) studime europiane.

3. Programet e studimeve, që organizohen pranë këtij institucioni, janë me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të parë është 3 vjet dhe kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë, është 2 vjet.

4. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit të ciklit të parë lëshohet “Diploma e nivelit të parë” (DNP), përkatësisht:

- a) në statistikë të zbatuar;
- b) në matematikë;
- c) në sistemet e informimit kompjuterik;
- ç) në biznes dhe ekonomik;
- d) në gazetari;
- dh) në anglisht;
- e) në gjermanisht;
- ë) në studime fetare dhe të etikës.

5. Në përfundim të studimeve, në programet e studimit të ciklit të dytë lëshohet “Diploma e i nivelit të dytë” (DND), përkatësisht:

- a) në lidhshmëri dhe vlerësim arsimor;
- b) në studime europiane.

6. Ngarkohet institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia””, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

7. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia”” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin për këtë qëllim.

8. Ndryshime në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe elementet e tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Institucioni privat i arsimit të lartë “Shkolla e Lartë “Nehemia”” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve ligjore të përcaktuara.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.108, datë 18.7.2008, faqe 4793*

**VENDIM**  
**Nr.875, datë 18.6.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E TË DREJTAVE E TË DETYRAVE DHE PËR PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES E TË EMËRIMIT TË KANCELARIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kancelari i institucionit publik të arsimit të lartë (më poshtë kancelari) është autoritet, në përbërje të rektoratit të institucionit publik të arsimit të lartë (më poshtë institucioni). Kancelari, për përmbushjen e funksionit, kryen detyrat e mëposhtme:

- a) Drejton veprimtarinë e administratës;
- b) Realizon administrimin financiar;
- c) Drejton planifikimin dhe realizimin e investimeve;
- ç) Mbikëqyr të gjitha procedurat e marrjes në punë;
- d) Drejton procedurat e marrjes në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të administratës;
- dh) Me autorizimin e rektorit, përfaqëson ose bashkëpërfaqëson institucionin në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta, persona, fizikë ose juridikë;
- e) Kryeson sekretariatit teknik, që mbështet veprimtarinë e këshillit të administrimit të institucionit (më poshtë KADM);
- ë) Mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit.

2. Për përzgjedhjen dhe emërimin e kancelarit të institucionit ndiqen procedurat e mëposhtme:

- a) KADM-ja miraton kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët;
- b) Institucioni shpall publikisht, për dy javë kalendarike, vendin e punës dhe kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët për kancelar, si dhe shpall fillimin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve, nëse janë paraqitur, së paku, tri kandidatura;
- c) KADM-ja harton skemën e vlerësimit të kandidatëve duke përshkruar me hollësi mënyrën e vlerësimit të kandidatëve, në bazë të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Përveç vlerësimit të dosjes mund të parashikojë edhe një intervistë;
- ç) Çdo anëtar i KADM-së bën vlerësimin, me shkrim, sipas skemës së miratuar, për çdo kandidat, dhe në fund, në bazë të pikëve të grumbulluara, shpallet renditja e kandidatëve;
- d) KADM-ja ka të drejtë të përzgjedhë, me votim të fshehtë, njërin nga tri kandidatët, që kanë grumbulluar më shumë pikë. Fitues shpallet kandidati, që merr 2/3 e votave të anëtarëve.
- dh) KADM-ja, pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve, shpall publikisht kandidaturën fituese. Kandidatët kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin e KADM-së, vetëm për procedurën e vendimmarrjes, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes. Ankesat depozitohen në protokollin e institucionit.

KADM-ja ka të drejtë të shqyrtojë ankesat, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, dhe u përgjigjet atyre me shkrim.

e) KADM-ja pas rishqyrtimit ia dërgon propozimin e vet rektorit të institucionit, brenda 2 ditëve pune.

ë) Rektori, pas përfundimit të procesit të ankimimit, ia përcjell Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dosjen e kandidatit për kancelar, brenda 2 ditëve pune nga data e ardhjes së propozimit, së bashku me vendimin e me relacionin shoqërues të KADM-së, ku pasqyrohet i plotë edhe qëndrimi i pakicës, që ka votuar kundër. Kur rektori nuk ia dërgon ministrit propozimin e KADM-së për

kandidaturën për kancelar brenda afatit të mësipërm, kryetari i këtij këshilli i dërgon ministrit vendimin, brenda 2 ditëve pune.

f) Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të pranojë ose refuzojë kandidaturën e propozuar, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së propozimit. Në rast refuzimi të kandidaturës, përsëritet e gjithë procedura e përzgjedhjes së kancelarit të institucionit. Në rast se ministri refuzon edhe kandidaturën e propozuar herën e dytë, ai ka të drejtë të emërojë një kancelar të komanduar, për jo më shumë se 1 vit. Gjatë kësaj periudhe, KADM-ja përzgjedh një kandidaturë të re, sipas procedurave të mësipërme.

3. Kancelari shkarkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me nismën e vet, me propozimin e KADM-së ose të rektorit të institucionit. Procedurat, që ndiqen nga KADM-ja, për shkarkimin e kancelarit e për mënyrën e votimit, janë të njëjta me atë të ndjekura për përzgjedhjen e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.109, datë 18.7.2008, faqe 4830*

**VENDIM**  
**Nr.1037, datë 2.7.2008**

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET  
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË  
TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, të jetë 21 702, të ndara si më poshtë vijon:

- |  |         |
|--|---------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë | 20 602; |
| b) Kuota në program të dytë studimi                                    | 500;    |
| c) Kuota për transferim studimesh                                      | 500;    |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj  | 100.    |

2. Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, përbëhet nga:

- |   |         |
|---|---------|
| a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit | 19 622; |
| b) Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit    | 980.    |

3. Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij vendimi, 19 620, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. 20 kuotat e tjera parashikohen për kandidatët me statusin e të verbërit.

3.1 Kuotat për kandidatët me statusin e të verbërit shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për institucionet publike të arsimit të lartë, në programe të ndryshme studimi, me propozimin e shoqatës së të verbërve. Kandidatët, që përfitojnë nga këto kuota, duhet të kenë shlyer

detyrimin e maturës shtetërore dhe të plotësojnë kushtet e tjera, që përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me shoqatën e të verbërve.

4. Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë, nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave bëhet nga ministrinë respektive të arsimit, të cilat sjellin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat e kandidatëve fitues. Ministria e Arsimit dhe Shkencës i përcjell këto lista në institucionet publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, janë pasqyruar në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy e shumëpalëshe.

6. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jenë:

a) Në Universitetin e Tiranës	
- Për të gjitha programet e studimit:	
i) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës	15 000 lekë;
ii) Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja	15 000 lekë;
iii) Në Fakultetin e Drejtësisë	30 000 lekë;
iv) Në Fakultetin e Shkencave Sociale	30 000 lekë;
v) Në Fakultetin e Mjekësisë:	
- Programet e studimit farmaci, stomatologji dhe shëndeti publik	30 000 lekë;
- Në programin e studimit mjekësi	25 000 lekë;
vi) Në Fakultetin e Infermierisë	25 000 lekë;
vii) Në Fakultetin e Histori-Filologjisë	20 000 lekë;
viii) Në Fakultetin e Ekonomisë	25 000 lekë.
b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës	
i) Në programin e studimit arkitekturë	30 000 lekë;
ii) Në programin e studimit inxhinieri ndërtimi	25 000 lekë.
iii) Në programet e studimit inxhinieri elektrike dhe inxhinieri elektronike	20 000 lekë;
iv) Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
c) Në Akademinë e Arteve	
i) Në programin e studimit “Regji filmi”	80 000 lekë;
ii) Për të gjitha programet e tjera të studimit	30 000 lekë.
ç) Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”	
- Për të gjitha programet e studimit	20 000 lekë.
d) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës	
- Në programet e studimit:	
i) Drejtim fermash dhe agrobiznes	20 000 lekë;
ii) Ekonomi dhe politikë agrare	20 000 lekë;
iii) Inxhinieri pyjesh, inxhinieri e përpunimit të drurit	20 000 lekë;
iv) Financë-kontabilitet	20 000 lekë;
v) Veterinari	20 000 lekë;
vi) Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.

dh) Në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	
- Në programet e studimit:	
i) Gjuhë-letërsi, gazetari, punë sociale dhe psikologji	15 000 lekë;
ii) për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
e) Në Universitetin e Gjirokastrës “Eqrem Çabej” dhe në universitetin e Korçës “Fan S.Noli”	
i) Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.
ë) Në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”	
- Në programet e studimit:	
i) Gjuhë-letërsi, punë sociale, psikologji	15 000 lekë;
ii) Drejtësi	16 000 lekë;
iii) Për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
f) Në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”:	
- Në programin e studimit:	
i) Drejtësi	20 000 lekë;
ii) Gjuhë-letërsi	15 000 lekë;
iii) Për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
g) Në Universitetin e Durrësit “Aleksandër Moisiu”	
i) Për të gjitha programet e studimit	15 000 lekë.

7. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, të ciklit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, dhe studentët e viteve më të larta, që vijnë nga shtresat sociale, si të verbër/shurdhër, invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë, fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës apo që vijnë nga shtresa e ish-të përndjekurve politikë, përjashtohen nga tarifa e shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

9. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, 5 (pesë) studentët e vitit të parë, me rezultate më të larta të notës mesatare të shkollës së mesme dhe të provimeve të maturës shtetërore, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Në asnjë rast, këtë përjashtim nuk e përfitojnë studentët me notën mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota 8 (tetë).

10. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe kuotat e transferimeve, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

11. Transferimet e studentëve, brenda numrit përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në statutin dhe në rregulloret përkatëse.

12. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi, do ta fitojnë këtë të drejtë, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe pa iu nënshtruar detyrimeve të “Maturës Shtetërore”.

13. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin një program të dytë studimi në Akademinë e Arteve, në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve “Vojo Kushi”, Tiranë, në programin e studimit të edukimit fizik dhe sporteve, në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe në programin e studimit të arkitekturës, në Universitetin Politeknik të Tiranës, duhet t’u nënshtrohen kriterëve të veçanta (konkurruese të pranimit), të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në ciklin e parë të studimeve.

14. Kandidatët, që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi, dhe studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet, sipas pikës 10 të këtij vendimi, u nënshtrohen tarifave të shkollimit, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.13, datë 28.5.2007 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrisë të Financave.

15. Studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme, të ciklit të parë, në një program tjetër studimi, brenda të njëjtit institucion publik të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit.

16. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë përcaktuar mënyra të tjera për caktimin e tarifave.

17. Mënyrat e plotësimit të kuotave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

18. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.120, datë 31.7.2008, faqe 5300*

Tabela nr.1

## KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	∑
1	Histori	100						90					190
2	Gjeografi	100						90					190
3	Histori-Gjeografi				90	80							170
4	Gjuhë Letërsi	100			120	80	100	120	150				670
5	Gazetari	80			80			80					240
6	Edukate Qytetare				100								100
7	Anglisht	180			100	80	100	100	160			100	820
10	Frëngjisht	100			80			80					260
11	Italisht	110			80	60		100	160				510
12	Gjuhë Spanjolle	40											40
13	Rusisht	40											40
14	Gjermanisht	100			80			80					260
15	Gjuhë Letërsi Greke	60				80							140
16	Gjuhë Turke	40											40
17	Cikli i Ulët				180	80	100	120	130			150	760
18	Cikli i Ulët Parashkollor				100	60	60	60	100				380
20	Fizkulturë							60			150		210
21	Matematikë	100						100	300				500
22	Fizikë	120						60					180
23	Inxh. Matematike dhe Informatike	90											90
24	Matematikë-Fizikë				150	80	60						290
25	Biologji - Kimi				100	80		120					300
26	Biologji	120											120
27	Kimi	80											80
28	Kimi ushqimore	80											80
29	Kimi Industriale	80											80
30	Matematikë-Informatikë					120	100						220
31	Informatikë	180						120	250				550
32	Teknologji Informacioni								250				250
33	Punë Sociale	100			100			80					280
34	Filozofi	100											50
35	Filozofi-Sociologji				90		100						190
36	Sociologji	100											100
38	Psikologji	100			90			60					250
39	Shkencat Politike	100											100
40	Drejtësi	400						200	120				720
41	Regji Filmi dhe TV									10			10
42	Aktrim									12			12
43	Regji									8			8
44	Skenografi-Kostumografi									10			10
45	Koreografi									10			10
46	Pikturë									50			50
47	Skulpturë									10			10
48	Muzikologji									4			4
49	Kompozim									4			4
50	Dirigjim									4			4

51	Piano									10			10
52	Violine									8			8
53	Violoncel									3			3
54	Viola									6			6
55	Kitare									6			6
56	Kontrabas									3			3
57	Flaut									5			5
58	Oboe									6			6
59	Klarinete									5			5
60	Fagot									3			3
61	Korno									2			2
62	Trombe									5			5
63	Trombone									5			5
64	Bastub									3			3
65	Kengetare									15			15
66	Shendeti Publik	80											80
67	Mjekësi	300											300
68	Stomatologji	80											80
69	Farmaci	100											100
70	Infermieri e Pergjithshme	250			150	100	120	150	250				1020
72	Mami (Infermieri)	50			100		40	90					280
73	Tek. i Larte Laboratori	35											35
74	Fizioterapi	35						30					65
76	Imazheri	35											35
77	Administrim Publik					80							80
78	Administrim-Biznes	460			100		80	120	240				1000
79	Ekonomiks	80											80
80	Ekonomia dhe e Edrejta				50								50
81	Finance-Kontabilitet	460			100	80	100	120					860
82	Info.Ekonomike	100											100
83	Administ-Biznes(Turizem)Sarande	200											200
84	Administrim-Biznes (Kukës)	100											100
85	Turizëm					90	90	120	160				460
86	Marketing						80						80
87	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	UD	0
89	Inxh. Navigacioni								80				80
90	Inxh. Mekanike		150						400				550
91	Inxh. Metalurgji Materiale		60										60
92	Inxh. Tekstile dhe Mode		60										60
93	Inxhinieri Elektrike		120										120
95	Inxh. Elektronike		150										150
96	Inxh. Informatike		150										150
97	Inxh. Telekomunikacioni		150										150
98	Inxh. Mekatronike		100										100
99	Inxhinieri Ndertimi		150										150
100	Inxhinier Hidroteknik		100										100
101	Arkitekturë		100										100
102	Inxh. Matematike		60										60
103	Inxh. Fizike		60										60
104	Inxhinier Gjeodet		60										60
105	Inxh. Mjedisi		60										60



106	Inxh. ne Shkencat e tokes		60										60
107	Inxh. Gjeoinformatike		100										100
108	Inxhin. i Gjeoburimeve		100										100
109	Menaxhim Agrobiznesi			150			60						210
110	Ekonomi dhe P. Agrare			150									150
111	Financë-Kontabilitet			150									150
112	Mbrojtje bimësh			100									100
113	Hortikulturë			100			60						160
114	Prodhim bimor			100									100
115	Zootekni dhe Biznes Blegtoral			100									100
116	Akuakulturë dhe Menaxh.. Peshkimi			100									100
117	Agromjedis dhe Ekologji			100									100
118	Tek. Agroushqimore			100									100
119	Vreshtari-Enologji			100									100
120	Inxhinier Pyjesh			60									60
121	Inxhinier Perpunim Druri			60									60
122	Mjekesi Veterinare			100									100
123	Inxhinieri Agronomike						60						60
124	Shkenca të Administrimit											150	150
125	Menaxhim Turizmi											150	150
128	Espert në Proceset e Formimit											100	100
129	Spec. Rrjetash Kopjuterike											200	200
130	Menaxhim Ndërtimi											60	60
131	Menaxhim Transporti											60	60
132	Teknologji Automobilash											60	60
133	Asistent Ligjor											60	60
134	Asistent Administrativ											60	60
135	Infermieri											60	60
136	Ndihmës dentist											60	60
	GJITHSEJ	5165	1790	1470	2040	1150	1310	2350	2750	207	150	1270	19602

KUOTAT PËR KANDIDATËT NGA TROJET PËR VITIN AKADemik 2008-2009  
TABELA NR.2

Nr.	DEGA	KOSOVA										MAqedoni								MALIZI						P R E S H E V E						Σ							
		UT	AA	UB	USH	UE	ASH	UD	UG	UV	UP	UT	UP	UB	ASH	UE	UD	AA	UV	UK	UT	UPT	UB	USH	AS	UV	AA	UT	UPT	UB	AA		USH	UD	UG	UE	UV	AS	
1	Histori	2			1						1									2			3				1												11
2	Gjeografi	2			1						1									2			3				1												10
3	Histori-Gjeografi					2				1					2																				1	1			7
4	Gjuhe Letersi	2			1	2				1	4				2				3	2	1			4		0	1				1			1	1	2		29	
5	Edukim Qytetar																																					0	
6	Anglisht	10			3	2			2		4			4		2	2		3	2	3			3		1		4				2	1		1	2		51	
7	Italisht				3	1					4				2				3					5		1					2					2		23	
8	Frëngjisht				3	1									1									5							2						12		
9	Gjermanisht				3	1									1							2															15		
10	Inxh. Matem. dhe Informatike	3												3																	2							10	
11	Cikli i Ulet				1	1			2	1	4				2	2			3	2			4		1						1	1	1		2		28		
12	Cikli i Ulet Parashkollor				1	1			1	4					1				3	2			5		1					1	1			2		23			
13	Fizkulture				1		3							2									3	15						1					1		26		
14	Matematike	3			1																2		3				2										15		
15	Matem-Fizikë					3			1	4					5				3	2						1					1	2	2				24		
16	Teknologji Informacioni										10									5						2									3		20		
17	Matem-Informatikë									1																											2		
18	Fizikë	3			1																	2		3				2									15		
19	Biologji	3								1												2						2						1			12		
20	Biologji-Kimi				1	3				1					5								1								1	1	2				15		
21	Kimi	2																				1						1									5		
22	Kimi Ushqimore	3																				2						2									10		
23	Kimi Industriale	3																				2						2									10		
24	Informatikë	2			1																	1		2			1										9		
25	Gazetari	2			1	2									2								1				1						1		1		16		
26	Punë Sociale	1			1	2									2							4		3			1								1		16		
27	Sociologji																						1														1		
28	Filozofi	1				2									2							2					1							1			9		
29	Psikologji	1			1	2									2							3		3			1						1		1		15		
30	Shkencat Pol.	1																									1										2		
31	Drejtesi	4			1					4		3							3		3		2		10		2								2		35		
32	Regjistrë																										2										2		
33	Aktrim																										2										2		
34	Art Skenik			5															2							2											10		
35	Pikturë																									1											1		
36	Arte Figurative			2															1							12											16		
37	Muzikë			5															3							22											30		
38	Mjekësi e Përgjithshme	3																				2		3				1									9		
39	Stomatologji	2																									1										6		
40	Farmaci	2																									1										7		
41	Shendet Publik	1																									1										3		
42	Infermieri	10			1	2				1	4				2				3	2				8		1						1		1	1	2	39		
43	Mami				1	2									2					2				3												12			
44	Laborator	2																									1										5		
45	Fizioterapi	5			1																				5												12		
46	Ekonomiks	1																																			5		
47	Adm-Bines(Turizem)Sarandë	1																																			1		
48	Adminstrim-Biznesi(Kukës)	20																																			27		
49	Administrim-Publik									1																									1		2		
50	Administrim.-Biznes	5			1	2					4				2				3	5	4					3		1						1	1	2	34		

		K o s o v a												M a q e d o n i												M a l i Z i P r e s h e v a												0
Nr.	DEGA	UT	AA	UB	US	UE	ASP	UD	UG	UV	UPT	UT	UPT	UB	ASP	UE	UD	AA	UV	UK	UT	UPT	UB	US	AS	UV	AA	UT	UPT	UB	AA	US	UD	UG	UE	UV	AS	0
51	Financ-Kontabilitet	2			1	2			1			1				2				5	2			2				1					1	1	1		22	
52	Inf. Ekonomike	1																																			1	
53	Turizem				3				1	4										3	5			15		1						2		1		2	37	
54	Marketing																				5																5	
55	Ekonomia dhe E Drejta					1										2																					3	
56	Inxh. Elektrike										2		2																								4	
57	Inxh. Informatike										2		1																								3	
58	Inxh. Telekomunikacioni										2		1																								3	
59	Mekanike										5		3									1															10	
60	Inxh. Materiale										4		1																								5	
61	Gjeodezi										3		1									1															5	
62	Tekstil dhe Mode										5		3									1															10	
63	Elektronik										2		1																								3	
64	Ndertim										3		2																								5	
65	Arkitekture										1		1																								2	
66	Hidroteknike										1		1																								2	
67	Inxhin ambienti										3		1									1															5	
68	Inxh. Matematike										3		1									1															5	
69	Inxh. Fizike										3		1									1															5	
70	Inxh. Mekatronike										1		1																								2	
71	Inxh. Navale									4											3						1								2	10		
72	Navigacion									4																									2	10		
73	Menaxhim Agrobiznesi				2									1							3																8	
74	Ekonomi dhe P. Agrare				2									1								1															5	
75	Financ-Kontabilitet				2									1							3																8	
76	Mbrojtje Bimesh				2									1								1															5	
77	Hortikulture				2									1							3																8	
78	Prodhim Bimor				2									1								1															5	
79	Zootekni dhe Biz. Blektoral																																				0	
80	Akuakult. dhe M. Peshkimi																																				0	
81	Agromjedis dhe Ekologji				2									1									1														5	
82	Tek. Agroushqimore				2									1									1														5	
83	Vreshtari-Enologji																																				0	
84	Inxh. Pyjesh				2									1								1															5	
85	Inxh. Perpunim Druri				2									1								1															5	
86	Veterinari				5																3																10	
87	Shkenca te Administrit										2																										5	
88	Menaxhim Turizmi										2																										5	
89	Ekspert ne P. Formim it										2																										5	
90	Asistent Ligjor										2											2															5	
91	Asistent Administrativ										2																										5	
92	Infermieri										2																										5	
93	Ndihmes Dentist										2											2															5	
94	Spec. Rrjetash Kompjuterike										2																										5	
95	Menaxhim Ndertimi										2																										5	
96	Menaxhim Transporti										2																										5	
97	Teknologji Automobilash										2																										5	
<b>GJITHSEJ</b>		<b>103</b>	<b>12</b>	<b>25</b>	<b>34</b>	<b>34</b>	<b>3</b>	<b>26</b>	<b>12</b>	<b>58</b>	<b>40</b>	<b>38</b>	<b>21</b>	<b>13</b>	<b>2</b>	<b>41</b>	<b>26</b>	<b>6</b>	<b>41</b>	<b>45</b>	<b>49</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>103</b>	<b>15</b>	<b>22</b>	<b>41</b>	<b>41</b>	<b>2</b>	<b>11</b>	<b>2</b>	<b>29</b>	<b>13</b>	<b>12</b>	<b>15</b>	<b>27</b>	<b>1</b>	<b>980</b>

**VENDIM**  
**Nr. 1133, datë 5.8.2008**

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, PRIVAT, “SHKOLLA  
E LARTË NËNA MBRETËRESHË, GERALDINË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e institucionit të arsimit të lartë, privat, “Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë”, i cili do të ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Burrelit.
2. Institucioni i arsimit të lartë, privat, “Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë” do të organizohet në dy fakultete:
  - a) Fakulteti i Infermierisë, me programin e studimit, në formën e studimit me kohë të plotë, “Infermier i përgjithshëm” (3 vite akademike).
  - b) Fakulteti i Mësuesisë, me programin e studimit, në formën e studimit me kohë të plotë, “Mësues i ciklit të ulët” (3 vite akademike).
3. Institucioni i arsimit të lartë, privat, “Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë” do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 vite akademike dhe, në përfundim të studimeve, do të lëshojë diplomën e nivelit të parë, në fushën e arsimimit të kryer.
4. Ngarkohet institucioni i arsimit të lartë, privat, “Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.
5. Institucioni i arsimit të lartë, privat, “Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë” do ta fillojë veprimtarinë mësimore, për programet e studimit, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo me vonë se tre javë para fillimit të vitit akademik.  
Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni përmbush angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.
6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
7. Institucioni i arsimit të lartë, privat, “Shkolla e Lartë Nëna Mbretëreshë, Geraldinë” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara ligjore.
8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.134, datë 22.8.2008, faqe 5991*

**VENDIM**  
**Nr.1288, datë 24.9.2008**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, pranë universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, në Fakultetin e Mësuesisë, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët “Gjuhë-letërsi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) në lëndët “Histori-gjeografi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën histori-gjeografi.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, datë 3.10.2008, faqe 7401*

**VENDIM**  
**Nr.1289, datë 24.9.2008**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT “FAN.S.NOLI”, KORÇË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, pranë universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programeve të mëposhtme, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët “Gjuhë-letërsi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) në lëndët “Gjuhë angleze”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Fan.S.Noli”, Korçë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, datë 3.10.2008, faqe 7401*

**VENDIM**  
**Nr.1290, datë 24.9.2008**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, PRANË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, pranë universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të mëposhtme të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë:

a) në lëndët “Gjuhë-letërsi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) në lëndët “Biologji-kimi”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët biologji-kimi;

c) në lëndën “Gjuhë italiane”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë italiane;

ç) në lëndën “Gjuhë gjermane”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë gjermane;

d) në lëndën “Gjuhë frënge”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë frënge;

dh) në lëndët “Gjuhë angleze”, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, mastër i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze.

2. Programet e studimeve master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, datë 3.10.2008, faqe 7402*

**VENDIM**  
**Nr.1509, datë 30.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ARSIMIN E LARTË, 2008-2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin e lartë, 2008-2013, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.180, datë 18.12.2008, faqe 8953*

**STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ARSIMIN E LARTË ( SKALA) (2008-2013)**

**1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM DHE KUSHTET AKTUALE**

1. Arsimi i Lartë (AL) dhe kërkimi shkencor në Shqipëri nuk janë akoma në standardet ndërkombëtare; progresi ka qenë disi zhgënjyes në 14 vitet e fundit. Ligji i ri për arsimin e lartë (2007) ka qenë një hap i rëndësishëm përpara për përmirësimin e sistemit, por shënon vetëm fillimin. Kjo strategji shtron synime dhe objektiva më afatgjatë për sistemin dhe paraqet politikat për prioritetet strategjike për vitet që pasojnë deri në vitin 2013.

2. Strategjia është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të AL në Europë dhe në botë, dhe në veçanti, me procesin e Bolonjës; qëllimi i saj është të përmirësojë AL-në, që Shqipëria të zërë vendin që i takon brenda Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL).

3. Strategjia pasqyron vizionin e Qeverisë për politikat afatmesme dhe afatgjata në sferën e AL-së. Në të janë përfshirë sugjerimet e botës akademike dhe të grupeve të interesit brenda vendit si dhe të ekspertëve dhe zyrtarëve të lartë të Këshillit të Europës. Strategjia përbën bazën e një plani veprimi me detyra të programuara për zbatim deri në vitin 2013.

4. Kapitulli në vijim evidenton problemet kryesore të gjendjes aktuale duke i ndarë në tri çështje të mëdha: kuadri institucional, mësimdhënia dhe kurrikulat, aspektet financiare.

**Kuadri institucional**

5. Kuadri institucional aktual i AL-s nuk u përgjigjet zhvillimeve të kohës. Ligji i AL (2007) është hap i mirë drejt një sistemi modern. Zhvillimet e parashikuara në kuadrin e kësaj strategjie mund të kërkojnë edhe përmirësime për aspekte të veçanta të tij. Lidhur me kuadrin institucional vërehen disa mangësi të renditura më poshtë.

6. Së pari, sistemi i AL-s nuk u përgjigjet ende mjaftueshëm nevojave të së ardhmes së shoqërisë dhe ekonomisë së vendit. Shumë aspekte të AL-s, dhe në veçanti niveli i mësimdhënies dhe kërkimit në institucionet e arsimit të lartë (IAL) nuk i janë përgjigjur dinamikës së ndryshimeve të shoqërisë shqiptare dhe prirjeve europiane.

7. Së dyti, sistemi aktual është tepër homogjen dhe nuk inkurajon IAL-të të zhvillojnë misione të ndryshme. Baza ligjore lipset të jetë më elastike që të lejojë shumëllojshmërinë e misioneve.

8. Disa nga IAL-të jashtë Tiranës ende nuk luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e rajonit të tyre, dhe, nga ana tjetër nuk kanë nxitjen e nevojshme për të orientuar veprimtarinë e tyre në këtë drejtim. Për më tepër, disa prej tyre nuk kanë madhësinë e nevojshme për të operuar realisht me efikasitet si IAL: çdo zgjerim i ardhshëm i sistemit normalisht do të bëhet nëpërmjet konsolidimit dhe rritjes së kapaciteteve të institucioneve ekzistuese dhe jo nëpërmjet krijimit të institucioneve të reja.

9. Së treti, mësimdhënia (në IAL) dhe kërkimi (në institutet kërkimore jashtë sistemit të arsimit të lartë, kryesisht në varësi të Akademisë së Shkencave) kanë qenë të ndarë nga njëri-tjetri. Reforma e sistemit të kërkimit shkencor, e ndërmarrë në fillim të vitit 2006, po përfundon duke përmbushur objektivin kryesor të saj, integrimin e kërkimit shkencor me arsimin e lartë. Me integrimin e instituteve kërkimore të Akademisë së Shkencave dhe të rrjetit kërkimor jashtuniversitar janë integruar në universitetet e Tiranës, si rezultat i ndryshimit të kuadrit ligjor, Integrimi i kërkimit shkencor me arsimin e lartë pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së shkollimit universitar në të gjitha ciklet, kryesisht në atë të dytë dhe të tretë të studimeve universitare.

10. Së katërti, përjashtuar formimin fillestar të mësuesve, ka tepër pak arsim të lartë të orientuar në drejtimin profesional: ka pak programe të tilla në ciklin e parë, në mënyrë të veçantë ka pak formime ose programe të arsimit të lartë jouniversitar. Kjo është një arsye më shumë që u ka vështirësuar IAL-ve rajonale përmbushjen e rolit të tyre në mbështetje të ekonomive lokale.

11. Së pesti, mungesa e aftësisë për t'iu përgjigjur nevojave dhe sfidave nuk është tërësisht përgjegjësi e IAL-ve, pasi ato nuk kanë gëzuar autonominë e nevojshme për të funksionuar efektivisht si institucione të shekullit XXI. Ligji i AL (2007) ndonëse është hap i rëndësishëm përpara në këtë drejtim, nuk arrin deri në autonomi të plotë, që do t'i shndërronte IAL-të tona nga shtetërore në publike. Një nga synimet themelore të strategjisë është që ato të shndërrohen realisht IAL publike. Ky transformim do të kërkojë përmirësime të mëtejshme të qeverisjes dhe menaxhimit të tyre, si dhe ndryshime në mekanizmat e sigurimit të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme.

12. Së fundi, pranohet se Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka ende kapacitet të kufizuar analitik për të zhvilluar politikat strategjike për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

#### **Mësimdhënia dhe kurrikulat**

13. Si metodat e mësimdhënies ashtu edhe përmbajtja e kurrikulave e shumicës së programeve universitare nuk përmbushin nevojat e së ardhmes së shoqërisë dhe ekonomisë. Përsa u përket metodave dhe stilit të mësimdhënies, ka një prirje që t'u jepet studentëve informacion i gatshëm duke iu kërkuar atyre më shumë riprodhimin e tij, në vend që të inkurajohet të menduarit kritik. Përsa i përket përmbajtjes së lëndëve që zhvillohen, ato janë shpesh të ngushta dhe tradicionale, që ndjekin një disiplinë dhe pa module e kredite, sikurse kërkohet nga procesi i Bolonjës. Ato lipset t'u japin studentëve alternativa zgjedhjesh dhe fleksibilitet në studime. Këto mangësi të formimit janë një nga arsyet që një numër i konsiderueshëm i studentëve zgjedhin për të studiuar jashtë shtetit, dhe vetëm pak prej tyre kthehen në atdhe.

14. Matura Shtetërore dhe përdorimi i saj si mekanizëm përmes të cilit nxënësit fitojnë të drejtën për të hyrë në IAL, ka pasur zhvillime të rëndësishme në vitet e fundit. Ky mekanizëm ka nevojë të pasurohet e të përsoset më tej, duke u bazuar edhe në modele të përparura të vendeve të tjera. Hapat e mëtejshëm për zhvillimin e Maturës Shtetërore përcaktohen në planin e veprimit.

15. Për të pasur një mësimdhënie cilësore dhe me informacion të pasur, personeli akademik duhet të angazhohet në një punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike që t'i lejojë ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse. Kjo veprimtari duhet dalluar nga "kërkimi shkencor" fundamental i mirëfilltë, i cili nënkupton përftim rezultatesh origjinale. Në një vend të vogël si Shqipëria, duke pasur parasysh edhe stadin aktual të zhvillimit, kërkimi shkencor fundamental kjo veprimtari mund të përballohet ose të ndërmerret nga një numër relativisht i kufizuar punonjësish akademikë. Për këtë kategori punonjësish, financimi i kërkimit shkencor do të realizohet përmes një procesi konkurrues. Për përparimin në karrierë akademike të personelit është i nevojshëm një kontribut kërkimor i mjaftueshëm, i konkretizuar në gradën shkencore "Master" dhe "Doktor", si dhe një përvojë e mjaftueshme në mësimdhënie. Raporti midis kontributit në kërkimin shkencor dhe atij në mësimdhënie mund të përshtatet në përputhje me këto kritere nuk duhet të jenë të njëjta për të gjitha IAL-të, por të pasqyrojnë misionet e ndryshme të IAL. Sidoqoftë, titullarët e lëndëve/moduleve që zhvillohen në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve universitare duhet të kenë fituar gradën shkencore "Doktor".

16. Investimet për përmirësimin e mësimdhënies, në mënyrë të veçantë përsa i përket zbatimit të metodave bashkëkohore, kanë qenë të pamjaftueshme. Nuk ka ende një sistem të menaxhimit të performancës për personelin akademik, ndonëse ligji i AL (2007) e kërkon një gjë të tillë. Ngritja e këtij sistemi do të ndihmojë për të identifikuar pjesën e personelit akademik që përdor



metoda të vjetra mësimdhënie dhe që duhet të përfitojë nga kualifikimet përditësuese në mësimdhënie.

17. Në përgatitjen fillestare të mësuesve, kurrikulat janë shpesh të tejngarkuara dhe nuk tregohet vëmendje se çfarë programesh e lëndësh janë të nevojshme për një mësues të suksesshëm. Nuk zhvillohen aq sa duhet praktika të mbikëqyrura për mësimdhënien. Pak vëmendje është treguar për trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve. Tashmë është hartuar një dokument i politikave për këtë qëllim dhe Instituti i Kurrikulave dhe i Trajnimit (IKT) do të jetë në rolin e koordinatorit për identifikimin e nevojave, hartimin e katalogut kombëtar të trajnimeve dhe akreditimin e programeve. Përmirësimi i trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve do të ishte pa vlerë, nëse nuk do t'i kushtohej vëmendja e duhur ndryshimit të përgatitjes fillestare të mësuesve. Për të realizuar këtë ndryshim, strategjia përcakton rrugët e zbatimit dhe etapat.

18. Sigurimi i cilësisë, si koncept dhe praktikë, është futur që në vitin 1999 me ngritjen e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), e cila ka rritur rolin e saj dhe ka përmirësuar metodat e funksionimit. Por veprimtaria e saj nuk ka mbuluar të tre ciklet, në mënyrë të veçantë studimet me kohë të pjesshme, ndonëse në këto të fundit prurja e studentëve është dyfishuar në dhjetëvjeçarin e fundit. Një situatë e tillë lipset të ndryshojë.

#### **Çështjet financiare**

19. IAL-të financohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit, burime të cilat nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbështetur një përmirësim cilësor dhe zhvillimin sasior të tyre. Për më tepër, shpesh herë menaxhimi i këtyre burimeve ka lënë për të dëshiruar. Kapaciteti i disa prej ndërtesave, pajisjeve dhe bibliotekave, si dhe cilësia e shërbimit të ofruar prej tyre nuk është në standardet rajonale dhe sigurisht, jo në nivelet ndërkombëtare, megjithëse është jorealiste të mendosh se ato do të sillen në këto nivele në një të shkurtër. Edhe nivelet e pagës së personelit janë më ulëta sesa duhej të ishin, gjë që detyron personelin akademik të përfshihet në veprimtari të tjera, mjaft herë në dëm të cilësisë së punës në IAL.

20. Nevoja më urgjente dhe më e rëndësishme për investim është rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes zhvillimit të personelit akademik në IAL, i cili do t'i përgjigjet më mirë kërkesave në rritje të studentëve.

21. IAL-të nuk kanë pasur lirshmërinë e nevojshme për përdorimin e fondeve. Procedurat financiare kanë qenë të tilla që nuk i nxitnin IAL-të të gjeneronin më shumë të ardhura, pavarësisht disa përpjekjeve pozitive të bëra në këtë drejtim. Vetëm një pjesë e vogël e financimeve publike të alokuara IAL-ve llogariteshin mbi një bazë objektive, përjashtuar fondet për pagat. Për më tepër, metodat e përdorura për përcaktimin e këtyre financimeve nuk merrnin parasysh rezultatet dhe nivelet e IAL-ve. Me hyrjen në fuqi të ligjit AL (2007), IAL-ve u krijohet më shumë hapësirë për përdorimin efektiv dhe fleksibël të burimeve financiare. Rritja e mëtejshme e lirshmërisë së përdorimit të këtyre burimeve përbën një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit të autonomisë institucionale, por ajo duhet të shkojë krahas fuqizimit të kapaciteteve menaxhuese dhe rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërinë në përdorimin e fondeve. Ky ligj, gjithashtu, parashikon edhe zhvillimin e një metodologjie të re për alokimin e fondeve.

22. Tarifat e studimit të paguara nga studentët janë burimi tjetër i rëndësishëm i të ardhurave për IAL-të, por strukturimi i niveleve të ndryshme të tarifave nuk ka qenë racional. Gjithashtu, ka pasur pak transparencë në përdorimin e këtyre të ardhurave, e cila natyrisht ka shqetësuar ata që paguajnë. Mekanizmi për të ndihmuar studentët me të ardhura të pakta ka qenë i konceptuar jo mirë dhe për rrjedhojë nuk ka mbështetur përherë ata, të cilët realisht kanë pasur këtë nevojë.

#### **2. VIZIONI, PRIORITETET STRATEGJIKE DHE SYNIMET PËR ARSIMIN E LARTË**

23. Ndonëse niveli aktual i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor ka përmirësime në krahasim më të shkuarën, ai do të ishte i papranueshëm për të ardhmen. AL-ja dhe kërkimi shkencor duhet të evoluojnë, nëse Shqipëria dëshiron të ketë vendin e saj në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Shqipëria ka nevojë për qytetarë të formuar dhe edukuar më mirë, si edhe për një forcë pune më të aftë, me qëllim që të ndërtojë një shoqëri të së ardhmes, bazuar në dije. Për këto arsye, është vendosur që arsimit të jetë prioritet kryesor për shtatë vitet e ardhshme.

24. Objektivat kryesore për AL mbështeten në Strategjinë e Kombëtare për Zhvillim dhe

Integrimit (SKZHI). Ato përmblihen si më poshtë:

- Zhvillimi i shoqërisë dhe promovimi i standardeve të demokracisë nëpërmjet edukimit të studentëve për një jetë qytetare aktive.

- Zhvillimi ekonomik i vendit në përgjithësi dhe atij rajonal në veçanti nëpërmjet formimit të një force pune të kualifikuar.

- Përmbushja e aspiratave të brezit të ri për zhvillim.

- Zhvillimi dhe konsolidimi i një baze të gjerë e të përshtatshme dijesh në shërbim të vendit.

25. Për të përmbushur këto objektiva, duke u mbështetur në nevojat e shoqërisë, sistemi i AL-së do të krijojë, zhvillojë dhe transmetojë njohuritë nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ky i fundit, përveç vënies në shërbim të zhvillimit ekonomik e social të vendit, do të jetë edhe në funksion të përditësimit, dhe rifreskimit dhe zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve si të mësimin dhe ofrimit të shërbimeve.

Për realizimin e objektivave të mësipërme, dallohen pesë prioritete strategjike në shtatë vitet e ardhshme:

a) Zgjerimi i sistemit në mënyrë që të plotësohen nevojat e vendit në perspektivën e arritjes edhe të standarteve për integrimin në Bashkimin Europian (BE) (në kuptimin e treguesve për shkollimin terciar të popullsisë), duke krijuar njëkohësisht mundësi për arsimim të lartë të të gjithë atyre që dëshirojnë të përfitojnë prej tij.

b) Sigurimi i shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit.

c) Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve në sistemin e AL, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të kulturës së cilësisë.

d) Përmirësimi i mekanizmave të qeverisjes nëpërmjet zhvillimit të autonomisë së IAL-ve, përkundërit rritjes së cilësisë së menaxhimit me llogaridhënie dhe transparencë, në mënyrë që ato të funksionojnë realisht si institucione publike.

e) Përshtatja e metodave dhe e niveleve të financimit, në mënyrë që të inkurajohet i tërë sistemi për arritjen e objektivave të përgjithshme.

26. Objektivat dhe prioritetet strategjike kërkojnë investime të rëndësishme për AL-n dhe kërkimin shkencor. Këto shpenzime do të jenë rrjedhëse dhe për investime.

27. Procesi i ndryshimit të një sistemi kompleks, si ai AL, do të kërkojë kohë dhe është kjo arsyeja, për të cilën strategjia shtrihet në një periudhë prej shtatë vitesh. Me zhvillimet në vijim, mund të nevojiten ndryshime në ligjin e AL (2007).

28. Strategjia mbështetet mbi një analizë rigorozë të gjendjes aktuale të vendit; ajo merr gjithashtu në konsideratë zhvillimet ndërkombëtare. Kahu i propozimeve të saj është në përputhje me prirjet kryesore europiane dhe globale në AL. Si e tillë, kjo strategji synon të mbartë mbështetjen e gjerë të aktorëve të AL dhe politikëbërësve, si brenda dhe jashtë vendit.

### **3. POLITIKAT PËR PRIORITETET STRATEGJIKE**

#### **3.1 Përmasat e sistemit të arsimit të lartë**

29. Për të realizuar objektivat e mësipërme, zhvillimi i Shqipërisë do të kërkojë një zgjerim të sistemit të AL me kohë të plotë. Ky zgjerim do të shoqërohet edhe me ndryshimin e formës aktuale të sistemit. Zgjerimi do të ketë kosto financiare dhe është me vlerë nëse kryhet duke e transformuar AL në një sistem modern dhe cilësor. Me një sistem të reformuar, kostot e zgjerimit do të jenë më shumë investim për të ardhmen sesa thjesht shpenzim. Strategjia parashtro zhvillimet e politikave – si për sistemin ashtu edhe për çdo IAL. Plani i veprimit do të përmbajë detaje për reformat që do të realizohen, si pjesë integrale e çdo zgjerimi.

30. Niveli i zgjerimit të sistemit të AL duhet të jetë në përputhje me objektivin afatgjatë të integritetit të vendit në BE dhe me kërkesën. Dy aspekte të kërkesës merren në konsideratë: nevojat e ardhshme të tregut të punës dhe dëshirat e studentëve për të hyrë në sistemin e AL. Ndonëse nuk ka konstatime për kërkesa të paplotësuara për të diplomuarit nga AL në përgjithësi, por hasen nevoja të paplotësuara në veçanti. I tillë është rasti i vendeve të paplotësuara të punës për specialistë të IT-së në mbarë vendin dhe mësues në zona të largëta. Si një ekonomi në tranzicion, kushtet e tregut të punës në vend janë larg të qenit të stabilizuara dhe për pasojë duhet që zgjerimi i sistemit të jetë gradual dhe jo i menjëhershëm.

31. Plani Kombëtar i Zhvillimit ka përcaktuar tre sektorë më prioritarë: Turizmin, industrinë agro-ushqimore dhe zhvillimin e eksporteve në përgjithësi. Këto prioritete do të pasqyrohen edhe në miratimin e kuotave në rritje të numrit të studentëve në IAL. Në vitin 2005-2006 vetëm 13 % e studentëve ndiqnin programe studimi në drejtime, si matematika, fizika, informatika dhe shkencat inxhinierike në përgjithësi. Ky raport, i krahasuar me 26%, që është mesatarja e vendeve të BE-së, sugjeron ndërmarrjen e një studimi për të gjykuar nëse duhen vendosur objektiva më të lartë pjesëmarrjeje në formimet e mësipërme, bazuar në nevojat e zhvillimit të vendit dhe përvojat analoge në rajon dhe më gjerë.

32. Numri i të punësuarve në sektorin privat po rritet me shpejtësi. Një numër i madh të diplomuarish do të punësohen në të ardhmen në veprimtari të sektorit privat që sot mund të mos ekzistojnë - dhe ata duhet të jenë të përgatitur për t'u riorientuar profesionalisht dhe ripunësuar disa herë gjatë jetës së tyre. Përvoja e vendeve të tjera sugjeron dy konsiderata të rëndësishme lidhur me trajtimin e nevojave perspektive të tregut të punës. E para, është që të diplomuarit duhet të jenë të përgatitur me shprehje të përgjithshme dhe të transferueshme, si ato të analizës, të të menduarit, arsyetimit, paraqitjes dhe komunikimit. Tregu i punës në Shqipëri ndoshta ende nuk e koncepton plotësisht nevojën e një përgatitjeje të tillë, prandaj mund të kërkojnë veprime aktive nga ana e qeverisë për të inkurajuar punëdhënësit që të njohin dhe t'u përgjigjen sfidave të së ardhmes. AL në Shqipëri aktualisht nuk kultivon si dhe sa duhet krijimin e shprehive të tilla, ndërkohë që prej tij pritet të luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e një ekonomie dhe shoqërie të bazuar në dije. Për këtë do të kërkojnë kurse dhe programe të reja formimi, por ajo që është më e rëndësishmja - ndryshime thelbësore në kurrikulat e studimeve universitare të ciklit të parë dhe të dytë.

33. Konsiderata e dytë, që buron nga përvoja e vendeve të tjera, veçanërisht e atyre të Europës Lindore dhe Qendrore, është se formimet 2-vjeçare pas shkollës së mesme, do të marrin një rëndësi më të madhe. Këto formime, që i përgjigjen një shkollimi të lartë jouniversitar, sigurojnë diploma profesionale, si dhe tituj të tjerë kualifikimi, me orientim të fortë nga tregu. Ato mund t'i japin një nxitje të rëndësishme zhvillimit të biznesit të vogël dhe industrive të reja, veçanërisht në nivel lokal. Aktualisht ka disa nisma pozitive në këtë drejtim, por shtrirja e tyre është tepër e kufizuar dhe përvoja e grumbulluar, e pakët.

34. Zhvillimi i formimeve postsekondare 2-vjeçare duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat. Plani i veprimit parashikon që një grup i posaçëm pune të studiojë nevojat për diploma 2-vjeçare si dhe, mënyrën e organizimit të tyre. Zhvillimi i kurseve përkatëse pritet të kërkojë edhe motivimin financiar të IAL-ve për t'u përfshirë në një veprimtari të tillë. Në planin e veprimit do të parashikohen fonde të posaçme për këtë qëllim, të cilat IAL-të do të mund t'i përftojnë nëpërmjet konkurrimit. Formimet jouniversitare duhen konsideruar si pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe duhen konceptuar në mënyrë të tillë, që të lejojnë studentët e suksesshëm të vazhdojnë (nëse dëshirojnë) ciklin e parë të formimit universitar, nëpërmjet transferimit të krediteve.

35. Zgjerimi i AL është një prioritet që do të ndiqet në vijimësi, por pa cenuar cilësinë. Ky zgjerim nuk mund të jetë më i shpejtë se rritja e kontingjentit të përshtatshëm për shkollim të lartë, që kushtëzohet nga evolucioni i sistemit parauniversitar. Në vitin 2006-2007 u arrit që mbi 90% e atyre që përfunduan shkollën e mesme të regjistrohen në arsimin e lartë (pa përfshirë shkollimet jashtë vendit), por cilësia e një pjese të këtij kontingjenti linte mjaft për të dëshiruar. Objektivi, lidhur me arsimin e mesëm, është që në vitin 2015 pjesa më e madhe e kontingjentit të kësaj grupmoshe (rreth 80 %, kundrejt 53% në vitin 2006), të përfshihen në një formë ose tjetër të arsimit të mesëm, i cili do t'i nënshtrohet një reforme të thellë me synim kryesor, rritjen e cilësisë. Objektivi, lidhur me AL, është që deri në vitin 2017, mbi 85% e kontingjentit që përfundon shkollën e mesme, të hyjë në një nga drejtimet dhe ciklet e AL. Kjo nënkupton që numri i studentëve në të gjitha ciklet e studimeve tretësore (postsekondar, bachelor, master dhe doktoratë) dhe format e studimeve (kohë e plotë, kohë e pjesë, edukim në distancë) në vitin 2013 të jetë mbi 120 000, krahasuar me rreth 91 000 aktualisht (gjendja korrik 2008). Ky zgjerim, me afro 30 000 studentë për një periudhë 5-vjeçare, është rrjedhojë e rritjes së pritshme vjetore të kontingjentit të nxënësve që përfundojnë me sukses shkollën e mesme, e cila është 2 - 3%, (ii) hapjes së studimeve të ciklit të

dytë (master), dhe (iii) zgjerimit të AL privat.

36. Ky objektivi zgjerimi është ambicioz dhe do të shqyrtohet më në detaje në planin e veprimit. Një pjesë e zgjerimit do të realizohet sigurisht në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të programeve universitare dhe kryesisht në IAL-të, që i ofrojnë të tre këto cikle; pjesa tjetër, që mendohet se do të jetë më e madhe, do t'u takojë formimeve të ndërmjetme apo jouniversitare (zakonisht 2-vjeçare). Këto, jo vetëm do të sigurojnë kualifikime me impakt të menjëhershëm më të madh për tregun e punës dhe me kurrikula që mund të përshtaten sipas nevojave lokale, por do të jenë edhe me kosto më të ulët, krahasuar me një cikël të parë të plotë. IAL-të me orientim rajonal janë mjedisi më i përshtatshëm për krijimin dhe zhvillimin e formimeve të tilla që përfshijnë edhe trajnime/ritrajnime në funksion të nevojave të sektorit privat në rajon dhe tregut të punës. Ofrues të tjerë potencialë diplomash të tilla do të jenë, nëse plotësojnë kushtet e akreditimit, edhe institucionet private, me tarifa që paguhen nga vetë studentët ose që sponsorizohen nga punëdhënësit.

37. Rritja e numrit të studentëve duhet të shkojë krahas rritjes së kapacitetit të sistemit për të ofruar një shërbim që respekton standardet. Për këtë duhet të sigurohet, së pari, numri i nevojshëm i personelit akademik me kualifikim të përshtatshëm. Raporti aktual student/personel akademik (mesatarisht rreth 26 në fund të vitit 2007) ishte ende larg mesatares së BE (20), në të cilën nuk përfshihet personeli kërkimor, i cili është kryesisht grupi i studentëve të doktoratës, i cili edhe pse nuk ka ngarkesë mësimore të planifikuar mbështet profesorët dhe docentët në seancat mësimore si ushtrime, laboratore dhe seminare. Ky raport duhet të përmirësohet krahas rritjes së numrit të studentëve në sistemin e AL. Mbi këtë bazë, shtesa prej rreth rreth 30 000 studentësh në 5 vjet, do të kërkojë shtesë vjetore të personelit mësimdhënës, në AL publike dhe private, prej rreth 2000 veta, pa llogaritur këtu edhe nevojën për zëvendësimin e atyre që largohen apo dalin në pension. Vetëm në vitin 2008 në sistemin e AL publik u shtuan 583 vende të reja pune për personel mësimor kërkimor. Përveç këtyre sistemit iu shtuan edhe rreth 400 punonjës të tjerë kërkimorë – mësimorë si rrjedhojë e zbatimit të reformës së integritimit të instituteve kërkimore të Akademisë së Shkencave dhe ministrive të linjës në sistemin e AL. Rruga kryesore për zgjidhjen e problemit të personelit do të jetë punësimi i pedagogëve të rinj, duke synuar në veçanti tërheqjen e kontingjentit cilësor të të shkolluarve dhe të të kualifikuarve jashtë vendit nëpërmjet mekanizmave motivues. Në funksion të kësaj të fundit qeveria ka ndërmarrë, që në vitin 2006, programin afatgjatë Brain Gain, i cili parashikon një paketë nxitëse që lehtëson kthimin e përhershëm ose të përkohshëm të kandidatëve që kanë përfunduar me rezultate mbi mesatare, studimet e masterit ose doktoratës në shkolla të larta të huaja të akredituara.

38. Shumica e personelit të ri akademik, të kërkuar nga zgjerimi i sistemit (personelit shtesë), do të përqendrohet në rolin mësimdhënës, kryesisht në ciklin e parë dhe në programet e ndërmjetme jouniversitare. Për këtë kërkohet një kualifikim në nivelin Master dhe doktorata (PhD). Plani i veprimit parashikon zhvillimin e një procesi monitorues, i cili:

- do të përcaktojë nevojat për personel të ri;
- do të vlerësojë shkallën në të cilën këto nevoja do të plotësohen nga integrimi i instituteve kërkimore në AL;
- do të verifikojë nëse konceptimi i programeve të reja Master, potencialisht të aftë për të furnizuar këtë shtesë personeli akademik, siguron fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur nevojave në momentin që ato shfaqen.

39. Rritja e nivelit të mësimdhënies në IAL-të nuk është thjesht çështje numrash; ajo kushtëzohet në radhë të parë prej faktit se janë ende të pakët pedagogët që operojnë me metoda që zhvillojnë tek studentët ato shprehje dhe kompetenca, që u duhen atyre për të ardhmen. Ndryshimi i stilit dhe metodave të mësimdhënies kërkon një investim madhor në zhvillimin e personelit akademik ekzistues, duke përfshirë, së pari pedagogët e vjetër; po ashtu i domosdoshëm është edhe trajnimi i personelit të ri. Për shumë nga personeli ekzistues, do të nevojitet një investim më vete, që do të jetë i kushtueshëm, por duke e konsideruar zhvillimin e burimeve njerëzore si një prioritet të lartë, atij do t'i kushtohet një mbështetje e veçantë financiare.

Për të mbështetur zhvillimin e shpejtë të burimeve njerëzore në AL qeveria ka filluar të zbatojë që në vitin 2007 një program ta veçantë të emërtuar "Fondi i Ekselencës", i cili ofron bursa për personelin e ri akademik që dëshiron të kryejë një pjesë ose të gjitha studimet e doktoratës dhe

postdoktoratës në universitetet e huaja, të njohura. Ky program mbështet edhe studentët shqiptarë që kryejnë studimet e nivelit master në një nga 10 universitetet më të mira të botës.

40. Aspekti i dytë, lidhur me zgjerimin e sistemit, ka të bëjë me burimet fizike të ndërtesave dhe pajisjeve. Aktualisht, mjediset e IAL-ve përdoren përgjithësisht jo në mënyrë efektive gjatë javës, dhe gjatë vitit; një përdorim në një shkallë më të lartë i mjediseve dhe pajisjeve në orët e pasditës dhe gjatë fundjavës, do të rriste mundësinë e sistemit për zgjerim. Disa fakultete brenda një IAL-je kanë mungesë hapësire dhe të tjerë e kanë atë me tepri; të gjitha fakultetet duhet të pranojnë se ndërtesat dhe klasat i përkasin IAL-së në tërësi dhe jo fakulteteve të veçanta, pavarësisht origjinës së financimit të tyre. Një organizim më racional i shfrytëzimit të mjediseve do të lejonte rritjen e numrit të studentëve edhe pa zgjerime ekuivalente të hapësirës në dispozicion të IAL-ve. Shifra të detajuara në këtë drejtim nuk ka dhe plani i veprimit parashikon një studim urgjent lidhur me përdorimin dhe kushtet e mjediseve dhe të infrastrukturës së IAL-ve.

41. I njëjti problem shtrohet edhe për përdorimin e pajisjeve, megjithëse duhet pranuar se mungesa e pajisjeve të përshtatshme për mësimdhënie moderne është e evidente. Përsëri, nuk disponohet informacion i detajuar për shkallën e shfrytëzimit të pajisjeve ekzistuese dhe as për përmasat e mungesave. Studimi i mësipërm, do të shqyrtojë rrugët e rritjes së efektivitetit të përdorimit të pajisjeve dhe do të bëjë një vlerësim realist të asaj që nevojitet për të sjellë standardin e tyre në nivel të pranueshëm për një perspektivë 10-vjeçare. Ky studim do t'u referohet edhe gjendjes dhe përvojave analoge të vendeve të tjera europiane me kushte ekonomike të afërta me ato të Shqipërisë. Përmirësimi i nivelit të pajisjeve do të ketë si synim prioritar modernizimin e metodave të mësimdhënies dhe në përgjithësi rritjen e cilësisë së procesit mësimor, pa përjashtuar edhe zhvillimin e kërkimit shkencor, kur kjo është e mundur.

42. E treta, e cila është thelbësore, ka të bëjë me përshtatshmërinë e mbështetjes financiare në të ardhmen. Qeveria është e angazhuar të dyfishojë fondet publike për arsimin në 5 vitet e ardhshme. Parashikohet që AL-ja të ruajë përqindjen aktuale në buxhetin total të arsimit, por ajo të jetë kryesisht për kostot rrjedhëse dhe jo për investime kapitale. Mbështetja financiare nga burime të tjera, përfshirë kontribute private dhe ndihmë nga agjenci shumëpalëshe apo dypalëshe, është një nga mundësitë që do të shfrytëzohet. Plan i veprimit do të bashkërendojë mundësitë e financimit nga burime të ndryshme.

43. Pavarësisht kufizimeve, mendohet se objektivi për zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë mund të realizohet pa prekur cilësinë e tij.

44. Zgjerimi i sistemit, nuk do të bëhet me krijimin e institucioneve të reja të AL publike, por me zgjerimin e atyre ekzistuese, në mënyrë të veçantë ato rajonale. Pjesa më e madhe e zgjerimit do të jetë për formimet e larta jouniversitare dhe të ciklit të parë të studimeve, në varësi edhe të rezultateve e përfundimeve që do të arrijë grupi i punës për diplomat. Në të njëjtën kohë, synohet të zgjerohet llojshmëria e lëndëve, e cila aktualisht është e ngushtë, në mënyrë që nga njëra anë të sigurohet një formim më i plotë për studentët dhe nga ana tjetër të ofrohen më shumë mundësi zgjedhjeje të kombinimeve të lëndëve.

45. E ardhmja e studentëve me kohë të pjesshme është e paqartë. Aktualisht shumë nga ata që mbarojnë shkollën e mesme ndjekin studimet me kohë të pjesshme, pasi rezultatet e tyre kanë qenë të pamjaftueshme për të fituar studimet me kohë të plotë në degët që kanë synuar. Ndonëse kjo përmbush një pjesë të kërkesës, ky nuk është qëllimi kryesor për këtë formë studimi, i cili duhet të jetë për ata studentë që nuk kanë mundësi reale për të ndjekur studimet me kohë të plotë (p.sh. për ata që janë të punësuar). Ekzistojnë edhe shqetësime të tjera në lidhje me formën e organizimit të studimeve me kohë të pjesshme. Së pari, standardet e hyrjes për studentët me kohë të pjesshme duhet të jenë të barasvlefshme me ato të studentëve me kohë të plotë, përndryshe standardet e AL në tërësi do të pësojnë rënie. Nëse maturantët do të jenë të formuar për të ndjekur studimet e larta, sistemi duhet të jetë në gjendje t'i pranojë me kohë të plotë; nëse nuk i plotësojnë këto standarde, atëherë në asnjë mënyrë ata nuk duhen pranuar. Së dyti, vlera e arsimit me kohë të pjesshme merret e barasvlefshme me atë me kohë të plotë, ndërkohë që numri i orëve të studimeve është vetëm sa dy të tretat. Së treti, tarifrat që paguhen nga studentët me kohë të pjesshme sigurojnë një të ardhur shtesë të konsiderueshme për personelin akademik, dhe kjo përbën rrezik për të shmangur

vëmendjen e tyre nga mësimi te studentët me kohë të plotë.

46. Sistemi i studimeve me kohë të pjesshme është tepër i vlefshëm për ata që mund ta ndjekin vetëm këtë formë studimi, p.sh. për shkak të marrëdhënieve të punës ose angazhimeve familjare. Studentë të tillë sigurisht ka dhe do të ketë më shumë kur të nxënësit gjatë gjithë jetës do të bëhet veprimtari normale e një ekonomie në rritje. Qëllimi kryesor për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme është që t'u shërbejë nevojave të këtyre studentëve dhe punëdhënësve të tyre. Shumë nga këta studentë do të jenë në moshë më të madhe, dhe, kjo formë studimi duhet rregulluar në përshtatje me nevojat e tyre, p.sh. kurse të shkurtra formimi për të nxënësit gjatë gjithë jetës. Sistemi i studimeve me kohë të pjesshme nuk duhet të shërbejë si alternativë për maturantët që nuk plotësojnë kriteret për t'u regjistruar në studimet me kohë të plotë. Efekti i këtij ndryshimi do të jetë zvogëlimi në mënyrë të ndjeshme i numrit të studentëve me kohë të pjesshme, që do të çojë në zvogëlimin e të ardhurave për IAL dhe për personelin akademik. Politika për këtë formë studimi duhet të jetë pjesë e një strategjie më të gjerë për "të nxënësit gjatë gjithë jetës", përfshirë "mundësitë e hapura". Këto çështje janë komplekse dhe plani i veprimit parashikon ngritjen e një grupi pune për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme dhe të nxënësve gjatë gjithë jetës, i cili të analizojë gjendjen dhe të përgatisë rekomandimet e duhura.

47. Në kuadrin e zgjerimit të sistemit, do të ketë rritje edhe në institucionet private, krahasuar me totalin aktual prej afro 10 000 studentësh (gjendja korrik 2008). Roli i tyre në plotësimin e nevojave të shoqërisë për arsim të lartë do të vijë duke u fuqizuar. APAAL-i do të vazhdojë të aplikojë një sistem rigoroz të sigurimit të cilësisë për IAL-të private, për të mbrojtur interesat e studentëve të tyre dhe për të garantuar që ato të veprojnë brenda një kuadri me standarde të qarta. Gjithashtu, për të mbrojtur interesat e studentëve në IAL-të publike, do të forcohet kërkesa aktuale që personeli i tyre akademik të japë eventualisht mësim në IAL-të private, vetëm brenda rregullave të institucionit publik. Strategjia përshkohet nga ideja se pavarësisht rritjes së numrit të studentëve në IAL-të private, kërkesa për arsim të lartë do të mbulohet kryesisht, edhe në të ardhmen, nga IAL-të publike. Arsimi i lartë është dhe do të mbetet përgjegjësi publike.

48. Zgjerimi i ndjeshëm i sistemit përkon me zhvillimin e vazhdueshëm të Maturës Shtetërore, si mjet nëpërmjet së cilës sigurohet hyrja në IAL. Planin e veprimit do të përmbajë hapat dhe procedurat për Maturën Shtetërore, duke punuar me Agjencinë e Vlerësimit të Arritjeve (AVA). Synimi kryesor për zhvillimin e Maturës Shtetërore është që të bëhet një provim më i plotë, të paktën për lëndët bazë, të hartuara dhe administruara në mënyrë të centralizuar. Matura Shtetërore do të ketë një bërthamë me lëndë të detyrueshme në dy nivele. Për lëndët me zgjedhje synohet në zgjerimin e llojshmërisë së tyre, të cilat, po ashtu do të zhvillohen në dy nivele.

49. Me një bazë lëndësh formuese për Maturën Shtetërore, do të bëhet e mundur të zhvillohet një sistem i kompjuterizuar për shpërndarjen e studentëve në IAL-të (sikurse bëhet në vende të tjera europiane). Ky sistem do të orientohet nga pragu i hyrjes, bazuar në lëndët e përcaktuara nga fakultetet dhe do të marrë për bazë preferencat e studentëve dhe rezultatet e provimeve. Planin e veprimit parashikon ngritjen e një organi të ri: Agjencia për Pranimit në Institucionet e Arsimit të Lartë (APIAL). Matura Shtetërore e plotë, së bashku me sistemin e ri të pranimeve në IAL-të, është planifikuar të realizohet deri në vitin 2010.

50. Me qëllim që të ndihmohen studentët të bëjnë zgjedhjet e tyre për kurset e studimeve të arsimit të lartë, nga IAL-të do të kërkohet të përgatisin një Prospectus, posaçërisht për kandidatët e mundshëm. Sidoqoftë ky Prospectus nuk do jetë i mjaftueshëm për kandidatët që të bëjnë zgjedhjet për të ardhmen e tyre. Për këtë arsye, planin e veprimit përfshin ngritjen e një grupi për karrierën, i cili do të ndihmojë kandidatët të orientohen për të ardhmen e tyre. Ky grup do të japë edhe sugjerime për përmbajtjen e Prospectus-it që do përgatisin IAL-të. Anëtarët e grupit për karrierën do të përfshijnë interesat e shkollës, të AL dhe punëdhënësve.

### **3.2. Misionet e diferencuara të IAL-ve: Mësimi, shërbimet dhe kërkimi shkencor**

51. Aktualisht sistemi i AL-ve funksionon sikur të gjitha IAL-të të ishin të njejta, por në fakt, ka dhe duhet të ketë dallime të rëndësishme mes tyre. Diferencimi i misioneve të IAL-ve është domosdoshmëri. Ai duhet të jetë i tillë që çdo IAL t'i shërbejë më efektivisht nevojave të vendit. Ky diferencim do të ketë implikimet e veta në strukturën dhe funksionet e tyre.

### **Diferencimi i misioneve**

52. Mësimi në IAL-të rajonale do të vazhdojë të orientohet me përparësi drejt formimeve profesionale, në veçanti të mësuesve për sistemin e arsimit bazë, specialistëve të IT, si dhe të infermierëve, punonjësve socialë, menaxherëve, asistentëve ligjorë etj. Këto formime do të realizohen me kurse të ciklit të parë universitar, me përjashtime të mundshme për mësuesinë. Kuadri i Bolonjës nuk i pengon IAL-të rajonale të ofrojnë vetëm ciklin e parë, kur nuk ekzistojnë kushtet apo nevojat për të zhvilluar të tre ciklet. Ndërkohë, ato do të kenë një rol shumë të rëndësishëm në ngritjen dhe konsolidimin e programeve postsekondare 2-vjeçare. Të tre ciklet e studimeve universitare do të ofrohen vetëm nga ato IAL, në Tiranë apo në rrethe, që përmbushin standardet.

53. Strategjia nuk synon të kufizojë IAL-të rajonale vetëm në ofrimin e ciklit të parë. Ky pozicion nuk është i ngurtë, si për studentët, ashtu edhe për këto institucione. Për studentët e IAL-ve rajonale, nëpërmjet bashkëpunimit me IAL-të që i ofrojnë të tre ciklet (aktualisht, tre universitetet kryesore në Tiranë), do të mundësohet hyrja në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, me kusht, gjithmonë që ata (studentët) të plotësojnë kriteret e vendosura për këtë qëllim. Në fakt, kjo transferueshmëri është një nga objektivat kryesore të Procesit të Bolonjës. Ligji i AL (2007) e bën të qartë, që IAL-të rajonale do të kenë mundësi për të ofruar ciklin e 2-të ose edhe të 3-të në një fushë apo drejtim të caktuar, në rast se provojnë se kanë plotësuar kriteret kombëtare për atë fushë apo drejtim. Kriteret përcaktohen nga KALSH-i, bazuar në rekomandimet e APAAL-it dhe verifikohen nga kjo e fundit.

54. Është e pritshme që IAL-të rajonale (pa përjashtuar edhe ato private), të jenë në pararojë të zhvillimit të programeve postsekondare 2-vjeçare dhe të jenë ofruesit kryesorë të diplomave të tyre. IAL-të rajonale do të bëhen në këtë mënyrë edhe përfituesit kryesorë të fondeve për zhvillim, që do të akordohen nga qeveria, pikërisht, për këtë qëllim. Ato do të përfitojnë nga tarifat e shkollimit në këto programe, duke rritur në këtë mënyrë të ardhurat e tyre. APAAL do të zhvillojë kriteret të veçanta për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve 2-vjeçare.

55. Orientimi i IAL-ve rajonale drejt formimeve profesionale, do të forcojë kontributin e tyre në ndihmë të zhvillimit ekonomik e social të rajonit përkatës. Strategjia synon që këto IAL të identifikohen gjithnjë e më tepër si “Qendra të Zhvillimit Rajonal”, me lidhje të forta me komunitetin lokal dhe me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të këtij komuniteti. Marrja e një roli të tillë nga IAL-të rajonale do të forcojë identitetin i tyre; ato do të jenë shumë më specifike dhe më të njohura nga sa janë aktualisht.

56. Roli i IAL-ve rajonale në ndihmë të zhvillimit ekonomik dhe social, nënkupton që ato, krahas mësimin, do të ofrojnë konsulencë, kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime të tjera, duke përfutur në këtë mënyrë edhe të ardhura shtesë. “Klientët” potencialë për këto shërbime do të jenë komunitetet dhe bizneset lokale, organet qeverisëse, vendore dhe qendrore, dhe organizata donatore të ndryshme; të gjithë këta, veçanërisht Ministrinë dhe donatorët, do të inkurajohen të përdorin shërbimet e ofruara prej IAL-ve. Në planin e veprimit do të përcaktohen financime të posaçme - fonde nxitëse - për të ndihmuar IAL-të rajonale të zhvillojnë këtë rol. Çdo IAL-je do t’i kërkohet të paraqesë një plan të detajuar dhe të shoqëruar me kostot, që të demonstrojë se çfarë shërbimesh synon të zhvillojë. Ky plan do të shqyrtohet nga KALSH-i, dhe në rast miratimi, të paktën një pjesë e kostove të nisjes së veprimtarive përkatëse do të mbulohen nga fondi nxitës.

57. Në të njëjtën mënyrë dhe me strategji të ngjashme, tre universitetet kryesore në Tiranë do të ndihmojnë për zhvillimin e komunitetit dhe bizneseve lokale. Ato do të jenë në gjendje të ofrojnë një llojshmëri më të gjerë shërbimesh në sajë të integritimit në to të instituteve kërkimore, nga ku pritet të gjenerohen të ardhura shtesë të konsiderueshme për këto universitete. Ato duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë shërbime të tilla pa nevojën për fonde nxitëse, të cilat do të destinohen për IAL-të rajonale.

58. Procedurat, që u lejojnë IAL-ve të lidhin kontrata për shërbimet që ofrojnë, kanë pësuar ndryshime në drejtim të thjeshtëzimit të tyre. Por, këto ndryshime nuk janë përvetësuar dhe shfrytëzuar sa duhet nga IAL-të. Në planin e veprimit do të parashikohen masa për të aftësuar dhe inkurajuar IAL-të në shfrytëzimin e të gjitha mundësive ligjore për gjenerim të ardhurash. Në kuadrin e këtij plani, grupi i punës për financat, do të studiojë mundësinë e lehtësimeve të tjera për

ato procedura që ende kërkojnë miratim nga organet qendrore, si ato për ngritjen e ndërmarrjeve apo për mënyrën e përdorimit të të ardhurave.

59. Kostoja e lartë e kërkimit shkencor imponon fokusimin në mënyrë selektive të disa fushave apo drejtimeve prioritare; vetëm kështu mund të maksimalizohet impakti i tij - një praktikë e tillë ndiqet, madje, edhe në vendet e pasura. Përzgjedhja e fushave dhe drejtimeve prioritare do të bëhet nga një organizëm i posaçëm në varësi të KALSH-it, Grupi për Strategjinë e Kërkimit Shkencor. Detyrë e këtij Grupi do të jetë edhe monitorimi i zbatimit të strategjisë për kërkimin shkencor, si dhe rishikimi dhe përditësimi i saj, për t'iu përgjigjur në vijimësi zhvillimeve të brendshme dhe të jashtme.

60. Strategjia e kërkimit shkencor do të shërbejë si platformë për vendimmarrjen lidhur me fushat ku do të orientohen programet e kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor akademik do të financohet në bazë projekti, nëpërmjet një procedure transparente konkurrimi, ku përzgjedhja e fituesve do të bëhet sipas meritës. Zhvillimi i kësaj procedure do të jetë një detyrë tjetër e Grupit për Strategjinë e Arsimit të Lartë. Për këtë ai do të mbështetet nga disa panele ekspertësh, bazuar në ndarjen e kërkimit shkencor në disa fusha të gjera, për shembull, tre. Çdo panel do të përbëhet nga personalitete të fushës dhe njëri prej tyre mund të jetë edhe ekspert i huaj. Plani i veprimit do të përcaktojë në detaje mënyrën e konstituimit të Grupit për Strategjinë e Kërkimit Shkencor, detyrat dhe kompetencat që ai do të ketë dhe në veçanti, procedurën e alokimit të fondeve.

61. Parashikohet që në Grupin për Strategjinë e Kërkimit Shkencor të përfshihen drejtuesit e paneleve - si rregull, anëtarë të KALSH-it, një përfaqësues i MASH-it, përfaqësues të sektorëve industrialë apo prodhues, që përfitojnë drejtpërdrejt nga kërkimi shkencor, si dhe personalitete të shquara nga fushat kryesore të kërkimit shkencor (që mund të jenë edhe anëtarë të paneleve përkatëse). Përbërja e Grupit për Strategjinë e Kërkimit Shkencor do të shqyrtohet më konkretisht në planin e veprimit.

62. Për arsye objektive, të paktën në këtë fazë të zhvillimit të vendit, vëllimi i kërkimit shkencor do të jetë relativisht modest, dhe pjesa më e madhe e tij do të realizohet në universitetet kryesore të Tiranës, të fuqizuara tashmë nga integrimi i Instituteve Kërkimore. Ky integrim do të krijojë mundësinë e racionalizimit të kapaciteteve kërkimore në nivel kombëtar, në përputhje me prioritetet e Strategjisë së Kërkimit Shkencor; kjo është dhe arsyeja e urgjencës për hartimin e kësaj strategjie. Për të ndihmuar procesin e integrit të Instituteve Kërkimore dhe racionalizimin e kërkimit që vjen si rrjedhojë, plani i veprimit parashikon mundësinë e alokimit të fondeve në bazë rastesh dhe nevojash të argumentuara nga universitetet e interesuara. Këto fonde do të sigurohen në një shkallë të madhe prej kursimeve të realizuara nga rritja e efijencës së administrimit të burimeve njerëzore dhe materiale me integrimin në universitete të Instituteve Kërkimore të mëparshme. Që këtë buron një detyrë tjetër e rëndësishme e Grupit për Strategjinë e Kërkimit Shkencor, që ka të bëjë me hartimin e një plani për racionalizimin e kapaciteteve kërkimore në shkallë vendi, dhe për shpërndarjen e fondeve në funksion të këtij racionalizimi.

63. IAL-të rajonale do të ndërmarrin veprimtari të ndryshme praktike në shërbim të komuniteteve e tyre lokale, por ato, natyrisht, do të kenë të drejtë, si të gjitha IAL-të, të konkurrojnë me projekte akademike të kërkimit shkencor - nëse zotërojnë realisht kapacitetet e nevojshme për ndërmarrjen e tyre. Për t'i ndihmuar IAL-të rajonale për t'u specializuar në një ose disa drejtime të kërkimit shkencor, për shembull, në sferën e arsimit, atyre do t'u alokohen fonde, të cilat ato do të gjykojnë vetë si t'i përdorin, në bazë të strategjisë së tyre për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore.

#### **Rrjedhime lidhur me raportin e ngarkesës së punës për personelin akademik**

64. Diferencimi i misioneve të IAL-ve do të ketë rrjedhimet e veta edhe në raportin e ngarkesës së personelit akademik. Pavarësisht këtij diferencimi, mësimdhënia do të jetë detyrë kryesore e të gjithë këtij personeli dhe prej secilit do të pritët që të aftësohet dhe kualifikohet vazhdimisht për të ngritur dhe përditësuar nivelin e mësimi që zhvillon, si në aspektin pedagogjik, ashtu edhe në atë të përmbajtjes.

65. Kërkimi i aplikuar, konsulenca dhe veprimtaritë zhvilluese (të cilat nuk janë të natyrës për t'u pasqyruar në botime shkencore), duhet të jenë shërbime që të gjitha IAL-të u ofrojnë komuniteteve dhe bizneseve lokale, si në Tiranë edhe në rrethe. Prandaj, çdo pjesëtar i personelit



akademik (pa përjashtuar edhe atë ndihmës), pritet të kontribuojë në këto lloj veprimtarish. Po ashtu, i gjithë personeli duhet të jetë i disponueshëm për kryerjen e detyrave administrative të kërkuara nga IAL-të.

66. Kërkimi shkencor i mirëfilltë, në ndryshim me sa më sipër, do të kryhet nga një pjesë e kufizuar e personelit akademik; nuk mendohet që i tërë personeli doemos të përfshihet në këtë lloj kërkimi. Këtu nuk përfshihet procesi i përfutimit dhe i rifreskimit të dijeve, që ndihmon në mësimdhënie dhe që është detyrë parësore e çdo anëtari të personelit akademik. Kërkimi shkencor i mirëfilltë do të ndërmerret nga pjesa e personelit akademik, e cila ka qenë e suksesshme në konkurrim për fitimin e financimeve të projekteve kërkimore, ose nga ajo pjesë e tij që punon në një fushë të përcaktuar nga IAL-të për zhvillimin e kapaciteteve për kërkim shkencor të mirëfilltë. IAL-ja, në këtë rast, mbulon shpenzimet me fonde të brendshme të saj. Për pjesën tjetër të personelit akademik, e gjithë koha e punës duhet të vihet në dispozicion të mësimdhënies, shërbimeve që ofron IAL-ja, detyrave administrative dhe kërkimit shkencor të aplikuar.

67. Përsa i përket ngarkesës akademike, mund të ketë konceptime të ndryshme të saj për IAL të ndryshme, madje edhe për fakultete të ndryshme brenda një IAL-je. Gjithsesi, ngarkesa akademike përfshin katër lloje veprimtarish:

- mësimdhënie (së bashku me kualifikimin e vazhdueshëm profesional),
- kërkim shkencor, zhvillim dhe transferim të teknologjisë dhe njohurive,
- mbështetje për institucionin.

68. Strukturat e IAL-ve do të miratojnë në mënyrë institucionale ngarkesën akademike për çdo pjesëtar të personelit të tyre dhe do të vlerësojnë performancën në secilin zë të veprimtarive të mësipërme (për mësimdhënien do merret parasysh raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë si edhe opinioni i studentëve). Plani i veprimit do të përfshijë udhëzimet drejtuar IAL-ve, për konceptimin dhe zhvillimin e rregullave lidhur me vlerësimin e performancës.

69. Konceptimet e ndryshme të ngarkesës do të kenë ndikime të rëndësishme mbi kriteret e punësimit të personelit akademik dhe të progresit në karrierë. Aktualisht nuk është rregulluar përputhja e gradave shkencore e titujve akademik me vendet e punës. Titulli akademik "Profesor" nuk nënkupton një vend pune të profesorit, siç ndodh në shkollat e huaja. Kjo ka bërë që edhe kriteret për kërkimin e titujve akademik janë të njëjta për të gjithë IAL-të.

70. KALSH-i do të rekomandojë kriteret e punësimit dhe të karrierës akademike, duke pranuar parimin që ato do të jenë fleksibël në varësi të misionit të IAL-ve. Pas përcaktimit të kriterëve të qarta për çdo IAL, secila prej tyre duhet të jetë e përgjegjshme për të operuar me to në mënyrë plotësisht transparente. Pas konsolidimit të këtij standardi, roli i Komisioni të Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) duhet të rikonsiderohet. Me personelin e punësuar rishtas, IAL-të nuk do të lidhin kontrata afatgjata, përderisa të jetë provuar se kandidatët meritojnë një të tillë nëpërmjet performancës së dëshmuar kryesisht në mësimdhënie.

71. Plani i veprimit përfshin konceptim dhe zhvillim modelesh të ndryshme për ngarkesën e personelit akademik, parimet e të cilave mund të përfshihen në termat e punësimit të tij. Këto terma punësimi do të përfshijnë gjithashtu referenca lidhur me përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Si pjesë e marrëveshjes me personelin, që do të realizojë këto përmirësime, do të parashikohen edhe forma nxitjeje financiare. Në këtë mënyrë, pagat do të përfshijnë një komponent, të lidhur me performancën.

### **3.3 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i të nxëniet**

72. Nevojat e të ardhmes së vendit kërkojnë që të tre ciklet e ofertës akademike të përmbushin kërkesat e Standardeve Europiane dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane e Arsimit të Lartë. Për momentin, standardet e ofertës akademike shqiptare përgjithësisht nuk e arrijnë ende këtë nivel. Për të përmirësuar cilësinë e ofertës akademike, kërkohet zhvillimi dhe rifreskimi i saj në nivel kombëtar. Në këtë kontekst, do të fuqizohet roli i APAAL-it, në mënyrë që kjo e fundit të operojë me këto standarde, dhe, për më tepër, të garantojë që çdo nismë për hapjen e programeve apo cikleve të reja, të plotësojë kriteret dhe standardet e përcaktuara.

73. Është gjithashtu e rëndësishme të kultivohet një kulturë më e shëndetshme e cilësisë brenda IAL-ve. Po aq i rëndësishëm është edhe krijimi i klimës së përshtatshme për të luftuar

formalizmin dhe fiktivitetin, të vënë re deri tani në këtë lëmi. Në terma formalë, kjo nënkupton përcaktimin e standardeve dhe rritjen përgjegjësiwe institucionale, për zbatimin e tyre në nivel IAL-je, veçanërisht përsa i përket vlerësimit të brendshëm.

74. Përsa i përket mësimdhënies, ka dy kategori standardesh cilësi: standarde për metodat e mësimdhënies dhe standarde për përmbajtjen e mësimit. KërkoheW një metodologji e studiuar për t'i zhvilluar ato në nivel kombëtar.

#### **Metodat e mësimdhënies**

75. Shqipëria në shekullin XXI, si kudo në Europë, do të ketë nevojë për njerëz që kanë shprehur fleksibël dhe të adaptueshme të të menduarit, të analizës, krijimtarisë dhe zgjidhjes së problemeve, si në ekonomi ashtu edhe më gjerë për shoqërinë. Sigurimi i këtyre shprehive është ndryshimi i më i rëndësishëm që i nevojitet tërë sistemit të AL. Sigurisht, do të ketë nevojë të vazhdueshme për njohuri specifike profesionale, por shprehitë e përgjithshme do të bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe, për shumë të diplomuar, do të jenë më me vlerë se njohuritë në drejtime specifike.

76. Metoda aktuale e mësimdhënies në IAL-të nuk zhvillon shprehur të tilla. Ajo ka më shumë prirjen e "paraqitjes së fakteve", se sa të përdorimit të një metode mësimdhënie ndërvepruese dhe të përqendruar tek studentit. Natyra e marrëdhënieve ndërmjet personelit akademik dhe studentëve nevojitet të ndryshojë, në mënyrë që ajo të jetë ndërvepruese dhe e bazuar në diskutime, në të menduarit dhe zhvillimit të ideve. Kjo është një nga mangësitë më serioze në sistemin e AL – dhe ka të bëjë me të tre ciklet e formimit, si edhe me formimet para-universitare. Për të përmirësuar cilësinë e të mësuarit, ndryshimi më i madh që duhet ndërmarrë, ka të bëjë me metodat. Ky ndryshim është i rëndësishëm për të ardhmen e arsimit dhe në drejtim do të përqendrohen edhe investimet për zhvillimin e burimeve njerëzore në të ardhmen.

77. Ndryshimi në metodat e mësimdhënies do të jetë një sfidë e vërtetë për një pjesë të madhe të personelit akademik. Ky ndryshim ka të ngjarë të jetë më i vështirë – por edhe më i nevojshëm, për pedagogët e vjetër, të cilët për vite kanë përdorur të njëjtën mësimdhënie dhe ndoshta nuk e kuptojnë nevojën për ndryshim. Është detyra e IAL-ve të gjejnë mënyrat e zhvillimit të burimeve njerëzore dhe plani i veprimit do të kërkojë propozime prej IAL-ve se si do ta realizojnë këtë. IAL-të do të planifikojnë zhvillimin e burimeve njerëzore në këto drejtime:

- Kualifikime jashtë shtetit: Shkëmbimet afatshkurtra të personelit akademik mund të jenë një mënyrë efikase për të zhvilluar shprehitë mësimdhënëse.

- Personeli që kthehet nga jashtë shtetit: Personeli që kryen periudhën e formimit pedagogjik dhe shkencor jashtë shtetit duhet të përhapin përvojën e fituar dhe ta shkëmbejnë atë me kolegët e tyre.

- Kurse afatshkurtër për metodat e mësimdhënies: IAL-të duhet të kenë në vëmendje të vazhdueshme metodat e mësimdhënies dhe të organizojnë sistematikisht kurse afatshkurtra dhe veprimtari për shkëmbim përvoja në nivel IAL-je, rajonal e kombëtar.

- Reagimi nga studentët: Studentët janë përgjithësisht gjykues të mirë të mësimdhënies, ndonëse ata kanë nevojë të trajtohen për aspekte specifike të vlerësimit të saj si dhe për mënyrën e strukturimit të formulimit të opinionëve të tyre. Është e rëndësishme të evitohet dukuria e dhënies prej tyre të vlerësimeve pozitive për pedagogët më pak kërkues.

- Menaxhimi i performancës së personelit akademik: Sipas ligjit të AL (2007), IAL-të duhet të ngrenë sistemet e tyre zhvillimit të performancës për personelin akademik, pjesë e rëndësishme e të cilit do të jetë vlerësimi i metodave të mësimdhënies. IAL-të do të kërkojnë mekanizma të përshtatshëm, që performanca e mirë të shpërblehet edhe financiarisht.

- Kriteret e promovimit: Për të gjitha IAL-të, kriteret e promovimit duhet të përfshijnë performancën e mësimdhënies, ndonëse pësha që do t'i jepet asaj do të jetë e ndryshme në përputhje me misionin e IAL-së. Kjo pëshë duhet të jetë maksimale për ato IAL, që kanë për mision kryesor mësimdhënien.

78. Plani i veprimit do të përfshijë fonde të veçanta investimi për IAL-të që të zhvillojnë një nga metodat e përmendura (përfshirë edhe atë të marrjes së opinionit të studentëve) për përmirësimin e mësimdhënies. APAAL-i t'i kushtojë vëmendje më të madhe vlerësimit të metodave dhe stilit të mësimdhënies në procesin e sigurimit të cilësisë. Rezultatet e këtij vlerësimi do të

ndikonin në shpërndarjen e numrit të studentëve në fakultete dhe në financimet për to.

### **Përmbajtja e mësimdhënies**

79. Përmbajtja e mësimdhënies, krahas metodave të mësimdhënies, lipset të përditësohet me të reja më të fundit për shekullin XXI – dhe brenda Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, që të përputhet me kuadrin e përgjithshëm të HEAL-it. IAL-të janë vënë në lëvizje për të adoptuar një përfaqje modulare dhe sistem të transferimit të krediteve për kurset e studimit, që është ndër prioritetet e Procesit të Bolonjës. Por në këtë drejtim IAL-të nuk kanë shkuar më larg se një ripaketim i programeve ekzistuese dhe nuk kanë lëvizur drejt qasjes së “rezultateve të të nxënit”, sikurse parashikohet nga Marrëveshja e Bergenit. IAL-të duhet të kuptojnë se sistemi i modularizimit dhe i transferimit të krediteve nuk bëhet për qëllime administrative, por për të përfutur studentët. Ky sistem synon zgjerimin e shanseve për studentët, duke u siguruar atyre zgjedhje reale dhe mundësi transferimi, si brenda institucionit ashtu edhe mes IAL-ve. Me qëllim që të ketë përfitime për studentët dhe në kuadrin e përmbushjes së kërkesave të Deklaratës së Bolonjës, plani i veprimit parashikon që IAL-të të zhvillojnë modularizimin dhe një sistem transferimi të krediteve. Ky duhet të jetë i konceptuar në mënyrë të tillë që t’u mundësojë studentëve ndjekjen e kurseve brenda IAL-së së tyre, ose edhe në IAL të tjera. Plan i Veprimit parashikon që APAAL-i të raportojë për progresin në këtë drejtim.

80. Programet e studimeve ndërdisiplinare, të tilla si “Inxhinieri menaxhimi” apo “Inxhinieri mjedisore” do të bëhen të rëndësishme në të ardhmen. Përgatitja e programeve të tilla është shumë më e lehtë me një sistem modular transferimi kreditesh. Ato nuk kërkojnë struktura apo degë të reja, por do të krijohen si veprimtari e përbashkët mes dy fakulteteve ose edhe mes IAL-ve. Personeli akademik parashikohet të punojë në të dy fakultetet për programe të tilla, si pjesë normale e detyrës së tyre në mësimdhënie. Për të hartuar kurse të tilla do të nevojitet një forum brenda IAL-ve që të diskutojë dhe zhvillojë idetë; kjo do të jetë pjesë e përgatitjes së planeve në IAL. Do të jetë me dobi për IAL-të t’u drejtohen për ndihmë universiteteve të huaja për të zhvilluar kurse ndërdisiplinare. Institucionet vendimmarrëse do të mbështesin aktivisht zhvillimin e programeve të tilla. Plan i veprimit do të përcaktojë nëse kjo mund të kryhet nëpërmjet metodologjisë së financimit dhe/ose nëpërmjet një fondi të veçantë nismëtar.

81. Familjarizimi me njohuritë dhe shprehitë për teknologjinë informatike e të komunikimit dhe gjuhën angleze do të jenë të rëndësishme për studentët e të ardhmes. IAL-të pritet të bëjnë përgatitjet në këto aspekte, dhe disa IAL rajonale mund të kenë nevojë të “blejnë” prej jashtë institucionit (psh., nga universitete të tjera ose institucione private). Plan i veprimit parashikon të përfshihen fonde nxitëse për të siguruar këto kushte.

82. Në disa lëndë kurrikulat e mësimdhënies janë të vjetëruara, sidomos në shkencë; ndonjëherë kjo është rezultat i pajisjeve që u ka kaluar koha dhe/ose për shkak se personeli akademik nuk është i përditësuar me zhvillimet e sotme. Ka një prirje për përmirësimin e gjendjes, duke filluar nga pajisjet, kryesisht të natyrës kompjuterike. Por, nevojitet informacion objektiv dhe i detajuar për gjendjen aktuale përpara se të identifikohen nevojat në tërësi. Plan i veprimit parashikon që të çdo IAL, si pjesë e procesit të vlerësimit të personelit akademik, sikurse përcaktohet në ligj, të evidentojnë përmbajtjen e vjetëruar të mësimdhënies dhe mbi këtë bazë të programojnë dhe realizojnë trajnimin e nevojshëm të personelit.

83. Bashkë me zhvillimin e vendit, edhe nevojat e tregut të punës do të ndryshojnë me ritme më të shpejta se më parë. Kjo do të thotë se shumë njerëz do të kenë nevojë t’i kthehen të nxënit në momente të caktuara të jetës së tyre, psh., me kurse të shkurtra verore ose kurse mbrëmjeje. Mundësitë për “të nxënë gjatë gjithë jetës” janë të kufizuara për momentin, pjesërisht për shkak të kërkesës së ulët, por edhe për arsye se nuk ekzistojnë mekanizma nxitës për IAL-të që të ofrojnë shërbime të tilla. Parashikohet që kjo kërkesë të rritet dhe do të mbështetet krijimi i kushteve për realizimin e saj. Grupi për studimet me kohë të pjesshme dhe “të nxënë gjatë gjithë jetës”, do të përcaktojë në detaje ecurinë dhe hapat e realizimit të këtyre kurseve.

### **Trajnimi i mësuesve në shkollë**

84. Cilësia e shërbimeve të trajnimit të mësuesve është kryesore për të ardhmen e vendit. Çështjet e mësipërme për nevojën e ndryshimit të stilit dhe metodave të mësimdhënies zbatohen

shumë më mirë në përgatitjen e mësuesve se në çdo formim tjetër në IAL. Është shumë më tepër e rëndësishme që metodat e reja të mësimdhënies të përdoren nga personeli i fakulteteve të mësuesisë, pasi studentët e tyre do të jenë mësuesit e ardhshëm në shkolla, ku atyre do u duhet të adoptojnë të njëjtat metoda të mësimdhënies, me qëllim që të zhvillojnë te nxënësit shprehitë e të menduarit të nivelit të lartë.

85. Në lidhje me përgatitjen fillestare të mësuesve për arsimin bazë, përfaqësojnë aktuale me kurrikula “bërthamë” ka çuar në mbingarkesë për studentët. Studentëve në këtë program studimi, u zhvillohen lëndë që nuk do t’u duhen në të ardhmen si mësues, dhe, për pasojë ata mbingarkohen me shumë orë mësimi dhe pak praktikë. Parashikohet që kjo të ndryshojë duke synuar që përgatitja fillestare e mësuesve të arsimit bazë të realizohet në ciklin e parë të studimeve. Gjatë këtij cikli studimesh, do të zhvillohet përmbajtja e lëndëve dhe pedagogjia e nevojshme për formimin e një mësuesi të arsimit bazë. Ky model është i realizuar me sukses në vende të tjera të Europës dhe është në përputhje me Procesin e Bolonjës, Për më tepër, qeveria si punëdhënësi kryesor i mësuesve të kualifikuar, është e arsyeshme që të përcaktojë se çfarë kërkesat ndaj mësuesve si dhe të specifikojë kurrikulën bërthamë për përgatitjen e tyre.

86. Plani i veprimit do të përfshijë ngritjen e një Grupi për Përgatitjen Fillestare të Mësuesve për hartimin e udhëzimeve të qarta lidhur me një kurrikul bërthamë. Ajo do të ketë përmbajtje të reduktuar të lëndëve, duke mënjanuar çështje të panevojshme dhe do t’i japë rëndësi formimit pedagogjik me më shumë theks te shprehitë bazë, TIK dhe gjuhë angleze. Ky Grup do të hartojë rekomandime edhe për raportin minimal të kohës që studentët duhet të shpenzojnë për praktikën e mësimdhënies në klasat e shkollës, i cili duhet të jetë më i lartë se nivelet aktuale. Në të njëjtën kohë do të përgatiten edhe rekomandimet për mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të studentëve në shkollë nga tutorët e tyre të IAL-së, që duhet të jetë më e vlerësuar se deri tani.

87. Përgatitja fillestare për mësuesit e shkollave të mesme do të kryhet mbi një model 3+N, ku 3 vitet e para do të jenë cikli i parë mbi një lëndë të veçantë, por me fleksibilitetin modular për të studiuar më shumë se një lëndë. Pjesa ‘+N’ do të jetë në mënyrë të veçantë mbi pedagogjinë e mësimdhënies në shkollat e mesme; ajo do të jetë e detyrueshme për ata që dëshirojnë të japin mësim në këto shkolla. Pjesa ‘+N’ do të jetë “degë” e veçantë në Fakultetin e Edukimit që do të ngrihet i ri. Vlera e ‘N’ do të jetë 1 ose 2 vjet. Ky grup do të përgatitë sugjerime edhe për sasinë minimale të praktikës mësimdhënëse që duhet të realizojnë studentët në shkolla.

88. Universiteti i Tiranës duket se aktualisht ka kapacitetet më të mëdha për të ofruar pjesën pedagogjike ‘+N’. IAL-të e tjera, që dëshirojnë të ngrenë fakultetet e tyre të edukimit për të zhvilluar pjesën “+N”, do të jenë në gjendje ta bëjnë, nëse përmbushin kriteret kombëtare të përcaktuara nga KALSH-i, bazuar në rekomandimet e APAAL-it. Studentët e diplomuar të çdo IAL që dëshirojnë të bëhen mësues të shkollave të mesme, mund të aplikojnë për të hyrë në çdo Fakultet Edukimi që ofron +N. Plani i veprimit do të sugjerojë mënyra për Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Tiranës që të japë asistencë pedagogjike për IAL-të rajonale të cilat ofrojnë përgatitjen e mësuesve për arsimin bazë 3+0.

89. Ka disa nisma për të përmirësuar dhe koordinuar trajnimin në shërbim, të cilat synojnë të përmirësojnë veprimtarinë mësimdhënëse të mësuesve në shkolla. Në këtë kuadër parashikohet të ngrihet një sistem vlerësimi për veprimtarinë mësimdhënëse të mësuesve, përmes të cilit do të përcaktohen nevojat e tyre për trajnim. Plani i veprimit do t’i japë të njëjtin prioritet zhvillimit të përgatitjes fillestare si dhe trajnimit në shërbim.

90. Aktualisht asnjë nga IAL-të nuk siguron kushte për trajnim në shërbim të mësuesve. Kjo është një mundësi e humbur, si për kombin ashtu edhe për IAL-të. Në Planin e veprimit parashikohet që të rritet niveli i financimit për trajnimin në shërbim dhe të ndryshojë mënyra e financimit të këtij trajnimi. Metoda e re do të jetë më afër tregut të punës, ku fondet publike u bëhen të disponueshme përfutuesve të trajnimit dhe jo ofruesve të këtij shërbimi. Fillimisht, fondet publike do t’u jepen rajoneve që do të veprojnë si “klientë” në emër të shkollave të tyre. Më pas, kur shkollat të jenë gati për këtë përgjegjësi, fondet do t’u jepen drejtpërdrejt atyre që mund të “blejnë” nga çdo ofrues i akredituar, trajnimin për të cilin kanë nevojë. Kjo procedurë e re financimi do të jetë një motivim i fortë financiar për IAL-të që të hyjnë në “treg” duke ofruar trajnime të tilla.

### **3.4 . Qeverisja bashkëkohore**

#### **Autonomia, përgjegjshmëria dhe menaxhimi**

91. Për t'iu përgjigjur sfidave të ndryshimeve të shpejta në shoqëri dhe ekonomi, IAL-të bashkëkohore kanë nevojë për një autonomi të arsyeshme nga qeveria. Ligji i AL (2007) shënon një hap të rëndësishëm drejt rritjes së autonomisë së IAL-ve, ndonëse nuk i shndërron ato tërësisht nga institucione shtetërore në publike. Plani i veprimit vendos detyra për hartimin e orientimeve kryesore për IAL-të se çfarë duhet të bëjnë ato për të qenë në përputhshmëri me ligjin e AL (2007). Çdo IAL do të përgatisë planin e saj strategjik 5-vjeçar, mbështetur në synimet dhe orientimet e kësaj Strategjie.

92. Synimi afatgjatë është që çdo IAL të bëhet plotësisht autonome dhe të funksionojë si institucion publik. Autonomia për IAL-të do të mbështetet në katër kolona dhe konkretisht në:

- autonominë akademike – që nënkupton liritë akademike të individëve dhe atë të institucionit, që ky i fundit të mund të hartojë kurrikula novatore, përmbajtje të reja të lëndëve dhe, në kuadrin e Sigurimit të Cilësisë dhe kushtëzimeve financiare, të vendosë për hapjen apo mbylljen e degëve dhe të formimeve. Kjo gjë do të ndikojë në përcaktimin e numrit të studentëve sipas fakulteteve për çdo IAL;

- autonominë strukturore – që nënkupton se IAL-të do të përcaktojnë strukturat e tyre të brendshme (fakultete, departamente, etj.) dhe do t'i përshtatin ato në përputhje me ndryshimet e rrethanave dhe të nevojave;

- autonominë administrative – që nënkupton se IAL-të do të përcaktojnë mënyrat se si do të vetëmenaxhohen në përputhje me misionin e tyre – gjithsesi brenda kornizës së orientimeve kombëtare dhe në përputhje me praktikat e përparuara;

- autonominë financiare – që nënkupton se IAL-të do të kenë mundësi që përveç grantit nga buxheti i shtetit të thithin fonde të tjera private ose publike dhe të kenë autonomi të plotë në shpërndarjen e burimeve të brendshme mbi bazën e planeve dhe të buxhetit si edhe shpenzimin e tyre, të miratuara nga KADMI i universitetit. Statusi publik i IAL –ve kërkon të reformohet edhe modeli i financimit të AL në Shqipëri.

93. Secili nga këto aspekte të autonomisë është i rëndësishëm për IAL-të e të ardhmes. Dy çështje kushtëzojnë një autonomi më të gjerë; zhvillimi i kapaciteteve të brendshme të menaxhimit dhe forcimi i përgjegjshmërisë dhe i transparencës. Ato do të garantojnë që autonomia të mos rezultojë as anarki dhe as qeverisje e mbështetur në komandë dhe jo në bashkëpunim me organet dhe autoritetet përfaqësuese të IAL.

94. Kushti i parë për IAL-të shtetërore që të fitojnë autonomi më të madhe, është që ato të kenë menaxhim të brendshëm dhe vendimmarrje rigorozë e transparente, me llogaridhënie më të mirë. Kjo gjë kërkon që IAL-të të kenë struktura të duhura dhe të praktikojnë procese të qarta menaxhimi.

95. Koncepti modern i menaxhimit është relativisht i ri për IAL-të (jo vetëm në Shqipëri) dhe ka të bëjë me:

- përcaktimin e prioritetëve dhe realizimi i procesit të planifikimit dhe të hartimit të buxhetit mbi baza realiste dhe objektive;

- respektimi i limiteve buxhetore të cilat janë të lidhura me politikat e ligji mbi buxhetin;

- metodat e përcaktimit të përdorimit të burimeve të brendshme financiare përmes prioritetëve konkurruese;

- monitorimin financiar dhe kontrollin në bazë IAL-je dhe fakulteti apo departamenti në varësi të njësisë buxhetore;

- vendimet për nivelet e delegimit financiar;

- mbështetjen e fuqishme profesionale për menaxhimin, si dhe kryesisht për aspektet financiare si dhe forcimin e rolit të Kancelarit (në zbatim të kërkesave të ligjit për AL (2007));

- zhvillimin e politikave për përmirësimin e mësimdhënies dhe të veprimtarisë e tjera akademike;

- zbatimin dhe zhvillimin e procesit të Sigurimit të Cilësisë nga vetë IAL-të;

- zhvillimin e kriterëve të punesimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të karrierës së tyre përzgjedhjen dhe rritjen në karrierë të personelit mbi bazën e kriterëve objektive;
- menaxhimin treguesve të performancës së personelit si edhe përcaktimin e ngarkesës së punës;
- strukturën e menaxhimit dhe përshkrimin e vendeve të punës të personave të përfshirë në aktivitetet manaxhues .

96. Ligji i AL (2007) kërkon prej IAL-ve të zhvillojnë secilin nga këto procese. Plani i veprimit parashikon që IAL-të të konceptojnë dhe të propozojnë procese qeverisëse dhe struktura për vendimmarrje. Për këtë qëllim atyre do t'u ofrohet asistencë teknike e jashtme.

97. Për të marrë vendime menaxhuese, çdo IAL ka nevojë për një grup të brendshëm menaxhimi, të kryesuar nga Rektori, dhe që do të përfshijë edhe autoritete të larta drejtuese (normalisht Zv/Rektorët dhe Dekanët) dhe Kancelarin; ligji i AL (2007) i referohet këtij organi si Rektorat. Ky është një grup i brendshëm menaxhimi, i cili nuk është i njëjtë me Këshillin e jashtëm, që do të nevojitet për llogaridhënien, kur IAL-të të bëhen publike. Rektorati duhet të ketë terma të qarta reference dhe duhet të operojë me një dokumentacion, i cili, nëse nuk ka arsye të ruajtjes së sekretit, duhet të jetë i disponueshëm për komunitetin e IAL-ve. Kur procesi i qeverisjes të arrijë pjekurinë e tij, atëherë përgjegjësitë e Rektoratit duhet të përqendrohen mbi çështje të menaxhimit dhe financës; ndërsa ato të Senatit, mbi çështje akademike.

98. Për të përmbushur synimin afatgjatë, që çdo IAL të gëzojë autonomi të plotë si institucion publik, Plani i veprimit përcakton edhe hapat e mëtejshëm, krahas parakushteve për një qeverisje më efektive lidhur me menaxhimin e brendshëm dhe transparencën e jashtme. Pas përmbushjes së parakushteve, komponentët kryesorë të tyre do të përfshihen në Statutin e IAL-ve dhe ai do të fitojë statusin e IAL-së publike.

99. Kushti i dytë lidhet me llogaridhënien e jashtme. Ligji i AL (2007) parashikon ngritjen e "Këshillit Administrativ" (KA) për çdo IAL, me një pakicë anëtarësh të jashtëm. Ky është zhvillim pozitiv drejt një prirjeje të qartë ndërkombëtare, që IAL-të publike të kenë "Borde", ku shumica e anëtarëve përfaqësojnë grupet e jashtme të interesit. Anëtarët e brendshëm të KA-së zgjidhen nga personeli akademik, jo akademik dhe nga studentët.

100. Me kohën, KA-të grumbullojnë përvojë dhe IAL-të do të binden për vlerën e tyre. Kësisoj, ato mund të shndërrohen hap pas hapi në "Borde të Jashtme" (BJ), të përbërë nga një shumicë anëtarësh, që nuk janë të punësuar në strukturat e IAL-ve. Si të tillë, ato (BJ) do të kenë përgjegjësinë përfundimtare për miratimin e planeve dhe buxhetit të IAL-ve, për kontrollin e përgjithshëm financiar dhe për emërimin e autoriteteve të IAL-ve. Bordet e Jashtme nuk do të merren me çështjet e përditshme të menaxhimit të IAL-së (ajo do të jetë detyra e Rektoratit) dhe as me detyrat e Senatit për çështje akademike. Transformimi i Këshillave të Administrimit në Borde të Jashtme do të pasqyrohet edhe në ndryshimin e statusit të institucioneve nga shtetërore në publike; ky ndryshim mund të mos ndodhë njëkohësisht në të gjitha IAL-të.

101. Anëtarët e jashtëm të BJ-së do të përzgjidhen nga personalitete jo vetëm të fushës ekonomike dhe nga bizneset lokale, por edhe nga shoqëria civile, nga të diplomuarit e IAL-ve, nga institucione të sektorit publik, përfshirë edhe shkollat e mesme për ato IAL, që kanë si detyrë edhe formimin e mësuesve. Çdo anëtar i jashtëm do të përzgjidhet në bazë të kompetencës. Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Shqiptare (KRUSH) do t'i kërkohej të japë sugjerimet e veta për mënyrën e zgjedhjes dhe përbërjen e anëtarëve të jashtëm të BJ.

102. Llogaridhënia e jashtme, kërkon që IAL-të të publikojnë një raport vjetor, i cili do të përfshijë arritjet e institucionit, që lidhen me tregues të specifikuar të performancës dhe me rezultatet e përfuara nga procesi i jashtëm i Sigurimit të Cilësisë. Raporti do të përfshijë edhe bilancin vjetor të IAL-ve, të monitoruar dhe kontrolluar në mënyrë të pavarur. Rektori duhet të shpallë raportin vjetor në një mbledhje të hapur të senatit, në të cilën kanë të drejtë të marrin pjesë studentët dhe personeli mësimor kërkimor dhe ai ndihmës. Plani i veprimit do të bëjë propozime për mënyrën e monitorimit si edhe për treguesit financiarë dhe të performancës të IAL-ve. Ky monitorim, së bashku me kontrollin e jashtëm të pavarur do të përbëjë një garanci ndaj keqpërdorimit të fondeve.

103. Së fundi, lidhur me llogaridhënien, do të zbatohen tre nivele të pavarur kontrolli institucional të IAL-ve nga:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit,
- Kontrolli i Brendshëm i Këshillit të Ministrave,
- Drejtoria e Kontrollit të MASH-it.

Kjo gjë mund të jetë kohë-shpenzuese, pasi ka mbivendosje të kontrolleve. Plani i veprimit do të përfshijë një vlerësim, për të parë se si mund të ulet barra e kontrollit.

104. Autonomia e plotë për IAL-të publike do të kërkojë shumë përgatitje. Ndryshimet në kulturën e menaxhimit do të jenë të konsiderueshme dhe mund të marrin më shumë kohë në disa IAL krahasuar me disa të tjera. Mbështetur në përvoja të ngjashme, i gjithë procesi në shkallë vendi mund të zgjasë deri në 10 vjet.

### **3.5. Financimi dhe financat**

105. IAL-të lipset të kenë një të ardhme financiare të shëndetshme dhe të qartë; buxheti i shtetit do të mbetet burimi kryesor i financimit të tyre. Megjithatë, pavarësisht se synohet të dyfishohet buxheti për arsimin në pesë vitet e ardhshme, AL ka kosto të lartë dhe raporti i tij në buxhetin total të arsimit mund të mos ndryshojë. Rritja e planifikuar në numrin e studentëve me kohë të plotë me rreth 30 000 studentë në 5 vjet, do të kërkojë një rritje të koston vjetore me së paku 15-20 milionë USD. Edhe vendet e zhvilluara e ndjejnë peshën e mbështetjes financiare të AL-së nga shpenzimet publike, prandaj kërkojnë edhe burime të tjera të ardhurash për të plotësuar buxhetin e IAL-ve.

106. Së pari, pritet që IAL-të të zhvillojnë kapacitetet e tyre si entitete kolektive dhe të realizojnë të ardhurat e tyre vetjake, duke ofruar shërbime për të ndihmuar zhvillimin lokal, rajonal dhe më gjerë, ose duke ofruar trajnime për publikun sipas skemës së re të financimit. Në vitin 2006 u thjeshtësuan procedurat administrative për sa i përket kontratave që lidhin IAL-të (për shërbimin e ofruar), gjë që ka lehtësuar gjenerimin e të ardhurave. Ministrinë do të inkurajohen të zhvillojnë marrëdhënie kontraktuale me IAL-të dhe të paguajnë koston e plotë për shërbimet që përftojnë.

107. Ligji i AL (2007) u jep edhe më shumë mbështetje IAL-ve, që të ofrojnë shërbime të tilla duke siguruar që ato të mund të menaxhojnë të ardhurat e tyre. Megjithatë, këto të ardhura do të shpenzohen sipas një politike të integruar përkundrejt një planifikimi qendror, duke bërë të mundur që njësia e IAL-së (Fakulteti, Departamenti apo Grupi mësimor kërkimor), e cila ka qenë në origjinën e gjenerimit të tyre, të përfitojë pjesën kryesore të atyre të ardhurave.

108. Burimi i dytë potencial i të ardhurave do të jenë tarifave të shkollimit. Aktualisht këto tarifa për studentët me kohë të plotë bëjnë rreth 20-23 milionë USD në vit ose 22-25% të koston së plotë. Studentët janë përfituesit kryesorë të arsimit që u ofrohet në IAL-të, prandaj është çështje drejtësie sociale që edhe ata të kontribuojnë për të plotësuar koston e arsimit të tyre të lartë; në rast të kundërt, ky plotësim i koston do të mbulohej edhe nga individë që nuk kanë qenë të ulur dhe nuk do të ulen ndonjëherë në bankat e IAL-ve.

109. Plani i veprimit do të rivlerësojë mundësinë e një kombinimi racional të faktorëve objektivë dhe këndvështrimeve të politikave të caktuara, për të përcaktuar diferencimet në nivelet e tarifave të shkollimit mes degëve e cikleve të ndryshme (duke përfshirë këtu formimin e lartë jo-universitar), si edhe mes formimit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme. Lidhur me faktorët objektivë, nivelet e tarifave për ciklin e parë do të marrin parasysh koston dhe tarifave të studentëve, që përfitojnë nga kjo ofertë akademike. Nivelet e tarifave do të përshtaten në mënyrë të tillë, që ato të pasqyrojnë politikën e inkurajimit për studentët, që ata të kryejnë studimet në degë të caktuara (p.sh. tarifa të reduktuara për diplomat 2-vjeçare) ose të ndjekin programe të formimit të mësuesve në IAL-të rajonale.

110. Sistemi aktual i mbështetjes së studentëve në nevojë, (rreth 7-8 milionë USD në vit (mbështetje me bursa për studentë nga shtresat sociale në nevojë, studentët e shkëlqyer, si dhe mbështetje për shoqëritë anonime të "Trajtimin të Studentëve" për shërbimet e hotele të ndaj studentëve) nuk është drejtuar atje ku duhet dhe është i plogët administrativisht. Në kuadrin e planit të veprimit është parashikuar të kryhet një studim për përmirësimin e destinacionit dhe të efikasitetit të këtij sistemi. Sistemi i ri mendohet të zbatohet në shkallë vendi, pa ndarje rajonale, bazuar në

nevojat dhe të vendosë më shumë barazi.

111. Një tjetër çështje e rëndësishme është akomodimi i studentëve. Aktualisht, në shumicën e rasteve ai sigurohet në mënyrë të centralizuar dhe nuk është ende në standarde bashkëkohore. Ka dy modele kryesore për të asistuar studentët për akomodim:

- duke u ofruar drejtpërsëdrejti tarifa të subvencionuara (gjendja aktuale);
- duke u dhënë subvencione studentëve dhe ata ta gjejnë vetë akomodimin.

Në vende të tjera shpesh zbatohet një kombinim i të dy modeleve. Plani i veprimit do ta shqyrtojë edhe këtë çështje me përparësi për të gjetur zgjidhjen e përshtatshme për Shqipërinë.

112. Për arsye barazie sistemi i tarifave të plota për studentët me kuota dytësore është pezulluar. Kjo çështje mbetet e hapur edhe për studentët me kohë të pjesshme. Të ardhurat nga tarifat e studentëve me kohë të pjesshme janë të konsiderueshme për shumë IAL (4-5 herë më të larta se të studentëve me kohë të plotë). Një pjesë e madhe e këtyre të ardhurave shpenzohet për shpërblimin e personelit akademik dhe pak mbetet për zhvillimin e IAL-ve. Numri i studentëve me kohë të pjesshme pritet të reduktohet dhe rrjedhimisht të ardhurat nga këto tarifa do të ulen. Një gjë e tillë do të reduktojë të ardhurat e IAL-ve, prandaj atyre do t'u duhet të gjejnë burime të tjera të ardhurash.

113. Lidhur me metodën e shpërndarjes së fondeve publike për IAL-të, në planin e veprimit do të parashikohen politika si për financimin e përgjithshëm, ashtu edhe për nxitjen e nismave specifike. Niveli i financimit të përgjithshëm për çdo IAL prej Buxhetit të Shtetit do të mbështetet në politikat kombëtare të zhvillimit dhe duhet të pasqyrojë performancën tyre. Mënyra e financimit duhet të inkurajojë efikasitetin; kështu fondi i plotë i IAL-ve mund të ndahet në një ose dy blloqe, që të mbulojnë të gjitha veprimtaritë kryesore dhe më pas t'u kërkohet atyre të planifikojnë buxhetet brenda totalit. Ky financim me bllok do të ndihmojë në rritjen e autonomisë, pasi IAL-të do të përgatisnin planet dhe buxhetet e tyre brenda këtij tavani. Nga ana tjetër kjo mënyrë financimi do të krijojë motivim për efikasitet në procesin e integritit të Instituteve Kërkimore pranë IAL-ve.

114. Lidhur me mësimdhënien, matësit më të drejtpërdrejtë të performancës së IAL-ve janë numri i studentëve të pranuar dhe ai i atyre që diplomohen. Pra, pika e fillimit për përcaktimin e formulës së financimit nga Buxheti i Shtetit për mësimdhënien do të jetë, në një farë mënyre, një kombinim i këtyre dy shifrave. Numri i studentëve të pranuar në IAL-të publike do të përcaktohet, për një periudhë afatmesme, në mënyrë të centralizuar, mbështetur në rekomandimet e KALSH-it, për çdo nivel studimi (nënndarje dhe për secilin nga të tre ciklet) dhe drejtim formimi, mbështetur në faktorë të tillë si:

- Prioritetet kombëtare për drejtime të veçanta formimi.
- Kërkesat e studentëve.
- Kërkesat e tregut të punës.
- Propozimet e IAL-ve.
- Lidhja e performancës së IAL-ve me tregun e punës.
- Cilësia e ofertës akademike së IAL-ve, vlerësuar nga APAAL-i.
- Kapacitetet fizike të IAL-ve (ndërtesat, laboratorët, pajisjet etj).

115. Alokimi i fondeve publike për mësimdhënie për çdo IAL do të bëhet me anë të një formule që e ponderon numrin e studentëve nëpërmjet dy grupe faktorësh: faktorë objektivë dhe faktorë mbi bazë politikash. Për të parët, ponderimi do të bëhet kryesisht në varësi të kostove të ndryshme të degëve apo disiplinave të ndryshme, të niveleve të ndryshme të studimit, të studimeve me kohë të plotë apo të pjesshme etj. Kostot do të jenë totale dhe do të përfshijnë pagat e personelit akademik dhe jo akademik, kostot operative si dhe shpenzimet e përgjithshme. Për disa IAL, shifrat e koston së përdorur në formulë mund të rezultojnë më të ulëta kundrejt nivelit aktual – gjë që do t'i nxiste ato të rritnin efikasitetin e përdorimit të burimeve. Lidhur me faktorët mbi bazë politikash, ponderimi mund të përdoret për t'u dhënë IAL-ve një stimul që ato të rekrutojnë studentë në një program apo kurs të caktuar, sipas nevojave dhe prioriteteve kombëtare të zhvillimit të arsimit.

116. Kjo metodë për alokimin e burimeve financiare është e ngjashme në filozofi më atë që përdoret për shpërndarjen e kostove operative, por në të shprehen në mënyrë më të qartë faktorët mbi bazë politikash. Përfshirja e pagës së personelit brenda një formule të vetme, përbën një ndryshim të rëndësishëm kundrejt praktikës ekzistuese të alokimit të fondeve, ndryshim ky që do të



marrë vlerë të plotë vetëm kur IAL-të të funksionojnë realisht si institucione publike, me një autonomi të plotë financiare, përfshirë edhe vendimmarrjen për numrin e personelit. Deri në atë moment, duhet shqyrtuar mundësia e përdorimit të një formule të ndarë për pagat. Realizimi i autonomisë së plotë financiare të IAL-ve mund të kërkojë edhe ndryshime të kuadrit ligjor financiar.

117. Alokimi i fondeve publike të IAL-ve si buxhet në bllok, do të sjellë një ndryshim thelbësor edhe në mënyrën e përgatitjes së buxhetit nga vetë IAL-të. Aktualisht përgatitja e buxhetit të një IAL-je bëhet në formën e kërkesës për financim drejtuar MASH-it, i cili, pasi e shqyrton atë, ia paraqet Ministrisë së Financave. Një alokim buxheti në bllok nuk mund të ndjekë këtë rrugë. Ai kërkon që të përcaktohet fillimisht buxheti total për IAL-në, nëpërmjet formulës, e cila vendos tavanin e financimit të IAL-së nga shteti. Më pas, IAL-së do t'i duhet të detajojë buxhetin e saj brenda këtij tavan.

118. IAL-të do të operojnë me buxhetin total që u është alokuar në bazë të formulës dhe nuk do të kenë mundësi të përftojnë nga shteti financime shtesë. Ato duhet ta planifikojnë përdorimin këtij buxheti duke vendosur prioritete për financimin e projekteve konkurruese brenda IAL-së. Në rast se ky planifikim nuk bëhet ashtu si duhet, ose nëse nuk arrihet mbajtja nën kontroll e shpenzimeve (në nivel fakulteti ose edhe më poshtë), ekziston mundësia reale që IAL-ja të mbetet pa fonde – dhe teknikisht të falimentojë. Pra, mënyra e re për planifikimin dhe buxhetimin do të kërkojë një mentalitet shumë të ndryshëm nga ai i sotmi dhe e gjithë e ardhmja e IAL-së do të varet prej kësaj. Planifikimi dhe buxhetimi do të jenë elemente thelbësore të zhvillimit të IAL-ve; këto do të përbëjnë ndër detyrat më të rëndësishme dhe më të vështira për Rektoratin.

119. Shumica e nismave specifike politike (në kuptimin e politikave arsimore), do të kërkojnë që IAL-ve t'u jepen financime specifike, përgjithësisht mbi bazë kërkesash konkurruese. Plani i veprimit do të identifikojë nivelet e financimit që nevojiten për nxitjen e çdo nisme specifike, si p.sh., për aftësimin e personelit akademik në përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, për zhvillimin e programeve prioritare të studimeve universitare, etj.

120. Për krijimin e kushteve për kërkim shkencor të aplikuar dhe shërbime në IAL-të rajonale, Plani i Veprimit do të parashikojë fonde të veçanta nxitëse. Në këtë mënyrë, këto institucione do të ndihmohen për t'u bërë Qendra të Zhvillimit Rajonal dhe për të zhvilluar gradualisht shërbimet e tyre mbi baza tregu. Pas një periudhe fillestare, shërbime të tilla do të kryhen kundrejt tarifash (të cilat do të mbulojnë, së paku, koston e plotë të shërbimit), që do t'i sjellin IAL-së të ardhura neto. Fondet nxitëse do të jepen në bazë të një plani të shoqëruar me kosto, të përgatitur nga IAL-të e interesuara.

121. Lidhur me kërkimin shkencor akademik, mbetet për t'u shqyrtuar më në detaje problemi i menaxhimit të burimeve që më parë u përkisnin Instituteve Kërkimore, të integruara tashmë me IAL-të. Por, pavarësisht këtyre burimeve, për financimin e kërkimit shkencor në përgjithësi, alokimi i fondeve do të bëhet në përputhje me prioritetet kombëtare, që do përcaktohen nga Grupi për Strategjinë e Kërkimit Shkencor. Treguesi kryesor i performancës në kërkimin shkencor shprehet nëpërmjet paraqitjes së një projekti kërkimi; kjo është edhe arsyeja që kërkimi do të vazhdojë të financohet mbi bazë projekti. IAL-të (përfshirë edhe strukturat e krijuara nga Integrimi i Instituteve Kërkimore), do të konkurrojnë për financim me projektet e tyre, sipas fushave prioritare të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Kërkimit. Plani i veprimit do të përfshijë një analizë të detajuar të metodës të alokimit të fondeve për kërkim dhe të zërave të koston që do të mbulojnë nga këto fonde.

122. Plani i veprimit do të parashikojë edhe dhënien e një sasive të kufizuar fondesh për projekte që janë ekselente (të nivelit të lartë), por jo në linjë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor; edhe në këtë rast, vlerësimi i projekteve dhe vendimi për financimin ose jo të tyre do të merret nga Grupi për Strategjinë e Kërkimit Shkencor. Do të ketë edhe një fond tjetër, relativisht të vogël, në ndihmë të IAL-ve rajonale që ato të zhvillojnë kapacitete të kërkimit shkencor (nëse dëshirojnë), në një ose disa fusha specifike dhe të përgatiten për të qenë në gjendje të konkurrojnë në projekte kombëtare të kërkimit shkencor në këto fusha. Këto dy aspekte shtesë të financimit të kërkimit shkencor do të përfshihen në analizën e metodës së alokimit të fondeve, të përmendur më sipër.

123. Pjesa më e madhe e fondeve rrjedhëse të investimit do të sigurohen nga të ardhurat e fituara nga vetë IAL-të. Ligji i AL (2007) u jep të drejtën IAL-ve të mbajnë “për vete” të gjitha të ardhurat që mund të gjenerojnë (përfshirë taksat kombëtare). Por, krahas tyre, do të nevojiten edhe burime të tjera financimi, si për përmirësimin e sistemit, ashtu edhe për dhe zgjerimin i tij.

124. Fondet e investimit për përmirësimin e sistemit ekzistues nuk do të shpërndahen nëpërmjet një formule, por mbi bazë projekti, nisur nga vlerësimi objektiv i nevojave të IAL-ve. Çdo IAL do të bëjë propozime të shoqëruara me kosto për projekte investimi, duke argumentuar nevojën për këto investime dhe prioritetin e tyre; për këtë, atyre do t'u duhet të zhvillojnë procesin e vlerësimit të kapitalit ekzistues. Baza e informacionit, për gjykimin e projekteve konkurruese për investime, do të sigurohet nga vlerësimi i gjendjes së IAL-ve përsa i përket infrastrukturës së tyre (godina dhe pajisje). Kryerja e këtij vlerësimi është një nga detyrat e parashikuara dhe të detajuara në planin e veprimit.

125. Pjesën më të madhe të kërkesës për investime të reja do ta përbëjnë fondet e nevojshme për zgjerimin e sistemit. Rritja e numrit të studentëve do të kërkojë shpenzime kapitale të rëndësishme, të cilat do të shtrihen në një periudhë 7-vjeçare. Për të siguruar këtë nivel investimi, do të duhet një planifikim i kujdesshëm i fondeve publike. Nuk përjashtohet edhe nevoja e sigurimit të një mbështetjeje të jashtme, gjë që do të shqyrtohet në planin e veprimit.

126. Do të jetë në përgjegjësinë e MASH-it dhe të Ministrisë së Financave përcaktimi i nivelit total të fondeve publike për AL, si dhe i sistemit të financimit të IAL-ve në tërësi. Në këtë sistem parashikohet të bëhen ndryshime të rëndësishme, që lidhen me politikat e tarifave të shkollimit, të financimeve për akomodimin e studentëve, të mbështetjes së studentëve në nevojë etj. Të gjitha këto kërkojnë studime dhe analiza të thelluara. Plani i veprimit parashikon ngritjen, për këtë qëllim, të një Grupi të përbashkët MASH-Ministri e Financave, për të parë se si mund të arrihen këto ndryshime.

127. Në përputhje me parimet e përgjithshme të financimit të AL, të vendosura bashkarisht nga MASH-i dhe Ministria e Financave, do të bëhet shpërndarja e fondeve publike të destinuar për IAL-të. MASH-i mban përgjegjësinë e politikave që do ndiqen lidhur me parimet e shpërndarjes së fondeve, sikundër është, për shembull, parimi sipas të cilit nivelet e financimit duhet të pasqyrojnë performancën e IAL-së. Por, MASH-i nuk do të ndërhyjë në hollësitë e formulave dhe të metodave të financimit. Këto do të jenë objekt i punës së KALSH-it, i cili në rolin e tij si organ ndërmjetës, do të japë rekomandimet e duhura. Alokimi përfundimtar i buxhetit, me këshillim nga KALSH-i, do të mbetet gjithsesi përgjegjësi e MASH-it.

128. Aspekti përfundimtar i financave lidhet me kontrollin mbi shpenzimet e fondeve publike. Ligji i AL (2007) dhe kjo strategji synojnë të rrisin nivelin e autonomisë financiare të IAL-ve. Një ndryshim pozitiv në këtë drejtim, që mund të zbatohet shpejt, është reduktimi i zërave sipas të cilave IAL-të detyrohen të detajojnë projektbuxhetet e tyre dhe që janë, për rrjedhojë, objekt kontrolli të centralizuar. Edhe në të ardhmen, çdo IAL do të ketë nevojë të përgatisë buxhetin e saj rrjedhës në detaje, por ky detajim do të jetë në funksion të shpërndarjes dhe kontrollit të brendshëm financiar. Kur një IAL do të ketë marrë statusin e një institucioni publik me autonomi të plotë financiare, kontrolli qendror i Qeverisë do të jetë për buxhetin në tërësi, të përbërë prej vetëm dy zërash, kostot operative dhe pagat; madje edhe këto, në një zhvillim të mëtejshëm, do të shkrihen në një bllok. Një tjetër ndryshim i realizuar nga Ligji i AL (2007), është që IAL-të kanë të drejtë të bartin fondet e përdorura (nga të ardhurat e tyre) në vitin pasardhës, gjë që u rrit atyre mundësitë për të akumuluar kursime dhe rezerva. Në kushtet e autonomisë së plotë, e drejta e bartjes do të zbatohet edhe për fondet nga Buxheti i Shtetit.

129. Gjatë rrugës drejt autonomisë së plotë, do të hidhen disa hapa të rëndësishëm për ndryshimin e kontrollit të buxhetit për pagat. Hapi i parë do të jetë që kontrolli qendror të ushtrohet mbi totalin e buxhetit për pagat dhe jo mbi numrin e personelit. Kjo nënkupton që IAL-të të vendosin vetë për numrin e personelit të tyre (akademik ose jo), brenda buxhetit që u është alokuar për pagat. Hapi i dytë do të jetë shkrirja e zërit të pagave dhe atij të kostove operative në një bllok të vetëm, me kontroll qendror vetëm për bllokun total. Shënim: ky duhet të jetë hapi i parë sepse kjo fazë është kaluar sepse projektbuxheti i vitit 2009 i cuar në parlament, shkrirja e zërit të pagave dhe atij të kostove operative në një bllok të vetëm, me kontroll qendror vetëm për bllokun total. Hapi

përfundimtar do të jetë që IAL-të të vendosin vetë për nivelet e pagave të personelit të tyre – kjo pritet të realizohet në fazën e fundit të tranzicionit ose pas kapërcimit të tij.

130. Grupi i Financës do të përcaktojë afatet për konceptimin e këtyre ndryshimeve dhe vënien e tyre në zbatim.

#### **4. RRJEDHOJAT PËR BURIMET**

131. Kjo strategji do të zbatohet në vitet që mbeten brenda periudhës që ajo mbulon, pra deri në vitin 2013 – dhe për disa aspekte, edhe përtej kësaj periudhe. Zbatimi i saj do të kërkojë tipe të ndryshme burimesh, ku ato financiare janë vetëm një prej tyre. Në këtë kuadër, kontributi i disa strukturave, organeve apo agjensive, do të jetë po aq i rëndësishëm sa edhe sigurimi i burimeve të financimit.

132. Tri nga strukturat kryesore ekzistojnë tashmë prej disa vitesh: vetë MASH-i, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) dhe Instituti i Kurrikulave dhe i Trajnimit (IKT). E katërta sapo është krijuar – KALSH-i. Në strategji parashikohet ngritja edhe e dy strukturave të reja: Agjencia për Pranimet në IAL (APIAL) dhe Grupi për Strategjinë e Kërkimit Shkencor. Këto gjashtë struktura apo agjenci, do të kenë role specifike shumë të rëndësishme në zbatimin e Strategjisë së Arsimit të Lartë.

##### **Agjensitë zbatuese si burime**

##### **Ministria e Arsimit dhe Shkencës**

133. MASH-i sigurisht është nyja qendrore për zbatimin e strategjisë. Për një periudhë të gjatë, ky dikaster ka operuar si organ administrativ me kapacitete të kufizuara analitike dhe ekzekutive. Strategjia synon rritjen e kapacitetit analitik të MASH-it, në mënyrë që ai të mund të zhvillojë në vazhdimësi politikatat kryesore arsimore në shkallë vendi, të diskutojë dhe argumentojë në qeveri nivelet e nevojshme të financimit të AL dhe në veçanti, t'i japë mbështetje analitike KALSH-it, për kryerjen e funksioneve të veta si organ këshillimor i pavarur.

134. Strategjia nuk synon të fuqizojë kompetencat ekzekutive të MASH-it, por Ministri i Arsimit do të mbetet propozuesi në qeveri i hapjes, mbylljes apo shkrirjes së IAL-ve dhe do të duhet të miratojë statutet e tyre. Ministri do të jetë, gjithashtu, vendimmarësi përfundimtar për shumë nga çështjet e këshilluara prej pesë strukturave të tjera zbatuese, apo “ndërmjetëse”, përjashtuar ato që kërkojnë miratim të Këshillit të Ministrave.

135. Për secilën nga strukturat ndërmjetëse, është përgjegjësi e Ministrit që të përcaktojë termat e referencës, mënyrën e raportimit dhe të monitorimit, si dhe kriteret e përbërjes. Strategjia parashikon që roli i këtyre strukturave të vijë duke u fuqizuar, gjë që do të rezultojë në ndihmë të rritjes së kapacitetit të vet MASH-it për bërjen e politikave.

##### **Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë**

136. APAAL-i ekziston prej vitit 1999 dhe funksionet e saj kanë ardhur duke u konsoliduar. APAAL-i do të vazhdojë të luajë rolin e tij për zhvillimin e standardeve dhe procedurave për sigurimin e cilësisë, për monitorimin e sistemeve të brendshme të sigurimit të cilësisë të çdo IAL-je dhe për akreditimin e tyre. Procesi i vlerësimit të jashtëm të cilësisë është aktualisht i detyrueshëm për çdo IAL në Shqipëri (publik apo privat) dhe në periudhën e mbuluar nga kjo strategji ky proces do të kryhet rigorozisht për të gjithë IAL-të. Për kryerjen e vlerësimeve sa më objektive dhe profesionale, veçanërisht të programeve të studimit dhe të metodave të mësimdhënies, synohet që në këtë proces të angazhohen në mënyrë sistematike edhe ekspertë të huaj. Në kuadrin e planit të veprimit, APAAL-it do t'i kërkohej të bëjë propozime konkrete dhe realiste për arritjen këtij synimi.

137. APAAL-i do të vazhdojë të asistojë IAL-të për ngritjen e sistemeve të tyre të brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Pasi IAL-të të aftësohen për të zhvilluar procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, vëmendja e APAAL-it do të përqendrohet më tepër në kontrollin e vlefshmërisë së këtij procesi dhe në auditimin e sistemeve të tyre (të IAL-ve) të Sigurimit të Cilësisë, në tërësi. Ky auditim do të jetë pjesë e vlerësimit të jashtëm institucional, i cili do të kryhet periodikisht në periudha jo më të gjata se 6 vjet. Raportet e APAAL-it mbi vlerësimin e jashtëm të IAL-ve do të vazhdojnë të bëhen publike dhe përfundimet e tyre do të përfshihen në raportet vjetore të IAL-ve përkatëse.

138. Plani i veprimit parashikon kërkesën që APAAL-i të kryejë rolin e vet në drejtim të Sigurimit të Cilësisë për sistemin me kohë të pjesshme, në të njëjtën mënyrë si për atë me kohë të plotë. Sigurimi i Cilësisë do të shtrihet gjatë periudhës që mbulon kjo strategji në të tre ciklet e studimit, përfshirë edhe të gjitha programet Master, të cilat ende nuk kanë filluar të vlerësohen në këtë aspekt. Kontrolli i cilësisë për programet e doktoraturës është më i vështirë të realizohet, por jo më pak i rëndësishëm. Përvoja relativisht e pakët lidhur me këto programe dhe konstatimi se standardet e doktoraturave shqiptare nuk u përgjigjen gjithmonë standardeve ndërkombëtare, e bëjnë të domosdoshme shtrirjen sa më të shpejtë të mekanizmave të Sigurimit të Cilësisë në ciklin e tretë. Plani i veprimit parashikon një ekspertizë ndërkombëtare për shqyrtimin e mënyrës së realizimit të doktoraturës në Shqipëri dhe të kërkesave ndaj saj, me synim përputhjen e standardeve të doktoraturave shqiptare me ato të HEAL.

139. Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, vëmendje e veçantë do t'u kushtohet stilit dhe metodave të mësimdhënies. APAAL-i do të vlerësojë progresin e IAL-ve në drejtim të zhvillimit të metodave të reja, që venë në qendër studentin dhe që e bëjnë më ndërveprues procesin mësimor. APAAL-i do të shqyrojë gjithashtu edhe mjetet me të cilat çdo IAL gjykon mbi shkallën e zbatimit të metodave të reja të mësimdhënies nga personeli i vet akademik. Ky shqyrtim do të përfshijë detyrimisht edhe mënyrën e administrimit të informacionit të vjelë nga reagimet (feedback) e studentëve, kryesisht nëpërmjet pyetësorëve. Do të jetë me vlerë të veçantë për APAAL-in angazhimi në këtë proces edhe i ekspertëve të huaj, zgjedhja e të cilëve duhet bërë me kujdes, sepse metodat e mësimdhënies nuk janë universale apo të unifikuara brenda BE-së.

#### **Instituti i Kurrikulave dhe i Trajnimit (IKT)**

140. Ky institut do të vazhdojë të përmbushë rolet e tij kryesore:

- zhvillimin e dokumenteve të politikave dhe të orientimeve si edhe të planeve të veprimit për trajnimin e mësuesve në shërbim,
- specifikimin dhe miratimin e përmbajtjes së moduleve për trajnimin në shërbim, përfshirë edhe përcaktimin e moduleve të detyrueshme për kategori të caktuara mësuesish,
- identifikimin e nevojave (në aspektin sasior dhe cilësor) për trajnime në të ardhmen,
- licencimin dhe koordinimin e trajnimeve nga ofrues të ndryshëm modulesh të miratuara – përfshirë donatorë apo OJF, që dëshirojnë të kontribuojnë në veprimtari trajnimi.

IKT nuk do të angazhohet vetë me zhvillim trajnimesh, përveç se në pak fusha të specializuara.

141. Plani i veprimit do të përcaktojë ndryshime në sistemin e financimit të trajnimit në shërbim, që do të funksionojë më shumë sipas logjikës së tregut; do të shkohet drejt asaj që fondet publike të destinuar për trajnime t'u vihen në dispozicion përfituesve të trajnimit dhe jo ofruesve të tij.

#### **Këshilli i Arsimit të Lartë dhe i Shkencës**

142. KALSH-i u krijua në vitin 2006. Ai u ngrit si organ këshillimor për MASH-in dhe Këshillin e Ministrave. Sugjerimet dhe rekomandimet e KALSH-it do të bëhen publike.

Rolet e përcaktuara në ligj janë:

- Të këshillojë për strategjitë, politikat dhe prioritetet. Një nga detyrat e e menjëherëshme do të jetë vlerësimi i planeve strategjike 5-vjeçare të propozuar nga çdo IAL për të parë përputhshmërinë me strategjinë, përshtatshmërinë me bazën e vet analitike, si edhe nivelin e ndihmës dhe që ka nevojë çdo IAL për të zhvilluar proceset e veta të qeverisjes dhe të menaxhimit.
- Të propozojë kriteret për akreditimin dhe Sigurimin e Cilësisë, në konsultim me APAAL-in, ku përfshihen edhe ato për hapjen e ciklit të dytë e të tretë të studimeve.
- Të propozojë kriteret për promovimin e personelit akademik, që do të jenë të ndryshme në IAL të ndryshme, sipas misionit të tyre.
- Të këshillojë për çështje që i kërkojnë nga Ministri.

143. KALSH-i, sikundër përcaktohet në ligjin e AL (2007), përbëhet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, 3 anëtarë "ex officio" dhe 15 anëtarë të tjerë, përzgjedhur nga personalitete të arsimit dhe të shkencës në Shqipëri.

144. Në dy ose tre vitet në vijim, parashikohet që KALSH-i të zhvillohet më tepër si "organ ndërmjetës, mbështetës", mes MASH-it dhe IAL-ve, që i jep Ministrin këshilla të pavarura të bëra

publike mbi politikat dhe mbi çështje të rëndësishme operative dhe ekzekutive. Është e rëndësishme që këto këshilla të pasqyrojnë pikëpamjet e komunitetit akademik, por edhe ato të shoqërisë më gjerë. Struktura dhe funksionet e KALSH-i do të përshtaten në të ardhmen krahas transformimit të IAL në shkolla të larta krejtësisht publike dhe zgjerimit të sektorit të AL privat.

145. KALSH-i do të jetë organi parësor këshillimor për MASH-in dhe për Qeverinë në kuptimin më të gjerë, për zgjerimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të sistemit, dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e kësaj Strategjie. KALSH-i do të rishikojë vazhdimisht Strategjinë, duke i dhënë sugjerime Ministrit dhe Qeverisë për ndryshime të nevojshme, e në të njëjtën kohë, do të mbikqyrë edhe zbatimin e Planit të Veprimit.

146. Parashikohet që roli i KALSH-it të zgjerohet për të dhënë këshilla, që do bëhen publike, kryesisht për dy funksione ekzekutive të lidhura me drejtime strategjike të zhvillimit të AL. Në secilin rast, vendimi përfundimtar, mbi bazë të këtyre këshillimeve, do të jetë formalisht përgjegjësi e Ministrit dhe/ose Këshillit të Ministrave, siç do jetë e përcaktuar.

147. Një nga dy funksionet ekzekutive dhe më strategjike për të cilat KALSH-i do të japë këshillime ka të bëjë me shpërndarjen e numrit të studentëve të rinj për çdo IAL, sipas ciklit dhe në kategori degësh e programesh studimi. Shpërndarja e numrit të studentëve është mjeti nëpërmjet të cilit do të përcaktohet rritja ose jo e IAL-ve dhe do të kushtëzojë nivelin e fondeve publike që një IAL do të marrë për mësimin. Shpërndarja e fondeve do të marrë parasysh disa faktorë dhe totali për të gjitha IAL-të së bashku do të duhet të jetë brenda kufijve të buxhetit të përgjithshëm për AL.

148. Sigurimi i rekomandimeve nga KALSH-i për shpërndarjen e numrit të studentëve, do të ketë nevojë për një bazë të dhënash për studentët, për tregun e punës dhe për treguesit e cilësisë së IAL-ve dhe fakulteteve të tyre. Zhvillimi i një banke të tillë të dhënash dhe përditësimi i saj në vazhdimësi, kërkon marrëdhënie më të ngushta me çdo IAL. Plani i veprimit do të përfshijë edhe një afat kohor për diskutimet për këtë çështje mes KALSH-it dhe Konferencës së Rektorëve, për të parë mënyrën më të mirë të realizimit.

149. KALSH-i do të ketë edhe një funksion të dytë ekzekutiv strategjik, të ofrojë këshillime për metodat e ndryshme të financimit. Përveç të dhënave për studentët, zhvillimi dhe zbatimi i një metodologjie të re do të kërkojë të dhëna dhe një punë të konsiderueshme analitike për financim, bazuar mbi treguesit e cilësisë. KALSH-i do të ketë nevojë për kapacitet analitik të nivelit relativisht të lartë, në mënyrë që të kryejë këto funksione këshillimore. Pjesërisht, kjo do të sigurohet nga kapacitetet analitike shtesë brenda MASH-it, por plani i veprimit do të shqyrtojë edhe rrugë të tjera për të siguruar kapacitete të tilla.

#### **Agjencia për Pranimet në Institucionet e Arsimit të Lartë (APIAL)**

150. Matura Shtetërore do të zhvillohet mbi një bazë të orientuar më shumë nga aspektet lëndore. Zhvillimi dhe realizimi i Maturës Shtetërore është përgjegjësi e AVA-s (Agjencia e Vlerësimit të Arritjeve), e cila do të punojë së bashku me IAL-të për të garantuar që provimi të jetë i përshtatshëm edhe për hyrjen në IAL. Zhvillimi i Maturës Shtetërore nënkupton se procesi për pranimin e studentëve të rinj do të ketë mundësi të përdorë më shumë të dhëna për treguesit e cilësisë dhe aftësitë e kandidatëve, që do të thotë se do të bëhet më mënyrë komplekse.

151. Degët e ndryshme brenda një IAL-je, aktualisht, kanë përcaktuar peshë të ndryshme mes lëndëve të Maturës Shtetërore, të cilat përdoren për të llogaritur një rezultat të vetëm, si bazë për pranimet. Matura Shtetërore me një bazë të shëndoshë të orientuar nga lënda, nënkupton që fakultetet do të jenë në gjendje të përcaktojnë pragun e Maturës Shtetërore si kriter pranimi në secilin nga programet e tyre; këto më pas barazpeshohen nga preferencat dhe rezultatet e kandidatëve. Mbi këtë bazë, realizohet shpërndarja atje ku ata të mund të marrin zgjidhjen më të mirë të mundshme.

152. Për pranimet parashikohet ngritja e një institucioni të ri, Agjencia e Pranimeve në IAL (APIAL), e cila do të përcaktojë këto rregulla e dispozita dhe do t'i realizojë ato në vijimësi. Plani i Veprimit parashikon diskutime mes Konferencës së Rektorëve dhe KALSH-it, për të vendosur mënyrën e administrimit të APIAL-it.

### **Grupi i Strategjisë për Kërkimin Shkencor**

153. Për kërkimin, me prioritetet për temat që mund dhe duhet të bëhen mirë në Shqipëri si psh., albanologji, bujqësi dhe industri ushqimore, aspekte të burimeve natyrore, etj., nevojitet një strategji kombëtare e qartë. Për këtë qëllim, parashikohet të ngrihet një grup i përhershëm i nivelit të lartë, Grupi për Strategjinë e Kërkimit Shkencor, i cili do të funksionojë nën KALSH-in. Detyra e tij do të jetë zhvillimi dhe ndjekja e vazhdueshme e Strategjisë Kombëtare për kërkimin. Grupi do të përbëhet prej personalitetesh nga komuniteti i kërkimit shkencor ashtu edhe nga ata që kanë interesa për zhvillimin ekonomik e social të ardhshëm të vendit. Plani i veprimit parashikon vlerësimin e situatës, mënyrën e organizimit si edhe mënyrat e financimit të Grupit.

### **Rrjedhime financiare**

154. Shumë nga nismat e parashikuara në Strategji kanë nevojë për financim fillestar si investim në të mira kapitale ose në burime njerëzore; disa prej zhvillimeve do të kërkojnë mbështetje financiare të vazhdueshme. Përveç financimeve nga buxheti do të kërkojnë edhe burime të tjera financimi, nga donatorë apo organizma të ndryshme në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe. Burimi kryesor i financimit do të mbetet buxheti i shtetit. Mbështetur në programin e Qeverisë, shpenzimet publike për arsimin në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) parashikohen të rriten nga 2.8% në vitin 2006 në 5% në vitin 2011. Pjesa e shpenzimeve publike për AL parashikohet të rritet nga 0.66% në vitin 2006, në 1% të PBB në vitin 2011. Strategjia konsideron një burim të rëndësishëm financimi rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në AL në formën e (i) hapjes së shkollave të larta private që plotësojnë standartet e cilësisë, dhe (ii) bashkëfinancimit të programeve të veçanta të studimeve në IAL publike përkundrejt aksesit në vendimmarrje dhe autonomisë së plotë në administrimin financiar. Prirja e rritjes së shpejtë të peshës së investimit të sektorit privat në zhvillimin e AL në vendet e BE duhet të gjej zbatim edhe në vendin tonë, i cili karakterizohet nga një raport disproporcional midis kërkesës së lartë për shkollim të lartë dhe burimeve të kufizuara buxhetore për investime. Në vendet e BE investimet e sektorit privat në AL zënë mesatarisht rreth 27 % të shpenzimeve totale për AL. Aktualisht nuk ka të dhëna të sakta mbi përqindjen që zë sektori privat në totali i shpenzimeve për AL në vend. Sidoqoftë pesha e ulët që zë AL privat (më pak se 10 %) tregon se Shqipëria ka resurse investimi private për AL së paku tri herë më të mëdha se sa përqindja aktuale e investimit. Në këtë këndvështrim, rritja me rreth 3 herë e peshës së AL privat në vendin tonë do të ishte një objektiv realist për periudhën deri në vitin 2013.

155. Tabela në vijim përcakton shpenzimet kryesore shtesë që kërkojnë për realizimin e strategjisë. Përveç shpenzimeve të paraqitura do të ketë edhe efekte të tjera financiare, sikurse janë ato që rrjedhin prej integritit të instituteve të kërkimit pranë IAL-ve.

KËRKESAT FINANCIARE TË STRATEGJISË

Qëllimi (numrat tregojnë paragrafët në Strategji)	Aktivitete dhe çështje	Metoda e alokimit	\$ '000				Vitetore	Viti
			Investimet					
			Personel lokal	Pajisjet etj.	As. tekn e jashtme			
79. Bolonja: Kurrikulat standardet, trajnimi	Asistenca teknike ndërkombëtare plus kohën e personelit	Organizimi qendror	0	0	300 (80)	0	07	
42. Përmirësimi i laboratorëve për mësimdhënie	Pajisje kompjuterike dhe orendi mbështetëse	IAL-të bëjnë propozime me kostot përkatëse të argumentuara	0	4,800	0	-	07/09	
34. Zhvillimi i diplomave 2- vjeçare	Kosto kryesisht për personelin, plus pajisje të reja dhe 50% e kohës së 1 personi për të stimuluar zhvillimin e vazhdueshëm	IAL-të konkurrojnë për një fond – propozime të përbashkëta preferohen	300	200	0	50	08/09	
57. IAL-të rajonale zhvillohen si qendra zhvillimi (ekonomike dhe sociale)	Asistencë teknike për zhvillimin rajonal; zyrë e vogël bashkëpunimi në çdo IAL rajonale	Projekt qendror “orientimi” plus ndihmë lokale; çdo IAL bën një plan zhvillimi me kostot përkatëse brenda një limiti buxheti	200	0	300	120	vjetore	
63. Lehtësimi i integrit të Inst. Kërkimore në Univ.	Kosto personeli	IAL-të paraqesin kërkesat (me kosto)	100	0	0	-	08	
63. Fonde 'dysHEME' për IAL-të rajonale që të zhvillojnë kapacitete kërkimi në 1-2 fusha specifike	Kosto personeli për një post shtesë për shqyrtimin e aplikimeve të projekteve të kërkimit	Një shkallë rrafsh çdo vit për çdo IAL rajonale (6 x \$20k)	0	0	0	120	vjetore	
74. Përmirësimi i stilit të mësimdhënies dhe metodave për gjithë personelin akademik	Organizim qendror për zhvillimin e personelit (IAL-të gjithashtu zhvillojnë programet e tyre; pajisje për personelin qendror dhe për çdo IAL	Ekspertizë ndërkombëtare për organizimin qendror. Çdo IAL bën propozimet dhe konkurron për zhvillim personeli	1,500 (pagesa për personelin që do ta ndjekë, shpenzime, admin, etc)	700	750	0	08-'11	
77. Për kurse ndër- disiplinare më të gjera	Kosto zhvillimi për personelin	IAL-të konkurrojnë për fond – preferohen propozime të përbashkëta	200	0	0	0	08/09	
78. Gjithë studentët përfitojnë kurse në	Kosto personeli, asistencë e jashtme (lokale) materiale, kaseta etj., Zhvillim në	Çdo IAL bën plane zhvillimi brenda një limiti buxheti	200	100	0	200	08/09 +vjetore	

anglisht dhe kompjuter	08/09 dhe më pas mbi bazë vjetore						
80. Tip i ri për formën me kohë të pjeshme	Kohë stafi për të identifikuar tregjet e vërteta part-time dhe për të zhvilluar kurse për to.	IAL-të konkurrojnë për fond, bazuar në analizën e kërkesës	100	0	0	0	08/09
87. Trajnim për mësuesit në shërbim, më i mirë dhe më i gjerë	Zhvillimi i kuadrit të përmirësuar/plotësuar, duhet bërë realizimi	Më shumë fonde dhënë rajoneve (më pas shkollave) që të "blejnë" trajnim nga ofrues të ndryshëm	0	0	0	2,000	vjetore
101. Procese menaxhimi të përmirësuara në çdo IAL	Asistencë teknike lokale dhe e huaj, plus kohën e stafit	Terma qendrorë reference për asistencë teknike; IAL-të zgjedhin ofruesin e as. teknike	200	0	500	0	08/09
Vlerësime e studime për planin e veprimit	Asistencë teknike lokale dhe e huaj	E përcaktuar në mënyrë qendrore	100	0	50	0	07/08
<b>TOTAL</b>			<b>2,900</b>	<b>5,800</b>	<b>1,900</b>	<b>2,500</b>	
79. Rifreskimi i infrastrukturës (pajisje dhe ndërtesa)	Investime në pajisje dhe për përmirësimin e ndërtesave	Plan kombëtar mbi bazë të një anketimi (studimi) për infrastrukturën, alokimi në IAL bazuar në propozimet e argumentuara të paraqitura	Mendohet të jetë shumë e madhe, ndoshta 5 milionë USD, - që do shpërndahet në disa vite				
35. Infrastruktura që duhet për zgjerimin e sistemit	Investime në pajisje e ndërtesa	Kjo do të arrihet nëpërmjet zgjerimit të IAL-ve ekzistuese (kryesisht rajonale)	Nevojitet më tepër punë për të vlerësuar kostot kapitale, por mund të jenë 25-30 milionë USD mesatarisht në vit për 10 vjet; kostot rrjedhëse shtesë për zgjerim do të jenë 5-6% për vit. (rreth \$3-3.5 milionë për vit)				



156. Kostoja vjetore shtesë e drejtpërdrejtë për realizimin e strategjisë është 2.5 milionë USD. Në të nuk përfshihen kostot rrjedhëse shtesë të zgjerimit; ato do të parashikohen çdo vit në Buxhetin e Shtetit. Në vitin 2006 buxheti për AL-të ishte rreth 60 milionë USD, përfshirë pagat; kështu që kostot e drejtpërdrejta për realizimin e strategjisë do të kërkojnë vetëm një rritje prej 4%. Kostot shtesë të zgjerimit të sistemit do të përfaqësojnë një rritje të buxhetit prej 5-6% në vit.

157. Mbështetja e investimeve me burime të huaja financimi që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e strategjisë është 5.8 milionë USD për vitet 2008-2009; pjesa më e madhe e saj do të sigurohet nga projekti “Cilësi e barazi në arsim”. Krahas kësaj janë në zhvillim edhe nisma të tjera për sigurimin e financimeve shtesë, të tilla si ajo për ndërtimin e rrjetit akademik, mbështetur me 4 milionë euro nga qeveria Italiane dhe e ngritjes së Njesisë Speciale të Pedagogjisë në Universitetin e Vlorës, mbështetur me 3 milionë euro nga qeveria zvicerane. Parashikohet që për zhvillimin e infrastrukturës aktuale në nivele bashkëkohore si edhe për zgjerimin e sistemit, nevojiten investime kapitale të rendit prej 3 milionë USD shtesë vjetore në vazhdimësi gjatë një periudhe 10-vjeçare.

##### 5. Llogaridhënia, monitorimi dhe vlerësimi

158. Strategjia për AL është ambicioze. Ajo përfshin shumë politika, që do ta ndryshojnë në mënyrë thelbësore sistemin, gjë që nuk do të jetë e lehtë, për më tepër që kërkojnë edhe ndryshime të kulturës brenda IAL-ve. Disa prej ndryshimeve më radikale, si shndërrimi i IAL-ve nga shtetërore në publike, me autonomi të plotë, parashikohet të shtrihet gjatë periudhës 7-vjeçare të strategjisë. Është e rëndësishme të ndiqet nga afër ky transformim, si dhe të vendoset se çfarë përshtatjesh mund të nevojiten për politikën në rrjedhën e procesit.

159. Monitorimi i arritjeve të synimeve të strategjisë nuk është i lehtë. Kjo strategji synon përmirësimin e AL në mënyrë që të përmbushen më mirë nevojat e vendit dhe Shqipëria të zërë vendin e vet, krahas kombeve të tjera europiane, për sa i përket cilësisë dhe rëndësisë së IAL-ve të saj. Për realizimin e të gjitha këtyre objektivave, masat nuk do të jenë të thjeshta.

160. Matja e rezultateve reale të sistemit është relativisht e pamjaftueshme. Ekzistojnë matës të thjeshtë për këto rezultate, ku më kryesoret janë:

A. Përputhja e të diplomuarve me nevojat e tregut të punës dhe me politikën e punësimit apo të zvogëlimit të papunësisë.

B. Përputhja e kërkesave të maturantëve për vende në AL.

C. Shkalla e lidhjeve mes IAL-ve dhe bizneseve për sa i përket veprimtarive të përbashkëta dhe kontratave.

D. Botimi i artikujve shkencorë në revista me indeks ndërkombëtar.

161. Për secilin nga matësit realë të rezultateve, do të përdoren tregues sasiore, por natyrisht ato nuk do të “tregojnë gjithçka” për zbatimin apo ndikimin e strategjisë në sistem. Megjithatë, matësit për temat kryesore të politikave të kësaj strategjie, do të jenë procese apo rezultate ndërmjetëse ose madje nga një këndvështrim i studentëve, do të jenë kontributet në hyrje të sistemit (inputs): përmasa më të zgjeruara, sistem më i diferencuar, mësimdhënie dhe të nxënë më i mirë, qeverisje dhe sistem financiar më produktiv.

162. Është vështirë të bëhet dallimi mes matësve të rezultateve (outputs), të procesit dhe të kontributeve hyrëse, në një sferë aq komplekse dhe afatgjatë si AL-ja, me përjashtim të rasteve kur këta matës janë të thjeshtë. Lista e matësve të përshkruar më poshtë për strategjinë, ku vetëm disa prej tyre janë sasiore, ka një kombinim të tre tipeve (rezultate të ndërmjetme, matës të procesit dhe kontribute në hyrje). Secili prej tyre ofron informacion me vlerë mbi disa aspekte të strategjisë, që krijojnë mundësi për të monitoruar progresin dhe mënyrën e zbatimit të saj.

163. Përveç katër treguesve të rezultateve A-D, të dhëna më sipër, do të përdoren edhe treguesit e mëposhtëm për të monitoruar Strategjinë (numrat në kllapa i referohen paragrafit të Strategjisë ku shqyrtohet çështja);

1. Përqindja e PPB (GDP) për AL (26).

2. Rritja e sistemit nga pjesëmarrja e grupmohës dhe përqindja e studentëve që studiojnë në drejtimet e shkencave dhe formimet inxhinierike (31).

3. Numri i diplomave të AL jo-univeritar, të ofruar nga IAL-të rajonale dhe nga ato të Tiranës, dhe numri i studentëve në to (34).

4. Numri i vendeve të reja në çdo IAL (35).

5. Raporti personel/student (39).
6. Numri i personelit që është trajnuar për të zhvilluar shprehitë e mësimdhënies (40).
7. Fondet e shpenzuara për pajisjet e reja (42).
8. Zhvillimi i studimeve me kohë të pjesshme në funksion të atyre që kanë nevojë për to (46).
9. Numri i vendeve në IAL-të private (48).
10. Zhvillimi i Maturës Shtetërore në ngjashmëri me modelet e përparuara europiane (49).
11. Ngritja dhe funksionimi i një organi të ri për pranimet në IAL (50).
12. Numri i IAL-ve që kanë prospectus me cilësi të mirë e që synon informimin e studentëve potencialë (51).
13. Ngritja e Shërbimit Këshillimor për Karrierën për maturantët (51).
14. Përcaktimi dhe zbatimi i kriterëve të qarta për IAL-të që të ofrojnë studimet e ciklit të dytë e të tretë (54).
15. Shndërrimi i IAL-ve rajonale në “Qendra të Zhvillimit Rajonal” të orientuara në përmbushjen e nevojave lokale dhe me lidhje të mira me komunitetin e tyre (56).
16. Ngritja dhe funksionimi i Grupit të Strategjisë për Kërkimin Shkencor dhe përgatitja e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit (60).
17. Krijimi i një sistemi për alokimin e granteve për projektet kërkimore (61).
18. Integrimi i instituteve të kërkimit në IAL-të (63).
19. Numri i IAL-ve që kanë një sistem për përcaktimin e ngarkesës së personelit akademik (67).
20. Numri i IAL-ve që në statutet e tyre parashikojnë rregulla për parandalimin e abuzimeve të stafit me detyrën (68).
21. Kriteretë ndryshme promovimi për personelin akademik, të lidhur me misionin e IAL-së (69).
22. Pranim në masë të gjerë se natyra e marrëdhënieve mes personelit akademik dhe studentëve duhet të jetë ndërvepruese dhe e bazuar në diskutime, mendimin kritik dhe zhvillimin e ideve, dhe jo thjesht transmetim faktesh (75).
23. Përqindja e personelit akademik që është përfshirë në veprimtari zhvillimi për të përmirësuar stilin dhe metodat e mësimdhënies (77).
24. Numri i IAL-ve që zbatojnë një sistem të vlerësimit të performancës për personelin (77).
25. Numri i IAL-ve të vlerësuar nga APAAL-i në lidhje me metodat e mësimdhënies në kuadrin e procesit të sigurimit të cilësisë (78).
26. Numri i IAL-ve që zbatojnë një sistem modularizimi dhe transferimi kreditesh për kurset e studimit (79).
27. Numri i programeve të studimeve ndër-disiplinare (80).
28. Numri i IAL-ve që ofrojnë kurse intensive për TIK dhe gjuhë anglezë për të gjithë studentët (81).
29. Numri i pajisjeve të reja të blera nga çdo IAL, fakultet ose program formimi (82).
30. Përqindja e kohës së shpenzuar në klasë në përgatitjen fillestare për mësues të shkollave të arsimit bazë, në ciklin e parë (85).
31. Përqindja e kohës së shpenzuar në klasë në përgatitjen fillestare për mësues të shkollave të mesme sipas modelit 3+N (87).
32. Përdorimi i një metode financimi, më të orientuar nga tregu, për trajnimin në shërbim të mësuesve (90).
33. Numri i IAL-ve që kanë një plan strategjik 5-vjeçar të miratuar, në përputhje me Strategjinë (91).
34. Numri i IAL-ve që funksionojnë me struktura dhe procese të reja qeverisëse për vendimmarrjen e tyre (95).
35. Zhvillimi dhe zbatimi i metodës së përzgjedhjes së autoriteteve drejtuese të IAL-ve dhe i performancës së tyre (95).
36. Numri i IAL-ve që i kanë shndërruar këshillat e tyre të Adminstrimit në Borde të Jashtme (99).

37. Numri i IAL-ve që publikojnë raport vjetor të veprimtarisë së tyre (102).
38. Numri i IAL-ve që janë shndërruar nga shtetërore në publike (104).
39. Përqindja nga totali i buxhetit që çdo IAL e realizon me kontrata të jashtme (106).
40. Ekzistenca e një kuadri të vetëm në bazë IAL-je për tarifat e shkollimit (108).
41. Ekzistenca e një sistemi të ri që ofron mbështetje financiare për studentë në nevojë (110).
42. Konceptimi dhe shkalla e zbatimit të një formule të re financimi për alokimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit (113).
43. Ekzistenca e një baze racionale për përcaktimin e numrit të studentëve që do shpërndahen sipas degëve dhe cikleve në çdo IAL (114).
44. Përmasat e financimeve për nisma të veçanta, të alokuar përgjithësisht mbi bazë të propozimeve konkurruese nga IAL-të (119).
45. Përmasat e investimit për përmirësimin e infrastrukturës aktuale të IAL-ve (124).
46. Sasia e fondeve të investimit për zgjerimin e sistemit (125).
47. Zvogëlimi i numrit të zërave që duhet të përdorin IAL-të në paraqitjen e buxhetit dhe alokimi i Buxhetit të Shtetit si bllok i vetëm (128).
48. Kontrolli qendror mbi personelin nëpërmjet buxhetit total për pagat (129).
49. Zgjerimi i kapacitetit analitik të Ministrisë (133).
50. Ekzistenca e ciklit të rregullt i vlerësimit të jashtëm për gjithë IAL-të (136).
51. Ekzistenca e vlerësimeve të APAAL-it për programet me kohë të pjesshme dhe për programet e ciklit të dytë (138).
52. Kualifikimet doktorale, PhD, kanë arritur nivelin si në vende të tjera europiane (138).
53. Dy të tretat e anëtarëve nga KALSH-i janë nga jashtë sferës akademike (144).
54. Ministri i delegon detyrën kryetarit të KALSH-it (144).
55. Ekzistenca dhe funksionimi i një baze të dhënash për studentët (148).
56. Ngritja dhe funksionimi i një organi të ri për pranimet në IAL (150).

## **6. PËRFUNDIME**

164. Masterplani për AL u përgatit si dokument paraprak i kësaj strategjie. Ai u bë objekt diskutimi e konsultimi në gjithë Shqipërinë, brenda komunitetit akademik dhe më gjerë. Masterplani iu dërgua edhe një grupi ekspertësh nga Këshilli i Europës, që dhanë komente me vlerë, të cilat u morën në konsideratë në përgatitjen përfundimtare të Strategjisë. Ky dokument paraqitet tani si strategji e miratuar prej Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, pas konsultimeve me KALSH-in.

165. Tashmë ka filluar procesi i zhvillimit të një plani veprimi që do të zërthejë politikat e përcaktuara në këtë strategji në detaje të mjaftueshme për zbatimin e drejtpërdrejtë. Kjo përgatitje përfshin disa grupe pune që po punojnë për termat e referencës dhe për planifikimin kohor.

## **VENDIM**

**Nr.1549, datë 19.11.2008**

### **PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

## **VENDOSI:**

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, të jenë 4 845. Këto kuota ndahen, si më poshtë vijon:

- |  |        |
|--|--------|
| a) për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 3 045; |
| b) për programe të dyta studimi                                    | 1 400; |
| c) për transferim studimesh  | 200;   |
| ç) për shtetasit e huaj  | 200.   |

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, sipas shkronjave “a” e “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Këto kuota ndahen në raportin 2:1, përkatësisht, pranime të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, sipas shkronjës “a” të pikës 1, dhe programe të dyta studimi, sipas shkronjës “b” të pikës 1.

3. Kuota e pranimeve për transferim studimesh, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuota e pranimeve për shtetasit e huaj, sipas shkronjës “c”, të pikës 1, të këtij vendimi, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahet, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe të kërkesave individuale të tyre.

5. Çdo shtetas shqiptar, që ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron dëftesë pjekurie a çdo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, ka të drejtë të kandidojë për t’u pranuar në studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

6. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve, në Tiranë, duhet t’u nënshtrohen kritereve të veçanta (konkurseve të pranimit), të vendosura nga ky institucion, për pranimet në këto programe studimi.

7. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar sipas pikave 1, shkronja “c”, dhe 3, të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe të bëra publike, paraprakisht.

8. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin studimet, me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, do ta fitojnë këtë të drejtë, sipas kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë dhe të bëra publike, paraprakisht.

9. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2008-2009, të jenë, si më poshtë vijon:

- |   |              |
|---|--------------|
| a) në Universitetin e Tiranës:                              |              |
| i) Histori  | 52 000 lekë; |
| ii) Gjeografi   | 52 000 lekë; |
| iii) Gjuhë-Letërsi  | 52 000 lekë; |
| iv) Drejtësi  | 93 600 lekë; |
| v) Biologji   | 62 400 lekë; |
| vi) Financë-Kontabilitet                                    | 72 800 lekë; |
| vii) Administrim-Biznes                                     | 72 800 lekë; |
| viii) Psikologji  | 52 000 lekë; |
| ix) Punë sociale  | 52 000 lekë. |
| b) Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”: |              |
|   | 62 400 lekë. |
| c) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:                    |              |
| i) Menaxhim agrobiznesi                                     | 52 000 lekë; |
| ii) Ekonomi dhe politikë agrare                             | 52 000 lekë; |
| iii) Hortikulturë   | 52 000 lekë; |
| iv) Prodhim bimor   | 52 000 lekë; |
| v) Zootekni dhe biznes blegtoral                            | 52 000 lekë; |
| vi) Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi                       | 52 000 lekë; |

vii) Teknologji agrourbueshmëri	52 000 lekë;
viii) Agromekanizim	52 000 lekë;
ix) Vreshtari dhe enologji	52 000 lekë;
x) Inxhinieri pyjesh	62 400 lekë;
xi) Inxhinieri përpunim druri	62 400 lekë;
xii) Financë-Kontabilitet	62 400 lekë;
xiii) Mbrojtje bimësh	62 400 lekë;
xiv) Agromjedis dhe ekologji	62 400 lekë.
ç) Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:	
i) Histori-Gjeografi	41 600 lekë;
ii) Gjuhë-Letërsi	41 600 lekë;
iii) Edukatë qytetare	41 600 lekë;
iv) Punë sociale	41 600 lekë;
v) Filozofi-Sociologji	41 600 lekë;
vi) Administrim-Biznes	52 000 lekë;
vii) Financë-Kontabilitet	52 000 lekë;
viii) Biologji-Kimi	52 000 lekë;
ix) Cikli i ulët	31 200 lekë;
x) Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
xi) Matematikë-Fizikë	31 200 lekë.
d) Në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër:	
i) Histori-Gjeografi	31 200 lekë;
ii) Financë-Kontabilitet	41 600 lekë;
iii) Biologji-Kimi	41 600 lekë;
iv) Cikli i ulët	31 200 lekë;
v) Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
vi) Matematikë- Fizikë	31 200 lekë;
vii) Gjuhë-Letërsi	31 200 lekë;
viii) Administrim publik	41 600 lekë;
ix) Menaxhim turizëm	41 600 lekë.
dh) Në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë:	
i) Gjuhë-Letërsi	31 200 lekë;
ii) Financë	41 600 lekë;
iii) Cikli i ulët	31 200 lekë;
iv) Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
v) Menaxhim biznesi	41 600 lekë;
vi) Turizëm	41 600 lekë;
vii) Hortikulturë	31 200 lekë;
viii) Agrobiznes	31 200 lekë;
ix) Marketing	41 600 lekë.
e) Në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër:	
i) Gjeografi	41 600 lekë;
ii) Financë-Kontabilitet	52 000 lekë;
iii) Turizëm	52 000 lekë;
iv) Administrim- Biznes	52 000 lekë;
v) Biologji-Kimi	52 000 lekë;
vi) Histori	41 600 lekë;
vii) Cikli i ulët	31 200 lekë;
viii. Cikli i ulët parashkollor	31 200 lekë;
ix) Matematikë	31 200 lekë;
x) Fizikë	31 200 lekë;
xi) Gjuhë-Letërsi	41 600 lekë;
xii) Juridik	72 800 lekë.

ë) Në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë:

i) Infermieri

41 600 lekë.

10. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbërit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, personat e papunë, personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, nënat, që janë kryefamiljare, studentët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, ish-të përndjekur politikë, që do të fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, përjashtohen nga tarifa e shkollimit.

Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që i përkasin po këtyre shtresave shoqërore.

11. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

12. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin pasardhës.

13. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur në marrëveshjet zyrtare shtetërore janë përcaktuar mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave.

14. Kuotat e pranimeve në studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

15. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.181, datë 19.12.2008, faqe 8990

#### KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AEFS	Σ
1	Histori	150						60			210
2	Gjeografi	150						60			210
3	Histori-Gjeografi				60	60					120
4	Gjuhë-letërsi	150			60	60	40	60			370
5	Gazetari										0
6	Edukatë qytetare				80						80
7	Anglisht										0
10	Frëngjisht										0
11	Italisht										0
12	Gjuhë spanjolle										0
13	Rusisht										0
14	Gjermanisht										0
15	Gjuhë-letërsi greke										0
16	Gjuhë turke										0
17	Cikli i ulët				70	60	30	60			220
18	Cikli i ulët parashkollor				60	60	30	60			210
20	Fizkultura									60	60
21	Matematikë							30			30
22	Fizik							30			30
23	Inxh. Matematike dhe Informatike										0

24	Matematikë-Fizikë				60	60					120
25	Biologji-Kimi				70	60		60			190
26	Biologji	100									100
27	Kimi										0
28	Kimi ushqimore										0
29	Kimi industriale										0
30	Matematikë-Informatikë										0
31	Informatikë										0
32	Teknologji informacioni										0
33	Pune sociale	70			80						150
34	Filozofi										0
35	Filozofi-Sociologji				80						0
36	Sociologji										0
37	Pedagogji e specializuar										0
38	Psikologji	70									70
39	Shkencat politike										0
40	Drejtësi	200						60			260
66	Shëndeti publik										0
67	Mjekësi										0
68	Stomatologji										0
69	Farmaci										0
70	Infermieri e përgjithshme								150		150
71	Infermieri (Kukës)										0
72	Mami (Infermieri)										0
73	Tek. lartë laborator										0
74	Fizioterapi										0
75	Logopedi										0
76	Imazheri										0
77	Administrim publik					30					30
78	Administrim-Biznes	250			70		50	90			460
79	Ekonomik										0
80	Ekonomia dhe e drejta										0
81	Financë-Kontabilitet	250			70	30	50	90			490
82	Info.ekonomike										0
83	Administ-Biznes (Turizëm) Sarandë										0
84	Administrim-Biznes (Kukës)										0
85	Turizëm						30	90			120
86	Marketing						30				30
87	<b>PROGRAMI I STUDIMIT</b>	<b>UT</b>	<b>UPT</b>	<b>UBT</b>	<b>UE</b>	<b>UGJ</b>	<b>UK</b>	<b>USH</b>	<b>UV</b>	<b>AEFS</b>	<b>0</b>
89	Inxh. Navigacioni										0
90	Inxh. Mekanike										0
91	Inxh. Metalurgji materiale										0
92	Inxh. Tekstile dhe mode										0
93	Inxhinieri elektronike										0
95	Inxh. elektronike										0
96	Inxh. Informatike										0
97	Inxh. Telekomunikacioni										0
98	Inxh. Mekatronike										0

99	Inxhinieni ndërtimi										0
100	Inxhinien hidroteknik										0
101	Arkitekturë										0
102	Inxh. Matematike										0
103	Inxh. Fizike										0
104	Inxhinier gjeodet										0
105	Inxh. Mjedisi										0
106	Inxh. në shkencat e tokës										0
107	Inxh. Gjeoinformatike										0
108	Inxh. i Gjeoburimeve										0
109	Menaxhim agrobiznesi			50			20				70
110	Ekonomi dhe P. Agrare			50							50
111	Finance-Kontabilitet			50							50
112	Mbrojtje bimësh			50							50
113	Hortikulturë			50			30				80
114	Prodhim bimor			50							50
115	Zootekni dhe biznes Bblegtoral			50							50
116	Akuakulturë dhe Menaxh. Peshkimi			50							50
117	Agromjedis dhe Ekologji			50							50
118	Tek. Agroushqimore			50							50
119	Vreshtari eno1logji			50							50
120	Inxhinier pyjesh			40							40
121	Inxhinier përpunim druri			40							40
122	Agromekanizim			25							25
123	Mjekësi veterinare										0
124	Inxhinieri agronomike										0
125	Shkenca të administrimit										0
126	Menaxhim turizmi						30				30
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>1390</b>	<b>0</b>	<b>655</b>	<b>760</b>	<b>450</b>	<b>340</b>	<b>750</b>	<b>150</b>	<b>60</b>	<b>4445</b>

**VENDIM**  
**Nr.23, datë 14.1.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË, DHE MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Universitetin e Tiranës, të programeve të studimit, master i nivelit të parë, sipas fakulteteve, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:



i) Në “Teknologji informacioni”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në teknologji informacioni.

b) Në Fakultetin e Infermierisë:

i) Në “Menaxhim infermieror”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në menaxhim infermieror;

ii) Në “Mami”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, për mami;

iii) Në “Teknik laborator”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, për teknik laborator.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Kuota e pranimeve në këto programe, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2008-2009, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Në “Teknologji informacioni” 30

b) Në Fakultetin e Infermierisë:

i) Në “Menaxhim infermieror” 100;

ii) Në “Mami” 50;

iii) Në “Teknik laborator” 50.

4. Universiteti i Tiranës shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata, që i kanë përfunduar këto studime pranë këtij universiteti. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë Universiteti i Tiranës ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar pranë tij. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, përcaktuar nga njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës, bëhen publike paraprakisht.

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, do të jetë, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Në “Teknologji informacioni” 70 000 lekë.

b) Në Fakultetin e Infermierisë:

i) Në “Menaxhim infermieror” 55 000 lekë;

ii) Në “Mami” 60 000 lekë;

iii) Në “Teknik laborator” 60 000 lekë.

6. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si të verbrit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuar, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë, që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, master i nivelit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8. Në çdo program studimi, master i nivelit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

9. Kuotat e pranimeve në programet e studimit master i nivelit të parë, sipas pikës 3 të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.6, datë 4.2.2009, faqe 89*

**VENDIM**  
**Nr.29, datë 14.1.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË DYTË, DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, FAKULTETI I EKONOMISË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42, e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, me kohë të pjesshme, si më poshtë:

a) Master i nivelit të dytë, në “Administrim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

b) Master i nivelit të dytë, në “Administrim publik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

c) Master i nivelit të dytë, në “Financë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

ç) Master i nivelit të dytë, në “Kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

d) Master i nivelit të dytë, në “Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MMD);

dh) Master i nivelit të dytë, në “Studime ekonomike europiane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë”(MMD).

2. Këto programe studimi të realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre të jetë 100 javë mësimore.

3. Kuotat e pranimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë”, pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë, për vitin 2008-2009, të jenë:

a) Master i nivelit të dytë, në “Administrim biznesi”	70 studentë;
b) Master i nivelit të dytë, në “Administrim publik”	70 studentë;
c) Master i nivelit të dytë, në “Financë”	37 studentë;
ç) Master i nivelit të dytë, në “Kontabilitet”	37 studentë;
d) Master i nivelit të dytë, në “Marketing”	37 studentë;
dh) Master i nivelit të dytë, në “Studime ekonomike europiane”	37 studentë.

4. Tarifa e shkollimit të jetë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo program studimi, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Studimi i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, duke e likuiduar në dy këste të barabarta, në fillim të çdo viti akademik.

6. Studentët e shkëlqyer nga cikli paraardhës i studimeve nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

7. Këto programe studimi do ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.6, datë 4.2.2009, faqe 94*

**VENDIM**  
**Nr.74, datë 21.1.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË,  
NË SHKOLLËN E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “UNIVERSITETI EVROPIAN I  
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44/2 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Universiteti Evropian i Tiranës” me seli në Tiranë, për të ofruar programe studimi, të ciklit të dytë.

2. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti Evropian i Tiranës” do të ofrojë programe studimi, të ciklit të dytë, të cilat do të realizohen me, së paku, 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite. Në përfundim të studimeve do të lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në fushën e arsimimit të kryer. Programet e studimit të ciklit të dytë do të ofrohen me kohë të plotë, në fushat:

a) “Financë – bankë”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Banka dhe tregje financiare ose Ekonomi-financë.

b) “Administrim biznesi”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Biznes marketing, Administrim publik ose Ekonomi evropiane.

c) “Shkenca politike”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Politikë e krahasuar ose Teori politike.

ç) “Marrëdhënie ndërkombëtare”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Organizata ndërkombëtare ose Studime strategjike.

d) “Komunikim – Marrëdhënie publike”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Studimet dhe teoritë e komunikimit ose Marrëdhënie publike.

dh) “E drejtë publike dhe ndërkombëtare”.

e) “E drejtë private dhe biznesi”, që mund të ofrohet edhe në profilet: E drejtë private ose E drejtë e biznesit.

3. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti Evropian i Tiranës” do të ofrojë edhe programet e studimeve “Master i nivelit të parë” (MNP), që synojnë arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Këto programe studimi do të realizohen me, së paku, 60 kredite e me kohëzgjatje normale 1 vit. Në përfundim të këtyre studimeve do të lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP), në fushën e arsimimit dhe të trajnimit të kryer. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” do të ofrohen në fushat:

- a) “Menaxhim biznesi”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Menaxhim i SME-ve, Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe karrierës ose institucioneve dhe Administrim publik.
- b) “Banka dhe sigurime”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Banka, sigurime ose politika fiskale.
- c) “Marketing”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Shërbime dhe turizëm, Inovacion dhe tregje strategjike ose Marketing bankar e financiar.
- ç) “Drejhtësi”, sipas profileve: E drejtë administrative, E drejtë ndërkombëtare ose E drejtë evropiane.
- d) “Gazetari”, sipas profileve: Gazetari televizive ose Gazetari për çështje politike.
- dh) “Marrëdhënie publike”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Sektori komercial ose politik dhe institucionale.
- e) “Shkenca politike”, sipas profileve: Sjellja dhe strategjitë politike ose Politika publike.
- ë) “Marrëdhënie ndërkombëtare – diplomaci”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Çështjet e Ballkanit ose Studime amerikane.
- f) “Studime evropiane”, që mund të ofrohet edhe në profilet: Politika në BE ose Ekonomia në BE.

4. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Universiteti Evropian i Tiranës” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

5. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti Evropian i Tiranës” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti Evropian i Tiranës” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, datë 9.2.2009, faqe 201*

**VENDIM**  
**Nr.92, datë 27.1.2009**

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË KINOKLUBIT**  
**“STUDENTI” NGA “TRAJTIMI I STUDENTËVE, NR.1”, SHA, TIRANË,**  
**UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR FAKULTETIN E DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2002 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 82 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e përgjegjësise së administrimit të kinoklubit “Studenti” nga “Trajtimi i studentëve, nr.1”, sh.a., Tiranë, Universitetit të Tiranës, për Fakultetin e Drejtësisë.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Trajtimi i studentëve, nr.1”, sh.a., Universiteti i Tiranës dhe zyra për regjistrimin e pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, datë 19.2.2009, faqe 920*

VENDIM  
Nr.96, datë 27.1.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË NË SHKOLLËN E  
LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “UNIVERSITETI “MARIN BARLETI””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti””, me seli në Tiranë, të hapë programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” (MND) në fushat:

- a) Shkenca politike, me profil:
  - i) Lidërsip;
  - ii) Administrim publik.
- b) Komunikim, me profil:
  - i) Gazetari ekonomike;
  - ii) Komunikim publik.
- c) Administrim biznesi, me profil:
  - i) Financë-kontabilitet;
  - ii) Marketing dhe menaxhim operacionesh;
  - iii) Shërbime bankare dhe financiare;
  - iv) Prona të paluajtshme dhe sigurimi;
  - v. Lidërsip dhe menaxhim burimesh njerëzore.
- ç) Shkenca juridike, me profil:
  - i) E drejtë publike;
  - ii) E drejtë e biznesit.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” synojnë arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Këto programe studimi do të realizohen me, së paku, 60 kredite e me kohëzgjatje normale 1 vit. Në përfundim të këtyre studimeve lëshohet diploma “Master i niveli të dytë” (MND), në fushat e arsimimit dhe trajnimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti”” që, për çdo program studimi, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, të sigurojë zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

4. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti”” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të

ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti “Marin Barleti”” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, datë 19.2.2009, faqe 922*

**VENDIM**  
**Nr.97, datë 27.1.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMI, NË UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, KORÇË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, pika 4, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, në Fakultetin e Bujqësisë, të programit të studimit “Master i nivelit të parë”, në zhvillimin e integruar rural, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP), në profilin “Zhvillim i integruar rural”.

2. Programi i këtij studimi realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, në zhvillimin e integruar rural, me kohë të plotë, në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë 40.

4. Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën jo më pak se 30%, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70%, për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në të.

5. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të përcaktuara nga njësitë kryesore të universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, bëhen publike paraprakisht.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, në programin e studimit “Master i nivelit të parë”, në zhvillimin e integruar rural, do të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

7. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër, të shurdhër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuar, fëmijë romë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, ish-të përndjekur, që do të fitojnë të drejtën ta ndjekin këtë program studimi, do të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi “Master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 3 të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Ky program studimi do të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.12, datë 19.2.2009, faqe 923*

**VENDIM**  
**Nr.135, datë 11.2.2009**

**PËR MBYLLJEN E AKADEMISË SË POLICISË “ARBEN ZYLYFTARI” DHE RIORGANIZIMIN E ARSIMIMIT POLICOR SI PJESË PËRBËRËSE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrisë të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbyllet e Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”, si institucion i arsimit të lartë, për shkollimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, dhe riorganizimin e arsimit policor si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Arsimimi policor të riorganizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me ligjin nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

3. Vendimi nr.281, datë 2.6.2000 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, datë 10.3.2009, faqe 1453*

**VENDIM**  
**Nr.176, datë 19.2.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMI, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Ismail Qemali”, në Vlorë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë” në “Operacione industriale dhe navale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në “Operacione industriale dhe navale”.

2. Programi i këtij studimi realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programin e studimit “Master i nivelit të parë” në “Operacione industriale dhe navale”, me kohë të plotë, në universitetin “Ismail Qemali”, në Vlorë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë 30.

4. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, në programin e studimit “Master i nivelit të parë” në “Operacione industriale dhe navale”, do të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

5. Universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata, që i kanë përfunduar këto studime pranë këtij universiteti. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, të diplomuar pranë tij.

6. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, përcaktuar nga njësitë kryesore të universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, bëhen publike paraprakisht.

7. Kandidatët, që u përjasin shtresave sociale, si: të verbrit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuar, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, fëmijët e ish-të përndjekurve politikë, që fitojnë të drejtën për të ndjekur këtë program studimi, të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi “Master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë nuk e paguajnë tarifën e shkollimit, në vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 3 të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Ky program studimi do ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

13. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.29, datë 18.3.2009, faqe 1678*



**VENDIM**  
**Nr.279, datë 12.3.2009**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, “PAVARËSIA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës private të arsimit të lartë “Pavarësia”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Vlorës.

2. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia”, do të organizohet në dy fakultete:

a) Në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Shkencave Shoqërore, me programet e studimit në “Drejtësi”, “Ekonomi” dhe “Shkenca politike”, në formën e studimeve me kohë të plotë;

b) Në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, me programet e studimit, “Inxhinieri informatike” dhe “Arkitekturë”, në formën e studimeve me kohë të plotë.

3. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia”, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, do të ofrojë programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë për “Arkitekturë”, i cili do të zgjasë 5 vite, dhe në mbarim të tij do të lëshojë “Diplomë të integruar, të nivelit të dytë” (DIND), në “Arkitekturë”, ndërsa programi tjetër i këtij fakulteti dhe programet e fakultetit të Ekonomisë dhe Shkencave Shoqërore do të jenë programe studimi, të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 (tri) vite dhe në mbarim të tyre do të lëshojnë “Diplomë të nivelit të parë (DNP)”, përkatësisht, në:

c) Drejtësi

d) Ekonomi;

e) Shkenca politike;

ç) Inxhinieri informatike.

4. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia”, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga personel akademik i huaj, me kualifikim të nevojshëm.

5. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, të bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla private e arsimit të lartë “Pavarësia” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 9.4.2009, faqe 2137*

**VENDIM**  
**Nr.331, datë 25.3.2009**

**PËR NDARJEN NË NIVELE, BRENDA KATEGORIVE, TË PERSONELIT AKADEMIK,  
NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, EMËRTIMIN E RENDITJEN E TYRE, SI  
DHE KRITERET DHE KUALIFIKIMET PËR SECILIN VEND PUNE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 47, pika 3, e 93, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I**  
**NDARJA NË NIVELE, BRENDA KATEGORIVE, TË**  
**PERSONELIT AKADEMIK**

1. Kategoritë e personelit akademik ndahen në nivele, të cilat emërtohen e renditen sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Ndarja në nivele bëhet për shpërndarjen e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas vendeve të punës, që ka çdo njësi, mbështetur në veprimtaritë, që do të zhvillojë dhe kualifikimin e kërkuar.

2. Kategoria “Profesor” përfshin personelin akademik, i cili është titullar lëndësh ose modulesh e udhëheqës i veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe përbëhet, përkatësisht, nga nivelet a/1 “Profesori” dhe a/2 “Profesori i asociuar”,

2.1 Niveli a/1 “Profesori”:

a) i cili është titullar i disiplinave/moduleve, në programe studimi, kryesisht të ciklit të dytë e të tretë, dhe i komisioneve të provimeve, në të gjitha ciklet e studimeve, udhëheq studentët në përgatitjen e tezave të diplomave, në të gjitha ciklet e studimeve, drejton hartimin e dokumentacioneve kryesore, shkollore dhe kurrikulare;

b) drejton veprimtaritë e kërkimit dhe të transferimit të teknologjive, drejton grupin kërkimor, udhëheq tezat e doktoratës, për përgatitjen e kërkuesve të rinj etj;

c) merr pjesë aktive në drejtimin dhe zhvillimin e institucionit të arsimit të lartë e të njëjësive të tij, si dhe jep ndihmesë profesionale, për çështjet e arsimit e të shkencës, në shkallë vendi.

2.2 Niveli a/1 kërkon personel akademik, me titullin “Akademik” ose “Profesor”, i cili e ushtron veprimtarinë mësimore e kërkuese në institucionet e arsimit të lartë.

2.3 Niveli a/2 “Profesori i asociuar”:

a) i cili është titullar i disiplinave/moduleve e i komisioneve të provimeve, në të gjitha ciklet e studimeve, udhëheq studentët në përgatitjen e tezave të diplomave të studimeve, të ciklit të parë dhe të dytë, merr pjesë në hartimin e dokumentacioneve kryesore, shkollore e kurrikulare, dhe në drejtimin e procesit mësimor;

b) kryen veprimtari të pavarura të kërkimit shkencor, të zhvillimit dhe transferimit të teknologjive e njohurive dhe jep ndihmesën e vet në përgatitjen e kërkuesve etj;

c) mund të jetë edhe udhëheqës i tezave të doktoratës, kur këshilli i profesorëve të fakultetit jep pëlqimin, mbështetur në veprimtarinë akademike të udhëheqësit dhe në natyrën e temës së disertacionit të doktoratës, që propozohet;

ç) merr pjesë në drejtimin dhe zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të njëjësive të tij, si dhe ofron ndihmesë profesionale, për çështjet e arsimit dhe shkencës, në shkallë vendi etj.

2.4 Niveli a/2 kërkon personel akademik, me titullin “Profesor i asociuar”, i cili e ushtron veprimtarinë mësimore e kërkuese në institucionet e arsimit të lartë.

3. Personeli akademik, me titullin “Profesor emeritus”, përbëhet nga personel akademik, i dalë në pension, me kontribute të spikatura në mësimdhënie, kërkim apo në shërbim të institucionit dhe që e ka fituar këtë titull, në përputhje me përcaktimet në aktet e tjera nënligjore. Ky personel

ftohet në institucionet e arsimit të lartë për elemente të veçanta të veprimtarisë, të përmendura më sipër në këtë vendim, si detyra të nivelit a/1 e a/2.

4. Kategoria “Docenti” përfshin personelin akademik, që zhvillon, kryesisht, veprimtari mësimore dhe ka titullin “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”. Kjo kategori përbëhet, përkatësisht, nga nivelet b/1 “Docenti”, b/2 “Lektor i parë”/ “Kërkuesi i parë”.

4.1 Niveli b/1 “Docenti” kryen këto veprimtari:

a) jep mësim, në mënyrë të pavarur, në të gjitha programet e studimit, të ciklit të parë dhe të dytë, si dhe, nën drejtimin e personelit akademik, të nivelit a/1 e a/2, në programet e studimit të ciklit të tretë. Ai mund të jetë anëtar në komisionet e provimeve, në të gjitha ciklet e studimeve, si dhe udhëheqës i studentëve në përgatitjen e tezave të diplomave, të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve;

b) harton programe mësimore të studimit të ciklit të parë, merr pjesë në hartimin e programeve mësimore studimi të ciklit të dytë e të tretë dhe për zhvillimin e teknikave e të teknologjive të reja në mësimdhënie etj;

c) merr pjesë në programe kërkimi, zhvillimi dhe transferimi të teknologjive e njohurive, në botime profesionale dhe të mësimdhënies etj;

c) merr pjesë në drejtimin dhe zhvillimin e institucionit të arsimit të lartë e të njësive të tij, në udhëheqje e këshillim karriere, për grupe studentësh, etj.

4.2 Niveli b/1 kërkon personel akademik me titullin “Docent”, që e ushtron veprimtarinë në institucionet e arsimit të lartë.

4.3 Niveli b/2 “Lektor i parë” / “Kërkuesi i parë” kryen këto veprimtari:

a) jep mësim, në mënyrë të pavarur, në programe të studimit, të ciklit të parë e të dytë, harton dokumentacionet e programeve të studimit e të programeve disiplinore etj.;

b) merr pjesë në programe e projekte kërkimore, të zhvillimit dhe të transferimit të teknologjive, në kërkim të pavarur, në botime shkencore dhe profesionale etj;

c) merr pjesë në drejtimin dhe zhvillimin e institucionit të arsimit të lartë e të njësive të tij në tutorët e këshillim karriere, për grupe studentësh etj.;

4.4 Niveli b/2 kërkon personel akademik, me gradën shkencore “Doktor”, që e ushtron veprimtarinë në fakultete, dhe quhet “Lektor i parë” ose në institute e qendra kërkimi dhe zhvillimi, dhe quhet “Kërkues i parë”.

4.5 Ky nivel zbatohet edhe për personelin akademik, të punësuar në drejtimet e studimeve universitare, në fushën e shëndetësisë, i cili ka kryer studimet specializuese afatgjata dhe ka, së paku, 2 vjet përvojë pune si specialist në fushën përkatëse.

5. Kategoria “Lektorë” përfshin personelin akademik, që zotëron një diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND) ose “Magistër”, ose ekuivalentin e këtyre kategorive, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në fushë të njëjtë ose të përafërt.

5.1 Kategoria “Lektorë” për fushat e krijimtarisë në arte përfshin edhe personelin akademik, që zotëron një diplomë të studimeve universitare, të modelit të vjetër, të ekuivalentuar sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e tretë të nenit 89 të ligjit nr.9741, datë 24.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili, pas përfundimit të studimeve dhe në vazhdim dëshmon se ka një veprimtari të spikatur artistike, të certifikuar të tillë nga personalitetet e fushës dhe organet e autoritetet drejtuese të Akademisë së Arteve.

5.2 Kategoria “Lektorë” përbëhet nga niveli: c/1 “Lektor”/ “Kërkuesi”, i cili kryen këto veprimtari:

a) jep mësim në programe të studimit universitar të ciklit të parë dhe në programe të studimit jouniversitar, merr pjesë në hartimin e dokumentacioneve kurrikulare të programeve të studimit të ciklit të parë, nën drejtimin e personelit akademik, të niveleve a/1, a/2 dhe/ose b/1, b/2, si dhe në procese të tjera, të cilat përputhen me formimin e tij etj;

b) jep mësim nën drejtimin e personelit akademik, së paku, të një kategorie mbi të, në programet e studimit në ciklin e dytë (DND) ose, në mënyrë të pavarur, në MNP;

c) merr pjesë në projektet kërkimore të institucionit, në programet rajonale të zhvillimit dhe transferimit të teknologjive etj.;

ç) merr pjesë në komisione provimesh, në monitorime, tutorët dhe këshillim karriere, për studentë e grupe studentësh etj.

5.3 Niveli c/1 e ushtron veprimtarinë në fakultete, dhe quhet “Lektor” ose në institute e qendra kërkimi dhe zhvillimi, dhe quhet “Kërkues”.

6. Institucionet e arsimit të lartë mund të punësojnë edhe studentë, që janë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës e të përgatitjes së disertacionit, për gradën shkencore “Doktor”, për të mbështetur profesorin udhëheqës të disertacionit në procesin mësimor. Kjo kategori nuk mund të vlerësohet personel akademik i brendshëm i institucionit. Ngarkesa mësimore e këtyre studentëve duhet të jetë jo më shumë se 25 për qind e asaj të përcaktuar për nivelin e lektorit, me qëllim që të mos ta pengojë atë në përgatitjen e disertacionit.

7. Personeli akademik, i punësuar në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim, përparon në karrierë, mbështetur në kualifikimet dhe në vlerësimet pozitive në punë.

7.1 Kalimi nga një kategori në një tjetër bëhet me kërkesë, me shkrim, dhe përkundrejt procedurave të konkurrimit për atë vend pune.

7.2 Kalimi nga një nivel në një nivel më të lartë, brenda kategorisë, dhe nga një kategori më e ulët në një tjetër më të lartë, të personelit akademik, bëhet kur institucioni ka vend të lirë për këtë nivel dhe kandidati ka kualifikimet e nivelit përkatës dhe ka marrë vlerësim pozitiv për punën e bërë nga këshilli i fakultetit. Këto vlerësime kryhen çdo 2 (dy) vjet.

## KREU II

### RIORGANIZIMI I PERSONELIT AKADEMIK ME VENDET E REJA TË PUNËS, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Personeli akademik, i cili në vitin akademik 2008-2009 nuk do të ketë shkallën e kualifikimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim, do të mbajë një vend pune, që i afrohet më shumë kualifikimeve të tij, me detyrimin që, brenda një periudhe 5-vjeçare, nga hyrja në fuqi e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, të ndryshuar, të kualifikohet, sipas kërkesave të vendit të punës.

1.1 Personeli akademik, i punësuar aktualisht në institucionet publike të arsimit të lartë, ka përparësi ndaj kërkesave të kandidatëve të tjerë, në kuotat, që miratohen për programe studimi “Master i nivelit të dytë” dhe doktoratë.

2. Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të klasifikojnë në kategoritë “Profesorë” dhe “Docentë” anëtarë të personelit akademik, të punësuar në institucion, të cilët nuk përmbushin kriteret përkatëse të kualifikimit, shkencor e pedagogjik, të vendit të punës.

3. Në nivelin c/1 “Lektori” apo “Kërkuesi” kalojnë anëtarët e personelit akademik, me një diplomë të marrë në studime të thelluara pasuniversitare, të ekuivalentuara, sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e tretë të nenit 89 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3.1 Në nivelin c/1 kalojnë edhe anëtarët e personelit akademik, që kanë një diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë të studimeve universitare, të modelit të vjetër, të ekuivalentuar, sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e dytë të nenit 89 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, të ndryshuar, maksimumi deri në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu.

4. I gjithë personeli akademik me titullin “Profesor”, aktualisht i punësuar në institucionet publike të arsimit të lartë, gëzon të drejtën e vendit të punës të nivelit a/1.

4.1 Vendet e punës, të zëna nga personeli akademik, që, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë arritur moshën 60 vjeç për meshkujt dhe 55 vjeç për femrat, nuk shpallen e rishpallen për konkurrim. Ky personel ka të drejtë ta ruajë, deri në daljen në pension, vendin e punës, në kategorinë dhe nivelin që do të klasifikohet, në bazë të këtij vendimi, pa zbritur nga paga që ka gëzuar deri në atë çast.

4.2 Për të tërhequr personel akademik me kualifikimin e nevojshëm, institucionet e arsimit të lartë duhet të shpallin, para fillimit të çdo viti akademik, të gjitha vendet e punës, të zëna nga

personeli akademik, i punësuar me kontratë të përkohshme, por që nuk përmbush kriteret përkatëse të kualifikimit, shkencor e pedagogjik, të vendit të punës.

5. Vendet e lira të punës, në institucionet publike të arsimit të lartë, shpallen, si rregull, në muajin qershor të çdo viti.

6. Në kuadër të strategjisë për thithjen e trurit, “Brain gain”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë parashikojnë të kenë, çdo vit, kuota për vende të lira pune, për të emëruar ose riemëruar në këto institucione, në çdo kohë, personel akademik, i cili:

6.1 ka përfunduar me vlerësim, me notë mbi mesataren, studimet e doktoratës dhe ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” ose “Ph.D.”, në universitete të huaja, të akredituara nga agjenci ose organizma, të njohura në shkallë ndërkombëtare;

6.2 pas përfundimit të studimeve të doktoratës, ka qenë i punësuar në profesion në një universitet perëndimor a qendër kërkimore;

6.3 pas studimeve të doktoratës në Shqipëri, ka përfunduar studime postdoktorale, të paktën njëvjeçare, në një universitet a qendër kërkimore perëndimore të akredituar nga agjenci, të njohura në shkallë ndërkombëtare.

7. Personeli akademik i kategorisë “a” (pika 2, kreu I) punësohet me kontratë, me afat të pacaktuar, në institucion.

8. Ministri i Arsimit dhe Shkencës nxjerr udhëzim për kategoritë e personelit ndihmës, mësimor e shkencor, të institucioneve të arsimit të lartë dhe përshtatjen e tyre me kategoritë e personelit akademik.

9. Institucionet private të arsimit të lartë e kryejnë vetë riorganizimin e personelit akademik, por duhet, në çdo rast, të respektojnë kriteret dhe kualifikimet e kërkuara për secilin vend pune, në institucionet e arsimit të lartë, të përcaktuara në kreun I të këtij vendimi. Ato duhet ta punësojnë personelin akademik, në përputhje me nivelin e arsimit, që ofrojnë në institucion.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.68, datë 25.4.2009, faqe 3083*

**VENDIM**  
**Nr.516, datë 13.5.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.220, DATË 6.3.2009 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE MËSIMORË, ME**  
**KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2009, PËR**  
**MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pikat 1 e 2 të vendimit nr.220, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve mësimorë dhe të tjerë me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për periudhën janar-qershor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të jetë 3061 veta.

2. Të dhënat për numrin, afatin kohor të kontraktimit të punonjësve, të përcaktuar në pikën 1 të projektvendimit, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2009.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.90, datë 18.6.2009, faqe 3962*

EMERTIMI	Punonjës me kontratë të përkohshme Periodha 1 janar- 30 qershor 2009		
	Gjithsej	Mesimorë	Të tjerë
Berat	106	106	0
Arsimi Bazë 0.42	96	96	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	4	4	0
Arsimi i Mesëm Profes. 0.44	5	5	0
Ars.Mes.Prof.Komb. 0.44	1	1	0
Skrapar	31	31	0
Arsimi Bazë 0.42	25	25	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	3	3	0
Arsimi i Mesëm Profes. 0.44	3	3	0
Kuçovë	14	14	0
Arsimi Bazë 0.42	9	9	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	2	2	0
Arsimi i Mesëm Profes. 0.44	3	3	0
Durrës	180	180	0
Arsimi Bazë 0.42	173	173	0
Arsimi Mesëm 0.43	1	1	0
Ars.Mes.Prof.Komb. 0.44	6	6	0
Sh."B.Çela"	2	2	0
Sh."B.Qeraxhi"	4	4	0
Krujë	54	54	0
Arsimi Bazë 0.42	53	53	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	1	1	0
Dibër	83	83	0
Arsimi Bazë 0.42	69	69	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	10	10	0
Arsimi i Mesëm Profes. 0.44	4	4	0
Bulqizë	26	26	0
Arsimi Bazë 0.42	21	21	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	5	5	0
Mat	107	107	0
Arsimi Bazë 0.42	95	95	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	11	11	0
Arsimi i Mesëm Profes. 0.44	1	1	0
Elbasan	209	209	0
Arsimi Bazë 0.42	179	179	0
Arsimi Mesëm 0.43	16	16	0
Arsimi i Mesëm Profes. 0.44	10	10	0
Ars.Mes.Prof.Komb. 0.44	4	4	0
Sh."Luigj Gurakuqi"	1	1	0
Ah."Ali Myftiu"	3	3	0
Gramsh	33	33	0
Arsimi Bazë 0.42	28	28	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	5	5	0
Librazhd	60	60	0
Arsimi Bazë 0.42	60	60	0
Peqin	51	51	0
Arsimi Bazë 0.42	50	50	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	1	1	0
Fier	197	197	0
Arsimi Bazë 0.42	187	187	0
Arsimi Mesëm 0.43	5	5	0
Ars.Mes.Prof.Komb. 0.44	5	5	0
Sh. Artistike "Jakov Xoxa"	5	5	0

Mallakastër	31	31	0
Arsimi Bazë 0.42	31	31	0
Lushnjë	77	77	0
Arsimi Bazë 0.42	62	62	0
Arsimi Mesëm 0.43	10	10	0
Arsimi I Mesëm Profes. 0.44	5	5	0
Gjirokastër	34	34	0
Arsimi Bazë 0.42	27	27	0
Arsimi I Mesëm Profes. 0.44	7	7	0
Përmet	17	17	0
Arsimi Bazë 0.42	12	12	0
Arsimi Mesëm Përgjithshëm	5	5	0
Tepelenë	37	37	0
Arsimi Bazë 0.42	36	36	0
Arsimi Mesëm Përgjithshëm	1	1	0
Korçë	81	81	0
Arsimi Bazë 0.42	75	75	0
Arsimi I Mesëm Profes. 0.44	6	6	0
Kolonjë	6	6	0
Arsimi Bazë 0.42	5	5	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	1	1	0
Zyra Arsimore Devoli	12	12	0
Arsimi Bazë 0.42	10	10	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	2	2	0
Pogradec	47	47	0
Arsimi Bazë 0.42	46	46	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	1	1	0
Kukës	64	64	0
Arsimi Bazë 0.42	60	60	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	4	4	0
Has	57	57	0
Arsimi Bazë 0.42	55	55	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	2	2	0
Tropojë	54	54	0
Arsimi Bazë 0.42	47	47	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	7	7	0
Lezhë	86	86	0
Arsimi Bazë 0.42	71	71	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	15	15	0
Laç	63	63	0
Arsimi Bazë 0.42	58	58	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	5	5	0
Mirditë	66	66	0
Arsimi Bazë 0.42	66	66	0
Shkodër	241	241	0
Arsimi Bazë 0.42	199	199	0
Arsimi Mesëm 0.43	23	23	0
Arsimi I Mesëm Profes. 0.44	7	7	0
Ars.Mes.Prof.Komb. 0.44	12	12	0
Sh.Industriale "Arben Broci"	4	4	0
Sh.Pyjore "Kol Margjini"	4	4	0
Sh. Artistike "Prng Jakova"	4	4	0
Pukë	13	13	0
Arsimi Bazë 0.42	10	10	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	3	3	0
Malesi e Madhe	39	39	0
Arsimi Bazë 0.42	37	37	0
Arsimi Mesëm I Përgjithshëm 0.43	2	2	0



Kavajë	31	31	0
Arsimi Bazë 0.42	26	26	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	5	5	0
Bashkia Tiranë	557	501	56
Arsimi Bazë 0.42	263	223	40
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	167	151	0
Ars.Mes.Prof.Komb. 0.44	127	127	0
1 Shkolla e Mesme "J.Misja	67	67	0
2 Shkolla e Mesme Hoteleri Turizëm	7	7	0
3 Shkolla e Mesme Korografike	8	8	0
4 Shkolla e Mesme "L.Boriçi"	2	2	0
5 Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja	13	13	0
6 Shkolla e Mesme Ekonomike	13	13	0
7 Shkolla e Mesme e Ndërtimit	8	8	0
8 Shkolla e Mesme Teknike	9	9	0
DAR e Bashkisë Tiranë	0	0	16
Tirana Rreth	134	134	0
Arsimi Bazë 0.42	105	105	0
Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	29	29	0
Vlorë	87	87	0
Arsimi Bazë	73	73	0
Arsimi i Mes. Përgjith.	10	10	0
Arsimi i Mesëm Profes.	2	2	0
Ars.Mes.Prof.Komb.	2	2	0
Sh.Industriale "Pavarësia"	2	2	0
Sarandë	56	56	0
Arsimi Bazë	52	52	0
Arsimi i Mesëm Profes.	4	4	0
Delvinë	20	20	0
Arsimi Bazë	19	19	0
Arsimi i Mes. Përgjith.	1	1	0
Arsimi Parauniversitar	3061	3005	56
1 Arsimi Bazë 0.42	2490	2450	40
2 Arsimi Mesëm i Përgjithshëm 0.43	357	341	0
3 Arsimi i Mesëm Profes. 0.44	57	57	0
4 Ars.Mes.Prof.Komb.	157	157	0
DAR e Bashkisë Tiranë	0	0	16

**VENDIM**  
**Nr.564, datë 28.5.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT "MASTER I NIVELIT TË DYTË", PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private "Universiteti Marin Barleti", Tiranë, për hapjen e programeve të studimit "Master i nivelit të dytë" në:

- a) Shkenca politike, me profile:
  - i) Lidership;
  - ii) Administrim publik.
- b) Komunikim, me profile:
  - i) Gazetari ekonomike;

- ii) Komunikim publik.
- c) Administrim biznesi, me profile:
  - i) Financë-kontabilitet;
  - ii) Marketing dhe menaxhim operacionesh;
  - iii) Shërbime bankare dhe financiare;
  - iv) Prona të paluajtshme dhe sigurimi;
  - v) Lidërsip dhe menaxhim burimesh njerëzore.
- ç) Shkenca juridike, me profile:
  - i) E drejtë publike;
  - ii) E drejtë biznesi.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” të jenë programe studimi të ciklit të tretë, në plotësimin e, të paktën, 60 krediteve. Në mbarim të programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND) në:

- a) Shkenca politike, me profile:
  - i) Lidërsip;
  - ii) Administrim publik.
- b) Komunikim, me profile:
  - i) Gazetari ekonomike;
  - ii) Komunikim publik.
- c) Administrim biznesi, me profile:
  - i) Financë-kontabilitet;
  - ii) Marketing dhe menaxhim operacionesh;
  - iii) Shërbime bankare dhe financiare;
  - iv) Prona të paluajtshme dhe sigurimi;
  - v) Lidërsip dhe menaxhim burimesh njerëzore.
- ç) Shkenca juridike, me profile:
  - i) E drejtë publike;
  - ii) E drejtë biznesi.

3. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Marin Barleti” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

4. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Marin Barleti” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Marin Barleti”, pas marrjes së lejes përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, për hapjen e programeve të ciklit të tretë, të strukturohet si universitet.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.97, datë 3.7.2009, faqe 4269*

**VENDIM**  
**Nr.615, datë 11.6.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË AKADEMINË E ARTEVE, NË UNIVERSITETIN “ ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN DHE NË UNIVERSITETIN “ FAN S. NOLI”, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Muzikës, në Akademinë e Arteve, si më poshtë vijon:

- a) “Pedagogji muzikore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.
- b) “Fizarmonikë klasike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

2. Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, sipas fakulteteve, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës: “Teknologjitë e informacionit”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

b) Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit: “Edukim fizik e sporte”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

3. Hapjen e programit të studimit “Teknologji e prodhimit bimor”, në Fakultetin e Bujqësisë, në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP.

4. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen në 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

5. Këto programe studimi të ciklit të parë ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar, respektivisht, për Akademinë e Arteve, universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe universitetin “Fan S. Noli”, Korçë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Akademia e Arteve, universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.104, datë 16.7.2009, faqe 4986*

**VENDIM**  
**Nr.619, datë 11.6.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË,  
NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Hapjen në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programit të studimit “Studime shqiptare dhe etnokulturore”, me profilet:

- a) Studime shqiptare;
- b) Studime të thelluara në gjuhësi;
- c) Etnokultura dhe letërsia shqipe.

2. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohen, përkatësisht:

- a) Diplomë e nivelit të dytë, DND, në “Studime shqiptare dhe etnokulturore”, profili “Studime shqiptare”;
- b) Diplomë e nivelit të dytë, DND, në “Studime shqiptare dhe etnokulturore” profili “Studime të thelluara në gjuhësi”;
- c) Diplomë e nivelit të dytë, DND, në “Studime shqiptare dhe etnokulturore”, profili “Etnokultura dhe letërsia shqipe”.

3. Ky program studimi i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

4. Programi i studimit “Studime shqiptare dhe etnokulturore” do të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.104, datë 16.7.2009, faqe 4987*

## VENDIM

**Nr.620, datë 11.6.2009**

### **PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programeve të studimit të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

- a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, programi i studimit “Mbrojtje mjedisi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në mbrojtje mjedisi.
- b) Në Fakultetin e Shkencave Humane, programi i studimit “Trashëgimi kulturore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në trashëgimi kulturore.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

3. Këto programe studimi do ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.104, datë 16.7.2009, faqe 4988*

**VENDIM**  
**Nr.621, datë 11.6.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË  
UNIVERSITETIN “ ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, sipas fakulteteve të mëposhtme:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit:

i) Programin e studimit “Master i nivelit të parë”, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët “Edukatë qytetare dhe gjeografi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukatë qytetare dhe gjeografi;

ii) Programin e studimit “Master i nivelit të parë”, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët “Edukatë qytetare dhe histori”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët “Edukatë qytetare dhe histori”.

b) Në Fakultetin e Shkencave Humane, programin e studimit “Master i nivelit të parë” në “Redaktim, në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në redaktim.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.104, datë 16.7.2009, faqe 4988*

**VENDIM**  
**Nr.675, datë 18.6.2009**

**PËR HAPJEN E FILIALIT TË UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË, NË QYTETIN  
E POGRADECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 11, 25, 26 e 41 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në qytetin e Pogradecit, të filialit të Fakultetit të Ekonomisë, në programin e studimit të ciklit të parë, për “Turizëm”.
  2. Ky program studimi të realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është tri vite akademike.
  3. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të parë “Turizëm”, përftohet “Diplomë e nivelit të parë” DNP në “Turizëm”.
  4. Ky filial do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2009-2010.
  5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Fan S. Noli”, Korçë.
  6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.112, datë 24.7.2009, faqe 5399*

**VENDIM**  
**Nr.686, datë 18.6.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN  
E DREJTËSISË, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1278, datë 23.12.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.182, datë 10.3.2010)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, si më poshtë vijon:
  - a) Doktoratë në “Shkenca juridike civile”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).
  - b) Doktoratë në “Shkencat penale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).
  - c) Doktoratë në “E drejta publike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).
2. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën 3 vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

3. Kuotat e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010, janë, gjithsej, 100, prej të cilave 19 për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë vendit. Ndarja e këtyre kuotave sipas programeve të studimeve, është, si më poshtë vijon:

- a) Doktoratë në “Shkenca juridike civile” 32 kuota;
- b) Doktoratë në “Shkencat penale” 32 kuota;
- c) Doktoratë në “E drejta publike” 36 kuota.

4. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës.

6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.112, datë 24.7.2009, faqe 5402*

*Vendim i KM nr.1278, datë 23.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.192, datë 15.1.2010, faqe 8498*

*Vendim i KM nr.182, datë 10.3.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, datë 15.4.2010, faqe 1469*

## **VENDIM**

**Nr.695, datë 18.6.2009**

### **PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimit të ciklit të tretë, të doktoratës, në “Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit”.

2. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në “Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit”.

3. Kohëzgjatja e këtij programi studimi është, të paktën 3 vite, ku përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kouta e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 12, prej të cilave 2 për kandidatët nga jashtë kufijve të vendit.

5. Tarifa e shkollimit për këtë program të plotë studimi është 400 000 (katërqind mijë) lekë, dhe likuidohet, për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me këste të caktuara nga fakulteti përkatës. Kandidatët, që do të ndjekin programin e studimit të doktoratës, nga stafi akademik i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë, paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.113, datë 24.7.2009, faqe 5451*

**VENDIM**  
**Nr.696, datë 18.6.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË  
UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, sipas fakulteteve, si më poshtë vijon:

A. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit:

a. Doktoratë në “Bujqësia dhe mjedisi”, me drejtimet:

i) “Shkencat agronomike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në bujqësi dhe mjedis, me drejtim “Shkencat agronomike”.

ii) “Shkencat e prodhimit shtazor”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në bujqësi dhe mjedis, me drejtim “Shkencat e prodhimit shtazor”.

iii) “Shkencat e hortikulturës”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në bujqësi dhe mjedis, me drejtim “Shkencat e hortikulturës”.

iv) “Shkencat mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në bujqësi dhe mjedis, me drejtim “Shkencat mjedisore”.

v) “Shkencat e mbrojtjes së bimëve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në bujqësi dhe mjedis, me drejtim “Shkencat e mbrojtjes së bimëve”.

B. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit:

a) Doktoratë në “Ekonomi dhe agrobiznes”, me drejtimet:

i) “Drejtim agrobiznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në ekonomi dhe agrobiznes, me drejtim “Drejtim agrobiznesi”.

ii) “Ekonomi dhe politikë agrare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në ekonomi dhe agrobiznes, me drejtim “Ekonomi dhe politikë agrare”.

iii) “Financë-Kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në ekonomi dhe agrobiznes, me drejtim “Financë-Kontabilitet”.

C. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, doktoratë në “Shkencat dhe bioteknologjia ushqimore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.), në “Shkencat dhe bioteknologjia ushqimore.”.

D. Fakulteti i Shkencave Pyjore:

a) Doktoratë në “Shkencat pyjore”, me drejtimet:



i) "Qeverisja e qëndrueshme e burimeve pyjore dhe kullosore", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore "Doktor" (Dr.), në shkencat pyjore, me drejtim "Qeverisja e qëndrueshme e burimeve pyjore dhe kullosore".

ii) "Teknologjia e drurit", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë për gradën shkencore "Doktor" (Dr.), në shkencat pyjore, me drejtim "Teknologjia e drurit".

2. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është të paktën 3 vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

3. Kuotat e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, për vitin 2009, janë, gjithsej, 49, prej të cilave 9 kuota për kandidatët nga jashtë kufijve të vendit. Ndarja e këtyre kuotave, sipas programeve të studimeve, është, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në "Bujqësia dhe mjedisi" : 20 kuota;

b) Doktoratë në "Ekonomi dhe agrobiznes" : 15 kuota;

c) Doktoratë në "Shkencat dhe bioteknologjia ushqimore": 5 kuota;

ç) Doktoratë në "Shkencat pyjore" : 9 kuota.

4. Mënyra e plotësimit të kuotave, që mbeten të paplotësuara në një program studimi, përcaktohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Tarifa e shkollimit për këtë program të plotë studimi është 400 000 (katërqind mijë) lekë, dhe likuidohet, për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me këste të caktuara nga fakulteti përkatës. Kandidatët, që do të ndjekin programet e studimit të doktoratës, nga stafi akademik i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë, paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.113, datë 24.7.2009, faqe 5451*

## **VENDIM**

**Nr.697, datë 18.6.2009**

### **PËR HAPJEN E FILIALIT TË UNIVERSITETIT PRIVAT "UFO UNIVERSITY", NË QYTETIN E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, 11, pika 2, shkronja "b", 26, 33, 44 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen, në qytetin e Beratit, të filialit të Fakulteteve të Shkencave Shoqërore dhe të Shkencave të Aplikuara, si pjesë përbërëse e universitetit privat "UFO University", Tiranë.

2. Hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

a) Shkenca politiko-administrative;

b) Psikologji e përgjithshme;

c) Shkenca të komunikimit;

ç) Financë bankë.

3. Këto programe studimi të jenë të njëjta me programet e studimit, që universiteti privat "UFO University" ofron në selinë qendrore të tij, në Tiranë. Ato do të realizohen me 180 kredite

dhe kohëzgjatja e tyre do të jetë tri vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), përkatësisht, në:

- a) Shkenca politiko-administrative;
- b) Psikologji e përgjithshme;
- c) Shkenca të komunikimit;
- ç) Financë bankë.

4. Hapjen e programeve të studimit, Master i nivelit të parë, në:

- a) E drejtë tregtare;
- b) E drejtë private;
- c) Shkenca penale.

5. Këto programe studimi të jenë të njëjta me programet e studimit, që universiteti privat “UFO University” ofron në selinë qendrore të tij, në Tiranë. Ato do të realizohen me, së paku, 60 kredite. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diplomë Master i nivelit të parë (MNP), përkatësisht, në:

- a) E drejtë tregtare;
- b) E drejtë private;
- c) Shkenca penale.

6. Ngarkohet universiteti privat “UFO University”, që, për çdo program studimi, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik, me kualifikimet e nevojshme.

7. Universiteti privat “UFO University” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit të përcaktuara në pikat 2 e 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

8. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Universiteti privat “UFO University” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.113, datë 24.7.2009, faqe 5453*

**VENDIM**  
**Nr.793, datë 22.7.2009**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA UNIVERSITETI I TIRANËS QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TË PALESTRËS SPORTIVE TË UT-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësive së administrimit, nga Universiteti i Tiranës Qendrës së Studimeve Albanologjike, të objektit “Palestër sportive” të Universitetit të Tiranës (UT), së bashku me mjediset e tjera ndihmëse, truallin e ndërtesës dhe oborrin e rrethuar, sipas genplanit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Objekti i mësipërm, pas kryerjes së rehabilitimit dhe përshtatjes, të përdoret në funksion të qëllimit dhe të veprimtarisë së Qendrës së Studimeve Albanologjike.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.129, datë 5.9.2009, faqe 6034*

**1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE**  
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Emri i Pushtetit Qendror: QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE Identifikimi: Arben Jollani / Financier.

Kopjona: TIRANE. Supervizori: \_\_\_\_\_ (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Perdorimit te Prones: \_\_\_\_\_ A. Aprovi: \_\_\_\_\_ (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

**C**


(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

A		B				C			
Zona Kadastr. & Indeksii Hartes	Nr. Pasurise	Lloji Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m <sup>2</sup> )	Nga Sip. Totale Sa Ndertese (m <sup>2</sup> )	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me privilegjesi administrative	Institucioni / Enti per dorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
2.	3.	4.	5.	6.	7.	8.	9.	10.	11.
			Godina e Q.S.A dhe Muzeut Arkeologjik - Tirane	8.904	8.904	Zyra Muzeu Fondu.	QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIK	QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIK	
			Sheshi "Nene Tereza" TIRANE.	1240	547		Q.S.A	Q.S.A	
			Palestra + Zyra Depast. Ed. Trijok dhe pushore basketbollit + dhoma qendrore						

**GENPLANI I FUSHES SE BASKETBOLLIT DHE AMBJENTEVE  
TE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES**

**SH 1:500**

- Sip. Ndertimi DHOMAT 121.50m<sup>2</sup>**
- Sip. Ndertimi ZYRAT 71.70m<sup>2</sup>**
- Sip. Truali FUSHA 517.38m<sup>2</sup>**
- Sip. Ndertimit 193.20m**
- Sip. Truallit 710.58 m<sup>2</sup>**



**GENPLANI I FUSHES SE BASKETBOLLIT DHE AMBENTEVE  
TE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES**

**SH 1:500**


Sip. Ndertimi DHOMAT 121.50m<sup>2</sup>

SIP. NDERTIMIT 193.20m

Sip. Ndertimi ZYRAT 71.70m<sup>2</sup>

SIP. TRUALLIT 710.58 m<sup>2</sup>

Sip. Trualli FUSHA 517.38m<sup>2</sup>



**PLAN RILEVIMI**

**PERGATITI**  
 Studio Ligtore "Gimaj"  
 Servet Allaj

Licence Nr. TZ 0487 Date: 2003  
 Data e pergatitjes: 29/06/2009  
 Nipi K 71704001 W

Vule-Firme

**IDENTIFIKIMI I PASURISE**  
 ZONA KADASTRALE 8160  
 NR. I PASURISE 7/10 7/9/2  
 INDEKSI HARTES TR-S-12  
 SHKALLA 1:500  
 ADRESA E PASURISE: Rrethi, Tmarrë  
 QJE TIRANE, Rr. SHESHI NEN TEREZA"  
 P/G Sh. K. Ap.  
 PRONARI: QENDRA STUDIUMVE ALBANOLOGJIKE  
 (INSTRUMERI ABBELOGJISE)

**SIP. TOTALE NDERTIMIT = 193.20 m<sup>2</sup>**  
**SIP. TOTALE TRUALLIT = 710.58 m<sup>2</sup>**

Sip. Ndertimi DHOMAT 121.50m<sup>2</sup>  
 Sip. Ndertimi ZYRAT 71.70m<sup>2</sup>  
 Sip. Truallit FUSHA 517.38m<sup>2</sup>

**GENPLANI I FUSHES SE BASKETBOLLIT DHE AMBJENTEVE TEKNIKE**  
 SH 1:250

Sip. Ndertimi DHOMAT 121.50m<sup>2</sup> SIP. NDERTIMIT 193.20m<sup>2</sup>  
 Sip. Ndertimi ZYRAT 71.70m<sup>2</sup> SIP. TRUALLIT 710.58 m<sup>2</sup>  
 Sip. Truallit FUSHA 517.38m<sup>2</sup>

Vetiu: Nr.Pasurise 7/2 (Lulishte Pallati "Kongreseve")



Lindje: Nr.Pasurise 7/15

Jugu: Nr.Pasurise 7/9/3 (Q. S. A.)


Perendimi: Nr.Pasurise 7/9/2, 7/9/3 (Q. S. A.)

Pronari : MINISTRIA E ARSIMIT

V.O. Ky rilevim eshte hartuar duke ju referuar faktit  
 dhe hartes kadastrale te Z.R.P P TIRANE



**GENPLANI I PALESTRES SE UNIVERSITETIT POLITEKNIK TE TIRANES**  
**SH 1:500**  
**SIP. NDERTIMIT 354.03 m<sup>2</sup>**  
**SIP. TRUALLIT 519.50 m<sup>2</sup>**





**VENDIM**  
**Nr.796, datë 22.7.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE, “UNIVERSITETI EVROPIAN I TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të dytë”, pranë shkollës së lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, në:

a) “Ekonomi dhe zhvillim i qëndrueshëm”, me profile:

- i) Administrata dhe politikat publike;
- ii) Urbanizimi, zhvillimi territorial dhe politikat mjedisore;
- iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- iv) E drejtë ekonomike.

b) “Financë”, me profile:

- i) Financat publike;
- ii) Qeverisja e korporatave;
- iii) Tregjet financiare dhe menaxhimi bankar;
- iv) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare.

c) “Menaxhim”, me profile:

- i) Lidershipi dhe menaxhimi i karrierës;
- ii) Biznes dhe marketing ndërkombëtar;
- iii) Komunikimi në biznes;
- iv) E drejtë ekonomike.

ç) “Sociologji”, me profile:

- i) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- ii) Krimnologji;
- iii) Globalizimi dhe zhvillimi;
- iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.

d) “Shkenca komunikimi”, me profile:

- i) Komunikimi dhe sjelljet politike;
- ii) Komunikimi në biznes;
- iii) Lidershipi dhe menaxhimi i karrierës;
- iv) Teori dhe modele komunikimi.

dh) “Shkenca politike”, me profile:

- i) Globalizimi dhe zhvillimi;
- ii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- iii) Administrata dhe politikat publike;
- iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.

e) “Marrëdhëniet ndërkombëtare”, me profile:

- i) Globalizimi dhe zhvillimi;
- ii) Studime të sigurisë dhe gjeopolitikës;
- iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
- iv) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare.

ë) E drejtë publike, me profile:

- i) E drejtë kushtetuese dhe administrative;
- ii) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare;

- iii) Kriminalogji;
- iv) E drejtë penale.
- f) “E drejtë private”, me profile:
  - i) E drejtë ekonomike;
  - ii) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare;
  - iii) E drejtë civile;
  - iv) Qeverisja e korporatës.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” (MND) të jenë programe studimi të ciklit të tretë, me, të paktën, 60 kredite. Në mbarim të programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në:

- a) “Ekonomi dhe zhvillim i qëndrueshëm”, me profile:
  - i) Administrata dhe politikat publike;
  - ii) Urbanizimi, zhvillimi territorial dhe politikat mjedisore;
  - iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
  - iv) E drejtë ekonomike.
- b) “Financë”, me profile:
  - i) Financat publike;
  - ii) Qeverisja e korporatave;
  - iii) Tregjet financiare dhe menaxhimi bankar;
  - iv) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare.
- c) “Menaxhim”, me profile:
  - i) Lidërshipi dhe menaxhimi i karrierës;
  - ii) Biznes dhe marketing ndërkombëtar;
  - iii) Komunikimi në biznes;
  - iv) E drejtë ekonomike.
- ç) “Sociologji”, me profile:
  - i) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
  - ii) Kriminalogji;
  - iii) Globalizimi dhe zhvillimi;
  - iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.
- d) “Shkenca komunikimi”, me profile:
  - i) Komunikimi dhe sjelljet politike;
  - ii) Komunikimi në biznes;
  - iii) Lidërshipi dhe menaxhimi i karrierës;
  - iv) Teori dhe modele komunikimi.
- dh) “Shkenca politike”, me profile:
  - i) Globalizimi dhe zhvillimi;
  - ii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
  - iii) Administrata dhe politikat publike;
  - iv) Komunikimi dhe sjelljet politike.
- e) “Marrëdhëniet ndërkombëtare”, me profile:
  - i) Globalizimi dhe zhvillimi;
  - ii) Studime të sigurisë dhe gjeopolitikës;
  - iii) Politika, shoqëria dhe demokratizimi;
  - iv) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare.
- ë) “E drejtë publike”, me profile:
  - i) E drejtë kushtetuese dhe administrative;
  - ii) E drejtë evropiane dhe ndërkombëtare;
  - iii) Kriminalogji;
  - iv) E drejtë penale.
- f) “E drejtë private”, me profile:
  - i) E drejtë ekonomike;
  - ii) E drejtë financiare, fiskale dhe bankare;

- iii) E drejtë civile;
- iv) Qeverisja e korporatës.

3. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

4. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Shkolla e lartë universitare, private, “Universiteti Evropian i Tiranës”, pas marrjes së lejes përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës strukturohet si universitet.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.129, datë 5.9.2009, faqe 6042*

**VENDIM**  
**Nr.802, datë 22.7.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT RAJONAL TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË “EU BUSINESS LAW””, NË FAKULTETIN E DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1051, datë 23.10.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, të programit të përbashkët rajonal të studimit “Master i nivelit të dytë” në “EU Business Law”.

2. Programi i studimit “Master i nivelit të dytë” në “EU Business Law” organizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit përfshirë edhe mikrotezën. Në përfundim të studimeve të këtij programi lëshohet një diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “EU Business Law”.

3. Në këtë program studimi të pranohen kandidatët, që kanë fituar diplomë të nivelit të dytë (DND) ose diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND), si dhe diploma të tjera, ekuivalente me to.

4. Shfuqizohet.

5. Kuotat e pranimit në këtë program studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, do të jenë 40 studentë.

6. Tarifa e shkollimit do të jetë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.129, datë 5.9.2009, faqe 6047*

*Vendim i KM nr.1051, datë 23.10.2009,botuar në Fletoren Zyrtare nr.159, datë 23.11.2009, faqe 7112*

**VENDIM**  
**Nr.803, datë 22.7.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË MATEMATIKË,  
NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE TË UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”  
TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në matematikë, në Fakultetin e Shkencave Teknike të universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor”.

2. Kohëzgjatja normale e programit të studimeve të doktoratës në matematikë është, të paktën, 3 (tri) vite dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

3. Kuotat e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, janë gjithsej 25, prej të cilave 10 për kandidatë nga jashtë kufijve të vendit.

4. Tarifa e plotë e shkollimit për këtë program studimesh është 400 000 (katërqind mijë) lekë dhe likuidohet me këste, sipas përcaktimeve të bëra nga fakulteti përkatës, për çdo vit të kohëzgjatjes normale. Doktorantët, nga stafi akademik i brendshëm i institucioneve të arsimit të lartë, paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.129, datë 5.9.2009, faqe 6048*

**VENDIM**  
**Nr.825, datë 29.7.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E  
MJEKËSISË VETERINARE TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, SI DHE  
MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFËS PËR KËTË PROGRAM**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1168, datë 25.11.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.1281, datë 23.12.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare të Universitetit Bujqësor të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në mjekësi veterinarë.
2. Në përfundim të këtij programi studimesh të doktoratës, lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr), në mjekësi veterinarë.
3. Kohëzgjatja e këtij programi studimesh të doktoratës, është, të paktën, 3 (tri) vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 30.  
4/1. Për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë përcaktohen 5 (pesë) kuota, të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e institucioneve përkatëse zyrtare të vendeve nga vijnë kandidatët.  
4/2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
5. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga fakultetet përkatëse, të Universitetit Bujqësor të Tiranës.
6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.
7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.130, datë 5.9.2009, faqe 6079*

*Vendim i KM nr.1168, datë 25.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7728*

*Vendim i KM nr.1281, datë 23.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.192, datë 15.1.2010, faqe 8501*

**VENDIM**  
**Nr.826, datë 29.7.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË  
UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Hapjen e programeve të studimeve, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, sipas fakulteteve, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, si më poshtë vijon:

A. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit:

a) Në “Teknologji mjedisi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në teknologji mjedisi.

b) Në “Menaxhimi i resurseve dhe përmirësimi gjenetik i bimëve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në menaxhimin e resurseve dhe përmirësimin gjenetik të bimëve.

c) Në “Kontrolli i integruar i parazitëve në bimë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kontroll i integruar i parazitëve në bimë.

ç) Në “Hortikulturë e qëndrueshme”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në hortikulturë e qëndrueshme.

d) Në “Shkencat e prodhimit shtazor”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkencat e prodhimit shtazor.

B. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit:

a) Në “Ekonomi dhe agrobiznes”, me profilet:

i) “Menaxhimi i ndërmarrjeve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil menaxhimi i ndërmarrjeve.

ii) “Ekonomi dhe politika agrare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil ekonomi dhe politika agrare.

iii) “Zhvillimi rural i integruar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil zhvillim i integruar rural.

iv) “Menaxhim financiar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në ekonomi dhe agrobiznes, me profil menaxhim financiar.

C. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare:

a) Në “Mjekësi veterinarë”, me profilet:

i) “Diagnozë laboratorike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në mjekësi veterinarë, me profil diagnozë laboratorike.

ii) “Klinikë veterinarë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në mjekësi veterinarë, me profil klinikë veterinarë.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi, një vit.

3. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.130, datë 5.9.2009, faqe 6079*

**VENDIM**  
**Nr.827, datë 29.7.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË  
UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e programeve të studimeve, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në fakultetet e Universitetit të Tiranës, si më poshtë vijon:

A. Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë:

a) Në “Gjuhësi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjuhësi.

b) Në “Studime letrare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në studime letrare.

c) Në “Shkencë e bibliotekave”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkencë e bibliotekave.

ç) Në “Gjeografi”, me drejtimet:

i) “Gjeografi fizike dhe mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjeografi, me drejtim gjeografi fizike dhe mjedisore.

ii) “Gjeografi humane dhe rregullim territori”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), gjeografi humane dhe rregullim territori.

B. Fakultetin e Shkencave Sociale:

a) Në “Kërkime në edukim”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kërkime në edukim.

b) Në “Kërkim psikologjik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kërkim psikologjik.

c) Në “Kërkim shkencor në punë sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kërkim shkencor në punë sociale.

C. Fakultetin e Drejtësisë:

a) Në “Shkenca juridike civile”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkenca juridike civile.

b) Në “Shkencat penale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në shkencat penale.

c) Në “E drejta kushtetuese, e krahasuar dhe evropiane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në e drejta kushtetuese, e krahasuar dhe evropiane.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi, një vit.

3. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.130, datë 5.9.2009, faqe 6080*

**VENDIM**  
**Nr.829, datë 29.7.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË  
FAKULTETIN E MUZIKËS TË AKADEMISË SË ARTEVE DHE MIRATIMIN E  
KUOTAVE DHE TË TARIFAVE PËR KËTO PROGRAME**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1070, datë 21.10.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në:

a) “Kompozim”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në kompozim.

b) “Muzikologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në muzikologji.

c) “Interpretim”, me profilet:

i) “Piano”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil piano.

ii) “Violinë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil violinë.

iii) “Violë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil violë.

iv) “Violonçel”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil violonçel.

v) “Klarinetë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil klarinetë.

vi) “Flaut”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil flaut.

vii) “Muzikë dhome”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në interpretim, me profil muzikë dhome.

2. Këto programe studimi realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është, minimumi një vit.

3. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, është 15, prej së cilës 2 për kandidatët nga jashtë kufijve të vendit.

Kuota e pranimit në programin e studimeve “Master i nivelit të dytë”, në “Interpretim”, është 40. Dy kuota prej tyre caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi është 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi.

5. Studentët e shkëlqyer nga cikli paraardhës i studimeve nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

6. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Akademinë e Arteve.



8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia e Arteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.130, datë 5.9.2009, faqe 6082*

*Vendim i KM nr.1070, datë 21.10.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.162, datë 27.11.2009, faqe 7219*

**VENDIM**  
**Nr.832, datë 29.7.2009**

**PËR MBYLLJEN E DISA PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË UNIVERSITETIT USHTARAK “SKËNDERBEJ”, TIRANË, DHE TRANSFERIMIN E STUDENTËVE TË KËTIJ UNIVERSITETI NË UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 24 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 35, pika 1, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbylljen e programeve të studimit, të ciklit të parë, me kohë të plotë, “Administrim biznesi” dhe “Inxhinieri elektronike”, në universitetin ushtarak “Skënderbej”, Tiranë.

2. Transferimin e studentëve, që studiojnë në Fakultetin e Menaxhimit, dega administrim biznesi, në universitetin ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

3. Transferimin e studentëve, që studiojnë në Fakultetin Teknik, dega inxhinieri elektronike, në universitetin ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, në Fakultetin Elektrik të Universitetit Politeknik të Tiranës.

4. Rektorati i Universitetit të Tiranës, Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës dhe dekanët e fakulteteve të universitetit ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, të marrin të gjitha masat për transferimin e studentëve, të përmendur në pikat 2 e 3 të këtij vendimi.

5. Ministria e Mbrojtjes të vazhdojë respektimin e kontratës me studentët e përcaktuar në pikat 2 e 3 të këtij vendimi, në interes të përgatitjes së tyre për oficerë të Forcave të Armatosura, dhe të mbulojë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit pranë Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Rektorati i Universitetit të Tiranës, Rektorati i Universitetit Politeknik të Tiranës, si dhe rektorati i universitetit ushtarak “Skënderbej”, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.130, datë 5.9.2009, faqe 6085*

**VENDIM**  
**Nr.854, datë 5.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN  
E SHKENCAVE SOCIALE DHE NË ATË TË MJEKËSISË, TË UNIVERSITETIT TË  
TIRANËS**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1169, datë 25.11.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.163, datë 3.3.2010)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në:

a) Filozofi, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Filozofi”.

b) Sociologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sociologji”.

c) Pedagogji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Pedagogji”.

ç) Psikologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Psikologji”.

d) Punë sociale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Punë Sociale”.

2. Hapjen në Fakultetin e Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë të doktoratës, në:

a) Studime të Thelluara në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.), përkatësisht, në Studime të Thelluara, në Farmakologji, Fiziologji, Fiziologji Patologjike”.

b) Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.), në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve Infektive Emergjente dhe Riemergjente në Shqipëri”.

c) Shëndet publik, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Shëndet publik”.

ç) Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.), në Studime të Thelluara të Aspekteve Epidemiologjike, Diagnostike dhe Terapeutike të Sëmundjeve të Lëkurës”.

d) Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime të Thelluara dhe Kërkime në Otorinolaringologji”.

dh) Studime të Thelluara në Kardiologji, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime të Thelluara në Kardiologji”.

e) Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Patologji Oro-Maxilo-Faciale”.

ë) Studime në Neuroshkencë, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Neuroshkencë”.

f) Studime në Obstetrikë-Gjinekologji, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Obstetrikë-Gjinekologji”.

g) Mjekësi Laboratorike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Studime në Mjekësi Laboratorike”.

gj) Morfologji Klinike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Morfologji Klinike”.

h) Sëmundjet Kirurgjikale, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet Kirurgjikale”.

i) Imazheri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Imazheri”.

j) Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Anatomi Patologjike dhe Mjekësi Ligjore”.

k) Sëmundjet e syrit, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet e syrit”.

l) Pediatri, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Pediatri”.

ll) Shkencat farmaceutike, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Shkencat Farmaceutike”.

m) Sëmundjet e brendshme, në përfundim të së cilës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Sëmundjet e Brendshme”.

3. Kohëzgjatja e programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, janë, si më poshtë vijon:

A. Fakulteti i Shkencave Sociale:

a) Doktoratë në filozofi	24;
b) Doktoratë në sociologji	34;
c) Doktoratë në pedagogji	19;
ç) Doktoratë në psikologji	23;
d) Doktoratë në punë sociale	20.

B. Fakulteti i Mjekësisë:

a) Doktoratë në studime të thelluara në farmakologji, fiziologji, fiziologji patologjike	10;
b) Doktoratë në studime të thelluara të aspekteve epidemiologjike, diagnostike dhe terapeutike të sëmundjeve infektive, emergjente dhe riemergjente	17;
c) Doktoratë në shëndet publik	16;
ç) Doktoratë në studime të thelluara të aspekteve epidemiologjike, diagnostike dhe terapeutike të sëmundjeve të lëkurës	13;
d) Doktoratë në studime të thelluara dhe kërkime në otorinolaringologji	10;
dh) Doktoratë me studime të thelluara në kardiologji	19;
e) Doktoratë në studime në patologji oro-maxilo-faciale	43;
ë) Doktoratë në studime në neuroshkencë	23;
f) Doktoratë në studime në obstetrikë-gjinekologji	17;
g) Doktoratë në mjekësi laboratorike	26;
gj) Doktoratë në morfologji klinike	17;
h) Doktoratë në sëmundjet kirurgjikale	48;
i) Doktoratë në kardiokirurgji	4;
j) Doktoratë në imazheri	14;
k) Doktoratë në anatomi patologjike dhe mjekësi ligjore	14;
l) Doktoratë në sëmundjet e syrit	16;
ll) Doktoratë në pediatri	30;
m) Doktoratë në shkencat farmaceutike	13;
n) Doktoratë në sëmundjet e brendshme	28.

4/1. Për kandidatët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, përcaktohen 10 (dhjetë) kuota në programet e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe 40 (dyzet) kuota në programet e studimeve të doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë. Këto

kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e institucioneve përkatëse zyrtare të vendeve nga vijnë kandidatët.

4/2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me këste, të caktuara nga fakulteti përkatës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

6/1. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Nga kuotat e mësipërme të këtyre programeve të studimit caktohet 10 (dhjetë) për qind për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, datë 17.9.2009, faqe 6271*

*Vendim i KM nr.1169, datë 25.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7729*

*Vendim i KM nr.163, datë 3.3.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, datë 15.4.2010, faqe 1457*

**VENDIM**  
**Nr.855, datë 5.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE MINIERAVE, TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1167, datë 25.11.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në “Gjeoshkencat, Burimet dhe Mjedisi”.

2. Në përfundim të këtij programi lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në Gjeoshkencat, Burimet dhe Mjedisi”.

3. Kohëzgjatja e këtij programi studimesh është, të paktën, 3 (tri) vite, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 15.

4/1. Përcaktohen 10 (dhjetë) kuota për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare përkatëse.

4/2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, me këste, të caktuara nga fakulteti përkatës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, datë 17.9.2009, faqe 6274*

*Vendim i KM nr.1167, datë 25.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7728*

**VENDIM**  
**Nr.856, datë 5.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË “GJUHË-LETËRSI SHQIPE DHE FRËNGE”, NË UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, TË KORÇËS**  
*(Ndryshuar me vendim të KM nr.977, datë 8.10.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në universitetin “Fan. S. Noli” të Korçës, në fakultetin e mësuesisë, të programit të studimit “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.

2. Ky program studimi i ciklit të parë realizohet me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale është 3 (tri) vite akademike.

3. Në përfundim të këtij programi studimi përfitohet “Diplomë e nivelit të parë” DND, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.

3/1. Kuota e pranimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 50 (pesëdhjetë).

4. Ky program studimi do ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4/1. Tarifa e shkollimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Fan S. Noli” të Korçës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli” të Korçës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, datë 17.9.2009, faqe 6274*

*Vendim i KM nr.977, datë 8.10.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.162, datë 27.11.2009, faqe 7212*

**VENDIM**  
**Nr.857, datë 5.8.2009**

**PËR HAPJEN, NË QYTETIN E PESHKOPISË, TË FILIALEVE DHE TË PROGRAMEVE  
TË STUDIMEVE, TË FAKULTETEVE TË EKONOMISË E TË ADMINISTRIMIT, TË  
EDUKIMIT DHE TË SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT  
“ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË  
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI, NË  
VITIN AKADEMIK 2009-2010**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.912, datë 26.8.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.978, datë 8.10.2009)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, 11, pika 2, shkronja “b”, 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në qytetin e Peshkopisë, të filialeve të Fakulteteve të ekonomisë e të administrimit, të edukimit dhe të shkollës së lartë profesionale, të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

2. Filiali i Fakultetit të Ekonomisë dhe të Administrimit do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në:

a) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Financë-Kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Financë-Kontabilitet;

b) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Financë-Bankë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Financë-Bankë;

c) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Menaxhim marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Menaxhim-marketing;

ç) “Shkenca të Administrimit”, me profil “Administrim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Shkenca të Administrimit, me profil Administrim biznesi.

3. Filiali i Fakultetit të Edukimit do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:

a) Matematikë-Fizikë, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në matematikë-fizikë;

b) Matematikë-Informatikë, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në matematikë-informatikë;

c) Informatikë-Anglisht, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në informatikë-anglisht;

ç) Gjuhë-Letërsi-Anglisht, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në gjuhë-letërsi-anglisht;

d) Biologji-Kimi, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në biologji-kimi;

dh) Psikologji-Sociologji, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në psikologji-sociologji;

e) Procese formimi, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në procese formimi.

4. Filiali i Shkollës së Lartë Profesionale do të ofrojë programet e studimit, në:

a) “Infermieri të Përgjithshme”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë (DNP)”, në Infermieri të Përgjithshme;

b) “Drejtësi”, me profil “Asistencë ligjore”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë jouniversitare në Drejtësi”, me profil asistencë ligjore;

c) “Informatikë”, me profil “Rrjete kompjuterike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë jouniversitare në Informatikë”, në rrjete kompjuterike.

5. Programet e studimit të ciklit të parë, në filialet e Fakultetit të Ekonomisë e të Administrimit dhe të Edukimit, në qytetin e Peshkopisë, përcaktuar në pikat 2, 3 e 4, shkronja “a”, realizohen me 180 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

6. Programet e studimit të ciklit të parë, në filialin e Shkollës së Lartë Profesionale, përcaktuar në shkronjat “b” e “c”, të pikës 4, realizohen me 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

7. Këto programe studimi do ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

8. Numri i kuotave të pranimeve, në këto programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, është përcaktuar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që regjistrohen në vitin e parë, në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, datë 17.9.2009, faqe 6275*

*Vendim i KM nr.912, datë 26.8.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.142, datë 6.10.2009, faqe 6450*

*Vendim të KM nr.978, datë 8.10.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.162, datë 27.11.2009, faqe 7213*

**TABELA E KUOTAVE TË PRANIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS (FILIALI PESHKOPI)**

Nr.	PROGRAMET E STUDIMIT	KUOTAT
	<b>FAKULTETI I EKONOMISË DHE I ADMINISTRIMIT</b>	
1	Shkenca të Administrimit (profil Financë-Kontabilitet)	30
2	Shkenca të Administrimit (profil Financë- Bankë)	30
3	Shkenca të Administrimit (profil Menaxhim-Marketing)	30
4	Shkenca të Administrimit (profil Administrim-Biznesi)	30
	<b>FAKULTETI I EDUKIMIT</b>	
1	Informatikë-Anglisht	30
2	Gjuhë-Letërsi-Anglisht	30
3	Matematikë-Fizikë	30
4	Matematikë-Informatikë	30
5	Biologji-Kimi	30
6	Psikologji-Sociologji	30
7	Procese formimi	30
	<b>SHKOLLA E LARTË PROFESIONALE</b>	
1	Drejtësi (Asistent ligjor)	30
2	Infermieri e përgjithshme (3-vjeçare)	30
3	Informatikë (Specialist Rrjetash Kompjuterike)	30
	<b>Gjithsej</b>	<b>420</b>

**VENDIM**  
**Nr.864, datë 29.7.2009**

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET  
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË  
TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009-2010, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, të jetë 22 134, e ndarë, si më poshtë vijon:

- |  |         |
|--|---------|
| a) Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë | 21 034; |
| b) Kuota për program të dytë studimi                                   | 300;    |
| c) Kuota për transferim studimesh                                      | 700;    |
| ç) Kuota për shtetasit e huaj  | 100.    |

2. Kuota e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, përbëhet nga:

- |   |         |
|---|---------|
| a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit | 19 702; |
| b) Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit    | 1 307;  |
| c) Kuota për të verbërit (të veçanta)                           | 25.     |

3. Kuotat e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, ndahet, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij vendimi, ndërmjet institucioneve publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, janë pasqyruar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuota e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet kandidatëve shqiptarë, nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet nga ministrinë e arsimit dhe autoritetet përgjegjëse respektive, të cilat sjellin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat e kandidatëve fitues. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ua përcjell listat institucioneve publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, janë pasqyruar në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuota e pranimeve për të verbërit ndahet për kandidatët me statusin e të verbërit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi të merret vendimi i shoqatës së të verbërve.

6. Kuota e pranimeve për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga persona të interesuar.

7. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë:

I. Në Universitetin e Tiranës:

Për të gjitha programet e studimit, sipas fakulteteve përkatëse:

- |                                       |              |
|---------------------------------------|--------------|
| 1. Në Fakultetin e Shkencave Natyrore | 15 000 lekë. |
| 2. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja   | 15 000 lekë. |
| 3. Në Fakultetin e Drejtësisë         | 30 000 lekë. |
| 4. Në Fakultetin e Shkencave Sociale  | 30 000 lekë. |
| 5. Në Fakultetin e Mjekësisë:         |              |



a) Në programet e studimit në:	
i) "Farmaci"	30 000 lekë.
ii) "Stomatologji"	30 000 lekë.
iii) "Shëndet Publik"	30 000 lekë.
b) Në programin e studimit "Mjekësi"	25 000 lekë.
6. Në Fakultetin e Infermierisë	25 000 lekë.
7. Në Fakultetin e Histori-Filologjisë	20 000 lekë.
8. Në Fakultetin e Ekonomisë	25 000 lekë.
II. Në Universitetin Politeknik të Tiranës:	
1. Në programin e studimit "Arkitekturë"	30 000 lekë.
2. Në programin e studimit "Inxhinieri ndërtimi"	25 000 lekë.
3. Në programet e studimit:	
a) "Inxhinieri elektronike"	20 000 lekë.
b) "Inxhinieri telekomunikacioni"	20 000 lekë.
c) "Inxhinieri informatike"	20 000 lekë.
4. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
III. Në Akademinë e Arteve:	
1. Në programin e studimit "Regji filmi"	80 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	30 000 lekë.
IV. Në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi"	
Për të gjitha programet e studimit	20 000 lekë.
V. Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:	
1. Në programet e studimit:	
a) "Drejtim fermash dhe agrobiznes"	20 000 lekë.
b) "Ekonomi dhe politikë agrare"	20 000 lekë.
c) "Inxhinieri pyjesh"	20 000 lekë.
ç) "Inxhinieri e përpunimit të drurit"	20 000 lekë.
d) "Financë-kontabilitet"	20 000 lekë.
dh) "Mjekësi veterinare"	20 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
VI. Në universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit:	
1. Për programet e studimit për "Mësuesi"	12 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	15 000 lekë.
VII. Në universitetin "Eqerem Çabej" të Gjirokastrës:	
Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.
VIII. Në universitetin "Fan S. Noli" të Korçës:	
Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.
IX. Në universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës:	
1. Në programet e studimit:	
a) "Gjuhë letërsi"	15 000 lekë.
b) "Punë sociale"	15 000 lekë.
c) "Psikologji"	15 000 lekë.
ç) "Drejtësi"	16 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e tjera të studimit	12 000 lekë.
X. Në universitetin "Ismail Qemali" të Vlorës:	
1. Në programet e studimit:	
a) "Drejtësi"	20 000 lekë.
b) "Gjuhë-letërsi"	15 000 lekë.
2. Për të gjitha programet e studimit	12 000 lekë.
XI. Në universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit:	
Për të gjitha programet e studimit	15 000 lekë.

8. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, të ciklit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010, dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si: të verbër/të shurdhër, invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, e të ish-të përndjekurve politikë, përjashtohen nga tarifa e shkollimit. Nga kjo tarifë vjetore shkollimi përjashtohen edhe studentët e viteve më të larta, që vijnë nga këto shtresa sociale.

9. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.

10. Në çdo program studimi, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, 5 (pesë) studentët e vitit të parë, me rezultate më të larta në plotësimin e kriterëve të pranimit (pikët e fituara në sistemin meritë-preferencë), në programin e studimit përkatës, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Këtë përjashtim, në asnjë rast, nuk e përfitojnë studentët me notën mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota 8 (tetë).

11. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Transferimet e studentëve, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore dhe statutin e rregulloret e tyre.

13. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të parë, në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

14. Kandidatët, që dëshirojnë të vijnë në një program të dytë studimi, e fitojnë këtë të drejtë, brenda numrit të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe pa iu nënshtrohet detyrimeve të “Maturës Shtetërore”.

15. Kandidatët, që kërkojnë të studiojnë në një program të dytë studimi, në Akademinë e Arteve, në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve “Vojo Kushi”, në Tiranë, në programin e studimit të ciklit të parë “Edukimit fizik dhe sporte” të universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës dhe të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, të Elbasanit në programin e studimit të ciklit të parë “Pedagogji e specializuar”, në universitetin e Vlorës, dhe në programin e studimit “Arkitekturë” të Universitetit Politeknik të Tiranës, duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta (konkurset e pranimit), të vendosura nga vetë këto institucione.

16. Studentët, që vijnë në një program të dytë studimi i nënshtrohen tarifës së shkollimit, të përcaktuar në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

17. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

18. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të porealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme, në zbatim të këtij vendimi dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.135, datë 17.9.2009, faqe 6278*

**VENDIM**  
**Nr.880, datë 12.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË  
UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në fakultetet, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit:

i) në “Teknologji e avancuar në hortikulturë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, (MNP)”, në “Teknologji e avancuar në hortikulturë”;

ii) në “Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, (MNP)”, në “Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia”;

iii) në “Biznes blegtoral”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Biznes blegtoral”;

iv) në “Teknologjia e kultivimit të bimëve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Teknologjia e kultivimit të bimëve”;

v) në “Menaxhim mjedisi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, (MNP)”, në “Menaxhim mjedisi”.

b) Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit:

i) në “Menaxhim i ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Menaxhim i ndërmarrjeve”, me profil “Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit”;

ii) në “Ekonomi dhe agrobiznes”, me profil “Financë kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, (MNP)”, në “Ekonomi dhe agrobiznes”, me profil “Financë kontabilitet”;

iii) në “Ekonomi dhe politikë agrare”, me profil “Ekonomi dhe politikë agrare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Ekonomi dhe politikë agrare”, me profil “Ekonomi dhe politikë agrare”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, pa efekte shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.136, datë 18.9.2009, faqe 6303*

**VENDIM**  
**Nr.881, datë 12.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË  
UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Drejtim dhe administrim arsimit”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Drejtim dhe administrim arsimit”;

b) “Qeverisja dhe politikat publike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Qeverisjen dhe politikat publike”;

c) “Këshillim psikologjik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Këshillim psikologjik”;

ç) “Orientim profesional”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Orientim profesional”;

d) “Punë sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Punë sociale”;

dh) “Filozofi praktike dhe humane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Filozofi praktike dhe humane”;

e) “Analizë e politikës sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë, “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Analizë e politikës sociale”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.136, datë 18.9.2009, faqe 6304*

**VENDIM**  
**Nr.909, datë 26.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË  
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programit të studimit, të ciklit të dytë, matematikë e zbatuar, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, në matematikë e zbatuar.

2. Ky program i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është dy vite.

3. Programi i studimit matematikë e zbatuar ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.142, datë 6.10.2009, faqe 6447*

**VENDIM**  
**Nr.910, datë 26.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË**  
**UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, “Inxhinieri matematike” dhe “Inxhinieri fizike”.

2. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht, diplomë e nivelit të dytë, DND, në “Inxhinieri matematike” dhe “Inxhinieri fizike”.

3. Këto programe studimi realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

4. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.142, datë 6.10.2009, faqe 6448*

**VENDIM**  
**Nr.911, datë 26.8.2009**

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË, PRIVATE “UNIVERSITETI PLANETAR I TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti planetar i Tiranës”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Universiteti planetar i Tiranës”, të organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Sociale, që do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:

i) Mësuesi për arsimin parashkollor;

ii) Psikologji;

iii) Sociologji;

iv) Mësuesi për arsimin fillor.

b) Fakultetin e Shkencave të Zbatuara, që do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:

i) Teknologji informacioni;

ii) Informatikë ekonomike;

iii) Infermieri e përgjithshme;

iv) Teknologji dhe shkenca farmaceutike.

3. Shkolla e lartë, private “Universiteti planetar i Tiranës” të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe me plotësimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në:

i) Mësuesi për arsimin parashkollor;

ii) Psikologji;

iii) Sociologji;

iv) Mësuesi për arsimin fillor;

v) Teknologji informacioni;

vi) Informatikë ekonomike;

vii) Infermieri e përgjithshme;

viii) Teknologji dhe shkenca farmaceutike.

4. Ngarkohet shkolla e lartë private “Universiteti planetar i Tiranës”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Shkolla e lartë private “Universiteti planetar i Tiranës” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë private “Universiteti planetar i Tiranës” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.142, datë 6.10.2009, faqe 6448*

**VENDIM**  
**Nr.976, datë 8.10.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, NË  
“ADMINISTRIM DHE POLITIKË SOCIALE”, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE  
SOCIALE, E “BIOTEKNOLOGJI”, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE NATYRORE TË  
UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË  
PRANIMIT E TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.1, 33, pika 2,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës, të programeve të studimit, të ciklit të parë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Shkencave Sociale të programit “Administrim dhe politikë sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, (DNP), në administrim dhe politikë sociale;

b) Në Fakultetin e Shkencave Natyrore të programit “Bioteknologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, (DNP), në bioteknologji.

2. Këto programe studimi realizohen me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

3. Programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Numri i kuotave të pranimit për vitin akademik 2009-2010 të jetë, si më poshtë vijon:

a) 50 kuota, për programin “Administrim dhe politikë sociale”;

b) 80 kuota për programin e studimit “Bioteknologji”.

5. Tarifa vjetore e shkollimit, për këto programe studimi me kohë të plotë, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Për programin “Administrim dhe politikë sociale”, 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

b) Për programin “Bioteknologji”, 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

6. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën e studimit në njërin nga këto programe, në vitin akademik 2009-2010, dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si të verbër/shurdhër, invalidë paraplegjikë e tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.

7. Kuota e pranimeve për të verbërit ndahet për kandidatët me këtë status nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi të merret mendimi i Shoqatës Kombëtare të të Verbërve.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në secilin nga këto programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, 5 (pesë) studentët e vitit të parë, me notën mesatare më të lartë të shkollës së

mesme, të provimeve të “Maturës shtetërore”, të përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Këtë përjashtim, në asnjë rast, nuk e përfitojnë studentët me notë mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota 8 (tetë).

10. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në njërën nga këto programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve, kur, në marrëveshjet zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.162, datë 6.10.2009, faqe 7211*

**VENDIM**  
**Nr.984, datë 30.9.2009**

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE DHE “MASTER I NIVELIT TË PARË”, ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.1089, datë 4.11.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.1101, datë 11.11.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.1160, datë 25.11.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.1280, datë 23.12.2009;  
ndryshuar me vendim të KM nr.358, datë 12.5.2010)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kuota e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë dhe “Master i nivelit të parë”, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, të jetë 7 570 dhe të ndahet sipas skemës së mëposhtme:

a) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë (DND)	2830;
b) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i nivelit të parë” (MNP)	4470;
c) Kuota për programe të dyta studimi	100;
ç) Kuota për transferimin e studimeve	100;
d) Kuota për të huajt	50;
dh) Kuota për të verbërit (të veçanta)	20.

Kuota e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, të përbëhet nga:



a) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë (DND), për kandidatët brenda territorit të vendit	2547;
b) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë (DND), për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit	283;
c) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), për kandidatët brenda territorit të vendit	4023
d) Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit,	447.

3. Kuota e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë (DND), me kohë të plotë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit Master i nivelit të parë, (MNP), me kohë të plotë, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 2 të këtij vendimi, të ndahen nëpërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet nga autoritetet përgjegjëse respektive të këtyre vendeve, të cilat sjellin listat e kandidatëve fitues, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila ua përcjell ato institucioneve publike të arsimit të lartë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve të ndryshme publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, janë në masën 10 për qind të kuotës përkatëse, të dhënë në tabelën nr.1 dhe në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Kuota e pranimeve për të verbërit ndahen për kandidatët me statusin e të verbërit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi merret mendimi i Shoqatës Kombëtare të të Verbërve.

7. Kuota e pranimi për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij vendimi, të administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Kuota shpërndahet në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe, si edhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga kandidatët e interesuar.

8. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe transferimi i studimeve të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës bazuar edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë do të funksionojë në vitin e parë për vitin akademik 2009-2010, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimi të kandidatëve dhe i bëjnë publike paraprakisht.

11. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, (DND) dhe master i nivelit të parë me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, sipas tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër/të shurdhër, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, e të ish-të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë, në masën, 50 për qind të tarifës së shkollimit.

Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që i përkasin po këtyre shtresave sociale.

13. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë rregullisht studimet.

14. Në çdo program studimi në ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, studentët e vitit të parë, që kanë përfunduar shkëlqyeshëm ciklin e parë të studimeve, dhe studentët e vitit të dytë, që kanë përfunduar shkëlqyeshëm vitin e parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit për vitin akademik 2009-2010.

Në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, për lëndët fizikë, matematikë apo kombinimet e tyre, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, studentët që në ciklin e parë kanë pasur mesatare jo më të ulët se nota 8 (tetë), nuk paguajnë tarifën e shkollimit.

15. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që ndjekin një program të dytë studimi, në ciklin e dytë të studimeve DND dhe “Master i nivelit të parë” (MNP) janë sipas tabelës nr.4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

16. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.

17. Transferimet e studimeve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhënë në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore, në statut dhe rregulloret e tyre.

18. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi, apo nga programe të mëparshme studimi, të ciklit të dytë, në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

19. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të përcaktuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

20. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës për nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, datë 5.11.2009, faqe 6816*

*Vendim i KM nr.1089, datë 4.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.151, datë 6.11.2009, faqe 6861*

*Vendim i KM nr.1101, datë 11.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.173, datë 6.12.2009, faqe 7682*

*Vendim i KM nr .1160, datë 25.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 6.12.2009, faqe 7722*

*Vendim i KM nr.1280, datë 23.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.192, datë 15.1.2010, faqe 8500*

*Vendim i KM nr.358, datë 12.5.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2009, faqe 2569*

Tabela nr.1

	Emërtimet e programeve te studimit	UT	UPT	UBT	USH	UE	UD	UGJ	UV	Σ
1	Biologji mjedisore	30								30
2	Biologji molekulare	30								30
3	Fizikë	20								20
4	Bioteknologji molekulare dhe industriale	20								20
5	Kimi industriale dhe mjedisore	30								30
6	Inxhinieri e proceseve kimike	30								30
7	Shkenca dhe teknologjitë ushqimore	30								30
8	Kimi	30								30
9	Matematikë	30							50	80
10	Inxhinieri matematike dhe informatike	30								30
11	Informatikë	40								40
12	Gjuhë dhe komunikim ndërkulturor	80								80
13	Përkthim teknik letrar dhe interpretim	80								80
14	Gjuhësi	100								100
15	Histori	50								50
16	Arkeologji	50								50
17	Trashëgimi kulturore	50								50
18	Marrëdhënie ndërkombëtare	20								20
19	Gazetari	100								100
20	Përkatësi gjinore dhe zhvillim	60								60
21	Psikolog shkollor/organizacional	30								30
22	Psikolog klinik i zhvillimit dhe marrëdhënieve	30								30
23	Filozofi sociale	60								60
24	Shkenca politike	50								50
25	Sociologji e zhvillimeve shoqërore	40								40
26	Punë sociale	100								100
27	Inxhinieri elektronike		20							20
28	Inxhinieri e telekomunikacionit		20							20
29	Inxhinieri informatike		20							20
30	Inxhinieri elektrike		40							40
31	Inxhinieri mekanike		55							55
32	Inxhinieri materiale		20							20
33	Inxhinieri tekstili dhe mode		20							20
34	Inxhinieri gjeologjike		80							80
35	Inxhinieri e burimeve natyrore		80							80
36	Inxhinieri gjeofizike		20							20
37	Inxhinieri gjeomjedis		20							20
38	Inxhinieri mjedisi		60							60
39	Inxhinieri ndërtimi		120							120
40	Inxhinieri hidroteknikë		30							30
41	Inxhinieri gjeodezi		30							30
42	Inxhinieri agrare			170						170
43	Inxhinieri agromjedis			40						40
44	Inxhinieri agroushqimore			85						85
45	Inxhinieri përpunim druri			30						30
46	Inxhinieri pyjore			30						30
47	Ekonomi dhe politika agrare			200						200
48	Menaxhim agrobiznesi			200						200
49	Inxhinieri matematike		40							40
50	Inxhinieri fizike		40							40
51	Turizëm i qëndrueshëm				30					30
52	Mbrojtje mjedisi					30				30
53	Matematikë e zbatuar					25				25
54	Trashëgimi kulturore					30				30
55	Studime shqiptare dhe etnokulturore				90					90
56	Ekonomi biznesi						60			60
57	Menaxhim						60			60
58	Politika dhe administrim						60			60
59	Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike							25		25
60	Inxhinieri navale								25	25
	<b>Totali</b>	<b>1220</b>	<b>715</b>	<b>755</b>	<b>120</b>	<b>85</b>	<b>180</b>	<b>25</b>	<b>75</b>	<b>3175</b>

Tabela nr.2

	Nr. emërtimet e programeve të studimit	UT	UE	USH	UV	UK	UGJ	UBT	Σ
1	Mësuesi në CLAB në gjuhë - letërsi		90	60		60	50		260
2	Mësuesi në CLAB në biologji - kimi		130	60			50		240
3	Mësuesi në CLAB në gjuhë italiane		20	60	80				160
4	Mësuesi në CLAB në gjuhë gjermane		20	60					80
5	Mësuesi në CLAB në gjuhë frënge		30	60					90
6	Mësuesi në CLAB në gjuhë angleze		60	60	80	40	50		290
7	Mësuesi në CLAB në matematikë - Fizikë		40	60	30	20	50		200
8	Mësuesi në CLAB në matematikë – informatikë		20	60			50		130
9	Mësuesi në CLAB në histori - gjeografi		60				50		110
10	Mësuesi në AM në shkencë sociale	40				40			80
11	Mësuesi në AM në gjuhë angleze	150							150
12	Mësuesi në AM në gjuhë frënge	80							80
13	Mësuesi në AM në gjuhë gjermane	80							80
14	Mësuesi në AM në gjuhë italiane	80							80
15	Mësuesi në AM në gjuhë -letërsi	200				35			235
16	Mësuesi në AM në histori	100							100
17	Mësuesi në AM në gjeografi	100							100
18	Mësuesi në AM në kimi	30							30
19	Mësuesi në AM në biologji	60							60
20	Mësuesi në AM në fizikë	50							50
21	Mësuesi në AM në matematikë	60			30				90
22	Mësuesi në AM në informatikë	20			30				50
23	Menaxhim infermieror	150							150
24	Teknik laborator	70							70
25	Mami	50							50
26	Teknologji informacioni	20							20
27	Zhvillim i integruar rural					30			30
28	Operacione industriale dhe navale				30				30
29	Edukatë qytetare dhe gjeografi		70						70
30	Edukatë qytetare dhe histori		70						70
31	Redaktim		30						30
32	Drejtim dhe administrim arsimit	40							40
33	Qeverisje dhe politikë publike	50							50
34	Këshillim psikologjik	40							40
35	Orientim profesional	40							40
36	Punë sociale	100							100
37	Filozofi praktike dhe humane	40							40
38	Analizë e politikës sociale	100							100
39	Teknologji e avancuar në hortikulturë						10		10
40	Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia						0		0
41	Biznes blegtoral						10		10
42	Teknologji e kultivimit të bimëve						10		10
43	Menaxhim mjedisi						40		40
44	Menaxhim i ndërmarrjeve						0		0
45	Ekonomi dhe agrobiznes						0		0
46	Ekonomi dhe politikë agrare						0		0
47	Redaktori	70							70
48	Gjeomorfologji	20							20
49	Arkivistikë	100							100
50	Sipërmarrje dhe turizëm				70				70
51	Administrim publik				70				70
52	Perkthim dhe interpretim në gjuhë gjermane			20					20
	<b>Gjithsej</b>	<b>1940</b>	<b>640</b>	<b>500</b>	<b>420</b>	<b>225</b>	<b>300</b>	<b>70</b>	<b>4095</b>

TABELA 3

Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, DND, në vitin akademik 2009-2010:

a) në Universitetin e Tiranës:

I. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Fizikë	44 000 lekë
ii) Matematikë	40 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	56 000 lekë.

II. Fakultetin e Gjuhëve të Huaja: 48 000 lekë.

III. Në fakultetin Histori-Filologji:

i) Arkeologji	72 000 lekë
ii) Trashëgimi kulturore	72 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	48 000 lekë.

IV. Në Fakultetin e Shkencave Sociale: 60 000 lekë

b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës:

I. Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit:	56 000 lekë
II. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike	48 000 lekë
III. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike	40 000 lekë
IV. Në fakultetin e Gjeologji Miniera	40 000 lekë
V. Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit	60 000 lekë.

VI. Në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 56 000 lekë.

c) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:

I. Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit	36 000 lekë
II. Në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit	40 000 lekë
III. Në Fakultetin e Shkencave Pyjore	36 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit	48 000 lekë.

d) Në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë	40 000 lekë
e) Në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër	50 000 lekë
f) Në universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës	50 000 lekë
g) Në universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan:	
i) Matematikë e zbatuar	40 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	50 000 lekë.
gj. Në universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër:	
i) Arkeologji dhe administrim të pasurive arkeologjike	60 000 lekë.

Tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit “Master i nivelit të parë” me kohë të plotë, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009-2010:

a) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

- i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 30 000 lekë
- ii) Të gjitha programet e tjera 4 000 lekë

b) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

- i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 40 000 lekë
- ii) të gjitha programet e tjera 45 000 lekë
- c) Për të gjitha programet e tjera “Master i nivelit të parë” 60 000 lekë.

#### TABELA NR.4

Tarifat vjetore të shkollimit për programet e dyta të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, DND, në vitin akademik 2009-2010:

a) Në Universitetin e Tiranës:

I. Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Fizikë	95 000 lekë
ii) Matematikë	95 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	150 000 lekë
II. Në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja	95 000 lekë
III) Në Fakultetin Histori-Filologji:	
i) Arkeologji	200 000 lekë
ii) Trashëgimi kulturore	200 000 lekë
iii) Të gjitha programet e tjera	95 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Shkencave Sociale	95 000 lekë

b) Në Universitetin Politeknik të Tiranës:

I. Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit	200 000 lekë
II. Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike	200 000 lekë
III. Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike	150 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Gjeologji-Miniera	150 000 lekë
V. Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit	250 000 lekë

VI. Në Fakultetin e Inxhinierisë

Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

70 000 lekë.

c) Në Universitetin Bujqësor të Tiranës:

I. Në fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit	150 000 lekë
II. Në fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit	200 000 lekë
III. Në fakultetin e Shkencave Pyjore	95 000 lekë
IV. Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit	95 000 lekë

d) Në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë 95 000 lekë

e) Në universitetin “Luigj Gurakuqi, Shkodër 95 000 lekë

f) Në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës 95 000 lekë

g) Në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

gj. Në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër:

i) Arkeologji dhe administrim të pasurive arkeologjike	200 000 lekë.
i) Matematikë e zbatuar	80 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	95 000 lekë

Tarifat vjetore të shkollimit për programet e dyta të studimit “Master nivelit të parë” me kohë të plotë, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009-2010:

a) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

i) Për lëndën fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre	60 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	80 000 lekë

b) Për programet e studimit “Master i nivelit të parë” në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

i) Për lëndën fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre	80 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	100 000 lekë

c) Për programet e tjera “Master i nivelit të parë”:

i) Në Fakultetin e Infermierisë	200 000 lekë
ii) Të gjitha programet e tjera	

#### VENDIM

**Nr.999, datë 30.9.2009**

### **PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.2.3, dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Ekonomisë dhe të Drejtësisë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Sipërmarrje dhe turizëm”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në sipërmarrje dhe turizëm;

b) “Administrim publik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në administrim publik.

2. Programi i studimeve të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është një vit.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6961*

**VENDIM**  
**Nr.1000, datë 30.9.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.2.3, e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të programit të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën gjermane”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në përkthim dhe interpretim në gjuhën gjermane.

2. Programi i studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit.

3. Ky program studimi ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6962*

**VENDIM**  
**Nr.1001, datë 30.9.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pikat 1.2.3, e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin Histori-Filologji, të programeve të studimit të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Redaktori”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në redaktori;

b) “Gjeomorfologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në gjeomorfologji;

c) “Arkivistikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”, MNP, në arkivistikë;

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë, “Master i nivelit të parë”, realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.



4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6963*

**VENDIM**  
**Nr.1002, datë 30.9.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË**  
**UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.2.1, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në Fakultetin e Ekonomisë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, në:

a) “Menaxhim”, me profile:

i) Menaxhim biznesi, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në menaxhim, me profil menaxhim biznesi.

ii) Marketing, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në menaxhim, me profil marketing.

b) “Politika dhe administrim”, me profile:

i) Administrim publik, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në “Politika dhe administrim”, me profil administrim publik.

ii) Administrim financiar, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në “Politika dhe administrim”, me profil administrim financiar.

c) “Ekonomi-Biznes”, me profile:

i) Ekonomi biznesi, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në “Ekonomi-Biznes”, me profil ekonomi biznesi.

ii) Financë-Bankë, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në “Ekonomi-Biznes”, me profil financë-bankë.

2. Programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009 miratuar për universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6963*

**VENDIM**  
**Nr.1003, datë 30.9.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË  
UNIVERSITETIN “EQEREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1. 2.1, 29 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastër, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në bashkëpunim me Universitetin e Maceratës, Itali, të programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë “Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike”.

2. Në përfundim të këtij programi studimi të ciklit të dytë lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, e përbashkët, në “Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike”.

3. Ky program studimi i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është dy vite.

4. Programi i studimit “Arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike” ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Eqerem Çabej”, Gjirokastër.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6964*

**VENDIM**  
**Nr.1004, datë 8.10.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË, “MASTER I  
NIVELIT TË DYTË”, NË GJUHËN SHQIPE, NË QENDRËN NDËRUNIVERSITARE TË  
STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 3, 26, pika 1.3.4, e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Qendrën Ndëruniversitare të Studimeve Albanologjike, të programit të studimit, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjuhë shqipe.

2. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në gjuhë shqipe.

3. Programi i studimit realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit.

4. Ky program studimi ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
  5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Qendrën Ndëruniversitare të Studimeve Albanologjike.
  6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6965*

**VENDIM**  
**Nr.1005, datë 8.10.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, si më poshtë vijon:

a) Në “Inxhinieri mekanike”, në profilet:

i) “Sistemet e prodhimit dhe proceset teknologjike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Sistemet e prodhimit dhe proceset teknologjike”.

ii) “Sistemet e energjisë dhe proceset termike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Sistemet e energjisë dhe proceset termike”.

iii) “Sistemet e transportit dhe menaxhimi i trafikut”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Sistemet e transportit dhe menaxhimi i trafikut”.

b) Në “Materiale”, në profilet:

i) “Materiale metalike dhe alternative”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Materiale metalike dhe alternative”.

ii) “Materiale tekstile”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Materiale tekstile”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është, të paktën, një vit.

3. Këto programe studimesh ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6965*

**VENDIM**  
**Nr.1006, datë 8.10.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË, “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË FAKULTETET E HISTORISË E FILOLOGJISË, TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË SHKENCAVE NATYRORE, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4, e 42, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e programeve të studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Universitetin e Tiranës, në këto fakultete:

a) Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë:

i) Në “Histori”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Histori”.

ii) Në “Arkeologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Arkeologji”.

iii) Në “Trashëgimi kulturore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Trashëgimi kulturore”.

iv) Në “Marrëdhënie ndërkombëtare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Marrëdhënie ndërkombëtare”.

b) Fakulteti i Gjuhëve të Huaja:

i) Në “Shkenca gjuhësore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Shkenca gjuhësore”.

ii) Në “Letërsi botërore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Letërsi botërore”.

c) Fakulteti i Shkencave Natyrore:

i) Në “Matematikë teorike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Matematikë teorike”.

ii) Në “Sisteme informatike të avancuara”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Sisteme informatike të avancuara”.

iii) Në “Fizikë”, në profilet:

- “Fizikë teorike llogaritëse”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Fizikë teorike llogaritëse”.

- “Fizikë e aplikuar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Fizikë e aplikuar”.

- “Biofizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biofizikë”.

iv) Në “Fizikë dhe kimi materialesh”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Fizikë dhe kimi materialesh”.

v) Në “Inxhinieri e proceseve kimike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Inxhinieri e proceseve kimike”.

vi) Në “Teknologjitë dhe mikrobiologjitë e ushqimeve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Teknologjitë dhe mikrobiologjitë e ushqimeve”.

vii) Në “Analiza kimike dhe instrumentale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Analiza kimike dhe instrumentale”.

viii) Në “Biologji”, në profilet:

- Biologji shtazore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biologji shtazore”.

- “Biologji bimore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biologji bimore”.

- “Edukim biologjik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Edukim biologjik”.

ix) Në “Biologji eksperimentale”, në profilet:

- “Biologji qelizore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Biologji qelizore”.

- “Gjenetikë e popullatave”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Gjenetikë e popullatave”.

- “Mikrobiologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), me profil “Mikrobiologji”.

2. Programet e studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre, është, të paktën, një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, miratuar për Universitetin e Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.155, datë 20.11.2009, faqe 6966*

#### **VENDIM**

**Nr.1068, datë 21.10.2009**

### **PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELI TË DYTË”, NË KIMI DHE KIMI INDUSTRIALE E MJEDISORE, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE NATYRORE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4,e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në:

a) ”Kimi”, me profil “Elektrokimia e korrozionit dhe dukuritë sipërfaqësore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë”, MND, në kimi, me drejtim “Elektrokimia e korrozionit dhe dukuritë sipërfaqësore”;

b) ”Kimi industriale e mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë”, MND, në kimi industriale e mjedisore.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Universitetit të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.162, datë 27.11.2009, faqe 7217*

**VENDIM**  
**Nr.1070, datë 21.10.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.829, DATË 29.7.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË FAKULTETIN E MUZIKËS TË AKADEMISË SË ARTEVE DHE MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFAVE PËR KËTO PROGRAME”**

*(Ndryshuar me vendim të KM nr.439, datë 9.6.2010;  
ndryshuar me vendim të KM nr.69, datë 17.2.2010)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kuota e pranimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” (MND), për vitin akademik 2009-2010, është 1625, dhe ndahet, si më poshtë vijon:

a) 1575 kuota për kandidatët shqiptarë, nga të cilat 10% në kuotën e çdo programi studimi janë për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

b) 50 kuota për studentët e huaj.

2. Kuotat e pranimit, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen në institucionet publike të arsimit të lartë dhe programet përkatëse të studimit, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2/1. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

3. Kuotat për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve përkatëse zyrtare të këtyre trojeve.

4. Kuotat e pranimit të shtetasve të huaj, në programet e studimit MND, në institucionet publike të arsimit të lartë, të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të marrëveshjeve me vendet përkatëse dhe të kërkesave të vetë kandidatëve.

5. Tarifa e shkollimit, për studentët e regjistruar në MND, në vitin akademik 2009-2010, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, që likuidohet në këste të caktuara nga fakulteti përkatës.

7. Studentët nga Republika e Shqipërisë, që kanë kryer me rezultate të shkëlqyera ciklin pararendës të studimeve, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

8. Në pikën 3 të vendimit nr.829, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve dhe miratimin e kuotave dhe tarifave për këto programe”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kuota e pranimit në programin e studimeve “Master i nivelit të dytë”, në “Interpretim”, është 40. Dy kuota prej tyre caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet përkatëse publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.162, datë 27.11.2009, faqe 7219*

*Vendim i KM nr.439, datë 9.6.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.85, datë 12.7.2010, faqe 4455*

*Vendim i KM nr.69, datë 17.2.2010, botuar në Fletoren Zyrtare nr.24, datë 19.3..2010, faqe 732*

Tabela nr.1

**SHPËRNDARJA E KUOTËS SË PRANIMIT NË MND, SIPAS INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE PËRKATËSE TË STUDIMIT**

**A. UNIVERSITETI I TIRANËS**

<b>Nr.</b>	<b>Programi i studimit MND</b>	<b>Fakulteti</b>	<b>Kuota</b>
1	Gjuhësi	Fakul.i Historisë dhe Filologjisë	100
2	Studime letrare	“	70
3	Shkencë e bibliotekave	“	70
4	Histori	“	60
5	Arkeologji	“	30
6	Trashëgimi kulturore	“	20
7	Marrëdhënie ndërkombëtare	“	90
8	Gjografi, me profilet:	“	
	a) Gjeografi fizike dhe mjedisore	“	70
	b) Gjeografi humane dhe rregullim territori	“	70
9	Shkenca gjuhësore	Fakul. i Gjuhëve të Huaja	50
10	Letërsi botërore	“	60
11	Kërkime në edukim	Fakul. i Shkencave Sociale	25
12	Kërkim psikologjik	“	20
13	Kërkim shkencor në punë sociale	“	25
14	Shkenca juridike civile	Fakul. i Drejtësisë	50
15	Shkencat penale	“	50
16	E drejta kushtetuese, e krahasuar dhe europiane	“	50
17	Financë	Fakulteti Ekonomik	60
18	Kontabilitet	“	40
19	Studime ekonomike europiane	“	40
20	Marketing	“	40
21	Administrim biznesi	“	40
22	Administrim publik	“	40
23	Matematikë teorike	Fakult. i Shkencave natyrore	30
24	Sisteme informatike të avancuara	“	10

25	Fizikë, me profilet:	“	
	a) Fizikë teorike llogaritëse	“	15
	b) Fizikë e aplikuar	“	15
	c) Biofizikë	“	15
26	Fizikë dhe kimi materialesh	“	10
27	Inxhinieri e proceseve kimike	“	10
28	Teknologjitë dhe mikrobiologjitë e ushqimeve	“	10
29	Analiza kimike dhe instrumentale	“	10
30	Biologji, me profilet:	“	
	a) Biologji shtazore	“	15
	b) Biologji bimore	“	15
	c) Edukim biologjik	“	15
31	Biologji eksperimentale, me profilet:	“	
	a) Biologji qelizore	“	15
	b) Gjenetikë e popullatave	“	15
	c) Mikrobiologji	“	15
32	Kimi, me drejtim: Elektrokimia e korrozionit dhe dukuritë sipërfaqësore	“	10
33	Kimi industriale dhe mjedisore	“	10

#### B. UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Nr.	Programi i studimit MND	Fakulteti	Kuota
1	Automatikë dhe teknologjitë e kontrollit	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	20
2	Inxhinieri mekanike, me profilet:	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	
	a) Sistemet e prodhimit dhe proceset teknologjike	“	20
	b) Sistemet e energjisë dhe proceset termike	“	20
	c) Sistemet e transportit dhe menaxhimi i trafikut	“	30
3	Materiale, me profilet:	“	
	a) Materiale metalike dhe alternative	“	20
	b) Materiale tekstile	“	20

#### C. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Nr.	Programi i studimit MND	Fakulteti	Kuota
1	Teknologji mjedisi	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	20
2	Menaxhimi i resurseve dhe përmirësimi gjenetik i bimëve	“	20
3	Kontroll i integruar i parazitëve në bimë	“	20
4	Hortikulturë e qëndrueshme	“	20
5	Shkencat e prodhimit shtazor	“	20
6	Ekonomi dhe agrobiznes, me profilet:	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	
	a) Menaxhim i ndërmarrjeve	“	20
	b) Ekonomi dhe politika agrare	“	20



	c) Zhvillimi rural i integruar	“	20
	d) Menaxhim financiar	“	20
7	Mjekësi veterinare, me profilet:	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare	
	a) Diagnozë laboratorike	“	15
	b) Klinikë veteriniare	“	15

**D. QENDRA NDËRUNIVERSITARE E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

<b>Nr.</b>	<b>Programi i studimit të MND-së</b>	<b>Kuota</b>
1	Gjuhë shqipe	15
2	Studime letrare	15
3	Etnologji dhe folklor	15
4	Histori moderne e Shqipërisë	15
5	Arkeologji e prehistorisë	15
6	Arkeologji e antikitetit	15
7	Arkeologji mesjetare	15

**VENDIM**

**Nr.1108, datë 28.10.2009**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE MËSIMORË, ME KONTRATË TË PËRKOSSHME, PËR PERIUdhËN 14 SHTATOR – 31 DHJETOR 2009, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Numri i punonjësve mësimorë me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2009-2010, për periudhën 14 shtator-31 dhjetor 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, të jetë 2 243 (dy mijë e dyqind e dyzet e tre) veta.

2. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, sipas DAR/ZA-ve, dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve janë përcaktuar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2009, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.178, datë 22.12.2009, faqe 7861*

NUMRI I PUNONJËSVE MËSIMORË ME KONTRATË TË PËRKOHSHME DUKE  
FILLUAR NGA DATA 15 SHTATOR-31 DHJETOR 2009

Nr.	Emërtimi	Punonjës me kontratë të përkohshme 15 shtator-31 dhjetor 2009		
		Deri 30 qershor	15 shtator-31 dhjetor	
I	Berat	106	65	
a	Arsimi bazë 0,42	96	65	
b	Arsimi i mesëm i përgjithshëm 0,43	4	0	
c	Arsimi i mesëm profes. 0,44	5	0	
d	Ars. Mes. Prof. Komb 0,44	1	0	
I	Skrapar	31	20	
a	Arsimi bazë 0,42	25	17	
b	Arsimi i mesëm i përgjithshëm 0,43	3	2	
c	Arsimi i mesëm profes. 0,44	3	1	
I	Kuçovë	14	0	
a	Arsimi bazë 0,42	9	0	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	0	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	3	0	
I	Durrës	180	180	
a	Arsimi bazë 0,42	173	179	
b	Arsimi i mesëm 0,43	1	1	
d	Ars. Mes. Prof. Komb. 0,44	6		
	Sh. "B. Çela"	2		
	Sh. "B. Qerazhi"	4		
I	Krujë	54	44	
a	Arsimi Bazë 0,42	53	44	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	0	
I	Dibër	83	64	
a	Arsimi bazë 0,42	69	51	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	10	8	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	4	5	
I	Bulqizë	26	26	
a	Arsimi bazë 0,42	21	21	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	5	
I	Mat	107	81	
a	Arsimi bazë 0,42	95	76	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	11		
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	1	5	
I	Elbasan	209	180	
a	Arsimi bazë 0,42	179	146	
b	Arsimi i Mesëm 0,43	16	18	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	10	10	
d	Ars. Mes. Prof. Komb. 0,44	4	6	
	Sh. "Luigj Gurakuqi"	1	0	
	Sh. "Ali Myftiu"	3	6	
I	Gramsh	33	30	
a	Arsimi bazë 0,42	28	25	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	5	
I	Librazhd	60	35	

a	Arsimi bazë 0,42	60	32	
a	Arsimi i Mesëm 0,43	0	3	
I	Peqin	51	39	
a	Arsimi bazë 0,42	50	38	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	1	
I	Fier	197	150	
a	Arsimi bazë 0,42	187	140	
b	Arsimi i Mesëm 0,43	5	5	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	5	5	
	Sh. Artistike "Jakov Xoxa"	5	5	
I	Mallaksatër	31	26	
a	Arsimi bazë 0,42	31	26	
I	Lushnjë	77	70	
a	Arsimi bazë 0,42	62	49	
b	Arsimi i Mesëm 0,43	10	19	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	5	2	
I	Gjirokastrë	34	2	
a	Arsimi bazë 0,42	27	2	
b	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	7	0	
I	Përmet	17	0	
a	Arsimi bazë 0,42	12	0	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	5	0	
I	Tepelenë	37	15	
a	Arsimi bazë 0,42	36	15	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	1	0	
I	Korçë	81	55	
a	Arsimi bazë 0,42	75	51	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	6	4	
I	Kolonjë	6	7	
a	Arsimi bazë 0,42	5	7	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	0	
I	Devoll	12	2	
a	Arsimi bazë 0,42	10	2	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	0	
I	Pogradec	47	40	
a	Arsimi bazë 0,42	46	39	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	1	1	
I	Kukës	64	60	
a	Arsimi bazë 0,42	60	56	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	4	4	
I	Has	57	57	
a	Arsimi bazë 0,42	55	52	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	5	
I	Tropojë	54	66	
a	Arsimi bazë 0,42	47	58	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	7	8	
I	Lezhë	86	86	
a	Arsimi bazë 0,42	71	80	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	15	4	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	0	2	
I	Laç	63	50	
a	Arsimi bazë 0,42	58	49	

b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	1	
I	Mirditë	66	48	
a	Arsimi bazë 0,42	66	48	
I	Shkodër	241	69	
a	Arsimi bazë 0,42	199	63	
b	Arsimi i Mesëm 0,43	23	3	
c	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	7	3	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	12	0	
	Sh. Industriale “Arben Broci”	4	0	
	Sh.Pyjore “Kol Margjini”	4	0	
	Sh. Artistike “Preng Jakova”	4	0	
I	Pukë	13	0	
a	Arsimi bazë 0,42	10	0	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	3	0	
I	Malësi e Madhe	39	32	
a	Arsimi bazë 0,42	37	27	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	2	5	
I	Kavajë	31	22	
a	Arsimi bazë 0,42	26	19	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	5	0	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44 Sh. Agrobiznes Golem	0	0 3 3	
I	Bashkia Tiranë	557	343	
a	Arsimi bazë 0,42	263	223	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	167	70	
d	Ars. Mes.Prof. Komb. 0,44	127	50	
1	Shkolla e Mesme “Jordan Misja”	67	30	
2	Shkolla e Mesme Hoteleri Turizëm	7	3	
3	Shkolla e Mesme Koreografike	8	3	
4	Shkolla e Mesme “L. Boriçi”	2	1	
5	Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja	13	4	
6	Shkolla e Mesme Ekonomike	13	4	
7	Shkolla e Mesme e Ndërtimit	8	2	
8	Shkolla e Mesme Teknike	9	3	
I	Tirana Rreth	134	147	
a	Arsimi bazë 0,42	105	105	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	29	38	
c	Arsimi i Mesëm Profesional	0	4	
I	Vlorë	87	72	
a	Arsimi bazë	73	63	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	10	6	
c	Arsimi i Mesëm Profesional	2	1	
d	Ars. Mes.Prof. Komb.	2	2	
	Sh. Industriale “Pavarësia”	2	2	
I	Sarandë	56	50	
a	Arsimi bazë	52	44	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	0	4	
c	Arsimi i Mesëm Profesional	4	2	
I	Delvinë	20	10	
a	Arsimi bazë	19	10	
b	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	1	0	

A.	Arsimi Parauniversitar	3061	2243	
1	Arsimi bazë 0,42	2490	1922	
2	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 0,43	357	216	
3	Arsimi i Mesëm Profes. 0,44	57	39	
4	Ars. Mes.Prof. Komb.	157	66	

## VENDIM

Nr.1113, datë 13.11.2009

### **PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2009-2010, të jenë 6145, të cilat të ndahen, si më poshtë vijon:

a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme	5905; 40;
b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë	100;
c) Kuotat për transferim studimesh	
ç) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe për shtetas të tjerë të huaj	100.

2. Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” e “b”, të pikës 1 të këtij vendimi, të shpërndahen sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kuota e çdo programi studimi në raportin 2:1, përkatësisht, për pranimet e reja, për programe studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe për pranimet e reja, për programe të dyta studimi.

3. Kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e tjerë të huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe të kërkesave individuale të këtyre shtetasve.

5. Çdo shtetas shqiptar, i cili ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron dëftesë pjekurie apo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, ekuivalente me të, ka të drejtë të kandidojë për në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

6. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

7. Kandidatët, që dëshirojnë të ndjekin studimet, me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, brenda kuotës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, e fitojnë këtë të drejtë, sipas

kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë e të bëra publike paraprakisht.

8. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në programe të dyta studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Përjashtohen nga tarifa e shkollimit kandidatët, të cilët fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, si program i parë studimi, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010, që u përkasin këtyre shtresave shoqërore, si të verbërit, të shurdhët, invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë, kryefamiljaret (gratë) me fëmijë, kandidatët, që vijnë nga familje, të cilat trajtohen me ndihmë sociale, si dhe fëmijët, që gëzojnë statusin ligjor të jetimit.

11. Këtë të drejtë e kanë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave shoqërore.

12. Studentët e paguajnë tarifën e shkollimit të ndarë në këste vjetore, në përputhje me kreditet e lëndëve, që do të frekuentojnë në çdo vit akademik. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit për një lëndë sa herë e frekuenton atë.

13. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin pasardhës.

14. Shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e tjerë të huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë përcaktuar mënyra të tjera për tarifën.

15. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.178, datë 22.12.2009, faqe 7865*

## KUOTA E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010

Tabela nr.1

Kuota e pranimeve të reja në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë në vitin akademik 2009-2010

Nr.	Programi i studimit	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	Σ
1	Histori	250					60	310
2	Gjeografi	250					60	310
3	Histori-gjeografi			100	100			200
4	Gjuhë-letërsi	250		100	100	100	60	610
5	Gazetari							
6	Edukatë qytetare			80				80
7	Anglisht							
8	Frëngjisht							
9	Italisht							
10	Gjuhë spanjolle							

11	Rusisht							
12	Gjermanisht							
13	Gjuhë letërsi greke							
14	Gjuhë turke							
15	Cikli i ulët			200	100	75	60	435
16	Cikli i ulët parashkollor			100	100	75	60	335
17	Fizkulturë							
18	Matematikë						60	60
19	Fizikë						60	60
20	Inx.matematike dhe informatike							
21	Matematikë-fizikë			80	100			180
22	Biologji-kimi			90	100		60	250
23	Biologji	100						100
24	Kimi							
25	Kimi ushqimore							
26	Kimi industriale							
27	Matematike-informatike							
28	Informatikë							
29	Teknologji informacioni							
30	Punë Sociale	100		100				200
31	Filozofi							
32	Filozofi-sociologji			100				100
33	Sociologji							
34	Pedagogji e specializuar							
35	Psikologji	100						100
36	Shkencat politike							
37	Drejtësi	200					60	260
38	Shëndeti publik							
39	Mjekësi							
40	Stomatologji							
41	Farmacitë							
42	Infermieri e përgjithshme							
43	Mami							
44	Teknik imazherie							
45	Teknik laboratorit							
46	Fizioterapi							
47	Infermieri (Kukës)							
48	Mami (Infermieri)							
49	Tek. i lartë laboratorit							
50	Fizioterapi							
51	Logopedi							
52	Imazheri							
53	Administrim publik				100			100
54	Administrim-biznes	130		100		75	60	365
55	Ekonomiks							
56	Ekonomia dhe e drejta							
57	Financë-kontabilitet	130		100	100	90	60	480
58	Info ekonomike							
59	Administrim-biznes							

	(turizëm)Sarandë							
60	Administrim-biznes (Kukës)							
61	Turizëm				100	75	60	235
62	Marketing					75		75
63	Turizëm (Pogradec)					60		60
64	Inxh.navigacioni							
65	Inxh.metalurgji materiale							
66	Inxh.tekstile dhe mode							
67	Inxhinieri elektrike							
68	Inxh.elektronike							
69	Inxh. informatike							
70	Inxh. telekominikacioni							
71	Inxh.mekatronike							
72	Inxhinieri ndërtimi							
73	Inxhinier hidroteknik							
74	Arkitekturë							
75	Inxh.matematike							
76	Inxh.fizike							
77	Inxhinier gjeodet							
78	Inxh.mjedisi							
79	Inxh. në shkencat e tokës							
80	Inxh.gjeoinformatike							
81	Inxh.i gjeoburimeve							
82	Menaxhim agrobiznesi		100			75		175
83	Ekonomi dhe P. Agrare		100					100
84	Financë-kontabilitet		100					100
85	Mbrojtje bimësh		50					50
86	Hortikulturë		50			75		125
87	Prodhim bimor		50					50
88	Zootekni dhe biznes blegtoral		50					50
89	Akuakulturë dhe menaxh. peshkimi		50					50
90	Agromjedis dhe ekologji		50					50
91	Tek. agroushqimore		50					50
92	Vreshtari-enologji		50					50
93	Inxhinier pyjesh		60					60
94	Inxhinier përpunim druri		60					60
95	Mjekësi veterinare							
96	Agromekanizim		30					30
97	Shkenca të administrimit							
98	Menaxhim turizmi							
	GJITHSEJ	1510	850	1150	900	775	720	5905

Nr.	Programi i studimit	UPT
1	Inxh.Mek/Inxh.Logjistikë Prodhimi	40



Tabela nr.2. Tarifat e shkollimit për program të parë studimi me kohë të pjesshme

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për prog. të parë	Tarifë totale për prog. të parë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1	Hortikulturë	700	126,000
2	Mbrojtje bimësh	700	126,000
3	Prodhim bimor	700	126,000
4	Zootekni dhe biznes blegtoral	700	126,000
5	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	700	126,000
6	Agromjedis dhe ekologji	700	126,000
7	Agromekanizëm	700	126,000
Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit			
8	Menaxhim agrobiznesi	750	135,000
9	Ekonomi dhe politikë agrare	750	135,000
10	Financë-kontabilitet	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Pyjore			
11	Mbarështim pyjesh	700	126,000
12	Përpunim druri	700	126,000
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit			
13	Teknologji agroushqimore	700	126,000
14	Vreshtari enologji	700	126,000
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Financë	750	135,000
2	Administrim-biznes	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Natyrore			
3	Biologji	1,600	288,000
Fakulteti Histori-filologji			
4	Histori	850	153,000
5	Gjeografi	850	153,000
6	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i Shkencave Sociale			
8	Psikologji	850	153,000
9	Punë sociale	850	153,000
Universiteti Politeknik Inxh.Mek. (Eduk.distance)			
		1,800	324,000
Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1	Cikli i ulët	850	153,000
2	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
3	Kontabilitet-financë	750	135,000
4	Administrim publik	750	135,000
5	Turizëm	750	135,000
6	Histori-gjeografi	850	153,000

7	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8	Bio-kimi	1,700	288,000
9	Matematikë-fizikë	600	108,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			
10	Financë	750	135,000
11	Menaxhim	750	135,000
12	Marketing	750	135,000
13	Turizëm	750	135,000
14	Turizëm/Pogradec	750	135,000
Fakulteti i Mësuësisë			
15	Cikli i ulët	850	153,000
16	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
17	Gjuhë-letërsi	850	153,000
Fakulteti i Bujqësisë			
18	Agrobiznes	1,100	198,000
19	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			
1	Punonjës social	850	153,000
2	Filozofi-sociologji	850	153,000
3	Gjuhë-letërsi	850	153,000
4	Histori-gjeografi	850	153,000
5	Edukatë qytetare	850	153,000
6	Financë-kontabilitet	750	135,000
7	Administrim-biznes	750	135,000
8	Cikli i ulët	850	153,000
9	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
10	Matematikë-fizikë	600	108,000
11	Biologji-kimi	1,700	288,000
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Administrim-biznes	750	135,000
2	Financë-kontabilitet	750	135,000
3	Turizëm	750	135,000
Fakulteti i Drejtësisë			
4	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i shkencave të edukimit			
5	Cikli i ulët	850	153,000
6	Cikli i ulët parashkollor	850	153,000
Fakulteti i shkencave të natyrës			
7	Matematikë	600	108,000
8	Fizikë	600	108,000
9	Biologji-kimi	1,700	288,000
Fakulteti i shkencave shoqërore			
10	Gjuhë-letërsi	850	153,000
11	Histori	850	153,000
12	Gjeografi	850	153,000

Tabela nr.3. Tarifatat e shkollimit për program të dytë studimi me kohë të pjeshme

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për prog. të dytë	Tarifë totale për prog të dytë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1	Hortikulturë	1,300	234,000
2	Mbrojtje bimësh	1,300	234,000
3	Prodhim bimor	1,300	234,000
4	Zootekni dhe biznes blegtoral	1,300	234,000
5	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi	1,300	234,000
6	Agromjedis dhe ekologji	1,300	234,000
7	Agromekanizëm	1,300	234,000
Fakulteti i ekonomisë dhe i agrobiznesit			
8	Menaxhim agrobiznesi	850	153,000
9	Ekonomi dhe politikë agrare	850	153,000
10	Financë-kontabilitet	850	153,000
Fakulteti i shkencave pyjore			
11	Mbarështim pyjesh	1,300	234,000
12	Përpunim druri	1,300	234,000
Fakulteti i bioteknologjisë dhe i ushqimit			
13	Teknologji agroushqimore	1,300	234,000
14	Vreshtari biologji	1,300	234,000
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Financë	1,500	270,000
2	Administrim-biznes	1,500	270,000
Fakulteti i shkencave natyrore			
3	Biologji	1,300	234,000
Fakulteti Histori-Filologji			
4	Histori	1,500	270,000
5	Gjeografi	1,500	270,000
6	Gjuhë-letërsi	1,500	270,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7	Drejtësi	1,500	270,000
Fakulteti i shkencave sociale			
8	Psikologji	1,500	270,000
9	Punë sociale	1,500	270,000
Universiteti Politeknik Inxh.Mek. (Eduk.distance)			
		2,000	360,000
Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1	Cikli i ulët	1,100	198,000
2	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
3	Kontabilitet-financë	1,100	198,000
4	Administrim publik	1,100	198,000
5	Turizëm	1,100	198,000
6	Histori-gjeografi	1,100	198,000

7	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave të natyrës			
8	Bio-kimi	1,100	198,000
9	Matematikë-fizikë	1,100	198,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Financë	1,100	198,000
2	Menaxhim	1,100	198,000
3	Marketing	1,100	198,000
4	Turizëm	1,100	198,000
5	Turizëm/Pogradec	1,100	198,000
Fakulteti i mësuesisë			
6	Cikli i ulët	1,100	198,000
7	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
8	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
Fakulteti i bujqësisë			
9	Agrobiznes	1,100	198,000
10	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			
11	Punonjës social	1,100	198,000
12	Filozofi-sociologji	1,100	198,000
13	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
14	Histori-gjeografi	1,100	198,000
15	Edukatë qytetare	1,100	198,000
16	Financë-kontabilitet	1,100	198,000
17	Administrim-biznes	1,100	198,000
18	Cikli i ulët	1,100	198,000
19	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
20	Matematikë-fizikë	1,100	198,000
21	Biologji-kimi		
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1	Administrim-biznes	1,100	198,000
2	Financë-kontabilitet	1,100	198,000
3	Turizëm	1,100	198,000
Fakulteti i drejtësisë			
4	Drejtësi	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave të edukimit			
5	Cikli i ulët	1,100	198,000
6	Cikli i ulët parashkollor	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave të natyrës			
7	Matematikë	1,100	198,000
8	Fizikë	1,100	198,000
9	Biologji-kimi	1,100	198,000
Fakulteti i shkencave shoqërore			
10	Gjuhë-letërsi	1,100	198,000
11	Histori	1,100	198,000
12	Gjeografi	1,100	198,000

**VENDIM**  
**Nr.1161, datë 25.11.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELI TË PARË”, NË  
UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, DHE PËR MIRATIMIN E  
KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME  
STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në fakultetin e ekonomisë dhe administrimit të universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në:

- a) “Menaxhim”, me profilet:
  - i) “Menaxhim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në menaxhim”, me profil menaxhim biznesi;
  - ii) “Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në menaxhim”, me profil marketing.
- b) “Politika dhe administrim”, me profilet:
  - i) “Administrim publik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në politika dhe administrim”, me profil administrim publik;
  - ii) “Administrim financiar”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në politika dhe administrim”, me profil administrim financiar;
  - iii) “Drejtim turizmi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në Politika dhe administrim”, me profil drejtim turizmi.
- c) “Ekonomi-biznes”, me profilet:
  - i) “Drejtim i SME-ve”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në Ekonomi - biznes”, me profil drejtim i SME-ve;
  - ii) “Financë - Bankë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në ekonomi - biznes”, me drejtim financë-bankë.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore, në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe studimi “Master i nivelit të parë”, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

- a) Menaxhim 30 kuota;
- b) Politika dhe administrim 30 kuota;
- c) Ekonomi-biznes 30 kuota.

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7723*

**VENDIM**  
**Nr.1162, datë 25.11.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË  
UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR, DHE PËR MIRATIMIN E  
KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME  
STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, programin e studimit “Biologji mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në biologji mjedisore.

b) Në Fakultetin e Drejtësisë, programin e studimit “E drejta private dhe e biznesit”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në e drejta private dhe e biznesit.

2. Këto programe studimi të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Programet e studimit “Biologji mjedisore” dhe “E drejta private dhe e biznesit” ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe studimi të ciklit të dytë në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Biologji mjedisore 20 ;

b) E drejta private dhe e biznesit 30.

5. Kuota e pranimeve në këto programe studimi të ciklit të dytë në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për studentët, që i ndjekin këto programe studimi, si programe të dyta studimi, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Biologji mjedisore 5;

b) E drejta private dhe e biznesit 5.

6. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, të jenë:

a) Biologji mjedisore 50 000 lekë ;

b) E drejta private dhe e biznesit 50 000 lekë.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që i ndjekin këto programe studimi, si programe të dyta studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Biologji mjedisore 200 000 lekë ;

b) E drejta private dhe e biznesit 78 000 lekë.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7724*

**VENDIM**  
**Nr.1163, datë 25.11.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË  
UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË  
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, në Universitetin e Tiranës, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, si më poshtë vijon:

a) “Studime letrare”, me profilet:

i) “Teori letërsie dhe kritikë letrare”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Studime letrare”, me profil “Teori letërsie dhe kritikë letrare”;

ii) “Letërsi e përgjithshme dhe letërsi e krahasuar”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Studime letrare”, me profil “Letërsi e përgjithshme dhe letërsi e krahasuar”;

iii) “Studime letrare shqiptare dhe antropologji kulturore”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Studime letrare”, me profil “Studime letrare shqiptare dhe antropologji kulturore”.

b) “Gjeografi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë (DND)”, në “Gjeografi”.

2. Programet e studimit, të ciklit të dytë, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

3. Këto programe studimi, të ciklit të dytë, ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, të jetë:

a) Në programin e studimit “Studime letrare” 100;

b) Në programin e studimit “Gjeografi” 100.

5. Kuota e pranimit, për studentë, që i ndjekin këto programe si programe të dyta studimi, të jetë:

a) Në programin e studimit “Studime letrare” 5;

b) Në programin e studimit “Gjeografi” 5.

6. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët, që do të regjistrohen në këto programe studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë:

a) Në programin e studimit “Studime letrare” 48 000 lekë;

b) Në programin e studimit “Gjeografi” 48 000 lekë.

7. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që i ndjekin këto programe studimi si programe të dyta studimi, të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë:

a) Në programin e studimit “Studime letrare” 130 000 lekë;

b) Në programin e studimit “Gjeografi” 130 000 lekë.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.170, datë 9.12.2009, faqe 7612*

**VENDIM**  
**Nr.1165, datë 25.11.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË “SHKENCA KOMUNIKIMI”, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE FILOLOGJISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR KËTË PROGRAM STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në “Shkenca komunikimi”, me këto profile:

a) Komunikim- informim, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në shkenca komunikimi”, me profil komunikim-informim.

b) Komunikim masiv, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në shkenca komunikimi”, me profil komunikim masiv .

2. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009 - 2010.

3. Kohëzgjatja e programit të mësipërm të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 30.

5. Nga kuota e mësipërme caktohen dy kuota për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare përkatëse.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit, për këtë program të plotë studimi, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, i Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7726*

**VENDIM**  
**Nr.1166, datë 25.11.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Analizë dhe algjebër”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në analizë dhe algjebër”.

b) Doktoratë në “Metodat probabilitare, statistike dhe metodat e analizës numerike”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në metodat probabilitare, statistike dhe metodat e analizës numerike”.

2. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

3. Kohëzgjatja e programeve të mësipërme është, të paktën, 3 vite akademike, si dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, është 20 dhe ndahet, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në analizë dhe algjebër, 10;

b) Doktoratë në metodat probabilitare, statistike dhe metodat e analizës numerike, 10.

5. Nga numri i secilës prej kuotave të mësipërme të çdo programi studimi, 1(një) kuotë caktohet për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me kërkesat e institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit, për këto programe studimi të doktoratës, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste, të caktuara nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës i Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7727*

VENDIM

Nr.1170, datë 25.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË” (MNP), DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMEVE DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTË PROGRAM STUDIMI, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Infermierisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimit “Master i nivelit të parë” (MNP), në “Fizioterapi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP) në fizioterapi”.

2. Programi i studimit “Master i nivelit të parë” (MNP) realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit akademik.

3. Ky program studimi ta fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këtë program, për vitin akademik 2009-2010, të jetë 30.

5. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët, që do të regjistrohen në këtë program studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Universitetin e Tiranës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 16.12.2009, faqe 7729*

**VENDIM**  
**Nr.1182, datë 3.12.2009**

**PËR HAPJEN E INSTITUTIT TË STUDIMEVE EUROPIANE NË UNIVERSITETIN**  
**E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 2, 10, e 41, pika 5, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e Institutit të Studimeve Europiane (ISE), si njësi kryesore, ndërfakultetore, në Universitetin e Tiranës (UT).

2. Instituti i Studimeve Europiane ka për mision:

a) organizimin e veprimtarive kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit;

b) organizimin dhe ofrimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë;

c) ofrimin e shërbimeve për të tretë dhe konsulenca në fushën e studimeve europiane.

3. Instituti i Studimeve Europiane ka si qëllim të veprimtarisë të tij përgatitjen dhe formimin e vazhduar të specialistëve shqiptarë, në kuadër të proceseve integruese drejt Bashkimit Europian dhe më gjerë.

4. Njësitë bazë të Institutit të Studimeve Europiane janë departamentet, si më poshtë vijon:

a) Politika dhe qeverisje;

b) Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare;

c) Legjislacioni dhe institucionet europiane.

5. Struktura dhe mënyra e organizimit të Institutit të Studimeve Europiane përcaktohen në statutin e Universitetit të Tiranës, në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. Burimet njerëzore, kapacitetet për mësim dhe kërkim, si dhe mjetet e nevojshme financiare sigurohen nga Universiteti i Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 31.12.2009, faqe 8293*

**VENDIM**  
**Nr.1183, datë 3.12.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË TRETË, “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË INSTITUTIN E STUDIMEVE EUROPIANE NË UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e programeve të studimit, të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Institutin e Studimeve Europiane të Universitetit të Tiranës, në:

- a) Legjislacionet dhe institucionet europiane;
- b) Politika dhe qeverisja në Europë;
- c) Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Bashkimit Europian (BE).

Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND) në fushën e arsimimit të kryer.

2. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010, janë si më poshtë vijon:

- a) Legjislacionet dhe institucionet europiane 30 kuota;
- b) Politika dhe qeverisja në Europë 30 kuota;
- c) Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Bashkimit Europian. 30 kuota.

5. Nga kuotat e mësipërme të çdo programi studimi, 9 kuota janë për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Tarifa e shkollimit, për studentët e regjistruar në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, e cila likuidohet me këste të caktuara nga instituti përkatës.

8. Studentët shqiptarë, që kanë kryer me rezultate të shkëlqyera ciklin paraardhës të studimeve, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.178, datë 22.12.2009, faqe 7897*

**VENDIM**  
**Nr.1184, datë 3.12.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË  
UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË  
TARIFAVE TË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Fakultetin e Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimit të ciklit të dytë në:

a) “Infermieri”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program.

b) “Teknik laborator”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program.

c) “Fizioterapi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program;

ç) “Teknik imazherie”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program;

d) “Mami”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, DND, në këtë program.

2. Programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Infermieri	100;
b) Teknik laborator	25;
c) Fizioterapi	25;
ç) Teknik imazherie	25;
d) Mami	25.

5. Kuota e pranimit, në këto programe studimi, për ata studentë, që i ndjekin këto programe si programe të dyta studimi të jetë, si më poshtë vijon:

a) Infermieri	10;
b) Teknik laborator	3;
c) Fizioterapi	3.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Infermieri	100 000 lekë;
b) Teknik laborator	100 000 lekë;
c) Fizioterapi	100 000 lekë;
ç) Teknik imazherie	100 000 lekë;
d) Mami	100 000 lekë.

7. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që i ndjekin këto programe, si programe të dyta studimi, të ciklit të dytë, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Infermieri	200 000 lekë;
b) Teknik laborator	200 000 lekë;
c) Fizioterapi	200 000 lekë;
ç) Teknik imazherie	200 000 lekë;

d) Mami 200 000 lekë.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.178, datë 22.12.2009, faqe 7898*

#### VENDIM

**Nr.1185, datë 3.12.2009**

### **PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Hapjen në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në “Inxhinieri mekanike”, me këto profile:

a) Inxhinieri mekanike, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri mekanike”.

b) Inxhinieri materiale, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri mekanike”, me profil inxhinieri materiale.

2. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009 - 2010.

3. Kohëzgjatja e programit të mësipërm të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 14.

5. Nga kuota e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, caktohen dy kuota për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit për këtë program të plotë studimi është 200 000 (dyqind mijë) lekë, e cila likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik të Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.178, datë 22.12.2009, faqe 7899*

**VENDIM**  
**Nr.1211, datë 11.12.2009**

**PËR MIRATIMIN E KUOTAVE SHITESË TË PRANIMIT NË PROGRAMET E  
STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË”, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS DHE  
NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e 170 kuotave shtesë për pranimin në programet e studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë” (MND), në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, për vitin akademik 2009-2010.

2. Kuotat shtesë të pranimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi shpërndahen në universitetet, fakultetet dhe programet përkatëse të studimit, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kuotat e paplotësuara në programet e studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Universiteti i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 31.12.2009, faqe 8299*

Tabela 1: Shpërndarja e kuotave shtesë të pranimit në MND, sipas universiteteve dhe programeve përkatëse të studimit

**A. UNIVERSITETI I TIRANËS**

<b>NR.</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT TË MND-SË</b>	<b>FAKULTETI</b>	<b>KUOTA</b>
1	SHKENCA JURIDIKE CIVILE	FAKULTETI I DREJTËSISË	50
2	SHKENCAT PENALE	“	50
3	E DREJTA KUSHTETUESE, E KRAHASUAR DHE EUROPIANE	“	50

**B. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**

<b>NR.</b>	<b>PROGRAMI I STUDIMIT TË MND-SË</b>	<b>FAKULTETI</b>	<b>KUOTA</b>
1	TEKNOLOGJI MJEDISI	FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT	10
2	MENAXHIMI I RESURSEVE DHE PËRMIRËSIMI GJENETIK I BIMËVE	“	10

**VENDIM**  
**Nr.1212, datë 11.12.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË DHE ARSIMIN E MESËM, NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë” në:

a) “Mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte”;

b) “Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte”;

c) “Mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi”;

ç) “Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm në lëndën histori”;

d) “Mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuota e pranimeve në këto programe “Master i nivelit të parë”, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit në universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për vitin akademik 2009-2010, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte	50;
b) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte	50;
c) Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi	60;
ç) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori	60;
d) Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi	60.

5. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

a) "Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët edukim fizik dhe sporte"	40 000 lekë;
b) "Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndët edukim fizik dhe sporte"	45 000 lekë;
c) "Master i nivelit të parë në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët histori dhe gjeografi"	40 000 lekë;
ç) "Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën histori"	45 000 lekë;
d) "Master i nivelit të parë në mësuesi për arsimin e mesëm, në lëndën gjeografi".	45 000 lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Kuotat e pranimeve në programet e studimit "Master i nivelit të parë", sipas pikës 4, të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.187, datë 31.12.2009, faqe 8300*

**VENDIM**  
**Nr.1282, datë 23.12.2009**

**PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË, TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA, NË FAKULTETIN E MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2009 - 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.2, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kuota e pranimit në programet e ciklit të tretë, të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, që fillojnë studimet në vitin akademik 2009-2010, të jetë 285, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Nga kuotat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, 21 kuota caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

3. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studimet specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të jetë 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 22.1.2010, faqe 8705*



**VENDIM**  
**Nr.1300, datë 29.12.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË” NË  
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË  
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, si më poshtë vijon:

a) “Tekstil dhe stilim mode”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në tekstil dhe stilim mode”;

b) “Planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë, MNP, në planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kuotat e pranimeve në këto programe “Master i nivelit të parë”, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Tekstil dhe stilim mode 25;

b) Planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore 25.

5. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, të jenë, si më poshtë vijon:

a) Tekstil dhe stilim mode 60 000 lekë;

b) Planifikimi i sistemeve të transportit, menaxhimi i trafikut dhe siguria rrugore 75 000 lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

7. Kuotat e pranimeve në programet e studimit “Master i nivelit të parë”, sipas pikës 4 të këtij vendimi, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 22.1.2010, faqe 8709*

**VENDIM**  
**Nr.14, datë 7.1.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në informatikë.
  2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në informatikë”.
  3. Ky program studimesh e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
  4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
  5. Kuota e pranimit në programin e studimeve të doktoratës në informatikë, për vitin akademik 2009-2010, është 10.
  6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, caktohet një kuotë për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, e cila administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.
  7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
  8. Tarifa e shkollimit për këtë program studimesh të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara, nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.
  9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.
  10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.3, datë 27.1.2010, faqe 42*

**VENDIM**  
**Nr.15, datë 7.1.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës në “Inxhinieri ndërtimi”, i cili realizohet me tri profile:

a) Në inxhinieri ndërtimi, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri ndërtimi”.

b) Në inxhinieri hidroteknike, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri ndërtimi, me profil inxhinieri hidroteknike”.

c) Në inxhinieri mjedisi, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në inxhinieri ndërtimi, me profil inxhinieri mjedisi”.

2. Ky program studimesh e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

3. Kohëzgjatja e këtij programi studimesh të doktoratës është, të paktën 3, vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këtë program studimesh, për vitin akademik 2009-2010, është 14.

5. Nga kuota, e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, caktohen dy kuota për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit, për këtë program studimesh të doktoratës, është 2 00 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara, nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.3, datë 27.1.2010, faqe 42*

**VENDIM**  
**Nr.16, datë 7.1.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Në “Kërkime gjuhësore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në kërkime gjuhësore”.

b) Në “Studime letrare” në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në studime letrare”.

2. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

3. Kohëzgjatja e programeve të mësipërme të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, janë, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në kërkime gjuhësore 60 kuota;

b) Doktoratë në studime letrare 15 kuota.

5. Nga kuotat e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, për çdo program studimi, caktohen, për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, kuotat e mëposhtme:

- a) Doktoratë në kërkime gjuhësore 6 kuota;
- b) Doktoratë në studime letrare 2 kuota.

6. Kuotat për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit, për këto programe studimi të doktoratës, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara, nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.3, datë 27.1.2010, faqe 42*

**VENDIM**  
**Nr.36, datë 27.1.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE MËSIMORË, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUDHËN 1 JANAR - 30 QERSHOR 2010, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve mësimorë, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2009 -2010, për muajin janar 2010, të jetë 2011 veta dhe, për periudhën 1 shkurt - 30 qershor 2010, të jetë 704 punonjës.

2. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, sipas DAR/ZA-ve, dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepen sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare në shumën 290 460 465 (dyqind e nëntëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e vitit 2010.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.10, datë 17.2.2010, faqe 326*

Tabela 1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme sipas DAR/ZA

Nr.	Drejtoria arsimore rajonale/ zyra arsimore	Punonjës me kontratë të përkohshme për muajin janar 2010	Punonjës me kontratë të përkohshme për periudhën 1 shkurt-30 qershor 2010
1	Berat	65	10
2	Bulqizë	20	6
3	Delvinë	2	0
4	Devoll	2	5
5	Dibër	51	19
6	Durrës	180	70
7	Elbasan	180	70
8	Fier	150	70
9	Gramsh	29	10
10	Gjirokastër	2	0
11	Has	57	10
12	Kavajë	-	5
13	Kolonjë	-	0
14	Korçë	8	14
15	Krujë	44	10
16	Kuçovë	0	0
17	Kukës	56	10
18	Kurbini	43	10
19	Lezhë	86	15
20	Librazhd	35	6
21	Lushnjë	60	10
22	M e Madhe	32	10
23	Mallakastër	26	8
24	Mat	71	10
25	Mirditë	48	10
26	Peqin	38	10
27	Përmet	12	0
28	Pogradec	40	10
29	Pukë	0	0
30	Sarandë	45	10
31	Skrapar	11	0
32	Shkodër	74	20
33	Tepelenë	12	0
34	Tirana qytet	233	148
35	Tirana qark	179	98
36	Tropojë	48	10
37	Vlorë	72	10
	<b>Totali</b>	<b>2011</b>	<b>704</b>

**VENDIM**  
**Nr.89, datë 10.2.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT PRANË SHKOLLËS SË LARTË  
PRIVATE “UFO UNIVERSITY”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Hapjen në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë “Master i nivelit të parë”, MNP, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Pedagogji” me këto profile:

- a) “Didaktikë” ;
- b) “Menaxhim arsimit”.

2. Ky program studimi, i ciklit të dytë, realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma:

- a) “Master i nivelit të parë, në pedagogji”, (MNP), me profil didaktikë;
- b) “Master i nivelit të parë, në pedagogji”, (MNP), me profil menaxhim arsimit.

3. Hapjen në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë”, (MND), në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) “Psikologji klinike”;
- b) “Politikë e jashtme dhe diplomaci”;
- c) “Pushtet ekzekutiv”;
- ç) “Shkenca administrative”;
- d) “Marrëdhënie ndërkombëtare”;
- dh) “Kontratat dhe e drejta europiane”;
- e) “E drejta tregtare ndërkombëtare”;
- ë) “Gazetari globale”.

4. Këto programe studimi, të ciklit të tretë, realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma:

- a) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në psikologji klinike;
- b) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në politikë e jashtme dhe diplomaci;
- c) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në pushtet ekzekutiv;
- ç) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në shkenca administrative;
- d) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në marrëdhënie ndërkombëtare;
- dh) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në kontratat dhe e drejta europiane;
- e) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në e drejta tregtare ndërkombëtare;
- ë) “Master i nivelit të dytë”, (MND), në gazetari globale.

3. Shkolla e lartë private “UFO University”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 dhe 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, datë 3.3.2010, faqe 526*

**VENDIM**  
**Nr.90, datë 10.2.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË  
LARTË PRIVATE “EPOKA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Epoka”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Inxhinieri ndërtimi” me profilet:

- a) “Inxhinieri e strukturave të ndërtimit”;
- b) “Menaxhim i ndërtimeve”.

2. Ky program studimi i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND), në “Inxhinieri ndërtimi” me profilet:

- a) “Inxhinieri e strukturave të ndërtimit”;
- b) “Menaxhim i ndërtimeve”.

3. Hapjen në shkollën e lartë private “Epoka”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë (MND)”, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Inxhinieri ndërtimi”.

4. Ky program studimi i ciklit të tretë realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë (MND), në inxhinieri ndërtimi”.

5. Shkolla e lartë private “Epoka”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.17, datë 3.3.2010, faqe 527*

**VENDIM**  
**Nr.123, datë 17.2.2010**

**PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 9, 10, 41, 76 e 77 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Krijimi dhe misioni i Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST)

1. Krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (në vijim UST), mbi bazën e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”. UST-ja është institucion publik i arsimit të lartë.

2. UST-ja ka për mision:

a) formimin universitar të studentëve e të specialistëve në të gjitha ciklet e studimeve.

b) kualifikimin e punonjësve akademikë e shkencorë në fushat e edukimit fizik dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit.

c) nxitjen e kërkimeve e të studimeve në fushat e edukimit fizik dhe sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit.

ç) ofrimin e shërbimeve për të tretët dhe konsulenca në fushën e sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit.

II. Struktura e UST-së

1. Në strukturën e UST-së përfshihen këto njësi kryesore:

a) Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, me këtë përbërje, në njësi bazë:

i) Departamentin e mjekësisë sportive;

ii) Departamentin e shkencave sociale dhe të edukimit;

iii) Departamentin e sportit.

b) Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe i Rekreacionit, me këtë përbërje, në njësi bazë:

i) Departamentin e veprimtarisë fizike rekreative dhe të turizmit;

ii) Departamentin e organizimit dhe të menaxhimit;

iii) Departamentin e lëvizjes dhe shëndetit.

c) Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit, me këtë përbërje, në njësi bazë:

i) Departamentin e kërkimit të lëvizjes së aplikuar;

ii) Departamentin e kërkimit në veprimtarinë fizike, shëndetin dhe rekreacionin;

iii) Departamentin e kërkimit dhe të studimit të tregut të punës dhe të transferimit të teknologjisë.

III. Programet e studimeve të UST-së

UST-ja ofron të gjitha programet e studimit në të tria ciklet e studimit, që ka ofruar deri tani Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” dhe çdo program tjetër, të miratuar në përputhje me aktet, ligjore dhe nënligjore.

IV. Organet dhe autoritetet drejtuese

1. Organet dhe autoritetet drejtuese, të zgjedhura për strukturat e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, vazhdojnë mandatet e tyre, kur njësitë nuk pësojnë ndryshim. Organet dhe autoritetet drejtuese, për njësitë e reja të krijuara të UST-së, emërohen në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Autoritetet drejtuese të UST-së janë:

a) Rektori;

b) Dekanët e fakulteteve / Drejtori i Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit;

c) Përgjegjësit e departamenteve të kërkimit.

3. Rektori i Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, është rektor i UST-së deri në përfundim të mandatit të fituar në zgjedhjet e fundit sipas pikës 3 të nenit 21 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Autoritetet drejtuese të zgjedhura të strukturave ekzistuese kryejnë funksionet përkatëse në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe me statutin e UST-së.

5. Autoritetet e tjera drejtuese emërohen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. Organika dhe financimi

1. Në organikën e UST-së përcaktohet numri i punonjësve të njërive, që integrohen në këtë universitet dhe që përfshihen në numrin total të punonjësve, që janë miratuar për vitin 2010, për Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”.

2. Për vitin 2010, financimi i UST-së bëhet nga:

a) Buxheti i planifikuar për Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”;

b) Nga burime të tjera të ligjshme.



3. Universiteti i Sporteve të Tiranës ruan të drejtën mbi të gjitha asetet dhe fondet buxhetore, që zotëron dhe disponon ish-Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”.

4. Universiteti i Sporteve të Tiranës e ka selinë në Tiranë, në ndërtesën e ish-Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”.

VI. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Universiteti i Sporteve i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

VII. Vendimi nr.266, datë 25.5.2000 i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e emrit zyrtar të Institutit të Lartë të Kulturës Fizike “Vojo Kushi” në Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 4.3.2010, faqe 553*

**VENDIM**  
**Nr.124, datë 17.2.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË**  
**NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të programeve të studimit, të ciklit të parë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, si më poshtë:

a) “Biologji”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në biologji.

b) “Fizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në fizikë.

c) “Kimi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në kimi.

d) “Ekonomiks”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në ekonomiks.

e) “Financë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në financë.

f) “Inxhinieri elektrike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në inxhinieri elektrike.

2. Këto programe studimi të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

3. Programet e studimit “Biologji”, “Fizikë”, “Kimi”, “Ekonomiks”, “Financë” dhe “Inxhinieri elektrike” ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.25, datë 19.3.2010, faqe 774*

**VENDIM**  
**Nr.177, datë 10.3.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË  
LARTË PRIVATE “SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 26, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Sevasti & Parashqevi Qiriazhi”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë” (MND), në formën e studimit me kohë të plotë, në:

- a) financë,
- b) kontabilitet,
- c) marketing.

2. Këto programe studimi të ciklit të tretë realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në:

- d) financë,
- e) kontabilitet,
- f) marketing.

3. Shkolla e lartë private “Sevasti & Parashqevi Qiriazhi”, Tiranë, të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, datë 15.4.2010, faqe 1465*

**VENDIM**  
**Nr.199, datë 24.3.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË TRETË, “MASTER I  
NIVELIT TË DYTË”, NË FAKULTETIN E INFERMIERISË TË UNIVERSITETIT TË  
TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË  
SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Infermierisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë” (MND), në “Infermieri dhe subspecialitete”.
  2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë (MND), në infermieri dhe subspecialitete”.
  3. Ky program studimi MND realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është një vit.
  4. Ky program studimi MND fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010 - 2011.
  5. Kuota e pranimit në këtë program studimi MND, për vitin akademik 2010 - 2011, është 30.
  6. Tarifa e shkollimit, për studentët e regjistruar në këtë program studimi MND, në vitin akademik 2010-2011, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.
  7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi dhe likuidohet në këste, të caktuara nga fakulteti përkatës.
  8. Studentët e Republikës së Shqipërisë, që kanë kryer me rezultate të shkëlqyera ciklin paraardhës të studimeve, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.
  9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.
  10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, datë 15.4.2010, faqe 1508*

**VENDIM**  
**Nr.282, datë 21.4.2010**

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS  
SË ZVICRËS, PËR PROGRAMIN MBËSHTETËS (ALBVET) PËR ARSIMIN DHE  
TRAJNIMIN PROFESIONAL SHQIPTAR (ATP), FAZA II, KORRIK 2009-QERSHOR 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për programin mbështetës (AlbVET) për arsimin dhe trajnimin profesional shqiptar (ATP), faza II, korrik 2009-qershor 2011.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, datë 26.5.2010, faqe 2277*

## MARRËVESHJE

### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE MBI PROGRAMIN MBËSHTETËS (AlbVET) PËR ARSIMIN DHE TRAJNIMIN PROFESIONAL SHQIPTAR (ATP) (FAZA II 1 KORRIK 2009 - 30 QERSHOR 2011) NJË PROJEKT BILATERAL BASHKËPUNIMI DHE ZHVILLIMI

*Në përpjekje* për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet të dy vendeve; *në vijim* dhe zbatim të marrëveshjes kuadër në lidhje me bashkëpunimin teknik dhe financiar dhe ndihmën humanitare ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë së Shqipërisë të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me ligjin nr.9801, datë 13 shtator 2007;

*duke respektuar* parimet demokratike dhe të drejtave themelore të njeriut siç parashikohen veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut që frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dy palëve dhe që përbën një element thelbësor të barasvlefshëm me objektivat e kësaj marrëveshjeje,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane kanë rënë dakord për termat dhe kushtet siç parashikohen më poshtë:

#### Neni 1

#### **Kushte dhe përkufizime të përgjithshme**

Kur përdoren në këtë marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

- a) “Palët kontraktuese” janë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane;
- b) “Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë” është Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- c) “Projekt” është programi mbështetës i arsimit dhe trajnimit profesional shqiptar;
- d) “Ministria” është Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- e) “SDC” është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Zvicrës;
- f) “Grand” është kontributi i dhënë nga Qeveria Zvicerane sipas kësaj marrëveshjeje;
- g) “Sëisscontact” është organizata zvicerane zbatuese.

#### Neni 2

#### **Përgjegjësia e zbatimit**

Autoritetet e mëposhtme janë zbatuese për zbatimin e marrëveshjes:

Për Qeverinë Zvicerane:

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e përfaqësuar nga zyra e Bashkëpunimit në Tiranë, Ambasada e Zvicrës,

Për Këshillin e Ministrave të Shqipërisë:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta janë dy homologët qeveritarë të projektit.

SDC ngarkon Sëisscontact me zbatimin e projektit.

### Neni 3

#### Qëllime dhe objektiva

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është mbështetja e sistemit arsimor dhe të trajnimit profesional shqiptar për t'u lidhur dhe përshtatur me kërkesat e tregut të punës, tërheqja e pjesëmarrësve, përpjekja drejt standardeve europiane dhe në këtë mënyrë kontribuimi për zhvillimi ekonomik dhe zbutjen e varfërisë.

Projekti përfshin gjashtë sfera madhore të ndërhyrjeve tek objektivat kryesorë, si më poshtë:

1. Zhvillimi i përfaqësive të përshtatshme trajnuese në arsimin profesional dhe mbështetja e zbatimit të tyre në dy kualifikime të zgjedhura (një prej tyre është instalimi i sistemeve hidraulike) dhe sigurimi i modeleve të organizimit për shkollat multifunkionale për të shërbyer si praktikë e mirë për zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve.

2. Ngritja dhe inkurajimi i një minimumi prej dy modeleve përkatëse dhe funksionale për partneritet publik-privat për të nxënë (PAFL) duke zhvilluar një mjedis nxitës për bashkëpunimin ndërmjet bizneseve dhe dhënësit e trajnimit për dhënien e arsimit dhe trajnimit profesional.

3. Mbështetja e pilotimit të menaxhimit të decentralizuar të arsimit dhe trajnimit profesional të larmishëm dhe fleksibël me financim nga shumë burime në të paktën një qark.

4. Zhvillimi i kapaciteteve të dhënësve publikë dhe privatë të trajnimit për të zhvilluar dhe zbatuar programe të përshtatshme për grupet e veçanta në nevojë, për të tërhequr burimet e nevojshme dhe lehtësuar mundësinë e pjesëmarrjes.

5. Kontributi për zhvillimin e sistemeve të mëtejshme në sferat kryesore të politikës duke përdorur mësimet e nxëna nga përbërësit operacionalë, shkëmbimi rajonal dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

6. Përfitimi nga sinergjia me programe të ngjashme në Kosovë dhe rajon, dhe intensifikimi i shkëmbimit me iniciativën e reformës në arsim në iniciativën e Europës Juglindore.

Objektivat kryesorë specifikohen në dokumentin e projektit, të datës 23 qershor 2009, që është pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

### Neni 4

#### Objekti dhe kohëzgjatja e marrëveshjes

Në pajtim me objektivat kryesorë, marrëveshja mbulon periudhën kohore nga 1 korrik 2009 deri në 30 qershor 2011. Projekti bashkëpunon me institucionet e mëposhtme:

1. Shkollat profesionale në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Lushnjë, Berat, Gjirokastër, Fier, Shkodër për zbatimin e përfaqësive të rishikuara të trajnimit në arsimin profesional.

2. Shoqatat e anëtarësisë së biznesit dhe dhënësit publikë dhe privatë të trajnimit për zbatimin e partneriteteve për të nxënë në Sarandë, Fier, Durrës.

3. Autoritetet rajonale të qarkut Durrës.

4. Agjencia Kombëtare AFP.

5. Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

6. Projektet, organizatat lokale dhe dhënësit e shërbimeve në Berat.

### Neni 5

#### Detyrimet e palëve kontraktuese

1. Detyrimet specifike të Qeverisë së Konfederatës Zvicerane përfshijnë:

a) Qeveria Zvicerane ofron një grand prej 2 600 000 franga zvicerane që përdoret vetëm për zbatimin e projektit sipas qëllimeve dhe objektivave të përkufizuara në nenin 3.

b) Ky grand nuk mund të caktohet për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grandit që mbetet në fund të projektit, duhet t'i shlyhet Qeverisë Zvicerane.

c) Qeveria Zvicerane nëpërmjet SDC-së kontraktton Sëisscontact si organizatë zbatuese.

d) Grandi disbursohet dhe auditohet në pajtim me dispozitat e kontratës ndërmjet SDC-së dhe Sëisscontact-it.

2. Detyrimet specifike të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfshijnë:

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës përfundon memorandumet mirëkuptimi operacional të veçanta për zbatimin e komponentëve individualë me agjencinë zbatuese;

b) Ministria e Arsimit dhe Shkencës aprovon programin bazë;

c) Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr masat e nevojshme për shkollat profesionale për të prokuruar materialet e nevojshme dhe mallrat për zbatimin e projekteve të të nxënit në bazë të rregullave të prokurimit të Qeverisë Shqiptare;

d) Ministria e Arsimit dhe Shkencës ofron ambientet e zyrave që i jepen Agjencisë Kombëtare VET për Koordinatorin Ndërkombëtar të Programit;

e) Ministria e Arsimit dhe Shkencës ofron burimet e nevojshme njerëzore për të marrë pjesë në masat për ngritjen e kapaciteteve të zbatuara nga projekti për arritjen e objektivave;

f) Ministria e Arsimit dhe Shkencës parashikon buxhetin për rimbursimin e TVSH-së për projektin sipas rastit;

g) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet organeve të saj të përshtatshme sheh mundësitë për të marrë pjesë në partneritete për të nxënë, në çfarëdo funksion të përshtatshëm;

h) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nëpërmjet organeve të saj të përshtatshme aprovon kurset dhe programet për partneritet për të nxënë;

i) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëpërmjet organeve të saj të përshtatshme, sheh mundësitë për mbështetjen e trajnimit për grupet me nevoja specifike.

## Neni 6

### **Menaxhimi i projektit**

1. Projekti është një ndërmarrje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe SDC-së.

2. Qeveria Zvicerane ka emëruar Sëisscontact si agjencinë zbatuese për projektin, sipas një kontrate të nënshkruar ndërmjet Qeverisë Zvicerane dhe Sëisscontact. Kjo agjenci zbatuese merr përsipër në emër të Qeverisë Zvicerane të gjitha detyrat operationale, administrative dhe mbikëqyrëse të projektit, duke përfshirë disbursimet, monitorimin dhe raportimin.

3. SDC-ja mund të autorizojë ekspertë të huaj dhe vendas afatshkurtër dhe afatgjatë për të mbështetur zbatimin e projektit, bazuar në konsultime me palët nënshkruese të marrëveshjes, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. SDC-ja mund të autorizojë individë të tjerë dhe organizata lokale dhe ndërkombëtare për zbatimin e pjesëve të caktuara të projektit, bazuar në konsultime me palët nënshkruese të marrëveshjes, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Qeveria Shqiptare nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta merr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të projektit të miratuar; merr pjesë në Komisionin e Rishikimit të Projektit/PRC – Komitetin Drejtues/SC; mundëson informacionin përkatës, duke përfshirë të dhëna statistikore që janë të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e projektit. Çdo përdorim tjetër paraqitet për pëlqimin paraprak të Ministrisë.

## Neni 7

### **Mbikëqyrja dhe bashkërendimi**

1. Me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja e përgjithshme dhe bashkërendimi i projektit, si dhe për të trajtuar çështjet e politikave, ngrihet një Komision i Rishikimit të Proejktit/KRP/KD –

Komitet Drejtues/SC dhe takimet mbahen dy herë në vit (normalisht në qershor dhe nëntor). KRP/KD-ja e ka kuorumin e nevojshëm kur janë të pranishëm përfaqësuesit e të dy palëve kontraktuese dhe vendimet merren me konsensus.

2. KRP/KD-ja përbëhet nga institucionet e mëposhtme me një votë secili:

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës (zëvendësministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe/ose drejtori i politikave parauniversitare të ministrisë);

b) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (zëvendësministri ose drejtori i politikave të punësimit të ministrisë);

c) Agjencia Kombëtare VET (drejtori);

d) Trajnimi Profesional i Shërbimit Kombëtar të Punësimit (drejtori);

e) SDC/zyra zvicerane e bashkëpunimit (drejtori i vendit dhe/ose përgjegjësi i programit).

Sekretariati i komisionit sigurohet nga projekti AlbVET. Koordinatorin ndërkombëtar të programit dhe menaxherin kombëtar të projektit janë të pranishëm në mbledhje pa të drejtë vote.

3. KRP/KD-ja kryen detyrat e mëposhtme:

a) Mbështet projektin dhe jep orientime në gjetjen e zgjidhjeve për problemet e rëndësishme të zbatimit;

b) Miraton planin e aktiviteteve të projektit (plani vjetor i operacioneve/YPO) i paraqitur zyrës së bashkëpunimit zviceran;

c) Rishikon rregullisht arritjet e projektit dhe merr dhe miraton raportet e progresit të projektit;

d) Diskuton dhe shkëmben informacion mbi politikën dhe çështje të tjera.

4. Mbledhjet e paplanifikuara mund të thirren me kërkesë të një prej anëtarëve të PRC-SC-së. Mbledhjet bashkëkryesohen nga palët kontraktuese.

5. Palët kontraktuese informojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe, në masën që është praktike normalisht, konsultohen me njëra-tjetrën, në lidhje me çdo ngjarje, që ndikon ose rrezikon të ndikojë negativisht te zbatimi i suksesshëm i projektit.

## Neni 8

### **Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve**

1. Mallrat dhe shërbimet që financohen nga shumat e kontributit zviceran prokurohen në pajtim me rregullat e SDC-së.

2. Për kohëzgjatjen e projektit, mallrat e siguruara me fondet e SDC-së për përdorim në projekt mbeten në disponim të pakufizuar të projektit dhe nuk devijohen nga projekti pa aprovimin paraprak me shkrim të zyrës së bashkëpunimit zviceran.

3. Nëse për një arsye projekti duhet të ndërpritet, përdorimi i mallrave të siguruara me kontributin zviceran vendost me shkrim nga palët. Në këtë rast, SDC-ja nuk merr përgjegjësi në lidhje me këto mallra.

4. Në fund të projektit, të dyja palët bien dakord me shkrim për pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruara gjatë 1 korrikut 2009 deri 30 qershor 2011, periudha e zbatimit të projektit.

5. Mallrat e prokuruara nga projekti për organizatat partnere dhe shkollat dorëzohen dhe merren në dorëzim nga autoriteti përkatës kompetent me aprovimin e përfaqësuesit të Qeverisë Zvicerane.

## Neni 9

### **Klauzola antikorrupsion**

Palët kontraktuese kanë të njëjtin shqetësim në luftën kundër korrupsionit që kërcënon qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve që nevojiten për zhvillimin. Kështu, ato marrin përsipër të bashkëpunojnë forcat në luftën kundër korrupsionit dhe, veçanërisht, deklarojnë që çdo ofrim, dhuratë, pagesë, shpërblim ose përfitim i çdo lloji që bëhet për këdo, drejtpërdrejt ose jo, me qëllim që të marrin këtë marrëveshje, ose gjatë zbatimit të saj, do të interpretohet si vepër penale ose praktike korruptive. Çdo veprim i këtij lloji përbën shkak të mjaftueshëm për të justifikuar

anulimin e kësaj marrëveshjeje, prokurimin ose dhënien e arritur, ose për të marrë çdo masë tjetër korrigjuese që parashikohet nga ligji i zbatueshëm.

#### Neni 10

#### **Prishja e marrëveshjes**

1. Secila palë ka të drejtën ta prishë këtë marrëveshje duke bërë një njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara prishjes.

2. Nëse një palë konsideron që qëllimet e kësaj marrëveshjeje nuk mund të arrihen ose që pala tjetër nuk i përmbush detyrimet e saj, ajo palë ka të drejtën të pezullojë ose prishë këtë marrëveshje duke bërë një njoftim me shkrim paraprakisht tre muaj para pezullimit. Pavarësisht nga sa më sipër, një palë mund ta prishë këtë marrëveshje me efekt të menjëhershme në rastin e shkeljes thelbësore të marrëveshjes. Shkelje thelbësore është shkelje serioze e një prej objektivave thelbësore të kësaj marrëveshjeje.

3. Nëse ngjarje që rrjedhin nga forca madhore (fatkeqësi natyrore etj.) parandalojnë ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, secila palë mund ta prishë marrëveshjen me efekt nga momenti kur bëhet e mundur për ta zbatuar atë.

4. Në rastin e prishjes së parakohshme të kësaj marrëveshjeje ose në fund të projektit, çdo fond i pashpenzuar i dhënë në kuadrin e projektit i kthehet SDC-së.

#### Neni 11

#### **Modifikimet dhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve**

Çdo modifikim ose ndryshim i kësaj marrëveshjeje bëhet me shkrim me pëlqimin e të dy palëve.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me mjetet e bisedimeve diplomatike ndërmjet palëve.

#### Neni 12

#### **Dispozita të përgjithshme**

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, palët nuk propozojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë përfitime të çdo natyre. Ato nuk pranojnë asnjë nga këto propozime. Çdo sjellje korruptive ose e paligjshme përbën një shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe justifikon prishjen e saj dhe/ose marrjen e masave korrigjuese shtesë në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm.

Bazuar në rezultatin e projektit dhe/ose rezultatin e vlerësimit të përbashkët të jashtëm, të dy palët kontraktuese vendosin nëse dhe në cilën formë do të vazhdojë bashkëpunimi tej qershorit të vitit 2011.

#### Neni 13

#### **Anekset**

Përshkrimi i projektit (aneksi 1) përbën pjesë integrale të marrëveshjes.

#### Neni 14

#### **Kohëzgjatja dhe fuqia**

Kjo marrëveshje mbulon periudhën nga 1 korriku 2009 deri më 30 qershor 2011.

Ajo hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve dhe përfundon sapo të dy palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre kontraktuale.

Kjo marrëveshje shkruhet në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe dhe angleze. Në rastin e dallimeve në interpretim, mbizotëron versioni në anglisht.



Palët konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje, bërë në Tiranë më (...)

Në emër të Qeverisë së  
Zvicrës  
Yvana Enzler  
Ambasadore  
Ambasada e Zvicrës në  
Shqipëri

Në emër të Ministrisë së Arsimit  
dhe Shkencës së Republikës së  
Shqipërisë  
MINISTRI ARSIMIT DHE  
SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

Në emër të Ministrisë së Punës,  
Çështjeve Sociale dhe Shanseve të  
Barabarta të Republikës së Shqipërisë  
MINISTRI  
Spiro Ksera

**VENDIM**  
**Nr.284, datë 21.4.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN  
E INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE NË ATË TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT NË  
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË  
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

- Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në inxhinieri elektrike, me tre drejtime:
  - Elektroteknikë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim elektroteknikë.
  - Automatizimi i industrisë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim automatizimi i industrisë.
  - Elektroenergjetikë, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në inxhinieri elektrike, me drejtim elektroenergjetikë.
- Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeodezi.
  - Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeodezi, lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr.) në gjeodezi.
- Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
- Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara.
- Kuotat e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2009-2010, janë si më poshtë vijon:  
- Inxhinieri elektrike, me drejtimet:

a)	Elektroteknikë	12 kuota;
b)	Automatizim i Industrisë	12 kuota;
c)	Elektroenergjetikë	12 kuota;
	- Gjeodezi	12 kuota

- Nga kuotat e mësipërme caktohet 10 për qind për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
  8. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga fakultetet përkatëse.
  9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.
  10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, datë 26.5.2010, faqe 2286*

**VENDIM**  
**Nr.285, datë 28.4.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË HISTORI, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në histori, me këto drejtime:
  - a) Histori, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në histori”.
  - b) Arkeologji, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor(Dr.) në histori, me drejtim arkeologji”.
  - c) Marrëdhënie ndërkombëtare, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në histori, me drejtim marrëdhënie ndërkombëtare”.
  - ç) Trashëgimi kulturore, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në histori, me drejtim trashëgimi kulturore”.
2. Ky program studimi fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
3. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 (tre) vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2009-2010, është si më poshtë vijon:

a)	Histori	30 kuota;
b)	Arkeologji	15 kuota;
c)	Marrëdhënie ndërkombëtare	30 kuota;
ç)	Trashëgimi kulturore	15 kuota.

5. Nga kuota e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, për këto programe studimi, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.
6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë i Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, datë 26.5.2010, faqe 2287*

**VENDIM**  
**Nr.286, datë 28.4.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË GJEOGRAFI, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, në gjeografi.

2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në gjeografi”.

3. Ky program studimi fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 (tre) vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2009-2010, është 30.

6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, për këtë program studimi, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi të doktoratës është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.60, datë 26.5.2010, faqe 2288*

**VENDIM**  
**Nr.320, datë 5.5.2010**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË OBJEKTIT “GODINA E KONVIKTIT” NGA SHOQËRIA “TRAJTIMI I STUDENTËVE NR. 2” SHA, TIRANË, TE UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2002 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, dhe të nenit 82 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të objektit “Godina e konviktit” bashkë me truallin nën godinë, që ndodhet brenda territorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, nga shoqëria “Trajtimi i studentëve nr.2”, sh.a., Tiranë, tek Universiteti i Sporteve të Tiranës, sipas planimetrive dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.63, datë 31.5.2010, faqe 2382*

**VENDIM**  
**Nr.350, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “JURIDIK”, “SHKENCA KOMPJUTERIKE”, “SISTEMET E INFORMACIONIT” DHE “TEKNOLOGJI INFORMACIONI”, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, e programeve të studimit të ciklit të parë “Juridik”, “Shkenca kompjuterike”, “Sistemet e informacionit” dhe “Teknologji informacioni”. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht “Diplomë e Nivelit të Parë DNP, në drejtësi”, “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në shkenca kompjuterike”, “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në sistemet e informacionit” dhe “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në teknologji informacioni”.

2. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

3. Programet e studimit “Juridik”, “Shkenca kompjuterike”, “Sistemet e informacionit” dhe “Teknologji informacioni” të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010-2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, pa efekte buxhetore shtesë.

5.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2564*

**VENDIM**  
**Nr.351, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, NË “FILOZOFI SOCIALE”, NË FAKULTETIN E MËSUESISË TË UNIVERSITETIT “FAN S.NOLI”, KORÇË, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26,34,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në fakultetin e mësuesisë të universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë, të programit të studimeve të ciklit të dytë, në “Filozofi sociale”.
  2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet “Diplomë e Nivelit të Dytë, DND, në filozofi sociale”.
  3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
  4. Programi i studimeve të ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike.
  5. Kuota e pranimit në këtë program studimesh, për vitin akademik 2010-2011, është 20.
  6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, për këtë program studimesh, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.
  7. Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë duhet të përcaktojë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe t’i bëjë ato publike paraprakisht.
  8. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
  9. Tarifa e shkollimit për këtë program studimesh të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010-2011, është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.
  10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Fan S.Noli”, Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.
  11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2564*

**VENDIM**  
**Nr.352, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, NË “BIOLOGJI-KIMI”, “HISTORI-GJEOGRAFI” DHE “CIKËL I ULËT DHE ANGLISHT NË CIKLIN FILLOR” NË UNIVERSITETIN “FAN S.NOLI” KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Hapjen, në universitetin “Fan S.Noli”, Korçë, të programeve të studimit të ciklit të parë “Biologji-kimi” dhe “Histori-gjeografi”.

2.Hapjen, në filialin e qytetit të Pogradecit, të universitetit “Fan S.Noli”, Korçë, të programit të studimit të ciklit të parë “Cikël i ulët dhe anglisht në ciklin fillor”.

3.Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht, “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në biologji-kimi”, “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në histori-gjeografi” dhe “Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në cikël të ulët dhe anglisht në ciklin fillor”.

4.Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

5.Programet e studimit “Biologji-kimi”, “Histori-gjeografi” dhe “Cikël i ulët dhe anglisht në ciklin fillor” të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010-2011.

6.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Fan S.Noli”, Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

7.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe universiteti “Fan S.Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2565*

**VENDIM**  
**Nr.353, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË NË “GJUHËSI”,  
NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR  
XHUVANI”, ELBASAN, DHE PËR KUOTËN E PRANIMIT E TARIFËN E SHKOLLIMIT,  
NË KËTË PROGRAM STUDIUMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Hapjen, në fakultetin e shkencave humane, të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programit të studimeve të ciklit të dytë, në “Gjuhësi”.

Në përfundim të këtij programi studimesh, lëshohet “Diplomë e Nivelit të Dytë, DND, në gjuhësi”.

2. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
  3. Programi i studimeve të ciklit të dytë, realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike.
  4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2010-2011, është 20.
    - a) Në kuotën e mësipërme të këtij programi studimi, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.
  5. Universiteti “Aleksandër Xhuvani” duhet të përcaktojë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe t’i bëjë publike paraprakisht.
  6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
  7. Tarifa e shkollimit, për këtë program studimi të ciklit të dytë, për vitin akademik 2010-2011, është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.
  8. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i universitetit “A.Xhuvani” të Elbasanit, pa efekte buxhetore shtesë.
  9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti i Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2566*

**VENDIM**  
**Nr.354, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, NË SHKOLLËN E LARTË PRIVATE “SEVASTI&PARASHQEVI QIRIAZI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të tretë, Master i Nivelit të Dytë (MND) në:
  - a) “Administrim biznesi”;
  - b) “Administrim publik”.
2. Këto programe studimi të ciklit të tretë realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i Nivelit të Dytë, (MND)”, përkatësisht, në:
  - c) “Administrim biznesi”;
  - d) “Administrim publik”.
3. Shkolla e lartë private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2566*

**VENDIM**  
**Nr.355, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, TË CIKLIT TË PARË, “INXHINIERI EKONOMIKE”, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të parë “Inxhinieri ekonomike”. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në inxhinieri ekonomike”.

2. Programi i studimeve të ciklit të parë realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite akademike.

3. Programi i studimeve “Inxhinieri ekonomike” fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2567*

**VENDIM**  
**Nr.356, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, MASTER I NIVELIT TË PARË, NË “TEKNIK IMAZHERI”, NË FAKULTETIN E INFERMIERISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË KËTË PROGRAM STUDIMESH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Infermierisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve të ciklit të dytë, Master i Nivelit të Parë, në “Teknik imazheri”.



2. Në përfundim të këtij programi studimesh, lëshohet diplomë “Master i Nivelit të Parë, në teknik imazheri”.

3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Programi i studimit Master i Nivelit të Parë realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale e tij është 1 (një) vit akademik.

5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin akademik 2010-2011, është 60.

6. Nga kuota e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi, për këtë program studimesh, caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare të këtyre trojeve.

7. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Tarifa e shkollimit, për këtë program studimesh, të ciklit të dytë, është 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

9. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2568*

**VENDIM**  
**Nr.357, datë 12.5.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË “UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shkollës private të arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”, Tiranë, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” të organizohet në dy fakultete:

a) Fakultetin e Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në:

i) Inxhinieri civile;

ii) Inxhinieri kompjuterike.

b) Fakultetin e Ekonomisë, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në:

i) Menaxhim biznesi;

ii) Informatikë ekonomike.

3. Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike dhe me plotësimin e së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

i) Inxhinieri civile;

ii) Inxhinieri kompjuterike;

iii) Menaxhim biznesi;

iv) Informatikë ekonomike.

4. Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.67, datë 31.5.2010, faqe 2568*

**VENDIM**  
**Nr.381, datë 12.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË MATEMATIKË-FINANCË, SHKENCA KOMPJUTACIONALE DHE SHKENCA AKTUARISTIKE, NË UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të lgjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshili i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të programeve të studimit të ciklit të parë “Matematikë-financë”, “Shkenca kompjutacionale” dhe “Shkenca aktuaristike”. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohen përkatësisht “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në matematikë-financë”, “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në shkencat kompjutacionale” dhe “Diplomë e nivelit të parë, DNP, në shkencat aktuaristike”.

2. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

3. Programet e studimit “Matematikë-financë”, “Shkenca kompjutacionale” dhe “Shkenca aktuaristike”, të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010-2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës e universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.72, datë 10.6.2010, faqe 3204*

**VENDIM**  
**Nr.406, datë 26.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMEVE NË SHKOLLËN E LARTË  
PRIVATE “UNIVERSITETI POLIS”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Art dhe dizajn;
- b) Studime mjedisore.

2. Këto programe studimesh të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- a) Art dhe dizajn;
- b) Studime mjedisore.

3. Hapjen, në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Dizajn i aplikuar;
- b) Arkitekturë;
- c) Menaxhim mjedisor urban.

4. Këto programe studimesh të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në:

- a) Dizajn i aplikuar;
- b) Arkitekturë;
- c) Menaxhim mjedisor urban.

5. Hapjen, në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë” (MND), në formën e studimeve me kohë të pjesshme, në:

- a) Dizajn arkitektonik dhe parametrik;
- b) Strehim dhe zhvillim toke;
- c) Dizajn estetik strukturor;
- ç) Dizajn urban dhe pejzazhi;
- d) Zhvillim social urban dhe burime njerëzore;
- dh) Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS.

6. Këto programe studimesh të ciklit të tretë realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master i nivelit të dytë” (MND), në:

- a) Dizajn arkitektonik dhe parametrik;
- b) Strehim dhe zhvillim toke;
- c) Dizajn estetik strukturor;
- ç) Dizajn urban dhe pejzazhi;
- d) Zhvillim social urban dhe burime njerëzore;
- dh) Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS.

7. Shkolla e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikat 1, 3 e 5 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

8. Ky institucion duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, datë 1.7.2010, faqe 4016*

**VENDIM**  
**Nr.407, datë 26.5.2010**

**PËR HAPJEN E FILIALIT TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “KRISTAL”, NË QYTETIN E GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e filialit të shkollës së lartë private “Kristal”, në qytetin e Gjirokastrës, dhe të programeve të studimeve të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Infermieri;
- b) Menaxhim biznesi dhe financë;
- c) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- ç) Drejtësi.

2. Këto programe studimesh të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- a) Infermieri;
- b) Menaxhim biznesi dhe financë;
- c) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- ç) Drejtësi.

3. Filiali në Gjirokastrë i shkollës së lartë private “Kristal” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, datë 1.7.2010, faqe 4017*

**VENDIM**  
**Nr.408, datë 26.5.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMEVE NË SHKOLLËN E LARTË PRIVATE “UFO UNIVERSITY”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Menaxhim biznesi”.

2. Ky program studimi i ciklit të parë realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Menaxhim biznesi”.

3. Hapjen, në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë, në “Shkenca juridike”, në formën e studimeve me kohë të plotë, me këto drejtime:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- b) E drejtë publike dhe administrative;
- c) E drejtë private;
- ç) E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi European;
- d) E drejtë penale.

4. Këto programe studimesh të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në “Shkenca juridike”, në drejtimet:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- b) E drejtë publike dhe administrative;
- c) E drejtë private;
- ç) E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi European;
- d) E drejtë penale.

5. Shkolla e lartë private “UFO University”, Tiranë ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë private “UFO University”, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.76, datë 1.7.2010, faqe 4018*

**VENDIM**  
**Nr.440, datë 9.6.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË KOLEGJIT  
PROFESIONAL PRIVAT “NEW GENERATION” (BREZI I RI), TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 26, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në kolegjin profesional privat “New Generation” (Brezi i Ri), Tiranë, të programeve të studimit jouniversitare, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Parukeri të avancuar;
- b) Estetikë të avancuar.

2. Këto programe studimi jouniversitare, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diplomë në:

- a) Parukeri të avancuar;
- b) Estetikë të avancuar.

3. Kolegji profesional privat “New Generation” (Brezi i Ri), Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, vetëm pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.85, datw 12.7.2010, faqe 4455*

**VENDIM**  
**Nr.490, datë 23.6.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMEVE, NË SHKOLLËN E LARTË  
UNIVERSITARE PRIVATE “LUARASI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Administrim publik”.

2. Ky program studimi i ciklit të parë realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Administrim publik”.

3. Hapjen, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të dytë, në formë e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) “E drejtë publike e administrative;
- b) “E drejtë civile e tregtare;
- c) “E drejtë penale”.

4. Këto programe studimesh të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të këtyre programe të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë“ (DND) në:

- a) “E drejtë publike e administrative;
- b) “E drejtë civile e tregtare;
- c) “E drejtë penale”.

5. Hapjen, në shkollën e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë, të programit të studimit “Master i nivelit të parë“ (MNP), në formën e studimeve me kohë të plotë në “Specialist/jurist në administratën publike”.

6. Ky program studimi realizohet me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 1(një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë“ (MNP), në “Specialist/jurist në administratën publike”.

7. Shkolla e lartë universitare private “Luarasi”, Tiranë të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikat 1, 3 e 5 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

8. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.96, datë 26.7.2010, faqe 5133*

**VENDIM**  
**Nr.491, datë 23.6.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI ELITE”,  
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Universiteti Elite”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë do të organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i stomatologjisë, që do të ofrojë programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, në “Stomatologji”.

b) Fakulteti ekonomik, që do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, në:

- i) “Menaxhim biznesi”;
- ii) “Financë-bankë”;
- iii) “Administrim publik”;
- iv) “Ekonomik”.

3. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë do të ofrojë programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, me kohëzgjatje 5 (pesë) vite akademike, duke plotësuar, së paku, 300 kredite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë e integruar e nivelit të dytë” (DIND) në “Stomatologji”.

4. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike dhe me plotësimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- i) “Menaxhim biznesi”;
- ii) “Financë-bankë”;
- iii) “Administrim publik”;
- iv) “Ekonomik”.

5. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë private “Universiteti Elite”, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.96, datë 26.7.2010, faqe 5134*

**VENDIM**  
**Nr.515, datë 30.6.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË NË**  
**UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe të Rekreacionit, të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të programit të studimit të ciklit të parë “Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit”. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në “Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit”.

2. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, të Universitetit të Sporteve të Tiranës, të programit të studimit të ciklit të parë “Shkenca të lëvizjes”, në bazë të riorganizimit të programit të studimit të ciklit të parë “Edukim fizik dhe sporte”. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në “Shkencat e lëvizjes”.

3. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

4. Studentët, të cilët ndjekin studimet në programin e studimit “Edukim fizik dhe sporte”, në kohëzgjatjen normale, edhe pas daljes së këtij vendimi, e përfundojnë atë me të njëjtin emërtim të programit të studimit, për të cilin kanë filluar studimet. Studentët përsëritës i nënshtrohen programit të studimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë studimet.



5. Programi i studimit “Fushat e veprimtarisë fizike, të shëndetit dhe të rekreacionit” të fillojë veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.

6. Programi i studimit “Shkencat e lëvizjes” të fillojë veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Sporteve të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, datë 2.8.2010, faqe 5269*

**VENDIM**  
**Nr.516, datë 30.6.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË**  
**UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, të programeve të studimit të ciklit të parë:

- a) Fizikë dhe teknologji informacioni;
- b) Teknologji informacioni.

2. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- a) Fizikë dhe teknologji informacioni;
- b) Teknologji informacioni.

3. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

4. Programet e studimit të ciklit të parë të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010–2011.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, datë 2.8.2010, faqe 5270*

**VENDIM**  
**Nr.517, datë 30.6.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË NË**  
**UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programeve të studimeve të ciklit të parë:

- a) Gjuhë shqipe dhe frënge,
- b) Histori dhe gjuhë gjermane,
- c) Gjeografi dhe gjuhë italiane.

2. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në:

- a) Gjuhë shqipe dhe frënge,
- b) Histori dhe gjuhë gjermane,
- c) Gjeografi dhe gjuhë italiane.

3. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

4. Programet e studimeve të ciklit të parë të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010–2011.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.101, datë 2.8.2010, faqe 5270*

**VENDIM**  
**Nr.518, datë 30.6.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, “TEKNOLOGJI**  
**INFORMACIONI”, NË UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, të programit të studimeve të ciklit të parë “Teknologji informacioni”.

2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në “Teknologji informacioni”.

3. Programi i studimeve të ciklit të parë realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike.

4. Programi studimeve “Teknologji informacioni” të fillojë veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Fan S. Noli”, Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.102, datë 3.8.2010, faqe 5285*

#### **VENDIM**

**Nr.568, datë 14.7.2010**

### **PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE, TË CIKLIT TË PARË “TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI” NË UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen, në Universitetin e Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të parë, “Teknologji informacioni dhe komunikimi (me drejtim teknologji informacioni)”. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, DNP, në “Teknologji informacioni dhe komunikimi (me drejtim teknologji informacioni)”.

2. Programi i studimeve të ciklit të parë realizohet me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike.

3. Programi i studimeve “Teknologji informacioni dhe komunikimi (me drejtim teknologji informacioni)” fillon veprimtarinë e vet në vitin akademik 2010 – 2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.103, datë 6.8.2010, faqe 5207*

**VENDIM**  
**Nr.678, datë 13.8.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË FAKULTETIN  
E INFERMIERISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR KUOTËN E  
PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Lëndët klinike”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në lëndët klinike”.

b) Doktoratë në “Lëndët paraklinike”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në lëndët paraklinike”.

2. Këto programe studimi e fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

3. Kohëzgjatja e këtyre programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën 3 (tri) vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin akademik 2010-2011, është si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Lëndët klinike”                      40 kuota;

b) Doktoratë në “Lëndët paraklinike”                40 kuota.

5. Në kuotën e mësipërme caktohet 10% për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit për këto programe studimi të doktoratës, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste, të caktuara nga Fakulteti i Infermierisë të Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.127, datë 20.9.2010, faqe 6810*

**VENDIM**  
**Nr.681, datë 25.8.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË  
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE,  
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 26, 34 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes të Universitetit të Sporteve, Tiranë, të programit të studimeve të ciklit të dytë, “Master i Nivelit të Parë” (MNP), në “Stërvitje Sportive”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma Master i Nivelit të Parë (MNP), në “Stërvitje Sportive”.
  2. Programi i studimeve “Master i Nivelit të Parë” realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik.
  3. Ky program studimesh e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
  4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Sporteve, Tiranë, pa efekte buxhetore shtesë.
  5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Sporteve, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, datë 30.8.2010, faqe 5839*

**VENDIM**  
**Nr.682, datë 25.8.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË FAKULTETIN  
E DREJTËSISË TË UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 26, 34 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, në fakultetin e drejtësisë të universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, të programit të studimeve të ciklit të dytë “E drejta kushtetuese dhe administrative”, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Nivelit të Dytë, (DND), në “E drejta kushtetuese dhe administrative”.
2. Ky program studimesh i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike.
3. Programi i studimeve “E drejta kushtetuese dhe administrative” të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, pa efekte buxhetore shtesë.

5.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, datë 30.8.2010, faqe 5840*

**VENDIM**  
**Nr.683, datë 25.8.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 26, 34 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Hapjen, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes të Universitetit të Sporteve, Tiranë, të programit të studimeve të ciklit të dytë, në “Shkenca sportive”, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Nivelit të Dytë, (DND), në “Shkenca sportive”.

2.Ky program studimesh i ciklit të dytë realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 (dy) vite akademike.

3.Programi i studimeve “Shkenca sportive” të fillojë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Sporteve të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Sporteve, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, datë 30.8.2010, faqe 5840*

**VENDIM**  
**Nr.684, datë 25.8.2010**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË EDUKIMIT, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI :**

1.Hapjen, në fakultetin e shkencave të edukimit të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i nivelit të parë”, në:

- a) "Punonjës social me fëmijët dhe familjen";
- b) "Psikolog në institucione".

2. Programet e studimit "Master i nivelit të parë" realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit akademik.

3. Programet e studimit ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohen diplomat "Master i nivelit të parë", MNP, në:

- a) "Punonjës social me fëmijët dhe familjen";
- b) "Psikolog në institucione".

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, pa efekte buxhetore shtesë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, datë 3.8.2010, faqe 5841*

**VENDIM**  
**Nr.685, datë 25.8.2010**

**PËR RIORGANIZIMIN E UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja "b", 41 e 42, pika 1 të ligjit nr.9741 datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Riorganizimin e universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në njësitë kryesore, si më poshtë vijon:

- a) Fakulteti i Edukimit;
- b) Fakulteti i Biznesit;
- c) Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
- d) Fakulteti i Shkencave Politike - Juridike;
- e) Fakulteti i Studimeve Profesionale.

2. Riorganizimin e filialit të këtij universiteti në qytetin e Peshkopisë, si njësi kryesore e universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

3. Fakulteti i Edukimit ofron programe studimi të ciklit të parë në:

a) "Cikël i ulët", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë (DNP)", në "Mësues i ciklit të ulët".

b) "Gjuhë angleze", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë (DNP)" në "Gjuhë angleze".

c) "Ekspert procesi formimi", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në "Ekspert në proceset e formimit".

ç) "Psikologji - Sociologji", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë (DNP), në "Psikologji - Sociologji".

d) "Gjuhë- Letërsi - Anglisht", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë" (DNP), në "Gjuhë- Letërsi - Anglisht".

3.1 Fakulteti i Edukimit përbëhet nga departamentet e mëposhtme:

- a) Departamenti i pedagogjisë;
- b) Departamenti i gjuhëve të huaja;

- c) Departamenti i sociologjisë;
  - ç) Departamenti i psikologjisë.
4. Fakulteti i Biznesit ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në:
- a) “Administrim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Administrim biznesi”.
  - b) “Menaxhim - Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Menaxhim - Marketing”.
  - c) “Shkenca ekonomike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Shkenca ekonomike”.
  - ç) “Financë - Kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Financë - Kontabilitet”.
  - d) “Bankë - Financë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Bankë - Financë”.
  - dh) “Menaxhim turizëm”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Menaxhim turizëm”, në profilet “Menaxhim hotel-restorant”, “Menaxhim turizëm kulturor”, “Menaxhim turizëm arkeologjik”.
- 4.1 Fakulteti i Biznesit përbëhet nga departamentet e mëposhtme:
- a) Departamenti i shkencave ekonomike;
  - b) Departamenti i menaxhimit;
  - c) Departamenti i marketingut;
  - ç) Departamenti i financë – kontabilitetit;
  - d) Departamenti i turizmit.
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (IT) ofron programe studimi të ciklit të parë në:
- a) “Shkenca kompjuterike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Shkenca kompjuterike”.
  - b) “Sistemet e informacionit”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Sistemet e informacionit”.
  - c) “Teknologji informacioni”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Teknologji informacioni”.
  - ç) “Matematikë - Informatikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Matematikë - Informatikë”.
  - d) “Informatikë - Anglisht”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Informatikë - Anglisht”.
- 5.1. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga departamentet e mëposhtme:
- a) Departamenti i shkencave kompjuterike;
  - b) Departamenti i sistemeve të informacionit;
  - c) Departamenti i teknologjisë së informacionit;
  - d) Departamenti i matematikës.
6. Fakulteti i Shkencave Politike - Juridike ofron programet e studimit të ciklit të parë në:
- a) “Juridik”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Drejtësi”.
  - b) “Shkenca politike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Shkenca politike”.
  - c) “Administrim publik” në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Administrim publik”.
- 6.1 Fakulteti i Shkencave Politike - Juridike përbëhet nga departamentet e mëposhtme:
- a) Departamenti i drejtësisë;
  - b) Departamenti i shkencave politike;
  - c) Departamenti i administrimit publik.
- 6.2 Programet e studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit (IT) dhe në Fakultetin e Shkencave Politike -Juridike realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.
7. Fakulteti i Studimeve Profesionale ofron programet e mëposhtme të studimit:



a) “Infermieri e përgjithshme”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Infermieri e përgjithshme”.

b) “Ndihmësdentist”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë”, “Ndihmësdentist”.

c) “Menaxhim ndërtimi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë” në “Menaxhim ndërtimi”.

ç) “Menaxhim transporti”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë”, në “Menaxhim transporti”.

d) “Asistent ligjor”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë”, “Asistent ligjor”.

dh) “Asistent administrativ”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë”, “Asistent administrativ”.

e) “Teknologji automobilash”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë” në “Teknologji automobilash”.

ë) “Specialist rrjetesh kompjuterike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë”, “Specialist rrjetesh kompjuterike”.

7.1 Fakulteti i Studimeve Profesionale përbëhet nga departamentet e mëposhtme:

a) Departamenti i mjekësisë;

b) Departamenti i inxhinierisë;

c) Departamenti i mekanikës dhe transportit.

7.2 Programi i studimit i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 7 të këtij vendimi, në Fakultetin e Studimeve Profesionale realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale është 3 (tre) vite akademike, ndërsa programet e studimit, të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” e “ë”, të po kësaj pike, realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja e tyre normale është 2 (dy) vite akademike.

8. Filiali në qytetin e Peshkopisë, si njësi kryesore e universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, ofron programet e studimit të ciklit të parë në:

a) “Shkenca të administrimit”, me profil “Financë - Kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Financë – Kontabilitet”.

b) “Shkenca të administrimit”, me profil “Bankë - Financë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Bankë – Financë”.

c) “Shkenca të administrimit”, me profil “Menaxhim - Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Menaxhim – Marketing”.

ç) “Shkenca të administrimit” me profil “Administrim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Administrim biznesi”.

d) “Matematikë - Fizikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Matematikë – Fizikë”.

dh) “Matematikë - Informatikë”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Matematikë – Informatikë”.

e) “Informatikë - Anglisht”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Informatikë- Anglisht”.

ë) “Gjuhë- Letërsi- Anglisht”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Gjuhë- Letërsi –Anglisht”.

f) “Biologji- Kimi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Biologji – Kimi”.

g) “Psikologji- Sociologji”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Psikologji – Sociologji”.

gj) “Procese formimi”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Procese formimi”.

h) “Infermieri e përgjithshme”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Infermieri e përgjithshme”.

i) “Drejtimi”, me profil “Asistencë ligjore”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë”, në “Asistencë ligjore”.

j) “Informatikë”, me profil “Rrjete kompjuterike”, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë”, në “Rrjete kompjuterike”.

8.1 Filiali në qytetin e Peshkopisë, si njësi kryesore e universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, përbëhet nga departamentet e mëposhtme:

- a) Departamenti i ekonomisë;
- b) Departamenti i edukimit;
- c) Departamenti i shkencave të aplikuara.

9. Programet e studimit të ciklit të parë në filialin e qytetit të Peshkopisë, si njësi kryesore e universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj” e “h”, të pikës 8 të këtij vendimi, realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tre) vite akademike, ndërsa programet e përcaktuara në shkronjat “i” dhe “j” të po kësaj pike, realizohen me 120 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike.

10. Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP) do të vijojë të funksionojë në përputhje me vendimin nr.827, datë 11.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen pranë universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP), dhe për mënyrën e funksionimit të tij për periudhën kalimtare”.

11. Vendimet e Këshillit të Ministrave, që kanë dalë për universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, dhe që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.118, datë 30.8.2010, faqe 5842*

**VENDIM**  
**Nr.699, datë 13.8.2010**

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR  
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, TË OBJEKTIT “DEPARTAMENTI I DETARISË”,  
NË VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përdorim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Ismail Qemali”, të objektit “Departamenti i Detarisë”, pjesë e pronës nr.904, me emërtesë “Akademia e Detarisë”, në Vlorë, për zhvillimin e programit mësimor, deri më datën 30.9.2017.

2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objektit, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.127, datë 20.9.2010, faqe 6833*

**UDHËZIM**  
**Nr.28, datë 17.9.2007**

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË  
STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË  
LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2007-2008**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr.517, datë 8.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2007-2008”, vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”,

**UDHËZOJ:**

1. Pranimi i kandidatëve në ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet sipas listave emërore të renditura nga Qendra e Përpunimit Informatik (QPI), pranë MASH-it.

2. Kandidatët fitues përcaktohen nga QPI-ja në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të “Maturës shtetërore” dhe për disa programe studimi edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.21, datë 16.8.2007 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe të ndryshme studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2007-2008”;

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A2.

3. QPI-ja deri në datën 17.9.2007 do të përgatisë listën paraprake të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A2, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr.517, datë 8.8.2007 të Këshillit të Ministrave.

4. Listat paraprake të kandidatëve fitues, në formë të shkruar dhe elektronike do t’u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programeve përkatëse të studimit, në datën 18.9.2007 nga QPI-ja. Këto institucione do t’i afishojnë listat në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve përkatëse, brenda orës 15.00 të datës 18.9.2007.

5. Për organizimin dhe realizimin e procesit të pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, ngarkohen njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Ky proces do të jetë nën monitorimin e administratës së Rektoratit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Regjistrimi i kandidatëve për të fituar statusin e studentit të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë do të zhvillohet me dy faza: regjistrimi paraprak dhe regjistrimi përfundimtar.

7. Regjistrimi paraprak

7.1 Kandidatët fitues do të bëjnë regjistrimin e tyre paraprak në programin e studimit, ku janë shpallur paraprakisht fitues pranë sekretarive të fakulteteve në datat 19, 20, 21, 22, 23 shtator 2007, prej orës 8<sup>00</sup> deri në 18<sup>00</sup>.

7.2 Për regjistrimin paraprak, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive dhe të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie;

b) Dokument identifikimi dhe fotokopje të tij. Në dosje do të mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1 500 lekë.

7.3 Në kryerjen e procedurës së regjistrimit paraprak, sekretaritë e fakulteteve mbajnë

regjistër të veçantë, ku kandidatët fitues nënshkruajnë në momentin e regjistrimit për dorëzimin e dokumenteve, duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit.

7.4 Sekretaria duhet ta pajisë kandidatin që bën regjistrimin paraprak me një fletë regjistrimi paraprak, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fletë regjistrimi paraprak duhet të jetë i nënshkruar nga dekan i fakultetit dhe i vulosur.

8. Deri në orën 14<sup>00</sup> të datës 24.9.2007, institucionet publike të arsimit të lartë do të dorëzojnë në QPI në formë të shkruar dhe elektronike:

- a) listën origjinale të dërguar nga MASH-i me regjistrimet paraprake të kryera;
- b) listën vetëm të kandidatëve që kanë kryer regjistrimin paraprak në programin e studimit ku paraprakisht janë shpallur fitues;
- c) listën e kandidatëve që nuk kanë kryer regjistrimin paraprak në programin e studimit ku paraprakisht janë shpallur fitues.

Formati teknik i paraqitjes së listave të mësipërme përcaktohet në aneksin A bashkëlidhur.

9. Kandidatët që nuk kryejnë regjistrimin paraprak brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdo lloj arsyeje, humbasin statusin e kandidatit për regjistrimin përfundimtar.

10. Në bazë të regjistrimeve paraprake të kryera dhe vendeve të paplotësuar, QPI-ja në datën 27 shtator 2007, do të përgatisë listën përfundimtare të kandidatëve fitues duke ruajtur parimet e shprehura në pikën 2 të këtij udhëzimi.

11. Listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në formë të shkruar dhe elektronike do t'u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programeve përkatëse të studimit, në datën 29 shtator 2007 nga QPI-ja. Këto institucione do t'i afishojnë listat në vende të dukshme, në mjediset e fakulteteve përkatëse, brenda datës 29 shtator 2007.

## 12. Regjistrimi përfundimtar

12.1 Kandidatët që janë shpallur fitues në listat përfundimtare, në një program tjetër studimi të një preference të tyre më të lartë, do të çregjistrohen nga programi i studimit ku janë regjistruar paraprakisht sipas listave paraprake dhe do të regjistrohen në programin e studimit ku janë shpallur përfundimisht fitues.

12.2 Sekretariteti e fakulteteve në datat 29, 30 shtator dhe 1, 2, 3, 4, 5 tetor 2007, prej orës 8<sup>00</sup> deri 18<sup>00</sup> do të kryejnë çregjistrimet e kandidatëve që janë shpallur fitues në një program studimi tjetër të një preference më të lartë të tyre dhe do të regjistrojnë kandidatët e rinj fitues, sipas listave përfundimtare të fituesve të shpallura nga QPI-ja. Kandidatëve që çregjistrohen do t'u kthehet dosja individuale, me dokumentet e cilësuar në pikën 7.2, ndërsa regjistrimi përfundimtar i kandidatëve të rinj do të bëhet sipas pikave 7.2, 7.3 dhe 7.4 të këtij udhëzimi.

12.3 Veprimet e çregjistrimit paraprak dhe ato të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve të rinj do të dokumentohen në regjistrin e veçantë sipas pikës 7.3 të këtij udhëzimi.

12.4 Kandidatët që edhe në listat përfundimtare rezultojnë fitues në të njëjtin program studimi, nuk kanë nevojë të reregjistrohen.

13. Në përfundim të procesit të regjistrimit, studentët e regjistruar në regjistrin e veçantë do të regjistrohen në regjistrin bazë të studentëve në vijim të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

14. Lista e kandidatëve fitues, sipas programeve të ndryshme të studimit, për shqiptarët nga trojet jashtë vendit, të përcaktuara nga ministritë e arsimit të vendeve përkatëse, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr.517, datë 8.8.2007 të Këshillit të Ministrave, dërgohen në institucionet publike të arsimit të lartë deri më 25 shtator 2007.

15. Kandidatët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja do të regjistrohen pranë sekretarive të fakulteteve në datat 26, 27 dhe 28 shtator 2007, duke paraqitur dokumentet sipas pikës 7.2. Dokumentet e përmendura në pikat 7.2a dhe 7.2b, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe e të noterizuara.

16. Me mbylljen e procesit të regjistrimit institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në QPI listat përfundimtare origjinale të dërguara nga MASH me regjistrimet e kryera.

17. Rektoratet dhe dekanatet, duke filluar nga data 18 shtator 2007, do të shpallin në mënyrë të qartë dhe në vende të dukshme, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit/çregjistrimit,

procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe njoftime të tjera që i gjejnë të nevojshme për sigurimin e një ecurie normale të procesit të pranimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

18. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës për arsimin e lartë, Qendra e Përpunimit Informatik të rezultateve të maturës 2007, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, rektorët e institucioneve publike të arsimit të lartë për zbatimin të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Genc Pollo

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.131, datë 3.10.2007, faqe 3647*

**UDHËZIM**  
**Nr.30, datë 26.9.2007**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË  
PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT  
TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË STUDIMIT NË CIKLIN E PARË, CIKLIN E DYTË DHE  
CIKLIN E TRETË TË STUDIMEVE, SI DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMEVE  
JOUNIVERSITARE, TË NATYRËS PROFESIONALE**

*(Ndryshuar me udhëzim nr.29, datë 28.7.2008;*

*ndryshuar me udhëzim nr.24, datë 2.9.2009;*

*revokuar pikat 4/1 dhe 4/2 të Kreut III me udhëzim nr.36, datë 9.11.2009)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

Subjekti juridik, vendas ose i huaj, për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë në fushën e arsimit të lartë privat, paraqet kërkesë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

**KREU I**  
**KRITERET DHE PROCEDURAT PËR LICENCIMIN E NJË INSTITUCIONI TË RI PRIVAT  
TË ARSIMIT TË LARTË**

Kërkesa për licencimin e një institucioni privat të arsimit të lartë, për programe të studimit të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, shoqërohet me:

1. Projektin konkret, i cili duhet të përmbajë:

a) tipin e institucionit të arsimit të lartë, emrin dhe objektivat afatmesme të veprimtarisë arsimore, kërkimore dhe zhvilluese të institucionit;

b) të dhëna për burimet financiare, shoqëruar me dokument bankar që shpreh vlerën e burimeve financiare që subjekti juridik zotëron, burimet materiale, bibliotekare dhe informatike. Këto të dhëna të shoqërohen nga deklaratat analitike për tatimin mbi të ardhurat dhe deklaratat e tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera, sipas formularëve të përcaktuar në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 të Ministrisë së Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

c) organizmin e studimeve, planet mësimore për programet e studimit, programet e lëndëve/moduleve me syllabuset përkatëse, emërtimet e diplomave në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. I gjithë dokumentacioni i kësaj pike të jetë në dy kopje;

d) një institucion privat, që zotëron një formë akreditimi në një shtet tjetër është i detyruar të paraqesë një dokument zyrtar mbi këtë akreditim;

e) në rast se institucioni parashikon të ofrojë programe studimi të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj, është i detyruar të paraqesë një dokument zyrtar bashkëpunimi, si dhe dokumentin zyrtar të akreditimit të institucionit bashkëpunues nëse ka;

f) strukturën e institucionit;

g) statutin, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”;

h) të dhëna për personelin akademik që do të punësohet dhe kriteret e punësimit për çdo vend pune në institucionin e arsimit të lartë;

i) subjekti duhet të deklarojë se do të plotësojë standardet akademike, sipas përcaktimeve përkatëse në shtojcën nr.1, bashkëlidhur udhëzimit dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

j) të dhëna për ambientet arsimore, të cilat do të jenë në formën e vetëdeklarimit duke plotësuar formularin përkatës të autodeklarimit, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili do të përmbajë konkretisht:

i) subjektet që kanë në zotërim ambiente, deklarin për zotërimin e tyre;

ii) subjektet që nuk kanë në zotërim ambiente, deklarin për sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor;

iii) numrin, emërtimin dhe datën e ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve ose të vendimit të gjykatës, për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit privat.

iv) deklaratën e subjektit që nuk është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë, proces gjyqësor, proces hetimi;

k) curriculum vitae e administratorit të shoqërisë.

1/1. “Propozimin për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të doktoratës, si rregull, mund ta bëjnë vetëm institucionet private të arsimit të lartë, të cilat janë licencuar dhe kanë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, për programe studimi të ciklit të parë dhe programe studimi të ciklit të dytë.

Propozimi për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të doktoratës duhet të jetë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.864, datë 5.12.2007 “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”” dhe udhëzimin e Ministrisë nr.5, datë 22.1.2008 “Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse.

Në të, të përcaktohen edhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor” në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.864, datë 5.12.2007, të cituar më sipër.

2. Në rastet e pikave “i” dhe “ii”, ambientet duhet të jenë sipas standardeve të përcaktuara në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Në rast deklarimi të rremë, subjekti aplikues i nënshtrohet masave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Kontrolli lidhur me vërtetësinë e informacionit të deklaruar në formularin e autodeklarimit dhe të pikave të këtij udhëzimi ndërmerret nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

4. Kërkesa për licencim, për fillimin e veprimtarisë me program studimi të ciklit të dytë, së bashku me dokumentet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu, duhet të shoqërohet edhe me një dokument zyrtar të një institucioni, publik ose privat, të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, të njohur zyrtarisht në vendin përkatës, i cili angazhohet zyrtarisht që të bashkëpunojë me institucionin që paraqet kërkesën për të ofruar programe studimi të ciklit të dytë, ose i jep atij mundësinë e zhvillimit të këtyre programeve studimi.

5. Kërkesa, projekti dhe dokumentacioni ligjor, (praktika) depozitohet/n në Drejtorinë për Shërbimet Juridike, e cila verifikon brenda dy javëve, nëse është plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 4 të kreut I. Drejtoria për Shërbimet Juridike, kur praktika rezulton me mangësi, i kërkon subjektit, që, brenda një muaji, t’i plotësojë ato. Për efekt të llogaritjes së afateve data e plotësimit të praktikës do të konsiderohet si datë e paraqitjes së kërkesës. Kur praktika nuk plotësohet brenda këtij afati, kërkesa nuk pranohet.

6. Drejtoria e Shërbimeve Juridike dërgon brenda tri javëve, kur dokumentacioni është i plotë, një kopje të dokumentacionit të pikës 1(c) të kreut I të udhëzimit tek Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), e cila e shqyrton dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 44 dhe të neneve në vijim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, jep vlerësimin e vet. Për kryerjen e këtij procesi APAAL, angazhon edhe ekspertë të jashtëm sipas programeve të studimit që do të vlerësohen. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) vlerëson vetëm dokumentacionin e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. APAAL, brenda 4 javëve, shprehet me shkrim, për programin/et e studimit të paraqitur, nëse nuk shprehet brenda këtij afati, vlerësimi për programet bëhet nga komisioni i veçantë i krijuar sipas pikës 9 të kreut I të këtij udhëzimi.

8. Vlerësimi me shkrim i AAAL-së bashkëlidhet me praktikën, e cila i kthehet Drejtorisë për Shërbimet Juridike, për vijimin e procedurave të mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

9. Kërkesa, së bashku me praktikën e plotë, shqyrtohet nga një komision i veçantë, i krijuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, i cili ka në përbërje drejtorin për arsimin e lartë, specialistë: një inxhinier, një financier, një jurist dhe një specialist të përmbajtjes sipas fushës së programit. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri, që mbulon arsimin e lartë. Pranë komisionit funksionon sekretariati teknik, i cili mban procesverbalet dhe kryen detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloren e punës së komisionit.

10. Drejtoria për Shërbimet Juridike përcjell brenda një jave dosjen e plotësuar së bashku me vlerësimin e AAAL-së, komisionit të veçantë, i cili brenda dy muajve shqyrton projektin/et e paraqitur. Gjatë shqyrtimit të një projekti, komisioni mund të kërkojë të dhëna ose dokumentacion shtesë për projektin e paraqitur dhe/ose mund të thërrasë subjektin kërkues për të prezantuar ose për të dhënë shpjegime për projektin. Kur komisioni ka kërkuar të dhëna ose dokumentacion shtesë, brenda një muaji nga plotësimi i tyre, rishqyrton projektin e plotësuar. Komisioni mund të shqyrtojë një kërkesë deri në dy herë, në mblledhjet e radhës. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni merr vendim për projektin e paraqitur.

11. Kur komisioni është shprehur pozitivisht për projektin, praktika përcillet te Ministri, i cili brenda 30 ditëve vendos për dërgimin ose jo në Këshillin e Ministrave të projektvendimit për dhënien e licencës, sipas neneve 43 e 44 të ligjit nr.9471, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

12. Kur komisioni shprehet negativisht për projektin, një kopje e vendimit me shkrim, i jepet kërkuesit, i cili ka të drejtë të parashtrojë objeksionet e veta. Kërkesa, së bashku me praktikën, vendimin me shkrim të komisionit dhe objeksionet e kërkuesit shqyrtohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, i cili brenda 30 ditëve, vendos kthimin për rishqyrtim ose refuzimin përfundimtar të kërkesës. Kërkesa e refuzuar, së bashku me praktikën e plotë arkivohet në protokollin e Ministrisë.

13. Subjekti juridik, i licencuar, jo më vonë se tre javë para fillimit të vitit akademik, duhet të ketë plotësuar angazhimet që kushtëzojnë fillimin e veprimtarisë dhe të dorëzojë këto dokumente:

a) listën e plotë emërore të personelit akademik, si dhe të autoriteteve drejtuese, për të gjitha programet e studimit, të shoqëruar me kontratat e punës, si dhe ngarkesat dhe formën e punësimit, për secilin personel të punësuar, së bashku me titullin apo gradën përkatëse; kjo listë duhet të shoqërohet me dosje individuale, e cila duhet të përmbajë një CV, dokumente që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, si dhe punësimin aktual dhe lejen e punëdhënësit kryesor për personelin akademik të ftuar apo me kontratë afatshkurtër;

b) rregulloren e institucionit;

c) programet e studimit të firmosura në çdo fletë, planet mësimore të shoqëruara me programet e lëndëve, si edhe drejtuesin e lëndës, ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit në orë mësimore dhe kreditet, format e mësimdhënies dhe raportet midis tyre;

d) planimetrinë dhe planvendosjen e godinës së institucionit, së bashku me bazën materiale dhe didaktike. Aktin e posedimit të godinës apo kontratën e qirasë me afat së paku 5-vjeçar, të shoqëruar me vërtetimin e pronësisë të qiradhënësit;

e) numrin e prishëm të studentëve, referuar standardeve akademike dhe të infrastrukturës, të deklaruara nga subjekti;

f) tarifën e shkollimit për studentët;

g) lejen higjierno-sanitare;  
h) vërtetimin nga njësia e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit;  
i) vendimin e gjykatës për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit privat;

j) çdo të dhënë tjetër që vlerësohet e nevojshme nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me ligjin nr.9471, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akte të tjera nënligjore;

k) dokumentacionin ligjor, për shoqërinë dhe për administratorin si: vërtetim nga prokuroria, (për administratorin dhe shoqërinë); vërtetim nga gjykata, (për administratorin dhe shoqërinë); vërtetim nga regjistri tregtar, (për shoqërinë); dëshmi penaliteti për administratorin/ët; vërtetim nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve, nëse shoqëria ka qenë e regjistruar dhe ka ushtruar veprimtari ekonomike; aktin e regjistrimit si person juridik (shoqëri ose filial i ndonjë shoqërie të huaj), me objekt ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit të lartë privat dhe statutin e shoqërisë (fotokopje të noterizuara).

14. Ministri i Arsimit dhe Shkencës cakton një grup pune, të përbërë nga punonjës të MASH-it: një inxhinier, një specialist i arsimit të lartë dhe një specialist i AAAL-së, për verifikimin e mjediseve të ndërtesave dhe laboratorëve të ndryshëm, nëse plotësojnë standardet dhe angazhimet e marra. Mjediset (godina/at) duhet të jenë të gatshme për fillimin e vitit akademik, të jenë pajisur me bazë materiale dhe didaktike, në përshtatje dhe përputhje me programin/et e studimit. Grupi i punës përgatit një relacion lidhur me verifikimin e kryer, i cili i bashkëlidhet dokumenteve, të përcaktuara në pikën 9. Dokumentet e pikës 9 dhe të pikës 10 i bashkëlidhen dosjes.

15. Komisioni i veçantë shqyrton dhe vlerëson të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe i propozon Ministrin:

- a) lejimin e fillimit të vitit akademik;
- b) moslejimin e fillimit të vitit akademik;
- c) fillimin e një ose disa prej programeve të studimit të kërkuara.

16. Subjekti juridik mund të fillojë veprimtarinë mësimore vetëm pas lejimit të fillimit të vitit akademik nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në përmbushje të angazhimeve të deklaruara.

## KREU II

### KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT

Kërkesa për hapjen e programeve të reja të studimit duhet të shoqërohet me këto dokumente:

1. Fotokopje të licencës së dhënë për fillimin e veprimtarisë dhe të lejes për fillimin e vitit akademik, të dhënë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, pasi ka plotësuar angazhimet dhe standardet e premtuara.

1.1 Për subjektet që kanë filluar veprimtarinë e tyre sipas ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, fotokopje të lejes së dhënë për hapjen e institucionit.

2. Projektin konkret, i cili duhet të përmbajë:

a) të dhëna për burimet financiare, shoqëruar me dokument bankar që shpreh vlerën e burimeve financiare që subjekti juridik zotëron, burimet materiale dhe informatike, të nevojshme për programet e reja të studimit. Këto të dhëna të shoqërohen nga deklaratat analitike për tatimin mbi të ardhurat dhe deklaratat e tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera, sipas formularëve të përcaktuar në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 të Ministrisë së Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar:

- a) deklaratat analitike për tatimin mbi të ardhurat;
- b) deklaratat e tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera;
- c) deklaratat vjetore e tatimit mbi fitimin;
- d) deklaratat e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi;

b) planet mësimore për programet e studimit, programet e lëndëve/moduleve të shoqëruara me syllabuset përkatëse, nivelet dhe emërtimet e diplomave në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007



“Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. I gjithë dokumentacioni i kësaj pike të jetë në dy kopje;

c) dokument zyrtar bashkëpunimi në rastet kur institucioni parashikon të ofrojë programe studimi të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaj, si dhe dokument zyrtar të akreditimit të tyre në vendin e origjinës, nëse ka;

d) të dhëna për personelin akademik të nevojshëm dhe kriteret e punësimit të tyre;

e) subjekti duhet të deklarojë se do të plotësojë standardet akademike, sipas përcaktimeve përkatëse në shtojcën nr.1, bashkëlidhur udhëzimit dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

f) të dhëna për ambientet arsimore, ku do të zhvillohen programet e reja të studimit, sipas kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

g) curriculum vitae e administratorit të shoqërisë.

3. Kërkesa, së bashku me projektin (praktika) depozitohet/n në Drejtorinë për Shërbimet Juridike, e cila verifikon brenda dy javëve, nëse dosja është plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të kreut II. Drejtoria për Shërbimet Juridike, kur praktika rezulton me mangësi, i kërkon subjektit, që, brenda një muaji t’i plotësojë ato. Për efekt të llogaritjes së afateve, data e plotësimit të praktikës do të konsiderohet si datë e paraqitjes së kërkesës. Kur praktika nuk plotësohet brenda këtij afati, kërkesa nuk pranohet.

3.1 Në rast deklarimi të rremë, subjekti aplikues i nënshtrohet masave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Kontrolli lidhur me vërtetësinë e informacionit të deklaruar sipas pikave të këtij udhëzimi ndërmerret nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

4. Drejtoria e Shërbimeve Juridike dërgon brenda tri javëve, kur dokumentacioni është i plotë, një kopje të dokumentacionit të pikës 2(b) të kreut II të udhëzimit, tek Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), e cila e shqyrton dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 44 dhe neneve në vijim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, jep vlerësimin e vet. Për kryerjen e këtij procesi APAAL angazhon edhe ekspertë të jashtëm sipas programeve të studimit që do të vlerësohen. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) vlerëson vetëm dokumentacionin e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. AAAL, brenda 6 javëve, shprehet me shkrim, për programin/et e studimit të paraqitur, nëse nuk shprehet brenda këtij afati, vlerësimi për programet bëhet nga Komisioni i veçantë i krijuar sipas pikës 9 të kreut I të këtij udhëzimi.

6. Vlerësimi me shkrim i AAAL-së bashkëlidhet me praktikën, e cila i kthehet Drejtorisë për Shërbimet Juridike, për vijimin e procedurave të mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

7. Drejtoria për Shërbimet Juridike i përcjell brenda një jave dosjen e plotësuar me vlerësimin e AAAL-së komisionit të veçantë, i krijuar sipas pikës 9 të kreut I të këtij udhëzimi, i cili brenda një muaji, nga data e vënies në dispozicion, shqyrton projektin e paraqitur. Gjatë shqyrtimit të projektit, komisioni mund të kërkojë të dhëna ose dokumentacion shtesë për projektin e paraqitur dhe/ose mund të thërrasë subjektin kërkues për të prezantuar, ose për të dhënë shpjegime për projektin. Kur komisioni ka kërkuar të dhëna ose dokumentacion shtesë, brenda 10 ditëve nga plotësimi i tyre, rishqyrton projektin e plotësuar. Komisioni mund ta shqyrtojë një kërkesë deri në dy herë, në mbledhjet e radhës. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni merr vendim për projektin e paraqitur.

8. Kur komisioni është shprehur pozitivisht për projektin, praktika përcillet te Ministri, i cili, brenda 30 ditëve vendos për dërgimin ose jo në Këshillin e Ministrave të projektvendimit për hapjen e programit/ve të studimit, sipas nenit 44 të ligjit nr.9471, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Dhënia e lejes për hapjen e programit/ve të studimit bëhet efektive për vitin akademik që fillon, pas datës së vendimit të Këshillit të Ministrave. Subjekti juridik, së paku dy javë para fillimit të vitit akademik duhet të ketë plotësuar angazhimet që kushtëzojnë fillimin e veprimtarisë. Për fillimin e veprimtarisë në programet e studimit të miratuara, subjekti juridik i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në pikat 11, 12, 13 dhe 14 të kreut I të këtij udhëzimi.

9. Kur komisioni shprehet negativisht për projektin, një kopje e vendimit me shkrim, i jepet kërkuesit, i cili ka të drejtë të parashtojë objeksionet e veta. Kërkesa, së bashku me praktikën,

vendimin me shkrim të komisionit dhe objeksionet e kërkuarit shqyrtohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, i cili brenda 15 ditëve, vendos kthimin për rishqyrtim ose refuzimin përfundimtar të kërkesës. Kërkesa e refuzuar, së bashku me praktikën e plotë arkivohen në protokollin e Ministrisë.

## KREU II/1

### PROCEDURAT PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË PROGRAMIT/VE TË STUDIMIT SIPAS KËRKESËS SË BËRË NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË

*(Shtuar Kreu II/1 me udhëzimin nr.29, datë 28.7.2008, pika 15)*

1. Kërkesa së bashku me programin/et e ndryshuar, sjellë nga institucioni privat i arsimit të lartë depozitohet/n në Drejtorinë për shërbimet juridike, e cila brenda dy javëve e dërgon tek Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), e cila, e shqyrton dhe, në mbështetje të pikës 4 të nenit 44 dhe neneve në vijim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, jep vlerësimin e vet, për programin/et e studimit të ndryshuar. Për kryerjen e këtij procesi APAAL angazhon edhe ekspertët të jashtëm sipas programeve të studimit që do të vlerësohen.

2. APAAL brenda gjashtë javëve, shprehet me shkrim, për programin/et e studimit të ndryshuar, nëse nuk shprehet brenda këtij afati, vlerësimi për programin/et e ndryshuar bëhet nga komisioni i veçantë i krijuar sipas pikës 9 të kreut I të këtij udhëzimi.

3. Vlerësimi me shkrim i APAAL-së bashkëlidhet me programin/et e ndryshuar dhe i kthehen Drejtorisë për Shërbimet Juridike, për vijimin e procedurave të mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

4. Drejtoria për Shërbimet Juridike përcjell vlerësimin me shkrim dhe programin/et e ndryshuar te komisioni i veçantë, i krijuar sipas pikës 9 të kreut I të këtij udhëzimi, i cili në mbledhjen e radhës, shqyrton programin/et e paraqitur. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni merr vendim për programin/et e paraqitur.

5. Kur komisioni është shprehur pozitivisht për programin e ndryshuar, praktika përcillet te ministri, i cili vendos për miratimin ose jo të tij.

6. Kur komisioni shprehet negativisht për programin e studimit/ve të ndryshuar, një kopje e vendimit me shkrim, i jepet kërkuarit, i cili ka të drejtë të parashtrijë objeksionet e veta. Kërkesa, së bashku me programin/et e ndryshuar, vendimin me shkrim të komisionit dhe objeksionet e kërkuarit shqyrtohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, i cili brenda 15 ditëve, vendos kthimin për rishqyrtim ose refuzimin përfundimtar të kërkesës. Kërkesa e refuzuar, së bashku me programin/et e ndryshuar arkivohen në protokollin e ministrisë. Arkivimi i dokumentacionit në protokollin e ministrisë ndodh edhe në rastin e miratimit të programit/ve.

## KREU III

### DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA LICENCIMI I INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË

1. Institucionet private të arsimit të lartë ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij. Ato funksionojnë me të njëjtat rregulla, të përcaktuara për institucionet homologe, publike, të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.

2. Subjekti juridik është përgjegjës për gjithë veprimtarinë, administrimin dhe financimin e institucionit, të licencuar. Ai duhet të informojë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për:

a) çdo ndryshim adrese të vendndodhjes së qendrës së subjektit juridik. Për ndryshimin e vendndodhjes së mjediseve mësimore paraqet kërkesë për miratim;

b) çdo ndryshim apo devijim të programeve lëndore;

c) të paraqesë çdo fillim viti tarifave për pranimet në secilin program studimi, si dhe gjendjen e llogarisë bankare të shoqërisë;

d) çdo fillim viti, paraqet listën e plotë të personelit akademik, ku të jenë të specifikuar titujt akademikë apo gradat shkencore për secilin, lëndët të cilët ata mbulojnë, si dhe forma e punësimit të tyre në institucion;

e) çdo fundviti, ecurinë e procesit mësimor të vitit akademik, në mbyllje (të dhëna statistikore lidhur me numrin e pranimeve, kalueshmërinë etj.).

3. Licenca, që i është dhënë një subjekti juridik, bëhet e pavlefshme në rastet kur institucioni privat nuk fillon veprimtarinë mësimore-shkencore, as në vitin akademik pasardhës.

4. Licenca, për fillimin e veprimtarisë së një institucioni privat, përmban detyrimin dhe garancinë, që, kur institucioni ndërpret veprimtarinë e tij, të ofrojë mjetet e nevojshme financiare, për përballimin e shpenzimeve, për përfundimin e studimeve të filluara, në institucione të tjera, për të gjithë studentët që janë të regjistruar në atë institucion, duke përballuar koston e plotë për atë vit akademik. Vetëm në rastet kur institucioni privat i arsimit të lartë mbyll aktivitetin e tij pa përfunduar ciklin e plotë të studimeve, studentët e tij, mund të vazhdojnë studimet në shkolla të larta publike. Për këtë kategori studentësh njoftohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës institucionet e arsimit të lartë publik. Studentët, të cilët transferohen nga arsimi privat në atë publik, vetëm për shkaqet e përmendura në këtë pikë, i nënshtrohen kuotave të ndërmjetme me pagesë.

5. Një institucion privat mund të ndërpresë veprimtarinë e tij vetëm në fund të vitit akademik.

6. Një institucion privat i arsimit të lartë, i licencuar, që ka organizim të programeve të studimit të ndryshëm nga ai i shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” është i detyruar ta njoftojë këtë publikisht, para fillimit të procesit të regjistrimit të studentëve.

7. Për institucionet private të arsimit të lartë, të cilat nuk respektojnë ose shkelin dispozitat e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, i propozon Këshillit të Ministrave, marrjen e masave konkrete, si pezullimin e veprimtarisë së tyre, për një periudhë deri në dy vjet, ndalimin e pranimit të studentëve të rinj, ose deri heqjen e licencës së dhënë.

8. Ministria e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjëse për standardet e veprimtarisë mësimore, kërkimore në institucionet private të arsimit të lartë. Standardet akademike, ato të infrastrukturës dhe kostot financiare në institucionet private të arsimit të lartë duhet të mos jetë nën nivelin e institucioneve publike të arsimit të lartë.

### KREU III/1

#### TARIFAT E SHËRBIMIT

*(Shtuar Kreu III/1 me udhëzimin nr.29, datë 28.7.2008, pika 18)*

1. Tarifa për aplikim, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, arkëtohet për llogari të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe paguhet pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të postës shqiptare me emërtimin “Tarifë aplikimi për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë”. Kjo pagesë është e pakthyeshme dhe përbën kusht refuzues të kërkesës në rast të kundërt.

2. Institucionet private të arsimit të lartë të licencuara me vendim të Këshillit të Ministrave u jepet leja për fillimin e veprimtarisë mësimore përkundrejt pagesës së një tarife e përbërë si më poshtë:

- a) për institucionin privat të arsimit të lartë të licencuar 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- b) për programet e reja të licencuara 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- c) Për miratimin e ndryshimit të programit/ve 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

### KREU IV

#### DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kërkesat për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë, të dorëzuara para hyrjes në fuqi të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar pozitivisht nga komisionet e vlerësimit, sipas dispozitave të ligjit nr.8461,

datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, për licencim.

2. Për subjektet juridike të licencuara sipas pikës 1, përpara dhënies së lejes për fillimin e veprimtarisë së tyre duhet që:

a) të merret vlerësimi i programeve të studimit në AAAL, të cilat do t’i nënshtrohen me përparësi, procesit të paraakreditimit, sipas nenit 25 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me kriteret e shtojcës 1, bashkëngjitur udhëzimit;

b) brenda 15 ditëve para fillimit të vitit akademik, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të bëhet verifikimi i përmbushjes së standardeve, sipas dispozitave të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe marrjen e miratimit për fillimin e vitit akademik, në vazhdim.

3. Subjektet juridike, të cilat kanë marrë miratimin, për fillimin e vitit akademik, do t’i nënshtrohen ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi, si dhe dispozitave të këtij udhëzimi.

Kërkesa së bashku me praktikën e plotë të këtyre subjekteve arkivohen në protokollin e ministrisë.

4. Kërkesat për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë, të dorëzuara para hyrjes në fuqi të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të cilat nuk janë shqyrtuar ose vlerësuar nga komisioni i veçantë, do të shqyrtohen me prioritet, sipas kriterëve dhe procedurave, të përcaktuara në këtë udhëzim. Afati i fillimit të procedurave do të llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

5. Kërkesat për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë, kërkesat për hapjen e programeve të reja të studimit dhe kërkesat për ndryshimin e programeve, të dorëzuara para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të shqyrtohen në bazë të kërkesave të parashikuara nga udhëzimi nr.30, datë 26.9.2007, i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Genc Pollo

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.131, datë 3.10.2007, faqe 3650*

*Udhëzim nr.29, datë 28.7.2008, botuar në Fletoren Zyrtare nr.129, datë 5.8.2008, faqe 5709*

*Udhëzim nr.24, datë 2.9.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.141, datë 2.10.2009, faqe 6414*

*Udhëzim nr.36, datë 9.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9769*

**SHTOJCA NR.1 E UDHËZIMIT PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, NË CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE**

A) Një institucion i arsimit të lartë që kërkon të licencohet apo të hapë programe të reja studimi, duhet të plotësojë këto standarde të organizimit dhe personelit:

1. Një institucion privat i arsimit të lartë organizohet në njësi përbërëse kryesore: fakultete, njësi kërkimi e zhvillimi apo kolegje e filiale; njësi bazë: departamente e qendra kërkimi, njësi ndihmëse: laboratorë, qendra eksperimentale, biblioteka dhe njësi shërbimi, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë duke respektuar kategorizimin e institucionit.

Institucioni duhet të ketë të paktën dy fakultete, ku secili mund të ofrojë programe studimi të llojeve dhe niveleve të ndryshme.

Çdo fakultet duhet të ketë të paktën tre njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive.

2. Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre duhet të jenë me gradë shkencore dhe/apo titull akademik.

2.1. Institucionet private të arsimit të lartë që fillojnë aktivitetin e tyre dhe që janë në vitin e parë të studimeve, duhet të propozojnë një personel akademik të mjaftueshëm për të paktën vitin e

parë të studimeve, por ata mbartin detyrimin që të raportojnë e miratojnë çdo vit në MASH personelin e ri që rekrutojnë për vitet shkollore në vijim, deri në plotësimin e tij në përputhje me kriteret e pikës 2.

3. Një institucion privat i huaj i arsimit të lartë apo filial i tij, që zotëron një formë akreditimi në një shtet tjetër, mund të ketë organizim tjetër strukturor nga ai i pikës 1.

4. Raporti personel akademik/student duhet të jetë rreth 1:20.

5. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë rreth 2/3 të ngarkesës mësimore për çdo program studimi.

6. Rektori dhe dekanët duhet të jenë personel akademik i institucionit.

7. Institucioni duhet të parashikojë ngritjen dhe funksionimin në mënyrë demokratike të organeve kolegjiale për vendimmarrjen akademike që lidhet me çështjet e programeve të studimit, kriteret e pranimit të studentëve etj.

8. Institucioni duhet të ketë personel ndihmës akademik, personel administrativ dhe shërbimi në masën nga 20-30% në raport me personelin akademik dhe në raport me numrin e studentëve.

9. Institucioni duhet të ketë mjedise mësimore të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturë, fasilite dhe mjete audiovizive mësimdhënëse bashkëkohore.

10. Programet e studimit të paraqitura në projektin e licencimit duhet të plotësojnë kriteret e paraqitura në kreun B dhe C të këtij aneksi.

B) Një institucion privat i licencuar i arsimit të lartë, që kërkon hapjen e programeve të reja të studimit të ciklit të parë, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Të përcaktojë qartë emërtimin dhe formën e studimit për çdo program studimi që kërkon;

2. Programet e studimit të propozuara duhet të organizohen në module dhe të vlerësohen në kreditë; sipas sistemit europian ECTS; në ato raste kur institucioni operon sipas një sistemi tjetër kreditimi, duhet të qartësojë ekuivalentimin e këtij sistemi në atë ECTS;

3. Programet e studimit të ciklit të parë, të hartuara sipas ligjit, për arsimin e lartë, zgjasin:

i) tri vite studimi dhe realizohen me së paku 180 kreditë, kur janë programe universitare;

ii) dy vite studimi dhe realizohen me së paku 120 kreditë, kur janë programe jouniversitare.

Kur punohet me modele të tjera, subjekti kërkues duhet të paraqesë ekuivalentimet përkatëse.

4. Planet mësimore për çdo program studimi duhet të parashikojnë modulet dhe lëndët përkatëse, ngarkesën mësimore për çdo modul/lëndë në auditor dhe jashtë auditorit, format e mësimdhënies, si leksion, ushtrime, seminare, laborator, projekt dhe raportet midis tyre sipas natyrës së programit, ngarkesën në kredite për çdo modul/lëndë dhe syllabusin e çdo lënde;

5. Njësinë akademike dhe personelin akademik përgjegjës për çdo program studimi të propozuar, si dhe lëndët që parashikohet të mbulojë çdo anëtar i personelit akademik;

6.1 kredit ECTS duhet të barazohet me rreth 25 orë mësimore gjithsej, nga të cilat rreth 10-12 orë mësimore në auditor dhe pjesa tjetër për studim individual;

7. Në përfundim të programeve të ciklit të parë, duhet të lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP);

8. Institucioni duhet të paraqesë emërtimin dhe modelin e diplomës që parashikon të lëshojë në fund të programit të studimit;

9. Diploma duhet të shoqërohet me suplementin e diplomës së përgatitur, sipas standardeve europiane;

10. Në statutin dhe rregulloret e institucionit duhet të paraqiten kushtet dhe kriteret e pranimit dhe/ose të përzgjedhjes (nëse ka) në çdo program studimi, metodat dhe format e vlerësimit të studentëve, si dhe kushtet, kriteret e procedurat për lëvizjen nga një program në tjetrin dhe të transferimit;

11. Në rastet e programeve të studimit, ndërdisiplinore apo të përbashkëta të tregohen institucionet bashkëpunuese dhe emërtimi i diplomës;

12. Në rastet e programeve të studimit për formim të vazhduar të paraqitet forma e organizimit, kushtet dhe kriteret e pranimit dhe lloji e modeli i certifikatës që do të lëshohet.

C) Një institucion i arsimit të lartë privat, që kërkon hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Të përcaktojë qartë emërtimin dhe formën e studimit për çdo program studimi që kërkon;
2. Programet e studimit të propozuara duhet të organizohen në module dhe të vlerësohen në kredite, sipas sistemit evropian ECTS; në ato raste kur një institucion operon sipas një sistemi tjetër, duhet të qartësojë ekuivalentimin e këtij sistemi në atë ECTS;
3. Programet e studimit të ciklit të dytë zgjasin përkatësisht:
  - i) 2 vite akademike (120 kredite) për programet e studimit të ciklit të dytë, në fund të së cilës lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND);
  - ii) 1 vit akademik (60 kredite) për programet e studimeve “Master i nivelit të parë”, në fund të së cilës lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP);
  - iii) 5 vite akademike (300 kredite) duke përfshirë dhe studimet e ciklit të parë, për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në fund të së cilës lëshohet diplomë e integruar e nivelit të dytë (DIND);
4. Planet mësimore për çdo program studimi duhet të parashikojnë modulet dhe lëndët përkatëse, ngarkesën mësimore për çdo modul/lëndë në auditor dhe jashtë auditorit, format e mësimdhënies, si: leksion, ushtrime, seminare, laborator, projekt dhe raportet midis tyre, sipas natyrës së programit, ngarkesën në kredite për çdo modul/lëndë dhe syllabusin e çdo lënde;
5. Njësinë akademike dhe personelin akademik përgjegjës për çdo program studimi të propozuar, si dhe lëndët që parashikohet të mbulojë çdo anëtar i personelit akademik;
6. Përgjegjësit e çdo lënde/moduli, të cilët duhet të kenë së paku gradën shkencore “Doktor”;
7. Institucioni duhet të ketë kriteret përzgjedhjeje për studentët që do të pranohen në programet e studimit të ciklit të dytë, të cilat bëhen publike;
8. Në statutin dhe rregulloret e institucionit duhet të paraqiten kriteret e pranimit, si programet e studimit që duhet të kenë përfunduar studentët për t’u pranuar në çdo program studimi të ciklit të dytë që ofrohet, metodat dhe format e vlerësimit të studentëve, si dhe kushtet, kriteret e procedurat për lëvizjen nga një program në tjetrin dhe të transferimit;
9. Në rastet e programeve të studimit, ndërdisiplinore apo të përbashkëta, të tregohen institucionet bashkëpunuese;
10. Për programet e studimeve të ciklit të dytë DND, institucioni kërkues duhet të zotërojë burime materiale (laboratorë, mjedise të posaçme, teknologji, literaturë) për të kryer formim të avancuar të studentëve, në funksion të programeve të kërkuara, si dhe personel akademik të mjaftueshëm e të specializuar në fushën përkatëse;
11. Për programet e studimeve të ciklit të dytë MNP, institucioni duhet të zotërojë burime materiale (laboratorë, mjedise të posaçme, teknologji), personel akademik të mjaftueshëm e të specializuar, si dhe mundësi për studentët për të kryer praktikën pranë institucioneve publike apo private në varësi të programeve të kërkuara;
12. Personeli akademik i angazhuar në programet e studimit të ciklit të dytë duhet të ketë gradë shkencore apo/dhe tituj akademikë; të paktën 50% e personelit akademik përgjegjës për programin e kërkuar, duhet të jetë i punësuar efektiv në institucion, me përjashtim të rasteve kur programet e studimit ofrohen në bashkëpunim zyrtar me institucionet apo filialet e një institucioni të huaj të arsimit të lartë;
13. Raporti personel akademik (i brendshëm + i jashtëm) student duhet të jetë rreth 1:20;
14. Institucioni duhet të paraqesë emërtimin dhe modelin e diplomës që parashikon të lëshojë në fund të kursit të studimit për çdo program studimi;
15. Diploma duhet të shoqërohet me suplementin e diplomës së përgatitur, sipas udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, nr.12, datë 14.5.2007 “Për akordimin e “Shtojcës së diplomës” (Suplementit të diplomës) nga të gjitha shkollat e larta”.

**SHTOJCA NR. 2 E UDHËZIMIT PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE  
DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E NJË  
INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, NË  
CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE**

Standarde (minimale) dhe normativa për infrastrukturën e institucioneve private të arsimit të lartë

Standardet normative për objektet që do të funksionojnë si institucione private të arsimit të lartë, do të jenë:

1. Objektet e arsimit të lartë privat duhet të jenë objekte të ndërtuara (ose të rikonstruata) me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin (rikonstruksionin) e objektit, nuk duhet të kenë në përbërjen e tyre elemente të dëmshme për shëndetin e studentëve dhe personelit. Materialet dhe teknologjia e punimeve, duhet të sigurojnë akustikë të mirë në ambientet e mësimit dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave, luhatjeve të temperaturës dhe lagështirës.

2. Objektet e arsimit të lartë privat, duhet të jenë të vendosura larg zonave të zhvillimit industrial, varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara, sipas standardeve përkatëse.

3. Objektet që do të përdoren për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë detyrimisht duhet të përmbajnë minimalisht ambientet, sipas natyrës dhe funksionit si më poshtë:

- a) Auditorë mësimi;
- b) Ambiente për laboratorë;
- c) Ambiente për personelin pedagogjik;
- d) Ambiente për personelin administrativ;
- e) Ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, kompjuterësh, multimedia etj. të kësaj natyre;

f) Ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit të godinës, si: kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike etj.), oborr dhe ambiente të gjelbëruara.

4. Objektet që do të ofrohen për institucionet e arsimit të lartë privat, detyrimisht duhet të plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme (për ambientet e përshkruara në pikën 3) prej 3.8–4.0 m<sup>2</sup>/student (minimumi) dhe 7.5–8.0 m<sup>2</sup>/student (maksimumi). Lartësia e ambienteve duhet të jetë jo më e vogël se 3.0 m (tavan–dyshe). Normativa minimale e mësipërme, do të pranohet për programe studimi të tilla, si: gjuhë, letërsi, sociologji, histori, gjeografi, shkencat ekonomike, juridik, matematikë, arkeologji etj. (të kësaj natyre, përgjithësisht për shkencat shoqërore e politike), kurse për programe studimi, si: arkitekturë, muzikë etj. (të kësaj natyre) do të pranohen normativa jo më pak se niveli mesatar më sipër. Për programe studimi inxhinierike apo të shkencave të natyrës (fizikë, kimi, biologji etj.) normativat e mësipërme minimalisht do të dyfishohen (minimumi dhe maksimumi). Në këto normativa nuk parashikohen sipërfaqet e nevojshme për ambientet kërkimore e shkencore.

5. Nyjet hidrosanitare duhet të parashikohen 1 boks dhe lavaman për 35-40 djem, 1 boks dhe lavaman për 30 vajza, si edhe 1 boks dhe lavaman për administratën, mundësisht edhe ujë të ngrohtë.

6. Në ambientet e mësimit, objekti duhet të plotësojë normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve duhet të mbulojë minimalisht (15–20)% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë i orientuar nga krahu i majtë i studentit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi duhet të realizohet nga dritare (rekomandohet me dopio xham) të tejdukshme.

7. Numri i studentëve në grupet e seminareve dhe ushtrimeve do të jetë 20–25 studentë (maksimumi 30 studentë), grupi i studentëve për laboratorë 12-15 studentë, për leksionet jo më pak se 80 studentë dhe për praktikat e stazhit jo më pak se 15 studentë.

8. Objektet e arsimit të lartë privat me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të jenë të pajisura me dalje dhe shkallë emergjence.

9. Të gjitha objektet që do të shërbejnë si institucione private të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit ose të jenë të kompletuara (sipas normativave

përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundër zjarrit, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

10. Institucionet private të arsimit të lartë duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë shëndetësore (ose ambient) dhe mjetet e pajisjet e nevojshme për këtë qëllim.

11. Objektet private të arsimit të lartë duhet të kenë të garantuara burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogenerator etj.), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (depozita uji).

12. Ambientet e mësim, detyrimisht duhet të jenë të kompletuara dhe të funksionojë sistemi i ngrohjes.

Datë \_\_\_\_\_

### AUTODEKLARIM

Drejtuar: Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_\_\_ deklaroj që jam banues në \_\_\_\_\_, adresë \_\_\_\_\_ me sili \_\_\_\_\_, tel \_\_\_\_\_, cel \_\_\_\_\_, dhe me dokument identifikimi/ nr. i pasaportës \_\_\_\_\_.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Jam i regjistruar me vendim gjykatë si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit privat, me nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.

2. Kam vërtetim pronësie nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_/deklaroj për sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor.

3. Nuk jam në proces gjykimi, hetimi apo të jem i dënuar në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Emër Mbiemër  
Firmë

### UDHËZIM

Nr.4, datë 22.1.2008

### PËR HAPJEN, MBYLLJEN DHE RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER TË NIVELIT TË PARË DHE TË DYTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

### UDHËZOJ:

1.Institucionet e arsimit të lartë, nxisin e promovojnë programe studimi të formimit profesional të vazhdueshëm e të perfeksionimit shkencor, në përfundim të të cilave jepen diplomat e studimeve “Master i Nivelit të Parë” (MNP) dhe “Master i Nivelit të Dytë” (MND), sipas përcaktimeve respektivisht në pikat 1.2.3 dhe 1.3.4 të nenit 26 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në programet e studimit “Master i Nivelit të Parë” mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë diplomë të nivelit të parë, diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë apo diplomë sipas sistemit të vjetër, të pandarë në cikle studimi.



Në programet e studimit “Master i Nivelit të Dytë” mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë apo diplomë sipas sistemit të vjetër, të pandarë në cikle studimi.

2. Programet e studimit “Master” realizohen nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme formuese në auditor, trajnim, praktikës apo stazhit, në përputhje me objektivat e programit, si dhe studimit e përgatitjes individuale të studentëve. Numri minimal i krediteve për këto programe studimi nuk mund të jetë më i vogël se 60 kredite apo 1500 orë punë të studentit, të shpërndara në jo më pak se një vit akademik.

a) Programet e studimit Master mund të zhvillohen dhe me kohë të pjeshme dhe në këtë rast ato shtrihen në dy vite akademike.

3. Frekuentimi nga studentët i aktiviteteve të ndryshme formuese është i detyrueshëm. Në çdo rast, për marrjen e titullit të studimit, frekuentimi duhet të jetë të paktën në masën 80% të aktiviteteve mësimore në auditor.

4. Në përfundim të programeve të studimeve “Master” parashikohet realizimi i një prove finale (mikrotezë, testim) që të vërtetojë fitimin e kompetencave profesionale apo njohurive të parashikuara.

5. Në programet e studimit “Master” pranohen vetëm ata persona të cilët plotësojnë kriteret akademike të përcaktuara nga institucioni, bazuar në ligjin për arsimin e lartë, i ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Kriteret përzgjedhëse bëhen publike.

6. Institucionet e arsimit të lartë, kërkesën e tyre për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit “Master” e shoqërojnë me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Objektivat e programit, kompetencat profesionale që synohet të arrihen në përfundim të tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi;

b) Kriteret e pranimit të studentëve;

c) Procedurat e pranimit të studentëve dhe të njohjes së krediteve universitare të fituara më parë prej tyre;

d) Kohëzgjatja e programit dhe struktura që e ofron;

e) Numri minimal dhe maksimal i pjesëmarrësve në program;

f) Frekuenca në aktivitetet e ndryshme formuese (leksione, seminare, laboratorë, praktika etj.);

g) Plani mësimor i programit, i detajuar në të gjitha aktivitetet formuese, shoqëruar me kreditet përkatëse. Numri minimal i krediteve për këto programe studimi nuk mund të jetë më i vogël se 60 kredite;

h) Personeli akademik që do të angazhohet për realizimin e programit të studimit, shoqëruar me të dhënat e nevojshme;

i) Komiteti Shkencor dhe koordinatori i programit, përcaktuar më poshtë në pikën 9;

j) Struktura akademike përgjegjëse për menaxhimin administrativ dhe financiar të programit, si dhe të karrierës së studentëve;

k) Tarifa për çdo student dhe mënyra dhe afatet e pagesës së saj;

l) Rregullorja e programit të studimit;

m) Modeli i diplomës. Për programet e studimit “Master i Nivelit të Dytë” (MND), bazuar në pikën 2 të nenit 31 të ligjit për arsimin e lartë, i ndryshuar, të paraqitet dhe modeli i suplementit të diplomës.

Kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm për hapjen apo riorganizimin e programeve të studimeve “Master”, të shoqërohet dhe me një përmbledhje sipas modeleve bashkëlidhur në shtojcat 1 dhe 2.

7. Për programet e studimit “Master” në fushat e mjekësisë duhet të paraqitet dhe marrëveshja me strukturat spitalore publike apo private, ku do të zhvillohen aktivitete formuese klinike, diagnostikuese dhe të njohjes së teknikave e instrumenteve specifike, të parashikuara në program.

8. Propozimet për hapjen, mbylljen apo riorganizimin e programeve të studimeve “Master” bëhen nga një apo më shumë njësi kryesore, njësi bazë apo dhe anëtarë të personelit akademik, kur disponohen burime të përshtatshme njerëzore dhe të infrastrukturës. Këto propozime shqyrtohen për

plotësimin e standardeve akademike në këshillin e njësisë kryesore përkatëse dhe në Senatin Akademik të institucionit.

9. Përgjegjësia organizative për programet “Master” është e një Komiteti Shkencor për çdo program, të përbërë nga jo më pak se tre anëtarë të personelit akademik. Komiteti Shkencor i programit të studimit “Master”, caktohet nga njësi bazë ose edhe vetinicohet. Ky Komitet Shkencor përcakton nga ana e tij personelin tjetër akademik e ndihmës, me të cilin do të bashkëpunojë për realizimn e programit të studimit.

10. Komiteti Shkencor zgjedh nga përbërja e tij koordinatorin e programit.

11. Hapja dhe mbyllja e programeve të studimeve “Master” bëhet sipas përcaktimeve të nenit 42 të ligjit për arsimin e lartë, i ndryshuar.

12. Programet e studimit “Master” disiplinohen me rregulloret përkatëse të programit.

13. Kërkesat e institucioneve të arsimit të lartë për hapjen dhe mbylljen e programeve të studimeve “Master i Nivelit të Parë” (MNP) dhe “Master i Nivelit të Dytë” (MND), duhet të paraqiten në MASH brenda datës 15 mars të çdo viti.

14. Programet e studimit “Master” vetëfinancohen me tarifat e shkollimit të studentëve të regjistruar në këto programe. Sidoqoftë ato mund të shfrytëzojnë dhe financime nga subjekte bashkëpunuese për programin, si dhe burime të siguruara nga njësi/njësitë kryesore propozuese apo institucioni.

15. Organizimi dhe drejtimi i programeve “Master”, si dhe aktiviteti mësimor i zhvilluar nga personeli akademik në këto programe, vlerësohen me orë mësimore.

16. Rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në programet e studimit “Master” vlerësohen çdo vit, në përfundim të tij, sipas modaliteteve të përcaktuara nga njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Ky vlerësim shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit në vitin e ardhshëm.

17. Asnjë nga programet e studimit “Master” të nivelit të parë apo të dytë, nuk mund të ekuivalentohet me ndonjë diplomë të nivelit të dytë.

18. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, datë 30.1.2008, faqe 202*

**SHTOJCA 1****PROPOZIM PËR HAPJEN / RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË  
STUDIMIT MASTER****“Emërtimi i programit të studimit Master”**

<b>NIVELI I MASTER-IT</b> (seleksiononi nivelin e Master-it)	<b>SASIA E KREDITEVE</b> (minimumi 60 kredite)
<input type="checkbox"/> NIVELI I	
<input type="checkbox"/> NIVELI II	
Vendimi i Senatit Akademik për hapjen e programit Master (Numri i vendimit dhe data)	
Fillon më:	
Përfundon më	

<b>MASTER I BRENDSHËM APO I JASHTËM PËR INSTITUCIONIN</b>
<input type="checkbox"/> Master i brendshëm (organizuar nga institucioni)
<input type="checkbox"/> Master i jashtëm (organizuar nga një institucion tjetër)

<b>STRUKTURA PROPOZUESE DHE STRUKTURAT E TJERA</b>	
Fakulteti apo një strukturë tjetër didaktike	
Struktura të tjera bashkëpunuese	
Institucione të huaja të arsimit të lartë ose Qendra të huaja kërkimore	

<b>GJUHA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT MASTER</b>	
<input type="checkbox"/> Shqip	
<input type="checkbox"/> Në gjuhën:	.....



KOMITETI SHKENCOR				
Personeli akademik	Grada shkencore apo titulli akademik	Struktura së cilës i përket	Detyra	Spektori mësimor-kërkimor

**Koordinatori i programit Master :**  
(i zgjedhur nga Komiteti Shkencor )

PLANI MËSIMOR						
Titulli i aktivitetit	Personeli akademik	Spektori mësimor-kërkimor	Kreditet	Struktura e krediteve		
				Nr. orë për leksione në auditor	Nr. orë për aktivitete të tjera mësimore	Nr. orë për studim individual
<b>TOTALI</b>						

Stazh apo praktikë profesionale	Kreditet	Nr. orë

Prova finale	Kreditet	Nr. orë

<b>TOTALI</b>	Totali i krediteve	<b>Totali i orëve</b> (nr. orë leksioni në auditor + nr. orë për aktivitete të tjera mësimore + nr. orë për studim individual + nr. orë stazh apo praktikë profesionale + nr. orë prova finale)

FORMA E STUDIMIT
<input type="checkbox"/> studime me kohë të plotë
<input type="checkbox"/> studime me kohë të pjesshme
<input type="checkbox"/> studime në distancë



ministria e arsimit dhe shkencës  
ministria e së nesërmes  
www.mash.gov.al

Udhëzim për programet e studimit Master Faqe 6 nga 8

<b>AMBIENTI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE I STRUKTURËS MENAXHUESE</b>	
Ambienti i zhvillimit të aktivitetit mësimor të Master-it	
Struktura përgjegjëse për menaxhimin administrativ e financiar të Master-it	
Struktura përgjegjëse për menaxhimin e karrierës së studentëve të Master-it	

<b>KRITERET E PRANIMIT</b>			
Numri minimal i studentëve		Numri maksimal i studentëve	
Titujt e studimit që duhen patur për pranim	<input type="checkbox"/> Diplomë e sistemit të vjetër		
	<input type="checkbox"/> Diplomë e Nivelit I		
	<input type="checkbox"/> Diplomë e Nivelit II		
	<input type="checkbox"/> Titull tjetër studimi		
Kriter tjetër	.....		

<b>PËRSHKRIM I SHKURTËR I OBJEKTIVAVE FORMUES TË PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER</b>
.....

<b>PROFILI PROFESIONAL DHE SEKTORËT E PUNËSIMIT RESPEKTIV</b>
.....

<b>INFORMACION PËR KOMUNIKIMIN ME PERSONELIN E CAKTUAR PËR PROGRAMIN MASTER</b>				
Emër - Mbiemër	Detyra	Telefon	Fax	E-mail



## **SHTOJCA 2**

### **PLANI FINANCIAR**

Institucionet publike të Arsimit të Lartë duhet të paraqisin planin financiar sipas tabelave më poshtë.

<b>FINANCIME (Hyrjet)</b>			
Nr.i studentëve		Tarifa e regjistrimit	
Financime të jashtme			
Financime të tjera			
<b>TOTALI:</b>			

<b>KOSTOT E MENAXHIMIT (Daljet)</b>			
			<b>TOTALI</b>
Nr.i studentëve		Tarifa e shkollimit për çdo student	
Shpërblimi për organizimin e programit dhe drejtimin e tij			
Shpërblimi për orët mësimore të personelit akademik			
Materiale didaktike, bibliografike, etj			
Blerje materialesh të inventarizueshme			
Shpenzime për promovimin e programit			
Shpenzime të tjera			

<b>BURSA STUDIMI TË PARASHIKUARA</b>		
Nr. i Bursave të parashikuara të studimit	Vlera e bursës	Enti që e ofron bursën

**UDHËZIM**  
**Nr.5, datë 22.1.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE AKADEMIKE TË NEVOJSHME PËR HAPJEN,  
MBYLLJEN DHE RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË  
DOKTORATËS, SI DHE TË ELEMENTEVE BAZË SIPAS TË CILAVE INSTITUCIONET E  
ARSIMIT TË LARTË DUHET TË PËRGATISIN RREGULLOREN PËRKATËSE**  
*(Ndryshuar me udhëzim të KM nr.20, datë 29.7.2009)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, dhe vendimit nr.467, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik”,

**UDHËZOJ:**

1. Programet e studimit të doktoratës, përcaktuar në pikën 1.3.1 të nenit 26 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përbëjnë nivelin e tretë të formimit universitar, në përfundim të të cilit jepet diploma për gradën shkencore “Doktor”.

2. Programet e studimit të doktoratës zhvillohen në universitete, akademi apo qendra ndëruniversitare (më poshtë do të përdoret vetëm termi universitete), sipas listës së përcaktuar në pikën 1.3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 18.7.2007 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin shkencor e pedagogjik të personelit akademik”.

3. Programet e studimit të doktoratës organizohen si rregull brenda një projekti të madh kërkimor-didaktik e kulturor dhe realizohen në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të aktiviteteve të kërkimit të njësisë apo institucionit përkatës.

4. Programet e studimit të doktoratës mund të jenë edhe ndërdisiplinore ose të përbashkëta.

5. Objektivat formues të programeve të studimit të doktoratës duhet të jenë të gjera, të motivuara dhe të lidhura me orientimet shkencore në fushën e zgjedhur apo në fushat e zgjedhura në rastin e doktoratave dy a më shumë disiplinore.

6. Programet e studimit të doktoratës përmbajnë aktivitete didaktike të formimit të thelluar teorik, përvetësimin të metodologjive të kërkimit dhe të teknikave operative specifike, të realizuara këto nëpërmjet moduleve mësimore, seminarëve me kualifikim të lartë, stazhit apo praktikave pranë strukturave të kualifikuara etj. Aktivitetet e mësipërme duhet të jenë të përcaktuara qartë, të lidhura me objektivat formues të programit të studimit të doktoratës dhe konkretisht të verifikueshme.

7. Programet e studimit të doktoratës përfshijnë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarur, si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës, rezultatet dhe mbrojtja e suksesshme e së cilës çojnë në fitimin e titullit “Doktor”.

8. Një njësi mund të formulojë propozimin për hapjen e programeve të studimit të doktoratës, kur plotëson standardet e mëposhtme:

a) Prani të personelit akademik me titull “Profesor”, Profesor i asociuar” ose me gradë shkencore “Doktor” fituar në universitete perëndimore dhe më së paku dy vjet eksperiencë mësimore-kërkimore postdoktorale.

b) Numër të nevojshëm të personelit akademik për të kryer udhëheqjen e çdo studenti të doktoratës në aktivitetet e kërkimit dhe detyrat respektive didaktike.

c) Struktura specifike operative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit (laboratorë, biblioteka, studime etj.).

d) Burime financiare mbështetëse.

e) Bashkëpunim me universitete të huaja apo subjekte publike e private të kërkimit që garantojnë programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe studentëve të doktoratës.

f) Modalitetet e verifikimit të veprimtarisë kërkimore apo krijuese të studentëve të doktoratës, veçanërisht lidhur me përgatitjen e tezës së doktoratës.

9. Përgjegjësia për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktoratës, sipas pikës 1 të nenit 19 të ligjit për arsimin e lartë, i ndryshuar, është e këshillit të profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse ku zhvillohen këto programe studimi.

10. Universitetet përcaktojnë me rregullore të veçantë organizimin dhe funksionimin e programeve të studimit të doktoratës, ku duhet të parashikohen:

a) Modalitetet për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës.

b) Organet përgjegjëse për menaxhimin e programit të studimit të doktoratës.

c) Kriteret e pranimit në programin e studimit të doktoratës të atyre që zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë, diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik ekuivalent të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente, brenda datës 30 shtator të vitit kur shpallet konkursi i pranimit.

d) Modalitetet për përzgjedhjen nga këshilli i profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse ku zhvillohet programi i studimit të doktoratës i kandidatëve fitues për ndjekjen e programit, bazuar në vlerësimin e kurrikulumeve personale të tyre, rezultateve dhe tipit të formimit të mëparshëm universitar të tyre, në vlerësimin e projektit të kërkimit të propozuar, rekomandimeve dhënë nga dy profesorë, njohurive të gjuhëve të huaja e sidomos të gjuhës angleze etj.

e) Modalitetet e publikimit në organe të medias së shkruar dhe në internet të kriterëve, procedurave dhe afateve për konkurset e pranimit me informacionet e tjera të nevojshme.

f) Të drejtat dhe detyrat e studentëve të doktoratës.

g) Modalitetet e përfshirjes njëkohësisht në programet e studimit të doktoratës të studentëve të regjistruar në programet e studimeve specializuese afatgjata të ciklit të tretë, sipas pikës 1.3.3 të nenit 26 të ligjit për arsimin e lartë, i ndryshuar.

h) Modalitetet e pjesëmarrjes në program të studentëve që janë në marrëdhënie pune, si p.sh. lektorë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë apo të administratës publike etj., në përqindje të caktuara, të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një frekuentim të plotë të aktiviteteve të parashikuara për doktoratën. Zgjatja e studimeve në rastet e mësipërme mund të shkojë deri në gjashtë vjet.

i) Tipologjinë e aktiviteteve formuese didaktike në programet e studimit të doktoratës, sipas përcaktimeve në pikën 6 të këtij udhëzimi në masë të tillë që të sigurohen 60 kredite.

j) Afatet e prezantimit dhe diskutimit të tezës së doktoratës, që s' duhet të kapërcejnë 4 vjet nga regjistrimi në program, përjashtuar studentët e kategorive të përcaktuara në pikën g dhe h më sipër.

k) Modalitetet për pranimin në mbrojtjen e tezës së doktoratës për marrjen e titullit, të përcaktuara nga këshilli përkatës i profesorëve, përfshirë dhe verifikimin e plotësimin të kushteve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.864, datë 5.12.2007 "Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë studenti për marrjen në përfundim të tyre të diplomës për gradën shkencore "Doktor".

l) Kushtet dhe kufijtë e angazhimit të studentëve të doktoratës si tutorë të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë e të dytë dhe në aktivitete për mbështetjen e udhëheqësit të tyre në mësimdhënie, duke respektuar dhe pikën 2 të nenit 49 të ligjit për arsimin e lartë, i ndryshuar.

m) Modalitete të sigurimit të mobilitetit të paktën tremujor të studentëve të doktoratës në universitete apo institute kërkimore të huaja.

n) Mundësitë dhe modalitetet për mbështetje financiare të studentëve të doktoratës.

o) Modalitetet e vlerësimit vjetor të rezultateve të programit, përcaktuar sipas udhëzimeve të njësisë së brendshme të sigurimit të cilësisë.

Rregullores së doktoratës t'i bashkëlidhen dhe modele të caktuara të dokumenteve për kontratat e ndryshme të bashkëpunimit, për vlerësimin vjetor të punës së bërë nga studentët e doktoratës, si dhe të tezës së doktoratës, për strukturën e hartimit të tezës së doktoratës dhe abstraktit të saj etj.

11. Universitetet mund të organizojnë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me



një a më shumë universitete të tjera, në bazë marrëveshjesh midis tyre, duke pasur parasysh si më poshtë:

a) Programin e studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezës së saj kryhen me periudha të alternuara në secilin prej universiteteve pjesëmarrëse.

b) Caktimin e dy udhëheqësve, një për secilin universitet për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezës së doktoratës.

c) Caktimin e gjuhës në të cilën do të hartohet dhe paraqitet teza e doktoratës apo pjesë të saj, përcaktuar në marrëveshjen midis universiteteve.

d) Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezës caktohen me vendim të autoriteteve drejtuese të secilit universitet në numër të barabartë.

e) Secili universitet i jep studentit që përfundon me sukses një program të tillë studimi, titullin “Doktor” ose ekuivalent me të, duke shënuar në diplomat përkatëse “Tezë doktrate në bashkëpunim me universitetin...”.

12. Studentët që janë në marrëdhënie pune dhe të përfshirë në aktivitete kërkimi pranë subjekteve publike ose private, si dhe studentët e regjistruar në programe të studimeve të specializimeve afatgjata, pas regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, mund të kërkojnë të zhvillojnë pjesë të aktivitetit të tyre të kërkimit në vendin e punës ose të specializimit, sipas një plani të përcaktuar nga këshilli përkatës i profesorëve.

13. Studentët që zotërojnë tituj shkollimi pas ciklit të dytë të studimeve p.sh. “Master i Nivelit të Dytë” etj. apo në kërkim, mund të kërkojnë pas pranimit në programin e studimit të doktoratës të kalojnë në vitin e dytë të saj ose t’u njihen dhe vlerësohen titujt e shkollimit që zotërojnë.

14. Nisma propozuese për hapjen, mbylljen apo riorganizimin e programeve të studimeve të doktoratës bëhet nga njësitë bazë apo grupe mësimore-kërkimore të tyre, pas verifikimit të burimeve të përshtatshme njerëzore, infrastrukturore dhe financiare. Propozimi i bërë miratohet nga këshilli i profesorëve të njësisë kryesore përkatëse dhe Senati Akademik.

15. Hapja dhe mbyllja e programeve të studimeve të doktoratës bëhet sipas përcaktimeve të nenit 42 të ligjit për arsimin e lartë, i ndryshuar.

16. Programet e studimit të doktoratës, të ofruara nga universitetet, sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, në bazë të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.864, datë 5.12.2007 “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë studenti për marrjen në përfundim të tyre të diplomës për gradën shkencore “Doktor”, riorganizohen sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, vendimeve nr.467 dhe nr.864 të Këshillit të Ministrave, të cituara në këtë udhëzim dhe këtij udhëzimi.

17. Kërkesat e universiteteve për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimeve të doktoratës duhet të paraqiten në MASH brenda datës 31 janar të çdo viti. Për vitin akademik në vazhdim kërkesat mund të bëhen deri në 31 mars 2008.

18. Universitetet, kërkesën e tyre për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës e shoqërojnë me dokumentacionin e përshtatur në pikën 2 të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë studenti për marrjen në përfundim të tyre të diplomës për gradën shkencore “Doktor”, si dhe të një skede përmblendhëse të përgatitur sipas modelit të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

19. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.7, datë 30.1.2008, faqe 209*

*Udhëzim i KM nr.20, datë 29.7.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.134, datë 11.9.2009, faqe 6256*

## SHTOJCA 1

### Program studimi i doktoratës

Viti akademik: .....

PROGRAM I RI	<input type="checkbox"/>
RIORGANIZIM	<input type="checkbox"/>

#### 1. Emërtimi i përgjithshëm i programit të studimit të doktoratës

në shqip	<input type="text"/>
në anglisht	<input type="text"/>

#### 2. Obiektivat formues të programit të studimit të doktoratës

<input type="text"/>
<input type="text"/>
<input type="text"/>

#### 3. Elemente të përgjithshme të programit të studimit të doktoratës

Viti I
Viti II
Viti III

Kur, për raste të veçanta, kohëzgjatja normale e programit të doktoratës, në formën me kohë të plotë, nevojitet të jetë më shumë se tre vjet, të specifikohen elementet e përgjithshme të programit të studimit dhe për vitet e tjera.”

#### 4. Plani i detajuar mësimor për thellimin teorik

Të jepet plani mësimor duke detajuar shpërndarjen në vite dhe semestra të disiplinave, të seminareve dhe çdo aktiviteti tjetër formues, shoqëruar me numrin e krediteve dhe orëve përkatëse, si dhe kërkesat për frekuentimin dhe verifikim të dijeve.

Emërtimi i aktivitetit	Kreditë	Orë mësimore	Viti/semestri	Frekuentim	Mënyra e verifikimit të dijeve	Personi përgjegjës
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						

Emërtimi i aktivitetit	Kredite	Orë mësimore	Frekuentim	Mënyra e verifikimit të dijeve	Personi përgjegjës
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

#### 5. Periudhat e formimit ose kërkimit në institucion tjetër brenda vendit

Institucioni	Tipi i institucionit (1)

(1) Specifikoni:

- Universiteti - Departamenti/Qendër kërkimi e zhvillimi e universitetit
- Instituti/Enti i kërkimit joakademik
- Fondacioni
- Subjekt privat jo i kërkimit
- Subjekt publik jo i kërkimit
- Strukturë spitalore
- Tjetër

#### 6. Periudhat e formimit ose kërkimit në institucione jashtë vendit

Institucioni	Periudha e qëndrimit në institucionin e huaj	Qëllimi i qëndrimit në institucionin e huaj (1)

(1) Specifikoni në se qëndrimi lidhet me:

- Frekuentim programesh disiplinore
- Aktivitete të kërkimit
- Aktivitete që lidhen me përgatitjen e tezës
- Stazh

Bashkëlidhur:

- Vendimi i pranimit në institucionin e huaj
- Informacion mbi mbulimin e shpenzimeve financiare për qëndrimin jashtë
- Informacion mbi objektivat relativë të funksionimit të doktoratës

#### 7. Zgjatja e programit

3 vjet                       4 vjet                       Tjetër

Për kohëzgjatje mbi tre vjet të argumentohet arësyeja.

#### 8. Njësia propozuese, përgjegjëse për problemet organizative

(bashkëlidhur vendimi i njësisë)



---

---

---

<b>a) Lista e detajuar e strukturave dhe pajisjeve që do të përdoren</b>

<b>b) Burimet financiare në dispozicion</b>

<b>c) Përvoja të mëparshme në formime pasuniversitare</b>

**9. Njësi bashkëpunuese, në se ka të tillë**  
*(bashkëlidhur vendimi përkatës)*

---

---

---

<b>a) Lista e detajuar e strukturave dhe pajisjeve në dispozicion të programit</b>

<b>b) Burimet financiare në dispozicion</b>

<b>c) Përvoja të mëparshme në formime pasuniversitare</b>

## 10. Vendimi i Senatit Akademik

Vendimi i Senatit Akademik për hapjen e programit (Numri dhe data)	Nr.: Data:
--	---------------

Bashkëlidhur vendimi i senatit akademik

## 11. Institucione të tjera bashkëpunuese në rastin e doktoratave të përbashkëta

Institucioni bashkëpunues	Departamenti/qendra	Marrveshja e lidhur në datën

Marrveshja t'i bashkëlidhet kërkesës.

## 12. Marrveshje me subjekte publike apo private (të bashkëlidhet secila marrveshje)

EMËRTIMI I SUBJEKTIT	TIPI I SUBJEKTIT (1)

(1) Specifikoni :

- Institut/Subjekt i kërkimit joakademik
- Privat jo kërkimor
- Publik jo kërkimor
- Tjetër

## 13. Kriteret e pranimit

Numri minimal i studentëve (jo më i vogël se tre)		Numri maksimal i studentëve	
Titujt e studimit që duhen patur për pranim	<input type="checkbox"/>	Diplomë e Nivelit II	
	<input type="checkbox"/>	Diplomë e e integruar e Nivelit II	
	<input type="checkbox"/>	Diplomë e sistemit të vjetër	
	<input type="checkbox"/>	Titull tjetër studimi i fituar jashtë	
Kriter tjetër		.....	
Kriter tjetër		.....	

## 14. Koordinator i programit të studimit të doktoratës

Koordinatori i programit të studimit të doktoratës, i zgjedhur nga Këshilli i Profesorëve me vendimin nr....., datë ..... është: .....  
(Bashkëlidhur vendimi)



ministra e arsimit dhe shkencës  
ministra e sërësme

Udhëzim për programet e studimit të doktoratës  
Faqe 9 nga 10

**15. Personeli i angazhuar për realizimin e programit**

a) Anëtarë të personelit akademik

Personeli akademik	Titulli akademik	Departamenti/Qendra	Universiteti	Spektori mësimor-kërkimor

Bashkëlidhur CV për çdo anëtar të personelit mësimor.

b) Anëtarë nga subjekte të tjera publike apo private

	Emër Mbiemër	Kualifikime	Subjekti që përfaqëson
1			
2			

Për secilin të bashkëlidhet CV.

**16. Informacion për personelin e caktuar për komunikim**

Emër - Mbiemër	Detyra	Telefon	Fax	E-mail

Koordinatori i Programit

Përgjegjësi i Njesisë propozuese

Firma

Firma

Rektori

Firma, Vula

Datë

**UDHËZIM**

Nr.14, datë 3.4.2008

**PËR HAPJEN DHE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26, pika 1.2.1, nenit 98, paragrafi i dytë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

**UDHËZOJ:**

1. Programet e studimit të ciklit të dytë, përcaktuar në pikën 1.2.1 të nenit 26 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përbëjnë

nivelin e dytë të formimit universitar, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë (DND) në fushën e arsimit të kryer.

2. Programet e mësipërme të studimit të ciklit të dytë organizohen dhe ofrohen vetëm nga institucionet e përcaktuara në nenet 5, pika 4 dhe 6, pikat 1, 2 e 3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike.

4. Programet e studimit të ciklit të dytë, nëpërmjet aktiviteteve formuese, teorike dhe praktike, duhet të garantojnë:

- a) specializim të njohurive të studentëve, krahasuar me programet e studimit të ciklit të parë;
- b) përgatitje të avancuar të tyre për formimin e kompetencave dhe aftësive, që iu korrespondojnë niveleve të kualifikuara të punësimit dhe të profesionalizmit;
- c) trajnim për kërkim të pavarur nëpërmjet njohjes së metodave, instrumenteve e teknikave të kërkimit.

5. Programet e studimit të ciklit të dytë mund të jenë edhe ndërdisiplinore ose/dhe të përbashkëta.

6. Programet e studimit të ciklit të dytë duhet të hartohen në mënyrë të tillë që:

- a) të shmangin përsëritjen e njohurive formuese të programeve të studimit të ciklit të parë, duke ofruar disiplina të një karakteri më të avancuar e specializues;
- b) kurrikulat e tyre t’i korrespondojnë një formimi bazë të gjerë dhe fleksibël, duke ju dhënë peshë programeve ndërdisiplinore, me qëllim mundësimin e pranimit në këto programe studimi si të studentëve të diplomuar në programin respektiv të studimit të ciklit të parë, ashtu dhe të atyre të diplomuar në programe të afërta studimi të ciklit të parë;
- c) të reflektojnë bashkëpunimin me tregun e punës dhe profesioneve në nivel kombëtar dhe lokal.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, përcaktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, përcaktojnë listën e programeve të studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në një program studimi të ciklit të dytë, si më poshtë:

- a) programin apo programet e studimit të ciklit të parë, që lejojnë regjistrimin në programin e studimit të ciklit të dytë pa plotësime shtesë (pa debite formimi);
- b) programin apo programet e studimit të ciklit të parë, që lejojnë regjistrimin në programin e studimit të ciklit të dytë me plotësim të njohurive formuese (me debite formimi), si p.sh. programe studimi të afërta të të njëjtit institucion apo programe të njëjta e të afërta të institucioneve të tjera të arsimit të lartë.

Në çdo program studimi të ciklit të dytë, së paku një program studimi i ciklit të parë kalon pa debite formimi.

8. Në programet e studimit të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 7 përfshihen programet, njohuritë formuese të të cilave konsiderohen të përputhshme e të pranueshme për regjistrimin në program për jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të krediteve të tyre, (jo më pak se 120 kredite). Vlerësimi i programeve të studimit të ciklit të parë kryhet nga një grup profesorësh të njësisë kryesore, ku do të zhvillohet programi i studimit i ciklit të dytë (strukturë përgjegjëse), të caktuar nga dekani.

a) Kur një programi studimi të ciklit të parë i vlerësohen të pranueshme jo më pak se 120 kredite, struktura akademike përgjegjëse përcakton disiplinat në të cilat studenti duhet të bëjë plotësimet e krediteve të mangëta (debitëve të formimit). Në çdo rast, numri maksimal i krediteve të mangëta për t’u plotësuar nuk duhet të kalojë 60 kreditet.

9. Mund të njihen si kredite të realizuara, për një program studimi të ciklit të dytë, kredite të fituara në programet master i nivelit të parë, po jo më shumë se 12-15 kredite.

Nuk njihen si kredite të realizuara, për një program studimi të ciklit të dytë, kredite të fituara në çfarëdo program studimi të ciklit të parë.

10. Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të dytë, japin informacionet e nevojshme për plotësimin e njohurive formuese (debitëve të formimit) sipas përcaktimit në pikën 8 “a” më sipër. Ato përcaktojnë edhe procedurat për kryerjen e këtyre

plotësimeve para pranimit në programin e studimit të ciklit të dytë, duke organizuar për këtë qëllim dhe shërbime të nevojshme të tutoratit (kujdestarisë) për studentët.

11. Për hapjen/organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, njësitë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) personel akademik me kualifikimin, kompetencat kurrikulare dhe në numrin e nevojshëm, për zhvillimin e disiplinave të ndryshme të programit të studimit;

b) infrastrukturën e nevojshme dhe të përshtatshme mësimore, laboratorike, kompjuterike, publikime etj., për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit;

c) mundësi për realizimin e tezës së diplomës.

Institucionet publike të arsimit të lartë mund të përcaktojnë, përveç titullit apo titujve të diplomave të nivelit të parë që duhet të zotërohen së paku nga studentët si kusht për pranimin e tyre në një program studimi të caktuar të ciklit të dytë, edhe kritere të tjera specifike, sipas përcaktimit në nenin 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kriteret e pranimit të studentëve bëhen publike.

12. Në përfundim të programit të studimit të ciklit të dytë, parashikohet realizimi i një teze diplome, si pjesë përbërëse e tij.

13. Programet e studimit të ciklit të dytë funksionojnë në përputhje me rregulloret përkatëse të tyre.

14. Institucionet publike të arsimit të lartë, kërkesën e tyre për hapjen/organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, e shoqërojnë me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) objektivat formues të programit, kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundim të tij dhe ndihmesën për qëllim punësimi;

b) planin mësimor të programit, të detajuar në aktivitetet e ndryshme formuese, shoqëruar me kreditet dhe orët mësimore përkatëse;

c) personelin akademik, që do të angazhohet për realizimin e programit të studimit, shoqëruar edhe me të dhënat e nevojshme të kualifikimit të tij dhe të fushave mësimore e kërkimore të mbuluara prej tij;

d) kriteret e pranimit të studentëve;

e) programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në programin e studimit, pa ose me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

f) mundësitë e transferimit të studentëve ndërmjet programeve të studimit të ciklit të dytë;

g) modalitetet e përgatitjes, paraqitjes dhe vlerësimit të tezës së diplomës;

h) numrin minimal dhe maksimal të pjesëmarrësve në program;

i) frekuencën në aktivitetet e ndryshme formuese (leksione, seminare, laboratore, praktika etj.);

j) strukturën akademike përgjegjëse;

k) propozimin për tarifën e shkollimit, të argumentuar lidhur me koston;

l) rregulloren e programit të studimit;

m) Modelin e diplomës dhe suplementit të diplomës.

Formati për paraqitjen e dokumentacionit për elementet kryesore të cituara më sipër, të përgatitet sipas modelit në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Dokumentacioni tjetër i kërkuar në këtë pikë të bashkëlidhet si pjesë përbërëse e propozimit.

15. Propozimet për hapjen/organizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë bëhen nga një apo më shumë njësi kryesore apo njësi bazë.

Këto propozime shqyrtohen dhe miratohen në këshillin e njësisë kryesore përkatëse dhe në senatin akademik të institucionit.

16. Kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë për hapjen/organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë duhet të paraqiten në MASH brenda datës 31 mars të çdo viti.

Për vitin akademik në vazhdim kërkesat mund të bëhen deri në 30 maj 2008.

17. Hapja dhe mbyllja e programeve të studimeve të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2 të nenit 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, si dhe mbështetur në këtë udhëzim.



18. Licencimi dhe hapja e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet private të arsimit të lartë bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 44 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007. Institucionet private të arsimit të lartë, që do të ofrojnë programe studimi të ciklit të dytë, u nënshtrohen rregullave të përcaktuara në udhëzimet specifike, për hapjen e tyre, dhe këtij udhëzimi për organizimin e studimeve në to.

Institucionet private të arsimit të lartë i nënshtrohen rregullit të pikës 11 të këtij udhëzimi vetëm për organizimin e studimeve.

Këto institucione përjashtohen nga rregullat e përcaktuara në pikat 15, 16 dhe 17 të këtij udhëzimi duke iu nënshtuar për hapjen e programeve të studimit rregullave të përcaktuara në aktet specifike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Genc Pollo

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.52, datë 16.4.2008, faqe 2329

### Shtojca 1

Institucioni i arsimit të lartë
---------------------------------

## PROPOZIM PËR HAPJEN DHE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

### Viti akademik:

#### 1. Emërtimi i përgjithshëm i programit të studimit

--

#### 2. Vendimet e organeve përgjegjëse për hapjen e programit të studimit

Vendimi i këshillit të njësisë kryesore për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë (Numri i vendimit dhe data)	
Vendimi i senatit akademik për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë (Numri i vendimit dhe data)	

Në rastin kur programi i studimit është ndërdisiplinor apo/dhe i përbashkët, të përfshihen të gjitha vendimet e marra, sipas modelit më sipër.

#### 3. Objektivat formues dhe karakteristikat e programit të studimit

##### a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit

---

---

---

##### b) Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin

---

---

c) Mundësitë për punësim

#### 4. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë.	
Institucione të huaja të arsimit të lartë	
Subjekte të tjera publike apo private	

Në rastin e bashkëpunimit me një apo disa struktura të tjera të bashkëlidhen marrëveshjet përkatëse.

#### 5. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit hartohet duke marrë në konsideratë dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”

Tipi i veprimtarisë dhe simboli përcaktues për të	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite	Totali i krediteve
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) (Simboli: A)	1. ....		
	2. ....		
	3. ...		
	.....		
Veprimtari në disiplina karakterizuese të programit të studimit (Simboli: B)	1. ....		
	2. ....		
	3. ...		
	.....		
Veprimtari në disiplina të ngjashme ose/dhe integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese (Simboli: C)	1. ....		
	2. ....		
	3. ...		
	.....		
Disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disiplinat e ofruara nga institucioni (Simboli: D)	1. ....		
	2. ....		
	3. ...		
	.....		
Njohuri të tjera formuese, si plotësime në gjuhë të huaja, informatikë, prezantuese, stazh apo praktika etj. (Simboli: E)	1. ....		
	2. ....		
	3. ...		
	.....		
Teza e diplomës (Simboli: F)			
<b>Totali</b>			<b>120</b>

Germet A- F janë përdorur si simbole për veprimtaritë e ndryshme formuese.

Në programin e studimit parashikohen:

- |                        |                          |    |                          |    |
|------------------------|--------------------------|----|--------------------------|----|
| - leksione             | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - ushtrime             | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - laboratore           | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - projekt/detyra       | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - seminare             | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |
| - praktikë, stazh etj. | <input type="checkbox"/> | Po | <input type="checkbox"/> | Jo |

#### 6. Personeli akademik për realizimin e programit

Personeli akademik (me kohë të plotë ose të pjesshme)	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Departamenti/qendra njësia kryesore	Spektori mësimor-kërkimor

#### 7. Plani mësimor

Disiplina mësimore apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprimtarisë (A - F)	Frekuentimi	Kreditet	Orët mësimore në auditor
<b>VITI I - SEMESTRI I</b>				
1.				
2.				
Totali			..... kredite	..... orë
<b>VITI I - SEMESTRI II</b>				
1.				
2.				
Totali			..... kredite	..... orë
<b>VITI II - SEMESTRI I</b>				
1.				
2.				
Totali			..... kredite	..... orë
<b>VITI II - SEMESTRI II</b>				
1.				

2.				
Totali			..... kredite	..... orë
Totali i përgjithshëm			..... kredite	..... orë

**8. Programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në programin e studimit të ciklit të dytë**

a) pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë	
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilat nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1.
	2. <input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>
Nga institucione të tjera të arsimit të lartë	
Programi apo programet e ciklit të parë, për të cilat nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1.
	2. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>
	<input type="checkbox"/>

b) me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë, për të cilat kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	1.	<input type="checkbox"/> .....kredite
	2. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	.....kredite
	<input type="checkbox"/>	
	<input type="checkbox"/>	
Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë, për të cilat kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	1.	.....kredite
	2. <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>	.....kredite
	<input type="checkbox"/>	
	<input type="checkbox"/>	

**9. Infrastruktura në dispozicion të programit**

Informacion lidhur me: auditorët, laboratorët e duhur, bibliotekën, mjetet kompjuterike etj.

**10. Kритere specifike të pranimit të studentëve në program**

Numri i propozuar i studentëve që do të pranohen në program	
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	

Kritere të tjera pranimi (nëse ka)

1	
2	
3	

### 11. Tarifa e shkollimit

Tarifa e shkollimit		Kostoja e shkollimit	
---------------------	--	----------------------	--

### 12. Financime të tjera

Financime të tjera që mund të mbulojnë pjesërisht apo plotësisht koston e shkollimit, në se ka të tilla.

REKTORI  
Firma, vula

Data \_\_\_\_\_

## UDHËZIM Nr.15, datë 4.4.2008

### PËR ORGANIZIMIN E STUDIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26 dhe nenit 98, paragrafi i dytë, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### UDHËZOJ:

#### I. Programet e studimit dhe titujt përkatës të diplomave

1. Programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit të ciklit të dytë, programet e integruara të studimit të ciklit të dytë dhe programet e studimit të doktoratës organizohen në cikle të njëpasnjëshme studimi, dhe respektivisht sipas cikleve, lëshohen diplomat:

- “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në fushën e arsimimit të kryer;
- “Diplomë e nivelit të dytë” (DND) në fushën e arsimimit të kryer;
- “Diplomë e integruar e nivelit të dytë” (DIND) në fushën e arsimimit të kryer;
- “Diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr)”.

2. Diploma e nivelit të parë DNP, diploma e nivelit të dytë DND, diploma e integruar e nivelit të dytë DIND, dhe diploma për gradën shkencore “Doktor”, lëshohen pas përfundimit respektivisht të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë apo të ciklit të parë dhe të dytë së bashku, e të ciklit të tretë (doktorata), të kryera në institucione të arsimit të lartë.

3. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, përcaktuar në nenin 26, pika 1.2.2.a., të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, janë programe të studimit të ciklit të parë dhe të dytë së bashku, për të cilat nuk parashikohen tituj universitarë të ciklit të parë.

Programet e studimeve, të cilat organizohen si programe të integruara studimi të ciklit të dytë, jepen në listën bashkëlidhur këtij udhëzimi. Listës mund t’i shtohen, me propozim të institucioneve të arsimit të lartë dhe miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, edhe programe të tjera studimesh të integruara të ciklit të dytë.

4. Programet e studimit të doktoratës, përcaktuar në nenin 26, pika 1.3.1 të ligjit nr.9741,

datë 21.5.2007, kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarur, duke përfshirë edhe 60 kredite për studime të organizuara.

Për fitimin e diplomës për gradën shkencore “Doktor” (Dr), studentët duhet të përmbushin edhe detyrimet e tjera që përcaktohen nga vendimi nr.864, datë 5.12.2007 i Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë studenti për marrjen në përfundim të tyre të diplomës për gradën shkencore doktor”.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë lëshojnë, gjithashtu, diplomat:

a) Diplomën “Master i nivelit të parë” (MNP) në fushën e arsimit dhe trajnimit të kryer, në përfundim të programeve të studimit master i nivelit të parë, pjesë e studimeve të ciklit të dytë dhe që realizojnë arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional të studentit, sipas nenit 26, pika 1.2.3, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007.

b) Diplomën “Master i nivelit të dytë” (MND), në përfundim të programeve të studimit master i nivelit të dytë, pjesë e studimeve të ciklit të tretë dhe që realizojnë arsimim dhe trajnim të një niveli më të lartë profesional ose shkencor të studentit, sipas nenit 26, pika 1.3.4., të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007.

c) Diplomën me titull “Specialist ...”, për shkencat mjekësore ose “Magjistër...”, për shkencat politike, juridike dhe sociale, ndjekur nga fusha e specializimit të kryer, në përfundim të një programi specializues afatgjatë, pjesë e studimeve të ciklit të tretë. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë profesionalisht të orientuara dhe ofrojnë njohuri për profesione specifike në fushat e mjekësisë, stomatologjisë, veterinarisë, drejtësisë etj., sipas nenit 26, pika 1.3.2 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë, bazuar në nenin 30 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, mund të ofrojnë edhe programe të formimit të vazhduar për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive, programe të kërkimit të avancuar, kurse e shkolla verore etj., në varësi të programeve të studimit që institucioni ofron, në përfundim të të cilave lëshohet certifikatë.

Struktura dhe kohëzgjatja e këtyre programeve përcaktohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Hapja e tyre bëhet pasi Ministria e Arsimit dhe e Shkencës shprehet formalisht për njohjen e propozimit të ardhur nga institucioni publik i arsimit të lartë. Propozimi përmban emërtimin e programit, strukturën dhe kohëzgjatjen e tij, si dhe modelin e certifikatës që do të lëshohet në përfundim të programit.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë mund të ofrojnë, mbështetur në nenin 26, pika 4 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, programe të studimeve jouniversitare dyvjeçare, të natyrës profesionale, në përfundim të të cilave lëshohen diplomat përkatëse.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë apo njësi kryesore të tyre, në bazë të marrëveshjes, mund t'i ofrojnë programet e mësipërme të studimeve edhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë. Në marrëveshje përcaktohet dhe tipi i diplomës që lëshohet, që mund të jetë diplomë e përbashkët e të dy institucioneve ose diplomë e dyfishtë, lëshuar nga secili institucion. Në të dyja rastet, në diplomat përkatëse shënohen institucionet bashkëpunuese.

## **II. Kreditet**

1. Një krediti të formimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit.

2. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh universitare nga një student me kohë të plotë është 60 kredite apo 1500 orë mësimore punë të studentit, që përfshijnë orë në auditor dhe orë për punë të pavarur të tij.

3. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore.

4. Ngarkesa javore në auditor për leksione, seminare, ushtrime dhe laboratorë është në intervalin e 20 - 25 orëve mësimore 60-minutëshe.

5. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (provimin).

6. Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të marra nga një student me qëllim vazhdimin e studimeve në një program tjetër studimi në të njëjtin institucion, si dhe në të njëjtin apo një tjetër program studimi në një institucion tjetër të arsimit të lartë, bëhet nga njësia që pret studentin, me procedura dhe kritere të përcaktuara në rregulloren mësimore të institucionit.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë mund të njohin si kredite të formimeve universitare në një program të caktuar studimi, sipas kritereve të përcaktuara, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese të nivelit pas shkollës së mesme dhe që janë në përputhje me objektivat specifike të programit përkatës të studimit.

Numri maksimal i krediteve të njohura në këtë rast nuk kalon 60 kredite për programet e studimit të ciklit të parë dhe 40 kredite për programet e studimit të ciklit të dytë.

8. Në rregulloret mësimore të institucioneve parashikohen kontrole për verifikimin dhe vlerësimin periodik të krediteve të fituara nga studentët që kanë ndërprerë përkohësisht studimet, kontrole këto për të garantuar mosvjedrimin e dijeve dhe azhurnimin e tyre për kreditet e fituara nga studentët. Edhe studentëve që i kanë zgjatur studimet për më shumë se tre vjet, përtej kohës normale të fitimit të diplomës për një program të caktuar studimi, para dhënies së tezës së diplomës iu kontrollon gjithashtu kreditet e fituara.

### **III. Kushtet e pranimit në programet e ndryshme të studimit**

1. Për t'u pranuar në një program studimi të ciklit të parë apo program të integruar të studimit të ciklit të dytë, kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses maturën shtetërore, të zotërojë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të ose të zotërojë një diplomë të lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë.

Institucionet publike të arsimit të lartë mund të përcaktojnë në përputhje me aktet ligjore në fuqi edhe kritere të veçanta pranimi për kandidatët, të cilët kanë mbaruar maturën shtetërore, të cilat i bëjnë publike të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

2. Për t'u pranuar në një program studimi të ciklit të dytë, kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të parë ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë në rregulloret mësimore përkatëse kritere specifike për pranimin e studentëve në çdo program studimi të ciklit të dytë, që lidhen me drejtimin e formimit të tyre në ciklin e parë dhe kualitetin e përgatitjes individuale të studentëve, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Këto kritere specifike bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

3. Për t'u pranuar në një program studimi të doktoratës kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë apo diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, ekuivalente me to. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kritere specifike të pranimit në programet e doktoratës, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Këto kritere bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

4. Për t'u pranuar në një program studimi specializimi afatgjatë, kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, diplomë të integruar të nivelit të dytë apo diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, ekuivalente me to, dhe të plotësojë standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kritere specifike të pranimit në këto programe studimi, bazuar dhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës, të cilat bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

5. Për t'u pranuar në një program studimi "Master i Nivelit të Parë" (MNP) kandidati duhet të ketë përfunduar së paku një program studimi të ciklit të parë, si dhe të plotësojë standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv për këto programe studimi, të cilat bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

6. Për t'u pranuar në një program studimi "Master i Nivelit të Dytë" (MND) kandidati duhet të ketë përfunduar së paku një program studimi të ciklit të dytë apo program të integruar të studimit të ciklit të dytë, si dhe të plotësojë standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv për këto programe studimi, të cilat bëhen publike para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

7. Për t'u pranuar në një program studimi jouniversitar, të natyrës profesionale, kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses maturën shtetërore ose të zotërojë një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të, si dhe të plotësojë standardet akademike të kritereve të pranimit të institucionit respektiv për këto programe studimi, të cilat bëhen publike të paktën një vit para fillimit të pranimeve të radhës në institucion.

8. Ekuivalentimi i titujve të studimit të fituar jashtë vendit, me qëllim pranimit në programet e ndryshme të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, bëhet nga institucionet e arsimit të lartë, duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

#### **IV. Fitimi i diplomave të studimit**

1. Për të fituar një diplomë të nivelit të parë (DNP), studenti duhet të ketë grumbulluar 180 kredite.

2. Për të fituar një diplomë të nivelit të dytë (DND), studenti duhet të ketë grumbulluar 120 kredite.

3. Për të fituar një diplomë të integruar të nivelit të dytë (DIND), studenti duhet të ketë grumbulluar së paku 300 kredite.

4. Për të fituar një diplomë të masterit të nivelit të parë (MNP), studenti duhet të ketë grumbulluar 60 kredite.

5. Për të fituar një diplomë të masterit të nivelit të dytë (MND), studenti duhet të ketë grumbulluar të paktën 60 kredite.

6. Për të fituar një diplomë të një programi studimi jouniversitar, studenti duhet të ketë grumbulluar 120 kredite.

7. Për të fituar një certifikatë në përfundim të një programi studimi të formimit të vazhduar, studenti duhet të ketë grumbulluar numrin e nevojshëm të krediteve, të përcaktuar nga institucioni respektiv i arsimit të lartë për atë program studimi.

#### **V. Kohëzgjatja e programeve të studimit me kohë të plotë**

1. Për çdo program studimi me kohë të plotë është përcaktuar si normë një kohëzgjatje në vite, proporcionale me numrin total të krediteve, përcaktuar në kreun IV të këtij udhëzimi, duke pasur parasysh që një viti i korrespondojnë 60 kredite.

2. Mbështetur në pikën 1 të këtij kreu, kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë është tre vite, kohëzgjatja normale e programeve të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë është edhe dy vite të tjera pas përfundimit të një programi studimi të ciklit të parë, kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë është së paku pesë vite.

3. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të doktoratës është së paku tre vite të tjera pas përfundimit të një programi studimi të ciklit të dytë apo programi të integruar të studimit të ciklit të dytë.

4. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit të specializimeve afatgjata është së paku dy vite të tjera pas përfundimit të një programi studimi të ciklit të dytë apo programi të integruar të studimit të ciklit të dytë.

5. Kohëzgjatja normale e programeve të studimit jouniversitar me kohë të plotë është dy vite.

6. Kohëzgjatja e programeve të ndryshme të studimit të formimit të vazhduar përcaktohet në mënyrë të pavarur nga secili institucion i arsimit të lartë.

7. Kur një program studimi ofrohet me kohë të pjesshme ose në distancë, kohëzgjatja e programit të studimit do të jetë sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin përkatës të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për organizimin e formave të studimit me kohë të pjesshme dhe në distancë.

8. Kohëzgjatja për programet e studimit të doktoratës do të jetë sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin nr.5, datë 22.1.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

#### **VI. Hapja e programeve të studimit**

1. Hapja e programeve të ndryshme të studimit, sipas pikës 1 të kreut I të këtij udhëzimi, bëhet kur plotësohen kriteret strukturore, organizative, si dhe kriteret lidhur me personelin akademik, që do të aktivizohet në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese, duke pasur parasysh dhe objektivat e nevojat për zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë.



Propozimet për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë bëhen pasi të jenë plotësuar kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 dhe udhëzimit përkatës të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Propozimet për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të doktoratës bëhen pasi të jenë plotësuar kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, në vendimin nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe kushtet e tjera që duhet të plotësojë studenti për marrjen në përfundim të tyre të diplomës për gradën shkencore “Doktor”, udhëzimit nr.5, datë 22.1.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për përcaktimin e standardeve akademike të nevojshme për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse”, si dhe akteve të tjera nënligjore lidhur me organizimin e studimeve në ciklin e tretë të studimeve.

Propozimet për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit “Master i nivelit të parë” dhe “Master i nivelit të dytë”, bëhen mbështetur në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 dhe udhëzimin nr.4, datë 22.1.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit master i nivelit të parë dhe master i nivelit të dytë”.

2. Hapja e këtyre programeve të studimit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, para se të marrë vendim, kërkon vlerësimin e programeve të studimit prej Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë. Vetëm në rastin e një vlerësimi pozitiv, ajo përcjell propozimin e saj në Këshillin e Ministrave.

3. Në rastin e mbylljes së një programi studimi, institucionet publike të arsimit të lartë duhet të parashikojnë për studentët mundësinë e përfundimit të studimeve në një program të njëjtë ose të ngjashëm studimi.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë publikojnë në faqen zyrtare të institucionit, programet e studimit të ofruara prej tyre.

## **VII. Objektivat dhe veprimtaritë formuese të një programi studimi**

1. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë një program studimi ndahen: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj.) dhe veprimtari të tjera, si praktika profesionale apo stazh pranë subjekteve publike apo private.

Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë përcaktohet nga personeli akademik përgjegjës për disipinën, në bazë të krediteve që asaj disipline i janë caktuar.

2. Çdo program studimi ka objektiva të caktuar për formimin e studentëve në atë program, të cilat përbëhen nga bashkësia e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin kulturor e profesional të programit.

3. Objektivat për formimin e studentëve në një program studimi ndahen në:

a) Objektiva përcaktues të programit të studimit, të cilat janë të njëjta për programe studimi të njëjta apo të ngjashme, të ofruara nga institucione të ndryshme publike të arsimit të lartë. Këto përcaktojnë përgatitjen, njohuritë, kompetencat dhe mundësitë për punësim dhe janë të njëjta, pavarësisht institucionit publik të arsimit të lartë që i ofron apo emërtimit të programit.

b) Objektiva specifike, të cilët diferencojnë programet e njëjta ose të ngjashme nga njëri-tjetri. Këto përcaktohen veças nga secili institucion publik i arsimit të lartë që ofron atë program studimi.

4. Për çdo program të caktuar studimi, objektivat formues përcaktues të programit dhe veprimtaritë formuese të domosdoshme për t'u ndjekur grupohen si më poshtë:

a) veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash që lidhen me formimin e përgjithshëm (bazë) për programin e studimit;

b) veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash, që karakterizojnë përkatësinë e programit të studimit;

5. Përveç veprimtarive formuese të përcaktuara në pikën 4, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij kreu, programet e studimit duhet të parashikojnë, gjithashtu:

a) veprimtari formuese të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit;

b) veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese (pika 4.b e këtij kreu), që lidhen kryesisht me formime ndërdisiplinore, njohuri ekonomike, juridike, etj.

c) veprimtari formuese të paparashikuara më sipër dhe të fokusuara drejt përfundimit të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose përgjithësisht të aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës, sikurse dhe aktivitete formuese që lidhen me praktikën profesionale pranë kompanive të ndryshme, administratës publike, enteve private apo publike, urdhrave apo kolegjeve profesionale, bazuar në marrëveshje të përbashkëta për këtë qëllim.

d) veprimtari formuese që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës;

6. Në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, jepen rekomandime për shpërndarjen e krediteve sipas veprimtarive të ndryshme formuese, si dhe ndarjen e orëve mësimore për një kredit në orë në auditor dhe orë për studim individual.

7. Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u njehsohet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi, jepet një shembull i njehsimit të notës mesatare të ponderuar.

### **VIII. Rregullorja mësimore e institucioneve publike të arsimit të lartë**

1. Institucionet publike të arsimit të lartë duhet të kenë rregulloren mësimore të tyre, në të cilën përcaktohet organizimi i planeve mësimore për të gjitha programet e studimit që ofrohen, sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, akteve nënligjore në fuqi dhe normave të përcaktuara në statutin e institucionit.

2. Rregullorja mësimore e institucionit, si edhe modifikimet e ndryshme të saj, miratohen në senatin akademik.

3. Në planin mësimor të çdo programi studimi përcaktohen:

a) emërtimi dhe objektivat formues të programit të studimit;

b) kuadri i përgjithshëm i veprimtarive formuese që duhen përfshirë në kurrikula;

c) kreditet për çdo veprimtari formuese, të përcaktuara sipas pikës 4, shkronjat “a” dhe “b” dhe pikën 5, shkronjat “a”, “b”, “c” e “d”, të kreut VII;

d) karakteristikat e tezës së diplomës.

4. Për fitimin e diplomës së nivelit të parë (DNP) parashikohet përgatitja e një teze diplome, pa kërkesa për origjinalitet të veçantë.

Për fitimin e diplomave të nivelit të dytë (DND) dhe diplomave të integruara të nivelit të dytë (DIND), duhet të parashikohet përgatitja e një teze diplome, të përpunuar në mënyrë të pavarur dhe krijuese nga studenti.

5. Për përcaktimet e pikës 3 të këtij kreu, institucionet publike të arsimit të lartë konsultohen paraprakisht me përfaqësues të bizneseve, shërbimeve apo profesioneve respektive, duke iu referuar gjithashtu edhe nevojave e kërkesave të tregut.

6. Rregullorja mësimore e institucionit përcakton, gjithashtu, aspekte të organizimit dhe administrimit të veprimtarive mësimore të përbashkëta për programet e studimit, si:

a) kriteret specifike të pranimit të studentëve në programet e studimit;

b) objektivat, afatet dhe mënyrat me të cilat strukturat përgjegjëse akademike parashikojnë kolegjisht programimin e veprimtarive të ndryshme formuese, koordinimin dhe verifikimin e rezultateve të tyre;

c) procedurat për ndarjen e detyrimeve mësimore vjetore kategorive të personelit akademik;

d) procedurat për zhvillimin e provimeve apo formave të tjera të kontrollit përfundimtar të dijeve të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese, e kontrolleve të pjeshme të dijeve, si dhe të paraqitjes e diskutimit të tezës së diplomës;

e) modalitetet për dhënien e diplomave, përcaktuar në kreun I të këtij udhëzimi.

f) kriteret dhe procedurat për njohjen e plotë ose të pjeshme të krediteve të grumbulluara nga studentët që kërkojnë të transferohen apo t'u njihen dije të fituara më parë të pas shkollës së mesme;

g) organizimin e plotësimit të debiteve formuese para hyrjes në një program studimi të ciklit të dytë;

h) organizimin e shërbimit për koordinimin e aktiviteteve orientuese për nxënësit në bashkëpunim me shkollat e mesme, si dhe shërbimin për çdo program studimi të kujdestarisë (tutoratit) për studentët, referuar përcaktimeve në pikën XI të këtij udhëzimi;

i) vlerësimin e cilësisë së të gjitha veprimtarive të kryera;

j) format e publikimit të procedurave të ndryshme dhe vendimeve të marra;

k) modalitetet e caktimit, për çdo veprimtari, të strukturës apo personit që mban përgjegjësi etj.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë caktojnë për çdo disiplinë/lëndë një numër të përshtatshëm kreditesh, duke evituar ndarjen në pjesë të vogla /copëzimin, e veprimtarive formuese. Për çdo program studimi të ciklit të parë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 22 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese, duke realizuar provime të integruara për më shumë se një disiplinë apo module të koordinuara.

Në këto raste, lektorët (titullarët) e këtyre disiplinave bëjnë vlerësim kolegjal të studentit, sipas modaliteteve të parashikuara në rregulloren mësimore të institucionit.

Për çdo program studimi të ciklit të dytë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 14 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Për programet e integruara të ciklit të dytë, përcaktuar në pikën 1, shkronja “c”, të kreut I të këtij udhëzimi, nuk mund të parashikohen në total më shumë se 35 provime apo forma të tjera të vlerësimit përfundimtar të dijeve, të fituara në një disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

8. Rregullorja mësimore e institucionit përcakton edhe modalitetet dhe formën e dhënies së Supplementit të diplomës, në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë apo programeve të integruara të ciklit të dytë, si dhe të programeve “Master i nivelit të dytë”, bazuar në udhëzimin nr.12 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, datë 14.5.2007 “Për akordimin e “shtojcës së diplomës” (suplementit të diplomës) nga të gjitha shkollat e larta”.

#### **IX. Rregulloret mësimore të programeve të studimit**

1. Institucionet publike të arsimit të lartë organizojnë çdo program studimi nëpërmjet rregullores mësimore përkatëse.

2. Rregullorja mësimore e një programi studimi, e hartuar nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me planin mësimor dhe duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve, specifikon aspektet organizative të programit të studimit. Rregullorja miratohet sipas procedurave të përcaktuara në statutin e institucionit.

3. Rregullorja mësimore e një programi studimi përcakton në veçanti:

a) listën e disiplinave mësimore, të ndara në module, si dhe veprimtaritë e tjera formuese;

b) objektivat formues specifikë të çdo discipline apo veprimtarie tjetër formuese;

c) kreditet dhe detyrimet penguese për çdo disiplinë mësimore apo veprimtari tjetër formuese;

d) kurrikulat e ofruara studentëve;

e) formën/format e studimit, të provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët;

f) detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin;

g) kushtet për procedurat e modalitetet për transferimin e studentëve etj.

4. Raportet ndërmjet krediteve dhe veprimtarive të ndryshme formuese, para se të

përfshihen në rregulloren mësimore të një programi studimi, miratohen në këshillat e njëjësive kryesore dhe në senatin akademik.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë garantojnë me dispozitë të veçantë të statutit të tyre rishikimin periodik të rregulloreve mësimore të programeve të studimit, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.

6. Në rregulloren mësimore të një programi studimi duhet të parashikohet numri maksimal i krediteve që mund të njihen në atë program për njohuri të fituara më parë nga studentët, referuar pikës 7 të kreut II të këtij udhëzimi.

#### **X. Grupet mësimore**

1. Grupet mësimore në programet e studimit të ciklit të parë, ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, rekomandohet të organizohen me numër studentësh si më poshtë:

a) Për programet e studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë:

Fushat e studimit	Numri i rekomanduar i studentëve cikli I	Numri i rekomanduar i studentëve cikli II
Shkenca natyrore	60	60
Shkenca të aplikuara (inxhinieri, teknologji dhe shkenca bujqësore)	100	80
Shkenca ekonomike, filologjike, historike, filozofike	120	100
Shkenca juridike, sociale, psikologjike, politike	150	120

b) Për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë:

Fushat e studimit	Numri i rekomanduar i studentëve
Stomatologji, veterinari	60
Mjekësi	80
Farmaci	100

2. Për zhvillimin e veprimtarive praktike të procesit mësimor, grupet mësimore mund të ndahen si më poshtë:

- a) grup mësimor për praktika mësimore apo profesionale 25 – 40 studentë;
- b) grup mësimor për laboratorë apo mësim praktik në AEFS 10 - 15 studentë;
- c) grup mësimor për praktika mësimore (Akad. e arteve) 5 - 10 studentë.

3. Normativat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu nuk respektohen në rastet kur numri i studentëve të regjistruar në një program studimi, është më i vogël se ai i përcaktuar në normativat e mësipërme ose në raste të tjera me vendim të Këshillit të Administrimit.

#### **XI. Veprimtaritë e orientimit dhe të kujdestarisë (tutoratit)**

1. Strukturat mësimore zhvillojnë si veprimtari institucionale:

- a) kujdestari (tutorat) për studentët;
- b) këshillim për nxënësit për përzgjedhjen e programeve të studimit;
- c) përpunim dhe shpërndarje të informacionit mbi programet e studimit, mbi funksionimin e shërbimeve për studentët;
- d) orientim për përfshirjen në tregun e punës etj.

2. Çdo institucion publik i arsimit të lartë parashikon me rregullore të posaçme kujdestarinë (tutoratin) për studentët, për çdo program studimi, nën përgjegjësinë e këshillave të fakulteteve. Ky shërbim synon mbështetjen e studentëve për parandalimin e largimeve apo zgjatjes së kohës së studimeve përtej kohëzgjatjes normale të tyre, i orienton dhe asiston studentët gjatë gjithë programit

të tyre të studimit dhe i nxit për një pjesëmarrje aktive të tyre në jetën universitare në të gjitha fushat dhe format e saj.

3. Çdo institucion publik i arsimit të lartë ndërmerr nisma për t'u bërë të njohur nxënësve të viteve të fundit të shkollës së mesme, programet e studimit që ofron, strukturat përbërëse të tij dhe shërbimet për studentët, për të ndihmuar në këtë mënyrë nxënësit në zgjedhjen e ndërgjegjshme dhe të motivuar të programit/programëve të studimit.

Fakultetet e veçanta organizojnë, gjithashtu, takime orientuese, të programuara dhe të publikuara, për dhënien e informacioneve të detajuara mbi objektivat formues të programeve të ndryshme të studimit, të aktivizuara në fakultetin e tyre, organizimin e tyre, mundësitë për punësim etj.

4. Personeli akademik, brenda kompetencës së tij, është i detyruar të impenjohet në detyrat e organizuara dhe të nxitura nga shërbimet e përcaktuara më sipër.

5. Veprimtaritë e kujdestarisë zhvillohen në bashkëpunim me këshillat studentorë respektivë.

## **XII. Organizimi i studimeve në institucionet private të arsimit të lartë**

1. Institucionet private të arsimit të lartë apo subjektet juridike private, që do të ofrojnë një model të ndryshëm programi studimi nga ai i përcaktuar në pikën 1 të kreut I të këtij udhëzimi, si parashikohet në nenin 45, pika 1 "b" të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, duhet të pasqyrojë dhe vlerësimin në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), për të mundësuar njohjen e studimeve dhe transferimet e studentëve.

Programi i studimi i paraqitur duhet të shoqërohet me rregulloren mësimore të institucionit dhe rregulloret mësimore të programit të studimit, të cilat duhet të përmbajnë elementet kryesore të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Institucionet private të arsimit të lartë, për organizimin e programeve të studimit, i referohen këtij udhëzimi, si dhe akteve të tjera për institucionet publike të arsimit të lartë, në të gjitha rastet kur nuk ka akte të tjera nënligjore që rregullojnë në mënyrë specifike organizimin e studimeve, si dhe çështje të tjera për programin e studimit, në këto institucione.

3. Një institucion privat i arsimit të lartë, që ka organizim të programeve të studimit të ndryshëm nga ai i pikës 1 të këtij kreu, është i detyruar ta njoftojë këtë publikisht, para se të fillojë regjistrimin e studentëve.

## **XIII. Dispozita të fundit**

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi të gjitha institucionet e arsimit të lartë, si dhe subjektet juridike private, të cilat do të aplikojnë për hapjen e institucioneve të arsimit të lartë për të ofruar programe të studimeve të parashikuara në këtë udhëzim.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë organizojnë programet e tyre të studimit, sipas këtij udhëzimi, duke filluar nga viti akademik 2008-2009.

3. Udhëzimet e mëparshme për organizimin e studimeve, si dhe aktet e tjera nënligjore të mëparshme të cilat bien ndesh me këtë udhëzim, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

**Genc Pollo**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.52, datë 16.4.2008, faqe 2336*

## **Lista e programeve të integruara të studimit të nivelit të dytë**

Programe të integruara të studimit të nivelit të dytë janë programet e mëposhtme të studimit:

- a) mjekësi e përgjithshme,
- b) stomatologji,
- c) farmaci,
- d) veterinari.

Shënim. Kësaj liste mund t'i shtohen me propozim të institucioneve të arsimit të lartë dhe miratim të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës edhe programe të tjera studimesh të integruara të ciklit të dytë.

### Shtojca 1

#### 1. Programet e studimeve universitare:

##### a) Programet e studimeve të ciklit të parë

$$3 \text{ vite akademike} = 180 \text{ kredite}$$

$$(60 \text{ kredite/vit} \times 3 \text{ vite} = 180 \text{ kredite});$$

##### b) Programet e studimeve të ciklit të dytë

$$2 \text{ vite akademike} = 120 \text{ kredite}$$

$$(60 \text{ kredite/vit} \times 2 \text{ vite} = 120 \text{ kredite});$$

##### c) Programet e integruara të studimit të ciklit të dytë

$$\text{së paku } 5 \text{ vite akademike} = \text{së paku } 300 \text{ kredite}$$

$$(60 \text{ kredite/vit} \times 5 \text{ vite} = 300 \text{ kredite}).$$

#### 2. Krediti dhe orët mësimore respektive

a) 1 kredit në formimet universitare është 25 orë mësimore pune të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij;

b) Sasia e përgjithshme e orëve mësimore të punës së studentit në 1 vit akademik.

$$60 \text{ kredite} \times 25 \text{ orë mësimore/kredit} = 1500 \text{ orë mësimore/vit};$$

c) Orë mësimore në auditor:

në javë = 20 - 25 orë mësimore

në një vit akademik = 30 javë x (20-25) orë/javë = 600 ÷ 750 orë/vit (rasti kur viti akademik ka 30 javë mësim)

d) Orë mësimore për studim e përgatitje individuale të studentit:

$$1500 \text{ orë/vit} - (600 \div 750) \text{ orë/vit (në auditor)} = 900 \div 750 \text{ orë /vit (studim i ndividual).}$$

#### 3. Kreditet për veprimtaritë e ndryshme formuese

Kreditet për veprimtaritë e ndryshme formuese, të domosdoshme për marrjen e një titulli studimi, përcaktuar në pikën 4, shkronjat "a" dhe "b" dhe në pikën 5, shkronjat "a", "b", "c", "d", të kreut VII të këtij udhëzimi, mund të jenë si më poshtë:

Tipi i veprimtarisë	Cikli i parë	Cikli i dytë
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	rreth 20% (rreth 36 kredite)	rreth 10% (rreth 12 kredite)
Disiplina të formimit karakterizues të programit	rreth 50% (rreth 90 kredite)	rreth 40% (rreth 50 kredite)
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	rreth 10% (rreth 18 kredite)	rreth 10% (rreth 12 kredite)
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët ndërmjet atyre që ofron institucioni	7 - 8% (12 - 14 kredite)	rreth 7 - 8% (8 - 10 kredite)
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktika apo stazhe	rreth 10% (rreth 18 kredite)	rreth 10% (rreth 12 kredite)
Përgatitje e tezës së diplomës	3 - 4% (5 - 7 kredite)	10% - 25% (12 - 30 kredite)
Totali	180 kredite	120 kredite

3.1. Modele të mundshme për qëllime metodologjike të shpërndarjes së krediteve:

a) Kredite në një model të mundshëm programi studimi të ciklit të parë në shkencat juridike

<b>Veprimtaria formuese</b>	<b>Fusha disiplinore</b>	<b>Kredite</b>
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	E drejta romake. Histori e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Hyrje në filozofi. Filozofia e së drejtës. Historia e institucioneve. E drejta kushtetuese. Sociologjia e së drejtës etj.	35
Disiplina të formimit karakterizues të programit	E drejta administrative. E drejta tregtare. E drejta e punës. E drejta civile. E drejta private. E drejta penale. Institucionet e së drejtës publike. Institucionet e së drejtës private. E drejta ndërkombëtare. Ekonomia politike etj.	95
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Disiplina juridike (Kriminalistikë, Mjekësi ligjore,...). Statistikë. Ekonomi tregu etj.	20
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	10
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktika apo stazhe	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, aftësi komunikimi e logjike, praktikë apo stazh etj.	14
Teza e diplomës		6
<b>Totali</b>		<b>180</b>

b) Kredite në një model të mundshëm programi studimi të inxhinierisë mekanike

<b>Veprimtaria formuese</b>	<b>Disiplina/at</b>	<b>Diplomë e nivelit të parë</b>	<b>Diplomë e nivelit të dytë</b>
		<b>Numri i krediteve</b>	<b>Numri i krediteve</b>
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	Disiplina matematike, informatikë, statistikë, fizikë e përgjithshme, kimi, fizikë eksperimentale, fizikë e trupit të ngurtë etj.	40	12
Disiplina të formimit karakterizues të programit	Disiplina të inxhinierisë mekanike, energjetike, të menaxhimit etj.	90	60
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Disiplina inxhinierike, si elektroteknikë, hidraulikë, kulturë juridike ekonomike etj.	20	10
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	12	8
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktika apo stazhe	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, praktikë apo stazh etj.	12	10
Teza e diplomës		6	20
<b>Totali</b>		<b>180</b>	<b>120</b>

c) Kredite në një model të mundshëm programi të integruar studimi të ciklit të dytë: stomatologji

<b>Veprimtaria formuese</b>	<b>Fusha disiplinore</b>	<b>Kredite</b>
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	Disiplina të përgjithshme për formimin e stomatologut (biologjia e aplikuar, fizikë, psikologji e përgjithshme, statistikë), morfologji njerëzore e funksione biologjike lidhur me organet e aparatet njerëzore (fiziologji, anatomi humane, istologji) etj.	50
Disiplina të formimit karakterizues të programit	Diagnostikë laborator (biokimi klinike, biologji molekulare, patologji, mikrobiologji), disiplina mjekësore me vlerë për stomatologjinë (farmakologji, mjekësi e brendshme, anatomi patologjike, neurologji, ...), disiplina stomatologjike e radiologjike	160
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Formime ndërdisiplinore (kimi e përgjithshme, kimi organike, shkenca dhe teknologjia e materialeve), mjekësi plastike, sëmundje infektive, mjekësi ligjore, njohuri sociologjike etj.	30
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	15
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike, praktika apo stazhe	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, praktikë apo stazh etj.	15
Teza e diplomës		30
<b>Totali</b>		<b>300</b>

d) Kredite në një model të mundshëm programi studimi të ciklit të parë për formimin e mësuesve të ciklit të ulët

<b>Veprimtaria formuese</b>	<b>Fusha disiplinore</b>	<b>Kredite</b>
Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë)	Pedagogjia e përgjithshme, histori e pedagogjisë, teori dhe filozofi edukimi, psikologji e përgjithshme, psikologji zhvillimi dhe edukimi, sociologji etj.	35
Disiplina të formimit karakterizues të programit	Disiplina pedagogjike e metodologjiko-didaktike, disiplina historike, gjeografike, ekonomiko-juridike, disiplina shkencore (botanikë, zoologji, kimi, fizikë, matematikë, etj), disiplina gjuhësore-letrare, disiplina artistike (muzikë, vizatim, arte figurative), disiplina sportive etj.	70
Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese	Shkenca teknike mjekësore, higjienë e përgjithshme, higjienë mentale, didaktika dhe pedagogjia speciale etj.	15
Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët	Disiplina të ofruara nga institucioni	10
Veprimtari formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike, praktikë laboratorike.	Njohuri informatike, gjuhë e huaj, aftësime komunikimi e logjike, laboratorë didaktikë, që konsistojnë në analizën, hartimin dhe simulimin e veprimtarive të ndryshme didaktike	20
Praktikë pranë institucioneve shkollore		25
Teza e diplomës		5
<b>Totali</b>		<b>180</b>



4. Raporte të mundshme të veprimtarive formuese brenda 1 disipline

Shpërndarja e krediteve brenda 1 disipline mund të jetë si më poshtë:

<b>Veprimtari formuese brenda disiplinës</b>	<b>Në % të numrit të krediteve për disiplinën</b>
Leksione	50 - 85% e krediteve
Ushtrime/seminare	15 - 33% e krediteve
Laboratorë	15 - 33% e krediteve
Projekte/detyra	8 - 15% e krediteve
<b>Totali</b>	<b>100% e krediteve</b>

Modele të mundshme të ndarjes së krediteve për veprimtaritë formuese, brenda një disipline me 6 kredite, për qëllime metodologjike:

*Model a*

<b>Veprimtari formuese brenda disiplinës</b>	<b>Numri i krediteve për çdo veprimtari brenda disiplinës</b>
Leksione	2.5 - 5 kredite
Ushtrime	1 - 2 kredite
Laboratorë	1 - 2 kredite
Projekte/detyra	0.5 - 1 kredite
<b>Totali</b>	<b>6 kredite</b>

*Model b*

<b>Veprimtari formuese brenda disiplinës</b>	<b>Numri i krediteve për çdo veprimtari brenda disiplinës</b>
Leksione	3.5 - 5 kredite
Seminare	1 - 2 kredite
Ushtrime	0.5 kredite
<b>Totali</b>	<b>6 kredite</b>

5. Ndarja e orëve mësimore për një kredit

Për veprimtaritë e ndryshme mësimore, ndarja e orëve mësimore të një krediti (gjithsej 25 orë) në orë për transmetim dijesh në auditor dhe orë për studim individual të studentit, mund të jetë:

<b>Lloji i veprimtarisë</b>	<b>Numri i krediteve</b>	<b>Orë në auditor</b>	<b>Orë studimi individual</b>	<b>Gjithsej orë</b>
Leksione	1 kredit	6 - 12	19 - 13	25
Seminare	1 kredit	6 - 8	19 - 17	25
Ushtrime	1 kredit	12 - 18	13 - 7	25
Laboratorë	1 kredit	18 - 25	7 - 0	25
Projekt kursi/ detyra	1 kredit	1 - 2	24 - 23	25
Praktikë/ekspedita	1 kredit	20 - 25	5 - 0	25

Konsiderohen orë mësimore në auditor edhe orët mësimore që zhvillohen gjatë praktikave mësimore a profesionale, ekspeditave etj., pjesë e planit mësimor, dhe që asistohen nga personel akademik/tutor.

Bazuar në tabelën më sipër, ndarja e orëve mësimore të një krediti për “Leksione”, do të thotë:

6 orë në auditor - 19 orë studim individual = 25 orë  
 (3 orë përgatitje për 1 orë leksion)  
 8 orë “ - 17 orë “ “ = 25 orë  
 (2 orë përgatitje për 1 orë leksion)  
 10 orë “ - 15 orë “ “ = 25 orë  
 (1.5 orë përgatitje për 1 orë leksion)  
 12 orë “ - 13 orë “ “ = 25 orë  
 (1 orë përgatitje për 1 orë leksion)

Ndarja e orëve mësimore për një kredit leksion varet nga tipi i disiplinës dhe mënyra më e përshtatshme për përvetësimin e saj p.sh., mund të përdoret ndarja:

- disiplina të shkencave shoqërore e humane  
 leksione në auditor = 7 - 9 orë, studim individual = 18 - 16 orë;  
 - disiplina të shkencave natyrore dhe të aplikuara  
 leksione në auditor = 8 - 10 orë, studim individual = 17 - 15 orë;  
 - disiplina të gjuhëve të huaja  
 leksione në auditor = 12 orë, studim individual = 13 orë.

Model për qëllim metodologjik

Disiplinë me 6 kredite:

6 kredite x 25 orë/kredit = 150 orë punë në auditor dhe studim e individual.

Zgjidhet nga lektori ndarja e krediteve në veprimtaritë e ndryshme mësimore, si më poshtë:

leksione	-	3 kredite
ushtrime	-	1.5 kredite
laboratore	-	0,5 kredite
projekt	-	1 kredit

---

Gjithsej 6 kredite

Zgjidhet ndarja e orëve mësimore për një kredit, në orë që zhvillohen në auditor dhe orë pune të studentit për studim individual, si më poshtë:

1 kredit leksion:	10 orë në auditor, 15 orë studim individual;
1 kredit ushtrime:	12 orë në auditor, 13 orë studim individual;
1 kredit seminare:	8 orë në auditor, 17 orë studim individual;
1 kredit laboratore:	24 orë në auditor, 1 orë studim individual;
1 kredit projekt:	2 orë në auditor, 23 orë punë individuale.

Në trajtë përmbledhëse, shpërndarja e 150 orëve mësimore punë gjithsej, në auditor dhe për studim individual, për disiplinën me 6 kredite, është si më poshtë:

Leksione: 3 kredite x 10 orë = 30 orë në auditor (45 orë studim individual)  
 Ushtrime: 1.5 kredite x 12 orë = 18 orë në auditor (19.5 orë studim individual)  
 Laboratore: 0,5 kredite x 24 orë = 12 orë në auditor (0.5 orë studim individual)  
 Projekt: 1 kredit x 2 orë = 2 orë në auditor (23 orë punë individuale)

---

6 kredite (gjithsej 150 orë) = 62 orë në auditor dhe 88 orë studim individual

Shtojca 2

Nota mesatare e ponderuar (Mp) njehsohet si më poshtë:

$$M_p = \frac{\sum_{i=1}^{nd} k_{id} * N_{id}}{\sum_{i=1}^{nd} k_{id}}$$

ku:

**nd:** numri i disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese, përfshirë dhe tezën e diplomës;  
**k<sub>id</sub>:** numri i krediteve për një disiplinë, apo veprimtari tjetër formuese, përfshirë dhe tezën e diplomës;

**N<sub>id</sub>:** nota e marrë në disiplinën respektive, veprimtarinë formuese apo për tezën e diplomës.

Shuma e  $\sum_{i=1}^{nd} k_{id}$  do të jetë:

- 180 për programet e studimit të ciklit të parë;
- 120 për programet e studimit të ciklit të dytë;
- jo më pak se 300 për programet e integruara të studimit të ciklit të dytë.

Shembull i thjeshtuar i njehsimit të notës mesatare të ponderuar të dy studentëve për tri disiplina:

Studenti I:

Disiplina D<sub>1</sub>: Nota e marrë: N<sub>1</sub> = 10, kreditet: k<sub>1</sub> = 6 kredite;

Disiplina D<sub>2</sub>: Nota e marrë: N<sub>2</sub> = 6, kreditet: k<sub>2</sub> = 4 kredite;

Disiplina D<sub>3</sub>: Nota e marrë: N<sub>3</sub> = 7, kreditet: k<sub>3</sub> = 3 kredite;

$$Mp = \frac{\sum_{i=1}^{nd} k_{id} * N_{id}}{\sum_{i=1}^{nd} k_{id}} = \frac{6 * 10 + 4 * 6 + 3 * 7}{6 + 4 + 3} = 8.076$$

Studenti II:

Disiplina D<sub>1</sub>: Nota e marrë: N<sub>1</sub> = 10, Kreditet: k<sub>1</sub> = 3 kredite;

Disiplina D<sub>2</sub>: Nota e marrë: N<sub>2</sub> = 6, Kreditet: k<sub>1</sub> = 6 kredite;

Disiplina D<sub>3</sub>: Nota e marrë: N<sub>3</sub> = 7, Kreditet: k<sub>1</sub> = 4 kredite;

$$Mp = \frac{\sum_{i=1}^{nd} k_{id} * N_{id}}{\sum_{i=1}^{nd} k_{id}} = \frac{3 * 10 + 6 * 6 + 4 * 7}{3 + 6 + 4} = 7.230$$

Për nota të njëjta, pra dhe notë mesatare aritmetike të njëjtë, nota mesatare e ponderuar është e ndryshme për dy studentët, pasi notat e njëjta i kanë marrë në disiplina me numër të ndryshëm kreditesh apo me pesha të ndryshme.

## UDHËZIM

Nr.34, datë 29.9.2008

### PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2008-2009 NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR ZBATIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,

#### UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të fillojë më 13 tetor 2008 dhe të përfundojë më 30 shtator 2009.

2. Viti akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë, diploma të nivelit të dytë, dhe në programet e studimit “master i nivelit të parë” me kohë të plotë, të fillojë në datën 20 tetor 2008 e të përfundojë në datën 30 shtator 2009.

3. Viti akademik 2008-2009 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të tretë “master i nivelit të dytë” me kohë të plotë, të fillojë në datën 10 nëntor 2008 e të përfundojë më datën 30 shtator 2009.

4. Viti akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe në distancë të fillojë në datën 10 nëntor 2008 dhe të përfundojë në datën 30 shtator 2009.

5. Brenda datës 10 nëntor 2008, institucionet publike të arsimit të lartë të njohin studentët me pjesët e statutit që përcaktojnë treguesit e programeve të studimit, rregulloren mësimore të institucionit dhe rregulloren e programit të studimit në të cilin ata janë regjistruar.

6. Raportet e kohëzgjatjes së veprimtarive të ndryshme mësimore, gjatë vitit akademik 2008-2009, të përcaktohen nga institucionet publike të arsimit të lartë, në funksion të natyrës së programit të studimit dhe të afishohen në mjedise të dukshme.

7. Periudha 24 dhjetor 2008 deri më 5 janar 2009, të jetë periudhë pushimesh për studentët.

8. Ndarja e grupeve mësimore për të gjitha vitet e studimit dhe përgatitja e regjistrave të grupeve të përfundojë deri në datën 10 tetor 2008.

9. Miratimi dhe shpërndarja e mësimdhënies së normuar vjetore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar, në programet e studimit me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, në përputhje me udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë ” të përfundojë deri në datën 10 tetor 2008.

10. Miratimi i planeve kalendarike të lëndëve që zhvillohen në programet e studimit me kohë të plotë të përfundojë deri në datën 10 tetor 2008.

11. Miratimi dhe shpërndarja e mësimdhënies së normuar vjetore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar, në programet e studimit me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2008-2009, në përputhje me udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë” të përfundojë deri në datën 30 tetor 2008.

12. Miratimi i planeve kalendarike të lëndëve që zhvillohen në programet e studimit me kohë të pjesshme të përfundojë deri në datën 6 nëntor 2008.

13. Miratimi e shpallja pranë departamenteve përkatëse e strukturës së detyrimeve të çdo programi studimi në çdo formë studimi të ofruar, afatet kohore të zhvillimit të provimeve apo formave të tjera të kontrollit përfundimtar të dijeve, të kontrolleve të pjesshme të dijeve, si edhe të paraqitjes e mbrojtjes së tezës së diplomës në përputhje me udhëzimin nr.15, datë 4.4.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” të përfundojë deri në datën 6 nëntor 2008.

14. Miratimi i programimit të kohës vjetore të punës për secilin anëtar të personelit akademik, si edhe nënshkrimi i marrëveshjes vjetore ndërmjet përgjegjësit të njësisë bazë dhe anëtarit të personelit akademik të përfundojë deri në datën 25 nëntor 2008.

15. Të merren masat organizative deri në datën 25 nëntor 2008, për planifikimin dhe realizimin e praktikave (kontrata me institucione dhe ndërmarrje shtetërore apo private etj.) dhe të dërgohet në MASH, një relacion analitik rreth dinamikës së tyre, brenda datës 1.12.2008.

16. Nga institucionet publike të arsimit të lartë të merren masat për zbatimin e udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” dhe deri më datën 25 nëntor 2008 të gjithë studentët e vitit të parë të pajisen me numrat e matrikullimit.

17. Të dhënat e regjistrave të strukturave të organizuara, sipas pikës 5 të urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.150, datë 7.4.2008 “Për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në institucionet e arsimit të lartë”, të dërgohen në MASH në formë elektronike në programin EXCEL, brenda datës 15 dhjetor 2008.

18. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtoritë e konvikteve listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve.

19. Në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, brenda periudhës tetor - nëntor 2008, të informohen studentët e të gjitha cikleve të studimit rreth “Strategjisë së arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, e të akteve nënligjore të bazuara në të dhe të objektivave e kërkesave të

“Procesit të Bolonjës”.

20. Ngarkohen zëvendësministri për arsimin e lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi në vitin akademik 2008 - 2009.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Fatos Beja**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 13.11.2008, faqe 8410*

**UDHËZIM**  
**Nr.35, datë 17.10.2008**

**PËR REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË RISHPËRNDARA NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2008- 2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009”, të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, sipas programeve përkatëse të studimit, kandidatët që shpallen fitues nga kuotat e përcaktuara pas përfundimit të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë.

2. Kandidatët të aplikojnë vetëm për vendet e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me urdhrin nr.462, datë 14.10.2008.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të “Maturës shtetërore” dhe për disa programe studimi, edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.24, datë 3.6.2008 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrin në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008 - 2009”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A3.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët që:

a) nuk kanë mundur të përfshihen në listat e fituesve për t’u regjistruar në ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2008-2009;

b) janë përfshirë në listat e fituesve dhe nuk janë regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2008-2009;

c) janë fitues të regjistruar në një program studimi në vitin akademik 2008-2009 dhe nuk preferojnë ta ndjekin atë program studimi;

d) kanë fituar provimet me zgjedhje në vitet 2007 dhe 2008 dhe nuk figurojnë të regjistruar në programet e studimit në institucionet publike të arsimit të lartë;

e) kanë fituar konkurset e pranimit në Akademinë e Arteve dhe Akademinë e Edukimit Fizik

dhe Sporteve në korrik të vitit 2008 dhe kanë fituar të dyja provimet me zgjedhje Z1 dhe Z2 në vitin 2007 ose 2008.

5. Formulari A3 përmban të gjitha kuotat e përcaktuara në listën bashkëngjitur urdhrit nr. 462, datë 14.10.2008 për secilin program studimi të ciklit të parë dhe mundëson orientimin dhe aplikimin për programin e studimit të preferuar nga kandidati, në bazë të pikëve të fituara dhe të pikëve të fituesit të fundit.

6. Formulari A3 të shpërndahet në DAR/ZA dhe në APRIAL, ku të tërhiqet nga kandidatët, të plotësohet dhe të dorëzohet i plotësuar në institucionin në të cilin është tërhequr.

7. DAR/ZA-të të tërheqin formularët A3 në APRIAL në datën 21 tetor 2008.

8. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4, germa "a", të paraqiten në DAR/ZA në periudhën 22-26 tetor 2008 për të tërhequr formularin A3.

9. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4, gerrat "b", "c", "d" dhe "e", të paraqiten në APRIAL deri në datën 22.10.2008, ora 18.00 për ta tërhequr formularin A3.

10. Dorëzimi nga kandidatët i formularëve A3 të plotësuar bëhet në DAR/ZA dhe APRIAL deri më datë 27.10.2008.

11. DAR/ZA-të sjellin në APRIAL formularët A3 të plotësuar në datën 28.10.2008.

12. APRIAL përpunon të dhënat e marra nga formularët A3 dhe në datën 5.11.2008 shpall listën përfundimtare të kandidatëve fitues të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A3, në përputhje me kuotat e rishpërndara dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dorëzon në datën 6.11.2008, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues sipas programeve përkatëse të studimit, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA. Këto institucione i afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

14. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë deri në datën 15.11.2008. Për regjistrim, kandidati të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie;

b) Certifikatë lindjeje me fotografi;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh;

e) Për kandidatët e përcaktuar në pikën 4/c, vërtetimi i çregjistrimit nga programi i mëparshëm i studimit.

15. Në rast se kandidatët fitues nuk kanë dëftesë pjekurie origjinale të kërkuar në pikën 14/a të mësipërme, të paraqesin dublikatën e dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar nga drejtoria arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse. Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaritetë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë, të cilat të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Pas verifikimit të bërë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaritetë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

16. Veprimet e çregjistrimit përfundimtar të kandidatëve të rinj nga sekretaritetë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë të dokumentohen në regjistrin bazë të studentëve nga data 7.11.2008 deri më datë 15.11.2008. Kandidatëve t'u kthehet dosja individuale me dokumentet e cilësuar në pikën 14 të këtij udhëzimi. Një kopje e listës së kandidatëve të çregjistruar të dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në APRIAL.

17. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritetë e institucioneve publike të arsimit të lartë regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

18. Sekretaria mësimore pajis kandidatin që bën regjistrimin sipas pikës 17 me fletëregjistrimi, ku shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga titullari i institucionit publik të arsimit të

lartë/njësisë kryesore që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor.

19. Tarifa e regjistrimit prej 1500 lekësh, e arkëtuar nga kandidati për regjistrimin përfundimtar të fazës së dytë të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë në institucionin publik të arsimit të lartë, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit, ku institucioni publik i arsimit të lartë ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të institucionit tjetër publik të arsimit të lartë, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i fazës së tretë të regjistrimeve.

20. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga APRIAL me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike brenda datës 30.11.2008.

21. Institucionet publike të arsimit të lartë nga data 6.11.2008 të shpallin, në vende të dukshme në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit/çregjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

22. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

23. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, Drejtoria e Kurrikulës, APRIAL, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Fatos Beja

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 13.11.2008, faqe 8411*

#### UDHËZIM

**Nr.36, datë 22.10.2008**

### **PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE MASTER I NIVELIT TË PARË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit të miratuara për vitin akademik 2008- 2009”,

#### UDHËZOJ:

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Kandidatët fitues përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë në bazë të kriterëve të pranimit të përcaktuara nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të publikuara më parë.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë. Procesi të monitorohet nga administrata e rektoratit dhe e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë.

5. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, të zhvillohet nga data 23.10.2008 deri në datën 27.10.2008, prej orës 8.<sup>00</sup> deri në orën 18.<sup>00</sup> pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore. Për regjistrim, aplikanti të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Certifikatë personale me fotografi;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2500 lekësh.

6. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, të ngrihen komisione *ad-hoc*, për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, në përputhje me kriteret e pranimit të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

7. Komisionet *ad-hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, përcaktojnë mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara për të gjithë ata kandidatë që vijnë nga programe studimi të ngjashme, të ciklit të parë.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16.<sup>00</sup> të datës 28.10.2008, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga kandidatët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara me vendimin nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave.

9. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 29.10.2008 deri në datën 31.10.2008, prej orës 8.<sup>00</sup> deri në orën 18.<sup>00</sup> pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës.

10. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare origjinale me regjistrimet e kryera brenda datës 30.11.2008, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

11. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 23.10.2008, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar e elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

13. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, zëvendësministri për arsimin e lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Fatos Beja**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 13.11.2008, faqe 8414*



**UDHËZIM**  
**Nr.37, datë 29.10.2008**

**PËR TRANSFERIM STUDIMESH NË CIKLIN E PARË ME KOHË TË PLOTË NË VITIN**  
**AKADEMIK 2008 - 2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 35 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1037, datë 2.7.2008 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si edhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2008-2009”,

**UDHËZOJ:**

1. E drejta për të transferuar studimet apo për të ndjekur studimet në një program tjetër studimi, në ciklin e parë me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, i takon çdo individ që është:

- a) Shtetas i Republikës së Shqipërisë;
- b) Shtetas i huaj me kombësi shqiptare;
- c) Shtetas i huaj.

2. Transferimi mund të realizohet midis institucioneve të arsimit të lartë, të cilat janë krijuar sipas kuadrit ligjor “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të njohura si të tilla me vendimin nominativ të Këshillit të Ministrave, si dhe nga institucionet e huaja të arsimit të lartë drejt institucioneve publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

3. Transferimi midis programeve të të njëjtit cikël të bëhet në një nga këto mënyra:

- i) Transferim brenda të njëjtit institucion publik të arsimit të lartë;
- ii) Transferim midis institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë;

iii) Transferimi mund të bëhet edhe nga programet e mëparshme në programet e studimit të ciklit të parë.

4. Transferimi i studimeve midis institucioneve publike të arsimit të lartë, si dhe nga institucionet private të arsimit të lartë drejt institucioneve publike të arsimit të lartë të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në statutet e institucionit dhe rregulloren e njësisë kryesore ku bëhet transferimi i studimeve, si dhe në përputhshmëri me numrin e kuotave, të cilat jepen për transferime studentësh nga Këshilli i Ministrave për çdo vit akademik, të detajuara këto në urdhrin e Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës për shpërndarjen e këtyre kuotave.

5. Për regjistrimin e studentëve që transferohen veprohet si vijon:

i) Njësitë kryesore të institucioneve publike pritëse të arsimit të lartë vendosin kritere specifike, në varësi të formës së studimit dhe të programit përkatës të studimit dhe i bëjnë ato publike paraprakisht;

ii) Njësitë kryesore të institucioneve publike pritëse të arsimit të lartë ngrenë komisione *ad-hoc* të transferimeve me anëtarë të personelit akademik për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me kriteret e vendosura, si edhe njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara prej tyre në programet apo vitet e mëparshme të studimit;

iii) Transferimi kryhet si transferim i vitit akademik dhe josemestral.

iv) Institucionet dërguese të arsimit të lartë duhet të certifikojnë kundrejt institucioneve pritëse çdo dokumentacion që ka të bëjë me nivelin e studimeve të kryera nga studenti dhe rezultatet e arritura prej tij.

v) Në kuadër të veprimtarisë së orientimit dhe kujdestarisë për studentët, këshilltarë nga personeli akademik në çdo institucion të arsimit të lartë duhet të informojnë studentët për karakteristikat e përgjithshme të edukimit të kërkuar, si dhe për institucionet e ndryshme të arsimit të lartë.

vi) Për lehtësim të procesit, institucionet e arsimit të lartë të përgatisin një format aplikimi për transferim studimesh.

6. Aplikimi për transferim bëhet pranë njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, brenda afateve kohore të përcaktuara dhe të bëra publike nga institucionet e arsimit të lartë dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për transferim;
- b) Formularin tip, të hartuar dhe të publikuar nga institucionet e arsimit të lartë, të plotësuar;
- c) Përmbajtjen e programit të studimit, listën e lëndëve, të krediteve dhe të notave të fituara pranë institucionit të arsimit të lartë përkatës.

7. Studentët që transferojnë studimet midis programeve të ciklit të parë, kërkohet që të kenë marrë të paktën 30 kredite në disiplina që përfshihen në “disiplina të formimit të përgjithshëm” dhe në “disiplina të formimit karakterizues”, në programet që ata kanë studiuar.

8. Nga rregulli i parashikuar në pikën 7 bëhet përjashtim për studentët që transferohen brenda programeve të të njëjtit cikël, nga studimi me kohë të plotë në studimin me kohë të pjesshme. Për shkak të natyrës së studimeve me kohë të plotë, studenti mund të kalojë në formën e studimit me kohë të pjesshme, pa pasur kreditet e mësipërme.

9. Studentëve që transferohen nga programet e mëparshme të studimit në një program studimi të ciklit të parë, duhet t’u vlerësohen programet e bëra dhe rezultatet e marra të jenë të barasvlershme me jo më pak se 30 kredite në programin ekzistues të institucionit publik pritës të arsimit të lartë.

10. Ngarkohet zëvendësministri i arsimit dhe i shkencës, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Fatos Beja

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 13.11.2008, faqe 8415*

## **UDHËZIM** **Nr.38, datë 3.11.2008**

### **PËR ADMINISTRIMIN E KUOTAVE PËR SHTETASIT E HUAJ QË DO TË STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2008- 2009, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në zbatim të pikës 1 ç dhe 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1037, datë 2.7.2008 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në IAL publike, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009”

#### **UDHËZOJ:**

1. Studentët që vijnë në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, të përzgjidhen, për programet e studimit të kërkuara, në bazë të dosjeve të ardhura nga përfaqësitë diplomatike ose nga ministrinë e arsimit të vendeve përkatëse.

2. Numri i kuotave të përcaktuara për studentë që vijnë në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe plotësohet nga shtetas të huaj që nuk vijnë në kuadër të këtyre marrëveshjeve.

3. Kjo kategori studentësh duhet të paraqesë në sektorin e marrëdhënieve me jashtë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për programin e studimit, në të cilin do të studiojë.

b) Formularin e aplikimit, të plotësuar.

c) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit, të përkthyer dhe të legalizuar në gjuhën shqipe.

d) Fotokopje të njësuar të diplomës së shkollës së mesme, bashkë me vërtetimin nga Ministria e Arsimit dërguese se diploma është e vlefshme për të vazhduar studimet e larta.

e) Certifikatën mjekësore të përkthyer dhe të legalizuar.

f) Kopjen e lejeqendrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme.

4. Përzgjedhja e studentëve, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, të kryhet pasi të shqyrtohet nga Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe nga sektori i marrëdhënieve me jashtë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dokumentacioni i paraqitur nga këta shtetas të huaj.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë listën e studentëve të përzgjedhur sipas këtij udhëzimi, për t'u regjistruar në programet e studimit përkatës.

6. Ngarkohen Zëvendësministri i Arsimit të Lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, sektori i marrëdhënieve me jashtë, rektoratet e institucioneve publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

**Fatos Beja**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 7.1.2008, faqe 10718*

## **UDHËZIM**

**Nr.40, datë 22.11.2008**

### **PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA TË PRANIMEVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË NË VITIN AKADEMIK 2008 - 2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5. 2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009"

#### **UDHËZOJ:**

1. Plotësimin e kuotave të porealizuara të pikës 1/a të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, pas përfundimit të regjistrimit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, sipas udhëzimit nr.35, datë 17.10.2008.

2. Kuotat e porealizuara të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, të ndara ndërmjet këtyre institucioneve sipas programeve të ndryshme të studimit, janë pasqyruar në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Agjencia e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL) të përgatisë formularin A4 me programet e studimit dhe kuotat përkatëse, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A4 të gjithë kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore 2008; dhe

b) nuk janë regjistruar në asnjë program studimi të ciklit të parë të studimeve, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2008-2009.

5. Formularët A4 të shpërndahen në DAR/ZA dhe në APRIAL.

6. DAR/ZA-të të tërheqin formularin A4, të personalizuar, APRIAL në datën 23 nëntor 2008.

7. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4 të këtij udhëzimi, që kanë plotësuar më parë formularin A3 dhe nuk janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë, të paraqiten në DAR/ZA në periudhën 24-28 nëntor 2008 për të tërhequr, plotësuar dhe dorëzuar formularin A4.

8. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4 të këtij udhëzimi, që nuk kanë aplikuar nëpërmjet formularit A3, të paraqiten në APRIAL në periudhën 24-28 nëntor 2008 për të tërhequr, plotësuar dhe dorëzuar formularin A4.

9. DAR/ZA-të sjellin në APRIAL formularët e plotësuar në datën 29 nëntor 2008.

10. Plotësimi i kuotave të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009 në Akademinë e Arteve të rregullohet me një udhëzim të veçantë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

11. Ngarkohen për zbatimin të këtij udhëzimi Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës për Arsimin e Lartë, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë, Agjencia e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL), institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Fatos Beja

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 7.1.2008, faqe 10719

#### KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

	Programi i studimit	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	Σ
1	Gjuhë-letërsi				49				49
2	Gazetari								0
3	Edukatë qytetare								0
4	Gjuhë angleze				59	67			126
5	Anglisht (Kukës)	16							16
6	Anglisht (Sarandë)	19							19
9	Frëngjisht			69			71		140
10	Italisht			14	55		51	70	190
11	Gjermanisht			69			69		138
12	Gjuhë-letërsi greke				70				70
13	Cikli i ulët			58	63	61		14	196
14	Cikli i ulët parashkollor			63	51	53	24	73	264
16	Fizkulturë						22		22
17	Matematikë						60	100	160
18	Fizikë						53		53
19	Matematikë-fizikë			100	79	56			235
20	Biologji-kimi				63		41		104
21	Matematikë-informatikë				100	82			182
22	Informatikë							100	100
23	Teknologji informacioni							100	100
24	Punë sociale								0
25	Infermieri e përgjithshme (Kukës)	41							41
26	Mami (Infermieri)					28	20		48
27	Turizëm				38	39			77
28	Marketing								0
30	Inxhinieri navigacioni							17	17
31	Inxhinieri mekanike							100	100
32	Menaxhim agrobiznesi (Lushnjë)		23			39			62
33	Financë-kontabilitet (Lushnjë)		13						13
34	Agromekanikë		19						19
35	Hortikulturë (Lushnjë)		24						24
36	Hortikulturë					55			55
37	Zootekni dhe biznes blegtoral		31						31
38	Vreshtari-enologji		32						32
39	Inxhinieri agronomike					50			50
	Gjithsej	76	142	373	519	530	411	574	2625

**UDHËZIM**  
**Nr.41, datë 4.12.2008**

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË  
STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT  
TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11. 2008 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2008-2009”,

**UDHËZOJ:**

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

2. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme. Procesi të monitorohet nga administrata e Rektoratit dhe e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme.

4. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore dhe të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të;

b) Dokument identifikimi (certifikatë lindjeje me fotografi ose pasaportë). Në dosje të mbahet certifikata e lindjes me fotografi ose fotokopja e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh.

5. Në qoftë se kandidati fitues nuk ka dëftesë pjekurie origjinale, siç përcaktohet në pikën 4/a të udhëzimit, duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse.

6. Kandidatët që do të regjistrohen në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretaritë mësimore diplomën e lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë (ose fotokopje të saj të noterizuar) ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar e barasvlefshme me të.

7. Kandidatët që do të regjistrohen në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme në Akademinë e Edukimit Fizik e Sporteve në Tiranë, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4 dhe 6 të këtij udhëzimi, duhet t’u nënshtrohen kriterëve të veçanta (konkurseve të pranimit) të vendosura nga ky institucion për pranimet në studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

8. Pranë njëjësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe për programe të dyta studimi, të ngrihen komisione *ad-hoc*, me anëtarë të personelit akademik, për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për këto programe, në përputhje me kuotat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008.

9. Institucionet publike të arsimit të lartë t’i shpallin dhe t’i afishojnë listat e kandidatëve

fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësisë kryesore përkatëse, brenda orës 12.00 të datës 15.12.2008, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës.

10. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 15.12.2008 deri në datën 19.12.2008, prej orës 8.00 deri në orën 16.00, pranë sekretarive mësimore të njësisë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës.

11. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar në datën 22.12.2008.

12. Kuotat e pranimeve në studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, të përcaktuara në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

13. Regjistrimi i kandidatëve për transferim studimesh kryhet pas shpërndarjes nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të kuotave të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008, bazuar në pikën 5 të udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.37, datë 29.10.2008 "Për transferim studimesh në ciklin e parë me kohë të plotë në vitin akademik 2008-2009".

14. Regjistrimi i kandidatëve të huaj, sipas shkronjës "ç" të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1549, datë 19.11.2008, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, kryhet pas dërgimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të listës së kandidatëve dhe shpërndarjes së kuotave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

15. Pas mbylljes së procesit të të gjitha regjistrimeve, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare me regjistrimet e kryera brenda datës 30.12.2008 në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

16. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 5.12.2008, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme.

17. Këto njoftime të bëhen publike dhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

18. Ngarkohen Zëvendësministri për Arsimin Lartë, Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Fatos Beja**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 7.1.2009, faqe 10721*

**UDHËZIM**  
**Nr.42, datë 9.12.2008**

**PËR REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË  
PAREALIZUARA NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PLOTË, NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2008- 2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009”,

**UDHËZOJ:**

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, sipas programeve përkatëse të studimit, kandidatët që shpallen fitues në bazë të kuotave të përcaktuara në udhëzimin nr.40, datë 22.11.2008 “Për plotësimin e kuotave të porealizuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2008-2009”.

2. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore dhe për disa programe studimi edhe të rezultateve të konkursit, të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.24, datë 3.6.2008 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2008-2009”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A4.

3. APRIAL përpunon të dhënat e marra nga formularët A4 dhe në datën 9.12.2008 shpall listën përfundimtare të kandidatëve fitues të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A4, në përputhje me kuotat e përcaktuara në udhëzimin nr.40, datë 22.11.2008 dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dorëzon në datën 10.12.2008, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues sipas programeve përkatëse të studimit, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA. Këto institucione afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

5. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë nga data 11.12.2008 deri në datën 16.12.2008. Për regjistrim, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie;

b) Dokument identifikimi (certifikatë lindjeje me fotografi ose pasaportë). Në dosje të mbahet vetëm certifikata e lindjes me fotografi ose fotokopja e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh.

6) Në rast se kandidatët fitues nuk kanë dëftesë pjekurie origjinale të kërkuar në pikën 5/a të mësipërme, të paraqesin dublikatën e dëftesës së pjekurisë së lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar nga drejtoria arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse.

Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaritet mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë, të cilat të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Pas verifikimit të bërë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaritet mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

7. Sekretaria mësimore e pajis kandidatin që regjistrohet me një fletëregjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë i nënshkruar nga dekan i dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit, e vulosur.

8. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritet mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

9. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga APRIAL me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike brenda datës 18.12.2008.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë nga data 10.12.2008 t’i shpallin në vende të dukshme në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

11. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, APRIAL, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Fatos Beja

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 7.1.2009, faqe 10723*

**UDHËZIM**  
**Nr.43, datë 9.12.2008**

**PËR REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË  
PAREALIZUARA NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PLOTË, NË  
AKADEMINË E ARTEVE, NË VITIN AKADEMIK 2008 - 2009**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të pikës 17 të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifën e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009”,

**UDHËZOJ:**

1. Plotësimin e kuotave të parealizuar të pikës 1/a të vendimit nr.1037, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, pas përfundimit të regjistrimit të pranimeve, në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në Akademinë e Arteve sipas udhëzimit nr.35, datë 17.10.2008 “Për regjistrimin e pranimeve për plotësimin e kuotave të rishpërndara për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2008-2009”.

2. Kuotat e parealizuar të pranimeve në Akademinë e Arteve, në vitin akademik 2008-2009, të ndara sipas programeve të ndryshme të studimit, janë pasqyruar në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve (APRIAL), në bazë të dy parimeve:



a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të maturës shtetërore të dhënë në vitet 2007 ose 2008 dhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.24, datë 3.6.2008 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, vitin akademik 2008-2009”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve.

3. APRIAL në datën 9.12.2008 shpall listën e kandidatëve fitues të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre, në përputhje me kuotat e përcaktuara në pikën 2 të këtij udhëzimi dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dorëzon në datën 10.12.2008, në formë të shkruar dhe elektronike, listën përfundimtare të kandidatëve fitues sipas programeve përkatëse të studimit, në Akademinë e Arteve, e cila afishon menjëherë listën në vende të dukshme në mjediset e saj.

5. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarisë mësimore të Akademisë së Arteve nga data 12.12.2008 deri në datën 14.12.2008. Për regjistrim, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie;

b) Dokument identifikimi (certifikatë lindjeje me fotografi ose pasaportë). Në dosje të mbahet vetëm certifikata e lindjes me fotografi ose fotokopja e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh.

6. Në rast se kandidatët fitues nuk kanë dëftesë pjekurie origjinale të kërkuar në pikën 5/a të mësipërme të paraqesin dublikatën e dëftesës së pjekurisë së lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar nga drejtoria arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse.

Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaria mësimore e Akademisë së Arteve, të cilat të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Pas verifikimit të bërë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaria mësimore e Akademisë së Arteve.

7. Sekretaria mësimore e pajis kandidatin që regjistrohet me një fletëregjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fletëregjistrimi duhet të jetë i nënshkruar nga dekan i kryesekretarja mësimore e fakultetit, e vulosur.

8. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaria mësimore e Akademisë së Arteve regjistron studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

9. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, Akademia e Arteve të dorëzojë në MASH dhe në APRIAL listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga APRIAL me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike brenda datës 19.12.2008.

10. Akademia e Arteve nga data 10.12.2008 të shpallë në vende të dukshme në mjediset e saj, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të plotë, në këtë akademi.

11. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga Akademia e Arteve.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri për Arsimin e Lartë, sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, APRIAL dhe Akademia e Arteve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Fatos Beja**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.196, datë 7.1.2009, faqe 10724*

Nr.	Programi i studimit	Kuota	Shuma
1	Kitarë	1	1
2	Klarinetë	1	1
3	Aktrim	4	4
4	Regji	3	3
5	Skenografi	2	2
6	Koreografi	2	2
7	Regji filmi	4	4
8	Skulpturë	2	2
9	Pikturë	1	1
		Gjithsej	20

**UDHËZIM**  
**Nr.21, datë 30.7.2009**

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E  
STUDIMIT TË DOKTORATËS, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË**  
*(Ndryshuar me udhëzim nr.39, datë 8.12.2009)*

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26, pika 1.3, e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar

**UDHËZOJ:**

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të doktoratës duke iu referuar numrit të kuotave të dhëna për programin përkatës.
2. Për t’u pranuar në një program studimi të doktoratës, kandidati duhet të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë, DND, një diplomë të integruar të nivelit të dytë, DIND, dhe çdo diplomë tjetër të vlerësuar të njëvlefshme me to, në fushën e programit të doktoratës apo në një fushë të përafërt të përcaktuar më parë në rregulloren e programit përkatës të doktoratës.
3. Gjithashtu kanë të drejtë të pranohen në programe të doktoratës edhe ata kandidatë që zotërojnë një diplomë apo certifikatë të kualifikimeve të ciklit të tretë të studimeve.
4. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve, pasi marrin paraprakisht mendimin e këshillit të profesorëve dhe i bëjnë ato publike paraprakisht.
5. Njësitë kryesore të institucioneve të arsimit të lartë që janë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit të doktoratës organizojnë edhe procesin e pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në çdo program përkatës studimi doktorate. Procesi monitorohet nga rektorati dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
6. Me caktimin e kuotave nga Këshilli i Ministrave për një program studimi doktorate, institucioni i arsimit të lartë përgjegjës shpall menjëherë hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave për një periudhë 2-javore pasi merr paraprakisht mendimin e njësisë kryesore përgjegjëse për organizimin e këtij programi studimi.
7. Aplikimi për regjistrim në programet e doktoratës bëhet pranë sekretarive të njësisë kryesore përgjegjëse për organizimin e programit përkatës së doktoratës.

8. Kandidatët aplikojnë për t'u regjistruar në një program studimi doktorate me dosje individuale, e cila duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesa e kandidatit drejtuar këshillit të profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e doktoratës.

b) CV personale dhe bibliografi të punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla.

c) Kopje të noterizuar të diplomës së nivelit të dytë (DND) apo të diplomës së integruar të nivelit të dytë, apo të një diplome tjetër studimi, ekuivalente me to, të shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diploma e huaj shoqërohet me vërtetimin e njohjes nga MASH-i.

d) Kopje të noterizuar të diplomave apo certifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose certifikate ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandidati disponon një të tillë.

e) Vërtetim për vazhdimin e programeve të studimit të specializimit, së bashku me listën e notave të fituara deri në atë moment, nëse kandidati është duke ndjekur një program të tillë.

f) Fotokopje të noterizuar të kartës së indentitetit/pasaportës.

g) Dy fotografi.

h) Dy rekomandime nga persona me titull akademik.

i) Një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, sipas përcaktimeve të bëra nga vetë institucioni.

j) Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja (fotokopje të noterizuar).

k) Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar.

l) Mandat për tarifën e aplikimit për konkurrim prej 2000 lekë.

9. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Këshilli i Profesorëve të njësisë kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, përgjegjëse për organizimin e programit përkatës të doktoratës, mbi bazën e propozimit të departamenteve përkatëse. Kandidatët nga personeli akademik, të punësuar me kohë të plotë në institucionet e arsimit të lartë, kanë përparësi.

10. Për shqyrtimin e propozimeve të ardhura nga departamentet, dekanati, në bashkëpunim me Këshillin e Profesorëve të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e doktoratës, ngre komisione *ad-hoc*, sipas departamenteve, të përbëra nga anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm të personelit akademik të drejtimit të studimit në fjalë, që kanë së paku gradën shkencore "doktor". Kryetari i çdo komisioni është përgjegjësi i departamentit. Në rastet kur përgjegjësi i departamentit nuk ka titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar", kryetari i komisionit është një anëtar i Këshillit të Profesorëve dhe përgjegjësi i departamentit është anëtar i komisionit *ad-hoc*.

11. Një javë pas mbylljes së aplikimeve, komisionet *ad-hoc* paraqesin listat e kandidatëve fitues në Këshillin e Profesorëve të njësisë kryesore. Lista e kandidatëve fitues shpallet nga dekanati jo më vonë se 2 javë nga mbyllja e aplikimeve.

12. Dekanati i njësisë kryesore përcakton afatet e ankimimit të kandidatëve të shpallur jo fitues. Dekanati shqyrton çdo aplikim dhe shprehet me vendim. Vendimi i tij është përfundimtar.

13. Kandidatët fitues regjistrohen në sekretarinë e njësisë kryesore përgjegjëse për programin përkatës të doktoratës për një periudhë njëjavore të përcaktuar nga dekanati i njësisë kryesore.

14. Kandidatët fitues duhet të paguajnë një tarifë 5000 lekë për regjistrim në programin e studimit të doktoratës ku janë shpallur fitues. Dosja individuale me dokumentet e aplikantëve jofitues u kthehet atyre kundrejt kërkesës në dorë ose me postë.

15. Studentët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë programe studimi të ciklit të tretë, nuk janë të detyruar të grumbullojnë 60 kreditet e studimeve të organizuara teorike, pjesë e programit të studimit të doktoraturës, vetëm nëse programi i studimit të cilin ata kanë përfunduar apo vijojnë ka formim teorik të njëjtë ose të afërt me atë të programit të doktoratës.

Këshilli i profesorëve ngre komisionet e drejtuara nga kordinatori i programit të doktoratës për njohjen dhe transferimin e krediteve të fituara nga studentët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë një program studimi të ciklit të tretë në varësi të përputhshmërisë së tyre me programin e studimit të doktoratës ku ai është regjistruar. Për çdo student të tillë përcaktohen

veprimtaritë formuese, modulet lëndore dhe kreditet përkatëse, të cilat ai është i detyruar t'i fitojë nga plani i studimeve të organizuara të programit të studimit përkatës të doktoratës.

16. Tarifa e shkollimit për një program doktorate është e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ku brenda vlerës së përcaktuar paraqet:

a) vlerën për pjesën e studimeve të organizuara, e cila ndahet për çdo modul lëndor në varësi të krediteve që i takojnë atij;

b) vlerën për pjesën e studimeve për periudhën që përmbledh kërkimin shkencor dhe përgatitjen e disertacionit deri në marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”.

17. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentit në këste të përcaktuara nga njësi kryesore e institucionit të arsimit të lartë përgjegjës për organizimin e doktoratës. Kësti i parë paguhet menjëherë me regjistrimin e studentit dhe është sa vlera e tarifës për pjesën e studimeve të organizuara. Studentët që kanë transferuar kredite nga programe të tjera të ciklit të tretë paguajnë vlerën përkatëse sipas moduleve lëndore dhe krediteve që ata duhet të fitojnë në programin përkatës të doktoratës.

18. Ngarkohet Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë të cilat organizojnë studime të doktoratës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Fatos Beja

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.134, datë 11.9.2009, faqe 6257*

*Udhëzim nr.39, datë 8.12.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9776*

## UDHËZIM

**Nr.27, datë 17.9.2009**

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 25, DATË 9.9.2009 TË MASH-IT “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2009 - 2010”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.864, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifën e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010”, të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar dhe të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”,

## UDHËZOJ:

1. Në pikën 7.1. të udhëzimit të MASH-it nr.25, datë 9.9.2009 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009–2010”, të shtohen si data regjistrimi: 19 e 20 shtator 2009.

2. Në fund të pikës 7.2.b të udhëzimit nr.25, datë 9.9.2009, të cituar më sipër, të shtohet fjalia:

a) “...Në mungesë të letërnjoftimit ID dhe të pasaportës, certifikatë lindjeje me fotografi.”.

3. Pika 8 e udhëzimit nr.25, datë 9.9.2009, e cituar më sipër, ndryshon si më poshtë vijon:

a) “Institucionet publike të arsimit të lartë, deri në orën 18.00 të datës 21.09.2009, të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL, listën origjinale të përgatitur nga APRIAL-i, me regjistrimet

paraprake të kryera, në formë të shkruar dhe elektronike, në dy kopje, sipas udhëzimit të përgatitur nga APRIAL-i.”.

4. Ngarkohen zëvendësministri i Arsimit dhe i Shkencës, Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, APRIAL, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9758*

**UDHËZIM**  
**Nr.30, datë 10.10.2009**

**PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 18 të vendimit nr.864, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010”, të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, sipas programeve përkatëse të studimit, kandidatët që shpallen fitues nga kuotat e parealizuara, pas përfundimit të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë.

2. Kandidatët të aplikojnë vetëm për vendet e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me urdhrin nr.323, datë 10.10.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të “Maturës Shtetërore” dhe për disa programe studimi edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.18, datë 7.7.2009 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009-2010”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A3.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët:

a) nuk kanë mundur të përfshihen në listat e fituesve për t’u regjistruar në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009-2010;

b) janë përfshirë në listat e fituesve dhe nuk janë regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009-2010;

c) janë fitues të regjistruar në një program studimi në vitin akademik 2009-2010 dhe nuk preferojnë ta ndjekin atë program studimi.

5. Formulari A3 përmban të gjitha kuotat e përcaktuara në listën bashkëngjitur urdhrin nr.323, datë 10.10.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për secilin program studimi të ciklit të

parë dhe mundëson orientimin dhe aplikimin për programin e studimit të preferuar nga kandidati, në bazë të pikëve të fituara dhe të pikëve të fituesit të fundit.

6. Kandidatët e përcaktuar në pikën 4, gjerat “b” dhe “c”, të paraqiten në DAR/ZA, deri në datën 16.10.2009, ora 18.00, për të bërë kërkesë për plotësimin e formularit A3.

7. DAR/ZA dorëzojnë në APRIAL më 18.10.2009 kërkesat e kandidatëve për formularë A3, sipas tabelave përkatëse të rekomanduara nga APRIAL.

8. Formulari A3 të shpërndahet në DAR/ZA më 21.10.2009, nga ku do të tërhiqet nga kandidatët e përcaktuar në pikën 4, gjerat “a”, “b” dhe “c”, të cilët duhet të dorëzojnë formularin e plotësuar në DAR/ZA deri më 26.10.2009.

9. DAR/ZA-t sjellin në APRIAL formularët A3, të plotësuar, në datën 27.10.2009.

10. APRIAL të përpunojë të dhënat e marra nga formulari A3 dhe në datën 30.10.2009 të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe të preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A3, në përputhje me kuotat e rishpërndara dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

11. APRIAL të dorëzojë, në datën 31.10.2009, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues, sipas programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA. Këto institucione afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

12. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë në datat 1, 2, 3 dhe 4 nëntor 2009, nga ora 8.00 deri në orën 18.00. Për regjistrim, kandidati të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie (në mungesë, vërtetim note me fotografi) të nënshkruar nga drejtori i shkollës e nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale (drejtori i zyrës arsimore), si edhe dokument të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë) dhe fotokopje të tij. Në dosje të mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit; në mungesë të tyre, kandidati dorëzon certifikatë personale me fotografi;

c) 2 fotografi;

ç) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh;

d) Për kandidatët e përcaktuar në pikën 4/c, vërtetimi i çregjistrimit nga programi i mëparshëm i studimit.

Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaritet mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë, të cilat të dërgohen në APRIAL. Pas verifikimit të bërë nga APRIAL, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaritet mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

13. Veprimet e çregjistrimit përfundimtar të kandidatëve të rinj nga sekretaritet mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë të dokumentohen në regjistrin bazë të studentëve nga data 1.11.2009 deri më datë 8.11.2009. Kandidatëve t’u kthehet dosja individuale me dokumentet e cilësuar në pikën 14 të këtij udhëzimi. Një kopje e listës së kandidatëve të çregjistruar të dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në APRIAL.

14. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritet mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë të regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit”.

15. Sekretaria mësimore të pajisë kandidatin me fletëregjistrimi ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga titullari i institucionit publik të arsimit të lartë/njësisë kryesore që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor.

16. Tarifa e regjistrimit prej 1500 lekësh, e arkëtuar nga kandidati për regjistrimin përfundimtar të fazës së dytë të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në institucionin publik të arsimit të lartë, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit ku institucioni publik i arsimit të lartë ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të institucionit

tjetër publik të arsimit të lartë, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i fazës së tretë të regjistrimeve.

17. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në APRIAL listat përfundimtare origjinale të përgatitura në APRIAL, me regjistrimet e kryera në formë të shkruar dhe elektronike, brenda datës 8.11.2009.

18. Institucionet publike të arsimit të lartë, nga data 31.10.2009 të shpallin në vende të dukshme, në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit/çregjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

20. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë, Drejtorja e Kurrikulës, APRIAL, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9759*

**UDHËZIM**  
**Nr.37, datë 20.11.2009**

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE DHE PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË  
PAREALIZUARA NË FAZËN E KATËRT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME  
KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN  
AKADEMIK 2009 - 2010**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 18, të vendimit nr.864, datë 29.07.2009, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010”, të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, sipas programeve përkatëse të studimit të shpallura nga MASH-i, kandidatët që shpallen fitues nga APRIAL për kuotat e parealizuara, pas fazës së tretë.

2. Kandidatët për studentë të aplikojnë vetëm për vendet e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës me urdhrin nr.389, datë 19.11.2009 të MASH-it, tabela 1.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të “Maturës Shtetërore” dhe për disa programe studimi edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.18, datë 07.07.2009 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009-2010”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A4.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A4 të gjithë kandidatët, të cilët nuk kanë fituar një vend studimi në listat e fituesve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009 - 2010;

5. Kandidatët, të cilët janë përfshirë në listat e fituesve në fazën II dhe në fazën III dhe nuk janë regjistruar në kohën e caktuar në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2009–2010, duhet të parashtrajnë kërkesë me shkrim në Drejtorinë e Politikave të Arsimit të Lartë dhe MASH-i të autorizojë APRIAL të verifikojë plotësimin e parimit meritë-preferencë të kandidatit dhe të dërgojë zyrtarisht në IAL Publike përkatëse, shkresën për regjistrimin e tij. Afati i këtyre veprimeve është deri më datën 27.11.2009.

6. Formulari A4 përmban të gjitha kuotat e përcaktuara në listën bashkëngjitur urdhrin nr.389, datë 19.11.2009, për secilin program studimi të ciklit të parë dhe mundëson orientimin dhe aplikimin për programin e studimit të preferuar nga kandidati, në bazë të pikëve të fituara nga ai dhe duke u orientuar nga pikët e fituesit të fundit në atë program studimi në Fazën 3.

7. APRIAL shpërndan në DAR/ZA-t më 20.11.2009 formularin A4 për kandidatët maturantë jofitues.

8. Formulari A4 do të tërhiqet nga kandidatët e përcaktuar në pikën 4, të cilët duhet të dorëzojnë formularin e plotësuar në DAR/ZA, deri në datën 25.11.2009.

9. DAR/ZA-t sjellin në APRIAL formularët A4 të plotësuar, në datën 26.11.2009.

10. APRIAL të përpunojë të dhënat e mara nga formulari A4 dhe në datën 30.11.2009 të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve fitues të ndarë, sipas programeve të studimit përkatës, në përputhje me kuotat e rishpërndara dhe njëkohësisht e dorëzon këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

11. APRIAL të dorëzojë, në datën 1.12.2009, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues, sipas programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA. Këto institucione afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

12. Regjistrimi i kandidatëve fitues bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë në datat: nga data 2 deri 5 dhjetor 2009, nga ora 8.00, deri në orën 16.00. Për regjistrim, kandidati të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie (në mungesë, vërtetim note me fotografi, të nënshkruar nga drejtori i shkollës e nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale (drejtori i zyrës arsimore), si edhe dokument të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë) dhe fotokopje të tij. Në dosje të mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit; në mungesë të tyre, kandidati dorëzon certifikatë personale me fotografi;

c) 2 fotografi;

ç) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.500 lekë.

Këta kandidatë të evidentohen edhe në lista të veçanta nga sekretaritë mësimore të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, të cilat të dërgohen në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës. Pas verifikimit të bërë nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të bëhet regjistrimi përfundimtar nga sekretaritë mësimore të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë.

13. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritë mësimore të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë të regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

14. Sekretaria mësimore të pajisë kandidatin me fletëregjistrimi ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, data dhe ora e regjistrimit. Fletë e regjistrimit duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga titullari i institucionit publik të arsimit të lartë/njësisë kryesore që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor.

15. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL listat përfundimtare origjinale në formë elektronike, të



përgatitura nga APRIAL me regjistrimet përfundimtare në vitin e parë të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë për vitin akademik 2009-2010, brenda datës 10.12.2009.

16. Institucionet publike të arsimit të lartë, nga data 1.12.2009 të shpallin në vende të dukshme, në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit/çregjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

17. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

18. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë, APRIAL, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9769*

**UDHËZIM**  
**Nr.38, datë 25.11. 2009**

**PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË  
STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË,  
NË VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1113, datë 13. 11. 2009 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010”,

**UDHËZOJ:**

1. Pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

2. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimin dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë. Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtorja e Politikave të Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit të kërkesave për kandidatët që dëshirojnë të vijojnë programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë.

4. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore dhe të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

- c) 2 fotografi;
- d) Mandatarkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh;
- e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.

5. Në qoftë se kandidati fitues nuk ka dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikat të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/ zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

6. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretaritet mësimorë diplomën e lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë (ose fotokopje të saj të noterizuar), diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit (ose fotokopje të saj të noterizuar), të vlerësuar e barasvlefshme me të.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 26.11.2009, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të aplikimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gryojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë.

8. Aplikimi i kandidatëve në programin e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, të zhvillohet nga data 2.12.2009 deri në datën 8.12.2009, prej orës 8.00 deri në orën 16.00, pranë sekretarive mësimore të njëjve kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

9. Pranë njëjve kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, dhe për programe të dyta studimi, të ngrihen komisione *ad-hoc*, me anëtarë të personelit akademik, për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për këto programe, në përputhje me kuotat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1113, datë 13.11.2009.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallin dhe të afishojnë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njëjve kryesore përkatëse, brenda orës 12.00 të datës 14.12.2009, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës.

11. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë ku janë shpallur fitues, të zhvillohet nga data 14.12.2009 deri në datën 18.12.2009, prej orës 8.00 deri në orën 16.00, pranë sekretarive mësimore të njëjve kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Regjistrimi i kandidatëve fitues të bëhet vetëm me dëftesën e pjekurisë origjinale të shkollës së mesme, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij udhëzimi. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës.

13. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar në datën 22.12.2009.

14. Kuotat e pranimeve në studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, të përcaktuara në pikën 1 të vendimit nr.1113, datë 13.11.2009 të Këshillit të Ministrave, që mbeten të porealizuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

15. Regjistrimi i kandidatëve për transferim studimesh kryhet pas shpërndarjes nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, të kuotave të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të vendimit nr.1113, datë 13.11.2009 të Këshillit të Ministrave, bazuar në pikën 5 të udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr.37, datë 29.10.2008 “Për transferim studimesh në ciklin e parë me kohë të plotë në vitin akademik 2008-2009”.

16. Regjistrimi i kandidatëve nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe për shtetas të tjerë të huaj, sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të vendimit nr.1113, datë 13.11.2009 të Këshillit të Ministrave, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, kryhet pas dërgimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të listës së kandidatëve dhe shpërndarjes së kuotave

të përcaktuara me vendimin nr.1113, datë 13. 11. 2009 të Këshillit të Ministrave.

17. Pas mbylljes së procesit të të gjitha regjistrimeve, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare me regjistrimet e kryera brenda datës 29.12.2009, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

18. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9771*

KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010

Tabela nr.1

KUOTAT E PRANIMEVE TË REJA NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIM NË DISTANCË NË VITIN AKADEMIK 2009-2010

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	Σ
1	Histori	250					60	310
2	Gjeografi	250					60	310
3	Histori-Gjeografi			100	100			200
4	Gjuhë Letërsi	250		100	100	100	60	610
5	Gazetari							
6	Edukate Qytetare			80				80
7	Anglisht							
8	Frëngjisht							
9	Italisht							
10	Gjuhë Spanjolle							
11	Rusisht							
12	Gjermanisht							
13	Gjuhë Letërsi Greke							
14	Gjuhë Turke							
15	Cikli i Ulet			200	100	75	60	435
16	Cikli i Ulet Parashkollor			100	100	75	60	335
17	Fizikure							
18	Matematikë						60	60
19	Fizikë						60	60
20	Inxh. Matematike dhe Informatike							
21	Matematikë-Fizikë			80	100			180
22	Biologji - Kimi			90	100		60	250
23	Biologji	100						
24	Kimi							
25	Kimi ushqimore							
26	Kimi Industriale							
27	Matematikë-Informatikë							
28	Informatikë							
29	Teknologji Informaticioni							
30	Punë Sociale	100		100				200
31	Filozofi							
32	Filozofi-Sociologji			100				100
33	Sociologji							
34	Pedagogji e Specializuar							
35	Psikologji	100						100
36	Shkencat Politike							
37	Drejtësi	200					60	260
38	Shendetë Publik							
39	Mjekësi							
40	Stomatologji							
41	Farmacitë							
42	Infermieri e Pergjithshme							
43	Mami							

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	Σ
44	Teknik Imazherie							
45	Teknik Laboratori							
46	Fizioterapi							
47	Infermieri (Kukës)							
48	Mami (Infermieri)							
49	Tek. i Larte Laboratori							
50	Fizioterapi							
51	Logopedi							
52	Imazheri							
53	Administrim Publik				100			100
54	Administrim-Biznes	130		100		75	60	365
55	Ekonomiks							
56	Ekonomia dhe e Edrejta							
57	Finance-Kontabilitet	130		100	100	90	60	480
58	Info Ekonomike							
59	Administ-Biznes(Turizem)Sarande							
60	Administrim-Biznes (Kukës)							
61	Turizëm				100	75	60	235
62	Marketing					75		75
63	Turizëm ( Pogradec)					60		60
64	Inxh. Navigacioni							
65	Inxh. Metalurgji Materiale							
66	Inxh. Tekstile dhe Mode							
67	Inxhinieri Elektrike							
68	Inxh. Elektronike							
69	Inxh Informatike							
70	Inxh. Telekomunikacioni							
71	Inxh. Mekatronike							
72	Inxhinieri Ndertimi							
73	Inxhinier Hidroteknik							
74	Arkitekturë							
75	Inxh Matematike							
76	Inxh.Fizike							
77	Inxhinier Gjeodet							
78	Inxh. Mjedisi							
79	Inxh. ne Shkencat e tokes							
80	Inxh. Gjeoinformatike							
81	Inxhin. i Gjeoburimeve							
82	Menaxhim Agrobiznesi		100			75		175
83	Ekonomi dhe P. Agrare		100					100
84	Financë-Kontabilitet		100					100
85	Mbrojje bimësh		50					50
86	Hortikulturë		50			75		125
87	Prodhim bimor		50					50
88	Zootekni dhe Biznes Blegtoral		50					50
89	Akuakulturë dhe Menaxh. Peshkimi		50					50

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	Σ
90	Agromjedis dhe Ekologji		50					50
91	Tek. Agroushqimore		50					50
92	Vreshtari-Enologji		50					50
93	Inxhinier Pyjesh		60					60
94	Inxhinier Perpunim Druri		60					60
95	Mjekesi Veterinare							
96	Agromekanizim		30					30
97	Shkenca të Administrimit							
98	Menaxhim Turizmi							
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>1510</b>	<b>850</b>	<b>1150</b>	<b>900</b>	<b>775</b>	<b>720</b>	<b>5905</b>

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UPT
1	Inxh.Mek./ Inxh.Logjistikë Prodhimi	40

**UDHËZIM**  
**Nr.40, datë 8.12.2009**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 9.5.2008 “PËR VEPRIMTARINË E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 47, pika 1 dhe 2, dhe 50 pika 4 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë” të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 7 e udhëzimit nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, ndryshohet si më poshtë:

“7. Elementet e mësimdhënies së normuar vjetore, të përcaktuara në pikën 4.1 të këtij udhëzimi, konvertohen në orë mësimore si më poshtë:

1 orë leksion në studimet e nivelit të parë	1.5 orë mësimore;
1 orë leksion në MNP, MND dhe DND	2 orë;
1 orë ushtrime/seminar	1.0 orë mësimore;
1 orë laborator	0.8 orë mësimore;
1 orë praktikë mësimore/profesionale	0.5 orë mësimore;
1 orë mësim shoqërimi në Akademinë e Arteve	0.5 orë mësimore.”

2. Pika 12.d dhe 12.k shfuqizohen.

3. Pas pikës 12 të shtohet pika 12.1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“12.1 Personeli akademik që angazhohet me udhëheqje teze doktorate dhe oponencë teze doktorate konsiderohen ngarkesë jashtë ngarkesës mësimore vjetore. Pagesa do të kryhet sipas akteve nënligjore në fuqi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9777*

**UDHËZIM**  
**Nr.41, datë 8.12.2009**

**PËR PROCEDURAT E NJOHJES SË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE TË FITUARA  
NË SHKOLLAT E LARTA TË HUAJA**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 37 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Fusha e veprimtarisë së njohjes së diplomave dhe certifikatave në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH):

Fusha e veprimtarisë së njohjes së kualifikimeve të fituara kryhet nga Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe ka për qëllim:

a) Të administrojë dhe të kryejë procedurat për të gjitha aplikimet për njohje të diplomave të përfunduara të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të diplomave Master i nivelit të dytë, si dhe certifikatave të specializimit të fituara jashtë shtetit;

b) Të kryejë procedurën verifikuese për vërtetësinë e certifikatave apo diplomave të tjera universitare të fituara jashtë shtetit që nuk përfshihen në pikën 1. a të këtij udhëzimi, kur kërkohet nga institucione të tjera;

c) Të kryejë procedurën verifikuese për vërtetësinë e certifikatave apo diplomave universitare të fituara në Republikën e Shqipërisë, kur kërkohet nga institucione të tjera jashtë shtetit;

d) Të mos shqyrtojë aplikime për rastet si më poshtë:

1. diploma dhe kualifikime të fituara nga institucione të akredituara në Republikën e Shqipërisë;

2. kurse studimi të paplotësuara; këto shqyrtohen nga institucioni i arsimit të lartë, ku aplikanti kërkon të vijojë/përfundojë studimet, në përputhje me statutin/rregulloren e tij;

3. certifikata për kurse të vetme si gjuhë e huaj, kompjuter etj.;

4. diploma ose certifikata lëshuar nga institucione të huaja që nuk kanë legjitimitetin e duhur;

5. dokumentet që nuk janë origjinale apo të njëvlefshme me to;

6. diploma ose certifikata të fituara në shkolla të larta ushtarake, përjashtuar diplomat për drejtime civile të studimeve;

7. diploma dhe certifikata të fituara në shkolla të larta fetare, përjashtuar diplomat për drejtimet civile të studimeve.

2. Aplikimi për njohje diplome

2.1 Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

a) formatin e aplikimit të plotësuar;

b) diplomën ose certifikatën/vërtetimin e diplomimit;

c) listën e notave ose suplementin e diplomës;

d) dokument zyrtar identiteti: fotokopje e pasaportës dhe kartës së identitetit për shtetasit shqiptarë dhe të huaj;

e) Mandatpagesën.

2.2 Dokumentet pranohen origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentet e përcaktuara në pikën 2.1, germa “b”, “c” dhe “d” për shtetasit e huaj, duhet të jenë me përkthim të vërtetuar.

Të paktën një nga dokumentet bazë që konfirmon diplomimin apo mbarimin e suksesshëm të kursit të studimit që do të njihet, duhet të jetë i legalizuar me vulën apostille ose nga ambasada shqiptare, ose nga Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë. Në rast pamundësie të marrjes së legalizimit, aplikimi do të pranohet edhe pa dokument të legalizuar dhe do të procedohet sipas përcaktimeve të pikës 3.2 të këtij udhëzimi.

2.3 Aplikimi duhet të dërgohet me postë në zyrën e marrëdhënieve me publikun të MASH-

it. Brenda 3 (tri) ditëve Sektori i Njohjes së Diplomave (SENJOD) informon aplikantin për mbërritjen dhe plotësinë e dosjes. Aplikimi nuk quhet i plotë, nëse mungon një nga dokumentet e cituara në pikën 2.1. Informimi mund të bëhet me e-mail ose postë të zakonshme. Nëse komunikimi bëhet me e-mail, duhet të konfirmohet marrja e tij nga aplikanti.

2.4 Aplikimi për njohjen e diplomave të ndryshme të të njëjtit individ, të lëshuara nga i njëjti institucion, konsiderohet si një dhe për të paguhet një tarifë.

### 3. Verifikimi i vërtetësisë së dokumenteve

3.1 SENJOD kryen verifikimin për të gjitha rastet, përfshi edhe njohjen e drejtpërdrejtë të autenticitetit të diplomës apo certifikatës së huaj si të statusit dhe legjitimitetin e institucionit që e ka lëshuar. Për vërtetësinë e diplomimit ose plotësimin të programit të studimit të pretenduar, SENJOD bazohet në dokumentin zyrtar që e konfirmon këtë, të legalizuar sipas pikës 2.2 të këtij udhëzimi.

3.2 Në të gjitha rastet kur dokumenti bazë nuk është i legalizuar sipas përcaktimeve të pikës 2.2, SENJOD, me miratimin e kryetarit të komisionit, nuk bazohet në dokumentin e paraqitur, por kryen verifikimin e tij me postë, faks ose e-mail me institucionin e arsimit të lartë ku është kryer kursi i studimeve.

3.3 Materialet shkresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit.

3.4 Komisioni i njohjes, pasi vë në dijeni ministrin, me miratimin e tij, pezullon procedurën e njohjes për raste ose grupaste të veçanta, kur ka informacione dhe konstatime që hedhin dyshime mbi vërtetësinë e dokumenteve shkollore ose kryerjen e programit të studimit të pretenduar dhe përcakton afatet dhe masat për mbylljen e procedurës.

### 4. Vendimi i njohjes

4.1 Vlerësimi i nivelit, profilit dhe drejtimit që përfshin një diplomë apo certifikatë e caktuar, kryhet nga komisioni i njohjes së MASH-it për rastet:

a) kur është pjesë e kuadrit të një marrëveshjeje ndërshtetërore;

b) kur një diplomë është lëshuar nga një institucion i akredituar në një nga vendet e listuara në aneksin bashkëngjitur këtij udhëzimi;

c) kur për të njëjtin program studimi apo titull diplome lëshuar në të njëjtin shtet, një komision i mëparshëm i MASH-it ka marrë një vendim njohjeje.

4.2 Komisioni i njohjes mund të kërkojë mendim nga universitetet publike ose të kontaktojë ekspertë të fushave përkatëse për raste që gjykon si të nevojshme për të marrë vendim përfundimtar, lidhur me vlerësimin e diplomës ose certifikatës.

4.3 Dosja e aplikantit i paraqitet komisionit të njohjes së MASH-it jo më vonë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë nga mbërritja e saj në MASH, kur ajo është e plotë. Brenda 1 (një) javë nga marrja e dosjes, komisioni i njohjes, mund të marrë vendim sipas përcaktimit në pikat 4.1., 4.2., ose mund të vendosë t'ia kthejë dosjen SENJOD-it për plotësime të nevojshme në dokumentacion, sipas këtij udhëzimi.

4.4 Në përfundim të procedurës, aplikantit i lëshohet një dëshmi njohjeje nga MASH, jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës. Dëshmia nënshkruhet nga kryetari i komisionit të njohjes. Në dëshmi përfshihen vitet e studimit, profili i diplomës, së bashku me drejtime sekondare që nënkupton një program studimi, kur nuk përfshihet ose nuk është i ngjashëm me emërtimet e drejtimeve dhe profileve të studimit në Republikën e Shqipërisë.

4.5 Bazë e vlerësimit të programit dhe kursit të kryer janë lëndët/modulet e programit, numri total i krediteve të fituara, vitet e studimit, kualifikimet që përcaktohen nga kuadri ligjor i vendit të origjinës, krahasuar me kuadrin vendas rregullues.

4.6 Në rastet e mosnjohjes së kursit të studimeve dhe kualifikimit të fituar, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procedurës për njohje, kryetari i komisionit njofton me shkrim aplikantin për mosnjohjen dhe arsyet përkatëse.

4.7 Kur disponohen informacione zyrtare që provojnë pavërtetësinë e informacioneve të mëparshme, komisioni i njohjes rishikon vendimin e marrë.

4.8 E gjithë procedura e njohjes së diplomave dhe certifikatave në MASH përfundon brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga dita kur dosja për aplikim është e plotësuar me dokumentacion e kërkuar sipas pikës 2.1 të këtij udhëzimi.



4.9 Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim te Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ankuesit i kthehet përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së ankesës.

4.10 Aplikanti mund të bëjë ankesë edhe në rast vonese të paarsyetuar. Në rastet kur vonesa ka ardhur jashtë përcaktimeve të udhëzimit dhe si rezultat i mosveprimit të autoritetit shqyrtues, merren masat në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

4.11 SENJOD nuk mban përgjegjësi administrative për vonesa që vijnë për shkak të mospërgjigjes së aplikantit për dorëzimin e dokumenteve shtesë. Aplikanti njoftohet me shkrim (postë, e-mail) për çdo vonesë të përgjigjes prej institucionit të huaj që ka lëshuar diplomën.

4.12 Tarifa për procedurat e njohjes është 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

5. Udhëzimi nr.24, datë 3.9.2007 “Për procedurat e njohjes së diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.201, datë 12.3.2010, faqe 9778*

## ANEKS

Diplomat e lëshuara nga institucione të arsimit të lartë të akredituara në shtetet e mëposhtme, do të shqyrtohen sipas përcaktimit në paragrafin 4.1 dhe 4.2.

1. Shtetet e BE-së, për diploma të lëshuara në kohën kur ky shtet ka qenë anëtar i BE-së;
2. Zvicër;
3. Norvegji;
4. Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
5. Kanada;
6. Japoni;
7. Kore e Jugut.

## UDHËZIM Nr.1, datë 4.1.2010

### **PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA DHE REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KËTYRE KUOTAVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2009 - 2010”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.1113, datë 13.11. 2009 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010”,

## UDHËZOJ:

1. Të plotësohen kuotat e porealizura të shkronjave “a” dhe “ b” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1113, datë 13.11.2009 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010”, pas përfundimit të regjistrimit të pranimeve në

ciklin e parë të studimeve, me kohë të pjesshme, sipas udhëzimit nr.38, datë 25.11.2009 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010”.

2. Të rishpërndahen kuotat e përcaktuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2009 - 2010, sipas programeve të ndryshme të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Kandidatët që do të pranohen në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë përkatës, në vitin akademik 2009-2010, të përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë, vetëm sipas kritereve akademike të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht dhe kuotave të përcaktuara në pikën 2 të këtij udhëzimi.

4. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë. Procesi të monitorohet nga rektoratet përkatëse.

5. Institucionet publike të arsimit të lartë shpallin menjëherë rihapjen e procedurës së pranimit të kërkesave, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gryojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë.

6. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njërive kryesore dhe të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi personale;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1 500 lekësh;

e) Deklaratë që vërteton se kandidati nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme;

7. Kandidatët që kanë depozituar më parë dosjet e tyre në sekretaritë mësimore të njërive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë duhet t'i plotësojnë ato në përputhje me pikën 6 të këtij udhëzimi.

8. Në qoftë se kandidati fitues nuk ka dëftesë pjekurie, siç përcaktohet në pikën 6 të këtij udhëzimi, duhet të paraqesë dublikat të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse ose dhe dokument me listën e notave të lëshuar nga Arkiva e Shtetit dhe të sigluar në DAR/ZA.

9. Kandidatët që do të regjistrohen në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 6 të udhëzimit, të dorëzojnë në sekretaritë mësimore dhe diplomën e lëshuar nga një institucion i arsimit të lartë (ose fotokopje të saj të noterizuar), ose diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar e barasvlefshme me të.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallin dhe të afishojnë listat e të gjithë aplikantëve të renditura sipas rendit zbritës të pikëve të fituara në përputhje me kriteret akademike të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht, në vende të dukshme, në mjediset e njërive kryesore përkatëse, brenda orës 12.00 të datës 9.1.2010 të ndarë sipas programeve të studimit përkatës. Në këto lista të jenë të evidentuar kandidatët fitues.

11. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, ku janë shpallur fitues të kryhet në datat 11, 12, 13,14 janar 2009, prej orës 08.00 deri në orën 16.00, pranë sekretarive mësimore të njërive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në datën 1.2.2009, listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar. Në lista të evidentohet dokumenti shkollor mbi të cilin është bërë regjistrimi.

13. Këto njoftime të bëhen publike dhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

14. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

15. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 799

Tabela nr.1

TABELA PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË P-T

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Nr.	Programi i studimit	Kuota	
		P.1	
1	Hortikulturë	5	
	Shuma	5	

Universiteti i Korçës

Nr.	Programi i studimit	Kuota	
		P.1	
1	Gjuhë letërsi	25	
2	Cikli i ulët	45	
3	Cikli i ulët parashkollor	30	
4	Administrim-biznes	20	
	Shuma	120	

Universiteti i Tiranës

Kuota shtesë/të përndjekurit

Nr.	Programi i studimit	Kuota	
		P.I	P.II
1	Histori	15/5	0
2	Gjeografi	15/7	0
3	Gjuhë-letërsi	10/2	2
4	Biologji	0/1	0
5	Punë Sociale	15/10	5
6	Psikologji	11	5
7	Drejtësi	30/30	5
8	Administrim-biznes	135/1	10
9	Financë-kontabilitet	135/8	6
	Shuma	366/70	33

Kuotat për komunitetin egjiptian

Nr.	Programi i studimit	Kuota	
		UT	UBT
1	Drejtësi	4	
2	Administrim-biznes	1	
3	Punë Sociale	2	
4	Psikologji	2	
5	Agrobiznes		1
	<b>Shuma</b>	<b>9</b>	<b>1</b>

Universiteti i Elbasanit

Nr.	Programi i studimit	Kuota	
		P.I	
1	Histori-Gjeografi	29	
2	Gjuhë-letërsi	23	
3	Edukatë qytetare	25	
4	Cikli i ulët	45	
5	Cikli i ulët parashkollor	27	
6	Matematikë-fizikë	25	
7	Biologji-kimi	30	
8	Punë sociale	27	
9	Filozofi-sociologji	25	
10	Administrim-biznesi	5	
11	Financë-kontabilitet	5	
	<b>Shuma</b>	<b>266</b>	

Universiteti i Shkodrës

Nr.	Programi i studimit	Kuota	
		P.I	
1	Cikli i ulët	20	
2	Cikli i ulët parashkollor	20	
	<b>Shuma</b>	<b>40</b>	

Universiteti Politeknik i Tiranës

Nr.	Programi i studimit	Kuota	
		P.I	
1	Inxhinieri mekanike/inxhinieri logjistikë prodhimi	15	

**UDHËZIM**  
**Nr.4, datë 5.2.2010**

**PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA DHE REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KËTYRE KUOTAVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.1113, datë 13.11.2009, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010”,

**UDHËZOJ:**

1. Të plotësohen kuotat e porealizuara të shkronjës “a” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1113, datë 13.11.2009 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010”, pas përfundimit të regjistrimit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të pjesshme, sipas udhëzimit nr.38, datë 25.11.2009 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010”.

2. Të rishpërndahen kuotat e porealizuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2009-2010, sipas programeve të ndryshme të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e të gjithë aplikantëve, të renditura sipas rendit zbritës të pikëve të fituara, në përputhje me kriteret akademike të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht, në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 12.00 të dates 9.2.2010, të ndara, sipas programeve të studimit përkatës. Në këto lista të jenë të evidentuar kandidatët fitues.

4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, ku janë shpallur fitues të kryhet nga data 9.2.2010, ora 13.00 deri më 13.2.2010, ora 12.00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

5. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në datën 17.2.2010, listat e kandidatëve fitues të regjistruar. Në lista të evidentohet dokumenti shkollor mbi të cilin është bërë regjistrimi.

6. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 807*

TABELA PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE

Nr.	Programi i studimit	UT	UE	USH
		Shtesë	Shtesë	Shtesë
1	Histori			
2	Gjeografi			
3	Gjuhë-letërsi			
4	Biologji	16		
5	Punë sociale	1		
6	Psikologji	1		
7	Drejtësi	21		20
8	Administrim-biznes	10		3
9	Financë-kontabilitet	10		
10	Cikli i ulët parashkollor			
11	Cikli i ulët			
12	Gjuhë-letërsi			
13	Matematikë-fizikë			
14	Kimi-biologji			
15	Administrim-biznes		10	
16	Financë-kontabilitet		10	
17	Turizëm			
18	Histori-gjeografi			
19	Gjuhë-letërsi			
20	Menaxhim-agrobiznesi			
21	Agromjedis dhe ekologji			
22	Ekonomi dhe politika agrare			
	<b>Totali</b>	<b>59</b>	<b>20</b>	<b>23</b>

**UDHËZIM**

Nr.6, datë 16.12.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË SHKOLLAVE TË MESME DHE TË LËNDËVE ME ZGJEDHJE PËR PROGRAME TË NDRYSHME STUDIMI NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, SI KRITER I PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2010 – 2011**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe në pikat 1 e 5 të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Përcaktimin e koeficientëve të shkollave të mesme dhe të lëndëve me zgjedhje, për programe të ndryshme studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, si kriter i përzgjedhjes së kandidatëve në vitin akademik 2010-2011, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, sipas tabelave bashkëngjitur, duke marrë në konsideratë propozimet e institucioneve publike të arsimit të lartë.

2. Institucionet publike të arsimit të lartë, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore, të gjitha drejtoritë e shkollave të mesme dhe të gjithë maturantët/kandidatët e interesuar të njihen me koeficientët, sipas tabelave bashkëngjitur.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zëvendësministrat e arsimit dhe të shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore, si edhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 809

**UDHËZIM**  
**Nr.9, datë 25.2.2010**

**PËR MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN DHE RAPORTIMIN E TË DHËNAVE STATISTIKORE**

Në zbatim të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe “Dispozitave normative për arsimin parauniversitar”, shtator 2002, kreu IV, si dhe ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

**I. Për sistemin parauniversitar:**

1. Të gjitha drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore, të mbledhin, përpunojnë dhe raportojnë në MASH për çdo vit shkollor, të dhënat statistikore bazë, sipas skedarëve të përgatitur nga Drejtoria e Analizës, Statistikave dhe Planifikimit Strategjik (DASPS) në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Të gjitha DAR/ZA të ndjekin me përparësi:

- a) Saktësinë e përpunimit të të dhënave statistikore në nivel shkolle;
- b) Saktësinë e përpunimit të të dhënave statistikore në nivel DAR/ZA;
- c) Respektimin e afateve kohore sipas këtij udhëzimi.

3. Të dhënat e përpunuara sipas skedarëve të raportohen me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike pranë DASPS në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në afatet e përcaktuara.

4. Të dhënat paraprake sipas skedarëve, të përcaktuara për regjistrimet e vitit të ri shkollor në arsimin publik dhe privat, në nivel DAR/ZA, të mblidhen, përpunohen dhe dërgohen në MASH, jo më vonë se 5 ditë pas fillimit të procesit mësimor.

5. Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara nga DAR/ZA, për regjistrimet e vitit shkollor në bazë shkolle, të dërgohen në MASH me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike (në CD), jo më vonë se 20 tetori.

6. Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara nga DAR/ZA, për zhvillimin e gjuhëve të huaja, të dërgohen me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike (në CD) në MASH, jo më vonë se 20 nëntori.

7. Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara nga DAR/ZA, për përfundimet e semestrit të parë, të dërgohen me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike (në CD) në MASH, jo më vonë se 20 shkurti (sipas skedarit bashkëlidhur, pasqyra A/9VJ dhe A/Mes).

8. Të dhënat e shkollave, të mbledhura dhe të përpunuara nga DAR/ZA, për përfundimet e vitit shkollor (qershor), të dërgohen me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike (në CD) në MASH, jo më vonë se 15 korriku.

9. Të dhënat e shkollave, të mbledhura dhe të përpunuara nga DAR/ZA, për përfundimet e vitit shkollor (qershor+vjeshtë), të dërgohen me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike (në CD) në MASH, jo më vonë se 25 shtatori. DAR/ZA të dërgojnë të dhënat për nxënësit maturantë që japin provimet e sezonit të dytë të MSH 5 ditë pas marrjes së rezultateve nga AVA.

10. Të gjitha DAR/ZA, në raste të veçanta, duhet të mbledhin dhe të përpunojnë të dhëna sipas skedarëve *ad-hoc* dhe t'i dërgojnë ato në MASH në afatet e përcaktuara.

11. Në zbatim të këtij udhëzimi, të gjitha DAR/ZA, jo më vonë se dy javë pas marrjes së tij, të hartojnë udhëzuesit e tyre, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore në bazë shkolle dhe t'i shpërndajnë ato në të gjitha shkollat publike dhe jopublike që kanë në varësinë e tyre.

12. Agjencia Qendrore e Vlerësimit dhe Arritjeve të Nxënësve (AVA), në përfundim të procesit të vlerësimeve për provimet e lirit të klasës së nëntë dhe provimet e Maturës Shtetërore, duhet të dërgojë në MASH një kopje të raportit statistikor vjetor për ciklin 9-vjeçar dhe atë të mesëm, jo më vonë se 15 dhjetori.

13. Instituti i Kualifikimit dhe Trajnimit duhet të dërgojë në MASH të dhëna në lidhje me nivelin arsimor të mësuesve sipas cikleve dhe numrin e mësuesve e drejtuesve të trajnuar gjatë vitit, jo më vonë se 15 dhjetori.

14. DASPS t'i dërgojë në formë elektronike (me CD) në çdo DAR/ZA, të gjitha modelet e skedarëve përkatës për raportim, si dhe të kryejë trajnimin e të gjithë specialistëve të statistikës së DAR/ZA, jo më vonë se 30 prilli.

## II. Për sistemin universitar:

1. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike, të mbledhin, përpunojnë dhe raportojnë në MASH, për çdo vit akademik, të dhënat bazë statistikore sipas skedarëve të përgatitur nga Drejtoria e Analizës, Statistikave dhe Planifikimit Strategjik (DASPS) në MASH.

2. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike, të ndjekin me përparësi respektimin e afateve kohore dhe saktësinë e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore në nivel fakulteti.

3. Të dhënat e përpunuara sipas skedarëve, të raportohen me shkresë zyrtare dhe në formë elektronike (në CD) pranë DASPS në MASH, në afatet e përcaktuara.

4. Institucionet e arsimit të lartë, publike dhe jopublike, të mbledhin dhe të përpunojnë të dhënat për:

- regjistrimet e studentëve në sistemin me kohë të plotë (*full-time*) dhe t'i raportojnë në MASH, jo më vonë se 30 nëntori;

- regjistrimet e studentëve për sistemin me kohë të shkurtuar (*part-time*, korrespondenca dhe edukimi në distancë) dhe t'i raportojnë në MASH jo më vonë se 30 janari (sipas skedarit bashkëlidhur-pasqyra A/ arsimit të lartë);

- përditësimet e regjistrimeve totale të studentëve sipas cikleve, sipas sistemit (*full-time/part-time*), sipas fakulteteve. Kjo e dhënë statistikore të dërgohet në MASH çdo javë të parë të muajve shkurt, mars, prill.

- përfundimet e vitit akademik për sistemin me kohë të plotë (për sesionin e korrikut) dhe t'i raportojnë në MASH jo më vonë se 20 gushti;

- përfundimet e vitit akademik për sistemin me kohë të plotë (për sesionin e korrik + vjeshtë) dhe t'i raportojnë në MASH jo më vonë se 30 tetori;

- përfundimet e vitit akademik për sistemin me kohë të shkurtuar (*part-time*, korrespondenca dhe edukimi në distancë) dhe t'i raportojnë në MASH, jo më vonë se 15 janar (sipas skedarit bashkëlidhur-arsimi i lartë- përfundime);

- regjistrimet e studentëve në konvikte t'i raportojnë në MASH, jo më vonë se 20 dhjetori;

- numri i studentëve që kanë përfituar bursë dhe t'i raportojnë në MASH, jo më vonë se 20 dhjetori;

- për stafin mësues-shkencor për sistemin me kohë të plotë dhe t'i raportojnë në MASH, jo më vonë se 30 nëntori.

5. Institucionet kërkimore-shkencore në varësi të MASH, të mbledhin dhe të përpunojnë të dhënat për personelin me tituj dhe grada shkencore dhe t'i dërgojnë në MASH jo më vonë se 15 nëntori.

6. Agjencia e Pranimeve të Reja në Institucionet e Arsimit të Lartë (APRIAL), në përfundim të procesit të regjistrimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, të dërgojë në MASH të dhënat statistikore mbi numrin e pranimeve të reja sipas programeve të studimit e fakulteteve në institucionet e arsimit të lartë publik, jo më vonë se 15 dhjetori.

7. DASPS të dërgojë në Institucionet e arsimit të lartë, publike e jopublike, në formë elektronike (me CD), të gjitha modelet e skedarëve përkatës për raportim, si dhe të kryejë trajnimin



e specialistëve të statistikës të institucioneve të arsimit të lartë, publik dhe jopublik, jo më vonë se 30 prilli.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Analizës, Statistikave dhe Planifikimit Strategjik; Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat në MASH, IKT, AVA, APRIAL, DAR/ZA dhe institucionet e arsimit të lartë publike dhe jopublike.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, datë 21.3.2010, faqe 812*

## SISTEMI I EDUKIMIT NË DISTANCË

Regjistrimet e studentëve në fillim të vitit akademik për sistemin e edukimit në distancë

Të dhënat identifikuese: 2009-2010

### A. Numri i studentëve të regjistruar sipas viteve të studimit

Regjistrimet e studentëve në fillim të vitit akademik për Sistemin e Edukimit në Distancë Të dhënat identifikuese 2009-2010		Viti i parë		Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt				Viti i pesë				Viti i gjashtë					
		Gjithsej		Fëmijë		Të huaj		Gjithsej		Fëmijë		Të huaj		Gjithsej		Fëmijë		Të huaj		Gjithsej		Fëmijë		Të huaj	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
<b>1. FAKULTETI I</b> .....																									
1. Titulli i Programit të Studimit 1																									
2. Titulli i Programit të Studimit 2																									
3. Titulli i Programit të Studimit 3																									
4. ....																									
<b>2. FAKULTETI II</b> .....																									
1. Titulli i Programit të Studimit 1																									
2. Titulli i Programit të Studimit 2																									
3. ....																									

### B. Numri i studentëve të regjistruar sipas grupmoshave

1. FAKULTETI I	Moshë 18 vjeç				Moshë 19 vjeç				Moshë 20 vjeç				Moshë 21 vjeç				Moshë 22 vjeç				Moshë 23 vjeç				Moshë 24 vjeç				Moshë 25 vjeç			
	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj				
1. Titulli i Programit të Studimit 1	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra				
2. Titulli i Programit të Studimit 2																																
3. Titulli i Programit të Studimit 3																																
4. ....																																
<b>2. FAKULTETI II</b> .....																																
1. Titulli i Programit të Studimit 1																																
2. Titulli i Programit të Studimit 2																																
3. ....																																

Moshë 26 vjeç				Moshë 27 vjeç				Moshë 28 vjeç				Moshë 29 vjeç				Moshë 30-34 vjeç				Moshë 35-39 vjeç				Moshë 40 vjeç e lart			
Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj	Studentë	Të rinj
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra



## PASQYRA A / LART.1 SISTEMI I KORRESPONDENCËS

Regjistrimet e studentëve në fillim të vitit akademik për sistemin e edukimit në distancë  
Të dhënat identifikuese: 2009-2010

### A. Numri i studentëve të regjistruar sipas viteve të studimit

UNIVERSITETI : .....		Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt				Viti i pestë				Viti i gjashtë			
		Gjithsej		Fshali		Te huaj		Gjithsej		Fshali		Te huaj		Gjithsej		Fshali		Te huaj		Gjithsej		Fshali		Te huaj	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
<b>1. FAKULTETI I</b> .....																									
1. Titulli i Programit të Studimit 1																									
2. Titulli i Programit të Studimit 2																									
3. Titulli i Programit të Studimit 3																									
4. ....																									
<b>2. FAKULTETI II</b> .....																									
1. Titulli i Programit të Studimit 1																									
2. Titulli i Programit të Studimit 2																									
3. ....																									

### B. Numri i studentëve të regjistruar sipas grupmoshave

UNIVERSITETI : .....		Mosha 18 vjeç				Mosha 19 vjeç				Mosha 20 vjeç				Mosha 21 vjeç				Mosha 22 vjeç				Mosha 23 vjeç				Mosha 24 vjeç				Mosha 25 vjeç			
		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj	
		Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra		
<b>1. FAKULTETI I</b> .....																																	
1. Titulli i Programit të Studimit 1																																	
2. Titulli i Programit të Studimit 2																																	
3. Titulli i Programit të Studimit 3																																	
4. ....																																	
<b>2. FAKULTETI II</b> .....																																	
1. Titulli i Programit të Studimit 1																																	
2. Titulli i Programit të Studimit 2																																	
3. ....																																	

Mosha 26 vjeç				Mosha 27 vjeç				Mosha 28 vjeç				Mosha 29 vjeç				Mosha 30-34 vjeç				Mosha 35-39 vjeç				Mosha 40 vjeç e lart				
Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		Studentë		Të rinj		
Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	







**UDHËZIM**  
**Nr.25, datë 2.8.2010**

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 9.5.2008 “PËR VEPRIMTARINË E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 47, pikat 1 dhe 2, dhe 50, pika 4, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

I. Në udhëzimin nr.20, datë 9.5.2008 “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 7 shtohen pikat 7.1 dhe 7.2, si më poshtë:

“7.1 Për institucionet e arsimit të lartë që procesin mësimor të ciklit të parë nuk e kanë të organizuar në leksione dhe seminare, 1 (një) orë mësimore konvertohet me koeficientin 1.4.

7.2 Për programin e doktoratës, 1 (një) orë mësimore (60 minutëshe) konvertohet me koeficientin 2.5.”.

2. Pas pikës 12.1 shtohet pika 12.2, si më poshtë:

“12.2 Pagesa për udhëheqjen e doktoraturës është 90 orë mësimore/vit dhe për oponencë teze doktorature është 20 orë mësimore/oponencë.”.

II. Ngarkohen institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**

*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, datë 26.7.2010, faqe 5794*